

ENVER HOXHA

VEPRA

3

PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI !

ENVER HOXHA

VEPRA

BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE
SHQIPERISE



ENVER HOXHA

gusht 1944

PARATHËNJE PËR VËLLIMIN 3

Në vëllimin 3 të Veprave të shokut Enver Hoxha hyjnë raporte, fjälime, artikuj, mesazhe, nota, telegrame¹, etj., të periudhës 1945—1946.

Në veprat e kësaj periudhe është përpunuar vija politike e Partisë në kushtet e krijuara pas fitores së Luftës nacional-çlirimtare, janë hedhur bazat e programit për rindërtimin dhe ndërtimin socialist të vendit.

Aty dalin në pah përpjekjet e Partisë për ruajtjen dhe për forcimin e pushtetit të ri popullor, si problemi qendror i revolucionit, për organizimin dhe përsosjen e tij në përshtatje me kushtet e reja të pasçlirimit; lufta për forcimin dhe modernizimin e ushtrisë dhe të organeve të tjera të diktaturës së proletariatit.

Në këto vepra janë pasqyruar politika e jashtme marksiste-leniniste e Partisë, qëndrimi i saj internacionalist për forcimin e miqësisë dhe të bashkëpunimit me Bashkimin Sovjetik, për ndërtimin e marrëdhënjeve vëllazërore me popujt e vendeve që kishin vendosur demokracinë popullore pas fitores mbi fashizmin, vendosmëria e Partisë për të mbrojtur fitoret e revolucionit

¹ Në këtë vëllim nuk janë përfshirë të gjitha notat, telegramet si dhe korrespondenca e shokut Enver Hoxha si Kryeministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme.

popullor nga synimet dhe veprimitaria armiqësore e imperialistëve amerikanë dhe anglezë dhe për të sigruar në arenën ndërkombe të gjitha të drejtat që populli shqiptar kishte fituar me luftë.

Të gjitha këto vepra përshkohen nga lufta për ruajtjen e pastërtisë së vijës politike, për forcimin e unitetit të radhëve të Partisë dhe për ruajtjen e pavarësisë dhe të qenjes së saj. Veprat e vëllimit 3 janë një dëshmi e qartë e luftës parimore të shokut Enver kundër gjithë shifaqjeve të oportunizmit, janë gjithashtu një dëshmi e qëndresës kundër synimeve antimarksiste dhe antishqiptare të udhëheqjes jugosllave, qëndresë që në vitet e ardhme do të shndërrrohej në një luftë të madhe parimore kundër revizionizmit jugosllav.

2

**NOTË DREJTUAR QEVERIVE TË SHTETEVE
ALEATE, ANGLISË, BASHKIMIT SOVJETIK DHE
AMERIKËS, NË EMËR TË QEVERISE DEMOKRATIKE
TË SHQIPËRISË ME ANËN E SË CILËS
KËRKOHET TË NJIHET QEVERIA DEMOKRATIKE
E SHQIPËRISË DHE TË VENDOSEN MARRËDHËNJE
DIPLOMATIKE**

4 janar 1945

Zotit Çërcill, Kryeministër i Britanisë së Madhe.

Zotit President të Komisarëve të Popullit të BRSS,
Mareshal i Bashkimit Sovjetik, Stalin.

Zotit Ruzvelt, President i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në emër të Qeverisë Demokratike të Shqipërisë kam nnderin t'Ju parashtroj sa vijon:

Më 7 prill 1939, kur trupat e Musolinit zbarkuan në Shqipëri, populli shqiptar i priti me armë duke i treguar kështu gjithë botës se ai nuk pranoi okupacionin e ven-

dit të tij nga i huaji. Në pak kohë ai u organizua dhe u hodh në luftë të hapët kundër okupatorit fashist.

Në shtatorin e 1942-së luftëtarë nga më të shquar të këtij populli u mblodhën në Konferencën e Pezës, ku pa dallim feje, krahine dhe ideje u bashkuan nën udhëheqjen e Këshillit të Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar për një luftë të ashpër e të paprerë kundër okupatorit dhe tradhëtarëve. Aty populli shqiptar, me zërin e luftëtarëve, shfaqi besimin e patundur në fitoren e aleatëve të mëdhenj anglo-sovjeto-amerikanë, shfaqi besimin e patundur në fitoren e popujve dhe të kombeve liridashës.

Deklaratat e mirënjojura të ministrave të punëve të jashtme të Britanisë së Madhe, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Sovjetik, bërë në dhjetor të vitit 1942¹, qenë një mbështetje e madhe morale e politike për luftën e popullit tonë dhe një premtim për sigurimin e lirisë dhe të pavarësisë, që fituan me luftë dhe me përpjekje. Lufta e aleatëve të mëdhenj qe për popullin shqiptar një garanci për fitore...

Duke pasur besim e bindje në kauzën e madhe të blokut antifashist, duke pasur besim e bindje në kauzën e shenjtë të çlirimt kombëtar, populli ynë vazhdoi luftën pa pushim dhe krah për krah me aleatët e mëdhenj e me popujt e tjerë liridashës. Në këtë luftë po-

¹ Është fjala për deklaratat zyrtare të BRSS, të SHBA dhe të Britanisë së Madhe të bëra në dhjetor 1942, me anën e të cilave njihej lufta e popullit shqiptar kundër pushtuesve fashistë.

pulli ynë u bashkua, u forcua dhe u organizua si kurrë ndonjëherë.

Në luftë për liri dhe demokraci populli shqiptar organizoi një ushtri kombëtare antifashiste, që është rritur e formuar me idéalin e demokracisë, me vëllazërimin e armëve si me aleatët e mëdhenj, ashtu dhe me popujt fqinjë që luftojnë kundër të njëjtit armik.

Në luftë për liri dhe demokraci, në luftë kundër pushtuesit dhe tradhëtarëve të vendit, populli shqiptar farkëtoi bashkimin kombëtar.

Kongresi i Përmetit dhe Mbledhja e Beratit¹ qenë kurorëzimi i kësaj përpjekjeje dhe lufte pesëvjeçare. Ata i dhanë Shqipërisë një pushtet të ri, një qeveri demokratike, një qeveri që është shprehja më autentike e vullnetit të gjithë popullit shqiptar, një qeveri që ka në gjirin e saj njerëzit më të sprovuar në këtë luftë çlirimtare antifashiste.

Qeveria Demokratike e Shqipërisë ka mbështetjen e gjithë popullit shqiptar të bashkuar në Frontin Nacional-Çlirimtar.

Sot që Shqipëria u çlirua, Qeveria Demokratike e Shqipërisë është e vetmja që përfaqëson Shqipërinë si brenda, ashtu dhe jashtë. As brenda, as jashtë Shqipërisë nuk ka kush e kundërshton faktin e qenjes së qeverisë sonë. Autoriteti i qeverisë sonë shtrihet sot mbi të gjitha

¹ Kongresi I Antifashist Nacional-Çlirimtar u mbajt në Përmet më 24 maj 1944, ndërsa Mbledhja e dytë e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar u thirr në Berat më 20 tetor 1944.

krahinat e Shqipërisë, mbi të gjithë popullin shqiptar.

Qeveria Demokratike e Shqipërisë i ka shpallur botërisht principet e saja demokratike, ka shpallur gjithashtu se është e vetmja që mbron dhe siguron të drejtat e njeriut.

Besnikërinë ndaj aleancës së madhe anglo-sovjeto-amerikane qeveria jonë e ka shpallur botërisht. Ushtria jonë jo vetëm që çlroi vendin tonë, por ka luftuar kundër ushtrive gjermane për kauzën e aleancës së madhe edhe në tokat e Jugosllavisë.

Qeveria Demokratike e Shqipërisë, shprehja e vërtetë e vullnetit të kombit e të popullit shqiptar, do të vazhdojë të forcojë aleancën e madhe të blokut antifashist si dhe raportet e miqësisë që e lidhin popullin shqiptar me popullin tuaj të madh.

Si sot për fitoren definitive mbi fashizmin dhe për ndërtimin e vendit tonë, ashtu dhe nesër për të sigruar demokracinë dhe paqen në botë, qeveria jonë do të qëndrojë besnike e singertë e kauzës së demokracisë dhe të indipendencës së popujve, besnike e frymës së Kartës së Atlantikut dhe të konferencave të Moskës e të Tëheranit.

Për të mbajtur, për të konsoliduar dhe për të përforcuar marrëdhënjet e miqësisë, që kanë lindur në luftën e përbashkët kundër fashizmit, për të forcuar bashkëpunimin në mes të Shqipërisë dhe të aleatëve të mëdhenj, kam nderin t'Ju shfaq vullnetin e popullit shqiptar që Qeveria Demokratike e Shqipërisë të njihet në radhë të parë nga ana e aleatëve të mëdhenj anglo-

-sovjeto-amerikanë dhe të vendosen marrëdhënje diplo-matike në mes të qeverisë Suaj dhe të qeverisë sonë.

Pranoni, zoti President, përshëndetjet e mia më të shquara.

Kryetari i Këshillit të Ministrave të
Qeverisë Demokratike të Shqipërisë
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 11,
4 janar 1945*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 11,
4 janar 1945*

USHTRIA NACIONAL – ÇLIRIMTARE MBUROJA E POPULLIT DHE E ATDHEUT¹

24 janar 1945

Me gjithë shpirtin luftarak të popullit tonë, i cili ka luftuar kurdoherë kundër armiqve të panumërt që kërkonin ta shtypnin dhe ta zhduknin, në vendin tonë ka munguar tradita e një ushtrie të organizuar. Populli ynë ka luftuar kurdoherë me çeta dhe në formë guerrilesh. Këto çeta, sidomaj që më të shumtën e herës të frymëzuara me ndjenja patriotike, s'kishin arritur kurrë të bëheshin themelia e një ushtrie të organizuar. Regjimi i Zogut krijoi një ushtri parade dhe parazite, ku vetëm ana formale ishte e theksuar dhe kjo mbyste çdo virtyt tjetër që kishte mundësi të zhvillohej në të. Ushtria e Zogut ishte një ushtri e tipit mesjetar. Në atë mbretëronte korrupsioni, akraballëku, spiunazhi, xhahillëku dhe tradhëtia. Në të zhvillohej ndjenja antikombëtare dhe anti-popullore. Regjimi i Zogut bënte çmos ta mbante ushtrinë larg «politikës», për ta pasur një armë të verbër në duart e tij për të shtypur popullin. Këtë ushtri populli ynë e urrente dhe bënte çdo gjë për të mos shkuar

¹ Artikull botuar në gazeten «Bashkimi».

ushtar. Ushtria e Zogut i dha frytet e saja: ajo, në vend që të bëhej mburoja e vendit në momentet e kritikshme, u shpartallua, u shkri përnjëherë dhe mbetën mbi ujë vetëm ata pak elementë përparimtarë, të cilët në kohën e regjimit të Zogut persekutoheshin dhe burgoseshin, sepse duke qenë djem të popullit dhe të ndërgjegjshëm, përpinqeshin ta ndërronin fryshtat e asaj ushtrie të krimbur.

Lufta nacional-çlirimtare kundër fashizmit krijoj ushtrinë e re, ushtrinë e vërtetë të popullit, me fryshtat e re e me kuadro të rinj, me kuadro të pastër e të ndërgjegjshëm, që u provuan në zjarrin e betejave të përgjakshme dhe jo në dancinge e në kafehane. Ushtria jonë Nacional-Çlirimtare, trashëgimtarja e vërtetë e virtyteve luftarake të popullit, po hyn në radhën e ushtrive të tjera të popujve përparimtarë të Evropës. Themelet e Ushtrisë Kombëtare u hodhën në këtë luftë dhe u vaditën me gjak. Ushtria jonë u formua nga populli, i cili vendosi më mirë të vdiste me ndër, se sa t'i nënshtrohej okupatorit dhe tradhëtarëve. Pra, ajo përfaqëson vullnetin dhe aleancën e madhe të fshatarëve, të punëtorëve dhe të intelektualëve të Shqipërisë, të cilët të bashkuar si një trup, luftuan për lirinë dhe për një jetë të re e të lumtur.

Bijtë e popullit erdhën në ushtri si bletë e plotë. Populli sakrifikoi çdo gjë për të: fshatari ynë përveç kafshatës së gojës, i bëri hallall ushtrisë dhe Shqipërisë edhe djalin e vogël 14-vjeçar, i cili luftoi si luan. Nënët e Kurveleshit heroik u thonin djemve të tyre: «Ngjishni shpejt gjerdhanët se erdhi dita të shpëtojmë popullin dhe Shqipërinë». Ato gra trimëresha të maleve tona,

që çirrnin shamitë e kokës e lidhnin plagët e partizanëve, u thonin foshnjave të tyre: «Sonte s'keni bukë, se atë kulaç të vogël që kemi, do t'ja japidh partizanëve që kthehen nga përpjekja». Një dashuri e pafund lindi në mes të ushtrisë dhe të popullit. Këta u lidhën ngushtë me njëri-tjetrin, u lidhën me gjak, me ndjenja, nga një ideal. Ushtria jonë u bë vendi, ku gjetën shprehje ndjenjat dhe aspiratat e bijve të popullit, të ndrydhura dhe të përbuzura nga regjimet e tiranisë, ajo u bë vend nderi e lavdie, se ajo u bë mburoja e lartë dhe e çelniktë e atdheut dhe e popullit.

Repartet e ushtrisë sonë, që lindën dhe u rritën në luftë, u edukuan gjithashtu me parimet e shëndosha të një ushtrie që shkonte me hapë të mëdha drejt modernizimit. Partizanët tanë të njësive dhe të çetave të para u edukuan në batalione dhe në brigada, ata mësuan taktilët e luftës dhe e përdorën në një mënyrë të mrekullueshme. Nevoja e luftës dhe të ndodhur përballë një armiku të egër, me tradita të mëdha ushtarake dhe i armatosur deri në dhëmbë, e bënë partizanin dhe oficerin e ri të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare të ndërgjegjshëm për detyrën e rëndë. Ata kuptuan se përveç vetëmohimit dhe guximit, që s'u mungonte, duhej t'u nënshtronsheshin të gjitha urdhërave dhe direktivave. Kështu lindi dhe respekti ndaj komendantëve dhe komisarëve, lindi disiplina e hekurt ushtarake dhe njëkohësisht e vetëdijshme. Zmadhimi i ushtrisë, rriti nevojat e saj, kriroi nevojën e ndërlidhjes moderne, organizimin e informacionit dhe të furnizimit, kriroi nevojën e seksioneve drejtuese në shtabet e ulëta dhe të larta.

Kjo ushtri e madhe dhe e lavdishme e popullit tonë,

që i bëri ballë stuhisë dhe që mundi italianët, gjermanët e kuislingët, po modernizohet dhe forçohet dita-ditës.

Populli ynë është krenar për ushtrinë e tij që e do me gjithë shpirt, është krenar dhe përulet me respekt përpara atij partizani të thjeshtë që e sheh me pushkë në krah. Populli ynë me një dashuri të patreguar i hap zemrën oficerit të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, i cili para tre vjetësh ruante bagëtinë në male, ose rrihte hekurin në kovaçanë, e që për tre vjet rrësht i theu oficerët italianë e gjermanë, i mundi ndër beteja dhe doli fitimtar. Oficerët tanë skuqen prej modestie kur shohin gradat e tyre që kanë në supe; populli ynë i adhuron, sepse e di që ata janë bijtë e tij të thjeshtë dhe heroikë, që e shpëtuan nga kthetrat e armikut, dhe që do ta mbrojnë me çdo kusht atë dhe pushtetin e tij.

Vetëm armiqjtë e kanë halë në sy ushtrinë tonë. Reaksionarët e poshtër, tradhëtarët e «Ballit» dhe të «Legalitetit» bënë çmos që ta pengonin formimin e kësaj ushtrie. Ata tok me gjermanët u lëshuan në ofensiva të tmerrshme kundër saj për me e shfarosë, se ishte një rrezik për ta, se do t'ua prishte planet sikundërqë ua prishi. Mbeturinat e këtij reaksiioni s'i kanë hedhur armët, por vazhdojnë punën e tyre tradhëtare në forma të ndryshme. Objektivi i tyre kryesor qëndron kurdoherë ushtria, ajo ushtri që i shpartalloi ushtarakisht, ajo ushtri që do t'i shfarosë nga rrënjet. Reaksionarët që i kanë shpëtuar dorës së hekurt të drejtësisë, pseudodemokratët dhe pseudointelektualët, njerëzit e kafeneve dhe të spekulimeve, agjentët e regjimeve të kaluara dhe të reaksiionit ndërkombëtar, që kujtojnë se do të shpëtojnë nga grushti i rëndë që do të bjerë mbi kokët e ty-

re, lëshojnë parulla kundër ushtrisë sonë. Këtyre njerëzve të turpit dhe të korruptionit, që për kolliuqe dhe për rehate, kanë ndihmuar okupatorin dhe tradhëtarët, u ardhka keq e u therka zemra «për të shkretët partizanë» që nuk «çmobilizohen». «Ç'na duhet kjo ushtri tani që u çlirua Shqipëria» thërrasin, «tani t'i hedhim arniët dhe të marrim kazmat dhe lopatat», «ç'na duhet ne që të vazhdojmë luftën me gjermanët», «ç'na duhet ne ky mobilizim që po bëhet». Me të vërtetë mbeturinave të reaksionit s'u duhet kjo ushtri dhe as që u ishte dashur kurrë, se ajo i ndaloj të sundonin dhe të spekulonin. Ata dëshirojnë demobilizimin e ushtrisë që të mëkëmben dhe të fillojnë punën e vjetër në kurriz të popullit, ata dëshirojnë që ortaku i tyre, gjermani, të zgjatë jetën dhe t'i lërë rast reaksionit tonë dhe atij ndërkombëtar të marrë veten dhe të mëkëmbet.

Por populli dhe pushteti i tij mendon ndryshe; kurdoherë ka menduar ndryshe nga ata dhe, tamam përkëtë arësy, ai rröku armët, luftoi, fitoi dhe tani do të vendosë vullnetin e tij. *Ushtria jonë nuk i lëshon armët derisa të zhduket dhe rreziku më i vogël për popullin. Ushtria jonë do të forcohet, do të çelnikoset edhe më shumë, ajo do të jetë mbrojtësja e fitoreve të popullit, mbrojtësja e ndërtimit të ri të vendit.* Populli do t'i shqelmojë parullat e helmatisura të mbeturinave të reaksionit dhe ushtria e tij do të kalojë mbi kufomat e shushunjave të popullit. Për këtë vepër të madhe që ka kryer ushtria jonë, e për këtë që do të kryejë në të ardhmen, populli ynë e ka rrethuar me dashuri të madhe Ushtrinë e tij Nacional-Çlirimtare, ai do të japë çdo gjë për të, se ajo është arma e tij e fortë që do ta mbrojë

nga çdo rrezik. Dhe ushtria nga ana e saj do të japë çdo gjë për popullin, do të japë gjakun e vët sikundërqë s'e ka kursyer, dhe me një harmoni të plotë e me një dashuri të madhe për shoqi-shoqin, ushtri e popull do të shkijnë drejt idealeve shekullore të popullit tonë, të heronjve të Rilindjes dhe të luftës antifašiste që ranë në fushën e nderit për të mbërritur në këtë ditë të lumtur që populli ynë i shumëvaujtur të marrë në duart e tij frenat e qeverimit dhe t'i mbajë përgjithmonë.

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 28,
24 janar 1945*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 28,
24 janar 1945*

VASIL SHANTO¹

1 shkurt 1945

Një mot më parë, buzë Liqenit të Shkodrës ra dëshmor në fushën e nderit dhe në krye të detyrës luftëtari i shquar Vasil Shanto. I ngarkuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë me një mision jashtëzakonisht të rrezikshëm dhe me rëndësi, përmes reaksionit më të egër, në kohën kur ofensiva e dimrit kishte filluar, përmes maleve të mbuluara me borë, ai shkoi dhe e kreua detyrën që i qe ngarkuar. Ai luftoi orë të tëra me armiqtë e shumtë që e rrethuan.

U shkëput nga gjiri ynë luftëtari i palodhur i çlirimt, një nga mbrojtësit dhe edukuesit e punëtorisë sonë, kandidati i Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë, Vasil Shanto.

Furxhiu Vasil Shanto, bir i popullit tonë fatkeq, që vuante të zezat e ullirit nga regjimet despotike, filloi luftën e tij të shenjtë me një bindje të plotë në fitoren, se klasa punëtore nga e cila ai dilte dhe ideali me të cilin ai ishte ushqyer dhe frymëzuar, ishin garancia më e

¹ Artikull botuar në gazeten «Bashkimi» me rastin e përvjetorit të parë të vrasjes së Vasil Shantos.

madhe e çlirimit tonë. Në kohërat më të errëta të regjimit zogist, kur po preqatitej robëria dhe invadimi, kur mbretëronte tmerri dhe litari, kur spiu nët e Musa Jukës përgjonin patriotët, shoku i Qemal Stafës, punëtori Vasil Shanto, punonte për popull, për liri. I palodhur dhe i guximshëm në furra e në kovaçana, në fshatra e në shkolla, Vasil Shantua, me fjalën e tij të zjarrtë, organizonte masat në kryengritje. Në sytë e Vasil Shantos pas-qyrohej shtypja e madhe që i bëhej klasës së tij dhe vullneti i hekurt për të dalë në dritë. Shpatullat e shëndosha të punëtorit Vasil Shanto, ishin të denja për një barrë kaq të rëndë.

Pas torturave në burgjet e Zogut¹, ai filloi luftën që në ditët e para të robërisë. Si një nga organizatorët e lëvizjes nacional-çlirimtare ai ishte në ballë të masave e të sabotazheve, ai ishte një nga organizatorët e parë të kryengritjes me armë. Ai ishte atje ku e lypte detyra, në vendet më të rrëzikshme, në betejat më të ashpra, në misionet më delikate. Ai ishte punëtor i vendosur që përfaqësonët vullnetin e çelniktë të Partisë së tij, të Partisë heroike Komuniste.

Sot në përvjetorin e vdekjes së tij, populli shqiptar, i çliruar nga thundra e barbarëve, kujton me mallëngjim bijtë e tij heroikë, kujton Vasil Shanton dhe shokët e tij, që ranë për këtë vend, që s'kursyen gjakun e tyre për çlirimin e popullit.

¹ Në fillim të vitit 1939 u arrestua si anëtar i Grupit Komunist të Shkodrës. Mbasit u gjykuva, u dënuva nga regjimi i Zogut me 19 vjet burgim të rëndë dhe u dërgua ta vuajë këtë dënim në Mbrezhdan të Beratit.

Furxhiun Vasil Shanto e ka në zemër populli shqiptar, e ka në zemër punëtoria trime shqiptare, e ka në zemër Partia Komuniste; kujtimi i të gjithëve, në këtë ditë përvjetori të rënjes së tij, shkon buzë Liqenit të Shkodrës dhe prej të gjithëve ngrihet thirrja: LAVDI TË PËRJETSHME HERONJVE TANË TË RËNË NË FUSHËN E NDERIT PËR ÇLIRIMIN E ATDHEUT!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 35,
1 shkurt 1945*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 35,
1 shkurt 1945*

PËRSHËNDETJE PIONIERËVE TË TIRANËS ME RASTIN E MANIFESTIMIT TË TYRE PËR JAVËN E RINISË BOTËRORE

27 mars 1945

Shoqe dhe shokë të vegjël,

Jam shumë i gjëzuar që edhe ju merrni pjesë në manifestime të ndryshme të Javës së Rinisë Botërore. Këto manifestime më prekin së tepërmi se bëhen prej jush që, në kohërat më të këqia, keni qëndruar të fortë dhe besnikë në përpjekjet për çlirimin e vendit.

Ne mburremi me ju, pse ju jeni brezi që do ta bëni Shqipërinë të lumtur. Qeveria do të vërë gjithë forcën që të bëheni të denjë për atdheun, do t'ju lehtësojë hallet dhe vuajtjet e gjertanishme dhe do t'ju sigurojë të gjitha mjetet për të studjuar në shkollë.

Sic keni qenë të fortë dhe të patrembur gjatë luftës, ashtu duhet të tregoheni edhe tani për rindërtimin e vendit.

Populli ka shumë nevojë për ju, prandaj unë ju këshilloj të shkoni në shkollë rregullisht, t'u bindeni më-

suesve e prindërve dhe të përpinqeni sa të jetë e mundur
të mësoni më tepër.

Rrofshin pionierët e Tiranës!

*Botohet sipas tekstit të bro-
shurës «Komandanti — Pio-
nierëve». Tiranë 1947*

K E R K E S E

DREJTUAR TRE KRYETAREVE TË FUQIVE TË
MEDHA: KRYEMINISTRIT ÇERÇILL, MARESHALIT
STALIN DHE PRESIDENTIT RUZVELT NË LIDHJE
ME PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË
KONFERENCËN E SAN-FRANÇISKOS¹

31 mars 1945

Shkëlqesë,

Duke shprehur dëshirën dhe vullnetin e popullit shqiptar, në emër të Qeverisë Demokratike të Shqipërisë, kam nderin t'i kujtoj Shkëlqesës Suaj, faktin që asnjë ftesë nuk i është drejtuar deri sot Qeverisë Demokratike të Shqipërisë për të marrë pjesë në Konferencën e San-Françiskos. Ndër shtetet që kanë luftuar krah për krah me shtetet aleate për të mposhtur Gjermaninë hitleriane, Shqipëria zë një vend të rëndësishëm për hir të luftës së pareshtur që ka bërë kundër armikut të përbashkët dhe

1 Konferenca e San-Françiskos, në të cilën morën pjesë përfaqësuesit e 50 shteteve, zhvilloi punimet nga 25 prill — 26 qershor 1945. Ajo aprovoi Kartën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

për hir të sukseseve që kanë kurorëzuar përpjekjet dhe sakrificat e saja të panumërtë. Me hidhërim konstatoj se shtete të tjerë, të cilët nuk kanë dhënë asnjë kontribut në këtë luftë, janë ftuar me kohë dhe preqatiten të dërgojnë përfaqësitë e tyre në San-Françisko. Kjo është një arësye më tepër që provon se pjesëmarrja në Konferencën e San-Françiskos i takon me të drejtë Qeverisë Demokratike të Shqipërisë, e cila është shprehja më e gjallë e popullit tonë heroik që meriton në çdo pikëpamje të japë gjithashtu kontributin e tij në rregullimin e çështjeve që i përkasin paqes së ardhshme të popujve, ashtu sikurse nuk ka kursyer në kohë lufte gjakun e tij përkauzën e përbashkët.

Duke shpresuar se do të jepen dispozitat e nevojshme për të ftuar Shqipërinë në Konferencën e lartpërmendur, i lutem Shkëlqesës Suaj që të ketë mirësinë të pranojë sigurimet e konsideratës sime më të lartë.

Kryetari i Këshillit të Ministrave të
Qeverisë Demokratike të Shqipërisë
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 85,
31 mars 1945*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 85,
31 mars 1945*

FJALA NË KONGRESIN E DYTE TË RINISE

16 prill 1945

Të dashur shokë dhe shoqe të rinisë,

Në emër të Qeverisë sonë Demokratike dhe në emër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, po i sjell Kongresit të dytë të Rinisë Antifashiste dhe gjithë Rinisë Antifashiste Shqiptare përshëndetjet tona më të nxehta dhe mirënjojen e mbarë popullit për sakrificat mbinjerëzore që ka bërë për çlirimin e vendit dhe për energjitë e pashteruara, që ka hedhur pa kursyer në balancën e luftës për rindërtimin e atdheut tonë të shkatërruar nga lufta.

Kur horizonti ndërkombëtar ishte i errët dhe bishat fashiste ishin vërsulur të mbytnin popujt, në një vend të vogël të Ballkanit, si ishte vendi ynë, krisi pushka e parë e çlirimit, u derdh gjaku i rinisë sonë, që u bë pishtar i luftës mbinjerëzore të një populli të vogël martir. Atdheu ishte në rrezik, populli ynë mund të shfarosej, do të merrej nëpër këmbë çdo gjë e shenjtë që kishim. Përpara kësaj katastrofe të pashmangshme populli ynë shtërngoi dhëmbët dhe zemrat u çuan peshë, populli ynë grumbulloi energjitë e vetë dhe u vërsul në luftë të pabarabartë po me besim të patundur në fitoren. Dhe ju,

brezi i ri i vendit tonë, ju, o shokët e mi të luftës, u çuat të gjithë më këmbë, ju ishit në vijat e para, atje ku e lypët detyra e shenjtë dhe nderi i atdheut. Detyrat që ju viheshin përpara ishin të rënda dhe moskryerja e tyre ishte vetëvrasje për popullin tonë. Ju e kuptuat menjëherë se momentet ishin kritike, dhe pa u frikësuar nga përgjegjësitë e mëdha që merrnit përpara popullit tonë dhe përpara historisë, i dualët zot atdheut dhe shkruat faqet e shkëlqyera të historisë sonë. Ju luftuat si trima, shokët tuaj ranë si heronj. Në fushën e nderit.

Pas kaq vjet lufte të ashpër dhe të paprerë, në e çliruam popullin tonë nga një robëri e tmerrshme, nga një armik i egër, nga tradhëtarët e poshtër. Lufta jonë çlirimtare ishte epopeja e lavdishme e një populli të tërë, që me shekuj ishte skllavëruar dhe munduar, shnderuar dhe gjakosur prej imperialistëve të huaj dhe prej klikave tradhëtarë të vendit, prej politikanëve të shitur kokë e këmbë te të huajt, prej njerëzve me shumë flamuj në xhep.

Lufta jonë antifashiste kundër brigandëve fashistë gjermanë ishte shprehja e dufit të madh revolucionar të popullit, i cili u ngrit më këmbë për të përmbysur një herë e përgjithmonë botën e poshtërsive e të intrigave dhe për të ngritur një botë të re, botën e lirisë dhe të demokracisë.

Lufta që na u imponua nga fashizmi italian dhe nga Gjermania naziste ishte e pamëshirshme, ishte totale. Përveç zjarrit dhe hekurit që ai derdhi mbi popullin tonë, armiku grumbulloi rrëth vetes për këtë vepër gjaksore gjithë të poshtrit e vendit tonë, i organizoi, i armatosi dhe i lëshoi në luftën vëllavrasëse. Përballuam dy

fronte të tmerrshme: frontin e armikut dhe atë të tradhëtisë, të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin dhe të betuar të shfarosnin rezistencën, Ushtrinë Nacional-Çlirimtare, të shfarosnin popullin tonë. Po qëllimi i tyre dështoi, sepse populli shqiptar rezistoi me një energji të çuditshme; ai u grumbullua në Frontin Nacional-Çlirimtar, ai mbushi radhët e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare dhe hodhi çdo gjë në balancën e luftës, se atje e shihte shpëtimin e sigurt.

Populli ynë fitoi në këtë luftë antifashiste, pse diti të zgjedhë rrugën e vërtetë, rrugën e drejtësisë, ai diti të dallojë miqtë nga armiqtë. Populli ynë kurrën e kurrës s'ka qenë me okupatorin, por në luftë me të, kurrën e kurrës s'ka qenë me kuislingët, por në luftë me ta. Çdo vepër të tyre, çdo akt zyrtar, çdo tentativë të tyre, që synonte të konfondonte popullin tonë me kuislingët dhe okupatorin, populli ynë e ka luftuar me tèrbim; populli ynë ka derdhur gjak për të hapur hendekun e madh që e ndan nga të shiturit që tradhëtuan kauzën e tij. Këtë e di gjithë bota dhe askush nuk do të ketë guximin dhe paturpësinë ta mohojë. Gjithë bota e di se sa ngushtë ishte lidhur populli ynë me aleatët tanë të mëdhenj: Bashkimin e madh Sovjetik, Anglinë dhe Amerikën, se sa me shpirt e me zemër luftoi për kauzën e përbashkët aleate, se sa gjak derdhi ky popull i vogël për një kauzë kaq të madhe. Se sa të larta janë ndjenjat e popullit tonë, dhe sa mirë e ka kuptuar populli ynë aleancën me të gjithë ato shtete e kombe, që luftojnë me të vërtetë fashizmin, e provon luftë jonë që kemi vazhduar dhe po e vazhdojmë gjer në fund jashtë tokave të atdheut tonë, e dëshmon gjaku i partizanëve shqiptarë

që derdhet tok me ushtrinë jugosllave¹. Dhe kjo aleancë është e natyrshme. Mendoni, o shokë të rinisë, ç'fat e priste popullin tonë dhe mbarë botën, po të mos ishte më këmbë, i fortë si çeliku dhe madhështor, vendi i madh i Leninit dhe i Stalinit, po të mos ishin popujt e Bashkimit Sovjetik, po të mos ishte Ushtria e Kuqe e lavdishme dhe komandanti gjenial i saj, strategu më i madh i kohërave të sotme, Mareshali Stalin. Pa dyshim vendi ynë dhe gjithë bota do të lëngonte për shumë kohë nën ligjet gjakpirëse, grabitqare dhe terroriste të Hitlerit, Himlerit, Gëringut, etj. Pa dyshim Ballkani do të ishte sheshi i intrigave dhe i dallavereve për elementë fashistë, shovinistë dhe reaksionarë, që përpiken akoma sot, po që u janë prerë krahët, të përfitojnë nga gjaku i popujve të Ballkanit, që është derdhur për liri dhe demokraci, dhe të mëkëmbin regjimet shtypëse dhe anti-popullore. Populli ynë s'mund të ndiqte tjetër rrugë përveçse atë të aleancës së madhe me popujt përparimtarë; populli ynë i ka treguar botës gjatë historisë së tij se di të vdesë për liri dhe për drejtësi.

Në këtë luftë antifashiste luftuam, derdhëm gjak, u dogjëm, u torturuam, u plaçkitëm prej fashistëve gjermanë dhe prej tradhëtarëve të «Ballit Kombëtar» e të

¹ Menjëherë pas çlirimtës së Shqipërisë me vendim të KQ të PKSH dhe me urdhër të Komendantit të Përgjithshëm, shokut Enver Hoxha, dy divizione të UNÇSH (V dhe VI) vazhduan ndjekjen e trupave hitleriane në Jugosllavi. Luftëtarët shqiptarë dhe luftëtarët jugosllavë, duke luftuar krah për krah kundër hordhive naziste, në dhjetor 1944 dhe janar—shkurt 1945 çliruan Malin e Zi, Sanxhakun dhe pjesën Jugore të Bosnjes dhe Hercegovinës.

«Legalitetit», por ne fituam lirinë dhe indipendencën, të cilat do t'i mbrojmë me gjak; ne ngritëm më këmbë, mbi gërmadhat e vendit tonë të vaditur me gjakun e dëshmorëve tanë, një pushtet të ri nga më demokratikët, një pushtet, ku e ka fjalën populli dhe vetëm populli. Ju e dini mirë, o shokë dhe shoqe të rinisë, sa gjak e djersë ka derdhur, sa vuajtje ka hequr dhe ç'sakrifica ka bërë mbarë populli për t'ja arritur kësaj dite dhe, pikërisht për këtë arësy edhe detyrat tona, sa të shenjta dhe të rënda kanë qenë, ashtu do të jenë kurdoherë, dhe ne do t'i kryejmë, se jemi djemtë e popullit dhe besnikë gjer në vdekje për të.

Në Mbledhjen historike të Beratit ne kemi thënë: «...do t'u tregojmë të gjithë pesimistëve se populli ynë dhe njerëzit e rinj që farkëton kjo luftë, aq sa dinë të luftojnë trimërisht për lirinë e vendit të tyre, do të dinë gjithashtu të punojnë e të ndërtojnë atdheun e tyre të shenjtë»¹. Kemi thënë gjithashtu: «Me vullnet të mirë dhe pa u lodhur të zhvillojmë punën për ngritjen e ekonomisë së vendit, ashtu si kemi vënë shpatullat për të luftuar okupatorin. Për këtë gjë nuk duhet vetëm djersë, por duhet të zhvillohet në mes të popullit ndjenja e solidaritetit dhe e ndihmës reciproke... Në këto kohë ai që ndihmon shokun ka ndihmuar veten e tij, ka ndihmuar ushtrinë, ka ndihmuar atdheun»². Dhe Qeveria jonë Demokratike, që është shprehja dhe vullneti i gjithë popullit tonë, qeveri dhe popull që janë një dhe të pandarë, kanë shkuar drejt kësaj rruge, kanë kapërcyer

¹ E. Hoxha, Vepra, vëll. 2, f. 349.

² E. Hoxha, Vepra, vëll. 2, f. 348-349.

pengesa të panumërtë dhe kanë korrur e po korrin suksesë të njëpasnjëshme në çdo lëmë aktiviteti. Pengesat kanë qenë të mëdha, thashë, se, me gjithë fitoren e plotë ushtarake dhe politike, armiqtë e popullit nuk fllinin. Mbeturinat reaksionare, pasuesit e «Ballit Kombëtar» dhe të «Legalitetit», që i kishin shpëtuar dorës së drejtësisë, punonin dhe fërkonin duart, duke thënë se shpejt do ta thyenim zverkun dhe do ta humbnim luftën për rindërtimin e vendit. Këta njerëz me mentalitete të vjetra reaksionare, që s'kishin nxjerrë aspak mësimme nga gjithë këto ngjarje që tronditën botën, ëndërrojn se gjoja me eksperiencën e tyre të madhe, që përmblidhej në grabitje dhe shtypje, do të na mundnin në luftën për rindërtimin e vendit. Por populli shqiptar dhe udhëheqësit e tij nuk e thyen zverkun, sepse koskën e kishin të fortë dhe kokën s'e kishin bosh. Populli ynë dhe qeveria e tij e dinin mirë se fidanishtja nuk mund të rritet dhe të lulëzojë, pa qëruar gjëmbat dhe ferrat, se pa shkulur nga rrënja fashizmin dhe pa shfarosur këlyshët e tij, s'ka demokraci, s'ka përparim. Dhe me drejtësinë më të madhe, që karakterizon popullin dhe luftën tonë, pushteti ynë demokratik u zgjati dorën të gjithë atyre që ishin të gabuar dhe të gënjyer nga armiku dhe nga tradhëtarët. Nga Mbledhja e Beratit u kemi thënë të gjithë këtyre njerëzve të ndërronin rrugë dhe metodë, në rast se u pëlqente që populli dhe pushteti të mos merrnin masa kundër tyre. Shumë prej tyre dëgjuan fjalën e pushtetit tonë, njohën rrugën e tyre të gabuar dhe ju përveshën punës ndërtimitare; disa, si Sulçe Beg Bushati, Dom Lazër Shantoja, Prenk Cali, Dom Ndre Zadeja, etj. tradhëtarë vazhduan rrugën e tradhëtisë dhe

morën dënimin e merituar nga populli ynë. Ashtu do ta pësojnë dhe të gjithë ata që do të cënojnë popullin dhe pushtetin e tij. Drejtësia e popullit triumfon anembanë Shqipërisë, ajo është në fuqi, e drejtë, humane dhe e pamëshirshme kundër kriminelëve të luftës dhe tradhëtarëve të atdheut.

Gjyqi i madh special që u zhvillua në Tiranë¹, ishte mishërimi i kësaj drejtësie të lartë. Populli pa atje, një muaj e gjysmë rresht, manevrat që ishin luajtur në kurrin e tij plot plagë, pa tragjedinë e tij, pa si ishin kurdisur nga tradhëtarët, terrori, vjedhjet, shnderimet, si ishte kurdisur tradhëtia, si ishte shitur shumë herë Shqipëria. Dhe përfaqësuesit e popullit të shumëvuanjtur, të atij populli që s'kurseu asgjë për atdheun, dënuan pa mëshirë tradhëtinë dhe falën ata njerëz të thjeshtë që ishin gënjer. Me këto vendime të drejta është lidhur lulëzimi i vendit tonë dhe e ardhmja e begatshme e brezave të rindë. Ky është objktivi ynë dhe drejt tij ne po shkojmë me hapa të mëdha. «Qentë le të lehin, karvani shkon përpara». Qeveria jonë dhe gjithë populli shqiptar rrëth saj i janë përveshur punës me bindjen e plotë në fitore. S'ishte aspak e lehtë të filloje punën në një vend, ku çdo gjë ishte shkatërruar dhe djegur, ku kishin kaluar hunët e kohërave moderne. Urat dhe rrugët ishin hedhur në erë, krahina të tëra ishin të izoluara nga njëra-tjetra, postave e telegrafeve s'u kishte mbetur shenjë. Këtej vareshin shumë gjëra vitale për vendin tonë. Qeveria hartoi planet e punës dhe këto plane u zbatuan me rigo-

¹ Ky gjyq, që u hap më 1 mars 1945 dhe vazhdoi deri më 13 prill 1945, gjykoi dhe u dha dënimin e merituar kriminelëve kryesorë të luftës dhe armiqve të popullit shqiptar.

rozitet. Populli i tërë dhe ju, o shokë të rinisë, me këngë në gojë, pa marrë parasysh se lodheshit tërë ditën dhe në mbrëmjet, shumë herë s'kishit bukë të hanit, derdhët djersën për këtë punë. Menjëherë pas dëbimit të okupatorit, për të bërë të mundshëm komunikacionin, u ndërtuan trape në lumenjt e Shqipërisë, u ndërtuan teleferikët mbi Osum, Seman dhe Shkumbin për transportimin e naftës dhe të vajgurit të Kuçovës. Njëkohësisht filloi rindërtimi i urave. Sot, me punën e djersën e popullit, janë ndërtuar ura e Librazhdit, e Murrashit, e Shijakut, e Limuthit, e Gjoles, Ura e Zezë dhe ura e Matit; është në ndërtim e sipër edhe ura e Kuçit, e Rrogozhinës, e «Hasan Beut», e Mifolit, e Penkovës dhe e Lezhës. Postat, telefoni dhe telegrafi kanë filluar të punojnë, po-thuaj në rregull. Shërbimi postar kryhet prej dyzet e tetë zyrave të PTT-së; shërbimi mandat-postar gjer tanë kryhet prej njëzet e tetë zyrave, gjithashtu janë krijuar deri tanë dhe funksionojnë dy herë në javë 12 linja postëmbartëse me automjete. Shërbimi telegrafonik funksionon në të gjitha zyrat e PTT-së të Shqipërisë, me përjashtim të disa pak qendrave, që janë në ngritje e sipër. Autotransportet tona kanë pasur dëme kolosale; më të shumtët armiku na i kishte shkatërruar dhe grabitur. Duhej një organizim i shëndoshë në këtë drejtim, duhej një kujdes i veçantë për kursimin e tyre, kërko-heshin dhe sakrifica nga ana e pronarëve të tyre. Për shumë prej tyre e kanë kuptuar se, pa sakrifica nuk çlirohej atdheu, nuk ndërtohet Shqipëria dhe për këtë gjë ata i vunë mjetet e tyre në shërbim të përgjithshëm.

Në fushën e ekonomisë u bë organizimi i kuadrit. Për t'i dhënë një impuls të ri industrisë, bujqësisë, bleg-

torisë, veterinarisë, pyjeve si dhe tregëtisë, janë dërguar në të gjitha qendrat më shumë se 200 agronomë, veterinerë, inxhinierë pyjesh, kontrollorë dhe janë marrë në shërbim gjithë teknikët disponibël. Në bujqësi është nxitur mbjellja e të lashtave, është këshilluar ndihma reciproke dhe kolektive dhe rezultatet janë të kënaqshme; traktorët janë vënë të punojnë sa më shumë toka, që të mos mbetet asnje pëllëmbë tokë pa u mbjellë; gjithashtu për punimin e tokave në Vlorë dhe në Pezë është dhënë karburant falas. Për t'u ardhur në ndihmë bujqve të dëmtuar nga lufta, po blihen nga ana e Ministrisë së Ekonomisë 800 kuintalë farë për ta shpërndarë në fshatarësinë e Vlorës dhe të Gjirokastrës. Fermat e shtetit janë organizuar dhe janë plotësuar me personel e mjete. Në fermën e Sukthit janë mbjellë 800 kuintalë farë grurë; tani po mbillet misër si dhe 250 kuintalë farë patate. Në fermën Xhafzotaj-Pjeshkës janë mbjellë 1 000 dynym me grurë. Në fermën e Cërrikut do të mbillen 800 dynym me misër. Në ferniën e Sukthit është hapur një kurs me 70 të rinj fshatarë, ku mësojnë njohuri agroteknike.

Qeveria është duke studjuar planin e zbatimit të reformës agrare¹. Katundarëve të mjeruar të të gjithë Shqipërisë, që brez pas brezi kanë derdhur lot e djersë, që kanë derdhur kaq gjak për këtë popull, u erdhi dita të marrin tokat, t'i punojnë për veten e tyre dhe jo për tjetrin, u erdhi koha të shohin ditë të lumtura.

¹ Qysh gjatë Luftës nacional-çlirimtare PKSH i kishte premtuar fshatarësisë se do të luftonte për zgjidhjen e çështjes agrare dhe kishte marrë masat pregitore. Menjëherë pas çlirimt Partia hodhi parullën: «Tokën fshatarëve».

Në Kuçovë, që prej 20 tetorit të vitit 1944 dhe gjersat, janë ndërtuar 3 distileri që përpunojnë naftë e nxjerrin benzinë, vajguri dhe vajra lubrifikante. Kuçova, ku derdhet djersa e popullit të lirë, na jep çdo muaj 615 000 litra benzinë, 600 000 litra naftë dhe 225 000 litra vajguri. Instalimet që u ndërtuan për prodhimin e gazolinës do të na jasin 60 000 litra gazolinë në muaj. Në Kuçovë vazhdon me ritëm të paprerë shtimi dhe përmirësimi i prodhimit. Në Selenicë po riparohen galeritë e shembura, kurse në Rubik janë bërë pastrimet e instalacioneve.

Në lëmin e shëndetësisë, me përjashtim të atyre të ushtrisë, janë çelur 11 spitale civile me kapacitet 1 400 shtretër; 6 spitale janë kompletuar me reparte kirurgjje dhe aparate «Rontgen». Në këto spitale, përveç atyre të ushtrisë, kurohen gratis edhe 97% e të sëmurëve. Kanë filluar punimet për zhdukjen e malarjes; këto kryhen në 10 qendra. Paralelisht me këto kanë filluar veprimtarinë dispensoritë antimalariake. Një sasi e mjaf-tueshme kininash do t'i jepen falas popullsisë së krahnave të dëmtuara nga lufta dhe popullsisë së vobektë. Është në projekt krijimi i një spitali në Korçë me 200 shtretër për kurimin e tuberkulozit si dhe hapja e një shkolle infermierësh me 100 kursistë, përveç kurseve të vogla që janë duke u bërë në spitale të ndryshme.

Në fushën e asistencës sociale janë bërë përpjekje të mëdha për t'u ardhur në ndihmë krahanave të djegura nga lufta; përveç bereqetit, që është shpërndarë falas në të gjitha krahanat e dëmtuara dhe që arrin në 3 175 kuintalë, sasi që nuk përfshin bereqetin e shpërndarë falas prej ushtrisë, Ministria e Asistencës Sociale u ka

dërguar qarqeve të ndryshme një shumë prej 1 389 500 franga shqiptare për të blerë bereqet dhe për ta shpërndarë falas. Seksionet e asistencës sociale të nënprefekturave dhe të prefekturave me buxhetet e tyre kanë çelur mensa në të gjitha qytetet, në të cilat ushqehen me mijëra vetë të varfër e të dëmtuar nga lufta. Janë ngritur shumë pak jetimore dhe me vështirësi po mundohemi të strehujmë dhe t'u sigurojmë bukën e gojës 25 000 vëllezërve çamë të persekutuar nga shovinistët grekë. Papunësia është një problem i madh, që na preokupon dhe që dita-ditës po përpinqemi ta pakësojmë. Kjo është një nga plagët që na shkaktoi lufta shkatërrimtare e imponuar nga armiku.

Në lëmin arësimor janë çelur 13 shkolla të mesme, ku mësojnë 5 420 nxënës, djem e vajza si dhe 820 shkolla fillore, nga të cilat 298 janë hapur prej Frontit Nacional-Çlirimtar gjatë luftës. Numri i shkollave fillore është duke u shtuar dita-ditës. Me mijëra e mijëra nxënës dhe nxënëse po ndjekin këto shkolla. Në minoritetin grek janë hapur afro 20 shkolla, ku mësohet gjuha e tyre amëtare dhe shqipja. Pothuajse në të gjitha krahinat e Shqipërisë janë hapur kurse kundër analfabetizmit, duke përjashtuar ato të ushtrisë, që numërohen me qindra. Ndodhen në shtyp 15 000 copë libra për shkollat fillore dhe klasat e ulëta të shkollave të mesme, si dhe 12 000 broshura mbi lëvizjen nacional-çlirimtare.

Në lëmin e kulturës dhe të propagandës, në një kohë shumë të shkurtër qeveria jonë ka bërë një punë të madhe. Një rrjet i gjerë gazetash ka mbuluar Shqipërinë. S'ka sot prefekturë pa tipografi dhe pa gazetë. Fronti, rinia, pionierët, gruaja antifashiste, ushtria, të

gjithë kanë gazetat e tyre. Po organizohet teatri kombëtar, po hapen shkolla dramatike dhe muzikore, po zhvillohet një lëvizje sportive që s'e ka parë kurrë Shqipëria. Radioja funksionon më së miri. Por ajo që ka më tepër rëndësi është dëshira e madhe për kulturë që kanë shtresat e gjera të popullit dhe që është rezultat i Luftës sonë nacional-çlirimtare.

Në çështjet financiare jemi përpjekur të tiganisemi me dhjamin tonë. Me gjithë vështirësitë e mëdha që hasim, kemi zhdukur taksat me karakter feudal, që rëndonin mbi katundarin fukara, si xhelepi, vergjia, të dhjetat. Me anën e taksave progresive, të cilat goditin ata që kanë dhe që janë dëmtuar më pak nga lufta, u vijmë në ndihmë të dëmtuarve dhe përballojmë nevojat më urgjente që kërkon aparati i shtetit. Tatimet mbi fitimet e luftës janë një masë e domosdoshme dhe e drejtë që është marrë kundër atyre tregëtarëve, të cilët tërë kohën e luftës s'kanë bërë tjetër përveçse të pasurohen në mënyrë skandaloze në kurriz të fakirfukarasë dhe që s'kanë bërë tjetër përveçse të mahen me gjakun dhe djersën e popullit që ripej në punë e vritej nëpër male për çlirimin e atdheut. Banka e Shtetit Shqiptar ka filluar punën e saj dhe ka hapur filialët në shumë qendra të Shqipërisë, duke aktivizuar tregëtinë, e cila pak nga pak po mëkëmbet.

Krahas me këtë aktivitet të shumanshëm, ushtria jonë heroike, që dha provat e saja në zjarr e në flakë për çlirimin e atdheut, po shkon drejt modernizimit dhe organizimit të përsosur. Kurse dhe shkolla ushtarake janë hapur për të edukuar me strategjinë e luftës moderne oficerët tanë trima, që mundën oficerët italianë dhe

gjermanë. U krijuar bërthama e shkollës së kadetëve¹, nga ku do të dalin oficerët e rinj të ushtrisë. Lart nga 300 djem të popullit prej 16 vjeç e poshtë, djem dëshmorësh, punëtorësh e katundarësh, po mësojnë me zell të madh për t'u bërë të denjë për atdheun, për të zëvendësuar me krenari të dashurit e tyre, që komanduan ushtrinë e popullit dhe që ranë dëshmorë për mëmëdhënë. Të tjerë partizanë të rinj, që dhanë prova në këtë luftë, kanë shkuar jashtë shtetit, ku do të pajisen me diturinë e artit modern ushtarak.

Me gjithë këto hapa që kemi bërë përpara, o shokë të mi të rinisë, nuk duhet të na dehin sukseset, pse këto që kemi bërë janë pak; ne duhet të punojmë ditë e natë, që të arrijmë rezultatet e dëshiruara. Të meta në punë kemi mjaft dhe në qoftë se dëshirojmë të shkojmë përpëra duhet të përpinqemi t'i zhdukim këto. Të njohim gabimet tonë dhe këto të na bëhen mësim. Të goditim rëndë padrejtësinë dhe ata që shkelin ose shtrembërojnë ligjet e pushtetit. Të rrojmë me popullin dhe t'i shërojmë plagët, të forcojmë pushtetin e popullit, pushtet që do të zgjidhë të gjitha problemet dhe hallet tonë. Ta bëjmë pushtetin nga më demokratikët, ku kritika e shëndoshë dhe konstruktive të jetë e lirë dhe e inkurajuar. Ata që pengojnë një zhvillim të tillë, ata që kërkojnë të krijojnë bajraqe dhe tarafe, ata që kërkojnë të sjellin

¹ Më 28 mars 1945, pranë shkollës së perfeksionimit të oficerëve u organizua shkolla e kadetëve. Këtë shkollë e ndoqën pionierë, kryesisht fëmijë të dëshmorëve, të moshave 12-16 vjeç dhe të rinj, të zgjedhur nga gjithë njësitet e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Më 1947 ajo mori emrin shkolla ushtarake «Skënderbeg».

frymën e vjetër në zyrat e pushtetit, ata veprojnë kundër parimeve demokratike dhe do të goditen pa mëshirë. Askush të mos ketë frikë të kritikojë dhe të qahet për neglizhencat ose padrejtësitë që mund t'i bëhen nga çdo njeri që punon në organet e pushtetit. Pushtetin duhet ta kemi demokratik, të fortë dhe të drejtë, se për këtë derdhëm kaq gjak. Sa për kritizerët e sëmurë dhe reaksionarët, atyre dimë t'ua mbyllim gojën.

Shokë dhe shoqe të rinisë,

Në fushën ndërkombëtare Shqipëria jonë e vogël, me luftën e saj të madhe, ka fituar dashurinë dhe admirimin e gjithë botës përparimitare. Kurrë në historinë e popujve s'është parë që një komb kaq i vogël, si yni, të ketë luftuar me kaq trimëri dhe abnegacion për kauzën e përparimit dhe kundër fuqive aq të egra dhe të armatosura me çdo mjet, si ishin ato të fashistëve italianë dhe gjermanë. Kemi bërë detyrën si duhet dhe me të drejtë mburremi. Gjatë luftës sonë për çlirim, oficerët e aleatëve, të Bashkimit Sovjetik, të Anglisë dhe të Amerikës, kanë qenë afër nesh, ata na kanë parë në përpjekjet tonë mbinjerëzore, ata na kanë parë të hidheshim të patrembur në vijat e para, atje ku rreziku ishte më i madh. Dhe pas kaq përpjekjesh, ne kërkojmë me ballë hapët të drejtat tona që s'ka kush na i mohon. Populli i tërë Shqipërisë, që nga kasollja më e largët e gjer në qytete dhe partizanët tanë të plagosur, që nga shtretërit ku lëngojnë, të gjithë njëzëri, kërkojnë prej aleatëve të mëdhenj: njohjen e qeverisë sonë, që është vullneti dhe shprehja e gjallë e tërë një populli, kërkojnë që populli

ynë të marrë pjesë në Konferencën e San-Françiskos. Ndokush mund të thotë që në Shqipëri situata s'është aq e qartë sa të justifikojë njohjen e qeverisë. Punët tona janë sheshit. Kushdo që dëshiron është i lirë t'i këqyrë dhe të bindet se në vendin tonë çdo gjë është e qartë.

Neve s'na kënaq përgjegjja që na jepet nga Departamenti i Shtetit për Punët e Jashtme të Shteteve të Bashkuara, se Amerika nuk mund të mbrojë pranimin tonë në Konferencën e San-Françiskos, meqenëse nuk është njohur qeveria dhe se konferanca në fjalë ka vetëm për qëllim organizimin e organizatës për mbrojtjen e paqes dhe aspak karakterin e Konferencës së Paqes. Të drejtën e njohjes së qeverisë së tij dhe pjesëmarrjen në Konferencën e San-Françiskos populli ynë e ka fituar me luftë dhe me sakrifica dhe derisa në atë konferencë janë ftuar shtete, që jo vetëm nuk kanë luftuar aspak kundër fashizmit, por edhe e kanë ndihmuar tërthorazi, lënja jashtë e popullit shqiptar është një padrejtësi. Ne e dimë dhe e ndjejmë thellë simpatinë që ka për popullin shqiptar, populli amerikan. Departamenti i Shtetit për Punët e Jashtme të Amerikës, në memorandumin që më ka drejtuar, thotë:

«Presidenti dhe populli i Shteteve të Bashkuara e dinë fare mirë në ç'mënyrë të papërkulur patriotët shqiptarë kanë përfunduar me sukses përpjekjet e tyre të pabarabarta kundër agresionit armik dhe e dinë fort mirë se populli shqiptar ka kontribuar në mënyrë të çmueshme për triumfin eventual të kauzës sonë të përbashkët. Të shtytur nga ndjenjat miqësore të popullit amerikan kundréjt popullit shqiptar, Qeveria e Shteteve të Bashkuara shpreson sinqerisht se Shqipëria për

'së shpejti do të zërë vendin që i përket në komunitetin e kombëve».

Dhe pikërisht, duke qenë të bindur se këto fjalë në të vërtetë dalin nga zemra e popullit amerikan, ne shpresojmë se do të na njihen të drejtat tona.

Përveç misionit ushtarak anglez, të kryesuar prej gjeneral Hoxhsonit dhe misionit amerikan, të kryesuar prej z. Ernest Xhejkobs që vjen këto ditë, sot mora dhe telegramin e mëposhtëm:

«Në emër të Mareshalit të Bashkimit Sovjetik, J.V. Stalin, i ngarkuari me punë i Ambasadës sovjetike në Beograd, i komunikon Kryeministrin dhe Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Shqiptare, Gjeneral-Kolonel Enver Hoxhës, sa më poshtë:

Qeveria sovjetike me kujdes të madh dhe simpati u vu në dijeni me notën e Kryetarit të Këshillit të Ministrave të Qeverisë Demokratike të Shqipërisë Gjeneral-Kolonel Enver Hoxhës, drejtar Kryetarit të Këshillit të Komisarëve të Popullit të Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike, Mareshalit të Bashkimit Sovjetik, J.V. Stalinit. Në këtë kohë qeveria sovjetike është gati të dërgojë në Shqipëri një mision ushtarak sovjetik dhe shpreson në aprovin e qeverisë shqiptare për pranimin e këtij misioni».

Ardhja e këtyre misioneve aleate do të thotë për ne shpejtimi i njohjes së të drejtave tona.

Dita-ditës pozitat tona ndërkombëtare po forcohen. Në mes tonë, përveç përfaqësuesve të Bashkimit Sovjetik, të Anglisë, të Amerikës dhe të Jugosllavisë, ne kemi dhe përfaqësues ushtarakë të Francës. Shpejt do të kemi në mes tonë dhe përfaqësuesit e popullit çekosullo-

vak, e atij populli që s'u përkul përpara tiranisë naziste.

Në këto rrrethana të brendshme dhe të jashtme të vendit tonë, në momentet kur Ushtria e lavdishme e Kuqe dhe ushtritë anglo-amerikane po marshojnë mbi Berlin, ju, shokë të rinj, çelni kaq solemnisht Kongresin tuaj të dytë. Ky kongres është rezultati i punës suaj, është triumfi i përpjekjeve dhe i mundimeve tuaja. Ky kongres është shprehja e punës suaj të palodhur. Populli ynë është krenar me ju, atij i shtohet besimi, i dhjetëfisohen energjitet. Kongresin tuaj e brohorit gjithë populli ynë, pse këtu ai sheh të bashkuar e të vëllazëruar rrininë e gjithë popujve të Ballkanit dhe të shteteve të tjera aleate, ju sheh të lidhur ngushtë si në luftë edhe në paqe, për të mirën e njerëzimit përparimtar. Kjo ëndërr e madhe e demokratëve të vërtetë gjeti realizimin në këtë luftë.

Ndërmjet jush, o shokë dhe shoqe të rinisë, ndodhen përfaqësuesit e Rinisë heroike Antifashiste të Jugosllavisë. Ushtarët tanë që luftojnë krah për krah me Ushtrinë Nacional-Çlirimtare Jugosllave në Mal të Zi, në Bosnjë e në Sanxhak panë me sytë e tyre dhe ndjenë thellë në shpirt se sa afër ishin popujt e Jugosllavisë me ne, se çfarë dashurie ekzistonte kundrejt nesh në popujt e Jugosllavisë.

Në mes tuaj ndodhen përfaqësuesit e EPON-it¹, përfaqësuesit e Rinisë heroike Antifashiste të popullit trim helen, me të cilin shovinistët e Athinës kërkojnë të na përcajnë. Zotërinjve reaksionarë fashistë të Athinës u ka shkuar mendja dhe u është hapur oreksi për tokat to-

¹ EPON — organizatë e bashkimit të rinisë për gjithë Greqinë.

na. Por krahinat tonë të Korçës dhe të Gjirokastrës nuk gëlltiten pse ato ka kush i mbron. Ata që qenë të zotët të çlirojnë Shqipërinë nga gjermanët, do të dinë më së miri të mbrojnë edhe integritetin tokësor të vendit të tyre nga këlyshët e fashizmit, që vegjetojnë në Athinë. Fashistët e «Megaliidhesë»¹ rrojnë akoma në botën e Hitlerit dhe me ëndrrat e çmendura të Hitlerit. Por ka të mençur për të marrët. Njëmijë e një provokacione po bëhen matanë kufirit tonë të Jugut, për të turbulluar ujët. Shovinistët grekë po lehin si qentë në hënëz për torturat që gjoja ne po i bëjmë minoritetit grek në Shqipëri. Ne s'jemi bisha si ata, po jemi njerëz. Ne as vrasim, as masakrojmë, as grabitim; te ne nuk shnderohen gratë e minoritetit, ash-tu si bëjnë bandat e Zervas dhe të Plastiras² me popullsinë shqiptare të Çamërisë, të cilën e kanë masakruar dhe e kanë vrarë në mënyrë shtazarake. Përkundrazi, qëndrimi ynë kundrejt minoritetit është qëndrimi i një populli nga më përparimtarët në botë, i një populli me ndjenja njerëzore dhe drejtësi shembulllore. Minoriteti grek në Shqipërinë demokratike gjëzon të gjitha të drejtat; ai ka shkollat e tij, mësuesit e tij, shtypin e tij, njerëzit e tij në pushtet e në ushtri. Këto të drejta të pamohueshme minoriteti grek i ka fituar me gjak, duke lutfuar krah për krah me vëllezërit e tij shqiptarë kundër armikut të përbashkët, fashizmit dhe këlyshëve të tij;

¹ «Megaliidhea» — (ideja e madhe). Platforma ideologjike e borgjezisë shoviniste greke që synonte të krijonte një shtet të madh grek me kufitë e Perandorisë së dikurshme Bizantine.

² Plastiras — gjeneral monarko-fashist grek, një nga udhëheqësit e lëvizjes kundërrevolucionare pas Luftës së dytë botërore.

shprehjen e vëllazërimit të pandarë dhe dashurinë e minoritetit grek kundrejt popullit bujar të Shqipërisë e shprehu minoritarja, mëma plakë e dëshmorit Thanas Ziko, në Mbledhjen e Beratit kur tha: «Vinj të gëzohem tok me ju për këtë ditë të lumtur që arrimë, vinj të shoh shokët e djalit tim që vdiq për Shqipërinë demokratike!». Këtë ditë të lumtur, për të cilën flet plaka minoritare, zotérinjtë e Athinës kërkojnë ta errësojnë, ata kërkojnë të mbulojnë krimet e tyre, duke shpifur për ne. Por shpifjet do t'u përplasen turinjve, se Shqipëria e vogël, po heroike ka miq të fortë. Krahas gjithë botës përparimtare me Bashkimin Sovjetik në krye, ajo ka gjithë popujt përparimdashës të Ballkanit, Shqipëria e vogël ka bash mik popullin heroik grek, atë popull, që s'e uli kurrë flamurin e rezistencës kundër Gjermanisë dhe agjentëve të brendshëm, atë popull grek, me të cilin kemi derdhur gjak së toku për liri dhe demokraci, atë popull, që s'ka të bëjë aspak me shovinistët e Athinës.

Ne jemi një popull që duam të rrojmë në paqe me të gjithë, por kur është puna për të mbrojtur të drejtat tonë, kur është puna për të mbrojtur integritetin e atdheut tonë dhe indipendencën e Shqipërisë, s'kemi frikë të matemi me këdo dhe askush s'na tremb. Këtë le ta marrin në shënim zotérinjtë e Athinës.

Afër jush qëndrojnë përfaqësuesit e popullit bullgar, të atij populli bujar që ka strehuar dhe ka ndihmuar patriotët tanë të Rilindjes, të atij populli që ka vuajtur të zezat nga fashistët gjermanë dhe klikat e tij antipopullore e që sot djemtë e tij luftojnë krah për krah me Ushtrinë e Kuqe kundër bishës fashiste.

Keni në mes tuaj përfaqësuesit e rinisë çekoslovake,

rinisë së atij populli trim që s'ju tremb syri, që goditi pa niëshirë xhelatët Hajndrih¹, etj. dhe që po lufton përkauzën e përbashkët.

Shokë dhe shoqe të rinisë,

Kongresi juaj, pra, duhet të jetë pishtar i një pune të shëndoshë dhe ndërtimtare që t'i ndritë brezit të ri të Shqipërisë rrugën e tij të lavdishme dhe detyrat e tija të mëdha. Qeveria Demokratike që ka vënë shpresën, te ju, është e bindur se do të jeni kurdoherë në pararojë, ju do të hidheni në punë ashtu si u hodhët në luftë, ju do të mësoni dhe do të edukoheni me një zell të madh për të mirën tuaj dhe të popullit, ju do të forconi dhe do të ndihmoni ushtrinë tonë, mburojën e çelniktë të interesave të popullit, ju do të mbronи pushtetin, për të cilin dhatë kaq gjak, ju do t'u bindeni dhe do t'i zbatoni ligjet e pushtetit, ashtu si keni qenë të bindur dhe keni zbatuar përpikërisht urdhërat e Komandës së Përgjithshme në kohën e luftës.

Rroftë rinia jonë heroike!

Rroftë Kongresi i dytë i Rinisë Antifashiste!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 98,
17 prill 1945*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Bashkimi», Nr. 98,
17 prill 1945*

¹ Rajnhard Hajndrih, një nga bashkëpunëtorët e ngushtë të Hitlerit, zv-shef i Gestapos SS të Himlerit. Më 27 shtator 1941 u ngarkua me detyrën e të plotfuqishmit të Protektoratit të Imperatorisë në Çeki dhe Moravi. Më 27 maj 1942 u vra nga pjesëmarrësit e lëvizjes së rezistencës çake.

RINIA NË LUFTË DHE NË PUNË

5 maj 1945

«Rinia është shpresa e atdheut», do të ishte një frazë boshe e përdorur në çdo qoshe artikulli, në rast se nuk mendojmë thellë mbi këtë të vërtetë të madhe dhe në rast se njerëzit në pushtet dhe udhëheqësit e rinisë nuk e vënë në planin e parë të aktivitetit të tyre problemin e zhvillimit të drejtë dhe të shëndoshë të brezit të ri të vendit tonë.

Problemi është aq delikat sa edhe vital për vendin tonë, se tani është koha më tepër se kurrë që, bimës së re t'i japim ushqimin e shëndoshë, ta rritim me kujdesin më të madh që ajo të ecë drejt dhe të lulëzojë. Njerëzit me vullnet të fortë kapërcejnë çdo pengesë dhe ja mbërrijnë qëllimit, dhe vullneti i mirë dhe i fortë nuk mungon, populli ynë i dha provat në këtë luftë. Rinia antifashiste në radhë të parë, u tregua në këtë periudhë kritike që kaloi atdheu, në lartësinë e misionit të saj; ajo theu të gjitha paragjykimet e vjetra të kalbura dhe fshiu me vrullin e saj të madh revolucionar të gjitha plehrat që e mybytnin dhe s'e linin të merrte frymë, ajo doli në dritë, pas një lufte titanike, me besim të madh në vetëvete, me ndjenja humanitare dhe altruiste të theksuara, me besim

të plotë në pushtetin që ajo kontribuoi kaq shumë për ta ngritur në këmbë; rinia jonë njohu ç'ishtejeta me vuajtje, përpjekje, mjerime, shpresa dhe realizime; ajo kaloi rrithin e ngushtë dhe vicioz, ku kërkonin ta mbanin regjimet fashiste dhe profashiste dhe u hodh në të gjitha manifestimet e jetës së kombit me gjallërinë e saj djalo-share dhe me një pjekuri mendimesh që habitën dhe atë më optimistin. Këto kualitete të shëndosha që kanë zënë rrënje në të rintjtë tanë, na bie barrë e madhe dhe delicate t'i përforcojmë shumë e më shumë, t'i zhvillojmë e t'i përmirësojmë dhe të dimë t'i lidhim sa më ngushtë me jetën e gjithë popullit; rinia jonë duhet të jetë hallka e hekurt e këtij revolucioni që bëri populli ynë, të jetë gjaku i ri dhe i shëndoshë që do t'i japë hov jetës së re në Shqipërinë e re.

I riu ynë, në këtë luftë, ndjeu thellë në shpirt nevojën imperative të një bashkimi të shëndoshë të të gjithë rinisë, për të kryer një punë aq të rëndë si ishte lufta kundër okupatorit; përveç kësaj, ai e kuptoi përnjëherë se për këtë ndërmarrje, nga ku varej fati i vendit të tij, ai duhej të sakrifikonte interesat e tij të vogla, personale, përpara interesit të madh, të përgjithshëm; ai shkoi edhe më tej: për popullin e tij të mjeruar që ai e donte shumë, që ai e donte ta shihte të lumtur, punoi, luftoi dhe dha jetën e tij të re për të.

I riu ynë në këtë luftë, kuptoi mirë se e ardhmja e tij e lumtur dhe përmirësimi i jetës së tij personale si në pikëpamje morale, ashtu dhe në pikëpamje materiale, ishin të lidhura ngushtë me kolektivitetin e vendit të tij. Ai kuptoi se pa pjesëmarrjen e gjithë popullit në luftën kundër okupatorit, nuk do të fitohej liria; ai ka kuptuar

gjithashtu se pa ngritjen e nivelit ekonomik, kultural dhe politik të gjithë popullit të tij, nuk do të ketë kurrë një përmirësim të vërtetë të jetës së tij personale. Një mur i madh do ta ndante në këtë rast nga kolektiviteti, mur që ai nuk do ta lejojë kurrë të ngrihet përsëri, pse për ta rrëzuar këtë mur prej shekujsh, ai derdhi kaq gjak.

Si rrjedhim i kaq përpjekjeve, si rrjedhim i natyrshëm i kësaj lufte antifashiste, u ngrit pushteti demokratik i popullit dhe për popullin, u ngrit ky pushtet që konkretizon aspiratat, ndjenjat, shpresat e mbarë popullit që punon, u ngrit ky pushtet që do t'i realizojë njérën pas tjetrës të gjitha këto nevoja të popullit. Rinia që ka qenë një nga faktorët kryesorë për arritjen në këto rezultate, ka besimin e patundur te pushteti i popullit, pse është pushteti i tij.

Roli i rinisë, pra, është i madh në këtë fazë të dytë të luftës për rindërtimin e vendit, për ngritjen e standarit të jetës së popullit tonë; roli i saj është aq i madh në këtë fazë, sa ka qenë dhe në kohën e luftës kundër fasizmit. Sikundër kemi pasur heronjtë e rinisë në luftë, do të kemi edhe heronjtë e rinj të punës dhe të rindërtimit. Rinia në këtë fazë të re është e armatosur me eksperiencën e madhe të jetës dhe të luftës dhe në çdo fushë aktiviteti për zhvillimin e vendit ajo duhet të jetë pionierja e kësaj vepre të madhe, pioniere me gjykim të shëndoshë dhe vullnet të hekurt. Me këtë rast më kujtohet, gjatë kohës së luftës, në një pyll në malet e Mokrës, pas një udhëtimi të lodhshëm, një ish-nxënësi im i vogël, që kish braktisur shkollën dhe kish rrrokur armën, më thotë: «Shoku Enver, kur mësoja gjeografinë e Shqipërisë në shkollë, sa e mërzitshme më dukesh, por, po të

dal i gjallë nga kjo luftë sa me zell do ta mësoj dhe do t'ua mësoj dhe të tjerëve, pse një metamorfozë e çuditshme ka ngjarë në mua. Ato që më dukeshin të thata në bankat e shkollës, për mua tanë kanë marrë jetë. Njoh malet dhe fushat tona me pëllëmbë, lumenjtë e përrrenjtë i kam kapërcyer dimër e verë, i ngarkuar rëndë me armët e partizanit dhe me detyrat e rënda që na ka ngarkuar populli; kam njohur fshatrat tona dhe kam luftuar për t'i mbrojtur; një pjesë e trupit tim digjej, kur shihja të digjej kasollja e katundarit ku gjeja një zemër vëllaù e motre në kohët më kritike; tanë njoh fare mirë katundarin tonë, të cilin e dua si vëlla, si shok, si shpirt, pse e pashë sa i mjeruar ishte, sa bujar, me gjithë fukarallëkun e tij, sa i lartë, sa i guximshëm. Ai më dëgjoi me vërejtje në fillim për çka i thoja unë, djali i vogël i qytetit, që mbaja një distancë me të, dhe e shikoja nga lart, kur ai vinte në qytet; por kur më pa si luftoja, se përsë luftoja, kur pa se shokët e mi po binin për një ideal që ishte i tij, ai më priti me krahëhapët, më pushtoi dhe të pandarë shkojmë në luftë për një të ardhme të lumtur. Kurrë nuk do t'i lëshojmë armët, derisa t'ja arrijmë këtij qëlli-mi». Këto më thosh, në pyllin e Mokrës, një ish-nxënësi im i vogël, i cili më vonë ra duke luftuar me trimëri te ura e Shëmbërdhenjit, ra si hero për detyrën që i kish ngarkuar populli, ra dëshmor i idealeve të tij të larta. Ai nxënës i vogël dhe luftëtar i madh ra, por me qindra mijë të tjerë të rinj, të grumbulluar në Bashkimin e Rinisë Antifashiste, po ndjekin gjurmat e tij me atë hov e me atë shpirt, me ato ndjenja e me ato ideale që frymëzuan heronjtë e rinisë antifashiste që derdhën gjakun për liri.

Këtë rini heroiko e pashë në Kongresin e madh të dytë që u zhvillua në Tiranë dhe zemra m'u bë mal; në sytë e të rinjve tanë, pasqyrohej energjia e madhe, etja për punë, për sakrifica të reja, etja për edukatë të shëndoshë e për të shkuar përpara; në sytë e tyre pasqyrohej vullneti i çelniktë, ashtu si ishte shfaqur te QEMAL STAFA dhe MISTO MAME në paroksizmën¹ e përpjekjeve të tyre. Me një rini të tillë populli ynë do të shkojë me siguri përpara drejt përparimit dhe begatistë. Pushteti do të vërë gjithë forcat, që rinisë të mos i mungojë asgjë për t'u ngritur dhe për t'u forcuar, për t'u edukuar dhe për të punuar. Pushteti ynë që di se pa një rini të shëndoshë dhe të edukuar mirë, jetën e tij s'mund ta ketë të gjatë; gjithashtu dhe rinia e ka kuptuar se vetëm me një pushtet të tillë ajo mund të rrojë dhe të përparojë. Prandaj pushteti dhe rinia janë të lidhur ngushtë dhe të pandarë. Pushteti ja ka hapur dyert rinisë kudo. Dhe kudo ajo duhet të jetë shtyllë kryesore e çdo ndërmarrjeje. Rinia e edukuar më së miri me parime të reja, e organizuar me metoda të reja edhe nga më të përshtatshmet për të, duhet të jetë kudo në pushtet, në Front, në sindikatë, në kooperativë, në fusha e në male, në fabrika e në punëtorira, ku do të derdhë energjitet e saja mendore dhe trupore me një disiplinë shembulllore dhe me rendimentet e saja të dhjetëfishuara do të dalë vlera e saj e madhe konstruktive. Pushteti i sotëm demokratik do të interesohet për edukatën e rinisë aq sa një prind nuk mund të interesohet kurrë për edukatën e kalamajve të tij. Kjo edukatë nga ana tjetër nuk do të jetë më privilegji i disa pasanikëve e shfrytëzuesve

¹ Në kulmin, shkallën më të lartë.

që kujtonin se ishin lindur për të zotëruar shkencën dhe këtë ta përdornin, natyrisht, për të shtypur të tjerët. Por edukata do të jetë për të gjithë dhe veçanërisht për djemtë e popullit punëtor e të shumëvuajtur, që edukatën dhe shkencën që do të marrin, do ta vënë në shërbimin e përgjithshëm dhe jo për ambicjet e tyre të ulëta. Ekziston ende një mentalitet i gabuar, sidomos në disa njerëz të kaluar nga mosha, të cilët kanë tendenca të mos ta shohin me sy të mirë pjesëmarrjen e rinisë në të gjitha lëmet e aktivitetit shoqëror dhe, edukimin e rinisë e shikojnë shumë ngushtë, e shikojnë ende nën prizmin e regjimeve të kaluara. Ëndrra e këtyre njerëzve është që djali ose vajza e tyre që kanë kaluar nga farka e kësaj lufte, të mos të ndjekin rrugën e aspiratave dhe të prirjeve që kanë, por të ndjekin rrugën e përcaktuar prej tyre. Atyre ju duket një hata po të qëndrojë djali në ushtri, ku do të ketë shkolla dhe akademi ushtarake të përsosura; ju duket hata po të shkojë djali i tyre në një shkollë bujqësore, teknike, ose në një kurs blegtorësh. Për ta, djali i tyre duhet të vejë patjetër në gjimnaz ose në lice, të mësojë klasikët, të dalë vetëm doktor ose jurist se përndryshe aveniri i tij është i komprometuar. Një nënë më thoshte një ditë: «Të lutem ma liro djalin nga ushtria pse ka dhe dy vjet që të mbarojë liceun». Djali i kësaj nënë është kapiten i ushtrisë, detyrë me përgjegjësi të madhe. M'u desh ta bindja këtë nënë, që e bëri këtë përqapje vetëm e vetëm e shtyrë nga dashuria që ka për djalin, se shteti interesohet për djalin e saj aq sa dhe ajo. Se djalit të saj, qoftë kapiten, qoftë ushtar i thjeshtë, duke qëndruar në ushtri do t'i jepen të gjitha mundësitet që ai të mësojë

atje ku është dhe të japë provimet si të tjerët. Kështu ngjet dhe për shumë të rinj që punojnë në të gjitha degët e pushtetit. Por të rinxjtë tanë, të dalë nga kjo luftë, mendojnë ndryshe nga shumë prindër të tyre. Ata e dinë se asnjë s'do të mbetet i pamësuar, se e ardhmja e tyre është e siguruar në këtë pushtet, për forcimin e të cilit ata duhet të zhvillojnë një aktivitet të shumanshëm. Ata dinë se populli ynë s'ka nevojë vetëm për juristë dhe për doktorë, por edhe për bujqë të mirë, punëtorë të specializuar, administratorë të shquar, inxhinierë dhe agronomë të zot, ushtarë të vendosur për të mbrojtur të drejtat e fituara me gjak. Ata dinë dhe hovin e madh të përparimit që ka marrë vendi ynë, ata dinë se ushtria jonë heroike ka nevojë për oficerë të zot, që trimërisë dhe guximit të tyre t'i shtojnë dhe kulturën e lartë. Një zhvillim të tillë e ka kuptuar mirë rinia jonë antifashiste.

Në Kongresin e dytë, u duk qartë se rinia i kish kuptuar më së miri këto detyra dhe me entuziazëm shkoi t'i zbatojë në jetë. Ky është një sigurim i madh për të ardhmen e begatshme, kjo është një fitore e madhe për popullin tonë.

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Rinia», Nr. 12,
5 maj 1945*

*Botohet sipas tekstit të
gazetës «Rinia», Nr. 12,
5 maj 1945*

MESAZH DREJTUAR POPULLIT SHQIPTAR ME RASTIN E DITËS SË FITORES MBI GJERMANINË HITLERIANE¹

10 maj 1945

Popull shqiptar,

Dita e madhe e fitores, për të cilën derdhëm kaq gjak dhe bëmë kaq sakrifica, erdhi. Gjermania hitleriane u thye, u dorëzua pa kushte. Lufta në Evropë mbaroi. Kur nga Moska heroike Mareshali Stalin i dha sihariqin botës se mbi Berlin valon flamuri i kuq, flamuri ngadh-njimtar i Sovjetëve, gjithë popujt u çuan peshë dhe muarën frymë. Ankthi i madh, që kishte shtërnguar vjete me radhë zemrën e njerëzve, u zhduk tok me kuçedrën naziste. Në këtë ditë të madhe gëzimi ne kthejmë kryet dhe shohim në ç'katastrofë të madhe e kishte hedhur Evropën Gjermania fashiste.

Kurrë bota s'kish parë një armik që t'i vërsulej njerëzimit me aq egërsi dhe barbarizëm si ju vërsul Gjermania hitleriane. Pushteti i errësirës mbuloi në gjak

¹ Dhënë me anë të radios më 10 maj 1945 dhe botuar në gazeten «Bashkimi», më 11 maj 1945.

Evropën. Nazistët gjermanë, kriminelët më të mëdhenj që ka parë historia, si bisha shqyen popujt, vranë, gjakosën, torturuan, therën, grabitën pa mëshirë. Këto shtazë me fytyra njeriu, që përfaqësonin mesjetën më të errët të baronëve gjermanë, me artin modern ushtarak dhe me mjetet më të reja të luftës, vendosën që me çdo kusht të përmbytnin botën e përparimit për të vendsur ligjet e tyre barbare. Evropa e tërë u mbyt në gjak nën peshën e hekurit dhe të zjarrit gjerman. Në Perëndim populli i Britanisë së Madhe qëndroi i pathyer, në Moskë, në Kremlin ndriste gjenia e Stalinit që shpëtoi njerëzimin, përtej Oqeanit populli i madh amerikan hodi në balancën e luftës antifashiste potencialin e tij luftarak. Aleanca e fortë kundër fashizmit agresor u bë një realitet. Ushtria e madhe dhe e lavdishme, Ushtria e Kuqe i theu njëren pas tjetrës armatat e Hitlerit. Ajo e përbysi situatën kryekëput. Mareshalët, gjeneralët dhe oficerët e shkollës staliniane përbysën planet djalëzore të armikut dhe e quan ushtrinë e popujve të mëdhenj sovjetikë në fitoren e madhe. Fitoret e tyre ishin fitoret e njerëzimit përparimtar, ishin fitoret tona. Krahas me Sovjetët, anglo-amerikanët dhanë kontributin e tyre të çmuar.

Në Evropën e gjakosur, edhe ne, popujt e shtypur u gjakosëm, po s'u thyem; nën një terror të papershkuar ne mbajtëm lart flamurin e rezistencës dhe s'e humbëm kurrë besimin e madh në fitoren. Për fitoren ne sakrifiкуам çdo gjë: u vramë, u dogjëm, u shkatërruam, por marshuam përpara, kurdoherë përpara për të thyer zinxhirët e robërisë. Lufta jonë ishte mbinjerëzore, pse ishte e pabarabartë; lufta jonë ishte madhështore, me-

gjithëse në fillim ishim të paarmatosur dhe të papregatitur mirë. Kontributi që i dhamë çështjes së madhe të njerëzimit është i pakufishëm, pse me shpirt në dhëmbë dhe me burrëri ngjitëm kalvarin¹ tonë e, kryelartë e më të fortë se kurrë, arritëm në apoteozin e fitores.

Në këtë luftë vigane populli shqiptar qëndroi në ballë, ashtu si qëndron sot në një radhë me të gjithë ata popuj që luftuan fashizmin. Vendi ynë, me ushtrinë e tij heroike e goditi rëndë armikun, e gjakosi, e shporri nga atdheu ynë. Populli ynë fitoi lirinë, siguroi independentencën, vendosi demokracinë, dhe sot i sigurt në forcat e veta, ai po shkon me hapa të mëdha drejt përparimit dhe lulëzimit. Populli ynë, që ka vuajtur pa masë, është i vendosur më fort se kurrë të zhdukë çdo gjurmë të së shkuarës së tmerrshme; ai është i vendosur të shkulë nga rrënjet të gjitha mbeturinat fashiste dhe profashiste që mund të ekzistojnë në vendin tonë; vetëm kësijo mund të shkojë përpara në rrugën e paqes dhe të rindërtimit. Për këtë gjë ai është më se i bindur. Detyra e tij kryesore është të forcojë pushtetin, të forcojë ushtrinë e tij, mbrojtësen e vërtetë të të drejtave që fitoi me gjak.

Sot, në kulmin e gjëzimit për fitoren e madhe, populli shqiptar, ashtu si ka qëndruar besnik i aleancës së madhe antifashiste në kohën e luftës, do të qëndrojë edhe paskëtaj besnik për mbrojtjen e paqes; ashtu si hodhi pa rezerva gjithë forcat e veta në këtë luftë çlirimtare, ashtu do të vërë gjithë forcat e veta dhe do të ngrëjë zérin për të fituar të gjitha të drejtat që i takojnë

¹ Rrugë më mundime.

dhe që i ka fituar me gjak. Është e drejta jonë, në bazë të kontributit që kemi dhënë në këtë luftë, të themi fjalën tonë dhe të zëmë vendin tonë në Kombet e Bashkuara. Këtë e kërkojmë me ballë hapët në emër të parimeve për të cilat është bërë kjo luftë, në emër të parimeve mbi të cilat duhet të bazohet dhe do të bazohet paqja e nesërme.

Rroftë aleanca e blokut të madh antifashist!

Rroftë Ushtria e lavdishme e Kuqe!

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë ushtria jonë heroike!

Lavdi dëshmorëve, që ranë në fushën e luftës për çlirimin e atdheut!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 117,
11 maj 1945*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 117,
11 maj 1945*

TELEGRAAM

DREJTUAR MARESHALIT TË BASHKIMIT
SOVJETIK JOSIF STALINIT, PRESIDENT I
KËSHILLIT TË KOMISARËVE TË POPULLIT,
ME RASTIN E FITORES MBI GJERMANINË
HITLERIANE

17 maj 1945

Shkëlqesë,

Në emër të gjithë popullit shqiptar, kam nderin t'i drejtoj Shkëlqesës Suaj si dhe gjithë popujve të Bashkimit Sovjetik dhe Ushtrisë së Kuqe të lavdishme, urimet më të nxehta për fitoren e madhe të korrur në luftë mbi nazizmin gjerman.

Në këto ditë të shënuara krejt populli shqiptar brohorit Ushtrinë e Kuqe fitimtare, e cila, duke dhënë prova të një trimërie të pashoqe, rrëzoi dhe shfarosi ushtrinë barbare të nazizmit për t'i siguruar paqen njerëzimit.

Kombet e vegjël, duke përfshirë edhe Shqipërinë, do t'i jenë mirënjohës për jetë Ushtrisë së Kuqe heroike

dhe Bashkimit Sovjetik, në të cilin ata shohin mbrojtësin e singertë të lirisë dhe të pavarësisë së tyre.

Kryetari i Këshillit të Ministrave të
Qeverisë Demokratike të Shqipërisë
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 122,
17 maj 1945*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 122,
17 maj 1945*

FJALA NË HAPJEN E SHKOLLES SË PARTISE

25 maj 1945

Të dashur shokë funksionarë dhe udhëheqës të Partisë,

Pa dyshim ju e kuptoni vetë rëndësinë e madhe që ka kjo shkollë e Partisë që po çelim sot. Këtej, kuadrot tanë, që gjatë luftës ditën të luftonin dhe të punonin me aq abnegacion dhe heroizëm, do të dalin të armatosur me kulturën marksiste-leniniste, e cila do t'u ndritë rrugën për zgjidhjen e problemeve dhe për kryerjen e detyrate të mëdha që u vihen përpara në këtë fazë të re. Faza është e re, por detyrat qëndrojnë aq të rëndësishme, bile edhe më tepër se në fazën e luftës kundër fashizmit.

Partia jonë e re, me kuadro të rinj, me kuadro të paformuar mirë, ndërmori një vepër sa të zorshme aq dhe madhështore. Gjatë tre vjetve e gjysmë luftë, në ballë të popullit dhe në ballë të përpjekjeve, Partia jonë me nder dhe lavdi, përbashi detyrën e saj, përbashi detyrat që i kish besuar populli, përbashi detyrat që i kish caktuar Kominterni. Partia jonë mobilizoi popullin dhe e hodhi në kryengritjen e përgjithshme, organi-

zoi ushtrinë dhe e çelnikosi në përpjekje të ashpra me okupatorin, ngriti pushtetin demokratik, fitoi luftën dhe tani ajo gjendet në postet e komandës. Kjo s'është një mrekulli e fatit, por është rezultat i djersës dhe i gjakut të shokëve të Partisë. Ishte vrulli i madh revolucionar, entuziazmi i pafrenuar; dashuria e madhe për popullin dhe urrejtja kundër fashizmit, ishte besimi i madh te Partia, besimi i madh dhe i patundur te Bashkimi Sovjetik dhe te shoku ynë i madh Stalin, që i bënë shokët komunistë të ngrenë lart flamurin e Partisë sonë. Partia jonë fitoi pse kurrë s'e humbi orientimin. Prizmi ynë në çdo moment ishte Bashkimi Sovjetik, ishte Partia Bolshevikë e Leninit, ishte Stalini. Në ndiqnim gjurmata e tyre të pagabueshme, të cilat na çuan në fitore.

Anëtarët e Partisë bënë një shkollë të madhe, shkollën e luftës; ata mësuan shumë gjëra, por nuk mund të themi dhe gabohemi rëndë po të themi se ata janë në gjendje të përballojnë si duhet punën e rëndë që do të kryejnë. Shokëve tanë në përgjithësi u mungojnë armët e rëndësishme, të cilat, tok me vullnetin e pamposhtur, me entuziazmin dhe me disiplinën e hekurt, do t'i bëjnë këta të shkojnë përpara, dua të them se u mungojnë njohuritë e marksizëm-leninizmit. Qëllimi i kësaj shkolle është pra, t'i armatosim shokët e Partisë me këtë armë të fortë.

Ju duhet të dini mirë një gjë: se s'është mjaft që Partia jonë të ketë frenat e komandës, por duhet të dijë t'i imbjë, t'i forcojë, për të shkuar përpara për përbushjen maksimale të programit tonë. Përbushja e këtij programi dhe realizimi i idealeve tona nuk mbërrihen as me blofe, as me vendime arbitrale, as me kulturë

marksiste të përciptë dhe as me një punë prej diletanti. Në qoftë se anëtarët e Partisë do të kujtojnë për një moment se problemeve të koklavitura që do të hasin përparrë mund t'u jepet një zgjidhje shkel e shko, një zgjidhje që mund t'i përshtatej «à la rigueur»¹ kohës së luftës, në qoftë se anëtarët e Partisë do të kujtojnë se, për të fshehur injorancën, dembellëkun, indisiplinën, do t'i zgjidhin çështjet, natyrisht, jo drejt, duke vënë përpara prestigjin e Partisë dhe autoritetin e saj, në qoftë se mendojmë dhe punojmë në këtë mënyrë, ne nuk mund t'i mbajmë dot pozitat e komandës që i kemi fituar. Dhe do të ishte një krim i madh që do të bënim ndaj Partisë dhe popullit në këtë rast.

Shokët duhet të kuptojnë mirë rëndësinë e momentit dhe përgjegjësitë e tyre të mëdha. Sot drejtojmë një popull, drejtojmë një shtet, Partia jonë ka marrë fatet e vendit në dorë. Askujt nuk i lejohet të bëjë lëshime, të neglizhojë punën, të kënaqet me ato pak gjëra që di dhe të mos mësojë. Ata që veprojnë ndryshe s'janë komunistë të tipit të ri dhe dëmtojnë Partinë. Askujt nuk i lejohet të shkelë disiplinën e hekurt të Partisë, pa të cilën nuk mund të shkojmë përpara, të sakrifikojë punën që i është ngarkuar dhe ta lërë pa e kryer, për ta zëvendësuar me rehatinë dhe qejfin. Komunisti i tipit të ri ndjen prehje dhe shlodhje vetëm atëhere kur ndërgjegjja e tij është e qetë pse ai e ka kryer punën që i ishte ngarkuar edhe më mirë se duhej. Anëtari i Partisë duhet të jetë kudo në ballë, në çdo lëmë aktiviteti, ai të udhëheqë masat në çdo drejtim, ai të shkëlqejë mbi të gjithë:

¹ «à la rigueur» (frëngj.) — nga zori.

nga vullneti, nga dituria, nga vendosmëria, nga durimi, nga modestia, nga drejtësia. Çdo anëtar partie duhet të mendojë në çdo moment se puna e tij e drejtë dhe e palodhshme forcon dhe ngrë lart prestigjin e Partisë dhe e bën këtë të adhurohet prej masave. S'duhet të ketë anëtar partie që të mendojë ndryshe, pse atëherë ai s'meriton të qëndrojë në radhët e Partisë.

Shokë, kjo shkollë hapet në momente të favorshme për ne, si në rrethanat e brendshme, ashtu edhe në ato të jashtme. Gjermania naziste u mposht, Bashkimi Sovjetik është në kulmin e forcës dhe të lavdisë, në shumë vende e sidomos në vendin tonë e në Jugosllavi, Partia Komuniste është në komandë, por megjithkëtë, në asnje minutë të mos harrojmë se reaksiuni ndërkombe të s'është mposhtur, përkundrazi ai përpinqet të fitojë pozitë, ai përpinqet të mëkëmbë klikat profashiste në dëmin tonë. Prandaj më tepër se kurrë duhet të jemi zgjuar, kurdoherë në sulm për të zhdukur çdo mbeturinë fasiste, të derdhim gjithë energjitet tona në punë e në luftë për rindërtimin e vendit. Dhe, që t'i bëjmë këto, duhet të kemi Partinë më të fortë se kurrë, të edukojmë dhe të çelnikosim kuadrot tanë. Të jemi kurdoherë të zgjuar në politikën tonë të brendshme dhe të jashtme dheasnje minutë të mos i heqim sytë nga eksperiencia e Bashkimit të madh të Sovjetëve, nga shoku ynë i dashur Stalin dhe, sikundërqë thotë Dimitrovi, ne duhet: «Të mësojmë dhe të luftojmë — të luftojmë dhe të mësojmë. Duhet të dimë të bashkojmë mësimet e madhnueshme të Marksit-Engelsit-Leninit-Stalinit, me qëndrueshmërinë staliniane në punë dhe në luftë, me principin e papajtueshmërisë staliniane kundrejt armi-

kut të klasës dhe kundrejt renegatëve të vijës bolshevikë,
*me pafrikshmërinë staliniane përpara vështirësive dhe
 me realizmin revolucionar stalinian»¹*

Pra, të dashur shokë, unë s'kam përvëçse t'ju uroj në emër të Byrosë Politike dhe të Komitetit Qendror të Partisë, suksese në punë, dhe t'ju këshilloj që të keni vëmendjen më të madhe në kurset, që të përfiton sa më shumë, për interesin tuaj dhe për interesin e madh të Partisë sonë të dashur.

Rroftë Partia jonë Komuniste!

Rroftë Partia heroike Bolshevikë e BRSS!

Rroftë shoku ynë i dashur Stalin!

*Botohet për herë të parë, si-
 pas origjinalit që gjendet në
 Arkivin Qendror të Partisë*

¹ Shih: Gj. Dimitrov «Mbi kuadrot», botim i «Zërit të Popullit». Shtypshkronja «Bashkimi», Tiranë 1945, f. 24.

LETËR DËRGUAR PRESIDENTIT TË SHBA HERRI TRUMANIT NË LIDHJE ME TRAJTIMIN E MIRE QË U BËHET KRIMINELËVE SHQIPTARE TË LUFTËS NGA AUTORITETET ANGLO-AMERIKANE NË ITALI

1 qershor 1945

Shkëlqesë,

Në emër të Qeverisë Demokratike të Shqipërisë kam nderin të vë në dijeninë Tuaj sa vijon:

Komisioni qendror për zbulimin e kimeve të kriminelëve të luftës dhe të armiqve të popullit i kishte kërkuar më 23 shkurt 1945 Komisionit ndërkombëtar për zbulimin e kimeve dhe të kriminelëve të luftës, dorëzimin e një numri kriminelësh shqiptarë të luftës, që ndodheshin në kampet e përqëndrimit të Italisë, si në Bari, Leçe, Salerno e gjetkë. Kjo kërkesë e ligjshme e popullit shqiptar jo vetëm nuk pati përgjegje, por ne vërejmë me keqardhje se kriminelët më të poshtër shqiptarë të luftës, si: Ali Këlcyrë, Mithat Frashëri, Abaz Kupi, Kadri Cakrani, Koço Muka, Vehip Runa e shumë të tjerë, në vend që të mbahen në kampet e përqëndrimit dhe të trajtohen si armiq duke marrë parasysh bashkëpunimin e tyre të vendosur me nazistët gjermanë, ata trajtohen në mënyrën më të favorshme dhe lihen të lirë në qytetet e Italisë të vazhdojnë intrigat e tyre

fashiste në dëm të popullit tonë dhe të njerëzimit përparimtar.

Një trajtim i tillë i kriminelëve shqiptarë të luftës, të cilët kanë kryer aq mizori në vendin tonë, nuk mund veçse të habitë popullin shqiptar, i cili ka një besim të patundur në drejtësinë e madhe për të cilën ai ka derdhur aq shumë gjak.

Fakti se këta kriminelë lufte nuk u dorëzohen autoriteteteve shqiptare, në bazë të vendimit të Konferencës së Moskës¹, e cila përcakton qartë se çdo kriminel lufte do të gjykohet në vendin ku ai ka kryer krimet e tij, si dhe trajtimi i favorshëm që u bëhet atyre nga autoritetet aleate në Itali, përbëjnë një padrejtësi dhe në të njëjtën kohë një fyerje ndaj popullit shqiptar, i cili ka bërë aq sakrifica për çështjen e përbashkët...

Ju lutem të keni mirësinë të merrni parasysh dhe të rishqyrtoni kërkesat e drejta dhe të ligjshme të popullit tonë.

Kryetari i Këshillit të Ministrave të
Qeverisë Demokratike të Shqipërisë
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin e Shtetit
të RPSH*

¹ Është fjala për Deklaratën e J.V. Stalinit, F. Ruzveltit dhe U. Çërcillit mbi përgjegjësinë e hitlerianëve për krimet e kryera kundër popujve, që u bë e njojur gjatë punimeve të Konferencës së Moskës të Ministrave të punëve të jashtme (19—30 tetor 1943).

SHOKU IM ALQI KONDI¹

1 korrik 1945

Të njoha fare të ri dhe në kohën më të rrezikshme që kalonte atdheu. I fshehur në shtëpinë e një duhanxhiu të varfër patriot tiranas të kisha lënë pjekjen e parë. Erdhe më takove, erdhe të merrje udhëzimet për organizimin e kryengritjes së madhe. Të pashë të mitur e me trupin delikat, duart e tua të holla s'gjenin vend ku të futeshin nga turpi, por kjo vazhdoi pak minuta, pse me t'u parë, ne u bëmë shokë të pandarë, u lidhëm për jetë, zemrat dhe ndjenjat tona u bashkuan. Në dhomën e varfër të duhanxhiut tiranas, unë dhe ti s'ishim veçse dy ushtarë të thjeshtë të popullit, që kishim vendosur të luftonim dhe të vdisnim për pavarësinë e atdheut tonë të shtrenjtë.

Armiqtë na shanin për ndërmarrjen tonë; ata i quanin përpjekjet tona punë prej kalamajsh, por ne dinim

1 Alqi Kondi (1925—1945) — Anëtar i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë, Sekretar politik i Komitetit Qendror të Rinisë Komuniste Shqiptare dhe Sekretar i Përgjithshëm i Bashkimit të Rinisë Antifashiste Shqiptare. U vra aksidentalisht më 24 qershor 1945. Me këtë rast shoku Enver Hoxha shkroi për gazetën «Rinia» këtë artikull.

ç'bënim. Ti dhe shokët e tu ishit kalamaj nga mosha dhe nga trupi, por mendonit si burra të pjekur, se kishit shpirt dhe zemër të madhe. Ju ishit shtylla të revolucionit popullor; ju ishit ndër ata që, qysh në urdhërin e parë, filluat rezistencën. Ti Alqi, shoku im i vogël, ishe nga ata nxënës që në ditët e para të okupimit, me dhëmbë dhe grushte shtërnguar shkruanit në dërrasat e zeza të shkollave: «Poshtë Italia, do të luftojmë!» Ti Alqi, shoku im i vogël, ishe nga ata të demostratave të para, të përleshjeve me karabinierët në sheshin «Skënderbeg» të Tiranës.

Ti ishe shprehje vullneti e rinisë heroike që do të shpëtonte atdheun. Para gjokseve tuaja të çelnikta, kurrihte zemra e një populli të tërë, do të thyheshin bajonetat e armikut. Kjo ishte bindja jonë e patundur dhe s'u gabuam.

Shoku im Alqi Kondi, të pashë të rriteshe në punë e në luftë; ndoqa me kujdes përparimin tënd të çuditshëm, për të cilin kishte aq nevojë populli dhe lufta jonë. Ndjeshjet e tua të pastra dhe ideali i madh që të frymëzonte të burrëruan, të hapën sytë, të edukuan, të bënë të doje popullin me gjithë shpirt, të ndriçuan rrugën tënde të lavdishme, të dhanë kurajo, zemër, të bënë hero. Dhe jeta tënde prej militanti është plot heroizma.

Ishe ushtar i bindur dhe i disiplinuar, i pajisur me të gjitha kualitetet.

T'u dha urdhër të shkoje të organizoje rininë e Beratit, shkove, punove dhe luftove me vullnet të madh. Të kapi armiku, të burgosi, të torturoi për vdekje, gjoksi tënd i vogël kulloj gjak, por ti qëndrove i pathyer. Sapo dole nga burgu dhe ende me gjoksin me plagë t'u dha

urdhër të shkoje në Elbasan. Ti shkove përnjëherësh, ushtar besnik i popullit. Për ty s'kish kuptim jeta pa luftë, pa përpjekje, pa rreziqe. Vajtja jote në Elbasan i dha hov luftës në atë krahinë. Kontingjente të rinjsh vinin nga Elbasani në Çermenikë, mbushnin brigadat tona, ata ishin plot entuziazëm, se kishin entuziazmin tënd që i kish frymëzuar. U thirre dhe t'u ngarkua një detyrë e rëndësishme politike në Brigadën II¹. Ti qëndrove në lartësinë e detyrës. Momente të këqia kaloi kjo brigadë, luftoi kundër reaksionit të tërbuar, kundër gjermanëve, kundër dimrit dhe urisë, por ti s'u theve. Ashpërsia e luftës të nxiste për një luftë më të madhe.

Alqi, shoku im, ti ishe një nga partizanët e mëdhenj të fitores, që s'u gabave në gjykimet e tua; në punën tënde dukej një siguri e madhe dhe një gjykim i thellë.

Me çlirimin e Shqipërisë na priste një punë e madhe dhe shumë e vështirë: kishim mbi shpatulla rregullimin e një shteti të ri që duhej ndërtuar nga themelat, kishim në kurri zotëruar nga lufta, që e kërcënonte uria dhe vuajtja. Ty s't'u tremb kurrë syri. Si në luftë, ashtu dhe në problemet e pasluftës, zgjuarësia jote, vullneti yt, hovjtë yt në punë ishin një garanci e madhe për pushtetin e për popullin. Të thirra pranë meje, në Sekretariatin e Përgjithshëm të Kryeministrisë, pse kisha nevojë për ndihmën tënde, kisha besim në punën dhe në gjykimet e tua.

Në ty, o Alqi Kondi, shihja të riun e vendit tonë, të

¹ Me krijimin e Brigadës II S të UNÇSH në 1943, u ngarkua nga Komiteti Qendror i PKSH me përgjegjësinë e rinisë në brigadë. .

riun e pastër, të drejtë, të guximshëm, të palodhur për kauzën e madhe të popullit.

Dhe zemra ime është copëtuar për ty, pse humba një nga bashkëpunëtorët e mi më të shquar dhe populli shqiptar një nga bijtë e tij më trima dhe nga udhëheqësit e tij më të zot.

Lufta tënde, përpjekjet e tua janë model për ne, për brezat e ardhshëm të vendit tonë. Në gjurmat e tua shkon një rini e tërë, një rini e shëndoshë dhe e pastër, që ka vendosur ta ndërrojë të shkuarën e saj të errët në. një të ardhshme të lulëzuar. Këtë rrugë ja ke caktuar ti dhe shokët e tu që shkritë jetën tuaj të re. Kujtimi yt dhe i shokëve të tu do të jetë i pavdekshëm dhe ai do të na japë zemër dhe vullnet për të korru fitore të reja për popullin dhe atdheun që ju e deshët aq shumë.

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Rinia», Nr. 20,
I korrik 1945*

*Botohet sipas tekstit të
gazetës «Rinia», Nr. 20,
I korrik 1945*

URDHËR DITE DREJTUAR USHTRISË KOMBËTARE ME RASTIN E FESTËS SË KRIJIMIT TË SAJ

10 korrik 1945.

Ushtarë, komandantë, përgjegjës politikë,

Sot, me rastin e festës së madhe të ushtrisë, po ju drejtoj përshëndetjet e mia. Në Shqipërinë tonë të çliruar nga robëria e rëndë sot festohet me madhështi dhe për të parën herë dita e ushtrisë sonë heroike. Gjithë populli shqiptar, me dashuri të madhe dhe me mirënjohje të pafund, është vënë përkrah ushtrisë së tij, që e shpëtoi nga kthetrat e armikut, që i dha lirinë dhe pavarësinë.

Ju, bij të denjë dhe trima të popullit tonë, që sot formoni Ushtrinë Kombëtare, rrëmbyet pushkët dhe dualët malit, duke lënë parmendat, punëtoritë dhe shkollat për të shpëtar popullin nga zhdukja që e kërcënonte, për të shpëtar vatrat, pasurinë dhe nderin e mëmave dhe të motrave tona. Furtuna të tmerrshme kaluan mbi ne; fashistët italianë dhe gjermanë me urë në dorë u vunë zjarrin fshatrave dhe qyteteve tona; ata vranë barbarisht pleqtë, foshnjat dhe mëmat tona; ata mbu-

shën burgjet dhe kampet e përqëndrimit me njerëz të pafajshëm dhe me patriotë. Po vullneti i madh i popullit tonë s'u mposht. Përkundrazi, ne përballuam ofensivat e mëdha të armikut dhe të tradhëtarëve, përballuam vuajtjet dhe torturat, përballuam urinë dhe dimrin, po i mposhtëm armiqtë dhe shërbëtorët e tyre. I mposhtëm, se ne mbronim kauzën e drejtë, mbronim dhe luftonim për çlirim e atdheut, pse ne luftonim për të ardhmen tonë.

Trimëria legjendare e partizanëve tanë kapérceu kufitë e atdheut dhe u bë simbol i rezistencës së pathyer të një populli të vogël, që lufton për kauzën e madhe të njerëzimit. Trimëria e Ushtrisë sonë Kombëtare ngriti lart emrin e Shqipërisë dhe e vuri këtë në një radhë me të gjithë shtetet e tjerë antifashistë që dhanë kontributin e tyre për fitoren. Fitorja e madhe mbi Gjermaninë naziste është e përbashkët dhe këtë fitore duhet ta mbrojmë me çdo kusht.

Ushtarë, nënoficerë, oficerë,

Ushtria jonë Kombëtare, e dalë nga gjiri i popullit, e përbërë nga djemtë më të mirë të tij, ashtu si ishte e gatshme, ashtu si u hodh në rreziqet më të mëdha të kësaj lufte për pavarësinë e vendit tonë, ashtu duhet të jetë edhe tani, më këmbë, e gatshme dhe më e fortë se kurrë për të mbrojtur lirinë e fituar me kaq sakrifica e gjak, për t'i siguruar atdheut indipendencën, integritin tokësor, paqen e brendshme e të jashtme. Ushtria jonë Kombëtare duhet të jetë mburoja e çelniktë e popullit, e pushtetit, e demokracisë. Ajo duhet të jetë nga

faktorët më me rëndësi të begatisë dhe të përparimit të popullit tonë.

Ushtarë, nënoficerë, oficerë të Ushtrisë sonë Kom-bëtare,

Detyrat tuaja janë aq me rëndësi sa dhe të shenjta. Nga puna juaj varet lumturia e vendit tonë. Prandaj të ruani dhe të forconi unitetin e ushtrisë sonë. Ushtria jonë të bëhet një vend·nderi dhe lavdie, ku të rreshtohen vetëm ata bij të popullit që janë të gatshëm në çdo kohë të punojnë, të luftojnë dhe të vdesin për atdhenë. Ushtria jonë të bëhet një shkollë e madhe për bijtë e popullit, ku ata të mësojnë artin modern luftarak, të zhvillojnë prirjet e tyre të vlefshme, të lartësojnë virtytet e mëdha të kombit tonë. Ushtria jonë të bëhet një ushtri moderne me tërë kuptimin e fjalës, një ushtri me disiplinë të hekurt dhe njëkohësisht të vetëdijshme. Në gjirin e saj të zhvillohet dashuria e pakufishme për popullin, për Partinë dhe për atdheun, dashuria dhe respekti për pushtetin; të zhvillohet dashuria e madhe për shoqi-shoqin. Të mbahet kurdoherë e gjallë dhe të shtohet sa më shumë urrejtja për mbeturinat fashiste dhe për të gjithë armiqtë e popullit. Këto detyra që ju dalin përpara, t'i kryeni me përpikërinë më të madhe dhe me ndër. Ai që s'i kryen këto, ai që s'e do ushtrinë — s'e do popullin, s'e do atdheun e nuk e ka vendin në ushtrinë tonë.

Ngrejeni lart flamurin e ushtrisë sonë dhe në këtë flamur, ku janë shkruajtur me gjakun e mijëra shokëve tanë fitoret e shkëlqyera dhe të panumërtë të përpjekjeve legjendare të popullit tonë, të shtohen fitore të reja,

fitore për mbrojtjen e paqes, për mbrojtjen e popullit,
të indipendencës dhe të integritetit tokësor të vendit
tonë.

Rroftë Ushtria jonë Kombëtare!

Komandanti i Përgjithshëm i Ushtrisë Kombëtare
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 168,
12 korrik 1945*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 168,
12 korrik 1945*

**MESAZH DËRGUAR GJENERALISIMIT STALIN,
KRYEMINISTRIT ÇERÇILL DHE PRESIDENTIT
TRUMAN NË KONFERENCËN E POTSDAMIT ME
ANËN E TË CILIT KËRKOHET NJOHJA E QEVERISE
DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË**

26 korrik 1945

Shkëlqesë,

Me rastin e mbledhjes së Konferencës historike të Potsdamit¹ jam i lumtur t'Ju shpreh në emër të popullit shqiptar dhe të Qeverisë Demokratike të Shqipërisë, si dhe në emrin tim, urimet më të sinqerta për sukseset e kësaj ndërmarrjeje të madhe fisnike për të mirën e gjithë njerëzimit.

Pöpulli shqiptar, që ka luftuar me guxim dhe abnegacion për kauzën e shenjtë të përbashkët, është plotësisht i bindur se sakrificat e shumta, gërmadhat dhe rrë-

¹ Konferenca e Potsdamit zhvilloi punimet nga 17 korrik deri më 2 gusht 1945 në qytetin e Potsdamit (Gjermani) me pjesëmarrjen e kryetarëve të qeverive të BRSS, të SHBA dhe të Britanisë së Madhe. Ajo vendosi çmilitarizimin, denazifikimin dhe ndërtimin mbi baza demokratike të Gjermanisë së mundur në Luftën e dytë botërore (1939—1945).

nimet që pësoi vendi, do të çmohen si duhet prej tre të mëdhenjve. Ai shpreson se një vendim që t'u përgjigjet dëshirave të tij nuk do të vonojë të mirret nga ana Juaj për njohjen e qeverisë së vet, që shpreh besnikërisht aspiratat e tija të thella dhe që, në bashkëpunim të ngushtë me aleatët e mëdhenj, e udhëhoqi në përleshjen e përgjithshme gjatë luftës së ashpër pér lirinë dhe pér pavarësinë e vendit të tij.

Unë jam i sigurt se një vendim i tillë do t'i përforcojë ndjenjat e dashurisë dhe të mirënjohjes së popullit shqiptar kundrejt fuqive aleate dhe do t'i lejojë këtij të vazhdojë të japë kontributin e tij modest në veprën e paqes dhe të marrëdhënjeve miqësore në mes kombeve.

Pranoni, Shkëlqesë, sigurimet e konsideratës sime më të madhe.

Kryetari i Këshillit të Ministrave
të Qeverisë Demokratike të Shqipërisë
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 179,
26 korrik 1945*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 179,
26 korrik 1945*

**PËRSHËNDETJE NË EMËR TË QEVERISË
DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË KONGRESIT
TË PARË TË FRONTIT DEMOKRATIK**

5 gusht 1945

Të dashur shokë,

Në emër të qeverisë ju përshëndes nga zemra dhe ju uroj punë të mbarë.

Lufta jonë e madhe jo vetëm që çlroi vendin nga okupatori dhe kuislingët, por zgjoi masat e gjera të popullit, i bëri këto të interesohen drejtpërdrejt për problemet e vendit, e nxori popullin në planin e parë dhe i dha frenat e drejtimit dhe të qeverimit. Ardhja e popullit në fuqi është garancia më e madhe dhe më e sigurt e së ardhmes së lumtur të atdheut tonë. Një popull që vetëqeveriset me tërë kuptimin e fjalës dhe që udhëhiqet në punën e tij prej parimeve të drejta dhe të vërteta demokratike, ai popull është i destinuar të shkojë përrapa. Populli shqiptar po shkon drejt kësaj rruge me sigurinë më të madhe, pse ai është i organizuar dhe i frymëzuar politikisht si duhet.

Edukata politike e drejtë dhe organizimi i masave të gjera të popullit ishin kondita sine qua non të fitores

mbi armikun. Këto qëndrojnë përsëri në planin e parë për realizimin e fitoreve të ardhshme.

Të nxjerrim konkluzione të mëdha nga kjo luftë që na kushtoi kaq gjak dhe rrënime. Regjimet antipopullore dhe okupatori u përpoqën ta skllavëronin popullin tonë, ta mbanin në errësirë, ta përdornin si kafshë, t'ja lidhnin buzët me një fashë të fortë për ta hequr prej hunde për realizimin e qëllimeve të tyre. Gjatë pesëmbëdhjetë vjetëve nën regjimin e Zogut populli ynë harroi ç'ishte liria e fjalës, liria e shtypit, liria e organizimit. Çdo tentativë në këtë drejtim mbytej me gjak; liri kishin vetëm hajdutët. Okupatori fashist ishte dhe më zanatçi për të shtypur popujt. Të paktë ishin ata që besonin thellësish në ringjalljen e ndërgjegjes së popullit tonë, mbi të cilin kishin kaluar kaq valë mjerimi. Detyra e kësaj pakice ishte të ngjallte besimin e popullit shqiptar në forcat e tija të mëdha, të ngjallte besimin në fitoren e tij. Kjo gjë u arrit me edukimin politik të popullit dhe me organizimin e tij për luftë; këtë gjë e bëri Fronti Nacional-Çlirimtar.

Anarki në organizim dhe në mendime do të thotë ta çosh popullin në greminë. Këtë gjë synonte reaksiuni ndërkombëtar dhe fashizmi okupator, këtë metodë pune u këshillonte armiku i huaj tradhëtarëve shqiptarë. Kusilingët shqiptarë, nën maska të ndryshme, me manevra pseudonacionaliste dhe pseudodemokrate, krijuan në mendjen e mjafit njerëzve një kaos, që kishte për qëllim ndalimin e organizimit të popullit në një front të përbashkët lufte kundër fashizmit. Në fillim të luftës sonë, kur organizimi mungonte, armiku kishte dorë të lirë dhe manevronte më lirisht në fatin e vendit tonë,

por me përbushjen e programit të Frontit, çdo gjë ndryshoi, pse ndër kampet ndërluftuese qëllimet dhe metodat ndryshonin qind për qind. Nga një anë luftohej për popullin dhe me popullin dhe nga ana tjetër kundër popullit dhe me okupatorin. Kauza e drejtë e popullit do të fitonte patjetër, sikundërqë fitoi.

Ushtria e popullit u ngrit më këmbë, e fortë dhe sulmuese. U rrëzua pushteti i vjetër dhe antipopullor dhe në vend të tij u ngrit pushteti demokratik i këshillave. Populli shqiptar u lidh ngushtë me Frontin Nacional-Çlirimtar, sepse kuptoi qëllimet e lëvizjes¹, që ishin qëllimet dhe aspiratat e tija. Me ndërgjegje të plotë populli kuptoi se duhej të organizohej në Front, për ta luftuar si duhej okupatorin dhe trádhëtarët, ai kuptoi se duhej të vepronte i disiplinuar në konditat e vështira të luftës. Populli shqiptar, me nuhatjen e tij të shëndoshë dhe me edukatën politike, që fitoi pak nga pak, arriti të kuptojë situatat që krijoreshin dhe problemeve që i shtröheshin përpara t'u gjente zgjidhje. Këtë edukatë politike ai e mori në Front, i cili edukonte dhe drejtonte masat në luftë për çlirim, në luftë për marrjen e pushtetit, në luftë për rindërtimin e vendit dhe përmirësimin e gjendjes. Front politik i gjithë popullit, Front Demokratik, ja ç'i duhej Shqipërisë në kohën e luftës, ja ç'i duhet Shqipërisë tanë në kohën e paqes, sepse detyrat që na vihen përpara në këto kohëra janë aq të rëndësishme dhe vitale, sa edhe ato të kohës së luftës. Këto detyra nuk mund të kryhen vetëm, nuk mund t'i kryejnë as pesë dhe as njëqind veta. Sikundër problemet e luftës u zgji-

¹ Lëvizja nacional-çlirimtare.

dhën vetëm me pjesëmarrjen aktive të të gjithë popullit tonë, ashtu edhe problemet e sotme mund të zgjidhen vetëm kur i gjithë populli të interesohet, të aktivizohet, të edukohet dhe t'i marrë me shpirt e me zemër të gjitha çështjet, që janë vetëm çështjet e tija. Këtu do të qëndrojë detyra dhe roli i madh dhe historik i organizatës politike të Frontit. Në Front, me përjashtim të fashistëve dhe të profashistëve, të gjithë jo vetëm që kanë vendin e tyre, por është detyrë e shenjtë të marrin pjesë aktivisht. Fronti i popullit duhet të bëhet tribuna e madhe e popullit, ku të gjithë të shfaqin lirisht mendimet e tyre, të rrahin problemet e vendit, të jenë frymëzuesit dhe njëkohësisht mbrojtësit më të vendosur të vendimeve, të ligjeve e të dekreteve të pushtetit e të qeverisë. Asgjë nuk mund të realizohet në rast se pushtet dhe popull nuk është një njësi e fortë, e koordinuar, e organizuar. Pa këtë njësi të shëndoshë nuk mund të fitohej lufta, nuk mund të mbrohet pavarësia jonë e fituar me kaq gjak e sakrifica, nuk mund të shfarosen nga rrënjet mbeturinat e tradhëtisë, nuk mund të demaskohen ata që në errësirë përpiken t'i hedhin zgjedhën në qafë përsëri popullit. Pa pjesëmarrjen e gjithë popullit do të ishte shumë zor të realizoheshin sukseset që kemi arritur në çdo lëmë aktiviteti brenda këtyre dhjetë muajve. Si mund të realizohen reformat e mëdha shoqërore dhe ekonomike që qeveria ka në program dhe që populli i dëshiron me këmbëngulje dhe me gjithë shpirt se janë të drejtat e tija, se për realizimin e tyre ai u vra e u dogj, po s'ekzistoi ky unitet i fortë mendimesh dhe pikëpamjesh, po s'ekzistoi entuziazmi dhe vrulli i të gjitha mësave në punë? Këtu qëndron roli i madh i organizatës së

Frontit. Stili i punës, entuziazmi, pjekuria në mendime, qëndrimi i drejtë politik dhe realizimet në Shqipërinë e re demokratike do të janë pasqyra e Frontit. Çdo gjë do të dalë e përsosur kur Fronti të jetë në lartësinë e detyrave të tija, kur Fronti të ketë bashkuar gjithë popullin në gjirin e vet, kur popullin ta edukojë politikisht, ta mobilizojë dhe në mënyrë të organizuar të bëhet krah i pushtetit e i qeverisë për realizimin e gjithë planeve të punës. Ekziston një mendim i gabuar që duhet luftuar dhe që përmblidhet në këto shprehje: «Të presim se mendon qeveria për këtë punë; e zgjidh qeveria këtë gjë», etj. Kjo mënyrë të menduari ishte e përshtatshme për regjimet e kaluara, ku populli ishte një faktor i dorës së dhjetë, po jo për kohën e sotme.. Forca e qeverisë së sotme qëndron te populli. Dhe kur qeveria thotë të luftojmë fashizmin dhe mbeturinat e tij, të luftojmë spekulimin, të forcojmë pushtetin, të forcojmë ushtrinë, të zbatojmë drejtësisht ligjet dhe vendimet, qeveria i bën thirrje gjithë popullit të aktivizohet në këtë drejtim, të luftojë ashpërsisht. Me një punë të tillë dinamike dhe me një luftë të ashpër dhe sistematike, ne do t'u presim hovin atyre që përpiken çdo ditë të pengojnë fitoren e plotë të një demokracie përparimtare, që përpiken të ruajnë pozitat e tyre të privilegjuara dhe mallin e grabitur prej popullit. Këtu qëndron roli i madh i Frontit në zhdukjen e mentaliteteve të trashëguara nga e shkuara e zezë.

Lufta e edukoi popullin të vërë përpara interesit të thjeshtë vetjak, interesin e madh të përgjithshëm dhe përkëtë interes të përgjithshëm ai të sakrifikojë çdo gjë gjer edhe jetën e tij. Populli e kuptoi se interes i thjeshtë

vetjak do të shikohet dhe do të përmbushet kur interes i përgjithshëm të shihet me një sy objektiv dhe të punohet në këtë drejtim. Fronti e ka për detyrë që këtë fitore të luftës ta mbajë gjallë, se vetëm në këtë mënyrë do të zgjidhen problemet e mëdha dhe të përgjithshme, zgjdhje që plotëson dhe nevojat individuale. Një nga problemet e rëndësishme, që do të na vihen në këto momente, është dhe zgjedhja e Asamblesë Kushtetuese, e cila do të bëjë Statutin e Shtetit dhe do të caktojë formën e regjimit. Këtu Fronti duhet të luajë rolin e madh dhe të luftojë për Asamblenë Kushtetuese, të preqatitë politikisht popullin për zgjedhjet, të bëjë që në këtë asamble të madhe historike të përfaqësoshet populli që ka vuajtur, që ka luftuar, populli i ndershëm dhe punëtor, me një fjalë populli punonjës e patriot shqiptar, i cili t'i japë vendit të vet regjimin që ai dëshiron.

Shokë,

Populli që na ka deleguar në këtë kongres ka pasur besim të madh te ne dhe ne duhet ta meritojmë këtë besim. Duhet me vëmendje të madhe të ndjekim punimet e këtij kongresi, të përfitojmë nga këto mësimet dhe pas këtij kongresi Fronti Nacional-Çlirimtar, që ka korru kaq suksese gjer tani, të bëhet organizata e gjithë popullit, Fronti i popullit dhe të korrë suksese të lavdishme.

Rroftë Kongresi i parë i Frontit!

Rroftë populli shqiptar!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 189,*

7 gusht 1945

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 189,*

7 gusht 1945

FJALA E MBAJTUR ME RASTIN E ZGJEDHJES PRESIDENT I FRONTIT DEMOKRATIK

8 gusht 1945

Të dashur shokë,

Ky besim dhe ky entuziazëm që shfaqni, më mbush zemrën me kurajo të madhe, pse shoh që populli ynë është më i vendosur se kurrë për të mbrojtur të drejtat e tija. Dhe unë si djalë i popullit, po ju betohem se besimin që ka populli te unë dhe te shokët e mi, do të bëjmë çmos, gjer në vdekje, që ta meritojmë.

Populli ynë, i cili bëri kaq sakrifica, që derdhi kaq gjak, meriton të rrojë më mirë dhe ne, të gjithë sa jemi këtu, përfaqësuesit e popullit, kemi bindje se me këtë entuziazëm, vullnet dhe guxim do të arrijmë nga suksesi në sukses. Unë dhe shokët e mi, që do të zgjidhen¹ në Kryesinë e Frontit, ju sigurojmë se do të vëmë të gjitha energjitetë dhe forcat tona që Fronti të bëhet me të vërtetë organizata politike për ta drejtuar popullin drejt një së ardhmeje të lumtur. Për t'ja arritur këtij qëllimi populli

¹ Presidenti i Frontit Demokratik u zgjodh drejtpërdrejt nga kongresi, përpara se të zgjidhej Këshilli i Përgjithshëm.

ynë duhet të sqarohet për çdo gjë, pse vetëm në këtë mënyrë ai do të mund të përmirësojë gjendjen e tij.

Këto detyra të Frontit janë me një rëndësi të jasht-zakonshme. Prandaj ju, shokë delegatë, që do të shkoni tanë nëpër krahinat, duhet që këto detyra t'i zbërtheni në popull, t'i konkretizoni dhe të bëni që ai t'i përvishet punës me mish e me shpirt, pse nga rezultati dhe nga puna jonë do të varet e ardhmja e vendit.

Me brohoritje ju kërkonit Republikën Demokratike. Patjetër kjo është dëshira e popullit dhe, po të punojmë si duhet ne të Frontit, po të sqarohet mirë populli mbi regjimet e vjetra, regjimet e satrapëve, regjimin e Zogut dhe regjimin e fashižnit, ai patjetër do të votojë për Republikën.

Ju faleminderit edhe një herë dhe ju uroj punë të mbarë.

Rroftë populli shqiptar!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 191,
9 gusht 1945*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 191,
9 gusht 1945*

FJALA E MBYLLJES NË KONGRESIN E PARE TË FRONTIT DEMOKRATIK

9 gusht 1945

Të dashur shokë,

Kongresi ynë i madh mori fund më sukses. Për pesë ditë rresht u manifestuan, në mënyrë të shkëlqyer, vullneti i madh dhe dëshirat e popullit tonë. Kjo gjë u bë me një entuziazëm, me një bindje dhe me një besim edhe më të madh se ai i kohës së luftës. Kjo tregon se populli ynë është plot dinamizëm dhe ecën kurdoherë përpara. Kjo duhet të na gjëzojë dhe të na forcojë për punën tonë.

Fronti Demokratik është bërë një realitet i shëndo-shë, pse ai është i gjithë populli ynë i pajisur me virtutet e larta dhe mendjenjat e holla që karakterizojnë njerëzit e vendit tonë. Fronti ynë është bërë një realitet, pse cilido që bën pjesë në të ka kuptuar rolin që duhet të luajë në jetën kolektive, ai ka kuptuar se duhet të jetë një ndërtues i ndërgjegjshëm. Me këto cilësi duhet të përpinqemi të pajisim gjithë popullin tonë.

Nuk dua të zgjatem mbi detyrat e Frontit, pse këto u prekën shumë dhe si duhet, vetëm dua të ritheksoj edhe një herë karakterin demokratik të Frontit. Gjaku

i shenjtë i popullit tonë u derdh për ngritjen e një demokracie të vërtetë dhe jo për një demokraci false. Prandaj s'duhet ta lejojmë kurrë që Fronti të bëhet arma e disa prapanikëve që do të përpiken arbitrarisht ose me mënyra tarafi të zgjidhin çështjet dhe problemet në interesin e tyre vetjak. Fronti duhet të jetë arma politike e gjithë popullit, ajo që do të edukojë masat, do të sqarojë të gabuarit dhe do të demaskojë armiqtë e popullit. Të gjithë njerëzit s'janë njësoj, këtë e dimë të gjithë dhe s'them ndonjë gjë të re, por të dish t'i marrësh njerëzit ashtu si janë me të mirat dhe të metat e tyre e t'i çosh në rrugën e mbarë të përparimit për të mirën e përgjithshme, kjo është një punë tjetër dhe shumë delikate, që s'e bën dot çdo njeri, por që Fronti ynë duhet ta bëjë. Që ta bëjmë këtë gjë duhet të luftojmë sektarizmin dhe paragjykimet në punën tonë. Ta lëmë lirisht tjetrin të flasë, të shprehët pa ndrojtje, të kritikojë gabimet që mund të bëjnë njerëzit e pushtetit, qoftë ky dhe nga ata që kanë humbur tre djem në luftë, ose janë plagosur pesë herë. Çdo njeri mund të gabojë dhe me një kritikë të tillë të shëndoshë punët shkojnë përpara dhe Fronti ynë e pushteti bëhen më demokratikë. Është një gabim të cilësojmë disa njerëz përnjëherë si reaksionarë dhe të refuzojmë kontributin e tyre. Ka shumë nga këta njerëz që u dhimbet çështja e popullit, që për një arësy ose për një tjetër kanë qëndruar larg e neutralë përpara evenimenteve të mëdha që ndryshuan krejt situatën në vendin tonë. Këta njerëz janë akoma të dezorientuar, por unë kam bindjen se ata mund të bëhen njerëz të mirë, po të dimë të punojmë me ta. Sjellja jonë e mirë me ta s'do të thotë aspak oportunizëm kundrejt tyre, por është vetëm një qëndrim

i drejtë i njerëzve që nuk lodhen për të shkëputur nga thonjtë e reaksionit mendje dhe krahë që t'i shërbejnë popullit. Në punë do t'i shohim këta njerëz në janë të mirë a të këqinj, në punë do t'u shohim zotësinë dhe vlerat e tyre, në punë do të shoshiten të këqinjtë dhe do të luftohen armiqjtë e popullit. Të mos kemi frikë nga këta njerëz, se kalaja e popullit është shumë e fortë dhe, po të punojmë në këtë drejtim, ajo do të forcohet edhe më tepër. Shihni si bien në dorën e drejtësisë kuislingët njëri pas tjetrit. Dje ishte radha e Pater Anton Harapit dhe e Lef Nosit, u shfaros krejt banda e Abaz Kupit me Bilal Kolën e Macukullës në krye, kurse nesër do të jetë radha, patjetër, e disa banditëve si Gjon Markaj që kanë shtypur popullin trim të Veriut dhe që tani s'gjejnë vend ku të futen. Këta njerëz s'i mban vendi, ata i ndjek populli këmba-këmbës për t'u hakmarrur. E vetmja shpresë e këtyre banditëve ka qenë dhe është bajoneta e huaj. E pamë sa u vlejtën bajonetat gjermane dhe italiane. Kohërat ndryshuan për ta dhe për Shqipërinë. Lufta e drejtë dhe heroike e popullit tonë dhe puna e pastër që bëhet në Shqipërinë e re shikohen me admirim nga gjithë vendet përparimtare. Pozitat tona ndërkombëtare forcohen dita-ditës. Le të lehin dhe le të spekulojnë të gjithë ata parazitë, që s'kanë asnjë vlerë morale, mbi vonësën e njohjes së qeverisë sonë. Qeveria jonë duhet të njihet dhe klikat e reaksionit ndërkombëtar s'do të jenë dot në gjendje që të shtypin vullnetin e popujve të lirë, ata s'do të jenë dot në gjendje t'u fshehin për shumë kohë popujve përparimtarë të vërtetët e madhe mbi Shqipërinë. Opinion i përbotshëm po sqarohet dita-ditës për situatën e vendit tonë. Korrespondentë të gazetave

të mëdha të Evropës dhe të Amerikës kanë ardhur të bien në kontakt me popullin tonë të vogël që hodhi në balancën e luftës antifashiste çdo gjë që kishte. Ata do të shohin me sy dhe duhet të sqarojnë popujt e tyre sa e ashpër ka qenë lufta jonë, sa besnikë i kemi qëndruar dhe po i qëndrojtmë aleancës së madhe, sa e gjerë dhe e vërtetë është demokracia jonë, sa me shpirt e me kurajo i është përveshur populli ynë i varfëruar punës për rindërtim. Ata do të çuditën, pse në asnje vend të botës nuk ka ngjarë që brenda pesë muajve, pa ndihmën e askujt dhe me gjithë varfërinë e madhe, të ngrihen në këmbë gjithë urat në Shqipërinë tonë, ura që regjimit të Zogut i janë dashur pesëmbëdhjetë vjet për t'i ndërtuar. Dhe një i lehtë nga mendja mund të kuptojë se këto mrekuillira nuk bëhen përveçse në ato shtete ku pushtet dhe popull janë një dhe të pandarë, në ato shtete ku armiqtë e popullit zbulohen dhe dënohen, në ato shtete ku ka demokraci. Numërohen me gisht ato shtete demokratike të pasluftës, ku reformat e mëdha sociale dhe ekonomike po bëhen me një ritëm të shpejtë dhe me sukses të madh, ku thërritet populli lirisht të votojë për çdo gjë në mënyrën më demokratike për Asamblenë e madhe Kushtetuese, për formën e regjimit që dëshiron t'i japë vendit të tij. Një nga këto vende të pakta, me të vërtetë demokratike është Shqipëria. Prandaj asgjë s'na tund, pse jemi në rrugë të drejtë. Ta ndjekim këtë rrugë me krenari dhe me ballë hapët për të mirën e popullit tonë dhe për të mirën e blokut të madh të popujve përparimtarë! Fatet e vendit tonë janë vetëm në duart tona dhe të askujt tjetër, prandaj të mos na zërë gjumi gjersa t'ja sigurojmë qind për qind atdheut të ardhmen më të lumenjve.

tur. Sa për të drejtat tona në fushën ndërkombejtare, të cilat duhet të na njihen patjetër, kemi të drejtë të themi me krenari se s'na dhurohen, por i kemi fituar me gjak e me djersë dhe i kemi merituar plotësisht.

Shokë të dashur,

Të shtérngojmë radhët tona, të forcojmë bashkimin e gjithë popullit tonë, ta bëjmë Frontin tonë Demokratik një barrierë të çelniktë, ku armiku të mos gjejë asnjë të çarë për të na dëmtuar, të punojmë pareshtur dhe pa u lodhur për vendin tonë. Ky duhet të jetë betimi solemni i njerëzve të rinj të Shqipërisë së re demokratike që duhet t'i bëjnë popullit të tyre të dashur.

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë Fronti ynë Demokratik!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 192,
10 gusht 1945*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 192,
10 gusht 1945*

TA KUPTOJMË SI DUHET REFORMËN AGRARE¹

2 shtator 1945

U realizua më në fund ëndrra e katundarëve tanë, ëndrra e gjyshërve dhe e stërgjyshërve të tyre, ëndrra e gjithë patriotëve të vjetër e të rinj, ëndrra e të gjithë atyre që e duan popullin shqiptar dhe Shqipërinë. Katundarët tanë u gdhinë me tokë të tyre.

Vendimi historik i Këshillit Antifashist² po depërtton si rrufe në gjithë Shqipërinë dhe te dera e kasolles, çdo bujk shqiptar me duart në ijë, i lodhur e i këputur nga vuajtjet e shekujve, po me kryet lart dhe mushkëritë plot ajër të pastër dhe të lirë, do t'i thotë gruas dhe kalamajve: «S'jemi më skllevër! Sot gjithë toka është e jona, përjetë e jona!» Dhe shpirti i tij i zhuritur do të çohet lart e me lot në sy do të kujtojë burrat që ranë dëshmorë në këtë luftë të madhe për lirinë e tij, për të drejtat e tij.

Fitorja është e madhe dhe kjo u arrit se u derdhën rrëke gjaku, se i gjithë populli u bashkua si një trup

¹ Artikull botuar në gazeten «Bashkimi» me rastin e shpallojës së «Ligjit të reformës agrare».

² Është fjalë për «Ligin e reformës agrare», aprovuar nga Kryesia e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar më 29.8.1945.

përpara rrezikut të madh dhe të përbashkët, se populli u udhëhoq nga parime të drejta dhe të shëndosha, që përfaqësonin dëshirat dhe aspiratat e tij dhe se u udhëhoq nga djemtë që dualën nga gjiri i tij plot plagë. Këto janë arësyet e fitoreve, që tanë i ka kuptuar i madh e i vogël.

E shkuara e katundarisë sonë ka qenë e zczë: feudalët xhelatë, Vrionasit, Vërlacët, Toptanasit, bejlerët e Këlcyrés e të Libohovës, Bushatllinjtë, Zogu dhe Krosët e të tjerë, i kishin pirë gjakun katundarit tonë. Jeta përkötë ishte skëterrë. Katundarët tanë gjatë historisë janë çuar me pushkë në dorë kundër këtyre satrapëve për të fituar lirinë e dëshiruar. Këto kryengritje katundarësh janë mbytur në gjak, se s'ishin të organizuara si duhej dhe ishin me karakter të ngushtë lokal. Katundarët e Mallakastrës me trimin Rrapo Hekali¹ luftuan, por lëvizja e tyre s'mori hov, u lokalizua dhe u shtyp. Katundaria e Shqipërisë së Mesme mori zjarr, u bë një lëvizje serioze kundër feudalëve latifondistë. «Rebelët» e Haxhi Qamilit² dogjën kullat e bejlerëve, rrëmbyen pasuritë e tyre, tokat e tyre, por feudali Esat Toptani i shpartalloi, i vrau, i dogji katundarët trima të Shqipërisë së Mesme dhe u hodhi përsëri zgjedhën shekullore. Nipërit e Esat Toptanit, Zogu dhe klika e tij e bejlerëve të degjeneruar

¹ Rrapo Hekali, fshatar nga Hekali i Mallakastrës, një nga udhëheqësit e kryengritjes fshatare të Shqipërisë së Jugut në vitet 1847–1848 kundër zbatimit të reformave të Perandorisë Otomane, që shkaktonin rrënimin ekonomik të masave fshatare.

² Haxhi Qamili, udhëheqës i kryengritjes fshatare të Shqipërisë së Mesme në vitet 1914–1915. U vra nga forcat e feudalistit Esat Pashë Toptani.

dhe hajdutë, për pesëmbëdhjetë vjet punuan për të forcuar pozitat e tyre në kurrizin e katundarit. Lumo Skëndot, Ali Këlcyrët, Bushatllinjtë, Qemal Vrionët, Shefqet Vërlacët e Biçakçinjtë dhe të gjithë shokët e tyre u lidhën me okupatorin për të përjetësuar traditat e vjetra të feudalizmit, u lidhën me okupatorin që kishte shkelur vatrat tona e të katundarisë në radhë të parë. Ata u bashkuan me atë armik që synonte kolonizimin e Shqipërisë nga Italia, me atë armik që përpiquej të bënte popullin shqiptar skllav të bejlerëve, të gjermanëve dhe të shërbëtorëve të tij shqiptarë.

Por sot kjo ëndërr e tmerrshme mori fund, ua shtypëm kokën gjakpirësve feudalë. Reforma agrare i dha grushtin e vdekjes klasës feudale dhe e mbylli përgjithnjë faqen e historisë së saj plot tmerr, turp, shfrytëzim dhe gjak.

Sot ndërroi faqja e Shqipërisë, mbi të frys një erë e re, frys era e lirë e maleve tona, frys era e lirisë, për të cilën dhanë jetën e tyre me mijëra djem të popullit, frys era e reformave të mëdha që do të lulëzojnë vendin dhe do ta çojnë popullin në sferat më të larta sociale, ekonomike dhe kulturale.

Reforma e madhe e sotme e ndarjes së tokës duhet të kuptohet drejt prej të gjithëve: prej atyre që përfitojnë nga kjo reformë dhe prej atyre që preken. Përqashojmë ata njerëz që preken nga kjo reformë, feudalët çifliksahibinj, për të cilët e dhamë mendimin tonë më lart dhe që është mendimi i gjithë popullit shqiptar.

Po të studjohet me kujdes reforma jonë agrare, do të shikohet se legjislatorët e popullit tonë janë përpjekur të godasin përgjithnjë feudalizmin shtypës dhe

shfrytëzues dhe të mbrojnë katundarin e varfër dhe katundarin e mesëm. Ligji i reformës agrare zhduk sistemin e cifliqeve të mëdha të shtetit dhe private në favor të katundarëve, ndan pronat tokësore të katundarëve në një mënyrë të drejtë dhe të mjaftueshme për të gjithë... Reforma agrare, natyrisht, u bë për të ndihmuar katundarët dhe në radhë të parë katundarin e varfër dhe, që të mundim të përballojmö kërkesat e mëdha që paraqiten, u desh që të preken pronarë të mesmë jo bujq, që rrinë nëpër qytete dhe merren me profesione të tjera. Kjo është e natyrshme: gjithkush punën e tij. Nga ana tjetër, dhe kjo është një masë e drejtë, reforma godet të gjitha ato forma të parazitizmit dhe tendenca të theksuarë në një kategori pronarësh, që kërkojnë të bëjnë një jetë të rehatshme me të ardhura të bollshme dhe pa kurrrfarë mundimi. Toka e punuar në vendin tonë nuk është në sásira të mëdha. Për të mundur të shtojmë sasinë e tokës së punuar dhe të kënaqim që të gjithë, duhet punë, duhen bënikime, të cilat qeveria i ka në programin e vet, por që nuk mund të realizohen përnjëherë. Në fushat e gjera do të vendosen një numër i madh bujqish, por në disa vende, si për shembull, në Dropull e në afërsi të disa qyteteve ku ka bujq dhe që njëkohësisht pronari i tokës¹ ka aq pak tokë, saqë ligji i reformës nuk e prek, detyrohem i ta shpronësojmë këtë pronar në favor të bujkut.

¹ Është fjala për zanatçinj ose njerëz të profesioneve të ndryshme që banonin nëpër qytete dhe që zotëronin edhe ngastra tokash të cilat nuk i punonin vetë, por ua jepnin për t'i punuar fshatarëve pa tokë ose me pak tokë, kundrejt shpërbimit në të holla ose me prodhime bujqësore.

S'mund të kuptohet ndryshe një demokraci pa bërë reforma të mëdha shoqërore, ekonomike, politike dhe kulturale dhe, në radhë të parë, pa bërë reformën agrare sidomos në një vend si yni, ku feudalizmi ekzistonte në formën e tij më të egër, ku bujku shfrytëzohej nga ana e beut latifondist.

Lufta e madhe e çlirimit u bë dhe u udhëhoq nga këto parime. Katundarët tanë, gati në tërësi, i kuptuan dhe i përvetësuan parullat e kushtrimit dhe u hodhën pa rezerva në luftë, ata dhanë kontributin më të madh në luftën e çlirimit. Ata u treguan aleatë besnikë të klasës punëtorë dhe të Partisë së lavdishme të saj: Partisë Komuniste të Shqipërisë. Ata u bashkuan pa rezerva me Frontin Nacional-Çlirimtar; ata me punëtorët dhe me intelektualët e Shqipërisë krijuan frontin e çelniktë, që theu armikun dhe që ndërton Shqipërinë e re. Duhet të vazhdohet kjo traditë e madhe e luftës, tradita e bashkimit të shëndoshë të të gjitha shtresave të popullit punonjës e patriot se vetëm atje është e ardhmja kurdoherë më e mirë e vendit tonë. Këtu e kishim fjalën kur përmëndëm më lart se kjo reformë duhet të kuptohet drejt prej atyre që përfitojnë dhe prej atyre që preken. Pa sakrifica nga të gjithë asgjë s'arrihet, pa sakrifica dhe vetëmohim nuk fitohej lufta dhe liria. Njerëzit me vullnet të mirë do ta kuptojnë; me rezultate do të trengjnë se reforma agrare, e cila prek një kategori njerëzish dhe favorizon një pjesë tjetër, u bë në të mirën e të gjithë popullit shqiptar. Reforma agrare s'do të sillte frytet e dëshiruara, në rast se kjo reformë nuk do të shoqërohej prej reformave të tjera dhe nuk do të shkonte krahas me ndërmarrje të tjera të guximshme në lëmin

ekonomik. Këto reforma dhe ndërmarrje janë të siguruara, do të realizohen, pse kemi pushtetin, i cili është në duart e popullit. Ja garancia për të gjithë, për të gjithë ata që duan të rrojnë me nder, të rrojnë të lirë dhe të fitojnë bukën me djersën e ballit. Patjetër, s'flasim për parazitët dhe dembelët, pse ata e kanë humbur davanë në rast se nuk ecin me stilin e ri të punës dhe të jetës.

Fshatarësia që favorizohet me reformën agrare, duhet të qëndrojë e ndërgjegjshme, ashtu si ka qenë në kohërat më të rrezikshme që kalonte atdheu, duhet të kuptojë mirë detyrën e madhe ndaj shtresave të tjera të vendit tonë, ndaj punëtorisë, ndaj intelektualëve shqiptarë, ndaj mbarë popullit. Çdo katundar do të ketë tokën e tij; atë duhet ta punojë me gjithë forcat e tija, me ato mjete që ka, me «thonj e me dhëmbë», si thotë populli ynë. Qeveria do të bëjë çmos që ta ndihmojë katundarin me farë, me vegla, me kafshë, me bonifikimet, por përsëri një fjalë e urtë thotë: «Nem të të jap». Qeveri e popull janë një. Asgjë s'do të na bjerë nga qielli. Me duart tona do të ndërtohet çdo gjë. Të zhduket pikëpamja në kuptimin e vjetër: «Na ndihmon qeveria». Po, qeveria do të ndihmojë, pse për t'i shërbyer popullit është zgjedhur. Qeveria drejton energjitë e mëdha të popullit në rrugën e përparimit, rregullon pasuritë e popullit në fitim të popullit, por forca e qeverisë është në ndërgjegjen e shëndoshë të popullit, në punën e palodhur dhe të nndershme të gjithsecilit, në solidaritetin e të gjithëve, për mbarëvajtjen e të gjithë kombit.

Fshatarësia do të jetë e lumtur vetëm atëherë, kur punëtorët dhe intelektualët e Shqipërisë të jenë dhe ata

të lumtur. Aktiviteti i madh, ndërgjegja në punë, solidariteti i të gjitha shtresave të popullit tonë, janë faktori i mirëqenjes së të gjithëve. Kur ta kemi kuptuar mirë këtë dhe ta zbatojmë për rindërtimin e Shqipërisë, ashtu si e zbatuam për çlirimin e atdheut, atëhere dhe ai pronari i varfër, skeptik gjirokastrit, që ka pasur 5 stremë¹ ara dhe që i shpronësohen në favor të bujkut të Dropullit, do të thotë: «E pastë hallall bujku, pse ai di ta punojë, pse ai më sjell me bollëk grurë në pazar, pse unë kam fituar tani një ndërgjegje të re, jam punëtor, e fitoj bukën me djersën e ballit dhe familja ime është më e lumtur se atëherë, kur kisha pesë stremë ara!...».

Kjo është Shqipëria e re dhe njerëzit e rinj, këtë epokë të lavdishme po hap reforma e madhe e ndarjes së tokës. Të punojmë në këtë drejtim, se kjo është e vetmja rrugë e lumturisë së popullit tonë të shumëvaujtur.

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 211,
2 shtator 1945*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 211,
2 shtator 1945*

¹ Stremë — masë toke baras me 1 dynym.

TELEGRAAM

KRYETARËVE TË QEVERTIVE TË TRI FUQIVE TË MËDHA: BRSS, ANGLI DHE SHBA ME ANËN E TË CILIT KËRKOHET PJESEMARRJA E SHQIPËRISË NË DISKUTIMIN E TRAKTATIT TË PAQES ME ITALINË

4 shtator 1945

Shkëlqesë,

Kam nderin t'Ju parashtroj Shkëlqesës Suaj sa vijon:

Sikurse dihet nga Shkëlqesa Juaj, Shqipëria është nga vendet e para që pësoi nga agresioni i fuqive të Boshtit dhe që e nisi që në fillim lëvizjen e rezistencës së armatosur kundër fashizmit.

Për këtë shkak dëmet e luftës që i janë shkaktuar Shqipërisë kanë arritur shifra shumë të mëdha, e proporcionalisht janë më të mëdha nga ato të shteteve të tjera, viktima të agresionit të Boshtit.

Në kohën më të volitshme qeveria shqiptare do të paraqesë ku duhet një listë të hollësishme dhe objektive të këtyre dëmeve që kanë dëmtuar rëndë dhe në një mënyrë të pandreqshme sektorët e ndryshëm të ekonomisë sonë kombëtare.

Meqenëse një nga problemet me të cilat do të merret Këshilli i Ministrave të Jashtëm të fuqive të mëdha, që do të mblidhet së shpejti në Londër¹, është ai i bisedimit dhe i përfundimit të Traktatit të Paqes me Italinë, Qeveria Demokratike e Shqipërisë, interprete e dëshirave dhe e ndjenjave të thella të popullit shqiptar, është duke pritur që fuqitë e mëdha aleate t'i marrin parasysh sakrificat e mëdha morale dhe materiale që bëri Shqipëria gjatë luftës. Duke vlerësuar të drejtat e saja gjatë diskutimeve të klauzolave financiare në lidhje me dëmshpërblimet që duhet të paguajë Italia si edhe për të gjitha çështjet e tjera që do t'i interesojnë së afërmë dhe në mënyrë të veçantë Shqipërisë, jemi plotësisht të bindur se do t'i jepet mundësia për të bërë që zëri i saj të dëgjohet si pjesëtare aktive e aleancës antifashiste.

Duke marrë parasysh sa u tha më sipër, Qeveria Demokratike e Shqipërisë në bazë të të drejtave të saja dhe të gjakut të derdhur në luftën e përbashkët përkrah aleatëve të saj të mëdhenj, shpreson se fuqitë e mëdha, me kujdesin e tyre për t'i ruajtur interesat e shteteve të vegjël, do ta shqyrtojnë këtë çështje me një shpirt të gjerë dashamirësie e drejtësie ndërkombëtare dhe se ato nuk do të mungojnë ta trajtojnë Shqipërinë sikurse të gjitha shtetet e tjera të interesuara, duke e thirrur të dërgojë në Londër një delegacion që të mund t'i shfaqë

¹ Është fjala për sesionin e parë të Mbledhjes së Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme të fuqive të mëdha që u mbajt në Londër nga 11 shtator deri më 2 tetor 1945. Ky sesion u thirr sipas vendimit të Konferencës së Potsdamit për preqatjen e traktateve të paqes me Italinë, Rumaninë, Bullgarinë, Hungarinë dhe Finlandën.

para Këshillit pikëpamjet e saja në lidhje me kërkesat e veta të drejta. Pranoni, Shkëlqesë, sigurimet e konsideratës sime më të lartë.

Kryetari i Qeverisë Demokratike të Shqipërisë
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 212,
4 shtator 1945*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 212,
4 shtator 1945*

PËRGJEGJE MESAZHIT TË FAN S. NOLIT

25 shtator 1945

I nderuar zoti Noli,

Mesazhi i përzemërt që më dërguat më preku shumë dhe ju faleminderit. Për mua, për shokët e mi të luftës dhe për gjithë popullin shqiptar, fjalët Tuaja shprehin ndjenjat e larta patriotike dhe pasqyrojnë shpirtin demokrat të vëllezërve tanë të dashur të Amerikës dhe tuajat, që keni qenë shpirti dhe mburrja e tyre.

Në vuajtjet e popullit tonë, në zjarrin e rreptë pérçlirim, ku hodhëm pa rezerva gjithë forcat tona pér kauzën e shenjtë të atdheut dhe të njerëzimit, ne mbanim të pashuar në zemër kujtimin dhe dashurinë pér ju, o vëllezërit tanë të Amerikës, që në çdo moment keni luftuar pér atdheun tonë të shenjtë dhe të përbashkët.

Shqipëria, pér lirinë dhe pavarësinë e së cilës ranë me mijëra djem të popullit, Shqipëria pér të cilën, i nderuar zoti Noli, keni shkrirë energjitet Tuaja, sot është e lirë; sot në qellin e saj valon flamuri i pavarësisë dhe i demokracisë.

Populli ynë heroik që dha prova të shkëlqyera në këtë luftë, me besim të madh në forcat e veta, i është

përveshur punës për të ndërtuar një të ardhme të lulëzuar. Dhe në përpjekjet tona për t'ja arritur këtij qëllimi do të jemi të gjëzuar që Ju, si një luftëtar i palodhur për pavarësinë dhe demokracinë shqiptare, të jeni në gjirin e ngrohtë të popullit tuaj, për t'i dhënë ndihmën tuaj të çmueshme dhe për të kurorëzuar përpjekjet e vlefshme në atdheun ku triumfuan idealet e popullit.

Mua ma do zemra që, në zgjedhjet e aférme për Asamblenë Kushtetuese, emri Juaj të figurojë tok me tanë¹ dhe populli shqiptar, lirisht dhe demokratikisht të sanksionojë përpjekjet dhe veprat tona të përbashkëta. Ashtu si kemi qenë kurdohërë të bashkuar me zemër në luftën tonë, ashtu të jemi edhe tani e përgjithmonë për të mirën e popullit tonë të dashur dhe për mbrojtjen e paqes së njerëzimit.

Gjeneral-Kolonei

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 229,
25 shtator 1945*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 229,
25 shtator 1945*

¹ Në zgjedhjet e 2 Dhjetorit 1945 për Asamblenë Kushtetuese, PKSH vendosi të paraqitej një listë e vetme e kandidatëve të Frontit, në të cilën do të bënin pjesë të gjithë kandidatët e Frontit Demokratik.

**RAPORT I MBAJTUR NË EMËR TË QEVERISË
DEMOKRATIKE NË SESIONIN E TRETE TE
KËSHILLIT ANTIFASHIST NACIONAL-
-ÇLIRIMTAR**

26 shtator 1945

Shokë këshilltarë,

Po mbushen dhjetë muaj që nga sesioni i dytë i Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar që u mbajt në Berat, ku në mbledhje solemne përfaqësuesit e popullit na ngarkuan detyrën e rëndë: drejtimin e punëve të shtetit. Qeveria Demokratike e Shqipërisë që kam nderin të kryesoj, duke paraqitur para jush veprimtarinë e saj, përulet me nderim përpara popullit tonë, i cili me një vullnet të çelniktë ka qenë faktori kryesor i realizimeve të shkëlqyera të kryera në një kohë kaq të shkurtër dhe kaq të vështirë.

Në prakun e çlirimit të plotë të Shqipërisë, qeveri e popull ishin të ndërgjegjshëm për vështirësitë e mëdha që do të gjenin në rrugën e tyre dhe të detyrave të rënda që duhen kryer. Lufta e madhe e ashpër që bëmë na kishte bërë të gjithëve realistë dhe objektivë, na kishte edukuar të mos trembeshim nga rreziqet, t'u bënim ballë këtyre dhe t'i kapërcenim. Lufta nacional-

-çlirimtare na mësoi, nga ana tjetër, se pa një bashkim të fortë e me baza të shëndosha të të gjitha energjive të kombit nuk mund të shkohej përpara. Me gjak të kulluar e të vlefshëm të djemve të Shqipërisë e paguam kalbë-sirën e regjimeve të kaluara dhe të njerëzve tradhëtarë që shitën atdheun dhe popullin te i huaji. Lufta nacional-çlirimtare na mësoi se për interesat e larta të kombit dhe për të siguruar të ardhmen e tij, duhej spastruar rruga dhe duhej të bënim që mbeturinat e tradhëtisë të mos na dëmtonin në punën tonë ndërtimtare.

Ktheni kujtimin tuaj, shokë, dhjetë muaj prapa, kur ushtria jonë, e zhveshur, por e mbuluar me lavdinë e fitoreve të panumërtë, po ndiqte këmba-këmbës hordhitë e Hitlerit dhe kriminelët tradhëtarë dhe mendoni në ç'gjendje të vajtuar ishte atdheu dhe populli ynë. Vetëm ai popull, vetëm ata njerëz që luftuan me mish e me shpirt, që njohën mjerimet e luftës, që u kullonte zemra gjak, kur shihnin fshatrat dhe qytetet e tyre të merrnin flakë, kur shihnin të binin heroikisht në fushën e nderit bijtë më të mirë të popullit që luftonin për liri dhe për një të ardhme më të mirë, nuk mund të dekura-joheshin përpara asaj situatë të vajtuar, pse ata kishin jetuar në situata edhe shumë më të vështira. Ky besim i madh në forcat krijuar, që ushqente populli ynë dhe njerëzit e rinj që dolën nga kjo luftë, e shpëtoi Shqipërinë.

Materialisht ishim në hall të madh. Me qindra e me qindra fshatra ishin bërë shkrumb e hi, numri i shtëpive të djegura e të rrënuara në gjithë Shqipërinë kalonte shifrën kolosale 23 000, popullata të krahinave të tëra ishin në udhë të madhe, pa strehë, pa bukë, pa veshje.

Të gjitha urat e Shqipërisë, të mëdha e të vogla, ishin hedhur në erë; rrugët, portet, centralet dhe rrjetat telegrafonike ishin të shkatërruara; centralet elektrike, ujësjellësit ishin të shkatërruar ose të dëmtuar rëndë; minierat tona ishin bërë të papërdorshme; instalimet e Kuçovës, të Patosit, të Selenicës, të Rubikut, të Pishkashit etj. ishin hedhur në erë nga gjermanët, rrugët ishin të prishura dhe pothuaj gjithë automjetet ishin të shkatërruara ose të dëmtuara rëndë, përveç grabitjeve të mëdha që na kishte bërë armiku. Ekonomia jonë ishte dëmtuar rëndë dhe normalizimi i gjendjes ishte shumë i vështirë, tregëtia ishte paralizuar fare nga varfëria e madhe dhe nga konsekuenca e tjera të luftës, si dhe nga mungesa e mjeteve të komunikacionit. Bujqësia jonë ishte në gjendje të vajtuar; blektoria ishte dëmtuar pa masë. Arkat e financës së qeverisë së re ishin bosh. Okupatorët gjermanë jo vetëm që kishin grabitur 253 615 390 franga shqiptare, që garantonin pjesërisht qarkullimin e monedhës së shtuar gjatë okupacionit, por në bashkëpunim me tradhëtarët e «Regjencës», të «Ballit» e të «Legalitetit», rrëmbyen arin e popullit tonë, që arrin shumën 8 062 827 franga ar. Populli ynë i shkatëruar nga lufta ndodhej në prakun e dimrit të egër që kaloi. Këtë gjendje të mjeruar, këtë trashëgim i lanë okupatorët dhe kuislingët popullit tonë dhe Qeverisë Demokratike që doli nga Mbledhja e Beratit.

Por, nga ana tjetër, morali i popullit tonë ishte jashtëzakonisht i lartë dhe këtu qëndronte kyçi i fitoreve tona në fushën e rindërtimit dhe të rimëkëmbjes. Duhej mobilizuar gjithë populli rrëth pushtetit dhe qeverisë, duhej zhdukur mentaliteti dhe fryma e qelbur e

regjimit fashist dhe tradhëtar, duhej që edhe në qytetet të frynte era e pastër e maleve tona. Duhej bërë spastimi i elementeve tradhëtarë, i sabotatorëve, i armiqve të popullit. Ligjet e votuara për këtë punë nga Kryesia e Këshillit Antifashist dhanë kontributin më të madh. Kurrë në Shqipëri gjyqet s'kanë gjykuar me aq drejtësi, sa gjyqet e popullit të krijuara në bazë të këtyre ligjeve. Forcimi i Frontit tonë ishte në rendin e ditës, pse me një Front të fortë dhe të gjerë, ku të merrnin pjesë të gjithë, edhe ata që deri dje e kishin shikuar lëvizjen nacional-çlirimtare me një sy të shtrembër, do të mund nim të realizonim programin e punës. Fronti do të ishte mjeti që do të bashkonte energjitë, që do të ngjallte iniciativën dhe shpirtin krijues të masave, Fronti do të ishte ai që do të mbante gjallë në masat ndjenjën e sakrificës në interesin e përgjithshëm. Fronti dhe pushteti ishin në lartësinë e detyrës që u kërkohej. Duke vënë të gjitha energjitë e tyre, ata zbatuan programin e qeverisë të mbështetur në ligjet e Kryesisë së Këshillit që ju parashroi në seancën e djeshme kryetari, dr. Omer Nishani.

Cili ishte programi i qeverisë dhe si u zbatua ky program do të përpinqem t'jua tregoj me një pasqyrë të shkurtër, me të mirat dhe me të metat e tij. Ju jeni përfaqësuesit e popullit me mandat për të shqyrtaur veprimet tona.

Programi i qeverisë përmblidhej në këto pikat kryesore:

1. — Të rregulloheshin financat e shtetit.
2. — T'u vihej urgjentisht në ndihmë të mjeruarve të luftës.

3. — Të ringjallej ekonomia e vendit.
4. — Të ringjallej bujqësia dhe të viheshin në zbatim reformat e mëdha shoqërore dhe ekonomike të shpallura me ligj nga Kryesia e Këshillit Antifashist.
5. — Të rindërtohesin sa më shpejt ato që na kish shkatërruar armiku e në radhë të parë urat, rrugët etj.
6. — Të rimëkëmbej dhe të përhapej sa më shumë arësimi.
7. — Të rivendosej drejtësia në frymë të re.
8. — Të mbrohej shëndeti i popullit.
9. — Të përhapej kultura në popul.
10. — Të forcohej dhe të modernizohej ushtria.
11. — Të forcohej miqësia jonë me aleatët e mëdhenj, Bashkimin Sovjetik, Anglinë, Amerikën; të forcohej miqësia jonë me Jugosllavinë Federative dhe me gjithë fqinjët e tjerë të Ballkanit e me popujt e tjerë përparimtarë.

Si e zbatuam këtë program dhe në ç'rezultate arri-tëm po jua parashtoj më poshtë:

1. — *Në lëmin financier qeveria* jonë duhej të zgjidhte me urgjencën më të madhe një nga problemet më të rëndësishme siç ishte ai i financave të shtetit. Financat dhe Banka e Shtetit u gjendën fare të boshatisura dhe me një aparat financier tepër burokratik, gjë që e preokupoi që në fillim qeverinë tonë. Me organizimin financier të ditëve të para dhe me zëvendësimin e ligjeve fiskale, në fillim të ardhurat financiare qenë shumë të kufizuara. U punua pa pushim për të zëvendësuar sistemin e vjetër të taksave me atë që u përshtatej parimeve tona demokratike dhe përparimtare. Brenda një kohe

jo më shumë se 6-7 muaj u hodhën themelit e sistemit të ri financiar. Parimi kryesor, që u ndoq në hartimin e ligjeve të reja, ka qenë ky: pesha kryesore e barrës fiskale të rëndonte mbi ato shtresa të popullit që janë në gjendje t'u bëjnë ballë. Tatimet dhe taksat indirekte, që në buxhetet e regjimeve të kaluara ishin burimi kryesor i të ardhurave shtetërore ua lanë sot vendin e parë tatimit dhe taksave direkte, të cilat nga natyra e tyre synojnë një drejtësi më të madhe në ndarjen e peshës së shpenzimeve të përgjithshme të shtetit. E dhjeta, xhelepi dhe anakronizmat e tjera të sistemit fiskal otoman, të mbeturat trashëgim nga kohërat më të errëta të sundimit të huaj, u zhdukën një herë e mirë ngajeta ekonomike e Shqipërisë, duke lënë në këtë mënyrë bujkun dhe blektorin shqiptar të marrin frymë lirisht dhe të zënë vend si një faktor i parë ekonomik. Ligji mbi të ardhurat e këshillave nacional-çlirimtare të nënprefekturave i jep fund kaosit të madh dhe abuzimeve që karakterizonin financat e vjetra bashkiake të regjimeve të kaluara. Taksat e konsumit, që në kohët e kaluara rëndonin mbi shumë produkte të nevojës së parë, tashti kufizohen vetëm mbi alkoolin, pijet alkoolike dhe duhanin, lëndë këto që s'janë jetike për popullin, por përkundrazi, të dëmshme për shëndetin e tij. Të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurive shtetërore, që deri dje grabiteshin dhe shkonin e mbushnin xhepat e sipërmarrësve privatë vendas ose të huaj, përfaqësohen sot në kuadrin e buxhetit të ri me një burim fondesh të dorës së parë. Minierat, pyjet shtetërore, peshkimi, fermat e shtetit, fabrikat, mullinjtë dhe ndërmarrje të tjera po organizohen dhe sistemoohen në mënyrë që të jalin rendimen-

tin e të ardhurave maksimale. Gjithë këto përpjekje në lëmin financier pasqyrohen në buxhetin preventiv të shtetit për ushtrimin financier të vitit 1945—1946. Ky buxhet për herë të parë në historinë e vendit tonë arrin shumën prej 1 016 220 000 franga shqiptare, ku para-shikimet e të ardhurave barazohen me shpenzimet. Një vështrim në pjesën e shpenzimeve të buxhetit të shtetit nxjerr në shesh rëndësinë që pushteti i ri i ka dhënë:

a) Rindërtimit të vendit, duke i akorduar Ministrisë së Punëve Botore në buxhetin nacional shumën kolo-sale prej 56 887 000 franga shqiptare dhe në buxhetet lokale, në formë subvencioni shumën prej 9 584 070 franga shqiptare.

b) Riaktivizimit ekonomik, duke i caktuar Ministrisë së Bujqësisë e të Pyjeve dhe asaj të Ekonomisë 80 675 000 franga shqiptare në buxhetin nacional dhe 10 399 945 franga shqiptare në buxhetet lokale.

c) Arësimit dhe kulturës popullore, duke u akorduar ministritive përkatëse në buxhetin nacional fondin prej 41 665 000 franga shqiptare dhe në buxhetet lokale 29 074 310 franga shqiptare.

Në buxhetin e ri figurojnë kapituj shpenzimesh që hedhin baza për shfrytëzimin më të gjerë dhe racional të pasurive të nëntokës dhe të sipërfaqes së tokës së vendit dhe ngritjen e ekonomisë përgjithësisht.

Në ditët e para funksionimi i bankës paraqiste vështirësi shumë të mëdha, për të mos thënë të pakapërcyeshme, nga shkaku se, si në qendër, ashtu dhe në agjencitë e saj, arkat kishin ngelur bosh, sikundërqë e përmenda më lart, por me një punë të palodhur u organizua banka dhe tani ajo funksionon më së miri, si

në qendër, ashtu edhe në qarqe. Përveç kësaj, duke marrë parasysh rezultatet e syrsharzhimit¹ të monedhës sonë, ku okupatori kishte bërë një inflacion të madh, rezultatet kanë qenë të shkëlqyera. Nga mosparaqitja për syrsharzhim e monedhave dhe çekmonedhave arrijtëm në një pakësim të monedhës në qarkullim prej 85 814 060 franga shqiptare.

Vënja në zbatim e gjithë ligjeve të reja, nga një anë, dhe ndryshimi rrënjosor në strukturën e administratës financiare, nga ana tjetër, në pesë muajt e parë të ushtrimit finanziar, kanë vonuar vjeljen e sasisë të të ardhurave të parashikuara; por, me masat energjike që janë duke marrë organet financiare, ritmi i punës do të shpejtohet përgjithësisht dhe s'ka dyshim se shumat e parashikuara për t'u nxjerrë do të realizohen përpara mbarimit të ushtrimit finanziar në vazhdim.

2. — *Asistenca sociale* kishte një detyrë të rëndë dhe delikate, përmrbushja e së cilës ishte urgjente. Duhej shpëtuar nga vdekja, nga uria e të ftohtët ajo pjesë e popullatës, që okupatori e kish lënë në mes të katër rrugëve. Për këtë u ngritën kudo mensat popullore, të cilat u mbajtën në fillim me lekët e popullit. Solidari-teti i kohës së luftës u përforcua akoma më tepër me çlirimin e Shqipërisë. Njerëzit e vendit tonë i dhanë dorën shoqi-shoqit dhe shpëtuan me mijëra vëllezër e motra nga uria. Shuma të mëdha u harxhuan nga asis-

¹ Syrsharzhim — Vënja e një shenje të veçantë mbi bankënotat. U bë në qershori të vitit 1945 me qëllim që të zhvlefëso-heshin bankënotat që gjendeshin jashtë kufive të atdheut dhe të zbutej inflacioni.

tenca dhe nga sektionet e saja për normalizimin e jetesës në vendin tonë. 2 700 000 franga shqiptare u harxhuan gjer në fund të marsit për mbajtjen e mensave dhe për të ndihmuar ata që vuanin. Gjer atëhere u shpërndanë 3 174 kuintalë misër. Me mijëra kuintalë bereqet janë shpërndarë në krahinat e mjeruara të Jugut dhe në malësitë e Veriut. Sot ekzistojnë në Shqipëri 32 mensa, ku hanë pothuaj çdo ditë 10 000 vetë. Për mbajtjen e tyre pushteti ka parashikuar 10 360 000 franga shqiptare në buxhetin e tij. Por ne nuk kemi ndër mend të krijojmë një numër të konsideruar parazitësh dhe dembelësh, as të favorizojmë krijimin e një fryme të tillë. Përkundrazi, për të luftuar këtë tendencë, pushteti shtroi çështjen e aktivizimit të të gjithë kësaj mase e sidomos në një kohë kur vendi ka kaq nevojë.

Ministria e Asistencës ka shtruar problemin e mbrojtjes së fëmijëve që nuk e kish shtruar kurrë ndonjë regjim në Shqipëri. Për jetimët, për fëmijët jolegjitimë, asistenca parashikon në buxhetin e saj një shumë prej 720 000 franga shqiptare.

Në më të shumtata e qendrave ka nga një jetimore, po punohet edhe për krijimin e një kopshti fëmijësh në Tiranë. Në Shkodër do të krijohet azili për pleqtë dhe paralitikët, ku parashikohet të strehohen 150 vetë. Gjithë familjeve të vobekta, të dëshmorëve, të invalidëve të luftës dhe të patriotëve të Rilindjes kombëtare, ju sigurua me ligj një jetesë më e denjë. Ministria e Asistencës ka edhe një tok problemesh të tjera shoqërore që në një të ardhme jo të largët do t'i zgjidhë; në radhë të parë ajo ka ligjin e punës, i cili do të ndihmojë punëtorët e krahut dhe të mendjes.

3. — Në fushën e ekonomisë qeveria ka pasur një barrë të rëndë për normalizimin e gjendjes ekonomike të vendit. Tregëtia ishte paralizuar krejt, industria në pjesën më të madhe ishte shkatërruar dhe tërësisht e paralizuar, minierat ishin në gjendje që s'mund të punonin dhe disa ishin hedhur në erë sidomos impiantet e Kuçovës e të Patosit. Në të tilla kushte dhe me gjithë vështirësitë qeveria ka mundur t'i bëjë ballë gjendjes dhe të arrrijë këto rezultate.

a) Për tregëtinë: Ministria e Ekonomisë kohët e fundit ka vënë në zbatim disiplinimin e çmimeve. Thatasira e madhe e këtij viti na dëmtoi shumë prodhimin e bereqetit dhe ky problem ka preokupuar shumë qeverinë. Për këtë gjë u krijuua Enti i grumbullimit të drithit, i cili do të mund të sigurojë bukën dhe njëkohësisht të disiplinojë çmimin e të ndalojë spekulimin. Me masat e marra qeveria ja ka siguruar popullit bukën për sivjet.

b) Për industrinë: Pas një studimi u vunë në veprim fabrikat që kanë qenë më të domosdoshme, duke i furnizuar këto me motora të ndryshëm. Distileria «Skënderbeg» në Vlorë u vu në veprim dhe po na jep rezultate të kënaqshme. Janë marrë nën kontrollin e shtetit disa fabrika si «Birra Korça», ajo e vëllezërve Ekonomi etj. dhe janë vënë në funksionim. Është gati për të punuar frigoriferi i shtetit me kapacitet 3 000 m³. Në një kohë jo të largët parashikohet aktivizimi i të gjithë industrisë dhe për këtë po bëhen përpjekje për të siguruar maqineritë dhe pjesët e shkëmbimit. Fabrika e cimentos po funksionon dhe jep mjaft çimento të kualitetit të mirë.

c) *Për minierat*: Në Kuçovë, ku çdo gjë ishte shkattereduar, u ngritën dy distileri dhe impiantet e vajrave lubrifikante. U bë riparimi dhe ngritja e centraleve elektrike, i rrotave për pompimin e puseve e kompresorëve të gazit. U ngrit impianti fare i ri i oksigjenit. Është në mbarim e sipër distileria e tretë për benzinë e naftë që llogaritet të vihet në përdorim në fillim të nënitorit, kështu që do të kemi një shtim të konsideruar karburanti. Përsa i përket Patosit, edhe këtu vazhdojnë punimet për aktivizimin e puseve vajgurore me rëndësi. Atje do të ngrihet së shpejti një central elektrik.

Në minierën e Selenicës janë ndrequur galeritë, furrat e tretjes, dekovili gjer në Vlorë, lokomotivat dhe të tjera. Kësaj miniere, nga më të rëndësishmet, i është kushtuar një kujdes i veçantë, duke i vënë në dispozicion një numër të madh punëtorësh dhe teknikësh. Brenda tectorit do të fillojë nga aktiviteti dhe së shpejti do të kemi sasira sere të kualitetit të lartë.

Minierës së bakrit në Rubik dhe minierave të kromit u është vënë një kujdes i veçantë; janë spastruar galeritë dhe janë rregulluar teleferikët.

Plani i qeverisë përsa u përket minierave është që, brenda vitit 1946 këto të shfrytëzohen intensivisht dhe të kapërcehet niveli i arritur në vitet 1940, 1941, 1942, 1943. Janë për t'u lavdëruar shumë inxhinierë që punojnë me ndërgjegje në këto miniera e në kantieret e Kuçovës.

Nga ana tjetër janë vënë në shfrytëzim fabrikat për prodhimin e tullave, të tjegullave e të tjera. Janë dërguar apostafat inxhinierë në malësitë e Shkodrës për të studjuar çështjen e ujit të pishëm dhe

për të bërë kërkime. Në Myzeqe gjithashtu po bëhen kërkime.

4. — Në sektorin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Pyjeve veprimitaria, siç dihet, ka nisur që nga Kongresi i Përmetit. Në këtë sektor armiku na kish shkaktuar shumë dëme. Pjesën më të madhe të barrës së luftës e mbajti mbi supe fshatarësia. Ajo luftoi dhe njëkohësisht furnizoi Ushtrinë Nacional-Çlirimtare. Inkursionet dhe ofensivat e armikut rëndonin më shumë mbi katundarin, ai s'mund ta përmirësonte bujqësinë ose blegtorenë, armiku i digjte ose i rrëmbente të mbjellat, armiku i merrte bagëtinë. Populli ynë bujk dhe blegtor, duhej të kishte kujdesin e veçantë të qeverisë. Duheshin marrë masa për rimëkëmbjen e bujqësisë dhe të bujkut, që kështu të sigurohej buka e popullit dhe të ndihmohej rimëkëmbja e sektorëve të tjerë të shtetit. Masat u muanë që me çlirimin e Tiranës. U caktuan kuadrot dhe u dhanë udhëzimet si në qendër, ashtu dhe në qarqe. U blokua fara dhe Banka e Shtetit dha një kredi prej 4 000 000 franga shqiptare për farë, u organizua shpërndarja e saj ndër fshatarët. U bë plani për 16 qendra të mekanikës bujqësore në zonat më kryesore të atdheut. U porositën jashtë vegla bujqësore, insekticide antikrip-togamike dhe plehra kimike. U riorganizuan fermat e shtetit, u krijuan fidanishtet antifilokserike në Korçë, Vlorë e Shkodër, u dha ndihmë dhe u mobilizua gjithë populli në luftimin e karkalecit që u përhap këtë vit në gjithë zonat bujqësore të vendit tonë.

Në digën e Dunavecit dhe të Devollit në Korçë po plotësohen punimet; në Elbasan, Peqin, Sulovë e në shumë vende të kësaj krahine, me iniciativën e popullit

dhe me ndihmën e madhe të pushtetit janë hapur, ndërtuar ose pastruar afro 170 km. kanale vaditëse, të cilat vaditin afro 3 680 hektarë tokë; është në vazhdim e sipër kanali i bonifikimit Sejmen-Çiflik i Ri, i cili do të zgjatet gjer te këneta e Tërbufit. Është në vazhdim e sipër çelja e disa kanaleve në fermën shtetërore të Sukthit, që do të bonifikojnë 450 ha., si dhe bonifikimi i kënetës së Trushit në nënprefekturën e Lezhës. Veç këtyre janë mbaruar studimet për kanalin vaditës të Velabishtit, të Letanit, të Leshanit, të Gjadrit, të Kënetës së Thumanës, bonifikimet në zonën e Durrësit, si dhe bonifikimi i kënetës së Maliqit. Vetëm prej kësaj të fundit do të përfitohen 4 500 ha. dhe do të përmirësohen 4 500 ha. të tjerë. Është në projektim e sipër kanali vaditës Penkovë-Llakatund, që parashikohet të vaditë 2 000 ha., si edhe kanali i Ibës 25 km. i gjatë që do të vaditë 600 hektarë. Në lidhje me pyjet janë dhënë gjithë udhëzimet për mbrojtjen, shfrytëzimin dhe administrimin e tyre. Janë ndarë fidane dhe janë furnizuar të gjitha entet shtetërore me lëndë të nevojshme druri për rindërtim. Janë ngritur sharra në Shkodër, në Durrës, në Berat, në Korçë, në Leskovik dhe në Pogradec.

Janë preqatitur planet dhe preventivet për ngritjen e 8 baxhove moderne në qarkun e Gjirokastërës dhe për ndërtimin e tri-katër lerave në qarkun e Vlorës, të cilat do të sigurojnë ujin për 20 mijë krerë bagëti. Janë shpërndarë 15 000 hape antigëlbazë dhe 500 000 doza vaksina kundër plasjes, të preqatitura prej Institutit baktériologjik shqiptar. Numri i bagëtive të vaksinuara arrin në 250 000 krerë. Dispenseritë veterinare të dëmtuara prej luftës në Tiranë, Durrës, Vlorë, Korçë janë vënë në

gjendje për të funksionuar. Janë porositur të gjitha barnat e nevojshme dhe të domosdoshme për veterinari, si dhe mjetet e veglat për peshkim dhe për shfrytëzimin sistematik të të gjithë dajlaneve të bregdetit dhe të ligureve të Shqipërisë. Edukimit dhe ngritjes profesionale të bujqve të rinj i është vënë rëndësia e duhur. Me gjithë konditat e këqia dhe të disfavorshme për një veprimtari në stil të gjerë gjer më sot janë çelur mbi 70 kurse bujqësore speciale periodike ku kanë marrë pjesë më tepër se 2 100 fshatarë. Meriton të theksohet hovi dhe interesimi që tregohet për kulturën bujqësore. Në muajin shtator nga kursi i fermës së Sukthit mbaruan me sukses 38 të rinj fshatarë. Ndërkaq vazhdojnë kurset për topografi, për teknikë minierash dhe për traktoristë; ka filluar ndreqja e shkollave bujqësore të Lushnjës e të Kavajës; janë preqatitur programet për hapjen e një shkolle bujqësore në Kavajë, një kurs për amvisa bujqësore po në Kavajë dhe një kurs tjetër dymbëdhjetë muajsh në Lushnjë. Për vitin e ardhshëm është në projekt hapja e një shkolle të mesme të plotë bujqësore që do të nxjerrë kuadro agrarë.

Por suksesi më i madh i pushtetit tonë demokratik në këtë sektor është reforma agrare. Këtu nuk do të theksoj rëndësinë e madhe politike dhe ekonomike të kësaj reforme, se për këtë është folur edhe herë të tjera, po vetëm do të theksoj se ligji i reformës agrare nisi të zbatohet. Me gjithë vështirësitë që kemi pasur gjer më sot dhe relativisht me kohën, është kryer mjaft punë. Në Lushnjë janë bërë të gjitha matjet për 23 katunde dhe çifliqe dhe brenda 4-5 ditëve kryhet edhe veprimi i dorëzimit të tokave fshatarëve. Në katundet Barbullinj

e Çiflik i Ri, fshatarët kanë marrë në dorëzim tokën që u takon. Në Fier janë bërë gati për parcelim dhe për vendosje bujqish 31 çifliqe, në 9 prej të cilëve ka mbetur për t'u bërë vetëm dorëzimi i tokës fshatarëve. Brenda kësaj vjeshte parashikohet që në këto 31 çifliqe të vendosen definitivisht 717 familje me 5 986 frymë. Veç këtyre, Zyra e reformës agrare në Elbasan ka organizuar punën preqatitore për ndarjen e tokave. Në të gjitha prefekturat e tjera janë në organizim e sipër grupet për matjen e tokave dhe për shkëputjen definitive të marrëdhënjeve në mes të bujqve dhe të pronarëve. Janë në program dhe në krijim e sipër zyrat e reformës agrare në Gjirokastër (për Delvinën), në Durrës (për Kavajën, Shijakun dhe Krujën), në Shkodër (për prefekturën e Shkodrës dhe Lezhën).

5. — *Në lëmin e rindërtimit mund të themi se kemi arritur suksese të habitshme.* Aktiviteti i Dikasterit të Botores ka qenë i madh dhe meriton lavdërim. Ministri-së së Punëve Botore, menjëherë pas çlirimit të Shqipërisë ju ngarkua barra e rindërtimit të vendit. Godina, mole, centrale elektrike, rrugë, ura, ujësjellës ishin hedhur në erë nga gjermanët. Po i hyhej një pune të vështirë, por të domosdoshme. Në Tiranë, pas luftës heroike prej 19 ditësh, një pjesë e godinave dhe e pazarit të vjetër ishte djegur, godinat e shtetit ishin dëmtuar. Armiku kishte proceduar me kohë në çmontimin dhe heqjen e mjeteve hidro-sanitare, të material-ndërtimit të çdo lloji, të mobilerive e të tjera. Gjer në muajin qershor të këtij viti, ministria në fjalë mundi të riparojë gjer më 110 godina me një shpenzim prej afro 1 000 000 franga shqiptare. Edhe në qytete të tjera zyrat e botores

kanë kryer mjaft ndërtimë në këtë drejtim. Dy grupë studimesh me teknikë shqiptarë punojnë për ngritjen dhe ndërtimin e qyteteve të djegura, si Përmeti dhe Podgadeci. Në portin e Durrësit u ndërtuan depot, doganat dhe zyrat përkatëse; është ndërtuar moli provizor ku mund të shkarkohen tani gjer në 10 000 ton mallra në muaj. Porti i Durrësit dhe i Sarandës po meremetohen akoma për të shkarkuar provizorët edhe gjer në 10 000 ton mallra të tjerë brenda një muaji.

Gjermanët, megjithëse të ndjekur këmba-këmbës nga ushtria jonë, nuk kursyen dinamitin për centralet tona elektrike. Në Sarandë u hodhën në erë 50% e ndërtesave të qytetit, gjithë moli dhe porti; shkatërruan edhe centralin elektrik. Po kështu u hodh në erë dhe centrali i Vlorës. Gjithë centralet elektrike të Shqipërisë u dëmtuan rëndë, vetëm heroizmi dhe befasia e ushtrisë sonë mundi të shpëtojë disa prej tyre. Tani pothuaj të gjitha centralet janë riparuar ose zëvendësuar me të reja. Ujësjellësit e Shqipërisë ishin mjaft të dëmtuar ose të shkatërruar pjesërisht. Ujësjellësi i Tiranës, sikundër centrali elektrik, u shpëtua nga heroizmi i partizanëve, por pas çlirimt u deshën mjaft punime dhe tani jemi duke instaluar dhe një grup të ri ndihmës, motori i të cilët do të punojë me gazogjen. Ujësjellësi i Durrësit, i dëmtuar rëndë, sot funksionon në rregull si në Durrës dhe në Shijak. Në Vlorë ujësjellësi u dëmtua rëndë dhe shpëtoi nga shkatërrimi i plotë në saje të luftës heroike të Brigadës XII. Ai tashti funksionon. Ujësjellësi i Gjirokastrës po shtrihet në tërë qytetin; edhe në Korçë rrjeti i ujësjellësit po bëhet dita më ditë më i gjerë. Është në studim ujësjellësi i ri i Tiranës, që nuk do të furni-

zohet më me ujë lumi, po me ujin e freskët të burimeve të Selitës së Madhe.

Armiku prishi instalacionet telefonike dhe zyrat e PTT-s kështu që, qysh në fillim, u nis puna me seriozitet. Janë sistemuar me qindra km. linja. Është në të ngritur e sipër një linjë e re prej 58 km. gjatësi me karakter definitiv. Po vazhdojnë punimet për ngritjen e dy linjave prej 120 km. gjatësi me karakter definitiv. Sot rrjeti telefonik është në gjendje të pëlqyer dhe dita-ditës po i bëhen përmirësimet e nevojshme. Posta, me gjithë ngushticën e automjeteve, funksionon në rregull dhe në ditët e caktuara.

Rrugët tona u dëmtuan edhe ato nga lufta dhe sot për sot qeveria s'është në gjendje të ndërtojë rrugë të reja. Ajo kufizohet në mirëmbajtjen e tyre dhe në përmirësimin e pjesëve që janë shkatërruar me qëllim prej okupatorëve. Kështu janë ndërtuar shumë pjesë rrugësh të shkatërruara dhe kanë filluar punimet në stil të gjerë për përmirësimin e mbistrukturës së rrugëve. Me gjithë vështirësitet ekonomike u përfundua ndërtimi i rrugës që lidh Vlorën me Sarandën nëpërmjet Kurveleshit. Ministria e Punëve Botore, pasi hapi 10 km. trase të re, po vazhdon punimet për përmirësimin e pjesës së trasesë që ishte hapur më parë dhe që arrin në 45 km.

Por suksesi më i madh ka qenë ngritja e urave në një kohë rekord. Pas prishjes së urave nga okupatori gjerman, Ministria e Punëve Botore dhe ajo e Mbrojtjes Kombëtare e morën në dorë me energji rimëkëmbjen e komunikacionit. Punimet e mëdha të Ministrisë së Punëve Botore për vendosjen e komunikacioneve mund t'i ndajmë në tri periudha. Periudha e parë është ajo e

trapeve, e dyta ajo e urave prej druri dhe e treta është ajo e ndërtimit në shkallë të gjerë e në formë definitive. Sot jemi në mbarimin e kësaj periudhe të tretë. Viti 1946 do të na gjejë me të gjitha urat të ndërtuara në formë definitive. Nuk do t'i numëroj një nga një këto ura që i ndërtuan vetë me thonj e me dhëmbë, por vetëm do të shtoj se këto do të dëshmojnë në të ardhmen për përpjekjet mbinjerëzore të një populli që del i varfër dhe me plagë nga lufta, por që i shtrin me vullnet e me forcë krahët e tij drejt jetës. Këto ura do të dëshmojnë për energjinë e madhe të popullit tonë, këto ura janë një provë e gjallë për gjithë botën se populli shqiptar meriton të rrojë i lirë dhe i nderuar nga të gjithë, jo vetëm për luftën që diti ta bëjë me aq trimëri, por edhe për punën ndërtuese dhe paqësore që po bën sot.

Teknikët shqiptarë, inxhinierë dhe gjeometra, jo vetëm që kanë dhënë prova të një preqatitjeje të shëndoshë teknike me projekte me projekte që kanë arritur të jenë gjëra origjinale, por kanë derdhur të gjitha energjitet e tyre për drejtimin dhe mbarëvajtjen e punimeve, si edhe për gjetjen e materialeve të çmuashme që na mungonin. Dhe bashkë me inxhinierët, punëtoria shqiptare ka puanuar me mish e me shpirt për të ndërtuar këto ura.

Prandaj, o shokë, për të nderuar punën e vlefshme të punëtorëve, të teknikëve shqiptarë, të inxhinierëve dhe të gjeometrave, ju ftoj të shfaqim mirënjohjen tonë për punën e tyre të palodhur.

6. — *Çështja e arësimit e ka preokupuar dhe po e preokupon shumë qeverinë tonë, pse pa arësim nuk mund të ketë përparim. Niveli arësimor në vendin tonë ka qenë dhe është shumë i ulët, dhe këtu qëndron shkaku i pra-*

pambetjes dhe i shumë të metave, që konstatohen në çdo fushë aktiviteti. Problemi i arësimit nuk qëndron vetëm në zhdukjen e analfabetizmit, që është baza e pajisjes së çdo qytetari me një kulturë të përgjithshme më të lartë, po qëndron edhe në krijimin e kuadrove të rinj teknikësh e specialistësh të pajisur me kulturë të lartë. S'mjafton vetëm vullneti për të ndërtuar një urë, por duhet teknikë dhe teknika fitohet duke mësuar. Në regjimet e kaluara arësimi ishte privilegji i disave, lufta jonë i hapi sytë popullit dhe i ngjalli këtij dëshirën për arësim. Në duart e popullit qëndron fati i tij dhe ai e sheh mirë, se, me gjithë bonsensin¹ dhe vullnetin e madh që ka për punë, i mungon arma që zgjidh mirë e shpejt çdo çështje, i mungon arësimi. Dëshirat e popullit në këtë lëmë i kanë kapërcyer mundësitë tona. Nga fshati më i humbur i Shqipërisë ngrihet zëri: «Duam shkolla! Duam mësues!». Dhe qeveria e ka për detyrë t'i përmbushë këto kërkesa të drejta, por të gjithë e kuptojmë se sa e vështirë është puna, të gjithë e dimë sa të varfër jemi në mësues dhe në profesorë. Ky është rezultati i regjimit obskurantist të Zogut dhe të fashizmit, të cilët në 20 vjet sundimi nuk lejuan të kemi më tepër se një-qind e ca profesorë të diplomuar. Këta regjime ishin konsekuente. Përse t'u duheshin mësuesit dhe profesorët? Apo për të rrëzuar themelat e regjimeve të tyre shtypëse? Kohërat tani ndryshuan, arësimi po bëhet i popullit dhe ai do të shkojë dita-ditës duke u përmirësuar. Në lëmin e arësimit kemi përparime të dukshme. Janë çelur 928 shkolla të rregullta fillore me 1 743

¹ Kuptimin e drejtë.

mësues dhe me 58 590 nxënës, si edhe 40 shkolla verore, të cilat janë pajisur me mjetet e nevojshme. Përveç mësuesve profesionistë u muarën për nevoja të ngutshme edhe mësues të tjerë të rinj me 3-4, a më shumë klasë shkollë të mesme. Për këta të fundit funksionon në Tiranë një kurs pedagogjik me karakter perfeksionimi. Afro 7 000 burra e gra kanë frekuentuar 380 kurse analabetësh. Në Tiranë e në disa qendra të tjera janë hapur kurse për mësuese shkollash foshnjore. Sivjet kemi pasur 258 shkolla dhe 394 mësues më shumë se në vitin 1938—1939. Shkollat minoritare janë shtuar nga 47 në 75 dhe mësuesit nga 69 në 96. Kanë ndjekur mësimet gjithsejt 3 500 nxënës minoritarë. Në lidhje me shkollat fillore janë shtypur abetare e libra leximi për të gjitha klasat e shkollës filllore.

Në marsin e vitit 1945 filluan rregullisht mësimet në 13 shkolla të mesme me 241 profesorë dhe 5 333 nxënës. Në Tiranë është çelur një kurs i posaçëm për 600 nxënës të rinj që kanë qenë në ushtri. Në vitin e ri shkollor, përveç shkollave të mesme që ekzistojnë, do të hapen shkolla plotore unike në Fier, Himarë, Përmet, Biliq, Pogradec, Ersekë, Kavajë, Krujë, Peqin, Kukës dhe Peshkopi. Pranë liceut të Gjirokastrës do të krijohet dega e liceut greqisht për nxënësit minoritarë. Në Durrës do të krijohet një lice dhe në Berat një shkollë normale. Do të hapen 4 konvikte kryesisht për fshatarët dhe fëmijët e dëshmorëve, në Gjirokastër, Elbasan dhe në Tiranë për Institutin femëror dhe Institutin teknik. Në këto konvikte do të mbahen 400 e ca nxënës. Është hartuar programi i ri i shkollës së mesme dhe po shqyrtohen ligjet e arësimit. Janë preqatitur tekstet shkencore

për shkollat e mesme. Këtë vit dualën 110 nxënës maturantë, të cilët qeveria bashkë edhe me të tjerë që kanë mbaruar shkollat e mesme, por që kanë qenë në male duke luftuar, do të përpinqet t'i dërgojë në shkollat e larta jashtë shtetit për t'u specializuar. Si thashë edhe më lart, pengesat janë të mëdha si përsa u përket kua-drove, ashtu edhe përsa u përket materialeve, por me gjithatë, Ministria e Arësimit, përveç shkollave të mesme dhe plotore që do të çelen, siç u përmend më sipër, do të çelë dhe një numër tjetër shkollash fillore e sidomos, në malësitë e Veriut, ku përqindja e analfabetizmit është shumë e madhe. Inkurajues për ne ka qenë vullneti i madh i mësuesve dhe i profesorëve, të cilët, në kondita të vështira jetese, s'janë kursyer të punojnë pa u lodhur tërë vitin. Karakteristike dhe përparimtare ka qenë iniciativa e shumë fshatrave dhe qyteteve, të cilat, duke parë vështirësitë e situatës, kanë marrë vetë përsipër për të ndihmuar Ministrinë e Arësimit në gjetjen e lokaleve për shkolla dhe në pajisjen e tyre me orënditë e nevojshme.

7. — *Në lëmin e drejtësisë janë kryer reforma rrënjësore. Me ligjin mbi organizimin e përkohshëm gjyqësor janë krijuar gjykatat popullore, në të cilat për herën e parë në vendin tonë marrin pjesë gjyqtarë të zgjedhur nga populli. Në krye qëndron Gjykata e Lartë. Kjo gjykatë, që është një garanci e fortë për aplikimin me drejtësi të ligjeve, do të jetë dhe fryshtuese e reformave të nevojshme për ngritjen e drejtësisë në lartësinë e saj, pse në të bëjnë pjesë njerëz të ndershëm dhe dinamikë, njerëz që u dhimbset çështja e popullit.*

Gjykatat popullore në ushtrimin e funksionit të

tyre veprojnë si institucione të pavarura nga administra-ta shtetërore.

Në gjykatat e vjetra kanë qenë grumbulluar çështje civile të shumta, të zvarritura prej shumë vjetësh. Me ligjin mbi arbitrazhin e detyruar këto çështje po përfundohen në një kohë shumë të shkurtër dhe një numër i rëndësishëm i tyre janë zgjidhur me anë pajtimi. Fryma e re ka hyrë në të gjitha gjykatat tona dhe drejtësia në Shqipërinë e re po bëhet një nga shtyllat më të forta të pushtetit tonë.

8. — *Për mbrojtjen e shëndetit të popullit* janë arritur suksese të kënaqshme. Në gjithë Shqipërinë kemi 13 spitale të mëdha civile me 1 700 shtretër. Përpara çlirimt kishte vetëm 800 shtretër në spitalet civile. Në 7 nga këto spitale bëhen operacione kirurgjike dhe ka një shërbim kirurgjie të organizuar mjaft mirë. Në të gjitha qendrat ku ka mjekë, bëhen dhe shërbime të organizuara ambulance dhe infirmierie. Seksionet e shëndetësisë në prefektura dhe nënprefektura të mëdha kanë organizuar ekipe mjekësore ambulante për krahi-nat dhe katundet e largëta nga qendrat. Këto ekipe kanë dhënë rezultate të mira, sepse shpien kujdesin mjekësor dhe barërat jo vetëm në krahinat më të largëta, por edhe në katundarët e varfër e të këputur nga sëmundjet. Çdo muaj ekzaminohen dhe kurohen në këtë mënyrë me mijëra të sëmurë. Në bazë të ligjit të mobilizimit civil, mjekët dhe gjithë personeli që merret me punë shëndetësore janë ndarë në qendra të ndryshme, sipas nevojave të shëndetësisë. Kundër malarjes dhe për të mbrojtur e kuruar popullin është organizuar një luftë sistematike kundër larvave të mushkonjave anofele, si edhe kurimi

sistematik. Janë bërë bonifikime në shumë qendra me rëndësi, është ndarë një sasi prej 7 milion kokrra me pakrinë, si dhe shumë kininë. Me masat urgjente të marrura nga organet e shëndetësisë janë luftuar me sukses tifua ekzantematike dhe abdominale që rrezikonin jetën e popullit. Me mijëra vetë u sëmurën nga këto sëmundje të rrezikshme, me mijëra u shpëtuan riga vdekja. Viktimat kanë qenë të pakta. Nga statistikat që kemi gjer tanë, në gjithë Shqipërinë kemi pasur 52 të vdekur nga tifua ekzantematike dhe 45 nga ajo abdominale.

Ministria e Shëndetësisë është duke organizuar një qendër antituberkulare në Korçë, ku do të shtrohen të paktën 200 të sëmurë. Kjo qendër, që po krijohet, ka më tepër karakter kurativ se sa profilaktik. Po organizohet shkolla e infirmierëve, e cila do të ketë 120 nxënës që do të diplomohen brenda një viti. Po organizohet në baza të reja sektori i higjenës dhe i profilaksisë, sektor me shumë rëndësi për të ardhmen e vendit tonë.

E dimë se s'është aspak e mjaftë sa kemi bërë në këtë lëmë veprimtarie, e dimë se me qindra fshatra vuajnë për doktorë, infirmierë dhe barëra. Jemi në korrent të kërkesave të drejta të popullit dhe përpinqemi me çdo mjet dhe brenda mundësive tona t'i përmbushim. Shumica e doktorëve tanë me ndërgjegje i janë përveshur punës, punojnë ditë e natë pa u lodhur dhe shumë herë në kondita të vështira materiale, po ata janë njerëz me zemër dhe e kuptojnë situatën, e kuptojnë që duhen bërë sakrifica. Ne dëshirojmë që edhe ajo pakicë shumë e vogël e doktorëve, që punojnë me frymë të vjetër, të jenë realistë dhe të ndërgjegjshëm, se e drejta

njerëzore nuk i lejon të luajnë me shëndetin dhe me mjerimin e popullit. Qeveria u ka bërë thirrje të gjithë doktorëve shqiptarë të diplomuar që ndodhen jashtë atdheut të kthehen sa më parë në Shqipëri, se detyra i thërret t'i shërbejnë popullit të tyre. Thirrja jonë, sigrisht, do të dëgjohet nga djemtë me zemër dhe të mësuar të popullit që në momentet më kritike nga konditat e luftës patën fatin e keq të ndodhen jashtë atdheut. Ata do të kthehen të zënë vendet e tyre në përpjekjen e madhe që bën populli ynë.

9. — *Për përhapjen e kulturës dhe në lëmin e propagandës, qeveria që prej dhjetorit të 1944-s dhe gjer tani ka bërë hapa të ndjeshme. Në sektorin e shtypit dhe të propagandës, përveç shtypshkronjave të vjetra, janë vënë në përdorim shtypshkronja të reja si në Gjirokastër, Berat, Peshkopi. Në Gjirokastër për nevojat e minoritetit është ngritur dhe një shtypshkronjë për botime greqisht, në të cilën shtypet gazeta «Laiko Vima», organ i Frontit Demokratik të Gjirokastrës për minoritetin grek. Në kryeqytet dhe në krahina dalin 11 gazeta, nga të cilat njëra është e përditshme me një tirazh prej 12 000 copësh. Gjer tani dalin 5 revista të përmuajshme, nga të cilat njëra satrike e përdyjavshme. Janë vënë afro 40 libra të ndryshme në qarkullim, përveç atyre të botuara nga Ministria e Arësimit. Përveç radio Tiranës, janë ngritur tri radiostacione: një në Shkodër, një në Korçë dhe tjetri në Gjirokastër. Është rindërtuar edhe radiostacioni i Laprakës. Janë organizuar ekspozita të mëdha me fotografi nga lufta jonë dhe nga rindërtimi i Shqipërisë.*

Në sektorin e kulturës popullore është krijuar grupi

teatral qendror i shtetit, që është baza për teatrin tonë kombëtar, është çelur dhe shkolla dramatike. Në kryeqytet e në krahina janë vënë në skenë dhjetë pjesë teatrale dhe dy të tjera janë preqatitur për të hapur stinën dramatike të vitit 1945—1946. Në muzikë është mëkëmbur një orkestër, është çelur dhe shkolla e muzikës. Janë dhënë në kryeqytet, në Korçë dhe në Elbasan 14 koncerthe korale dhe instrumentale. Me rastin e Kongresit të parë të Rinisë Ballkanike kori i përgjithshëm dha 4 koncerthe në Jugosllavi që patën sukses të madh. Janë çelur salsa të reja kinemaje si në Gjirokastër e në Peshkopi. Në sport janë bërë manifestime gjimnastikore; futbolli dhe atletika kanë marrë një hov të madh. U çel dhe mbaroi kursi për 50 instruktorë të edukatës fizike. U krijuar Federata sportive. Janë çelur nga ana tjetër 4 biblioteka të reja. Veç Bibliotekës së madhe kombëtare dhe asaj të Institutit të studimeve shkencore edhe Gjirokastra, Berati, Durrësi dhe Peshkopia kanë nga një bibliotekë. Është ndihmuar biblioteka e Prizrenit. Në kryeqytet është hapur Shtëpia e kulturës, e cila ndihmoi në krijimin e redaksisë së revistës «Bota e Re»¹, në formimin e komitetit iniciator për organizimin e shkrimitarëve të Shqipërisë. Në Shtëpinë e kulturës organizohen konferenca, çelen eksposita, si ajo sovjetike etj. Atje janë dhënë koncerthe të ndryshme. Agjencia Telegrafike Shqiptare nxjerr çdo ditë një butelin të

¹ «Bota e Re», revistë e përmuajshme kulturale. Në fillim organ i Shtëpisë së kulturës në Tiranë, ndërsa duke filluar nga Nr. 5 organ i Lidhjes së Shkrimitarëve të Shqipërisë.

rregullt të lajmeve të jashtme dhe një të lajmeve të brendshme për botën e jashtme.

10. — *Çështja e ushtrisë* është një nga problemet kryesore të qeverisë, pse ajo ushtri që bëri aq sakrifica për çlirimin e atdheut, që luftoi heroikisht në kondita shumë të vështira, që u tregua e zonja në betejat dhe mundi hordhitë e armikut, duhej mbajtur në këmbë për të mbrojtur liritë e fituara me kaq gjak, për të mbrojtur pushtetin e popullit dhe për të ruajtur integritetin tokësor dhe indipendencën e vendit. Ushtria e lavdishme Nacional-Çlirimtare, me çlirimin e Shqipërisë, hyri në një fazë të re, në fazën e modernizimit. Modernizimin e ushtrisë ne s'ë kuptojmë vetëm në formë, por edhe në përbajtje. Për t'ja arritur këtij qëllimi duhej dhe duhet akoma shumë punë e përpjekje, por ne do t'ja arrijmë, se vullneti i ushtarëve dhe i oficerëve tanë është shumë i madh dhe se Ushtria jonë Kombëtare gëzon dashurinë dhe respektin e gjithë popullit. Ushtari dhe oficeri i Ushtrisë sonë Kombëtare e ka kuptuar mirë kthesën e domosdoshme që bëhet në ushtri. Ata e dinë se ushtria duhet të pajiset me disiplinën e hekurt dhe të vetëdijshme, me artin modern ushtarak, se ata duhet të dinë të përdorin në mënyrën më të përsosur të gjitha armët që u vihen në dorë. Në Ushtrinë tonë Kombëtare po mësohet me zell të madh; ajo është bërë një shkollë e vërtetë. Atje po luftohet analfabetizmi nga të katër anët; s'ka repart, qoftë dhe ai më i vogli, që të mos ketë një kurs, ku t'u mësohet shkrim e këndim atyre që s'dinë. Çdo ushtar që lirohet nga ushtria jo vetëm që ka mësuar të shkruajë dhe të këndojet, por ka marrë dhe mjaft njoburi të përgjithshme që do ta ndihmojnë në

jetë. Kurse të larta për oficerët janë çelur në Tiranë si dhe më përpara në Berat, dhe këto po bëhen dita-ditës qendra të rëndësishme, ku oficerët tanë pajisen me artin modern ushtarak. Përveç shkollës së oficerëve në Tiranë në çdo repart janë çelur kurse ushtarake ku perfeksionohen njerëzit tanë të ushtrisë, si kurse artilierësh dhe të xhenjos; janë duke u preqatitur kuadro të rinj; shkolla e kadetëve ka më tepër se njëmijë nxënës, oficerë të ardhshëm, të rritur dhe të edukuar me bazat e artit ushtarak modern dhe me frymën e re demokratike. Të tjerë oficerë janë dërguar në shkolla jashtë shtetit për t'u specializuar në degë të ndryshme. Ushtria jonë edukohet politikisht, që ta dojë me gjithë zemër atdheun dhe popullin, të mbrojë pushtetin dhe interesat e popullit, të jetë një faktor paqeje dhe përparimi. Ushtria jonë Kombëtare edukohet për të qenë një nga faktorët politikë të rëndësishëm, pse ajo është pjesa më e gjallë dhe më dinamike e popullit tonë. Që ta sillnim ushtrinë në këtë shkallë kemi pasur shumë pengesa e sidomos materiale, në lidhje me situatën e vështirë të vendit. Por populli s'ka kursyer kurrë për ushtrinë e tij dhe ushtari ynë ka qenë dhe është me një moral të çuditshëm. Ushtarit tonë i kanë munguar dhe i mungojnë shumë gjëra, por ai s'do t'ja dijë, ai është i ndërgjegjshëm për gjendjen, ai ka besimin e patundur se Ministria e Mbrojtjes Kombëtare dhe qeveria e tij po bëjnë çdo përpjekje për të përmirësuar gjendjen materiale të tij. Ai mund të jetë i zbathur, po armën e mban fort, pse bën detyrën ndaj atdheut; me largimin e luftëtarëve të vjetër nga ushtria me rastin e çmobilizimit, me qindra telegrame më vijnë prej tyre, ku me mënyrat e tyre të thjeshta, e

të prekshme më shfaqin dashurinë për repartin e për ushtrinë e tyre, për shokët e tyre, për komandantët e tyre, me të cilët kanë shkuar kohërat më kritike dhe më të lavdishme.

Kjo është ushtria jonë, këtë fryshtë të re ka Ushtria Kombëtare, këtë edukatë përpinqemi dita-ditës t'i japim ushtrisë sonë. Nga ana tjetër, mund t'ju siguroj se ushtria jonë tanë është e armatosur me mjetet më moderne, me armët më moderne. Asaj s'i mungojnë veçse tanksat dhe avionat. Ushtria jonë s'është një ushtri agresive, agresionin s'e kemi në gjak, po përkundrazi e luftojmë. Ne jemi një popull paqëdashës, ne me mish e me shpirt do ta mbrojmë paqen, pse ne e dimë sa na kushtoi. Ne duam të rrojmë të lirë, të ndërtojmë vendin tonë, të kemi marrëdhënje me të gjithë, të ndihmojmë edhe të tjerë. Këtë fryshtë ka populli ynë, në këtë rrugë po shkon Shqipëria e re dhe, Ushtria e saj Kombëtare s'mund të ketë rrugë tjetër.

*

Ju mora një kohë të gjatë për t'ju parashtruar në vija të përgjithshme rezultatet e punës brenda këtyre dhjetë muajve, për t'ju vënë në dukje vullnetin e madh në punë të popullit tonë dhe të njerëzve të pushtetit. Do të jetë gabimi po të them se në zbatimin e punëve nuk ka pasur të meta, nuk ka pasur gabime dhe lëshime, nuk është shfaqur në disa raste rutina dhe fryma e vjetër. Gabimet, që jemi përpjekur t'i korrigojmë, të na bëhen mësime; shumë herë i kemi goditur rëndë, por kurdoherë me vend. Edukata dhe eksperiencia në punë

nuk fitohen përnjëherë. Ata që punojnë edhe do të gabojnë, por rëndësi është që gabimet të mos përsëriten dhe të mos cënohet as interes i personal, as interes i përgjithshëm.

Në fushën ndërkombëtare unë mund të them pa u gabuar se pozitat tonë po forcohen dita-ditës dhe s'ka asnjë arësy që të mos jetë kështu. Me aleatët tanë të mëdhenj dhe të fuqishëm Anglinë, Bashkimin Sovjetik, Amerikën, na lidh lufta ku derdhëm gjakun së bashku dhe për një qëllim. Gjatë luftës kemi pasur ndihmën e tyre, se ata e shihnin qartë rrugën e drejtë dhe të papërkulur që po ndiqnim, ata na shihnin që s'kursenim asgjë për kauzën aleate, ata na shihnin sa të drejtë dhe të vendosur ishim për popullin. Këto prova ne ua dhamë më shumë se të tjerë, ua dhamë në fushën e luftës, ku vriteshim së bashku kundër nazistëve dhe tradhëtarëve kuislingë. Këto prova shërbjen për të lidhur popujt tanë me një miqësi të singertë. Gazetat sovjetike si dhe gjithë shtypi i përbotshëm kanë njojur popujt e tyre me luftën heroike që bëri populli ynë i vogël dhe ne kemi miq në këto vende, miq që na duan dhe që na mbrojnë. Ashtu si luftuam së bashku për fitoren e madhe, ashtu edhe tani do të luftojmë për të mbrojtur këtë paqë që na kushtoi kaq shumë dhe paqen do ta mbrojnë ata që bënë luftën. Mbeturinat e fashizmit do të përpilen të turbullojnë ujërat, por ata s'do t'ja arrijnë kurrë qëllimit. Aleatët tanë të mëdhenj na njojnë në luftë, ata po na shohin edhe në punën tonë ndërtimtare, ata na shohin që vazhdojmë të ndjekim rrugën e drejtë, rrugën e demokracisë. Miqësinë tonë ne duam ta bazojmë në themelë të shëndosha dhe të singerta dhe për të kërkuar të

drejtat tona kurrë s'do të mungojmë. Shumë herë haka po na hahet. Në Konferencën e San-Françiskos, ku ne duhet të kishim vendin tonë, të cilin e fituam me gjak, nuk u thirrëm. Në Konferencën e Ministrave të Punëve të Jashtme që mbahet në Londër, ku bisedohet Traktati i Paqes me Italinë nga e cila ne kërkojmë reparacione, nuk u thirrëm. Qeveria jonë akoma s'është njohur. Ne kemi bindjen se një gjendjeje të tillë do t'i jepet fund, pse s'është e drejtë. S'ishte e drejtë që në San-Françisko të venin edhe shtete që kishin ndihmuar nazistët dhe të mos venimi ne. Në Londër s'do të jetë aspak e drejtë që të tjerët të marrin reparacione nga Italia dhe ne që kemi pasur kaq dëme, të harrohem. Mund të ketë shumë njerëz që bëjnë pyetjen: «Pse s'na njohin aleatët?» Ajo është puna e aleatëve. Ne, nga ana jonë, i kemi të gjitha konditat që qeveria jonë të njihet sa më parë. Ne luftuam si rrallëkush, ne mbrojtëm dhe mbrojmë kauzën aleate, ne luftojmë me mish e me shpirt për mbrojtjen e paqes, ne shkrimë të gjitha energjitetë për popullin, në vendin tonë ka liri dhe demokraci; sa për fashistët shpatën e kemi kurdoherë të mprehtë. Popull e qeveri janë një, populli është me qeverinë e tij, këtë e thotë populli dhe jo unë. «Dielli me shoshë nuk mund të mbulohet» dhe veprat e qeverisë s'mund t'i errësojnë sharlatanët dhe lakuriqët e natës që përshpëritin nëpër qoshe. Ne s'e humbasim kurrë besimin se e drejta s'do të mungojë të na jepet.

Me Jugosllavinë Federative miqësia jonë po forcohet. Në vendet e tjera të Ballkanit, si në Bullgari e Rumani, njerëzit tanë dhe delegacionet tona të rinisë, të gruas, delegacionet sportive etj., që kanë vajtur atje,

janë pritur me një simpati dhe me një ndjenjë vëllazërimi të madh. Ato e njohin luftën tonë dhe kanë admirim për të. Bullgaria dhe Rumania me kënaqësi të madhe kanë pranuar të kemi marrëdhënje të gjera kulturale dhe të shkëmbëjmë mallra. S'ka pasur kongres, qoftë i rinisë; qoftë i grave, qoftë i shkrimtarëve ose i minatorëve, që të mos jemi ftuar nga ana e bullgarëve dhe ne u jemi përgjegjur këtyre thirrjeve që vijnë nga zemra e popullit bullgar. Në Çekosllovaki gjithashtu delegacionet tona kanë gjetur pritje të përzemërt dhe këto kontakte të para do të hapin rrugën për marrëdhënje kulturale dhe tregëtare më të gjera. Edhe me Italinë marrëdhënjet po bëhen dita-ditës më të mira. Sa përfashistët e Athinës, e kemi thënë fjalën tonë. Është e mira t'i ulin pak pendët dhe të briturat dhe sidomos të ndalojnë provokacionet e poshtra që vazhdojnë të bëjnë në kufirin tonë të Jugut. Ata të mos kujtojnë se trembin njeri; poshtërsitë e tyre do t'i paguajnë shtrenjtë, pse populli i tyre nuk do të lejojë për shumë kohë, që këta dishepuj të Hitlerit, të vazhdojnë terrorin fashist.

E tillë është pozita jonë ndërkomëtare dhe kjo dita-ditës do të forcohet. Këtë e them pse dita-ditës ne i japim prova botës se sa përparimtar është populli dhe pushteti ynë. Lufta jonë antifashiste, ligjet dhe vendimet e kongreseve dhe të konferencave tona, të drejtat e qytetarit të proklamuara në Berat, ligjet e Kryesisë së Këshillit Antifashist i kanë treguar popullit dhe botës mbarë frymën e vërtetë demokratike që sundon në vendin tonë.

Ligji i zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese, që do

të diskutojmë dhe do të votojmë sot, është një provë tjetër e madhe, që tregon se sa demokratik është pushteti ynë. Kurrë në Shqipëri nuk janë bërë zgjedhje të tilla si ato që do të bëhen: të fshehta, të përgjithshme, të lira, të barabarta dhe direkte. Në ligj është parashikuar edhe mënyra e votimit e atillë që edhe analfabetët të ruajnë fshehtësinë e votës. Për herë të parë gratë shqiptare do të votojnë njësoj me burrat. Asnjë ligj i zgjedhjeve s'është bërë me një fryshtë kaq demokratike. Në ligjin tonë ruhet edhe parimi i proporcionalitetit, parim që mbron pakicat. Ligji ynë s'përjashton njeri nga zgjedhjet, përveç ministrave kuislingë dhe atyre që kanë humbur të drejtat e qytetarit. Populli ynë di tani të dallojë kush janë të mirët dhe kush janë të ligjtë. Populli i njoihu ata që sakrifikan jetën dhe që punojnë ditë e natë për të mirën e tij.

Në këtë ditë të madhe që arritëm, sot që vendosim thirrjen e Asamblesë Kushtetuese, të shterngojmë radhët tona më shumë se kurrë, të forcojmë dashurinë për shoqi-shoqin, të mos lëmë për asnjë minutë mangut punën tonë që na kanë ngarkuar. Në çdo zyrë, në çdo fabrikë, në kantiere e në fusha të punohet me një gjallëri të pashoqe. Popullit t'i tregojmë vepra dhe jo fjalë, se me fjalë ai është ngopur në të kaluarën. Këtu të synojë propaganda jonë elektorale. Të bëjmë që Asambleja Kushtetuese, e përbërë nga njerëzit më të denjë të vendit tonë, të mblidhet në një Shqipëri më të lulëzuar se ç'është sot, në një Shqipëri ku të jetë kryer një pjesë e madhe e reformës agrare, ku të jenë shfrytëzuar më me intensivitet minierat tona, ku industria të ketë marrë një hov më të madh dhe jetesa e popullit tonë të jetë për-

mirësuar. Dhe këto detyra do t'i kryejmë pse vetëm kështu do të na rrojë dhe do të na lulëzojë Shqipëria.

Rroftë populli shqiptar!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 231,
27 shtator 1945*

*Botohet sipas tekstit të bro-
shurës «Raporti i Qeverisë
Demokratike në sesionin e
tretë të Këshillit Antifashist»
Tiranë, 1945*

RAPORT I MBAJTUR NË PLENUMIN IV TË KOMITETIT QENDROR TË PKSH

17 tetor 1945

Shokë,

Përpara kësaj mbledhjeje të gjerë të Plenumit të KQ të Partisë na shtrohen shumë probleme e sidomos ato më me rëndësi, siç janë problemi i Partisë me të gjithë sektorët e punës së saj: pushtet, ushtri, Front etj., si dhe çështja e zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese. Siç u shënua dhe në rendin e ditës ne do të diskutojmë dhe do të vendosim edhe për thirrjen e konferencës së dytë¹ të Partisë. Këtu nuk do të shtrojmë ndonjë vijë të re politike ose organizative, por nga diskutimet e shokëve të Byrosë dhe të gjithë shokëve të tjerë, do të përpinqemi të shohim qartë situatën në të cilën ndodhemi dhe po punojmë, do të kemi një ide ekzakte të forcës së Partisë sonë në gjithë zhvillimin e saj gjatë luftës. Që këtej pastaj do të përcaktohet metoda e re e punës për

¹ Pas diskutimeve që u bënë në këtë plenum u vendos të thirrej Kongresi I i Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe jo konferenca e dytë kombëtare.

zgjidhjen e drejtë të çështjeve që na vihen përparrë në këtë situatë që ndryshon nga ajo e fazës së luftës.

Është bërë zakon që në çdo mbledhje e sidomos në mbledhjet e forumeve të larta të Partisë të vihet në ballë të rendit të ditës: «Situata politike e jashtme dhe e brendshme». Kjo është një praktikë e mirë në rast se kuptohet si duhet dhe nuk degjeron në një numërim faktash kronologjike të thjeshta; por, në rast se ne do të jemi në gjendje, që nga këto fakte kronologjike që përcaktojnë gjendjen ndërkombëtare dhe atë të brendshme, të nxjerrim konkluzione të drejta politike, ne do të dimë ta orientojmë si duhet punën tonë, qëndrimet tona politike dhe do të lehtësojmë zgjidhjen e problemeve të koklavitura. Ai anëtar partie që nuk sheh qartë zhvillimin e ngjarjeve dhe nuk bën deduksionet e duhura, ai nuk do të jetë kurrë në gjendje të zbatojë si duhet vijën e Partisë.

Si na paraqitet pra situata ndërkombëtare dhe ajo e brendshme në këtë fazë të re të pasluftës?

Do të gabohemi shumë në rast se mendojmë si ai njeriu i thjeshtë që bëri luftën dhe tani kujton se çdo gjë është në rregull. Punët s'janë aq të thjeshta as tani në kohën e paqes, ashtu sikundër s'kanë qenë as në kohën e luftës. Luftuam ashpër për ta fituar luftën mbi fashizmin, por duhet luftuar dhe duhet punuar me këmbëngulje për ta mbrojtur dhe për ta konsoliduar paqen.

U hodhëm në një luftë të madhe për të mposhtur fashizmin, armikun më të egër të demokracisë, por luftuam dhe për një jetë më të lumtur, për një demokraci më të shëndoshë dhe më përparimtare nga ajo që ekzistonte para luftës në Evropën Perëndimore. Popujt rrrokën

armët jo vetëm për të fituar liritë e grabitura nga fashistët, po edhe për të hedhur poshtë zgjedhën e imperialisteve dhe të klikave reaksionare, të mbuluara nën maskën e demokracisë. Për këtë shkak lufta nuk ishte aq e thjeshtë sepse në kampin aleat antifashist kishte shtete që hodhën gjithë forcat e tyre në luftë për mbrojtjen e lirisë dhe të demokracisë së vërtetë të tyre dhe të popujve të tjerë të robëruar, por kishte edhe shtete që e kuptionin dhe e bënin ndryshe luftën kundër fashizmit. Në blokun antifashist, Bashkimi Sovjetik ishte flamurtari i luftës së çlirimit; ai mbajti në supet e tij peshën më të madhe të luftës, ai ishte shtylla vertebrale e aleancës antifashiste, ai ishte frymëzuesi, inkurajuesi, dhe mbrojtësi i popujve të robëruar, ai ishte faktori i madh i mposhtjes së Gjermanisë naziste. Anglia dhe Amerika u hodhën në luftë kundër fashizmit pasi u kërcënua ekzistenca e tyre nga Gjermania, por lufta e tyre nuk mori kurrë karakterin e një lufte totale, përkundrazi përpjekjet e tyre për shpejtimin e mbarimit të luftës s'qenë aq të mëdha; ata i ruanin forcat e tyre për të mbrojtur dhe për të konsoliduar pozitat e tyre imperialiste dhe jo për t'i hedhur në balancën e luftës; ata u përpoqën të ngadalësonin luftën që bënin popujt e robëruar, ata u munduan të forconin pozitat e reaksionit në Evropë për ta pasur si mbështetje në fazën e tanishme të pages. Zhvillimi i ngjarjeve gjatë luftës i vuri në dukje të gjitha këto fakte që tregova më lart, por me gjithë këto kontradikta dhe pikëpamje të ndryshme për luftën antifashiste, që ekzistonin në mes Bashkimit Sovjetik dhe aleatëve të Perëndimit, Gjermania naziste dhe klikat imperialiste angleze dhe amerikane s'mundën dot ta çanin aleancën

e madhe të blokut antifashist, për arësyen e vetme sepse Bashkimi Sovjetik, me politikën e tij të drejtë, dhe me luftën e tij heroike, i mposhti të gjitha manevrat e fashizmit dhe të reaksionit.

Për komunistët, pra, qëndrimi dhe puna e tyre ishte e qartë, pse i qartë ishte qëndrimi i Bashkimit Sovjetik. Komunistët në gjithë vendet e robëruara duhej të ngri-nin popujt e tyre në kryengritjen e përgjithshme dhe të luftonin pa mëshirë fashizmin dhe hyzmeqarët e tyre. Me luftën e tyre të hapët kundër okupatorit dhe përpjekjeve të tij për të pérçarë blokun ata duhej të mbro-nin dhe të forconin aleancën e Bashkimit Sovjetik me Anglinë dhe Amerikën. Njëkohësisht ata duhej të forconin pozitat e demokracisë, të forconin pozitat e popullit dhe të merrnin frenat e komandës dhe të qe-verimit.

Të gjitha këto kontradikta dhe pikëpamje të ndryshme, që ekzistonin në blokun antifashist: koncepte të ndryshme mbi demokracinë, përpjekje për të përsëritur të shkuarën, për të forcuar pozitat e reaksionit dhe për të grabitur fuqinë nga duart e popullit, u bënë më të qarta, me thyerjen e Gjermainisë dhe po thellohen dita-ditës e më shumë gjatë periudhës që po kalojmë. Prandaj tani, në këtë fazë pregitore të paqes puna s'është aq e lehtë dhe e thjeshtë. Paqen duhet ta mbrojmë me çdo kusht, ky është interes i Bashkimit Sovjetik, ky duhet të jetë interes ynë. Prandaj ashtu si u orientuam kurdoherë nga Bashkimi Sovjetik gjatë gjithë periudhës së luftës dhe fituam, prapë atje duhet t'i kemi sytë, të shohim mirë qëndrimin e tij ndërkombëtar, të ecim në rrugën e tij leniniste-staliniane, të mbrojmë përpjekjet

dhe interesat e tij, pse vetëm ashtu do të mbrojmë interesat e vendit tonë.

C'po ngjet, pra, në Evropën e pasluftës, cilat janë pozitat dhe pikëpamjet e anglo-amerikanëve dhe të Bashkimit Sovjetik në fushën ndërkontaktore dhe si paraqiten pozitat e paqes?

Në prakun e thyerjes së Gjermanisë ne vumë re një fenomen që nuk duhej të na çudiste: ndërsa në frontin e Lindjes dhe në portat e Berlinit po luftohej me ashperësinë më të madhe, fronti i Perëndimit ishte shthurur krejt, rezistenca gjermane ishte e parëndësishme dhe ushtritë anglo-amerikane po rendnin mbi Gjermaninë. Në të gjithë frontet e tjera, ku luftonte Ushtria e Kuqe ose ushtritë e rezistencës, fashistët luftonin me ashperësi. Këtu, pra, duhet të jemi të qartë. Anglo-amerikanët përpiken të shpëtojnë ç'të mundin e sa më tepër nga mbeturinat e fashizmit; ata përpiken të forcojnë pozitat e reaksionit, ta rigrumbullojnë dhe ta riorganizojnë për ta bërë një barrierë kundër vendosjes dhe triumfit të demokracisë së vërtetë. «Exode¹ i madh» i kriminelëve fashistë të luftës dhe i kuislingëve, gjen strehë dhe përkrahje në gjirin e ushtrisë anglo-amerikane dhe në zonat e okupuarë prej tyre. Përveç kësaj, anglezët drejtpërdrejt dhe amerikanët tërthorazi, atje ku reaksiioni i ka pozitat të forta, duke shkelur çdo parim demokratik, me brutalitetin më të madh, ndërhyjnë ushtarakisht për të mposhtur lëvizjet përparimtare, për të sjellë në fuqi reaksiionin dhe

¹ Exode (frëngj.) — emigrim në masë. Këtu bëhet aluzion me ironi në legjendën biblike, mbi emigrimin e hebrevje nga Egjipti.

për të forcuar pozitat e këtij dhe të fashizmit. Kjo gjë ngjet në Greqi. Në prakun, pra, të thyerjes së Gjermanisë dhe të dorëzimit të saj pa kushte, shohim ofensivën e parë të hapët të reaksionit për të konsoliduar pozitat me çdo kusht, aq sa mund ta lejojë ky moment tranzitor dhe deri atje ku gjen rezistencën e fuqishme të Bashkimit Sovjetik, të lëvizjeve të rezistencës dhe të lëvizjeve progresive të të gjithë popujve të robëruar përgjithësisht.

Pra, nën hijen e aleancës antifashiste dhe të fitores së përbashkët, reaksiuni ndërkombëtar me në krye Anglinë dhe Amerikën po zhvillojnë një luftë «surnoise»¹ dhe provokuese kundër Bashkimit Sovjetik dhe gjithë demokrative popullore, të dala nga kjo luftë çlirimtare. Nga ana tjetër Bashkimi Sovjetik në krye dhe gjithë vendet e tjera ku është vendosur demokracia popullore si dhe tërë pjesa përparimtare e botës, duke pasur si param kryesor ruajtjen e forcimin e paqes, si dhe forcimin në baza të shëndosha të aleancës së lidhur në këtë luftë, luftojnë për triumfin e demokracisë në Evropë, për zhdukjen e fashizmit dhe të mbeturinave të tij, për pre-gatitjen e një paqeje të drejtë dhe të vazhdueshme.

Natyrisht s'ishte punë e lehtë që Anglia dhe Amerika të ndërmerrnin, që në fillim të periudhës së pasluftës, një fushatë të hapët kundër Bashkimit Sovjetik, por kjo fushatë shpifjesh dhe denigrimi dalëngadalë po merr formë dhe po bëhet më e mprehtë. Me gjithë pikëpamjet e ndryshme që ekzistonin në mes anglo-amerikanëve dhe Sovjetëve, prapë Konferenca e Jaltës² dhe ajo e Berlinit

¹ Surnoise (frëngj.) — të fshehtë.

² Konferenca e Jaltës (Krine-BRSS) e kryetarëve të qeve-

përfunduan me sukses; por Konferenca e fundit e Londrës mbaroi pa asnjë rezultat. Atje anglo-amerikanët, përvèç vështirësive të panumërt që nxirrin, kërkonin haptazi të diktonin vullnetin e tyre për traktatet e ndryshme të paqes, duke shkelur vendimet e marrura në Berlin nga tre të mëdhenjtë. Kjo ishte fazë e parë e një mosmarrëveshjeje të hapët, jo vetëm për çështje procedure, por esencialisht parimi. Shtypi reaksionar i përbotshëm, e zhveshi pallën kundër Bashkimit Sovjetik dhe fashistët me maskë, me shtypin e tyre, arritën deri në kërcënime e në provokacione të tipit të tyre të zakonshëm.

Anglo-amerikanët dhe reaksiioni i përbotshëm përipiqen të futin në kthetrat e tyre të gjithë ata popuj që gjatë luftës mundën, me luftën e tyre, të marrin në dorë pushtetin. Përpjekjet e reaksionit në këtë drejtim zënë vendin e parë. Në shumë vende të Evropës, lufta e ashpër e popujve kundër okupatorit dhe veglave të tija jo vetëm që i dha një grusht të fortë klikave reaksionare vendase, por komprometoi rëndë pozitat e Anglisë dhe të Amerikës. Në këtë luftë u ngjallën dhe u forcuan simpatia dhe miqësia për Bashkimin Sovjetik. Kundër kësaj gjendjeje reaksiioni ndërkombëtar po lufton ashpërsisht. Të gjitha shtetet deri dje të okupuara të Evropës e sidomos ata të Evropës Lindore dhe Juglindore në politikën

rive të BRSS, të SHBA dhe të Britanisë së Madhe me pjesëmarrjen e Ministrave të Punëve të Jashtme dhe të shefave të shtabeve zhvilloi punimet nga 4—11 shkurt 1945. Pasi përcaktoi planet për shkatërrimin përfundimtar të Gjermanisë hitleriane konferenca hartoi parimet e politikës së aleatëve lidhur me sigurimin e një paqeje të qëndrueshme dhe organizimin e një sistemi për sigurimin ndërkombëtar.

e tyre të jashtme janë prirur drejt Bashkimit Sovjetik, i cili i mbron dhe i përkrah për të forcuar demokracinë. Në Poloni dhe në Jugosllavi reaksiioni u përpoq të rimë-këmbë dhe të sjellë në fuqi klikat e vjetra reaksionare, por s'mundi¹. Konferenca e Jaltës e zgjidhi çështjen e qeverive të këtyre dy vendeve. Por kjo s'do të thotë se reaksiioni i hodhi armët. Ofensiva e reaksionit kundër Bullgarisë, Rumanisë, Hungarisë dhe Shqipërisë është jashtëzakonisht e gjerë dhe sidomos tani me rastin e fushatave elektorale, të cilat do të janë vendimtare.

Reaksiioni ndërkombëtar po mëkëmb dhe po forcon pozitat e tronditura ose të dëmtuara rëndë të reaksionit të çdo vendi. Organizimi i reaksionit në vende të ndryshme të Evropës po konkretizohet dhe po merr formë. Kundër kësaj rritjeje dhe kundër këtij forcimi po luftojnë Bashkimi Sovjetik dhe gjithë popujt dhe qeveritë e tjera përparimtare. Por në këtë luftë të ashpër për triumfin e demokracisë, kujdesi i Bashkimit Sovjetik dhe i qeverive të tjera përparimtare për ruajtjen e paqes është një çështje kryesore. Në këto pozita qëndrojmë dhe ne kundrejt anglo-amerikanëve. Ata nuk e shohin aspak me sy të mirë qeverinë dhe demokracinë tonë popullore dhe e luftojnë. Ata deri tani as që kanë ndër mend të na njohin dhe njohja, sipas mendimit tonë, nuk do të jetë aq e lehtë dhe e shpejtë. Çdo kërkesë e jonë e drejtë, në lëmin ndërkombëtar, ka mbetur pa përgjegje ose i është

¹ Në Konferencën e Jaltës qeveritë e Anglisë dhe të SHBA u përpoqën të sillnin në fuqi në Poloni dhe në Jugosllavi, klikat reaksionare të këtyre vendeve të përfaqësuara nga të ashtuquajturat qeveri të emigracionit. Me këmbënguljen e Bashkimit Sovjetik përpjekjet e reaksionit anglo-amerikan nuk patën sukses.

dhënë një përgjegje negative. Ata e akuzojnë qeverinë tonë, njëloj sikundër kanë akuzuar atë të Jugosllavisë, të Polonisë, etj. Po, natyrisht, lufta ka variantet e saja, sipas rëndësisë që i vënë çdo vendi dhe pozitave që ka ky vend. Deri tani nga ana e shtypit reaksionar nuk është shpallur kundër nesh një luftë e hapët sikundër ndaj vendeve të tjera, por kjo s'do të thotë se nuk do të ndodhë. Me rastin e zgjedhjeve ofensiva kundër nesh do të zhvillohet në të gjithë gamën.

Puna qëndron që ne të dimë të manevrojmë për t'i dhënë më pak armë reaksionit të jashtëm dhe të brendershëm për të na luftuar. Këtu është çështja e një politike elastike, pa rënë në oportunizëm, një politikë që të forcojë pozitat tona të brendshme dhe të jashtme. Qëndrimet tona të drejta dhe taktika jonë do të përcaktohen nga diskutimet që do të bëjmë këtu, pasi të shohim konkretisht gjendjen dhe pasi të analizojmë punën që kemi bërë. Forcimi i pozitave tona ndërkontrollare varet nga konsolidimi i pozitave tona të brendshme, të cilat janë të kondicionuara nga puna jonë intensive dhe e drejtë, varet nga zbatimi drejt i vijës së Partisë sonë.

Në një situatë të tillë ndërkontrollare, pa thënë se pozitat e paqes janë të komprometuara, prapëseprapë këto janë shumë të vështira për t'i mbrojtur. Ne duhet të vëmë gjithë forcat për të mbrojtur e për të forcuar pozitat e demokracisë së vërtetë popullore dhe të ruhemisë nga provokacionet që s'kanë munguar dhe s'do të mungojnë, si nga ana e Greqisë ashtu dhe nga ana e anglo-amerikanëve. Bashkimi Sovjetik tregon një interesim të veçantë për ne. Përveç mbështetjes së madhe morale që na jep në fushën ndërkontrollare, ai po na jep ndihmë

materiale dhe kulturale. Portat e Bashkimit Sovjetik janë të hapëta për ne; oficerë nga tanët janë pranuar në shkollat ushtarake; kontingjenti i parë i studentëve universitarë po niset. Duke parë shtërgesat tona në lëmin ekonomik, qeveria sovjetike pranoi kërkesat tona dhe na shiti 20 000 ton grurë, që ka filluar të vijë; për këtë kemi lidhur edhe një marrëveshje tregëtare. Me Jugosllavinë dhe me shtetet e tjera të Ballkanit si Bullgarinë, Rumaninë, Poloninë e Çekosllovakinë, jemi në marrëdhënje miqësore. Propozime për njohjen e qeverisë sonë janë bërë nga ana e qeverisë bullgare, rumune e poloneze.

E tillë është situata e jashtme në vija të përgjithshme dhe pozitat tona ndërkombëtare, sikundërqë thashë më lart, do të forcohen edhe më shumë, kur ne të forcojmë pozitat tona të brendshme.

Si na paraqitet situata brenda dhe ku qëndron forca jonë? Me çlirimin e Shqipërisë e këtej, situata jonë e brendshme është forcuar mjaft. Si kudo gjetkë, edhe në vendin tonë, reaksiioni u armatos prej fashizmit dhe tok me të na luftoi me armë. Reaksiioni i brendshëm, megjithëse lidhjet i kishte të dobëta me reaksiionin ndërkombëtar e sidomos me ate anglez dhe amerikan, prapë ai pati ndihmën e tyre direkte dhe indirekte. Megjithatë reaksiioni i brendshëm hëngri një grusht të rëndë ushtarakisht dhe politikisht. Krerët e tij ose dolën jashtë kufirit ose u kapën prej nesh dhe u gjuquan. Gjykimet e atyre shokëve, që kujtonin ose pretendonin se ne e shfarsëm nga rrënjet reaksiionin, ishin gjykime të pathelluara. Edhe pas çlirimit të Shqipërisë na u desh të bënim një operacion në Veri për të shuar rezistencën e armatosur dhe agresive të krerëve reaksiونarë dhe bajraktarë

të mbetur brenda¹. Reaksiioni ynë nuk mund të themi se i kishte rrënjet mbi ujë, me gjithë grushtin që hëngri, shpejt a vonë dhe në kondita më të favorshme për të, ai do të lëvizte dhe do të organizohej. Në fazën e parë pas çlirimit reaksiioni i kishte thonjtë të prerë, ai ishte topitur. Përpara forcës sonë dhe veprimeve tona të rru-feshme, mbeturinat e reaksiionit qëndronin në formë latente. Aktiviteti i tij përmblidhej në lëshime parullash kundër qeverisë dhe pushtetit, kundër ushtrisë. Qëndrimi i aleatëve anglo-amerikanë ndaj qeverisë sonë dhe intervencioni në Greqi, ja shtuan kurajon. Tani ai filloj të shtonte aktivitetin dhe u përpoq të godiste institucionet tona më të forta dhe më të rrezikshme për të. Organizimi i dezertimeve në ushtri ishte tentativa e tij e hapët. Por mund të themi se deri tani të gjitha tentativat e mbeturinave të reaksiionit për t'u armatosur dhe për t'u organizuar në njësite pak a shumë të gjera e për aksione të hapëta, kanë dështuar. Ndjekjet nga ana e forcave tona s'ju lënë asnjë mundësi krerëve bajraktarë si Muharrem Bajraktarit, Fiqri Dines, Gjon Markut etj. të organozohen dhe të armatosen. Është e vertetë se ata i kanë shpëtuar forcave tona dhe kjo duhet të na preokupojë fort, por është fakt që ata po lëvizin me zor të madh. Këta elementë, natyrisht, na shkaktojnë kokëçarje, pse në mjaft krahina të Veriut puna jonë ka qenë dhe vazhdon të jetë e dobët. Disa herë atje parullat e tyre zënë vend dhe ka akoma njerëz që vazhdojnë të qëndrojnë në pritje

¹ Është fjalë për shtypjen e rezistencës së armatosur dhe asgjësimin e bandave të kriminelëve të luftës, të arratisur brenda vendit.

të evenimenteve. Këta do t'i lidhë fort me këtë pushtet, vetëm një punë intensive politike nga ana jonë dhe interesimi drejtpërdrejt i pushtetit në zgjidhjen e problemeve të tyre në mënyrë konkrete. Forca e reaksionit s'qëndron vetëm në bandat e armatosura; atë do ta shohim të manifestohet edhe në elementë të tjera dhe në forma të ndryshme, të cilët, të përkrahur nga reaksiioni i jashtëm, po preqatitin rezistencën kundër pushtetit tonë demokratik. Ky proces i grumbullimit të reaksionit s'është një zhvillim i thjeshtë. Për ne, që drejtojmë politikën e Frontit dhe të pushtetit, do të jetë një gabim i madh po t'i bëjmë hesapet kaluar dhe po të idealizojmë gjendjen tonë të brendshme dhe të pushtetit tonë.

Të shohim realisht gjendjen, të mbajmë kontakt të ngushtë me masat pse përndryshe do të kemi deziluzione të mëdha, reaksiioni do të fitojë terren. Situata ndërkombëtare dhe qëndrimi jo i favorshëm që mbajnë aleatët anglo-amerikanë kundrejt qeverisë dhe pushtetit tonë, po favorizojnë grumbullimin e elementëve reaksionarë si elementët e pakënaqur, klerin katolik, intelektualët e pasqaruar dhe që kanë qenë ose në pozitat e armikut ose indiferentë, shtresat e tregëtarëve të mëdhenj, që janë goditur nga tatimet e fitimeve të jashtzakonshme, spekulatorët e përhershëm, shtresat e bejlerëve dhe të agallarëve që janë prekur nga ligji i reformës agrare. Në rast se ne s'punojmë drejt dhe nuk zbatojmë si duhet vijën e Frontit rrëth këtyre me siguri mund të grumbullohen të gjithë ata elementë indiferentë të papërzier në politikë dhe që nuk arrijnë të kuptojnë si duhet manevrën e reaksionit dhe përpjekjet tona në këtë situatë të vështirë. Kjo kategori njerëzish influencohej shpejt nga çdo parullë e

reaksionit dhe qëndron me ne vetëm kur ta mbajmë në kontakt të përherershëm. Të gjitha këto shtresa, që përmenda më lart, ne duhet t'i shikojmë me vëmendje, t'i shikojmë jo në mënyrë administrative, por të punojmë me to. S'është aq lehtë të punosh me klerin katolik. Kleri ka influencë në Shkodër e në rrethet e saj dhe kjo nuk mund të zhduket vetëm me masa administrative. Kleri katolik është një ent i organizuar mirë, me tradita dhe me lidhje të ngushta me reaksionin e jashtëm e me Vatikanin. Prandaj organizimit të tij, duhet t'i kundërvëmë organizimin tonë më të shëndoshë, politikës së tij, vijën tonë politike të drejtë dhe ta detyrojmë të luftojë në terrenin tonë dhe jo në terrenin e tij dhe me parullat që do ai. Lufta dhe politika me individë të shkëputur të klerit është e nevojshme. Ka pasë momente që kleri katolik, ka qenë në luftë të hapët me ne duke na luftuar edhe me armë. Ne i jemi përgjegjur dhe e kemi goditur. Por kleri katolik nuk është aq naiv saqë të insistojë në një luftë të hapët me pushtetin tonë, kur pozitat e tija janë të dobëta dhe kërcënohen dhe kur pozita ndërkombëtare nuk është e favorshme për të. Kleri, duke qenë armiku ynë, di të bëjë politikë jo në të mirën e popullit, por për forcimin e pozitave të tija. Do të jetë papjekuri politike nga ana jonë, në qoftë se nuk dimë të përfitojmë nga rastet dhe rrethanat. Duhet të bëjmë një politikë të zgjuar me klerin katolik. Në këtë politikë duhet të mos humbasim masën dhe të hidhemi nga një ekstrem në tjetrin, gabim që shokët bien shpeshherë. Rreth manevrave të klerit do të përqëndrohet gjithë lodra e reaksionit, e krerëve të arratisur nëpër malësi, e të pakënaqurve e të pasqaruarve. Këtu do të duket pjekuria jonë politike

që vijën politike të Frontit, të dimë ta adaptojmë në situata dhe në vende të ndryshme për të shpërndarë grumbullimin e reaksionit dhe për të fituar pozita të forta për ne. Shtresat e tregëtarëve të pasur dhe ato të bejlerëve dhe të agallarëve të pasur, të prekura direkt nga ligjet e drejta të pushtetit, po shtojnë radhët e të pakënaqurve. Kategoria e parë, në ditët e para të vjeljes së taksës së tatimit rezistoi në mënyrë të organizuar, por u desh të paguajë përpara masave të marrura nga ana e pushtetit. Kjo s'do të thotë se ata u bindën dhe u bënë paguesit më të gatshëm, përkundrazi, ata përpinqen t'i shpëtojnë pjesës tjetër të taksës.

Situata e brendshme nuk do të jetë e plotë në rast se nuk tregojmë sa të fortë jemi ne, ku qëndron forca jonë dhe të metat tonë. Këtë do ta theksojmë më poshtë, kur të flasim për Frontin dhe për pushtetin. Por këtu do të them se, me të tilla forca kundërshtare, që duhet të mos i nënçmojmë, ndodhemi në situatën e sotme dhe përpara zgjedhjeve të përgjithshme. Për zgjedhjet praduhet të luftojmë dhe që të fitojmë duhet që ne të dimë mirë vijën politike të Frontit dhe ta aplikojmë si duhet atë. Aplikimi i vijës së Frontit s'do të thotë vetëm me ba një konferencë, por me e zbatue në praktikë, në rrethana të ndryshme dhe në kategori të ndryshme njerëzish, të cilëve t'ju njoftohesh mentalitetin, mendimet, qëllimet. Të zbatosh mirë në praktikë vijën politike do të thotë të kuptosh mirë ç'është pushteti e si funksionon; të dish mirë ligjet, t'i respektosh i pari dhe t'i aplikosh si duhet, të kuptosh dhe të zbatosh politikën e qeverisë në çdo lëmë aktiviteti dhe duke qenë në kontakt të ngushtë me masat e popullit. Propagandën dhe agjita-

cionin t'i bazojmë në themele të shëndosha dhe t'i bëjmë konkrete për popullin, domethënë t'i bazojmë në realizimet e ndryshme të pushtetit, ku populli i edukuar dhe i ngritur politikisht, ka marrë vetë pjesë aktivisht. Vetëm në këtë mënyrë Fronti bëhet një realitet, bëhet një organizatë e masave që mbron dhe përkrah gjithë pushtetin. Pikërisht këtu po goditin armiqjtë: pushtetin, Frontin, ushtrinë. S'është nevoja të theksojmë me hollësi në raport manevrën e reaksionit ndërkombetar në këto momente të zgjedhjeve. Pika kryesore ku ai godit është akuza që i bën qeverisë sonë duke thënë se ajo është qeveri komuniste, prandaj këtu s'ka demokraci, këtu ka diktaturë të një partie, d.m.th. të Partisë Komuniste dhe prandaj zgjedhjet bëhen në kondita jo të lira. Duke u mbështetur në këto akuza të trilluara anglo-amerikanët, duan t'i sabotojnë me njëmijë mënyra këto zgjedhje ose të ndërhyjnë drejtpërdrejt. Kjo taktikë e reaksionit ndërkombetar, natyrisht, është bërë taktikë e reaksionit tonë të brendshëm. Fjalët e Gjergj Kokoshit në Mbledhjen e fundit të Këshillit¹ shfaqin tërë programin e reaksionit. Në Jugosllavi, në Bullgari dhe në Rumani reaksiioni i jashtëm në bashkëpunim me të brendshmin, janë në aktivitet të madh, ndërsa këtu sapo ka filluar. Të mos flemë duke thënë se këtu s'mund të veprohet si gjetkë, pse konditat janë ndryshe. Kjo është e vërtetë, situata paraqitet kurdoherë me variante, por edhe taktika e

¹ Në seancën e pestë të Mbledhjes së tretë të Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar (shtator 1945), Gjergj Kokoshi, zëdhënës i forcave reaksionare brenda Frontit Demokratik u shpreh kundër ligjit mbi zgjedhjet e Asamblesë Kushtetuese, duke e cilësuar atë si antidemokratik.

reaksionit ka variante. Sinjali i parë i ofensivës së anglo-amerikanëve kundër nesh me rastin e zgjedhjeve u dha nga Tajar Zavalani¹ megjithëse në mënyrë akoma jo konkrete. «Ballons d'essaie»² po hidhen si «Zogu ka vajtur në Kajro», «po formohet jashtë një qeveri shqiptare», etj. Gjenerali Hoxhson³ më bën letrën e parë dhe më pyet në se ne do t'i lëmë të lirë të gjithë oficerët britanikë të kontrollojnë lirisht fushatën e zgjedhjeve ditën e votimit. Ky është fillimi, resti pa dyshim do të vijë pas. Nga ana tjetër Gjergj Kokoshi, i cili pati kurajon të shfaqë pikëpamjen e reaksionit, është në lëvizje. Influencën e tij ai përpinqet ta shtrijë, natyrisht, në shtresat e intelektualëve dhe të borgjezisë së pakënaqur, në shtresat e kapitalistëve dhe të tregtarëve. Patjetër Gjergj Kokoshi dhe shoku i tij i porsarikthyer nga mërgimi, Mirash Ivanaj⁴, gjoja të njojur si kundërshtarë të klerit katolik, do të përpinqen që këtë forcë të reaksionit në Shkodër, ta drejtojnë kundër nesh. Akoma nuk po duket krijimi i ndonjë partie jashtë ose brenda Frontit sido që parulla lëshohen andej-këtej për tentativa krijimi

¹ Spiker i emisioneve në gjuhën shqipe të radio Londrës, intelektual borgjez pseudodemokrat. U vu në shërbim të imperializmit anglez dhe punoi në dëm të interesave të popullit dhe të atdheut.

² «Ballons d'essai» (frëngj.) — balona prove.

³ Gjeneral D.P.E. Hoxhson, erdhë në Shqipëri në mars të vitit 1945 me cilësinë e kryetarit të misionit ushtarak anglez.

⁴ Mirash Ivanaj, ministër i arësimit dhe më vonë Kryetar i Këshillit të Shtetit në periudhën e regjimit të Zogut. U largua nga Shqipëria në prill 1939 dhe u kthye në tetor 1945. Kreu veprimtari armiqësore në shërbim të imperializmit anglo-amerikan. U dënuar nga gjyqi i popullit.

partish. Por sidoqoftë fushata për abstemin në votimë po bëhet nga ana e tyre duke propaganduar si thashë më lart: «Këtu s'ka liri», etj. Gjergj Kokoshi dha dorëheqjen nga Fronti, por bëhet pyetja: Vallë Gjergj Kokoshi s'kishte shokë të një mendimi me të në Front? Duhet të mos kemi iluzione se të gjithë nacionalistët pa parti në Front janë qind për qind me ne. Ka nga ata që janë shumë afër nesh dhe që kanë lidhur fatin e tyre me atë të Partisë sonë, ka të lëkundshëm, që një punë e shëndoshë nga ana jonë do t'i bëjë të jenë kurdoherë me ne por ka edhe nga ata që s'mendojnë si ne dhe nesër do t'i kemi kundërshtarë. Këta njerëz s'e ndjejnë veten aq të fortë sa të dalin haptas kundër Frontit, dhe as që duket deri tani ndonjë tentativë serioze për formimin e ndonjë grupi o partie brenda në Front. Këta njerëz në një përqindje shumë të madhe do të vazhdojnë të qëndrojnë në Front, deri në mbarimin e zgjedhjeve, dhe nën flamurin e Frontit të zgjidhen në asamble. Krijimin e grupit, ose të partisë, krijimin e opozitës, sigurisht do ta bëjnë në gjirin e asamblesë dhe të kuvendit. Këtu duket se ka qenë mosmarrëveshja në mes të Gjergj Kokoshit dhe njerëzve të tjerë të lëkundshëm e kundërshtarë që ndodhen ende në Front, domethënë mosmarrëveshje në taktilë. Zhvillimi i fushatës elektorale do të na sqarojë më mirë mbi taktilën që po përdor reaksiuni për të minuar pushtetin dhe për të sabotuar zgjedhjet. Përparrë kësaj situate, pra, Partia jonë duhet të mobilizojë të gjitha forcat dhe Fronti Demokratik të bëhet një realitet. Vijën politike të Frontit e kemi shtruar shumë herë, prandaj s'po e ripërsëris.

Të punosh në Front, që është detyra e çdo komunisti,

do të thotë të punosh me popullin, të punosh edhe jashtë detyrës që ke në pushtet o në ushtri, të bësh punën speciale të partisë dhe nga më kryesoret: edukimin e masave. Mjerisht nga shokët e partisë kjo gjë është shikuar shumë ngushtë. Ta fillojmë çështjen nga puna politike me masat. Me punue në Front është kuptuar në këtë mënyrë: të vesh të bësh një konferencë në pesëmbëdhjetë ditë një herë dhe e ke mbaruar detyrën që të ngarkon Partia. Kjo është një pjesë e vogël e punës, por mjerisht edhe kjo punë e vogël nuk bëhet me seriozitetin që duhet t'i bëjë punët një komunist. Sa më të ulët të jenë ata shokë që zhvillojnë konferencën, aq më pak prepatiten. Ata kujtojnë se publiku është i detyruar të dëgjojë «përrallën» e tyre të prepatitur gjysmë ore përpara. Kjo ka shkaktuar që konferencat s'i ndjekin me aq qejf dhe shkakun nuk duhet ta kërkojmë në pasivitetin e masave, por në xhahillëkun, në neglizhencën, në nënçmimin e masave nga konferencieri dhe kur kjo bëhet nga një shok partie është një gabim që s'falet. Por si mund të prepatitet një konferencë që të dalë e mirë? Këtë, jam i bindur se shumë shokë, akoma s'e kanë kuptuar se, po ta dinin, kjo do të ishte e thjeshtë dhe konferencat do të bëhen interesante. Konferanca s'prepatitet duke mbledhur artikujt e gazetave ose referatet e të tjerëve. E kuptoj kur prepatitet një konferencë me karakter shkencor, por kur është puna për agitacion në masë dhe të atij karakteri, që gati zhvillohen të gjitha konferencat tona, (pse për konferanca shkencore mjerisht atij kapitulli i kemi vënë kapakun) temat e konferencave, mendimet që do të shtrojë dhe do të rrahë përpara publikut, ai do t'i gjejë vetëm në jetën e popullit dhe jo në

gazeta e revista. Por ky libër ku ai do të mësohet të bëhet agjитator i mirë, është lënë mënjanë, ai s'jeton me popullin, ai s'ja njeh hallet, ai s'i njeh problemet, ai qëndron në hava dhe konferenca e tij është një «avaz i mukës». Por masat e popullit s'ngopen vetëm me fjalë. Masa mund të dëgjojë me kënaqësi një konferencë të mirë, por ato që u thanë atje, ajo do t'i shohë të realizuara në praktikë, t'i prekë me dorë. Kjo është karakteristike për masat. Forca e Partisë sonë qëndron në realizimin e gjérave. Këtu s'e kam hallin të them se si preqatiten konferencat, por e kam fjalën se me ç'metoda gjysmake e edukojmë popullin. Shumë herë dëgjohen nga anëtarë partie: «s'kam kohë, më kanë mbuluar punët e zyrës, s'mund të vete atje, s'mund të bëj këtë». Në këtë pikë jam kategorik dhe them se kjo, në 90% të rasteve, s'është e vërtetë. Që nga unë dhe deri te anëtar i thjeshtë i Partisë, po të bëjmë një revizion të ndërgjegjes në punë, do të shohim se kohën mund ta gjejmë. Është e pamundur të mos ketë kohë një anëtar partie, për të bërë detyrën që i ngarkon Partia jashtë asaj zyrtare; por, edhe në qoftë se s'ka, duhet ta gjejë; ta heqë nga gjumi i natës. Të tillë njerëz duhet të jemi ne. Kam arësyte pse e theksova këtë gjë. Kjo është një sëmundje e madhe që duhet ta luftojmë sepse shkakton dobësimin tonë, këtu është burimi i të gjitha lëshimeve e gabimeve politike. Ekuipoj dhe e nderoj atë anëtar partie që është i mbytur deri në grykë me punë dhe ai është i vetmi, që me gjithë punën e tij të madhe, s'e lë kurrë mangut dhe punën speciale të Partisë. Por kështu s'ngjet me të gjithë. Me një mentalitet dhe me një frymë të tillë nuk mund të ecim përpara. Nën pretekstin se gjoja janë shumë të zënë,

shokët i shmangen detyrës, bile dhe atë detyrë që kryejnë, s'e nxjerrin të saktë. Po të pyesësh filan sekretar politik qarkori, do të të thotë: «kam shumë punë», ndër-kohë në organizatën që drejton ai po bëhen shumë gjëra të papëlqyera dhe antiparti dhe ai i sheh këto, kur i sheh tërë populli; filan sekretar i përgjithshëm i ministrisë të thotë se është i mbuluar me punë, por kur i kërkon diçka për sqarim, ai ose s'është në gjendje të të thotë asgjë, ose të rregullon një statistikë false e të pakontrolluar. Kjo është një. E dyta: shokët s'përpilen të mësojnë dhe të lartësohen; në përgjithësi po numërohet në vend. Njerëzit e pushtetit dhe shokët tanë në radhë të parë nuk dinë e nuk i mësojnë ligjet e pushtetit. Ngjasin gjëra të çuditshme, që t'i numërosh, duhen ditë. Njëra nënprefekturë gjoja meqë vetëqeveriset, me anën e këshillit, s'pranon as udhëzimet e qarkut dhe as të qendrës. Ajo bëhet «republikë më vete»; tjetri qark të krijon nënprefektura si kërpudha për t'i riprishur pas tre muajve. Taksat, njëri t'i mbledh kështu, tjetri ashtu, njëri të respekton ligjin, tjetri ta shkel fare dhe t'i fal taksat, pse ashtu e sheh «të arësyeshme» ai në krahanë e tij. Të tilla gjëra janë të zakonshme, por ka edhe raste më kritike: mungon respekti ndaj pushtetit, nuk përfille urdhërat e qeverisë. Qendra mund t'i bëjë njëzet telegramë një qarku dhe ai as i përgjigjet. Pse ngjet kjo? Kjo ngjet sepse disa shokë s'e kanë kuptuar akoma ç'është pushteti, ç'është centralizmi, si e drejton Partia pushtetin dhe përgjegjësitë e tij përpara Partisë dhe përpara pushtetit. Dhe mbi të gjitha këto, fillon të duket një mentalitet i rrezikshëm që duhet luftuar shpejt: me të hyrë në parti, komunistit i rritet mendja. Ai bëhet autoritar, ai punon

më pak se të tjerët dhe e quan veten të paprekshëm dhe se mund t'i lejohet të bëjë çdo gjë. Këto vërejtje i thashë që të mendojmë thellë mbi këto gjëra dhe t'i zhdukim pse, po s'u përmirësuam në këtë drejtim, edhe Frontin do ta kemi të dobët edhe pushtetin gjithashtu. Fronti s'është një gjë e shkëputur nga realiteti praktik. Vija politike e Frontit gjen realizimin konkret në punët e pushtetit, në realizimet e pushtetit. Në qoftë se ne nuk e kuptojmë si duhet vijën politike të Frontit do të jetë zor për ne të kuptojmë si duhet politikën e qeverisë në të gjitha fushat e veprimit dhe anasjelltas. Politika e Frontit dhe politika e qeverisë janë dy gjëra që shkojnë së bashku. Kemi thënë që Frontin duhet ta zgjerojmë, duhet të bindim të pakënaqurit, të aktivizojmë gjithë popullin. Këtë s'e kemi bërë sa duhet dhe si duhet; ekziston sektarizëm dhe rutinë në punë, insistohet në metoda të vjetra, të përshtatshme për dy vjet të kaluara, nuk shkojmë me zhvillimin e kohës dhe të ngjarjeve. Harrojmë se çështjet tani nuk mund të zgjidhen më me mënyrat e malit; harrojmë se metoda e punës duhet të ndryshojë jo vetëm në formë, por edhe në esencë; harrojmë që populli tani të kërkon shumë gjëra, gjërat që i premtovë; ai ka filluar që të kërkojë në një vit, ato që s'i janë plotësuar gjatë qindra vjet me radhë; fshati më i humbur të kërkon shkollë, por të kërkon edhe elektrik, sepse ka një vijë uji afër. Luftuam dhe çliruam vendin, ky është një triumf i madh për ne. Kjo është mbështetja jonë më e madhe, por s'mjafton; tani duhet të punojmë drejt dhe shumë, pse përndryshe errësohen dafinat. Përpara Partisë ishin vënë një tok problemesh, përvèç çësh-tjes së rëndësishme të Frontit. Problemi me rëndësi i

pushtetit dhe zbatimi i politikës qeveritare në fusha të ndryshme të aktivitetit shoqëror dhe ekonomik dominonin gjatë kësaj periudhe të çlirimt dhe vazhdojnë të jenë kurdoherë në rendin e parë të ditës. Çdo gjë do të zgjidhet më së miri kur Partinë tonë ta kemi të fortë dhe dita-ditës të shohim përmirësime në të.

Do të prek në vija të përgjithshme çështjen e pushtetit dhe politikën e qeverisë.

Me pushtetin ne do të zgjidhim çdo gjë, këtu qëndron forca jonë. Pushtetin ne duhet të dimë ta prefeksionojmë dhe ta përdorim më së miri. Partia jonë drejton pushtetin dhe rrjedh vetëvetiu që sa më e fortë të jetë Partia, aq më i fortë është pushteti. Më parë se t'i hyjmë në thelb çështjes, shokët duhet të kuptojnë një gjë: që Partia jonë e drejton pushtetin me anë të njerëzve të saj, të cilët janë kudo në vendet kyçë të komandës. Të gjitha vendimet përpunohen në Parti dhe zbatohen nga pushteti. Njerëzit e Partisë i çojnë këto vendime të Partisë në pushtet. Varet nga anëtarët e Partisë se si do t'i paraqesin, përpara njerëzve të pushtetit, përpara njerëzve të Frontit. Këtu duket sa e kemi kuptuar vijën e Partisë dhe si e zbatojmë në Front dhe në pushtet. Përveç kësaj, anëtarë i Partisë duhet të dijë se Partia është atje ku ai punon dhe është njëkohësisht përgjegjës përpara Partisë dhe përpara pushtetit, përpara superiorëve të tij në pushtet, cilëtdo qofshin këta, anëtarë partie ose jo. Zotësia e një anëtarë të Partisë, njihet dhe çmohet me punën që kryen atje ku e ka vendosur Partia; atje shihet sa i zoti është, sa i disiplinuar është, sa besnik i Partisë është. Nga moskuptimi mirë i çështjes rrjedhin gabime si: mosrespektimi i pushtetit dhe i hierarkisë në pushtet, shkelja e ligjit

dhe moskryerja e detyrës; këtej rrjedh sektarizmi në Front dhe në pushtet. Këto të meta ekzistojnë në shokët tanë dhe për këtë arësyё pushtetin nuk e kemi aq të fortë dhe ndodhin gabime.

Pikësëpari bazat e pushtetit, që janë këshillat e katundit, vazhdojnë të jenë të dobëta, të zgjedhura jo me një kriter të shëndoshë dhe nuk dinë akoma si duhet rolin e tyre në fshat. Këto këshilla nuk ndihmohen sa duhet nga shokët, e sidomos, në Veri.

Në formë, pushteti në Veri, paraqitet pak a shumë ashtu si e duam ne; por në praktikë po bëhet puna e vjetër, dua të them që interesimi i këshillit të nënprefekturës është shumë i paktë, për mos me thënë aspak; edhe ligjet e udhëzimet gati nuk shkojnë fare. Gjithashtu, shumë rrallë shkojnë shtypi, agjitarët dhe propagandistët. Kjo dobësi e këshillave bazë, patjetër shkakton që edhe këshillat e qarkut dhe ato të nënprefekturave nuk janë në lartësinë e duhur. Këshillat e qarkut s'janë në gjendje të drejtojnë si duhet gjithë krahinën, të gjitha këshillat e nënprefekturave. S'ekziston një lidhje e shëndoshë në mes të tyre dhe një koordinim pune. Shokët tanë janë të rinj, u mungon eksperienca, u mungon perspektiva dhe s'janë aq organizatorë. Shumë herë çështjet i shikojnë ngurtë dhe ngushtë, punët e vogla ju zënë këmbët dhe lënë mënjanë problemet kapitale. Shokët nuk bëjnë përpjekje serioze të mësojnë dhe të lartësohen; për shumë prej tyre ligjet janë të panjohura ose të njohura përciptazi. Problemët e vendit nuk studjohen me seriozitet dhe shumë pak sugjerime ose propozime merr qendra prej tyre. Në përgjithësi s'janë në korrent të gjendjes, pse kontaktet me qendrën janë formale dhe kjo shkakton

që plani i tyre i punës në qark të mos jetë i koordinuar mirë me planin e përgjithshëm të qeverisë. Shumë herë bien në pozitat e një pjese të popullit dhe duke interpretuar keq fryshtën e ligjit krijojnë ndarje administrative pa baza dhe të panevojshme; i shohin çështjet dhe problemet në fryshtën lokaliste pa studjuar problemin në tërësi. Të gjitha këto shkaktojnë që pushtetin në disa qendra ta kemi të dobët. Kjo shkakton që populli nuk mobilizohet si duhet rrëth pushtetit dhe të bëhet ndihmësi më i madh i tij e sidomos në këtë moment kur gjendja ekonomike dhe financiare nuk janë aspak të lulëzuara. Këtej rrjedh burokracia në punë, mungesa e përgjegjësisë dhe lënja e punës mbas dore. Shokët s'e kanë kuptuar rëndësinë e pushtetit, rëndësinë e organizimit, rëndësinë e drejtimit. Ka një proces në zhvillim dhe ky mund të shkojë në disfavorin tonë, në rast se shkojmë me ëndrra; pushteti mund të na dalë nga duart, në rast se nuk jemi të zot. Ekziston fryma sektare në shumë kuadro të pushtetit. Shumë nga ata që s'janë komunistë dhe zotërojnë shkencën, nuk përdoren si duhet. Këta janë inxhinierë, doktorë, agronomë, teknikë të ndryshëm, pa të cilët nuk mund të eci maqina. Shumë herë qëllon që në pushtet ndodhen shokë komunistë jokompetentë dhe jo të zot dhe, për të fshehur pazotësinë e tyre, sillen keq me këta kuadro. Kjo gjendje as mund të tolerohet, as mund të durohet shumë. Komunisti duhet të jetë në vendin që meriton, të tregohet më i zoti nga të tjerët me punë dhe jo me fjalë, se fjalët i merr era. Pa ndreqjen e këtyre gabimeve nuk mund të kemi pushtet të fortë, pse pushteti s'është i pagabueshëm, ideal dhe i paprekshëm, por është një realitet, që përmirëso-

het po të përmirësojmë punën. Sidoqoftë ne kemi realizuar mjaft gjëra me këtë pushtet dhe unë nuk do të rri këtu t'i analizoj një nga një; këtu do të shtroj vetëm në vija të përgjithshme disa probleme më me rëndësi të qeverisë dhe politikën e saj në sektorët më me rëndësi të shtetit. Këtë politikë të qeverisë do ta zbatojnë organet e pushtetit në rrrethana të ndryshme dhe të koklavitura e të zorshme që na paraqiten, prandaj gjithë Partia duhet të mobilizohet rrreth këtyre problemeve, të cilat do të realizohen si duhet kur Partia të jetë në krye, kur pushteti të jetë i fortë.

S'është hera e parë që Partia, dhe kur them Partia, kuptoj dhe qeveria, përcakton politikën e saj në sektorët e ndryshëm të aktivitetit të shtetit. Kjo politikë është përcaktuar me ligjet e ndryshme që janë aprovuar nga Këshilli Antifashist dhe që janë përpunuar më parë në Byronë Politike të Komitetit Qendror të Partisë. Qeveria në sektorët e ndryshëm ka caktuar dhe programin e punës gjatë kësaj kohe, program që është zbatuar me të mirat dhe me të metat që kemi treguar shumë herë.

Në Plenumin, që u mbajt në Berat¹, u muarën vendime në vija të përgjithshme përsa u përket masave urgjente që na diktonte situata, por këto vendime më vonë u përcaktuancë më mirë me çlirim e plotë të Shqipërisë, me rrrethanat e reja që na u paraqiten. Tani kemi një eksperiencë më të gjatë në zgjidhjen e çështjeve dhe jemi në gjendje ta përcaktojmë më mirë e më qartë politikën tonë në fushën ekonomike dhe sociale.

¹ Është fjala për Plenumin II të KQ të PKSH që u mblohdh në Berat më 23 nëntor 1944.

Cilat janë problemet më me rëndësi ku duhet të vëmë gjithë kujdesin tonë për t'i zgjidhur? Sipas mendimit tonë në radhën e parë janë: problemi ekonomik, ai bujqësor, i arësimit, i financës, i rindërtimit dhe çështja e ushtrisë, por kjo s'përjashton që këtu të diskutojmë dhe të sqarojmë dhe probleme të tjera të qeverisë.

Problemi ekonomik është më i rëndësishmi për ne, por edhe më i zorshmi, prandaj do të përpinqemi në vija të përgjithshme të tregojmë situatën dhe të përcaktojmë vijën tonë ekonomike. Ekonomia janë është shumë poshtë, shumë e shkatërruar. Sektorët e ndryshëm si industria, minierat, tregëtia e jashtme dhe e brendshme ose janë shumë të dobëta, ose janë krejt të paralizuara. Prodhimet e ndryshme të vendit tonë, i dëmtuar dhe i rrënuar nga lufta, janë të pakta, kjo krijon një gjendje kritike. Arësyja kryesore e kësaj gjendjeje është lufta dhe pastaj vijnë me radhë: mungesa e veglave, e transportit, mungesa e kapitalit, mungesa e tregut të jashtëm, situata ndërkontrolluese në lidhje me pushtetin tonë etj.

Ç'duhet pra të bëjmë që të përmirësojmë gjendjen tonë ekonomike? Pikësëpari duhet të shtojmë dhe të përmirësojmë prodhimet tona, të mëkëmbim industrinë e vogël që ka ekzistuar në vendin tonë, të forcojmë sektorin e shtetit dhe në radhë të parë në pushtet e vajgurit, minierat e serës të Selenicës, pastaj edhe në të tjerat me radhë; të aktivizojmë tregëtinë e brendshme dhe të jashtme. Shteti ynë nuk mund të forcohet dhe gjendja e vendit nuk mund të përmirësohet, në rast se ne nuk e shtrojmë drejt çështjen e mëkëmbjes ekonomike. Procesi i riprodhimit në një shkallë të gjerë dhe industrializimi i vendit janë lidhur ngushtë me formën e pushtetit tonë..

Në këtë proces zhvillimi, sektori i shtetit duhet të forcohen dita-ditës. Në fazën e parë të rindërtimit ne na duhet të ndërtojmë dhe të krijojmë në lëmin e ekonomisë të gjitha ato që na shkatërrroi lufta dhe të arrijmë në një kohë të shkurtër në gjendjen e paraluftës. Për t'ja arritur kësaj duhet që tregëtarët dhe industrialistët e vegjël të rifillojnë punën, në kondita të reja, duke siguruar, nën kontrollin tonë, një farë fitimi, por duke i ndaluar të bëjnë spekulime. Jugosllavia na ka furnizuar me materiale, kjo është bërë në bazë të një marrëveshjeje ku parashikohet që ne t'ja kthejmë Jugosllavisë vlerën me prodhimet që kemi. Këto detyrime ne duhet t'i shlyejmë. Me BRSS bëmë një marrëveshje tregëtare me të cilën ai na shet 20 000 ton grurë dhe një sasi të vogël materialesh kimike. Të gjithë vleftën e këtyre ne detyrohemit t'ua kthejmë në fund të vitit 1946 duke e shlyer ose me mallra të tjerë që disponojmë ne, ose me devizë të huaj. Në rast se ne nuk do të përmirësojmë sektorin ekonomik, detyrimet që kemi kundrejt popullit dhe kundrejt shteteve, me të cilët kemi marrëdhënje tregëtare, do të jenë një shkak që të na bëjnë të jemi të varur dhe politikisht. Këtë gjë mos ta harrojmë kurrë; e shkuara ka qenë e hidhur. Me përjashtim të Sovjetëve, kundrejt të cilëve ne duhet të jemi shumë korrekt në çdo pikëpamje, aleatët anglo-amerikanë nuk na ndihmojnë përsytë tanë të bukur. Qëllimet e tyre dihen.

Shteti ynë, me atë zhvillim të prapambetur që kishë para luftës dhe me gjithë masat që ushtronte regjimi i Zogut, prapëseprapë eksportonte diçka jashtë. Natyrisht, eksportimi ka lidhje me zhvillimin e sektorëve të ndryshëm të prodhimit: si bujqësia, blegtoria, industria

e peshkut, e drurit, etj. Lufta na ka dëmtuar shumë në këtë drejtim, por ne me një organizim të mirë dhe me aktivizimin e të gjithë kapitalit të vendit, mund të arrijmë në rezultate të kënaqshme. Sektorët e mëdhenj të shtetit i kemi vënë në veprim, por zhvillimi i tyre është rudimentar. Të ardhurat kryesore të vendit tonë sigurohen nga prodhimi i minierave, të cilat do të na ndihmojnë për forcimin e sektorëve të tjerë. Vajguri është burimi ynë kryesor dhe që u intereson të gjithëve. Natyrisht, në këtë sektor vital, ne do të mbështetemi në ndihmat e Bashkimit Sovjetik, por duke shikuar në radhë të parë interesin e vendit tonë. Janë bërë bisedimet e para në këtë drejtim dhe sovjetikët kanë pranuar të na dërgojnë disa specialistë që të studjojnë çështjen në vend, të shohin çfarë ndihme mund të na japid dhe q'maqineri duhet për t'i vënë në shfrytëzim maksimal pushtet e Kuçovës dhe të Patosit.

Problemi i bujqësisë paraqitet dhe ai shumë me rëndësi dhe shumë i vështirë. Bujqësia jonë është shumë e prapambetur, bujku ynë është shumë i varfër, metodat dhe mjetet e punës janë të vjetra. Me ndërrimin e konditave të bujkut, si rezultat i reformës agrare, duhet të ndryshojë dhe natyra e punës dhe e prodhimit. Ne duhet të prodrojmë sa më tepër, ne duhet të mos lëmë asnje pëllëmbë tokë pa mbjellë, ne duhet të inkurajojmë dhe të futim në prodhim kultura të tjera të nevojshme, që ose nga mosditja ose nga konditat e vështira në të cilat rronte bujku, nuk i mbillte. Kjo do të jetë politika jonë në këtë fushë. Patjetër këtu ne duhet të punojmë me sistem. Çështjen e bujqësisë, reformën agrare dhe problemet që rrjedhin duhet t'i shikojmë në përgjithësi.

Bujqësia duhet ndihmuar konkretisht dhe në të gjithë sektorët: në çështjen e farës, të veglave e të kafshëve, në lëmin e blegtorisë dhe të ngritjes së punishteve të vogla përpunimin e prodhimeve blegtorale si dhe në çështjen e pyjeve dhe të industrisë së drurit. Për këtë punë paraqitet e domosdoshme krijimi i një banke bujqësore¹, që t'i vijë në ndihmë bujqësisë dhe jo ta rjepë sikundër bëhej më parë. Krijimi i kësaj banke është duke u realizuar, por këtu duhet të kemi kujdesin që kreditë që u jepen bujqve të shkojnë realisht në ngritjen e bujqësisë. Për këtë duhet bërë një punë e gjerë edukuese me bujqit që këto kredi të përdoren drejt. Një politikë e mirë në këtë drejtim, do të jetë një nga faktorët kryesorë të ngritjes ekonomike të vendit. Po të arrijmë të përmirësojmë prodhimin e grurit e të misrit si dhe të kulturave të tjera, ne do të shpëtojmë nga një pjesë e madhe e importit të bukës nga jashtë, gjë që na lejon të importojmë gjëra të tjera që do të ndihmojnë për ngritjen e sektorëve të tjerë dhe shtimin e prodhimeve të tyre. Përveç kësaj, përmirësimi i blegtorisë do të na lejojë eksportimin e leshit dhe ngritjen e një industrie në vendin tonë. Lëkurët në këtë kohë kërkohen kudo pa dallim. Industria e drurit te ne ka qenë shumë pas. Ne importonim mjaft dërrasa nga jashtë, kurse ne mund të ngremë në vend një industri të drurit e të letrës që të përballojmë të paktën nevojat e vendit. Në këtë drejtim përveç barrës së madhe që i bie shtetit, mund të aktivizojmë fare lehtë

¹ Bankë bujqësore nuk u krijuar, por pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Bankës së Shtetit u krijuar seksioni i kreditit agrar.

edhe kapitalet private dhe sidomos në çështjen e blegtorisë dhe të prodhimeve industriale që nxirren nga ajo.

Reforma agrare ishte një nga reformat tona më të mëdha, e cila do t'i japë pa dyshim një hov bujqësisë sonë. Por në radhë të parë ne duhet të punojmë në zbatimin e mirë dhe të shpejtë të reformës. Në lidhje me reformën agrare është çështja e popullimit dhe e bonifikimeve. A do të mund t'i bëjmë dot ne këto, në këto momente? Është zor t'i kryejmë si duhet, por kjo s'do të thotë që ne s'duhet të fillojmë. Sipas statistikave që na paraqiten dhe sipas rezultateve të para që kanë rezultuar nga ndarja e disa çifligjeve, tani për tanit nuk parashikojmë të kemi shumë tokë për të populluar dhe popullimi do të jetë i kufizuar derisa të fillojnë bonifikimet në shkallë të gjerë. Për ato familje bujqish, që ne do të shpërngulim, duhet t'u sigurojmë të paktën minimumin e mjeteve të punimit. Duhet të kemi kujdes që në tokat e shpronësuara të vendosen në radhë të parë familjet e dëshmorëve, të ushtarëve dhe bujq të varfër. Ndërsa bonifikimet për arësyen buxheti dhe teknikësh s'mund të fillohen dot që tanit në shkallë të gjerë. Por konstatohet se masat e popullit me vullnet të madh kanë filluar dhe po hapin kanale dhe vija për kullimin e ujërave dhe përvaditjen e tokave. Këtë gjë ne duhet ta inkurajojmë dhe ta ndihmojmë më shumë.

Problemi finanziar dhe ky është një problem i madh që duhet të na preokupojë. Shpenzimet, të gjithë duhet ta dinë, janë shumë më të mëdha nga të ardhurat e zakonshme. Po t'u shtojmë këtyre edhe tatimet e jashtzakonshme arrijmë të kemi një buxhet të balancuar, por megjithatë ai do të realizohet me zor të madh. Sikundër-

që e dini, buxheti ynë është i mbështetur në më shumë se gjysma, në tatimet e jashtzakonshme. Të ardhurat e tjera janë taksat e ndryshme. Kuptohet vetëvetiu që, me një tregëti të paralizuar, me një industri të shkatërruar, me një bujqësi të dobët, me varfërimin e popullit dhe me zhdukjen e gati të gjitha taksave direkte, të ardhurat nga taksat janë të pakta. Kjo gjendje natyrisht pengon realizimin e programit të punimeve të ndryshme. Shumë qarqe ankohen pse s'u dërgohen kreditë që u janë caktuar në buxhet, por s'mendojnë se nga mund të dalin aq kollaj këto kredi. Shumë qarqe kanë lënë krejt pas dore vjeljen e taksave dhe mbahen vetëm me buxhetin që u ka caktuar qendra. Disa qarqe, pa menduar aspak mirë se ku po shkojmë me problemin financiar, shkelin edhe ligjin, duke kërkuar të mos i mbledhin fare taksat, pse gjoja kështu do të bëjnë përshtypje të mirë. Të gjithë e dimë se bën përshtypje të mirë po të mos marrësh asgjë nga populli, por kur të mos paguaj askush, qoftë dhe aq sa është caktuar, si bëhet puna? Si do ta përballojmë këtë vit financiar? Në radhë të parë me kursime dhe kur ne themi kursime, s'duhet të kuptojmë që të paguajmë me mijëra nëpunës që nuk punojnë dhe të lëmë mënjanë punimet. Kursime bëhen si duke spastruar parazitët, që mund të kenë mbushur zyrat, ashtu edhe duke aktivizuar popullin në punë vullnetare për të mirën e tij dhe atë të përgjithshme. Atij i duhet dhënë të kuptojë se konditat janë të vështira. Pastaj mbi të gjitha duhet të na dhimbset leku i shtetit, ta përdorim me vend, ta kontrollojmë si duhet. Në këtë drejtim jemi shumë pas dhe lypset patjetër një kthesë, pse përndrysht mund të gjendemi përpara një falimentimi. Mallrat që sjellim nga jashtë

dhe që i shesim janë një mjet që na lejon të përballojmë nevojat tona që shkaktohen nga vonesa e vjeljes së tak-save e të tatimeve, por mos të harrojmë se këto shuma mbeten kurdoherë në pasivin e buxhetit të shtetit. Me vënjen në qarkullim të kartmonedhës së re vihet në diskutim edhe çështja e një deflacioni të ri. Meqenëse jemi në çështje paraje, këtu dua të theksoj se shokët e Partisë që punojnë në pushtet dhe veçanërisht që gjenden në zyrat e shpërndarjes së mallrave, si në qendër dhe në qarqe, duhet të jenë rigorozë në çështjet financiare dhe në mbajtjen e pasqyrave në rregull. Kjo s'është një gjë e vogël, atje janë miliona dhe këtë e them sepse po bëhen abuzime në sektorë të ndryshëm deri edhe në ushtri, bile edhe nga ndonjë që e quan veten anëtar i Partisë. Gjëra të tilla do të shtypen pa mëshirë, qoftë kur bëhen me dashje, qoftë pa dashje. Anëtari i Partisë në radhë të parë duhet të ketë kokën në vend dhe ndërgjegjen të pastër.

Të shohim pak *problemin e rindërtimit* dhe ç'mund të bëjmë në këtë sektor. E dimë të gjithë si paraqitej gjendja. Plani i qeverisë ishte që në radhë të parë dhe urgjentisht të rregulloheshin komunikacionet, rrugët, urat, transportet. Në ngritjen e urave ne patëm një sukses të madh. Pse e patëm këtë sukses? Sipas mendimit tonë kjo u arrit sepse atje u punua më me ndërgjegje dhe udhëheqësit e atij sektori i qëndruan vetë mbi kokë punës. Gjithashtu shumë material u gjend prej njerëzve tanë dhe u ble prej pushtetit. Këto ishin faktorët e suksesit në këtë sektor. Gati të gjitha centralet elektrike janë vënë në rregull siç ishin më parë, por këto janë mjaft të vjetëruara. Më preokupante tani, pas ndreqjes

së urave, dhe meremetimit pak a shumë të mirë të rru-gëve, është problemi i strehimit të popullsisë që ka mbetur pa strehë. A mund të bëjmë shumë gjëra në këtë drejtim dhe gjëra me themel? Tani për tani është vësh-tirë. S'jemi në gjendje të bëjmë shtëpi të reja dhe në seri në fshatra të ndryshme që janë djegur dhe shkatërruar. Por ne duhet të përpinqemi që këta njerëz të popullit të futin diku kokën. Prandaj duhet të bëjmë çmos për të ndihmuar iniciativat private ose kolektive për ngritjen e kasolleve ose të shtëpive provizore për këtë dimër. Nga ana tjetër në këtë sektor duhet të punojmë për projektimin e planeve të fshatrave të djegura ose të qyteteve, që në raste të volitshme të fillojmë punimet. Por, si kjo, si çështja e elektrifikimit të vendit, gjë me shumë rëndësi, lypin kondita më të favorshme se këto që jetojmë. Në çështjen e transportit jemi shumë dobët. Ngjet një fenomen në çështjen e automjeteve. Të gjithë e dimë që jemi keq dhe që mund të mbetemi për hall. Asnjeri s'të jep automjete sepse kudo ndjehet nevoja. Të gjithë themi që duhet të bëjmë kursime dhe t'i ruajmë, por asnjeri s'bën gjë. Ata që kanë automjete për punët e shtetit, fare pak kujdesen, ata që s'kanë fare, kritikojnë nga të katër anët, por kur ju bie në dorë një automjet, «pëlcasin» sa ta prishin. Kjo s'është për të qeshur. Ato automjete që kemi trashëguar kanë qenë të vjetra, por fakti është që ne kemi abuzuar dhe vazhdojmë të abuzojmë në këtë drejtim. Si në çdo fushë aktiviteti e sidomos për çështjen e transportit, njerëzit e Partisë duhet të vënë patjetër rregull. Nga ato pesë maqina që kemi varet buka e popullit, varet transporti i kripës e i gazit, varen ndërmarrjet industriale, punët botore, shfrytëzimi i minierave

tona. Po të kemi parasysh rëndësinë e këtij problemi të madh do të vëmë gishtin në kokë. S'ka tjetër zgjidhje në këtë drejtim. Perspektivat s'janë të ndritura. Ky është realiteti.

Problemi i arësimit duhet të bëhet një problem i gjithë Partisë. Cila duhet të jetë politika arësimore e Partisë dhe e shtetit tonë? Të gjithë duhet të pajisen me arësim. Duhet luftuar analfabetizmi, shkolla fillore të bëhet e detyrueshme për të gjithë, të përpinqemi të pajisim brezin e ri me një kulturë të përgjithshme të shëndoshë, të orientojmë pjesën më të madhe dhe më të shëndoshë të rinisë në degën e bujqësisë dhe të industrisë, të formojmë kuadro arësimtarësh të shëndoshë dhe t'i shtojmë këta kuadro. Të zhdukim mentalitetin se «edhe pa arësim e pa kulturë mund të bëjmë çdo gjë». Boll e ndjejmë tani ç'do të thotë të mos kesh njerëz të kulturuar, që të drejtojnë punët, të mos kesh inxhinierë, teknikë, agronomë e të tjerë. Ç'do të ndodhë më vonë në rast se ne nuk marrim që tani masat dhe nuk bëjmë një politikë arësimore të shëndoshë dhe të gjerë? Do të fillojmë me këta që kemi. Rëndësi të veçantë duhet t'i vëmë arësimtarëve të shkollave fillore, pse ata kanë në dorë gjithë brezin e njomë. Me një politikë të drejtë kundrejt tyre, ne mund të kemi shumë sukses me ta, pse këta, mos harrojmë, shumica janë djem e vajza të popullit, të vobektë, më afër nesh, më afër popullit dhe që rrojnë me popullin. Mësuesi është çdo gjë në fshat. Kjo s'përjashton që edhe me profesorët¹ duhet të kemi një qëndrim të drejtë, sido që mjافت prej tyre janë indiferentë ose qëndrojnë

¹ Mësuesit e shkollave të mesme.

akoma larg pushtetit tonë. Kërkesat për hapje shkollash janë shumë të mëdha dhe kapërcejnë mundësitë tona. Çdo fshat kërkon të ketë një shkollë. As buxheti s'na e lejon këtë, por as edhe teknikisht s'jemi në gjendje. Megjithatë ne duhet të çelim një numër shkollash, duke u përpjekur të preqatitim mësues të rinj të dalë nga kurse pedagogjike që duhet të krijojmë. Këta mësues të rinj me kohë do të perfektionohen dhe do të plotësojnë dituritë e tyre. Programi i shkollave do të jetë një gjë e vështirë që të hartohet për këtë vit shkollor. Jemi duke studjuar programet e shkollave të mesme sovjetike, por kjo do të dojë një kohë mjaft të gjatë sa t'i përkthejmë, t'i studojmë dhe të vendosim një program të përshtatshëm për shkollat tona. Tani jemi të detyruar të ecim me programet e vjetra duke pasur shumë kujdes në zhvillimin e mësimeve të historisë, të pedagogjisë, të psikologjisë e të moralit, sepse në këto lëndë fare lehtë, mësues o profesorë me frymë të vjetër mund të çorientojnë të rinxjtë dhe t'i drejtojnë jo atje ku duam t'i çojmë ne, po në rrugën e kundërt. Hapja e konvikteve, gjë që është e domosdoshme, paraqit gjithashtu vështirësi të mëdha për konditat ekonomike dhe sidomos për mungesë të bazës materiale. Kemi vendosur të hapim katër konvikte ku duhet të shkojnë kryesisht bij fshatarësh, punëtorësh, bij të dëshmorëve dhe të luftëtarëve, fëmijë të varfër të popullit. Gjithashtu po përpinqemi që të dërgojmë të studjojnë jashtë në universitetë një numër studentësh. Këtu na pengon çështja financiare dhe marrëdhënjet financiare me vendet e tjera. Kemi kërkuar nga vendet miq të na pranojnë studentë me bursë.

Problemi i ushtrisë është natyrisht i rëndësishëm

dhe duhet që ta diskutojmë. Në situata të tilla ndërkom-bëtare, ku çdo gjë është e paqëndrueshme, ushtrinë duhet ta mbajmë në këmbë dhe ta kemi të fortë. Ushtria jonë operative arrin deri më..... Sikundërqë e shihni kjo ushtri është mjaft e madhe për vendin tonë dhe është e pamundur që ne të mbajmë për shumë kohë një efektiv kaq të madh në numër. Mbajtja për një kohë të gjatë e këtij efektivi jo vetëm që mund të na dëmtojë ekonomikisht, por mund të pengojë dhe forcimin e modernizimin e ushtrisë, pse ndjejmë mungesë të madhe në kuadro oficerësh për t'i edukuar këto masa. Prandaj na vihet përpëra çështja e riorganizimit të ushtrisë në pikëpamje efektivi dhe kuadrosht dhe në lidhje me këtë, preqatitja e bazave të mobilizimit dhe ajo e organikave të paqes. Tani ne sapo kemi filluar të rregullojmë çështjen e mobilizimit, pa të cilën në asnjë mënyrë nuk mund të proce-dojmë në çmobilizimin dhe mobilizimin e ri. Derisa ne të kemi organizuar çështjen e mobilizimit dhe të kemi preqatitur organikën e paqes dhe efektivat e kuadrot rezervë me armatimin e nevojshëm, ne mendojmë që divizonet që kemi, t'i përmbledhim në më pak divizione. Nga ata që ngelin, një pjesë ta çmobilizojmë, duke e inkadruar në kuadrot rezervë, një pjesë tjetër me ja dhënë Mbrojtjes¹ për të kompletuar efektivin e vet. Ushtarët e Mbrojtjes dhe ata të policisë do të janë efektivë me rrogë. Situata më vonë do të na mësojë se a duhet ta pakësojmë ushtrinë a jo. Prapavijat e ushtrisë janë mjaft të dobëta dhe organet tona megjithëse hasin

¹ Reparteve të Mbrojtjes, që kishin për detyrë shfarosjen e bandave të kriminelëve të luftës e të diversantëve.

mjaft pengesa, prapë nuk e kanë fituar eksperiencën e organizimit dhe të përgjegjësisë. Kjo shkakton që të gjendemi përpara situatave shumë të vështira, si për shembull kazermimi i ushtrisë dhe veshja e saj. Këtu jemi keq, për mos me thënë shumë keq. Ushtarët tanë akoma flenë jashtë ose detyrohemi të marrim masa jo të përshtatshme për kohën e sotme. Çështja e veshmbathjes së ushtrisë është një problem që duhet të zgjidhet në vend dhe ushtarit t'i sigurohen kurdoherë rrrobat dhe këpucët. Mos kujtojmë se entuziazmi mund të vazhdojë për jetë, po s'ditëm ta ushqejmë dhe ta mbajmë lart. Prandaj në këtë drejtim shokët e Partisë duhet të vënë të gjitha forcat dhe kujdesin pse këtej varen shumë gjëra. Një punë të madhe duhet të zhvillojmë në ngritjen e kuadrove të rinj dhe në edukimin e tyre. Këtu jemi mjaft prapa. Pa kuadro oficerësh të mësuar ne nuk mund të kemi një ushtri të rregullt dhe moderne. Nga partizanët e vjetër, një pjesë janë graduar, një pjesë kanë shkuar në pushtet, një pjesë do të çmobilizohen, pse s'mund të mbahen tërë jetën nën armë. Ata do të kalojnë në ushtrinë rezervë. Dhe kështu, ushtria jonë, do të përtërihet me datëlindje të reja me të cilat ne duhet të bëjmë një punë edukative të re, t'u futim në shpirt dashurinë për ushtrinë, t'i edukojmë si duhet. Kjo do të bëhet kur ne të arrijmë të kemi kuadrot e oficerëve të mirë dhe të mësuar se përndryshe ushtria jonë do të marrë formën e ushtrisë së Zogut, ku mbretëronte xhallëku. Konstatohet me kënaqësi se oficerët tanë të dalë nga lufta, që kemi dërguar për studime në Bashkimin Sovjetik, kanë një etje të madhe për mësim dhe shkojnë mirë në mësime. Kemi pra të bëjmë me një gjeneratë

oficerësh që i hapin ushtrisë një perspektivë shumë të mirë. Në këtë drejtim duhet të punojmë dhe në vendin tonë duke përmirësuar shkollat që kemi, kurset e ndryshme dhe të gjithë edukimin në ushtri. Kjo edukatë të mos jetë e përciptë, por serioze.

Në këtë situatë të jashtme dhe të brendshme, me këtë pushtet dhe me këtë program pune, Partia vihet përpara një prove të madhe që është ajo e zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese, për caktimin e formës së regjimit dhe të Statutit Themeltar të Shtetit. Zgjedhjet nuk janë një operacion i thjeshtë, këtu do të nijhet forca e Partisë, forca e saj udhëheqëse, këtu do të nijhet zotësia e çdo anëtar i Partisë. Në fushatën elektorale do të shoshiten vlerat e Partisë dhe kjo provë e madhe do të shërbejë për ndarjen e teserave¹. Të punojmë për zgjedhjet s'duhet të kuptojmë vetëm të bëjmë disa konferanca. Suksesi në zgjedhjet do të sigurohet me zbatimin e programit të punimeve, me ndërtimin e rrugëve dhe të shtëpive, me ndarjen mirë të misrit, të grurit, të kripës, të vajgurit, do të sigurohet me zbatimin si duhet të ligjit elektoral, me forcimin e pushtetit, me pjesëmarrjen e gjithë popullit në votime. Populli duhet të shohë konkretisht se njerëzit që çliruan atdheun nga okupatorët dhe tradhëtarët janë në gjendje të qeverisin, janë në gjendje të rindërtojnë vendin dhe të përmirësojnë jetën ekonomike dhe sociale të vendit. Nga fushata elektorale, shokët duhet të dalin me një eksperiencë të madhe,

¹ Është fjala për teserat e anëtarësisë në Parti, të cilat filuan të ndahen në vitin 1946 pas një revizionimi të përgjithshëm që u bë në Parti.

kjo të jetë një shkollë për ta dhe t'i armatosë për zgjidhjen e problemeve të tjera të mëdha që do të hasim përpara.

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

PËRSHËNDETJE NË KONGRESIN E PARË TË SINDIKATAVE

31 tetor 1945

Shokë e shoqe,

Delegatë të sindikatave shqiptare,

Unë e shokët e mi jemi shumë të prekur dhe shumë të gëzuar përdashurinë e madhe që tregoni ndaj qeverisë suaj, e cila sheh te ju shtyllën më të fortë të pushtetit popullor.

Kongresin tuaj e kam ndjekur me kujdesin më të madh dhe kam konstatuar se ju, si kurdoherë, jeni në lartësi të momentit që jeton populli shqiptar.

Si në kohët e vështira të luftës, ashtu edhe sot, ju po tregoheni udhëheqës dhe organizatorë të shquar, ashtu si u treguat trima dhe heronj në betejat më të përgjakshme.

Te ju, më tepër se te kushdo tjetër, dominon ndjenja e sakrificës, ndjenja e vetëmohimit, ndjenja përmbrrojtjen e interesave të përbashkëta të popullit. Dhe me ju, të pajisur me këto cilësi ne korrëm suksese, mposhtëm armikun okupator dhe krijuam një regjim të ri, regjinin

e popullit, regjimin e atyre që punojnë, regjimin tuaj. Me sakrifica të mëdha ju i bëtë ballë gjendjes, ju latë në shtëpi gratë, latë kalamajtë të vuanin për bukë, por nuk duruat armikun. Ju hodhët armët në krahë dhe shkuat në male; rrëth jush u organizua rezistenca dhe nga radhët tuaja dualën udhëheqësit dhe organizatorët e fitores së madhe. Dhe tani në luftë për mbrojtjen e demokracisë që ngritëm me kaq gjak, për rindërtimin e atdheut tonë të shtrenjtë, për përmirësimin e gjendjes sociale, ekonomike dhe kulturale të popullit, ju përsëri jeni në radhët e para, jeni pararoja.

Shokë! Kush më mirë nga ju e di se jeta është një luftë dhe një luftë e ashpër? Punëtorët shqiptarë të krahut dhe të mendjes që me qindra vjet kanë vuajtur nën robëri e mjerim e kuptojnë më mirë se kushdo tjetër se sa e shtrenjtë është liria, se sa e shtrenjtë është demokracia. Për atë ju derdhët gjakun, për atë ju po luftoni tani dita-ditës dhe lufta juaj po bëhet më e ndërgjegjshme, sepse ju keni kuptuar se puna e përditshme dhe sistematike do ta ngrëjë gjendjen e popullit tonë, do ta përmirësojë nga çdo pikëpamje.

Ne e dimë se sa vuajtje ka në popullin tonë, ne e dimë se një përqindje e madhe nga ju që jeni këtu keni shumë brenga në zemër dhe shumë familje nuk janë si duhet në gjendje ekonomike; shumë të tjera vuajnë për bukën e gojës. Këtë e dimë të gjithë, por përpara këtyre mjerimeve ne kemi vënë të gjitha energjitetona që t'i zhdukim dhe do t'i zhdukim. Ca njerëz flasin dhe derdhin lot krokodili gjoja për gjendjen tuaj të vajtueshme. Po cilët janë këta dhe pse e bëjnë këtë gjë? Këtyre s'u kamunguar kurrë buka, i kanë pasur dhe i kanë plot dolla-

pet e tyre dhe xhepat plot me të holla, po këtë gjë ata e bëjnë për të thyer unitetin e shëndoshë të Frontit tonë dhe kështu të peshkojnë më mirë në ujëra të turbullta. Paska edhe nga ata njerëz që ju therka zemra «për demokraci»! Dhe këta pretendojnë se këtu s'ka demokraci, s'ka liri. E kush janë këta njerëz? Janë mbeturinat e kalbura të regjimit të Zogut dhe të regjimeve të tjera, janë ata që na kishin lidhur duart e buzën dhe na kishin hedhur litarin në grykë, janë tamam ata që e urrejnë demokracinë.

Për të tillë njerëz dhe për veprat e tyre, po, nuk ka liri, por ka liri për njerëzit e ndershëm, për njerëzit që u dhimbset populli, që u dhimbset Shqipëria. Ne këto s'i kemi me fjalë, por i kemi me vepra, dhe me veprat do t'i mundim të gjithë ata që kërkojnë të dëmtojnë, që kërkojnë të minojnë që nga themel regjimin tonë. Dhe këtë gjë, ne jemi të sigurtë se do ta kryejmë, sepse rrëth pushtetit tonë është bashkuar i gjithë populli i ndershëm dhe punëtor, i cili ka ngritur lart flamurin e demokracisë. Prandaj, o shokë, forconi radhët në organizatën tuaj, forconi bashkimin rrëth Partisë suaj e në Frontin Demokratik. Kam bindjen më të plotë se me sakrificat, që janë të paevitueshme dhe me mundime, ne do të arrijmë në ditë të lulëzuara: këtë e dimë, prandaj i kemi marrë parasysh sakrificat dhe do të shkojmë përpëra.

Rrofshin punëtorët e krahut dhe të mendjes të Shqipërisë!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 261,
1 nëntor 1945*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 261,
1 nëntor 1945*

**PËRGJEGJE TELEGRAMIT TË KËSHILLIT
TË BASHKIMIT TË GRUAS ANTIFASHISTE
TË GJIROKASTRËS LIDHUR ME VËNJEN
E KANDIDATURËS SË TIJ PËR DEPUTET
NË QYTETIN E GJIROKASTRËS**

6 nëntor 1945

Mëma dhe motra të mia të Gjirokastrës, telegrami juaj më preku thellë, por me keqardhje më është e pamundur të mbush dëshirën tuaj, pse Komiteti Ekzekutiv i Frontit e gjeti me vend që unë të vë kandidaturën në kryeqytet.

Por në këto momente historike, me dashuri të madhe mendoj për qytetin tonë të dashur ku kam lindur dhe ku kam mësuar të dua popullin dhe të luftoj për të. Unë jam krejt i bindur se populli i Gjirokastrës, ashtu si u hodh i téri në luftë për çlirimin e atdheut. ashtu do të shkojë të votojë i téri për kandidatët e Frontit, për atë që luftuan për t'i siguruar atdheut fitoren dhe që do të luftojnë për t'i siguruar pavarësinë, demokracinë dhe lulëzimin.

Rroftë populli i Gjirokastrës!

**Gjeneral-Kolonel
Enver Hoxha**

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 265,*

6 nëntor 1945

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 265,*

6 nëntor 1945

**PËRGJEGJE AMBASADORIT POLONEZ NË
BEOGRAD NË LIDHJE ME NJOJJEN E
QEVERISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË
DHE VENDOSJEN E MARRËDHËNJEVE
DIPLOMATIKE**

7 nëntor 1945

Shkëlqesë,

Kam nderin t'Ju njoftoj marrjen e letrës të datës 4 nëntor 1945, me anën e së cilës Shkëlqesa Juaj patët mirësinë të më bënët të ditur se Qeveria e Republikës Poloneze ka njobur qeverinë shqiptare.

Si përgjegje nxitoj t'Ju bëj të ditur se Qeveria Demokratike e Shqipërisë mori shënim me kënaqësi të thellë për këtë hap miqësor të Qeverisë së Republikës Poloneze dhe do të jetë e lumtur të vendosë marrëdhënje diplomatike midis dy vendeve tonë, marrëdhënje të cilat do të kontribuojnë për së tepërtimi në zhvillimin e përforcimin e lidhjeve të miqësisë së përzemërt që i bashkon lumturisht të dy popujt tanë.

Ju lutem, Shkëlqesë, të keni mirësinë të bëheni pranë Qeverisë së Republikës Suaj interpret i falenderimeve më të nxehta dhe i mirënjoyjes së thellë të Qeve-

risë Demokratike të Shqipërisë për këtë dëshmi të shkëlqyer miqësie të singertë.

Duke ju falenderuar nxehësisht për këtë njoftim të pëlqyer, përfitoj nga rasti për t'i shprehur Shkëlqesës Suaj sigurimet e konsideratës sime të lartë.

Kryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 266,
7 nëntor 1945*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 266,
7 nëntor 1945*

**LETËR KRYETARIT TË MISIONIT USHTARAK
SOVJETIK NË TIRANË NË LIDHJE ME NJOHIJEN
E QEVERISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË DHE
VENDOSJEN E MARRËDHËNJEVE DIPLOMATIKE**

10 nëntor 1945

Zoti kolonel,

Me një gëzim të thellë mora sot notën Tuaj, me anën e së cilës patët mirësinë të më bëni të ditur se Qeveria e Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike ka marrë vendimin të njohë Qeverinë Demokratike të Shqipërisë dhe të vendosë marrëdhënie diplomatike me të.

Jam shumë i lumtur dhe gëzohem në mënyrë të veçantë që po bëhem në këtë çast interpreti besnik i kënaqësisë dhe i mirënjohjes së thellë që populli dhe Qeveria Demokratike e Shqipërisë kanë ndjerë nga ky gjest miqësor i qeverisë Suaj, të cilin e konsiderojnë si një provë të re dhe të shkëlqyer miqësie të singertë ndaj popullit shqiptar.

Qeveria Demokratike e Shqipërisë është gjithashtu posaçërisht e prekur nga ky vlerësim i lartë, që në këtë rast qeveria Juaj pati mirësinë t'i bëjë kontributit të popullit shqiptar për dërmimin e invaduesve gjermanë

dhe italianë, si edhe veprës së paqes dhe rindërtimit të brendshëm.

Duke ju lutur që të bëheni pranë qeverisë Suaj interpret i këtyre ndjenjave, nxitoj t'Ju komunikoj, zoti kolonel, se Qeveria Demokratike e Shqipërisë do të jetë e lumtur të vendosë marrëdhënje diplomatike me qeverinë sovjetike, marrëdhënje që do të kenë si pasojë jo vetëm të zhvillojnë dhe të përforcojnë edhe më tepër lidhjet e miqësisë të sinqertë që bashkojnë aq lumturisht të dy vendet tonë, por edhe ta bëjnë këtë miqësi një faktor të gjallë në lëmin e paqes dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar, me të cilët popujt tanë janë aq ngushtësisht të lidhur.

Pranoni, zoti kolonel, sigurimet e konsideratës sime më të lartë.

Kryeministri
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 270,
11 nëntor 1945*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 270,
11 nëntor 1945*

PËRGJEGJE NOTËS SË KRYETARIT TË MISIONIT
USHTARAK BRITANIK NË SHQIPËRI NË LIDHJE
ME NJOHJEN E QEVERISË DEMOKRATIKE TË
SHQIPËRISË NGA QEVERIA E BRITANISË
SË MADHE

11 nëntor 1945

Zoti gjeneral,

Kam nderin t'i përgjigjем notës së zotrisë Suaj me datë 10 nëntor 1945 duke ju lutur të keni mirësinë t'i transmetoni qeverisë Suaj sa vijon:

Me kënaqësi të madhe muarëm notën për vendimin që ka marrë qeveria britanike t'i akordojë njojje Qeverisë sonë Demokratike¹ dhe që është gati të këmbejë përfaqësuesit diplomatikë në rast se qeveria jonë e sigu-

¹ Është fjala për përbledhjen e një note të Qeverisë së Britanisë së Madhe, paraqitur Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare Gjeneral-Kolonel Enver Hoxhës nga kryetari i misionit ushtarak britanik në Shqipëri Gjeneral Brigade Hoxhson më 10 nëntor 1945. Ky njoftim për të vendosur marrëdhënje diplomatike të rregullta qe vetëm një manevr politike, sepse në të vërtetë ata nuk vendosën marrëdhënje diplomatike me Shqipërinë.

ron qeverinë Tuaj se, zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese, që do të bëhen për së shpejti, do të jenë të lira dhe të fshehta, shtypi do të jetë i lirë dhe do të lejohen korrespondentët e huaj të hyjnë në Shqipëri për të parë zhvillimin e zgjedhjeve.

Qeveria Demokratike e Shqipërisë, besnikë e parimeve demokratike për mbrojtjen dhe vendosjen e të cilave populli ynë derdhi kaq gjak e bëri kaq sakrifica gjatë luftës së përbashkët kundër fashizmit, me gjithë forcat e saja i ka mbrojtur dhe do t'i mbrojë këto parime që janë të konsakruara në ligje nga mbledhjet përfaqësuese të popullit shqiptar.

Ligjet tona demokratike u kanë siguruar njerëzve të Shqipërisë të gjitha të drejtat dhe liritë që mund të gëzojë njeriu në vendin më demokratik dhe qeveria jonë është garancia më e sigurtë për t'i mbrojtur dhe për t'i vënë në zbatim këto liri e të drejta.

Ligji për zgjedhjet e Asamblesë Kushtetuese, ligj nga më demokratikët, ka parashikuar dhe u ka siguruar të gjitha të drejtat, individëve ose grupeve jofashiste dhe qeveria jonë duke u mbështetur dhe duke i zbatuar përpikërisht këto ligje, u dha mundësinë të gjithëve, individë ose grup, të marrin pjesë direkt në këtë eveniment historik të vendit tonë duke zgjedhur dhe duke u zgjedhur. Asnjë grup ose individ jofashist nuk ekziston në Shqipëri që të mos gëzojë këto të drejta. Fshehtësia dhe liria e votës do të observohet me rigorozitetin më të madh. Liria e shtypit ka qenë dhe do të jetë një nga parimet themeltare të demokracisë sonë.

Qeveria jonë Demokratike nuk ka penguar hyrjen e korrespondentëve të huaj në Shqipëri, përkundrazi, me

kënaqësi ka pranuar çdo kërkesë të tyre dhe u ka dhënë atyre të gjitha mundësitë dhe lehtësitë për të vizituar vendin tonë. Ardhja e tyre me rastin e zgjedhjeve do të jetë një kënaqësi për ne pse ata do të shohin «de visu»¹ se me sa skrupolozitet mbrohen parimet e demokracisë në vendin tonë.

Duke e siguruar qeverinë Tuaj përsa më sipër, ne kemi bindje se ajo do të vendosë marrëdhënje diplomatike me Qeverinë Demokratike të Shqipërisë dhe kështu do të forcohet miqësia që ekziston në mes të popujve tanë dhe do të njihen më mirë sakrificat e mëdha të popullit shqiptar, i cili pa rezerva dha kontributin e tij të çmueshëm në luftën kundër fashizmit, për mbrojtjen e njerëzimit dhe të pavarësisë së tij dhe që është kurdoherë në radhë të parë për të mbrojtur paqen, si dhe pavarësinë dhe integritetin tokësor të vendit të tij.

**Kryeministri i Shqipërisë
Gjeneral-Kolonel**

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 274,
17 nëntor 1945*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 274,
17 nëntor 1945*

¹ me sy.

PËRGJEGJE NOTES SË KRYETARIT TË MISIONIT AMERIKAN NË TIRANË NË LIDHJE ME NJOHJEN E QEVERISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË NGA QEVERIA E SHBA

17 nëntor 1945

I nderuari zotri,

Kam nderin t'i përgjigjем notës së zotrisë Suaj që më drejtuat më datë 11 nëntor 1945 në lidhje me njojjen e Qeverisë Demokratike të Shqipërisë¹ dhe ju lutem të keni mirësinë t'i transmetoni qeverisë Suaj sa vijon:

Qeveria Demokratike e Shqipërisë, e bazuar në parimet demokratike, të cilat mbledhjet përfaqësuese të popullit i kanë konsakruar në ligje, i ka mbrojtur dhe do t'i mbrojë këto parime me gjithë-forcat e saja pse këto janë të lidhura ngushtë me ekzistencën e vet.

¹ Është fjala për njoftimin për vendosjen e marrëdhënjeve diplomatike midis SHBA dhe Shqipërisë, që i paraqiti më 12 nëntor 1945 shefi i misionit të SHBA në Shqipëri H.T.Fulc, Kryetarit të Qeverisë Demokratike të Shqipërisë Gjeneral-Kolonel Enver Hoxhës.

Ky njoftim i Qeverisë së SHBA, ashtu sikurse edhe ai i Qeverisë së Britanisë së Madhe që vetëm një manevër politike.

Ligjet tona demokratike u kanë siguruar njerëzve të Shqipërisë të gjitha liritë dhe të drejtat që mund të gëzojë një njeri në vendin më demokratik. Ligji për zgjedhjen e Asamblesë Kushtetuese, ligj nga më demokratikët, ka parashikuar dhe u ka siguruar të gjitha liritë dhe të drejtat individëve ose grupeve antifashiste dhe qeveria jonë duke u mbështetur dhe duke i zbatuar përpikërisht këto ligje u dha mundësinë të gjithëve, individë ose grup, të marrin pjesë direkt në këtë eveniment historik të vendit tonë duke zgjedhur dhe duke u zgjedhur. Fshehtësia dhe liria e votës do të observohet me rigorozitetin më të madh. Liria e shtypit ka qenë dhe do të jetë një nga parimet themelitore të demokracisë sonë.

Qeveria jonë që nuk ka penguar kurrë hyrjen në vendin tonë të korrespondentëve të huaj, por që kurdoherë ka pranuar kërkesat e tyre dhe u ka dhënë të gjitha lehtësitë, me kënaqësi do të vazhdojë t'i lejojë të vijnë të shohin zhvillimin e zgjedhjeve dhe të konstatojnë «de visu» se sa me skrupolozitet respektohen ligjet tona demokratike dhe se qeveria jonë është garancia më e sigurtë për t'i mbrojtur dhe për t'i vënë në zbatim këto ligje.

Përsa u përket traktateve ose marrëveshjeve që mund të jenë lidhur në mes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Shqipërisë para datës 7 prill 1939, i referohemi letrës që ju kemi drejtar më 13 nëntor 1945 me anën e së cilës ju kërkojmë të na dërgoni kopjet e instrumenteve të këtyre traktateve ose marrëveshjeve për të shikuar brendinë e tyre, meqenëse shumica e arkivës së Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë është

djegur ose grabitur nga okupatorët. Por ne shpresojmë se kjo nuk do të sjellë asnje vonesë në vendosjen e marrëdhënjeve diplomatike, kështu që qeveria jonë të marrë shpejt në shqyrtim të gjitha marrëveshjet që mund të ekzistojnë në mes dy vendeve tona.

Duke pasur si themel të shëndoshë parimet demokratike, duke i mbrojtur dhe duke i zbatuar përpikërisht me të gjitha forcat e veta, qeveria jonë shpreson se Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës do të vendosë sa më parë marrëdhënje diplomatike me qeverinë tonë, marrëdhënje që do të forcojnë miqësinë që ekziston në mes të dy popujve tanë. Populli shqiptar, që pa rezerva dha gjithë ç'kishte për kauzën e përbashkët me aleatët, këtë të drejtë e ka fituar me gjakun e tij që derdhi gjatë luftës së përbashkët për liri e demokraci. Ju sigurojmë gjithashtu se populli shqiptar, ashtu si ka qenë i pari në luftë, është dhe do të jetë kurdoherë në radhë të parë për të mbrojtur paqen, indipendencën dhe integritetin tokësor të vendit të tij.

Kryeministri i Shqipërisë
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 274,
17 nëntor 1945*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 274,
17 nëntor 1945*

FJALA NË MITINGUN E ORGANIZUAR NË KRYEQYTET ME RASTIN E PËRVJETORIT TË PARË TË ÇLIRIMIT TË TIRANËS

17 nëntor 1945

Popull i Tiranës dhe i gjithë Shqipërisë,

Si sot një mot, Ushtria heroike Nacional-Çlirimtare çlroi Tiranën. 19 ditë luftë të ashpër, rrugë më rrugë dhe shtëpi më shtëpi, në llogore dhe në barrikada lufthan si luanë bijtë e popullit. Shumë nga ata ranë në fushën e nderit që të rrojë Shqipëria. Ushtria jonë fitimtare dhe populli heroik i Tiranës shkruan me gjakun e tyre më të mirë, faqen e fundit dhe nga më të shkëlqyerat e epopesë së madhe të çlirimit. Në Tiranë, ku filloi dhe u organizua rezistenca e madhe që ngriti në këmbë gjithë Shqipërinë, në Tiranë ku qëndronte shtabi madhor i okupatorit dhe i kuislingëve dhe ku patriotët me ashpërsi të paprerë goditnin armikun dhe hyzmeqarët e tij, këtu në Tiranë u kurorëzuan me lavdi mundimet, vuajtjet, sakrificat e popullit tonë martir, të popullit tonë heroik, që kurrë s'u përkul përpëra forcës dhe barbarizmës së okupatorit dhe të kuislingëve, po me kryet lart ndoqi rrugën e nderit, rrugën e popujve për-

parimtarë, që e çoi në fitoren e lirisë, në fitoren e pavarësisë së vendit dhe në vendosjen e një demokracie të shëndoshë. Këto fitore të shkëlqyera janë rezultati i luftës së ashpër dhe të gjatë që bëri populli shqiptar kundër dy okupatorëve dhe tradhëtarëve, luftë e pabarabartë po vendimtare për kombin tonë. Kjo luftë u fitua pse ishte një luftë popullore, pse populli i kërcënuar për vdekje në ekzistencën e tij, me besim të patundur në forcat e veta, u bë i zoti i vetes dhe i vendit, marshoi përpara me flamurin e revolucionit populor, marshoi pa u ndrojtur, i zhveshur dhe i uritur, po zemërlart, marshoi përpara për të çliruar atdheun dhe për të vendosur ligjet e drejta të tij. Dhe populli e mori fuqinë në dorë. Rroftë populli shqiptar!

Dita e çlirimit të Tiranës shënon gjithashtu në historinë e luftës dhe të përpjekjeve të popullit tonë fillimin e një periudhe të re po aq të lavdishme sa e para. Fillon lufta e dytë për konsolidimin e fitores, për forcimin e pushtetit të popullit, fillon vepra e madhe e rindërtimit. Patjetër ai popull që ishte i zoti t'ju rezistonte valëve të tërbuara të fashizmit dhe të fitonte luftën, është i zoti të vëré rregull dhe të ndërtojë shtëpinë e tij. Sa keq u gabuan, të gabuarit e përhershëm, kur thonin se lufta e çlirimit është një sakrificë e kotë, se populli shqiptar është i lindur të rrojë nën hijen e tjetrit dhe të qeverisët e të administrohet nga të huajt; sa keq u gabuan po këta njerëz, kur, pas çlirimit të vendit, pa vënë mend nga e shkuara, përpara atdheut të rrënuar po luanin rolin e sehirxhiut dhe me buzëqeshje murmurisnin: «S'do ta ketë të gjatë kjo punë!» Mëndjemëdhënje pa tru po u del boja, se forca e popullit

është e pathyeshme, se forca e popullit është krijuese.

Gati një mot po kalon që nga dita e çlirimtë të plotë të Shqipërisë dhe populli shqiptar u tregoi miqve dhe armiqve se ai është i zoti të vetëqeveriset dhe të bëjë hapa të mëdha drejt përparimit. Në ç'vend është parë më mirë se në Shqipëri, vend i vogël dhe i rrënuar nga lufta, ku rron një popull i varfër dhe i plagosur rëndë nga okupatori, të arrihen rezultate kaq të shënuara në lëmin social, ekonomik dhe kultural? Është derdhur djersë, janë bërë sakrifica të mëdha nga ana e popullit, po kanë dalë vepra që vetëm një popull si yni, plot gjallëri, plot vullnet dhe vetëmohim, i ndergjegjshëm për detyrën e madhe që i ngarkon historia mund t'i kryejë në një kohë kaq të shkurtër dhe me mjete kaq të varfëra.

Pse vallë u arriten këto rezultate dhe pse shkohet me vrull të madh drejt përmirësimit të gjendjes së brendshme dhe të jashtme? Arësyja është së populli shqiptar është i bashkuar si një trup dhe i vendosur qind për qind të shfarosë çdo mbeturinë të keqe të së kaluarës, të ndërtojë një jetë të re plot dinjitet dhe të mbrojë me mish e me shpirt regjimin demokratik, për të cilin u vra dhe u copëtua. Populli ynë e ka kuptuar mirë se ç'donin të thonin njerëzit që e shtypnin dhe i pinin gjakun kur pretendonin: «Me shqiptarët s'bëhet punë, kurrë dy shqiptarë s'janë në një mendje!» Qëllimi i tyre ishte ta mbanin popullin të përçarë, në grindje me njëri-tjetrin për ta sunduar më mirë. Po populli ua tregoi këtyre në luftë se sa i vendosur dhe i bashkuar ishte për t'i fshirë një herë e përgjithmonë ngajeta e vendit të tij, populli ua tregoi sot se ai bashkim që u mbrujt me gjak po forcohet dita-ditës për mbarëvajtjen e kombit. Populli

i provoi, mjerisht duke paguar shtrenjtë, regjimet dhe njerëzit e kalbur, pseudopatriotët me njëzet flamurë në xhep që i thonin fjalë të mëdha, por që nga ana tjetër i pregetitnin varrin. I njohu njerëzit e kafeneve, duaxhinjtë e çdo regjimi, pseudodemokratët, që gjoja kanë qenë në kundërshtim me regjimet e mëparshme, por kur ka ardhur koha të provohen, s'kanë bërë tjetër përveçse t'u shërbënин regjimeve që shtypnin popullin. I pajisur me këtë eksperiencë të madhe, që i kushtoi kaq shumë, populli ynë nuk gënjetet më. Për këtë të jenë të bindur armiqjtë e popullit, dallaveraxhinjtë dhe politikanët aventurierë, spekulatorët dhe të shiturit; të jenë të sigurtë edhe për një gjë tjetër: se forca e madhe e popullit do t'i shfarosë që të lulëzojë Shqipëria. Populli ynë që ka fuqinë në dorë di edhe ta mbajë. Për këtë arësy ai po i vë gjithë forcën e vet pushtetit popullor, se ai është i veti, se ai vetë është pushteti.

Pushteti i popullit u dha zgjidhje të kënaqshme shumë problemeve të mëdha, që kurrë ndonjë regjim as nuk do t'i përfillte; ai ndërtoi vepra që do të shkruhen në historinë e vendit tonë. Një katundar nga Rrogozhina thoshte: «Kur u hodh ura në erë, qava me lot dhe thashë se do të shkojnë vjet që të rindërtohet. Sido që punova vetë për rindërtimin e saj, nuk e kuptoj dot si u bë kjo mrekulli». Katundarët e Shqipërisë me entuziazëm brohoritën reformën agrare. Në fushën e Myzeqesë ata e kanë ndarë tokën. Shumë shpejt do t'u jepen tapitë. Këto punime dhe këto reforma të mëdha që u realizuan dhe të tjerat që do të vijnë pas, janë vetëm rezultatet e një regjimi, ku populli është në fuqi, ku masat kryesore të popullit e kanë pushtetin në dorë me të gjitha

mjetet e tij. Kjo gjë ngjet në vendin tonë. Ka njerëz që u therin sytë nga ky realitet; ka njerëz që lëshojnë vrer. Zaten këta s'kanë punë tjetër, veçse të kritikojnë. Këtyre zotërinjve ne u themi se ka të meta dhe ka gabime, po këto janë të vogla përpëra sukseseve të mëdha të arritura. Është më mirë të punosh dhe të gabosh, nganjëherë, se sa të lidhësh duart e të bësh sehir. Vendi do punë, do lodhje, do mundime, se në punë njihen njerëzit që e duan popullin, fjalët e tyre i merr era, kurse veprat tona ngelin. Dhe me vepra ne i dhámë të kuptoja botës së përparuar dhe mike, se populli shqiptar meriton të jetë krah për krah me kombet e bashkuara, me popujt antifashistë, me të cilët luftoi heroikisht për të njëjtin ideal, për liri, për pavarësi dhe për demokraci...

Po populli kishte kapërcyer pengesa më të vështira. Ai me besim të patundur rreth qeverisë së tij, rreth Frontit Demokratik shkonte me hapa të sigurta në punën e tij ndërtimitare. Kjo ngjiste se popullit s'i ishte fshehur kurrë realiteti, por i ishte folur haptazi. I është thënë se pengesat do të jenë të mëdha në realizimin e planit tonë, se do të ketë momente të vështira, po do të kapërcehen...

...Bashkimi Sovjetik, miku dhe aleati ynë i madh dhe i gjithë popujve të vegjël, ai që me luftën e tij titanike u bë faktori më kryesor i thyerjes së fashizmit, njoju përpjekjet e popullit tonë, sakrificat e tija, veprën ndërtimitare të Qeverisë Demokratike të Shqipërisë. Nota e qeverisë sovjetike që i jepte sihariqin e madh dhe të merituar popullit shqiptar, u prit në gjithë Shqipërinë me një gëzim dhe me një entuziazëm të papërshkrueshëm. Populli shqiptar, në kulmin e gëzimit, u drejton popujve kreshnikë të Bashkimit Sovjetik, aleatë besnikë

dhe të fuqishëm të popullit tonë të vogël, i drejton udhëheqësit të tyre të madh, Gjeneralisimit Stalin, mi-rënjojen e tij pa kufi dhe i siguron ata se Shqipëria do të jetë kurdoherë në radhë të parë për mbrojtjen e paqes dhe të demokracisë...

Qeveria e Republikës së Polonisë njoihu qeverinë tonë. Me popullin heroik të Polonisë na lidhin vuajtjet, na lidh lufta dhe sakrificat e përbashkëta dhe ne do ta ruajmë dhe do ta forcojmë miqësinë në mes të popullit trim të Polonisë dhe popullit tonë...

Popull shqiptar dhe popull i Tiranës,

Po jetojmë në momente me një rëndësi të madhe historike për vendin tonë. Jemi në prakun e zgjedhjeve të përgjithshme për Asamblenë Kushtetuese që do të vendosë formën e regjimit dhe do të bëjë Statutin Themeltar të Shtetit. Me anën e votës së lirë, të fshehtë, direkte dhe të përgjithshme, populli ynë për herë të parë në historinë e tij do të votojë për njerëzit që ai dëshiron, për njerëzit që e kanë mbrojtur dhe do ta mbrojnë, për njerëzit që do ta udhëheqin në rrugën e begatisë.

Këto zgjedhje kanë një rëndësi të jashtzakonshme jo vetëm për qëllimin e tyre të madh, por edhe sepse në këto zgjedhje do të marrin pjesë, përveç masave të gjera të popullit edhe gratë e gjithë Shqipërisë, mëmat, motrat tona heroike që qëndruan të patundura në ballin e luftës së çlirimit, që treguan me punë, me luftë dhe me sakrifica, se ato janë të zonjat të marrin pjesë në çdo manifestim politik dhe social të vendit. Do të marrë pjesë në këto zgjedhje për herë të parë në historinë e

vendit tonë Ushtria Kombëtare, mburoja e çelniktë e atdheut, farkëtuesja e ditëve të lumtura të vendit tonë, ajo që u mbulua me lavdi në fushat e betejës, ajo që është mbrojtësja e pafjetur e interesave të popullit, e indipendencës dhe e integritetit tokësor të vendit tonë.

Ligji i zgjedhjeve, i votuar nga Këshilli Antifashist i Shqipërisë, u siguron të gjithëve, përveç atyre që tradhëtuan vendin, të drejtën të zgjedhin dhë të zgjidhen. Ligji i zgjedhjeve tona është nga më demokratikët dhe përveç sharlatanëve s'ka kush t'i bëjë as kritikën më të vogël.

Fronti Demokratik doli përpara popullit shqiptar me kandidatët dhe me programin e vet. Në Frontin Demokratik grumbullohen elementët më të vendosur dhe më përparimtarë të vendit tonë, ata që u dhimbset populli dhe atdheu dhe që janë sakrifikuar për të. Në Frontin tonë janë grumbulluar masat e gjera të popullit, të cilat në ballë të programit të tyre kanë mbrojtjen e indipendencës dhe të integritetit tokësor të vendit, mbrojtjen e pushtetit popullor dhe të të drejtave demokratike. Fronti ynë ka në program përmirësimin e jetës së popullit tonë dhe përparimin e vendit dhe do të mobilizojmë të gjitha forcat që ky program të realizohet.

Fronti Demokratik duhet të preqatitet me seriozitetin më të madh për këto zgjedhje, të cilat do të jenë vendimtare për vendin tonë, pse ashtu si e udhëhoqi me sukses popullin në kohën e luftës, Fronti Demokratik duhet ta udhëheqë me sukses edhe në kohën e paqes. Fronti duhet të mobilizojë gjithë forcat e tija që të sigurojë qind për qind fitoren; këtë e lyp interesit i

atdheut, këtë e kanë lënë amanet dëshmorët e luftës, bijtë dhe bijat e Shqipërisë që ranë në fusha e në male, në fshatra e në qytete. Fitorja e Frontit do të jetë fitorja e popullit dhe njëkohësisht shuplaka më e rëndë për ata që mohuan atdheun dhe për mbeturinat e tyre që përpiken të ngrenë krye dhe të mëkëmbin regjimet antipopullore. Fitorja e Frontit do të jetë një shuplakë për ata pseudodemokratë dhe hipokritë që fshehin një shpirt të zi e që mundohen me njëmijë dredhira e fjalëboshe të mashtrojnë një rrëth të ngushtë ose ndonjë individ të izoluar. Po këta njerëz do ta shohin, ditën e votimit, se sa ju vlen lëkura dhe sa kredi kanë në popull. Fronti Demokratik me një të shkuar të lavdishme dhe qeveria kanë korrur suksese në të gjitha lëmët e aktivitetit, dalin përpara popullit të tyre ballëhapët dhe me program të qartë. Populli shqiptar është i bindur, se i ka parë në luftë dhe në punë, se Fronti Demokratik dhe qeveria, ato që thonë i zbatojnë me përpikmëri dhe me drejtësinë më të madhe; ato që premtojnë i realizojnë. Populli shqiptar sheh në Frontin dhe te kandidatët e tij organizatën politike dhe njerëzit më të besuar dhe më të dashur të tij, besnikë gjer në vdekje dhe luftëtarë të palodhur për të mirën e tij. Prandaj kemi besim të plotë se populli do të shkojë i téri në kutitë e votimeve dhe dita e 2 Dhjetorit do të bëhet festa më e madhe, ku populli, sovran i fateve të tij, do të manifestojë lirisht vullnetin e tij.

Përpara kutisë së votimit i gjithë populli duhet të kujtojë të shkuarën e zezë të vendit tonë, të kujtojë regjimin shtypës dhe grabitës të Ahmet Zogut dhe të votojë i téri për Frontin Demokratik, që do t'i sigurojë

regjimin republikan, regjimin e popullit dhe nuk do të lejojë kurrë të përsëritet e shkuara.

Përpara kutisë së votimit, i gjithë populli duhet të kujtojë 7 prillin, të kujtojë robërinë e rëndë të okupatorit, të kujtojë urinë, torturat, burgimet, vrasjet në masë nga ana e okupatorëve dhe e tradhëtarëve dhe i gjithë të votojë për Frontin, i cili nuk do të lejojë kurrë që të përsëriten ato kohëra të llahtarës.

Përpara kutisë së votimit, i gjithë populli duhet të kujtojë me nderim sakrificat e mëdha të atyre mijëra martirëve që ranë në fushën e nderit për lirinë e Shqipërisë dhe për sigurimin e demokracisë; të kujtojë vuajtjet e tyre, të kujtojë fshatrat e djegura dhe të zhuritura nga zjarri i okupatorit dhe i gjithë të votojë për Frontin nën flamurin e të cilit ranë heronjtë e kombit dhe nën flamurin e të cilit do të ndërtohet Shqipëria e re.

Popull shqiptar,

Fatin e vendit e ke vetë në duart e tua, tregoje edhe njëherë, sikundërqë e tregove në kohën e luftës, se ti je jo vetëm i zoti për heroizma dhe qëndresa të çuditshme, po je i zoti edhe të krijosh dhe të organizosh një jetë të lumtur, një jetë të lulëzuar.

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë populli i Tiranës!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 275,
18 nëntor 1945*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Bashkimi», Nr. 275,
18 nëntor 1945*

**LETËR DREJTUAR KRYETARIT TË MISIONIT
AMERIKAN NË SHQIPERI LIDHUR ME RISHIKIMIN
E TRAKTATEVE TË PËRFUNDUARA NGA QEVERIA
E ZOGUT ME QEVERINË E SHBA**

23 nëntor 1945

I nderuar zotri,

Kam nderin t'i përgjigjем letrës së zotrisë Suaj të datës 17 nëntor 1945 dhe ju lutem të keni mirësinë t'i transmetoni qeverisë Suaj sa vijon:

Në lidhje me modifikimet që i bëni notës që na drejtuat me datën 11 nëntor 1945 përsa i përket pikës ku bëhet fjalë për traktatet¹, kam nderin të përcaktoj pikëpamjen e qeverisë sime mbi këtë çështje.

Qeveria Demokratike e Shqipërisë është kurdoherë e dispozuar të veprojë mbi çështjet e traktateve që ka lidhur Shqipëria me shtetet e tjera brenda vendimit që ka marrë Kongresi i përfaqësuesve të popullit në Përmet më 24 Maj 1944, i cili shprehet si më poshtë: «Të rishi-

¹ Është fjalë për marrëveshjet dhe traktatet që Qeveria e SHBA kishte lidhur me qeverinë e A. Zogut përpara 7 prillit të vitit 1939.

kohen të gjitha marrëveshjet me shtetet e huaja; lidhjet ekonomike dhe politike që janë bërë nga qeveria e Zogut në dëm të popullit shqiptar, të prishen dhe të bëhen marrëveshje të reja». Ne kujtojmë se një gjë e tillë është në përputhje të plotë me ligjet ndërkombëtare dhe me rrethanat e krijuara pas kësaj lufte të përbotshme antifashiste. Nga ana tjetër ne shpresojmë që kjo çështje të mos bëhet një vonesë për shkëmbimin e marrëdhënjeve diplomatike në mes vendeve tonë, marrëdhënje që do të shpejtojnë përsëtepërmë rishqyrtimin e traktateve që mund të ekzistojnë në mes të Shteteve të Bashkuara dhe të Shqipërisë.

Kryeministri i Shqipërisë
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin e Minis-
trisë së Punëve të Jashtme
të RPSH*

FJALIM MBAJTUR NË FSHATIN GORE TË LUSH-NJËS ME RASTIN E DHËNJES SË TAPIVE TË TOKAVE BUJQVE TË MYZEQESE

25 nëntor 1945

Të dashur shokë fshatarë,

Gëzimin që ndjejmë ne sot, të gjithë së bashku këtu, e ndjen edhe i tërë populli i Shqipërisë, pse sot në këtë ditë mbyllët një herë e mirë një faqe e zezë dhe e trish-tuar, plot vuajtje e mjerime, plot gjak e lot, një faqe e historisë së përpjekjeve shekullore të fshatarësisë përtokë dhe çelet një faqe e re e lumtur dhe e shkëlqyer e historisë së popullit tonë, një faqe, ku dita-ditës shkru-hen fitore.

Shekuj me radhë populli ynë, dhe veçanërisht ju, o fshatarë, keni hequr të zezat e ullirit. Mbi kurrizin tonë shkelnin çizmet e gjakosura të sundimtarëve gjakatarë të huaj, të bejlerëve feudalë, që kurrë nuk na lanë të gëzonim pak liri, kurrë nuk na lanë të ngrinim krye. Ata ishin shushunjat që na pinin gjakun. Por, me gjithë këto mjerime, populli ynë qëndroi i patundur dhe ushqente urrejtjen më të madhe kundër tyre. Ju, o shokë fshatarë, kurrë s'keni pushuar së luftuari për

t'ja arritur kësaj dite të madhe. Jeni ngritur me pushkë në dorë dhe në lëvizje të përgjakura keni djegur kullat dhe pallatet e bejlerëve feudalë që ju shtypnin, por, mjerisht, lëvizjet tuaja dështuan, pse ato nuk udhëhiqeshin nga njerëz të denjë, të dalë nga gjiri juaj plot plagë. Bejlerët feudalë i mbytën në gjak përpjekjet tuaja. Nën regjimin tiranik të Zogut binin në fushën e nderit bijtë e Myzeqesë si Hekuran Maneku¹, por kurrë ato lëvizje nuk mund të triumfonin, sepse s'ishin lëvizje masash, lëvizje të gjithë popullit. Megjithëse në këto lëvizje kishte disa patriotë, prapë në to futnin hundët njerëz si Qemal Vrioni me shokë, që kurrë s'u shkonte ndër mend të luftonin për çlirim e popullit nga zgjedha, por, përkundrazi, ta gënjenin dhe ta shtypnin edhe më shumë.

Por kohërat ndryshuan. Urrejtja e gjithë popullit tonë, dhe juaja veçanërisht, kundër atyre që na skllavëruan dhe na shtypën u rrit dita-ditës dhe një ditë të gjithë u ngritëm në këmbë me armë në dorë për të fituar lirinë, për të fituar të drejtat tona. Ne u ngritëm kundër fashizmit dhe kundër tradhëtarëve me besim të madh se do të fitonim. Ne s'kishim armë, ne s'kishim bukë, as veshje dhe as këpucë në këmbë, por kishim zemrën prej çeliku dhe fituam. Luftuam dhe fituam. Luftuam dhe fituam, se ata që udhëhiqnin popullin nuk ishin më feudalët, si Vrionasit dhe Vërlacët, por ishin djemtë e popullit, të dalë nga gjiri i popullit, nga vuajtjet e tij.

¹ Hekuran Maneku (aspirant nga Skrapari) pjesëmarrës i kryengritjes së Fierit të 1935-s kundër regjimit të Zogut. Mbas dështimit të kryengritjes u kap nga forcat zogiste dhe mbas torturash shtazarake u var.

Djemtë e Myzeqesë martire këtë herë me besim të patundur në udhëheqësit e tyre luftonin si petritë në majat e mbuluara me borë të maleve të Korçës e të Skraparit. Kësaj radhe fshatarët e Shqipërisë të zhveshur e të zbatur dinin përse luftonin dhe ishin të sığurtë se do të fitonin. Dhe kjo ditë është rezultati i përpjekjeve tona. U vramë e u premë, por ja arritëm kësaj dite të madhe që katundari të marrë tokën, të merrni tokën tuaj, o katundarë, ku gjyshërit dhe stërgjyshërit tuaj lanë koskat. Kjo tokë është vetëm juaja dhe ajo do të mbetet për jetë juaja.

Shokë të mi fshatarë,

Ju e dini mirë se me sa sakrifica e fituam luftën. E fituam luftën, pse ishim me të drejtën, pse kjo luftë ishte popullore dhe pse u bashkuam të gjithë si një trup kundër armikut të jashtëm dhe kundër tradhëtarëve shqiptarë, që kurdoherë ishin bërë vegla e të huajit. Bashkimi na nxori në selamet. Pra edhe tani, të bashkuar më fort se kurrë, le të ecim përpara, të shtërngojmë radhët tona, që të forcohet pushteti i popullit, që të ruhen fitoret që na kushtuan kaq gjak. Pushteti i ri është pushteti i popullit, është pushteti juaj. Pushteti demokratik është në duar të forta dhe atë do ta mbrojmë gjer në vdekje. Ka akoma njerëz si në fshatra, ashtu edhe në qytete që pëshpëritin parulla helmatuese si për shembull: «Reforma agrare nuk aplikohet dot», «Qeveria nuk njihet nga aleatët» etj. Po punët tona të qarta bëjnë që këto parulla ta kenë jetën të shkurtër, bëjnë që këto parulla të bien njëra pas tjetrës si shpresat e atyre që i

pëshpëritin e që humbasin fare kreditinë edhe në ata të mjerët që rrinë e i dëgjojnë pallavrat e tyre. Por ne s'kemi aspak frikë nga këta krimba, pse ne s'kemi pasur frikë nga të tjerë njerëz dhe në të tjera rrrethana shumë më të vështira. Ne jemi të fortë, pse populli dhe qeveria janë një dhe ecin të pandarë në rrugën e tyre të drejtë.

Shokë fshatarë, mbani kurdoherë sytë hapët dhe grushtin të rëndë për armiqtë e popullit. Ju duhet të dini, si bukën që hani, se fati juaj është i lidhur ngushtë me fatin e këtij pushteti. Rrëzimi i këtij pushteti do të ishte skllavërim për popullin tonë.

Shokë fshatarë,

Detyra juaj është të punoni më së miri tokën që ju e muarët, ta punoni anembanë për të mirën tuaj, për begatinë e familjes suaj, për të mirën e gjithë popullit shqiptar. Por detyra juaj s'mbetet me kaq. Ju duhet të merrni pjesë me gjithë forcat tuaja në gjithë veprimtarinë e shtetit tonë, ju duhet të arrini të bëheni një nga faktorët më kryesorë për zhvillimin social, ekonomik dhe kultural të vendit tonë. Pa ndihmën dhe pjesëmarrjen tuaj të gjallë në çdo punë, nuk mund të shkojnë punët mbarë në Shqipëri. Prandaj duhet të merrni pjesë aktivișt në këtë pushtet i cili është në tërë kuptimin e fjalës, i juaji. Këshillat duhet të jenë në duart tuaja, në duart e njerëzve tuaj më të mirë e më besnikë. Në këshillat të zgjidhen njërezit që e duan popullin dhe mbrojnë interesat e popullit; atje të sjellim njerëz të ndershëm dhe të punës. Vetëm kështu, duke marrë pjesë aktive

në jetën politike, duke u ndriçuar dita-ditës, Shqipëria do të shohë ditë shumë të lumtura.

Tani po bëhen zgjedhjet. Ju e kuptioni mirë rëndësinë e tyre, pse këto zgjedhje do të forcojnë themellet e shtetit tonë, që e ngritëm me kaq vuajtje. Në këto zgjedhje, që të gjithë, gra e burra, të shkoni e të votoni dhe të votoni për njerëzit e Frontit, se të votosh për Frontin, do të thotë të votosh për të mirën e popullit, për të mirën tuaj. Unë e di për kë rreh zemra juaj, unë e di se më 2 Dhjetor do të bëhet festa më e madhe dhe me votën tuaj do t'i thoni gjithë botës se ne luftuam me flamurin e Frontit dhe ne do të marshojmë kurdoherë përpara me flamurin e Frontit.

Shokë fshatarë,

Ndarja e tokës filloi. Filluan të ndahen tapitë dhe dita-ditës do të shihni përmirësime dhe ndihma nga qeveria juaj. Qeveria nuk ju premton qiejt, por të jeni të sigurtë se ajo ka vënë gjithë forcat për të përmirësuar gjendjen tuaj. Ato që themi ne, i mbajmë. Unë dhe shokët e mi të qeverisë ju urojmë nga zemra për tokën që morët. Rrofshi dhe e trashëgofshi brez pas brezi.

Rrofshin fshatarët e Shqipërisë!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 282,
26 nëntor 1945*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 282,
26 nëntor 1945*

**MESAZH DREJTUAR POPULLIT SHQIPTAR, ME
ANE TË RADIOS, ME RASTIN E 33-VJETORIT TË
SHPALLJES SË PAVARËSISË**

28 Nëntor 1945

Popull shqiptar,

Tridhjetë e tre vjet kanë kaluar që kur u ngrit për herë të parë flamuri në Vlorë, që nga ajo ditë e shënuar kur populli ynë i dha botës të kuptojë se ishim një komb i pavdekur dhe që donim të rronim të lirë dhe të pavarur në tokën që na kishin lënë të parët tanë.

Që prej asaj kohe, dita e 28 Nëntorit është bërë datë e shënuar për popullin tonë, pse ajo përfaqëson realizimet e përpjekjeve të panumërtë, të luftëtarëve heroikë të popullit tonë gjatë historisë për pavarësi. Në vigjiljen e çdo 28 Nëntori rrahin zemrat e kalamajve të shkollave fillore, rrahin zemrat e të rinjve, rrahin zemrat e burrave e të pleqve të thinjur të Shqipërisë, rrahin zemrat e grave shqiptare, pse 28 Nëntori, përveç kuptimit të madh që ka për popullin tonë është i lidhur ngushtë me tërë historinë e trishtuar të vendit tonë gjatë këtyre tridhjetë e tre vjetve. Sa ditë, sa vjet mjerimi kanë kaluar mbi popullin shqiptar: tradhëtira, vuajtje, uri,

tortura, regjime tiranike, okupacioni i huaj, kanë rën-
duar mbi supet e popullit tonë të vogël. Po në mes të
këtyre valëve të tërbuara, ku atdheu kërkonte të gjente
rrugën e shpëtimit, dita e 28 Nëntorit bëhej dita e
shenjtë, ku populli përmblidhte energjitet e tij, merrte
zemër dhe shembull nga e kaluara, shikonte në sy
realitetin. Më 28 Nëntor shfrehej dufi i një populli
të tërë kundër regjimit shtypës të Zogut. Më 28
Nëntor, në kohën më të zezë që kaloi vendi ynë nën
thundrën e okupatorit, shpërthenin demostratat e po-
pullit, në qytete dhe në fshatra gjakoseshin patriotë
shqiptarë me agjentët e OVRA-s dhe të Gestapos, me
xhandarët dhe tradhëtarët dhe në këto përpjekje të përg-
jakshme, flamuri i Vlorës, ngrihej lart dhe bëhej shenja
e kushtrimit, shenja e bashkimit të patriotëve për luftën
e çlirimit. Me flamurin kuq e zi në gjji, marshonin kryen-
gritësit e Rilindjes, me flamurin kuq e zi marshuan për-
para partizanët shqiptarë, që shkruan me gjakun e tyre
të kulluar epopenë e madhe të çlirimit të kohës së sotme.

Pesë vjet me radhë nën robërinë e rëndë të fashis-
tëve italianë e gjermanë dhe të shërbëtorëve të tyre po-
pulli ynë kurrë s'u përkul përpara terrorist dhe forcës së
armatosur, po me rezistencën e tij, me luftën e tij të
ashpër dhe të paprerë, u bë shembull për popujt e tjerë
të Evropës, u bë shembull heroizmi, sakrfice dhe një-
kohësish organizimi. Në këto pesë vjet e ca përpjekje
mbinjerëzore populli ynë vuajti pa masë, u dogj, u tor-
turua dhe shumë nga bijtë e tij më të mirë u burgosën,
u pushkatuan dhe u vranë, po besimi në fitoren ishte i
patundur. Ai e kuptoi se duhej luftuar me ashpërsinë
më të madhe për të shporrur sunduesin dhe për të thyer

zinxhirët që i kishin hedhur bejlerët feudalë dhe politikanët aventurierë. Kishte ardhur koha të shpërthente urrejtja dhe hakmarrja që ishte grumbulluar në zemrën e popullit kundër atyre që i kishin pirë gjakun dhe që e kishin bërë çiflik Shqipërinë. Kishte ardhur dita që populli të merrte fatet e veta në duart e tij. Dhe këtij qëllimi ja arriti nëpërmes të Luftës legjendare nacional-çlirimtare, nëpërmes kryengritjes popullore.

Popullit tonë i ka dalë nami, me plot të drejtë, se është një popull trim; por bota përparimtare, gjatë kësaj lufte antifashiste pa edhe diçka tjetër me shumë rëndësi te populli ynë. Ajo pa se populli shqiptar është i zoti të bëjë gjëra të mëdhë, të organizohet, të vetëqeveriset. Në momentet më të vështira të kryengritjes së armatosur, u organizua Ushtria Kombëtare, ushtria e fuqishme e popullit, që u mbulua me lavdi në fushat e luftës dhe tani ajo është bërë objekt adhurimi dhe dashurie nga ana e popullit. Gjatë kryengritjes së armatosur, u rrëzua pushteti i urryer i vjetër dhe mbi gërmadhat e tij u ngrit pushteti i ri i popullit, që ditë gjatë luftës si edhe tanigjatë paqes të korrë suksese të shkëlqyera. Gjatë kryengritjes së armatosur u organizua Fronti Nacional-Çlirimtar (sot Fronti Demokratik) që me politikën e tij të drejtë udhëhoqi popullin drejt fitores dhe tani po e udhëheq atë drejt fitoreve të reja.

Në prakun e fitores, Shqipëria jonë ishte në gjendje të vajtueshme, shkatërrimet ishin të mëdha, krahinave të tëra u kanosej uria, po besimi dhe vullneti i popullit tonë ishte i lartë dhe ai u bëri ballë të gjitha vështirësive. Asnjë nuk vdiq për bukë se solidariteti i madh i popullit në kohën e mjerimit, me sakrificat e tij të patreguara,

ishte shembullor; pushteti demokratik i popullit, me organizimin e tij, dha prova të shkëlqyera në çdo lëmë të aktivitetit shoqëror dhe ekonomik; ai me fakte dhe me vepra të pavdekshme çarmatosi dhe skeptikët më të mëdhenj. Ligjet, vendimet, zbatimi i tyre, politika e drejtë e pushtetit tonë, i rrëzuan përdhe dhe i demaskuan përgjithmonë poshtërsitë, manevrat e tradhëtarëve të atdheut, i demaskuan dhe i izoluan nga populli mbeturinat e fashizmit, që në kohën e mjerimit dhe njëkohësisht të rimëkëmbjes dhe të rindërtimit të atdheut, vazhdonin punën e tyre helmatuese. Triumfoi drejtësia e popullit, u ngritën vlerat morale dhe materiale të tij, u realizuan aspiratat e dëshmorëve tanë të vjetër e të rinj. Shqipëria që ka vuajtur kaq shumë po ecën në rrugën e përparimit dhe të begatisë. Të drejtat e popullit tonë të vogël, po me një shpirt të madh, nuk u shkelën. Shqipëria u mbulua me lavdi; kryelartë hyri në radhën e kombeve antifashiste me të cilët ajo derdhi gjakun krah për krah. Njohja e qeverisë sonë nga shtetet miq dhe aleatë ishte një e drejtë që ne e meritonim plotësisht, pse me prova kemi qenë dhe jemi besnikë dhe luftëtarë të papërkultur të aleancës së madhe antifashiste, të mbrojtjes së paqes dhe të demokracisë.

Popull shqiptar,

Themelet e shtetit tonë demokratik, që u vaditën me gjakun e bijve më të mirë të Shqipërisë, duhet t'i forcojmë; duhet të përjetësojmë lirinë, pavarësinë, demokracinë në vendin tonë. Pa këto kombi ynë është i dënuar të shuhet. Po kjo nuk do të ngjajë kurrë, se fatet

e Shqipërisë së re janë në duart e popullit shqiptar. Dhe populli shqiptar me 2 Dhjetor do të zgjedhë përfaqësuesit e tij për në Asamblenë Kushtetuese. Kjo do të jetë një provë tjetër e shkëlqyer që do të tregojë se populli shqiptar, që diti të luftojë aq trimërisht, di edhe të vendosë për fatin e tij. Populli shqiptar, i téri si një blok, do të shkojë në votimet dhe do të votojë për njerëzit më të dashur, më të drejtë, më të besuar të tij, për ata njerëz që e udhëhoqën në fitoren e madhe të çlirimt, për ata njerëz që do ta udhëheqin drejt rrugës së përparimit.

Popull shqiptar,

Në kohërat më të vështira që kalonte atdheu, njerëzit që mendonin për popullin dhe vdisnin për popullin, kishin të qartë një gjë: për t'i bërë ballë rrebeshit të madh që kish pllakosur vendin tonë, duhej të realizohej bashkimi i gjithë popullit shqiptar. Në një bashkim të shëndoshë e të çelniktë qëndronte kyçi i fitores. Fronti i lavdëshëm Nacional-Çlirimtar i Shqipërisë u bë tribuna e këtij bashkimi dhe u bë faktori i madh i fitores. Tradhëtarët e «Ballit Kombëtar» e të «Legalitetit», kuislingët e ndryshëm bënë çmundën që vëllavrasja të arrinte kulmin dhe të përjetësohej sundimi i çizmes gjermane dhe italiane. Ata dogjën Shqipërinë, ata vranë patriotët, ata muarën më qafë disa njerëz të thjeshtë të popullit të cilët, të gënjiyer, lanë koskat për një kauzë që s'ishte e tyre. Mbi këta tradhëtarë bie mallkimi i gjithë popullit tonë, mbi këta tradhëtarë ra dhe do të bjerë e pamëshirshme shpata e drejtësisë së popullit tonë.

Fronti Demokratik dhe Qeveria Demokratike e

Shqipërisë, kurdoherë i qëndron besnik idesë së bashkimit. Me bashkimin e çelniktë të popullit u arrit fitorja, me bashkimin e shëndoshë të popullit u arritën këto rezultate të mëdha. Brenda një kohe të shkurtër dhe me bashkimin e plotë dhe të shëndoshë do të shkojë Shqipëria me hapa të mëdha drejt lulëzimit. Të frymëzuar me një ideal të tillë, Kryesia e Këshillit Antifashist, me propozimin e Qeverisë Demokratike, me rastin e ditës së madhe të 28 Nëntorit shpalli faljen dhe uljen e dënimive për të dënuarit si kriminelë lufte dhe armiq të popullit e të tjerë, prej gjykatës speciale dhe gjykatave ushtarake. Nga kjo falje do të përfitojnë të gjithë ata që janë penduar për veprat që kanë kryer në dëm të popullit dhe që japid shpresa përmirësimi. Ky gjest i madh i popullit tonë t'u shërbejë atyre si një mësim, të shohin mirë të shkuarën e tyre të njollosur, të kuptojnë katastrofën që i shkaktuan atdheut dhe të ndërrojnë rrugën e gabuar që kishin zënë. Populli ynë goditi dhe do të godasë me drejtësinë dhe me ashpërsinë më të madhe të gjithë ata tradhëtarë dhe armiq të popullit që kërkojnë të pengojnë vrullin e tij të madh përparimtar. Por populli shqiptar do të ketë edhe mëshirë për ata që pendohen dhe përmirësohen, për mëmat, gratë e kalamajtë e tyre të pafajshëm.

Popull shqiptar,

Dita e 28 Nëntorit të bëhet dita ku çdo shqiptar të analizojë ndërgjegjen e tij, të peshojë shërbimet që i ka bërë popullit dhe atdheut dhe me bindje të plotë të thotë: «Nuk janë kurrë të mjaftha shërbimet e mia, por duhet

të vë të gjithë forcat e mia, zemrën time, shpirtin tim në shërbim të popullit që të rrojë dhe të lulëzojë Shqipëria». Në këtë ditë përvjetori të forcojmë bashkimin, të forcojmë dashurinë për njëri-tjetrin, të derdhim djersë e mëndim për interesin e Shqipërisë; këtë e kërkon interesi i kombit. Në këtë ditë të përvjetorit, të ngremë zemrat lart dhe të mendojmë me respekt e dashuri për ata që u vranë, për ata që u sakrifikuani, për dëshmorët e kombit që ranë në fushën e nderit duke brohoritur: RROFTË SHQIPËRIA!

Për të nderuar kujtimin e dëshmorëve që ranë për atdheun, ftoj të gjithë të ngrihemë në këmbë dhe të mbajmë një minutë heshtje për nderin e tyre.

LAVDI TË PËRJETSHME DËSHMORËVE TË KOMBIT!

RROFTË FLAMURI KOMBËTAR!

RROFTË SHQIPËRIA E RE DEMOKRATIKE!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 284,
28 nëntor 1945*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 284,
28 nëntor 1945*

FJALA E MBAJTUR NË NJË KONFERENCË SHTYPI, ORGANIZUAR NË TIRANË PËR GAZETARET E HUAJ

3 dhjetor 1945

Ju falemnderit që erdhët të asistoni në këto ditë tē shënuara për popullin shqiptar.

Dëshira jonë ka qenë që korrespondentë tē huaj tē vijnë dhe tē konstatojnë vetë se ç'është bërë këtu me luftën heroike tē popullit shqiptar. Ne dëshirojmë dhe besojmë që ju do ta sqaroni opinionin e përbotshëm përsa ngjet te ne dhe ju lutem tē jeni objektivë, tē mos shtonit as tē pakësoni mbi sa keni parë këtu. Vendi ynë është një vend i vogël, po ka një histori tē madhe me tē cilën mburremi. Populli ynë është një popull i vogël, por ka një shpirt tē madh. Ai ka luftuar shekuj me radhë kundër çdo okupatori, për tē mbrojtur lirinë dhe pavarësinë e tij. Ai ka luftuar gjithnjë për liri e për demokraci, po kohërat ishin tē ndryshme atëherë dhe, me gjithë gjakun që derdhte, nuk mund tē përmbushe-shin dëshirat e tij. Me gjithë mjerimet e mëdha që ka pasur ky popull, karakteristika e tij e veçantë është ajo që ai nuk u përkul kurrë. Dhe përpara kësaj tragjedie tē madhe që përshkoi botën, populli shqiptar diti tē mbajë anën e së drejtës. Ai u ngrit kundër fashizmit, se

ai pa te fashizmi armikun e tij më të madh, i ndjeu konsekuent më parë nga të gjithë popujt e Evropës dhe më parë nga të gjithë mori armët dhe luftoi. Gjendja ndërkontaktore ish akoma e errët kur ne u okupuam, por populli ynë nuk e humbi shpresën. Që në prill 1939 ai filloi demonstratat dhe grevat kundër okupatorit.

Lufta jonë, përvetë që ishte një luftë e shenjtë, ishte edhe e pabarabartë. Ne ishim pa armë dhe të deziluzionuar se regjimi i Zogut e kishte shtypur popullin. Por populli e mori veten përnjëherë dhe nëpërmjet grevash, demonstratash dhe aksionesh në qytete, organizoi rezistencën e tij që u lidh me luftën e aleatëve të mëdhenj kundër të njëjtët armik. Besimi ynë ishte i madh, se, si aleatët tanë dhe ne ishim në një rrugë të drejtë dhe ishim të sigurtë se do të fitonim. Mjerimi dhe vuajtjet e popullit tonë ishin të mëdha. Çetët tona s'kishin armë, ishin të zhveshura, rrinin ditë të tëra pa bukë, po s'kalonte ditë që këto të mos e goditnin armikun. Në fillim ishim të izoluar, s'kishim ndihmë, se aleatët s'kishin mundësi të na ndihmonin, meqë të gjitha komunikacionet ishin të prera; po ne kishim bindje se këto ndihma nuk do të mungonin dhe dita-ditës lufta jonë merrte një hov më të madh. Vendi ynë i shkatërruar, fshatrat e djegura, shtëpitë e rrënuara, vrasjet në masë, gjaku i derdhur nga partizanët tanë, tregojnë kontributin që dha populli ynë për kauzën e përbashkët. Juve mund t'ju ketë qëlluar rasti të keni parë me sytë tuaj provat e kësaj përpjekjeje të madhe të popullit tonë të vogël. Oficerët sovjetikë, anglezë, amerikanë dhe jugosllavë që kanë qenë këtu dhe kanë parë përpjekjet tona, le të dëshmojnë si kemi luftuar ne pa kompromis dhe gjer në fund kundër fashiz-

mit. Oficerët aleatë kanë parë me sytë e tyre sa ka vuajtur e si ka luftuar populli ynë.

Populli ynë i hyri kësaj lufte të madhe për të shporrur okupatorin, për t'i dhënë kontributin e tij të vogël kauzës antifashiste dhe njëkohësisht për të vendosur në vendin e tij demokracinë. Ne kemi bindje se detyrën e përm bushëm.

Vendi ynë ishte një vend ku intrigat ishin të mëdha nga ana e atyre shteteve që donin ta skllavëronin e që përkëtë gjë ndihmoheshin nga klikat tradhëtare të vendit.

Kjo luftë i sqaroi pozitat. Ata që deshën lirinë dhe demokracinë luftuan me mish e me shpirt për këtë ditë. Kjo vepër që shohim sot është vepra e gjithë patriotëve shqiptarë, të grumbulluar në Frontin Demokratik, është vepra e të gjithë popullit shqiptar që s'kurseu gjë, po u dogj e u gjakos dhe ngriti lart flamurin e demokracisë. Sot ne shohim qartë, se populli shqiptar luftoi se e kish kuptuar që duhesh të siguronte një jetë më të lumtur. Këtë ai e tregoi dje në luftë, po e tregon edhe tani në paqe, me veprën e madhe të rindërtimit, e cila tregon se populli ynë ka një vitalitet të madh dhe është një popull që shkon përpara. Gjithë parazitët që e pengojnë në rrugën e tij ai i zhduk me luftë e me përpjekje.

Në këtë luftë populli ynë pa qartë se cilët ishin ata shtete që luftuan për lirinë e tyre, për lirinë e njerëzimit dhe njëkohësisht na ndihmuan neve.

Populli ynë bëri në motmot gjithshka për të zhdukur shkatërrimet e mëdha që la okupatori dhe për të përmirësuar gjendjen e tij ekonomike.

Mund të ketë këtu, midis jush, njerëz që e kanë

ndjekur historinë e tridhjetë e tre vjetve të kaluar. Është e tepërt t'ju them se ç'ndryshim dhe ç'shpejtësi na kanë karakterizuar ne, në punë, në këto kohët e fundit. Në motmot punë u ndreqën rrugët, urat, centralet e elektrikut, uzinat, dhe u bënë të gjitha këto se vullneti ishte i madh, se populli e kishte marrë fatin e tij në dorë. Unë mendoj se këto gjëra që u bënë në vendin tonë brenda një moti, bëhen vetëm në ato vende ku ka demokraci dhe ku pushteti është në duart e popullit.

Pushteti ynë bëri reformën agrare, e cila ishte ëndrra shekullore e katundarëve tanë. Katundari ynë ka vuajtur me shekuj për bukën e gojës, se shumica e tokës ishte në duart e dhjetë vetëve, që kanë qenë kurdoherë në radhën e parë të tradhëtisë dhe që kanë luajtur me fatin e atdheut dhe të bujqve shqiptarë.

Në lëmin e kulturës janë bërë përparime të mëdha, bile edhe në zonat më të prapambetura. Dëshira për arësim ka qenë e madhe. Janë hapur 400 shkolla më tepër se në kohën e Zogut. Në këto shkolla fëmijëve u mësohet jo vetëm si ta duan atdheun, po dhe se atdheu shkon përpara, kur ata mësojnë mirë.

Në lëmin politik lëvizja jonë edhe në momentet më të këqia është përpjekur të grumbullojë gjithë popullin në një front të përbashkët. Thirrjet e Frontit kanë qenë të pareshtura dhe ai ka arritur rezultate të shkëlqyera. Përveç një pakice, të gjithë e panë rrugën e drejtë, të gjithë e përqafuan politikën e Frontit, si në luftën pa kompromis kundër fašizmit, ashtu dhe në rindërtimin e vendit. Populli shqiptar, pa sa e drejtë ishte politika e Frontit kundrejt aleatëve të mëdhenj. Fronti dhe populli luftuan ashpër gjithë ata që, të bashkuar me okupatorët

fashistë, s'linin gjë pa thënë kundër aleatëve tanë. Dhe sot akoma ky popull po lufton kundër mbeturinave fashiste. Prova më e madhe për këtë ishte dita e 2 Dhjetorit. Populli ynë shkoi me një shumicë dërmuese të votojë për Frontin, për njerëzit që e udhëhoqën në luftë dhe te të cilët ai ka besim se do ta udhëheqin në lulëzimin e atdheut. Sipas rezultateve të para që kemi, rreth 90% e zgjedhësve kanë votuar dhe afro 93% e tyre votuan për Frontin.

Ju e patë vetë si u bënë këto votime, sa lirisht dhe me sa qetësi të madhe u zhvilluan ato. Ata që pretendonin se këtu s'ka liri, se zgjedhjet do të bëhen me dhunë, se votat do të falsifikoheshin dhe se votimet do të bëhen me presion e terror, u demaskuan dhe u dolën në shesh gjenjeshat e tyre, ashtu siç u kanë dalë edhe më përpara.

Në Shqipërinë e re as ka pasur, as ka, as do të ketë terror e shtërngim, se ne jemi kundër këtyre. Regjimi ynë është një regjim nga më demokratikët, nga më të përparuarit dhe ligjet tona, që dihen botërisht, janë model ligjesh të një demokracie të përparuar. Të drejtat e njeriut në vendin tonë janë të konsakruara me ligj. Të gjithë kanë të drejtën e fjalës, të mbledhjeve dhe të besimit. Prona private respektohet. Çdo gjë këtu bëhet me ligje dhe mbrohet nga ligji. Ata që thonë të kundërtën, gjenjejnë dhe shpifin. Në Shqipërinë e re po ngrihet një jetë e re për gjithë demokratët e ndershëm, për gjithë ata që punojnë drejt. Këtu s'kanë vend as fashistët, as profashistët, që përpilen dhe kërkojnë të sjellin kohën e vjetër.

Eshtë pëshpëritur se këtu s'ka liri mbledhjeje, se

opozita s'ka të drejtë të flasë, të grumbullohet, të nxjerrë gazetë, etj. Njerëzve, që kishin kredi e besim në popull, as ligjet, as pushteti dhe askush tjetër s'ua kishin ndaluar këtë të drejtë. Në qoftë se ka njeri që thotë se s'kanë pasur kohë t'i ushtrojnë këto të drejta, kjo nuk është e vërtetë, sepse këto të drejta janë shpallur qysh një vit përpara. Dhe, që atëhere e gjer më sot, qeverisë nuk i është bërë asnjë kërkesë në këtë drejtim. Për çështjen e zgjedhjeve ata patën dy muaj kohë. Po puna është se ata s'kanë as më të voglën kredi në popull; se ata kanë luftuar kundër popullit dhe, për këtë, nuk guxojnë të dalin në skenë. Këtë e tregojnë qartë rezultatet e zgjedhjeve. Populli shqiptar ka vendosur me plot bindje të shkojë përpara. Fjalëboshe të tillë nuk e ndalojnë punën e tij të drejtë e përparimitare. Megjithatë pushteti ynë kurri nuk do të qëndrojë indiferent, por do të përpinqet t'i bëjë ta shohin edhe ata sa e qartë është këtu puna. Ai do të mundohet t'i sjellë në rrugën e drejtë. Pushteti ka dhënë kurdoherë prova për këtë gjë. Përveç thirrjeve për bashkim, përveç amnistisë ditën e hyrjes në Tiranë, ai bëri prapë falje më 28 Nëntor. Kjo tregon shpirtin e madh të popullit tonë, i cili di të mbrojë vendin dhe të drejtat e fituara, po ka edhe mëshirë për njerëzit e mashtruar që njojin fajet e tyre.

Punën tonë e kanë çmuar gjithë ata që duan të mirën e demokracisë dhe të vendit tonë. Mua më duket se vendi ynë, që ka luftuar kaq shumë, është ndihmuar më pak se të tjerët. Jo vetëm ato që kërkojmë, s'na vijnë të gjitha, po edhe kur na vijnë, mbërrinë me vonesë të madhe. Shembull është çështja e automjeteve. Në vendet e tjera janë dërguar me dhjetëra mijë automobila,

kurse këtu na kanë ardhur vetëm 60 kamjona. Po ne besojmë se kërkesat tona dë të merren parasysh dhe gjendja do të ndryshojë.

Populli ynë ka marrë ndihma nga Bashkimi Sovjetik dhe i është shumë mirënjohës. Vendi ynë, tepër i rrënuar, ka nevojë që këto ndihma të jenë të vazhdueshme. Kjo do të jetë vepër humanitare dhe solidariteti kundrejt popullit tonë, që ka qëndruar vjete të tëra besnik i luftës antifashiste dhe do të qëndrojë po ashtu edhe për paqen.

Ka edhe gjëra të tjera ku aleatët duhet ta tregojnë me fakte miqësinë kundrejt nesh. Kjo është njohja e qeverisë. Gëzim i madh qe për popullin shqiptar, kur Bashkimi Sovjetik njuhу qeverinë tonë. Edhe Jugosllavia Federative njuhу qeverinë tonë. Kjo ka qenë një ditë e shënuar për ne, pse vinte nga një popull me të cilin jemi njuhur që në ditët e para të luftës. Popujt e Jugosllavisë na nderojnë dhe na duan. Edhe ne gjithashtu i nderojmë dhe i duam.

Disa më kanë pyetur mbi marrëdhënjet tona me Jugosllavinë. Këto marrëdhënje janë miqësore dhe të sinqerta si me gjithë aleatët. Ne kemi bindje, se një miqësi e tillë është në të mirën e përgjithshme dhe në të mirën e paqes në Ballkan, prandaj populli shqiptar do ta ruajë këtë miqësi. Me popujt e tjerë ne jemi miq, si bie fjala me popullin bullgar. Për të, për trimërinë e tij, populli ynë ka pasur kurdoherë simpati dhe jemi të lumtur kur shohim që sot ai ecën në udhën e drejtë të demokracisë. Me popullin grek kemi luftuar së bashku kundër fashizmit dhe dëshirojmë të kemi relacione të mira me të. Mirëpo në lidhje me vendin tonë shumë

gjëra të papëlqyera ndodhin sot në Greqi. Qeveritarët e Athinës dhe monarko-fashistët kërkojnë si e si të turbullojnë ujërat, të bëjnë kërkesa pa vend, që nuk shërbejnë veçse të prishin marrëdhënjet që duhet të ishin miqësore pas kësaj lufte. Ata kërkojnë Shqipërinë e Jugut, kërkojnë atdheun tonë, kërkojnë të diskutohet çështja e Shqipërisë. Po ne e kemi thënë edhe herë tjetër, se nuk pranojmë të diskutohet çështja e Shqipërisë së Jugut, ose e tërësisë tokësore të atdheut tonë. Ne duam të rrojmë të qetë. Po ata që ngrenë çësh-tje të tilla duan të prishin qetësinë. Ne do ta mbrojmë vendin. Kjo është e thjeshtë dhe e qartë.

Në lidhje me minoritetin. Ndryshe sillen në Greqi kundrejt minoritetit tonë atje, ndryshe sillemi ne kundrejt minoritetit grek në Shqipëri, i cili gjëzon të gjitha liritë.

Ne këtu kemi bindjen se me minoritetin jemi sjellë si jo më mirë. Minoritetit grek ne i kemi dhënë të gjitha liritë, shkollat, gjuhën, të drejtën e pjesëmarrjes në ushtri dhe në pushtet. Asnjë shtypje nuk bëhet nga ne. Përkundrazi ne i japim mundësinë të zhvillohet. Çështjen e shkëmbimit të tij ne s'e shtrojmë. Minoritetin grek që luftoi me ne dhe derdhi gjak për një qëllim, që i dhamë të gjitha të drejtat e liritë, që i dhamë tokën me anën e reformës agrare, nuk e zbojmë. Ne e konsiderojmë atë si pjesë të popullit tonë. Përkundrazi, minoriteti ynë në Greqi ka pësuar të gjitha të zezat. Grekët masakruan minoritarët shqiptarë, i vranë dhe i shnderuan, u muarën tokën, shtëpitë e të tjera. Ata sot ndodhen këtu dhe ne i ndihmojmë që të mos vdesin urie. Ata kanë kërkuar dhe kërkojnë t'u kthejnë tokat dhe pasuritë

e tyre. Neve na duket se kjo është e drejtë dhe këtë duhet që autoritetet aleate ta shikojnë. Ata i kanë drejtuar një letër të hapët zotit Mak Nijl¹, po kjo nuk i ra në dorë.

Ne kërkojmë që gjithë ato të drejta që u janë dhënë popujve të tjerë që luftuan fashizmin, t'i jepen edhe popullit tonë, se i meriton. Ne që luftuam dhe u shkakruam kërkojmë me të drejtë reparacione nga Italia dhe Gjermania. Kemi kërkuar të marrim pjesë në konferencat e Kombeve të Bashkuara. Ministri ynë fuqiplotë në Beograd shkoi në Paris dhe ne shpresojmë se aleatët do ta pranojnë. Kërkojmë të pranohemi në Komisionin Interaleat të Kontrollit, për Italinë, se ajo i ka shkaktuar vendit tonë dëmet më të mëdha.

Kërkojmë mbi të gjitha të marrim pjesë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, se kjo është një e drejtë që e fituam me gjak, se ne e luftuam fashizmin krah për krah me aleatët dhe do të qëndrojmë besnikë gjer në fund për mbrojtjen e paqes. Ne kemi besim se ata do të na i pranojnë këto kërkesa.

Nuk kam se ç'tju them gjë tjetër, veçse në popullin e vogël shqiptar, aleatët e mëdhenj duhet të shohin një popull me shpirt e ndjenja me të vërtetë demokratike. Populli ynë dhe qeveria e tij do të vënë të gjitha fuqitë

¹ Është fjala për letrën e hapur që Komiteti Antifashist Çam i dërgoi më 22 nëntor 1945 nënministrit të punëve të jashtme të Britanisë së Madhe Mak Nijl, që ndodhej atë kohë në Greqi, nëpërmjet kryetarit të misionit ushtarak britanik në Shqipëri, gjeneralit Hoxhson. Letra u botua në gazeten «Bashki mi» Nr. 279, datë 23 nëntor 1945.

për të forcuar miqësinë dhe besojmë se aleatët tanë, Bashkimi Sovjetik, Anglia dhe Shtetet e Bashkuara nuk do të na e kursejnë ndihmën e tyre.

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 288,
4 dhjetor 1945*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 288,
4 dhjetor 1945*

D E K L A R A T E

SHEFIT TË INFORMATAVE TË RADIO SOFJES NË LIDHJE ME NJOHJEN E QEVERISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË NGA QEVERIA E BULLGARISË

20 dhjetor 1945

Pas rifillimit të marrëdhënjeve diplomatike, lidhjet midis Bullgarisë dhe Shqipërisë do të bëhen dita-ditës më konkrete dhe më miqësore, sepse ne e shohim dhe e dimë se ç'përfaqëson populli bullgar. Ai kurdoherë ka qenë një përkrahës për lëvizjet përparimtare të kohës së Rilindjes të vendit tonë. Në Bullgari shoqëritë tona të vjetra kurdoherë janë pritur mirë e në mënyrë miqësore nga populli bullgar. Prej andej, nga shtypshkronja jonë e parë, e themeluar në Sofje, na erdhën shumë libra të botuara në gjuhën shqipe.

Populli shqiptar e di se populli bullgar është demokrat dhe me gjithë okupacionin gjerman, dhe me gjithë politikën e Borisit III, populli juaj i mbeti besnik demokracisë. Sidomos këtë e tregoi, kur u ngrit së fundi i tëri kundër fashizmit. Ne e shohim dhe e kuptojmë rrugën e popullit bullgar, sepse ajo është e qartë dhe një faktor përparimi për Siujdhesën Ballkanike. Prej kësaj vjen vetëvetiu simpatia e madhe e popullit shqiptar që

ka pasur dhe që do të ketë kurdoherë për popullin bullgar. Nga ana e tij populli shqiptar do të bëjë ç'të jetë e mundur që marrëdhënjet midis të dy popujve të bëhen më të ngushta dhe më të përzemërta.

Kur të vijë në Tiranë ministri fuqipotë i Bullgarisë do të forcohen marrëdhënjet tonë miqësore dhe lidhjet ekonomike-kulturale midis dy vendeve.

Populli shqiptar priti me gëzim njohjen e qeverisë shqiptare nga ajo e Bullgarisë. Ky është një shembull i gjallë për forcimin e miqësisë dhe për lehtësimin sa më të madh të marrëdhënjeve midis të dy vendeve.

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 302,
20 dhjetor 1945*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 302,
20 dhjetor 1945*

**KËRKESË DREJTUAR KOMISIONIT PREGATITOR
TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR PRANIMIN E
SHQIPËRISË NË OKB**

20 dhjetor 1945

**SHKËLQESËS SË TIJ ZOTIT EDUARD R. STETINIUS,
PRESIDENT I KOMISIONIT PREGATITOR TË KOMBEVE
TË BASHKUARA,**

L o n d ē r

Zoti President,

Qeveria Demokratike e Shqipërisë, e dalë nga lufta e gjatë dhe e ashpër e popullit shqiptar kundër fuqive të Boshtit, armike të deklaruara të lirisë dhe të demokracisë, e mbështetur në vullnetin unanim të kombit dhe duke dëshiruar me gjithë zemër që të jetë krah për krah me shtetet demokratike në veprën e paqes dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar, ka nderin t'i lutet Shkëlqesës Suaj të ketë mirësinë të bëjë ç'duhet që Shqipëria të pranohet si anëtare në gjirin e komunitetit të Kombeve të Bashkuara, në konformitet me normat e Kartës (së Kombeve të Bashkuara) dhe me të drejtën që i takon

për sakrificat e popullit të saj që ka bërë për kauzën e përbashkët.

Jam i bindur se Shkëlqesa Juaj, duke marrë në konsideracion dëshirën e thellë të popullit shqiptar për të kontribuar në vendosjen e paqes, do të ketë mirësinë t'i japë udhë të favorshme kësaj kërkese.

Kryeministri i Shqipërisë
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 304,
22 dhjetor 1945*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 304,
22 dhjetor 1945*

PËRSHËNDETJE ME RASTIN E INAUGURIMIT TË DISTILERISË NR. 3 NË KUÇOVË¹

22 dhjetor 1945

Shokë punëtorë dhe teknikë të kantierit të Kuçovës,

Nuk do t'ju flas gjatë se ju jeni nga ajo kategori njerëzish që keni fjalë pak dhe punë shumë. Ne po ndërtojmë një Shqipëri të re, një Shqipëri të popullit dhe vetëm të popullit të ndershëm që punon. Për të gjithë ata që nuk u pëlqen kjo, ne andej poshtë themi një fjalë: «Le të hidhen në tra».

Për të çliruar Shqipërinë, popullit tonë ju desh të bënte shumë sakrifica; na u vranë me mijëra vëllezër dhe motra, por ne fituam lirinë, indipendencën, sovranitetin. Dhe këto, ashtu si ishim të zotët t'i fitonim, jemi të zotët edhe t'i ruajmë, t'i mbrojmë dhe të bëjmë që të na i respektojnë dhe të tjerët. Pse ka njerëz dhe rrethe reaksionarësh, që përpiken me çdo mjet të na shkëputin një pjesë të indipendencës sonë, ka shtete që mendojnë për ne si mendonin 25 vjet më parë. Por ne u themi këtyre se shkuan kohërat kur indipendenca dhe sovraniteti i Shqipërisë bëhej plaçkë tregu.

¹ Sot Qyteti «Stalin».

Liria që fituam duhet të na shërbejë për të ngritur vendin tonë në radhën e vendeve përparimtare, të ngremë ekonominë, të ngremë nivelin kultural, të lulëzojë Shqipëria nga çdo pikëpamje. Por duhet që i gjithë populli t'i vërë shpatullat kësaj pune të madhe. Gjithë populli duhet të kuptojë se rindërtimi është një luftë e madhe, e ashpër dhe plot sakrifica. Mbi të gjitha popullit i duhet të kuptojë se djersa e tij nuk shkon në xhepat e hajdutëve, por në arkën e shtetit, e cila është arka e tij, që përpinqet me mish e me shpirt të përmirësojë gjendjen e përgjithshme. Ju, punëtorë të Kuçovës, që e nxirri bukën e gojës me kaq mundime, e ndjeni më mirë se cilido tjetër se Shqipëria nuk mund të përparojë pa një punë të paprerë, të disiplinuar.

Kantieri i Kuçovës tanë është ngritur në këmbë. Kur ne filluam punën këtu, shumë njerëz qeshnin nën buzë dhe talleshin duke thënë: «Të shohim ku do t'u dalë; shpejt do të falimentojnë». Por ju punuat, dhatë prova, e dita-ditës po jepni; puna juaj do të përjetësohet. Populli shqiptar ju është mirënjohës, pse nga puna juaj plot abnegacion u shpëtuan me mijëra familje nga uria, u ndreqën ura dhe rrugë, u vunë në lëvizje centralet tona të ndryshme. Ju i keni dhënë gjak e jetë popullit tonë dhe ai jua di për të mirë. Puna juaj është e madhe dhe ju lavdëroheni prej të gjithëve. Po puna duhet vazhduar me një vrull gjithnjë më të madh. Ju punëtorët jeni realistë. Familjet tuaja janë në mjerim, kasolleth i keni të djegura, s'keni bukë aq sa duhet, gjendja juaj është e vështirë. Po si ju është gjithë populli ynë. Përmirësimi i gjendjes suaj është i lidhur ngushtë me përmirësimin e gjendjes ekonomike të vendit. Ju,

punëtorë të Kuçovës, jeni në gjendje të mendoni drejt dhe të jeni shembull për të gjithë që të shkojmë në këtë rrugë, që është ajo e shpëtimit të përhershëm.

Në kantierin e Kuçovës ju duhet të bëheni zot si në shtëpinë tuaj, të merrni maqinat në dorë, të mësoni, të perfektionoheni, t'i zotëroni. Maqina të bëhet skllavi juaj. Kuçova është fillimi i punës sonë, këtej duhet të dalin specialistët dhe teknikët që të fillojnë shfrytëzimin e fushave të tjera vajgurore.

S'duhet të na zërë gjumi. Jemi të fortë, kemi push-tetin në dorë, kemi një ushtri të fortë, populli është i gjithë me ne, por mos harroni kurrë se ka akoma njerëz që duan të na vënë gurë nën rrota. Ne duhet t'i kemi sytë hapur kundër këtyre. Ju duhet këtu të ruani çdo gjë si gjënë tuaj, se armiqtë përpinqen kurdoherë të na dëmtojnë. Ju i patë dhe i provuat vetë; patë se njërez të lidhur me fashizmin u përpoqën të na sabotonin punën¹, ju i diktuat dhe ata morën dënimin shembullor. Populli është i drejtë, është i butë ku duhet, por i pamëshirshëm për sabotatorët dhe për të gjithë ata që kërkojnë t'ja rrëmbejnë fitoren që i ka kushtuar kaq shumë.

Unë, në emër të qeverisë, ju falenderoj nga zemra. Përmirësoni më shumë punën për të mirën e përgjithshme. Të jemi kurdoherë të ndërgjegjshëm dhe të disiplinuar në punë. Vetëm kështu do të shkojë përpara

¹ Është fjala për sabotimin që u munduan të bëjnë në Kuçovë (sot Q. «Stalin») një grup teknikësh italianë, të cilët u përpoqën të djegin mbeturinat e vajgurit për të shkatërruar kantierin. Sabotimi u zbulua në kohë dhe sabotatorët muarën dënimin e merituar.

vendi ynë dhe do të kemi ndihmën kurdoherë të paprë rë të miqve tanë që na duan me plot sinqeritet.

Rroftë populli shqiptar!

Rrofshin punëtorët dhe teknikët e Kuçovës!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 306,
25 dhjetor 1945*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 306,
25 dhjetor 1945*

KËRKOJMË TË NA DOREZOHEN KRIMINELËT E LUFTËS¹

23 dhjetor 1945

Pas një luftë kaq të ashpër kundër fashistëve dhe agjentëve të tyre, po ngjet një gjë e habitshme. Për-gjegjësit direkt të kaq krimeve të poshtra, që do t'i mbajë mend historia, kriminelët e luftës po mbrohen! Toka italiane, ku për herë të parë doli dhe u vendos me terror dhe me gjak diktatura fashiste e Musolini, e cila organizoi hordhitë e këmishave të zeza dhe të ushtrisë mbretërore italiane, që sulmuani barbarisht vandin tonë, vazhdon të jetë çerdhja e fashizmit dhe një rrezik për paqen e përbotshme dhe për sigurimin e vendit tonë. Populli shqiptar nuk harron nga i erdhën sulmet që i shkaktuan kaq vuajtje, kaq mjerime dhe shikon me kujdes se në Itali shumë gjëra vazhdojnë të ecin si në kohën e parë. Kriminelët italianë të luftës, që kanë torturuar popullin tonë, shëtitin rrugëve, rrojnë rehat në pallatet e tyre ose janë funksionarë të lartë të

¹ Artikull botuar në gazeten «Bashkimi» me titull «Kriminelët e luftës shqiptarë».

shtetit italian. Të tjerë, që qeveria shqiptare i ka kërkuar nga aleatët si agjentë kryesorë të okupimit të Shqipërisë, dënohen në mënyrë qesharake nga disa gjykata false italiane.

Të tilla veprime ne i denoncojmë përpara botës përparimtare dhe antifashiste. Populli shqiptar do ta quajë një padrejtësi të madhe dhe do të jetë kurdoherë zgjuar derisa kriminelët e luftës, italianë dhe gjermanë që i ka kërkuar, të mos u dorëzohen gjyqeve shqiptare.

Disa italianë naivë kujtojnë se ne, meqë u nderëm dorën ushtarëve të shpartalluar italianë pas kapitullimit të Italisë, harruam ç'kemi pësuar prej imperializmit italian; ata kujtojnë se dora do të shërbejë si një trampolinë për imperialistët italianë për të filluar edhe një herë poshtërsitë e tyre; ata kujtojnë se duke blegëritur parullën e famshme: «Vetëm Musolini është përgjegjës për gjithshka ka ngjarë», ne do të mbyllim sytë përpara orvatjeve të reaksionit italian që e ka halë në sy demokracinë tonë. Ne me popullin punëtor italian mund të kuptohemi dhe mund të bashkëpunojmë. Këtë vullnet të mirë ne e treguam gjatë luftës ndaj atyre të paktëve ushtarë italianë të batalionit «Gramshi» etj., që bashkuan armët me ne dhe luftuan Gjermaninë naziste. Populli punëtor italian duhet të bëhet i ndërgjegjshëm për detyrimet e mëdha që ka kundrejt popullit tonë dhe jo vetëm t'i njoħë këto detyrime, por të fillojë një luftë të pamëshirshme kundër atyre kriminelëve të luftës, italianë dhe shqiptarë që prehen në gjirin e tij dhe të mos lërë të përsëritet koha e vjetër.

Kjo është rruga e një bashkëpunimi të sinqertë. Populli ynë me habi dhe me zemërim pyet: Pse nuk na

dorëzohen kriminelët shqiptarë të luftës? Pse ata që kanë bashkëpunuar gjer në fund me italianët dhe gjermanët dhe janë përgjegjësit e kaq mizorive në vendintonë, shëtitin të lirë në qytetet e Italisë, mbahen me rroga e përkëdhelen? Përgjegjen duhet të na e jep aleatët, me të cilët kemi luftuar kundër të njëjtët armik, sepse ata i kanë në dorëzim.

Që Lumo Skëndua, Ali Këlcyrë, Abaz Kupi, Xhafer Deva, Mehdi Frashëri, Gjon Marka Gjoni, Kolë Bibë Mirakaj dhe gjithë banda e tyre janë kriminelë lufte, janë përgjegjës të kolaboracionit dhe të masakrave, kjo është e qartë për të gjithë; flasin provat, flasin faktet. Përse nuk vihet në zbatim në këtë rast vendimi solemn që kanë marrë aleatët për t'u dorëzuar vendeve përkatëse kriminelët e luftës?

Ata që udhëhiqnin gjermanët në operacionet kundër Ushtrisë N.-Çl., ata që organizonin propagandën kundër aleatëve me trakte dhe me radio, ata që radio Londra i demaskonte si tradhëtarë dhe të shitur kokë e këmbë te okupatori italian e gjerman, ata që s'dëgjuan thirrjet tona dhe të aleatëve të dezertonin nga radhët e okupatorit, sot ata janë të lirë në qytetet e Italisë dhe lëshojnë vrer kundër atyre që u vranë për lirinë e popujve.

Gjaku i bijve të Shqipërisë, që u derdh në fushën e nderit tok me gjakun e bijve më të mirë të vendeve aleate, nuk mund të lejojë që kriminelët e luftës të meritojnë trajtime të këtilla. Dëshmorët e Luftës nacional-çlirimtare dhe i gjithë populli shqiptar kërkojnë drejtësinë për të cilën ata luftuan dhe u vranë. Kriminelët e luftës që kemi kërkuar duhet të na dorëzohen për të

dhënë llogari përpara popullit për krimet e tyre. Kjo është e drejta më elementare që u vulos me gjakun e popujve përparimtarë në luftën antifashiste për çlirim.

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 305,
23 dhjetor 1945*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 305,
23 dhjetor 1945*

REGJENTËT NË GJYQ¹

3 janar 1946

Shpejt do të dalin në gjyq tri nga ftyrat më të poshtra të tradhëtisë së madhe që ju bë popullit shqiptar gjatë gjithë historisë së tij: Pater Anton Harapi, Lef Nosi dhe kryeministri kuisling Maliq Bej Bushati.

Kriminelë lufte të dorës së parë, bashkëpunëtorë gjer në fund të fashistëve italianë e gjermanë, gjakpirës dhe mashtrues të popullit, trashëgimtarë direkt të atyre institucioneve antikombëtare që, nën maskë, luftonin dhe luftojnë për robërimin e vendit, trashëgimtarë të politikës së aventurës, që ka pasur kurdoherë për qëllim nënshtimin e Shqipërisë nën influencën direkte të huajve dhe robërinë tonë nationale, trashëgimtarë të gjakpirësve feudalë, për të cilët populli ishte skllav dhe i destinuar të lëngonte në vuajtje e në mjerim — këto tri figura banditësh dhe përgjegjës direkt e të ndërgjegjshëm për luftën vëllavrasëse, për bashkëpunimin me gjermanët, për shkatërrimin e vendit dhe për mjerimet që i shkaktuan popullit, do të japid llogari.

Procesi i madh i tradhëtisë nuk mund të mbarojë në një ditë, pse tradhëtarët e popullit, të ndihmuar nga

¹ Artikull botuar në gazeten «Bashkimi».

reaksioni i jashtëm dhe i brendshëm, kanë punuar dhe gjurmët e tyre duken akoma. Mbeturinat e tyre përpinqen të përfitojnë nga çdo zemërbujari e popullit dhe e pushtetit për t'u mëkëmbur, për të fituar pozitat e humbura dhe për të rivendosur regjimet e tyre anti-popullore. Fitorja e këtyre klikave fashiste dhe profashiste mund të bëhej realitet në të tjera kohëra dhe në të tjera regjime, por në Shqipërinë e re Demokratike të popullit, këto institucione e klika reaksionarësh janë të dënuara të shtypen pa mëshirë dhe të shfarosen për të mirën e popullit e të demokracisë. Pushteti i popullit, që hodhi rrënje të shëndosha, pse është themeluar nga vetë populli në një luftë të ashpër kundër fashizmit italian e gjerman dhe kundër gjithë atyre njerëzve, rretheve e institucioneve që u bënë vegla të tradhëtisë, do t'ua çjerrë maskën. Dinamizmi, që shtyn popullin tonë të shkojë përpara për ndërtimin e një jete të lumbtur, do të nxjerrë në shesh dhe do t'i pastrojë të gjithë ata që, me maskë e pa maskë, kërkojnë ta pengojnë popullin shqiptar për të ndërtuar një jetë të re. Mbeturinave profashiste, që janë një rrezik për kombin, populli ynë do t'ua tregojë vendin ku e kanë.

Pater Anton Harapi, përfaqësues eminent i pjesës tradhëtare të klerit katolik, s'është vetëm përgjegjës si person për tradhëtinë e tij të lartë kundrejt atdheut, por është njëkohësisht përgjegjës si anëtar i asaj pjese tradhëtare të klerit katolik. Nën maskën e fesë ai ka mashtruar popullin, ka gënjerë besnikët e kishës dhe i ka shpurë në vëllavrasje, në luftë kundër kauzës së shenjtë të popullit, që ishte edhe kauza e atyre besnikëve të gënjerë të kishës katolike në Shqipëri, viktivi-

ma të Pater Anton Harapit dhe akolitëve¹ të tij po të këtij profesioni.

Vepra të tilla të shëmtuara, nuk lahen as me blegërima dhe as me të fërkuara të duarve, siç e kanë zakon këta zotërinj. Vepra të tilla nuk janë sporadike dhe as të izoluara. Kjo është një rrugë antikombëtare e studjuar mirë, e peshuar mirë. Të jesh i një besimi kup-tohet, por të jesh klerik dhe, nën maskën e fesë, të bësh gjithë të zezat dhe me plan kundër popullit, kundër atdheut — kjo dënohet pa mëshirë dhe pa hezitim. Në Shqipërinë e re kanë të drejtë të rrojnë vetëm ata që e duan popullin e atdheun dhe që punojnë e janë gati të vdesin për të.

Lef Nosit, anëtar i Regjencës gjakatare, pjesëtar në mbledhjet ku janë marrë vendime aq të poshtra kundër popullit shqiptar, anëtar me influencë i «Ballit Kombëtar» dhe Maliq Bej Bushatit, kryeministër kuisling dhe përgjegjës për kaq krime, u erdhi dita të lajnë hesapet para popullit, para atij populli që ata e kanë përbuzur e gjakosur, por që sot është sovran.

Ka njerëz dhe rrethe reaksionarësh jashtë atdheut që përpiken t'i shfajësojnë sado pak qoftë këto plehra fashiste; ka njerëz dhe gazeta jashtë atdheut që, nën maskën e demokracisë, kërkojnë mëshirë për këto vegla të Musolini e të Hitlerit. Por këto rrethe dhe këta njerëz janë po ata që ndihmojnë kriminelët shqiptarë të luttës në Itali, janë po ata që u japid këtyre liri të plotë të shkruajnë nëpër gazeta fashiste italiane të sotme artikuj të tërë kundër Shqipërisë, kundër pushtetit de-

¹ Bashkëpunëtorëve.

mokratik, kundër rivendikimeve të drejta të popullit shqiptar ndaj Italisë. Mbrojtësit e këtyre njerëzve janë si ajo zonja e huaj qesharake, e cila për të mbrojtur regjentin Lef Nosi, jep këto argumenta: «Lef Nosi u bë regjent për të lehtësuar mjerimin e Shqipërisë. Ai s'është as mik i gjermanëve dhe as i italianëve dhe këtë e ka provuar duke ruajtur në shtëpinë e tij mobiljet dhe disa libra të miat dhe unë s'jam gjermane, as fashiste».

Reaksiioni ndërkombëtar po i mbron tradhëtarët e vendeve të ndryshme, bashkëpunëtorët e fashizmit, pse këta janë spiunët e përhershëm dhe të gatshëm për tradhëtira të reja kundër popujve të tyre. Ç'mund të presë njerëzimi dhe populli ynë nga njerëz si Lumo Skëndua, Ali Këlcyra, Mustafa Kruja, Shefqet Vërlaci e të tjerë kuislingë të vendeve të ndryshme? Patjetër, një kasaphanë tjetër.

Në vendin tonë kriminelët e luftës japin llogari përpara popullit dhe nuk rrojnë nëpër hotelet luksoze. Pater Anton Harapit e Maliq Bushatit u ka ardhur dita të lajnë hesapet. Sa për Lef Nosit me gjithë «kurajon e madhe» që ka pasur për të ruajtur në shtëpinë e tij ato mobiljet «demokratike» të asaj zonjës së huaj, nuk mund t'i shpëtojë dot drejtësisë së popullit, por do të paguajë krimet e tij të panumërtë, të bëra me ndërgjegje të plotë naziste.

*Botuar për herë të parë në gazeten «Bashkimi», Nr. 312,
3 janar 1946*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Bashkimi», Nr. 312,
3 janar 1946*

FJALA NË ASAMBLENË KUSHTETUESE ME RASTIN E PARAQITJES SË DOREHEQJES SË QEVERISE

11 janar 1946

Asamble e lartë Kushtetuese,

Më 22 tetor 1944 në Berat, prej Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar të Shqipërisë m'u besua nderi i madh të kryesoja Qeverinë e parë Demokratike të Shqipërisë, e cila kishte karakterin e një qeverie provizore.

Përgjegjëse përpara popullit për kryerjen e detyra e rënda që i ngarkoheshin dhe besniket ndaj vendimeve të marrura prej Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar të Shqipërisë, qeveria veproi në mënyrën më demokratike për zgjedhjen e Asamblesë Kushtetuese të popullit shqiptar.

Besoj se detyra ime është t'i paraqes sot, kësaj Asambleje sovrane që përfaqëson vullnetin e gjithë popullit tonë, dorëheqjen e qeverisë që kam nderin ta kryesoj.

Unë kam bindjen se Qeveria Demokratike e Shqipërisë i kreua me nder, me besnikëri dhe me sukses detyrat që i viheshin përpara. Nën drejtimin e saj u vazh-

dua me ashpërsinë më të madhe lufta heroike e popullit tonë kundër zaptuesve dhe u çirua atdheu ynë i dashur. Nën udhëheqjen e saj u konsolidua pushteti i popullit, u stabilizua rendi dhe qetësia, u përmirësua gjendja e vajtueshme ekonomike e vendit që dilte nga një luftë shkatërrimtare, u rindërtua një pjesë e atyre që na kish shkatërruar armiku, u zbatuan reformat e mëdha shoqërore dhe ekonomike në të mirën e popullit punëtor, u mëkëmb dhe u përmirësua arësimi i popullit, u forcua dhe hyri në rrugën e modernizimit ushtria jonë heroike që është mbrojtësja e pathyeshme e interesave të popullit, e indipendencës dhe sovranitetit të Shqipërisë.

Qeveria Demokratike e Shqipërisë, me politikën e saj të drejtë dhe të matur, siguroi për popullin tonë miqësinë e singertë dhe të shëndoshë të popujve demokratë, aleatë dhe miq, konsolidoi pozitat ndërkombëtare të Shqipërisë me njohjen e saj prej shumë shteteve të fuqishme dhe përparamtare të Evropës. Qeveria Demokratike e Shqipërisë punoi me sukses që vendi ynë i vogël të bëhet një faktor i madh vëllazërimi dhe paqeje në Ballkan dhe në Evropë.

Duke u betuar përpara popullit tonë, se ne do të bënim detyrën që na ngarkohesh në momentet më kritike, ju bie juve të gjykoni veprat tona dhe të merrni vendimet e nevojshme për interesin e atdheut.

Bashkë me paraqitjen e dorëheqjes së qeverisë, kam nderin e madh të falenderoj Këshillin Antifashist të Shqipërisë, gjithë funksionarët e shtetit dhe mbarë popullin shqiptar për ndihmën e madhe që i kanë dhënë qeverisë në ushtrimin e funksioneve të saja dhe beto-

hemi përpara popullit tonë se ne do të qëndrojmë besnikë gjer në vdekje dhe ushtarë të pamposhtur përkauzën e shenjtë të tij.

Rroftë populli shqiptar!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 320,
12 janar 1946*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 320,
12 janar 1946*

INTERVISTË DHËNË KORRESPONDENTËVE TË KRYEQYTETIT

26 janar 1946

PYETJE: A mund të na thoni diçka për të svaruar opinionin rreth arrestimeve për të cilat bënte fjalë komunikata e Drejtorisë së mbrojtjes e botuar në gazeten «Bashkimi» datë 24.I.1946?¹

PËRGJEGJE: Prej shumë kohe organet e mbrojtjes kishin nën vigjilencën e tyre të fortë aktivitetin fashist dhe profashist të disa institucioneve dhe individëve që, të lidhur me njëri-tjetrin, tentonin të organizonin luftën kundër pushtetit, duke pasur në programin e tyre ak-sione dhe atentate kundër pushtetit popullor dhe kundër udhëheqësve të tij. Këto mbeturina të fashizmit, të mbështetura te shpresa e ndërhyrjes së jashtme, te armiqtë e popullit e të demokracisë përparimtare të vendit tonë dhe duke punuar nën maskë ose me një konspi-

¹ Komunikata e Drejtorisë së mbrojtjes së popullit e datës 24 janar 1946 bënte fjalë për arrestimin në qytete të ndryshme të Shqipërisë të një numri spionësh, sabotatorësh, terroristësh në shërbim të imperialistëve anglo-amerikanë. Midis armiqve të arrestuar ishin Sami Qeribashi, Qenan Dibra, Lluk Bibi, etj.

racion të fortë, kujtonin se do të realizonin planet e tyre tradhëtare dhe do t'i shpëtonin syrit vëzhgues dhe drejtësisë së popullit. I gjithë aktiviteti i tyre gjer në hollësitë më të vogla është në dijeni të pushtetit. Inspiruesit e hapët dhe të fshehtë të këtyre veprimeve dihen fare qartë, udhëheqësit e këtyre organizatave tradhëtare dhe të veprimitarive terroriste janë në duart e drejtësisë.

PYETJE: A mund të na tregoni, në bazë të dokumentave që ka pushteti në dorë, cili ka qenë qëllimi i këtyre elementëve dhe si kërkonin t'ja arrinin këtij qëllimi?

PERGJEGJE: Qëllimi i këtyre elementëve ishte të rrëzonin pushtetin e popullit dhe të sillnin në fuqi re gjimet e vjetra shtypëse dhe antipopullore. Për t'ja arritur këtij qëllimi ata kishin arritur të organizonin disa grupe, në të cilat figurojnë, në radhë të parë, tregëtarë të mëdhenj spekulatorë, ish-oficerë të Zogut, pseudointelektualë dhe pseudodemokratë, feudalë dhe qehallarë bejlerësh, të gjithë njerëz të radhës së Xhelal Staraveckës e të Ali Këlcyrës me shokë. Veprimitaria e tyre do të fillonte duke bërë atentate kundër udhëheqësve të shtetit, si gjeneral Myslim Pezës e shumë të tjerëve. Për të tilla veprime ata kishin caktuar dhe atentatorët. Atentatet në fjalë do të kishin për qëllim jo vetëm zhdukjen fizike të këtyre personaliteteve, por njëkohësisht dhe sidomos të përqanin unitetin e Frontit Demokratik duke i paraqitur këto atentate si të kryera prej komunistëve.

Këta elementë tentonin të organizonin banda të armatosura me kriminelë të zakonshëm për të kryer

aksione të ndryshme si prerje rrugësh e shtyllash telefon i dhe të arrinin në një kryengritje. Për këtë qëllim ata ishin në lidhje me kriminelë të luftës. Shpresa dhe mbështetja e tyre kryesore ishte intervencioni i huaj me armë. Fashistët grekë ishin një mbështetje e tyre dhe për këtë gjë ata ishin në bashkëpunim të ngushtë me ta dhe u njihnin këtyre rivendikimet mbi Shqipërinë e Jugut.

PYETJE: A mund të na thoni në se ekziston një lidhje midis këtyre elementeve dhe atyre të klerit katolik që u arrestuan disa javë më parë në Shkodër e që zhvillonin një aktivitet fashist me anën e organizatës së tyre fashiste «Bashkimi Shqiptar»¹ dhe në se qëllimet e tyre pajtoheshin?

PËRGJEGJE: Po, ekziston një lidhje e ngushtë në mes të këtyre grupeve fashiste terroriste dhe atyre të klerit katolik të organizatës «Bashkimi Shqiptar». Kjo lidhje del e qartë nga qëllimet e njëjta të tyre në radhë të parë, por ka pasur edhe lidhje organizative në mes të tyre. Elementët e klerit katolik të implikuar në Shkodër, nën maskën e fesë dhe në seminaret e tyre, kishin krijuar qendrën e një organizate fashiste, e cila, në lidhje me elementë joklerikë dhe me kriminelë të luftës, zhvillonte një aktivitet të organizuar kundër pushtetit

¹ «Bashkimi Shqiptar» organizatë tradhëtare e krijuar nën drejtimin e klerit reaksionar katolik në Shkodër pas çlirimt të vendit, sipas udhëzimeve të drejtpërdrejta të Vatikanit dhe të imperialistëve anglo-amerikanë. Kjo organizatë synonte përmby-sjen me armë të rendit të ri demokratik popullor në Shqipëri. Pas zbulimit krerët e saj u arrestuan dhe u dënuan nga Gjykata populllore e Shkodrës në shkurt 1946.

popullor. Klerikët katolikë dhe akolitët e tyre u zunë në flagrancë me dokumenta në duar dhe në seminarin e tyre u kap materiali që u shërbente për punën e tyre, e cila konsistonte në preqatitjen e kryengritjes me armë, në rrëzimin e pushtetit të popullit dhe në atentate kundër njerëzve të Frontit.

PYETJE: Ç'mendoni Ju: aktiviteti i këtyre elementeve është shkaktuar vetëm nga situata që u krijuar pas çlirimit të Shqipërisë, apo veprimtaria e tyre është vazhdimi i tradhëtisë së madhe që i është bërë popullit shqiptar gjatë okupacionit?

PËRGJEGJE: S'ka dyshim se, situata e krijuar në vendin tonë pas çlirimit të Shqipërisë, ka influencuar në këta elementë të tentojnë rigrupimin e forcave të tyre të shpartalluara për të rifilluar luftën kundër kësaj situate që po shkon në favor të popullit. Por këta elementë janë prej asaj kategorie që, kur populli luftonte kundër okupatorit dhe tradhëtarëve, ata ndodheshin matanë barrikadës. E shkuara e këtyre njerëzve është e errët dhe faktet që kemi në duar tregojnë se veprimtaria e tyre nuk është veçse vazhdimi i tradhëtisë së madhe që ju bë popullit tonë gjatë okupacionit. Interesat e këtyre elementeve dhe të shtresave që përfaqësojnë kanë qenë dhe janë në kundërshtim të hapët me interesat e popullit. Këta njerëz e konsiderojnë, me plot të drejtë, qenjen e popullit në fuqi, vdekje për ta. Për këtë arësyе ata ndihmonin okupatorin gjatë Luftës nacional-çlirimitare; për këtë arësyе ata sot tentojnë të rigrumbullojnë forcat e tyre. Çifliksahibinjtë, klerikët fashistë dhe antipopullorë, shërbëtorë të regjimit të errët të Zogut, tregëtarët e mëdhenj spekulatorë, të

mësuar të rrojnë në kurrizin dhe me djersën e popullit punëtor, nuk mund të pajtoheshin me këtë regjim, që solli popullin në fuqi, që i dha frenat e komandës në dorë dhe e bëri zot të pasurisë dhe të punës së tij. Nuk mund të konsiderohet e rastit që elementët e klerit katolik dhe sidomos nga rrethet e larta të këtij kleri, të dalin në luftë të hapët kundër popullit dhe pushtetit të tij. Të tillë elementë fenë e kanë përdorur si maskë për të luftuar popullin. Agjentë të OVRA-s dhe të Gestapos si Pater Anton Harapi, Dom Lazër Shantoja, Dom Ndre Zadeja e të tjerë do të mbeten figurat më tipike të klerikëve që shitën atdheun. Elementë të lartë të rrethit të episkopatit katolik të Shqipërisë edhe sot bile e justifikojnë bashkëpunimin me armikun kësisoj: «Do të merrnim pjesë për një bashkëpunim kombëtar, po të mos na kishin dezorientuar retë e ideologjive të ndryshme që ishin drejtpërdrejt në kundërshtim me ndërgjegjen dhe me parimet tona fetare».

«Retë ideologjike» që i penguan këta zotërinj të merrnin pjesë për një bashkëpunim kombëtar ishin forcat e ndritura të popullit që shpëtuán atdheun nga robëria. Por që të bashkëpunonin me fashizmin italian dhe me Gestapon gjermane, të bëheshin agjentët e tyre dhe xhelatët e popullit, kjo pajtohej me «ndërgjegjen» dhe me «parimet e tyre fetare».

Disa pseudodemokratë si Gjergj Kokoshi, Suat Asllani etj., që kanë qenë frymëzues dhe bashkëpunëtorë me këto grupe fashiste kanë pasë kujtuar se do të përfitonin lehtë nga kjo situatë e re, për të rifilluar punën c një Mithat Frashëri ose Ali Këlcyre. Të tillë elementë, armiq të popullit dhe negativë, kanë luajtur pjesën e sehirxhiut

përpara tragjedisë së madhe të popullit ose në mënyrë hipokrite janë përpjekur të kallajisin emërin e tyre me gjakun dhe sakrificat e të tjerëve. Këta njerëz në bashkëpunim me këto grupe fashiste-terroriste u dhanë një memorandum aleatëve, me të cilin kanë tentuar të gjenjenin aleatët mbi realitetin e vërtetë të gjendjes në Shqipëri. Populli dhe pushteti i tij këtyre njerëzve u kandur dorën, por këta kanë mprehur thikën që ta goditin pas shpine.

Demagogjia e këtyre elementëve fashistë dhe profashistë s'mund të ndezë gjatë në një vend si Shqipëria e re, ku rron një popull që luftoi kaq vjet dhe fitoi kundër armës, dinakërisë dhe demagogjisë më të madhe që ka parë historia, të Gestapos gjermane, ku rron një popull vigjilent dhe xheloz për pushtetin që ka në duar dhe që e fitoi pas kaq shekujsh robërie dhe pas kaq vuajtjesh dhe sakrificash.

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 333,
27 janar 1946*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Bashkimi», Nr. 333,
27 janar 1946*

INTERVISTË DHËNË GAZETËS «BASHKIMI» MBI DISKUTIMET NË LONDËR RRETH PRANIMIT TË SHQIPËRISË NË ORGANIZATËN E KOMBEVE TË BASHKUARA

31 janar 1946

*PYETJE: Ç'mendoni për pjesëmarrjen e Shqipërisë
në Organizatën e Kombeve të Bashkuara në lidhje me
kërkesën e paraqitur prej qeverisë sonë?*¹

PËRGJEGJE: Në luftën kundër fashizmit, popujt e robëruar të Evropës, të mëdhenj e të vegjël dhanë kontributin e tyre të çmueshëm krah për krah me aleatët e mëdhenj; pra, janë dhe ata pjesëtarë të drejtpërdrejtë në fitoren e arritur. Këtyre popujve, që ju kushtoi kaq shtrenjtë kjo luftë, për interesin e tyre vital, ju vihet për detyrë kryesore konsolidimi i fitores dhe ruajtja e paqes.

Kuptohet lehtë pra se në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, krah për krah me Bashkimin Sovjetik, Anglinë dhe Amerikën duhet të marrin pjesë dhe aleatët e tyre të luftës antifashiste, të marrin pjesë të gjithë ato kombe që e provuan me gjak se sa të vendosur ishin në

¹ Shih në këtë vëllim, f. 215

luftë kundër gjermanëve dhe që do të jenë natyrisht më të vendosurit për të ndaluar të ngrenë krye ata që janë përgjegjës direkt ose tërthorazi të kësaj kasaphane të madhe.

Shqipëria duhet të jetë nga të parët e atyre kombeve që duhet të gëzojnë anëtarësinë e kësaj organizate. dhe këtë të drejtë ajo e ka, jo për hatërin e ndokujt, por se e ka fituar me gjakun e bijve të saj më të mirë. Në qoftë se Organizata e Kombeve të Bashkuara udhëhiqet nga parimi i bashkëpunimit të singertë midis popujve liridashës dhe shpresojmë dhe dëshirojmë të jetë kështu, në qoftë se anëtarësia fitohet prej një kombi jo pse është i madh ose i vogël, por për hir të sakrificave që ka bërë dhe për vendosmërinë e tij për të mbrojtur paqen, atëhere s'duhet të ketë asnje hezitim për pranimin e Shqipërisë në gjirin e saj. E kundërtta ose vonesa do të provojë se çështjet nuk shikohen me objektivitet dhe me drejtësi prej të gjithë atyre që kërkojnë t'i qesin penge-sa hyrjes sa më shpejt të Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

PYETJE: A janë paraqitur pengesa për pranimin e Shqipërisë në gjirin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara?

PËRGJEGJE: Pas propozimit për pranimin e Shqipërisë dhe pas pranimit të menjëhershëm nga shumë delegatë të kombeve të tjera, delegati i Shteteve të Bashkuara zoti Eduard Stetinius si edhe ministri i jashtëm i Anglisë zoti Bevin u shprehën në favor «të shtytjes për më vonë të shqyrimit të kësaj kërkese» duke shfaqur si arësyse se «kjo ishte një çështje serioze që kërkonte një vemannje të madhe».

Një qëndrim i tillë i delegatëve të Anglisë dhe të Amerikës kundrejt kërkesës së drejtë të Shqipërisë, jo vetëm që e çudit popullin shqiptar, por edhe e hidhëron.

Ç'i ndalon zotin Stetinius dhe zotin Bevin të marrin në shqyrtim menjëherë dhe të vendosin pranimin e Shqipërisë? Këtë nuk do ta kuptojë populli shqiptar, ashtu si nuk ka kuptuar pse nuk u thirr vendi ynë në San-Françisko, ku morën pjesë shtete si Argjentina etj. që kishin përkrahur me mish e me shpirt Gjermaninë naziste. Në San-Françisko ju bë një padrejtësi Shqipërisë dhe populli shqiptar kujtoi se ajo do të ishte e fundit, ashtu sikundër shprehej dhe vetë zoti Stetinius në mesazhin që më drejtoi me këtë rast më 22 maj 1945, ku në mes të tjerash më thoshte: «... Unë e di mirë luftën e pareshtur që ka bërë populli shqiptar kundër agresorit dhe unë i çmoj plotësisht sakrificat që ai ka bërë për të kryer çlirimin e vendit të tij dhe për të ndihmuar në realizimin e fitores përfundimtare kundër armikut të përbashkët... Dëshiroj t'ju siguroj për simpatinë dhe miqësinë që populli i Shteteve të Bashkuara ndjen për Shqipërinë dhe popullin e saj dhe unë e di se në të ardhmen Shqipëria do t'i sjellë çështjes së paqes po të njëtin kontribut të shëndoshë që i ka dhënë realizimit të fitores».

Historia e luftës legjendare që bëri populli shqiptar kundër okupatorëve italianë, gjermanë dhe kuislingëve shqiptarë nuk duhet të jetë një «çështje serioze» për t'u biseduar, por një provë serioze dhe një garanci e madhe për t'u pranuar menjëherë Shqipëria në gjirin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Kur asnjeri s'po ngrinte zërin për Shqipërinë e

vogël që po sulmohej, përvèç vendit të lavdishëm të Sovjetëve, populli ynë që më 1939 e filloj luftën e tij të shenjtë. Gjaku u derdh në Durrës, në Vlorë e gjetkë. Demostratat dhe përleshjet në rrugët e qyteteve me karabinierët dhe me njerëzit e Vërlacit e të kuqislingëve të tjerë që i deklaruan luftë Greqisë dhe atentati në Tiranë i djaloshit shqiptar¹, që qolloi Viktor Emanuelin në rrugën e «Durrësit»², ishte fillimi i një kryengritjeje të madhe që po pregete. Partizanët e Pezës goditën me armë që më 1941 forcat e karabinierisë në Ndroq për t'u prerë rrugën furnizimeve italiane që ushqenin skllavë-ruesit e popullit tonë dhe të popujve fqinjë. Ushtarët shqiptarë, të dërguar në frontin grek nga italianët dhe kuqislingët dezertuan ose sabotuan armët. Një pjesë e madhe e tyre u internuan në kampe përqëndrimi nga Italia e një pjesë nga Greqia, në Kretë, kurse pjesa tjeter u bashkua me forcat e gjalla të popullit që luftonin nëpër male kundër italianëve dhe shërbëtorëve të tyre. Në zonat shqiptare ku gjendej ushtria greke, populli ynë kërkoi të luftojë kundër italianëve po komanda e ushtrisë greke jo vetëm që i refuzoi këto kërkesa, po mori masa të rrepta për të penguar çdo veprim në këtë drejtim. Megjithkëtë populli ynë jo vetëm s'e ndërpren luftën, por e vazhdoi me trimëri. Më 1942 Shqipëria ishte plot me partizanë të cilët luftonin në Pezë e në Skrapar, në Çorovodë e në Gjorm. Më 1943 ushtria jonë e rregullt luftonte me ashpërsinë më të madhe në Vlorë

¹ Është fjala për atentatin që kreu punëtori Vasil Laçi në maj 1941, kundër mbretit të Italisë, Viktor Emanuelit III.

² Sot rruga «Kongresi Përmetit».

e në Mallakastër, në Gjirokastër, në Kuqar e në Përmet, në Leskovik e në Berat, në Selenicë e në Barmash. Toka digjej zjarr nën këmbët e italianëve dhe të gjermanëve, të cilët pas kapitullimit të Italisë, organizuan tok me kuislingët dhe me tradhëtarët ofensivat e përgjakshme e të njëpasnjëshme. Mollotovi, Hulli dhe Ideni bënë deklarata për luftën tonë dhe për sigurimin e pavarësisë së Shqipërisë. Katër divizione gjermane ndodheshin në përleshje me ushtrinë tonë, kur anglo-amerikanët zbarkonin në Francë. Kudo partizanët shqiptarë sulmonin gjermanët, deri në tokën greke, në bashkëpunim vëllazëror me partizanët grekë. Ndërsa qytetet dhe rrugët e Shqipërisë po vritheshin me mijëra gjermanë, po hidheshin në erë depo, po sulmoheshin kazermat dhe autokolonat armike: gjermanët ndiqeshin këmba-këmbës në tërheqjen e tyre. Lufta epike e Tiranës kurorëzoi luftën e çlirimit. Shqipëria u çlirua vetëm me forcat e popullit shqiptar, të cilat s'mbaruan me kaq po kapërcyen kufirin dhe u bashkuan me vëllezërit jugosllavë për ta vazhduar luftën me trimëri gjer në kapitullimin e Gjermanisë.

Lufta e popullit tonë është e njohur mirë prej të gjithëve. Vetë oficerët anglezë dhe amerikanë kanë parë me sytë e tyre përpjekjet tona, dhe në mbledhje publike kanë shfaqur admirimin për kontributin e madh që ka dhënë populli ynë në luftën e përbashkët. Komandanti i Përgjithshëm aleat i Mesdheut Meitlland Uillson në një mesazh që më drejtonte më 12 tetor¹ 1944 në mes të tjerash më thoshte: «Kam vërejtur me admirim për-

¹ Në botimet e mëparshme gabimisht është shkruar 12 nëntor.

mbushjen e detyrave nga ana e Ushtrisë suaj Nacional-Çlirimtare në përpjekjet e saja të shkëlqyera kundër armikut të përbashkët dhe pér qëllimin e njëjtë tonin». Nënmareshali i ajrit, komandanti i forcave ajrore të Ballkanit zoti Uilliam Eliot e mbaron kështu mesazhin që më drejtonte më 5 gusht 1944: «Në këtë mes po ndjekim me simpati dhe admirim përpjekjet tuaja të mëdha dhe të ushtrisë suaj që bëni në këtë luftë të përbashkët».

Lufta e çlirimt i kushtoi Shqipërisë me mijëra të vrarë, me mijëra invalidë: fshatra dhe qytete u dogjën dhe u bënë hi, dëmet arrijtën mbi 4 500 000 000 franga ar. Në vendin tonë, ku u luftua që në fillim me aq ash-përsi kundër okupatorëve, morën dënimin e merituar nga gjyqet e popullit të gjithë kuislingët, përgjegjës pér tradhëtinë e tyre, pér aktet e tyre, pér bashkëpunimin me italianët dhe me gjermanët. E paguan me kokë Fejzi Alizoti, Kostandin Kotte, etj., e paguan me burgim të përjetshëm Qemal Vrioni dhe shokët e tij, kurse në Romë, nëpër pallate dhe nën mbrojtjen e autoritetet e angleze dhe amerikane, po rrojnë në rehati kuislingët me famë, fashistët më të poshtër, kriminelët e luftës, Shefqet Vërlaci, Mustafa Kruja, Xhafer Deva, Abaz Kupi e të tjerë.

Populli shqiptar pyet me habi: A mund të mohohen ose të errësohen gjithë këto prova gjaku dhe sakrifica që ka bërë një komb i vogël pér çështjen e përgjithshme të njerëzimit? A mund të diskutohet pranimi në gjirin e Kombeve të Bashkuara i Shqipërisë martire dhe heroike, dhe të shtyhet diskutimi i çështjes në sesionin e ardhshëm të organizatës? Këtë populli shqiptar nuk dëshiron ta besojë pse atëherë do të jetë padrejtësia më

e madhe dhe shkelja e idealeve dhe e parimeve për të cilat ranë me miliona njerëz në luftën kundër fashizmit, do të jetë shkelja e çdo të drejte njerëzore dhe e lirive të popujve përparimtarë.

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 336,
31 janar 1946*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 336,
31 janar 1946*

RAPORT I MBAJTUR NË PLENUMIN V TË KQ TË PKSH

21 shkurt 1946

Në mbledhjen e Plenumit IV u tha për mundësinë e mbledhjes së Plenumit V, ku të rishikohej për së afërmë preqatitja e kongresit të Partisë¹. Mbledhja e sotme ka një rëndësi të madhe dhe të veçantë për gjithë Partinë tonë, pse për herë të parë, pas kësaj Luftë heroike nacional-çlirimtare, të organizuar dhe të udhëhequr nga Partia, kjo preqatitet të dalë përpara popullit shqiptar me kongresin e saj. Kongresi i Partisë do të jetë një nga ngjarjet më të shënuara të historisë së vendit tonë dhe të masave punonjëse të Shqipërisë. Në atë kongres Partia jonë që ka qenë, üshtë dhe do të jetë udhëheqësja e sigurt e popullit dhe realizuesja e dëshirave dhe e aspiratave të tij do të dalë e bashkuar, monolite dhe me një program të hapët, të qartë dhe të drejtë.

Të preqatitësh kongresin do të thotë të dalësh përpara popullit me një vijë politike dhe organizative të qartë, të drejtë dhe të përcaktosh konkretisht progra-

¹ Plenumi V i KQ të PKSH vendosi që Kongresi I i PKSH të thirrej më 25 maj 1946. Për shkak të ndërhyrjes së udhëheqjes së PKJ ky vendim nuk u zbatua dhe thirrja e kongresit u shty për një kohë të pacaktuar.

min e Partisë. Pikërisht për këtë gjë jemi mbledhur sot, prandaj e kam për detyrë të vë në dukje përparrë Komitetit Qendror, përgjegjësinë e madhe që na bie, ta marrim çështjen me seriozitetin më të madh, pse punimet që do të zhvillohen sot do të shërbejnë si bazë e çmueshme jo vetëm për punimet e kongresit, por për zhvillimin e drejtë të punës që do të kryejmë pas këtej.

Partia jonë asgjë s'mund ta marrë të shkëputur. Forcën e saj ajo ja detyron eksperiencës së vet në të kaluarën dhe në të tanishmen si dhe perspektivës së qartë për realizimin e qëllimeve të saja. Prandaj Komiteti Qendror, në dritën e realizimeve dhe të evenimenteve politike si brenda, ashtu dhe jashtë vendit tonë, është më se e domosdoshme të këqyrë punën e realizuar dhe të vihet përparrë përgjegjësive që i ka ngarkuar Partia. Kjo gjë, natyrisht, do të bëhet kur ne të kemi analizuar konkretisht vijën tonë politike dhe organizative sipas së cilës Partia jonë dhe pushteti kanë vepruar për një periudhë njaft të gjatë që prej Plenumit të Beratit dhe deri tani.

Me pasë një vijë të drejtë është gjëja kryesore, por edhe zbatimi i saj si duhet ka të njëjtën rëndësi. Në këto dy çështje kryesore shihen te Partia jonë karakteristikat e një partie të re, e cila me gjithë luftën e madhe që ka bërë, s'ka mundur dot t'u shpëtojë tendencave sektare ose oportuniste që shfaqen në kuptimin e vijës dhe në zbatimin e saj. Ajo s'ka mundur dot të evitojë me kohë dhe të parashikojë pengesat, të luftojë rreptësisht dhe rrënëjisht gabimet dhe tendencat e gabuara, të qëllojë ashpër këto gabime o tendencia dhe të mësojë si duhet nga to, të gjitha organizatat dhe anëtarët e saj. Kuptimi

dhe zbatimi i drejtë i vijës duhet të jetë qederi më i madh i çdo anëtari të Partisë sonë ose i çdo forumi. Asnjë s'mund t'i shpëtojë përgjegjësisë. Por kjo nuk mund të themi se është parë drejt prej të gjithëve, sepse ka munguar fryma e shëndoshë e kritikës dhe e autokritikës, ka munguar përgjegjësia dhe disiplina në punë, ka çaluar metoda dhe stili në kryerjen e detyrave që na ngarkoheshin. Kjo është akoma më keq kur ngjet në radhët e udhëheqësve të Partisë.

Përpara disa sprovave të kritikshme nga ku ka kalluar Partia, shumë shokë kanë qenë të hutuar dhe ju është dashur një kohë mjaft e gjatë për të kuptuar ç'kishte ngjarë. Hutimi i tyre rridhete, sepse ata nuk ishin të lidhur ngushtë me punën, me zhvillimin dhe me rritjen e saj. Një gjë e tillë sjell me vete konsekuenca të rënda dhe të hidhura për punën e Partisë. Kthesat e mëdha që bëhen, të shkaktuara qoftë nga një krizë e brendshme, qoftë nga një situatë e re që krijohet, jo vetëm që nuk kuptohen por ato merren si një operacion i thjeshtë o si një autokritikë e zakonshme forumi o individi. Nuk shihet thellë origjina e gabimit dhe rrethanat që e kanë shkaktuar, të peshohet përgjegjësia e përgjithshme dhe ajo individuale, të studjohet problemi me imtësi nga të gjitha anët dhe të armatoset pastaj si duhet e tërë organizata me eksperiencën e fituar.

Të analizosh vijën e Partisë, për të përcaktuar me përpikmëri vijën e vërtetë, për të goditur gabimet dhë tendencat e huaja, është pra një punë e rëndë, delikate dhe nga më seriozet. Nga një analizë e imtë e vijës politike do të dëlin vetëvetiu gabimet dhe tendencat tonë të irrezikshme që janë shfaqur në vijën politike të

Partisë, do të dalin përgjegjësia e përgjithshme dhe individuale e jona. Pasi të analizohen dhe të goditen ashpër të gjitha tendencat e gabuara, është shumë e rëndësishme që këtej të dalë vija jonë e paskëtajme, një vijë e shëndoshë, e drejtë, e qartë që do të na prijë në kongresin e afërt të Partisë dhe në gjithë punën tonë të ardhme.

Gjithë shokët e Komitetit Qendror e kanë për detyrë ta diskutojnë me kujdesin më të madh këtë çështje dhe jo të regjistrojnë faktet pse atëhere do të jetë një punë e shterpët.

* * *

Plenumi i Beratit ishte një mbledhje me rëndësi për Partinë tonë¹. Atje u bë një analizë e vijës sonë politike dhe organizative që ishte ndjekur gjatë gjithë kohës së

¹ Plenumi II i KQ të PKSH u mbajt në nëntor 1944 në Berat. Mbledhja e plenumit ishte e domosdoshme për të bërë analizën e veprimtarisë së Partisë gjatë Luftës Nac.-Çl. dhe për të caktuar detyrat për etapën e re që fillonte me çlirimin e vendit.

Por qëllimet e drejta u shtrembëruan nga ndërhyrja armiqësore e udhëheqjes jugosllave me anë të Velimir Stojniçit, i dërguar i KQ të PKJ. Ai organizoi në prapaskenë një komplot kundër PK të Shqipërisë me pjesëmarrjen e Sejsulla Malëshovës, të Koçi Xoxes, të Pandi Kristos e të tjerë dhe në këtë mënyrë plenumi u zhvillua në fryshtë e vijës antimarksiste jugosllave.

Pikësynimi kryesor i planit titist për të përbysur udhëheqjen e Partisë me shokun Enver Hoxha në krye e për ta zëvendësuar atë me një udhëheqje të re projugosllave, nuk u arrit për shkak të kundërshtimit të pjesës më të madhe të anëtarëve të plenumit. Megjithatë Plenumi i Beratit hapi rrugën për një ndërhyrje më të thellë e të gjithanshme të udhëheqjes revolucioniste jugosllave në punët e brendshme të Partisë e të vendit tonë.

luftës. Nga ana tjetër aty u përcaktua vija politike dhe organizative që duhej ndjekur në rrethana të reja dhe në situata të ndryshme që sillte me vete çlirimi i plotë i Shqipërisë. Partia kishte pra përparrë një detyrë shumë të rëndësishme, atë të drejtimit të gjithë shtetit.

Tendencat e gabuara që ishin shfaqur gjatë periudhës së luftës u kritikuan dhe u muarën edhe vendime të prera; por disa shokë kanë pasë tendenca të gabuara, sepse nënvleftësonin punën e kryer deri atëhere nga Partia jonë. Këta linin të kuptohej sikur «nga Plenumi i Beratit u fillua me të vërtetë të punohej». Një pikëpamje e tillë kishte rreziqet e veta, sepse ai që mendonte kësisoj, neglizhonte eksperiencën e luftës së Partisë së nё, eksperiencën e përbërë prej sukseseve e gabimeve dhe kujtonte të kalonte në etapën e re, pa ruajtur si thesar shumë të vlefshëm këtë eksperiencë të madhe të Partisë. Ai që mendonte kësisoj dhe harronte vazhdimësinë në zhvillimin e Partisë, do të gabonte më shumë në të ardhmen. Të shohësh gabimet, t'i goditësh këto ashpër, është një gjë e dorës së parë, por duhet të mësosh organizatën të nxjerrë mësimë nga këto gabime dhe njëkchësishë ta ruash organizatën nga pikëpamjet e gabuara. Eksperiencia individuale duhet t'i shtohet eksperiencës së Partisë, por kjo c fundit duhet të jetë kurdoherë guri themeltar për çdo anëtar partie që e do Partinë dhe popullin. Pasionet dhe besimi jo i shëndoshë në rolin e Partisë dhe në eksperiencën e madhe të saj, janë burimi i tendencave të gabuara, i gabimeve të mëdha, i deviacioneve etj. të këtij lloji. Këtë gjë e përmendim pse Partia jonë e re mund të gjendet shumë herë përparrë situatave të tilla, të cilat me dashje a pa

dashje të çojnë në rrugë të shtrembëra dhe që rrezikojnë të ardhmen tonë.

A përcaktoi Partia një vijë politike dhe organizative për periudhën e çlirimit? Po, dhe unë besoj se të gjithë jemi në një mendje. U përcaktua vija politike e Frontit, vija politike në lidhje me aleatët dhe me Jugosllavinë, u përcaktua vija ekonomike dhe sociale që duhej të ndiqte Partia jonë, u përcaktua vija organizative e Partisë sonë. Patjetër eksperienca do të na mësonte shumë gjëra për të konkretizuar më mirë çështjet qoftë në pikë-pamje politike, qoftë në format organizative, por ç'ka kishte rëndësi për ne dhe që s'duhej ta harronim në asnjë minutë, ishte se ne duhet të shkonim, me hapa të shpejta dhe të matura mirë, drejt socializmit. Një gjë e tillë sillte me vete kujdesin që duhej të kishim ne që çdo veprim politik ose organizativ, të ndihmonte progresivisht në këtë drejtim. Çdo gjë duhej të mobilizohej drejt kësaj perspektive dhe aktivitetet në sektorët e ndryshëm duhej të harmonizoheshin të gjitha për t'ja mbërrijtut qëllimit. Me gjysmëmasa nuk arrihej dhe as me lëkundje. Këtë na e kish provuar periudha e luftës. Këtu, mendoj unë, ishte çështja të mos humbisnim mësën, dhe e shkuara të na shërbente. Ka shokë që mund të pretendojnë, si Sejfulla Malëshova, që thotë: «Me të vërtetë unë s'e kuptoja mirë vijën e Partisë për Frontin». Sejfullai ishte ai më i rrepti për të goditur «tendençen sektare» dhe «lëkundjet» në vijën e Partisë në Plenumin e Beratit. Në fakt ai vazhdoi të jetë deri tani partizan i një vije të lëkundshme dhe të dominuar nga tendenca oportuniste. (Për këtë çështje do të flas më poshtë).

Ç'ishte Bashkimi Sovjetik për ne dhe si duhej të vepronim në këtë drejtim? Unë mendoj se Partia e kishte caktuar mirë vijën. U bë dallimi në mes Bashkimit Sovjetik nga njëra anë dhe Anglisë e Amerikës nga ana tjetër dhe u theksua se duhej të punohej në këtë drejtim. Çështja ekonomike, që kishte rëndësinë e dorës së parë dhe ku Plenumi i Beratit duhej të insistonte në përcaktimin më të qartë të saj, u shtrua në përgjithësi. U fol për rëndësinë e sektorit të shtetit, për masat kryesore që duheshin marrë me çlirimin e plotë të Shqipërisë, por, të studjohej çështja në tërësi, sikundër-që do të bëjmë në këtë mbledhje, kjo s'u bë. Do të ishte naivitet nga ana e ndonjërit, po të pretendonte se ne nuk do të hasnim vështirësi në kryerjen e detyrave, por këto vështirësi duhej t'i kalonim duke ruajtur kthjellësinë e vijës sonë politike e organizative. Këtë vijë, ne duhej ta futnim thellë jo vetëm në shpirtin e anëtarëve të Partisë, por ta bënim të pranueshme nga të gjitha masat punonjëse të vendit tonë, të cilat pa i pasur të mobilizuara fort dhe të qarta rrëth Partisë, ishte gjë e zorshme të shkonim përpara dhe të realizonim qëllimet dhe detyrat tona. Tani le të shohim si e kuptuam dhe si e zbatuam këtë vijë pas çlirimit.

Është e vërtetë se në Berat, përsa i përket vijës së Frontit, pamë tendencën sektare që ishte shfaqur në punën tonë, por e kërkuam atë edhe atje ku nuk kishte, dhe çështja e sektarizmit u ngrit si rreziku më i madh i Partisë. Kjo gjë kishte rreziqet e saja. Bënte që, një parti e re dhe pa një eksperiencë të gjatë, siç ishte kjo e jona, të hidhej në anën tjetër, në qëndrime oportuniste. Duhej kujdes i madh për të mbajtur masën, pse

rrëshqitej lehtë në qëndrime oportuniste. Ata që e humbën më shumë masën, ishin ata shokë që s'u mbështetën sa duhej në eksperiencën e Partisë dhe që panë në të kaluarën kudo tendencën sektare. Në ngritjen e një lëvizjeje të madhe masash, ku populli u hodh në kryengritje të armatosur dhe ku merita e gjithë kësaj pune i bie Partisë sonë, sido që ajo ishte e re dhe pa eksperiencë, përveç sektarizmit të dëmshëm duhej të shiheshin shumë gjëra të çmueshme, të cilat të konsideroheshin si një kapital i madh për çdo anëtar partie. Vrulli, entuziazmi, vendosmëria, sakrifica, vetëmohimi, disiplina dhe dashuria e madhe për Partinë që ushqente çdo anëtar partie gjatë gjithë periudhës së luftës, nuk mund të ekzistonin në një parti, «ku bëheshin vetëm gabime dhe ku dominonte kryekëput sektarizmi». E kundërta është e vërtetë: atje ku shfaqen të theksuara tendenca oportuniste (dhe sidomos në këtë periudhë plot rreziqe që po kalojmë), fare lehtë anëtari i Partisë mund t'i humbasë të gjitha ato kualitete që janë konditë sine qua non për mbarëvajtjen e punës. Këto që them duhet të kuptohen drejt prej të gjithëve; këtu s'është çështja të mbrohen gabimet, por të mbrohet Partia nga sharlatanët dhe nga arrivistët.

Gjatë periudhës së luftës, Frontit i binte barra të mobilizonte masat e gjera të popullit për luftë kundër okupatorit dhe tradhëtarëve, t'i lidhte këto ngushtë me Partinë dhe të izolonte organizatat tradhëtare. Kjo jo vetëm që do të forconte Partinë tonë, jo vetëm që do t'i bëhej një luftë totale armikut dhe tradhëtarëve, jo vetëm që do të konsolidonte ushtrinë dhe pushtetin e ri që po ngrinim, por kjo do të ishte forca dhe baza e shëndoshë

në kohën e paqes për realizimin e qëllimeve tona. Partia jonë, që udhëhoqi masat e gjera në luftë dhe që ngjalli ndër to dashurinë për të, në kohë paqe duhej t'i drejtonte këto masa, t'i lidhte fort pas vijës së saj për t'i çuar në socializëm. Kjo ishte detyra kryesore e Frontit në periudhën pas Plenumin të Beratit. Konditat për të shkuar në këtë rrugë në prakun e çlirimt të plotë të Shqipërisë kanë qenë të favorshme nga pikëpamja politike dhe ushtarakë. Por ta kuptosh Frontin të shkëputur nga problemet vitale të vendit, ta kuptosh vijën politike të Frontit të veçantë nga vija ekonomike dhe sociale dhe nga qëndrimi kundrejt politikës së jashtme, do të thotë ta kuptosh keq dhe natyrisht ta zbatosh keq. Në Front mund të hynin dhe njerëz të lëkundshëm me përjashtim të armiqve, të cilët na kishin luftuar hapët dhe me armë. Këtyre të fundit duhej t'u mbyllej dera. Për njerëzit e lëkundshëm, që mund të futeshin në Front, shumë pak shpresë kishim se ata do ta përqafonin vijën e Frontit, por duke i futur në Front, ne përpiquehim të shkëputnim nga ta, rrethin e tyre të gënjer e që e influenconin në démin tonë. Njerëzit me dy faqe e me qëllime të këqia duhej të luftoheshin brenda Frontit për t'i demaskuar keqas. Prandaj këtu s'është çështja pse hyri Cen Elezi o Jahja Çaqi në Front; ata mund të janë formalisht në Front, por kur qëndrimi të jetë i drejtë dhe i palëkundshëm në çështjen e vijës dhe në zbatimin e saj, diferencimi bëhet shumë shpejt. Armiku do të përfitojë nga qëndrimet jo të matura dhe jo të drejta për të sabotuar në çdo gjë. Në përgjithësi roli i Frontit nuk është kuptuar drejt. Ai me të vërtetë është një organizatë e gjerë masash, por është i lidhur ngushtë

me Partinë dhe i udhëhequr prej saj. Kjo lidhje nuk mund të bëhet vetëm nëpërmjet një konference formale pa kuptim ose me subjekte që ju ka shkuar koha, por nëpërmjet gjithë jetës së pushtetit, nëpërmjet problemeve konkrete dhe vitale të ekonomisë, nevojave të masave të gjera të popullit që luftuan kaq vjet me radhë dhe që kërkojnë të shohin realizimin e tyre në jetë. Lufta për realizimin e këtyre masave dhe realizimi vetë i reformave, për të cilat luftoi populli ynë, kjo është ajo që i lidh masat e gjera të popullit me Partinë tonë, kjo është e vetmja formë që e bën Frontin një realitet. Mobilizimi i masave rrëth problemeve të pushtetit dhe të vendit, që janë zgjidhja dhe e problemeve individuale të gjithsecilit, kjo është via politike e Frontit. Të kërkosh ta mobilizosh popullin në Front me të tjera përralla, kjo do të thotë të rrahiësh ujë në havan. Duke e parë vijën e Frontit në këtë prizëm, domethënë të lidhur ngushtë dhe në harmoni me politikën e brendshme dhe të jashtme, me politikën ekonomike dhe sociale arrijmë në konkluzionin se në vijën tonë janë shfaqur tendenca oportuniste. Ç'ka ndodhur? Në prakun e çlirimit të Shqipërisë duheshin të merreshin menjëherë një tok masash si: shtetëzimi i minierave, reforma agrare, masat kundër kriminelëve të luftës dhe tatim-fitimet e jasht-zakonshme kundër tregëtarëve të mëdhenj spekulatorë. Këto masa të drejta dhe të domosdoshme duhej të shërbenin si mbështetje për të forcuar pozitat tona politike dhe ekonomike, për të realizuar sa më shpejt reformat më të guximshme qofshin këto ekonomike ose politike. Masa të tilla të drejta dhe të zbatuara mirë jo vetëm që duhej të çoheshin deri në fund pa lëkundje

dhe pa tronditje, por e kundërtë do të ishte e dëmshme. Përballë qëndrimeve të tilla të drejta dhe të prera si: forcimi i sektorit të shtetit, kontrolli mbi sektorin privat të ekonomisë, qëndrimi i drejtë ndaj aleatëve, reaksioni i brendshëm dhe i jashtëm do të luftonte me aq ashpërsi sa i drejtë dhe i vendosur të ishte qëndrimi i Partisë. Njëkohësisht do të bëhej diferencimi i reaksionit dhe konsolidimi i pozitave të Partisë në popull.

Po të analizojmë veç e veç çdo sektor të aktivitetit tonë, do të shohim një analogji simptomatike në qëndrimet dhe në rezultatet e punës. Këto nuk kanë qenë ato që duhet të ishin. Kjo s'do të thotë se vija politike e Partisë ka qenë e gabuar dhe oportuniste, por faktet tregojnë se oportunizmi kish filluar të bënte fole dhe të bëhej i rrezikshëm. Në çështjen e vetë Frontit, në qëndrimin politik kundrejt mbeturinave të reaksionit është mbajtur një qëndrim oportunist, i cili ka arritur derisa të bëhet një rrezik për Partinë dhe për pushtetin. Me forcimin e Frontit, domethënë me grumbullimin e masave të gjera të popullit rreth Partisë dhe pushtetit, rreth problemeve vitale të tyre, duhej të kuptohej njëkohësisht mirë, lufta e paprerë dhe e ashpër që u duhej bërë mbeturinave të fashizmit, reaksionit të brendshëm dhe të jashtëm, i cili i hutuar për një çast do të ngrinte kokë dhe do të organizohet kundër pushtetit, kundër reformave. Rreziku që na vinte prej këtej nuk u çmuar sa duhej. «Reaksionin do ta mundim me luftë dhe në luftë», «sektorin privat do ta mundim me luftë» e të tjera «teorira» të tilla përmendeshin vazhdimisht, po në praktikë harrohej se ishim në luftë me reaksionin dhe me sektorin privat të ekonomisë dhe duhej ta vazhdo-

por te Bashkimi Sovjetik, sido që populli ynë s'e njihte mirë realitetin mbi BRSS. Qëndrimi i drejtë i Partisë sonë kontribuoi pa masë për t'ja forcuar këtë besim. Dhe qëndrimi i saj gjatë gjithë luftës ka qenë i drejtë, ashtu si ka qenë i drejtë përgjithësisht ndaj anglezëve, amerikanëve dhe ndaj misioneve ushtarake të këtyre që ishin në Shqipëri. Aktiviteti i dëmshëm i oficerëve anglezë dhe amerikanë që vepronin në Shqipëri u frenua me të gjitha mjetet; u ruajtëm nga kurthet që kërkonin të na ngrinin për të na tërhequr në qëndrime të gabuara që do të kishin konsekuenca të rënda për vendin tonë.

Pas çlirimit të Shqipërisë pozita jonë ndërkombëtare nuk mund të themi se s'ishte e fortë, bile ishte shumë më e fortë nga vendet e tjera që kishin qenë të robëruara. Ne i kishim të gjitha mundësitë dhe fushë të gjerë vepimi të zhvillonim shumë më mirë se në kohën e luftës forcimin e dashurisë dhe të miqësisë të popullit tonë me Bashkimin Sovjetik dhe të bënim diferencimin në mes të aleatëve. Për t'ja mbërrijtur këtij qëllimi jo vetëm që duhej të punohej me plan dhe me sistem, por duhej edhe manevrim i zgjuar. Por manevrimi nuk duhet të kuptohet si lëshim dhe oportunizëm. Të manevrosh në favorin tënd, për të forcuar pozitat e tua ndërkombëtare, dhe të dobësosh sa më tepër që të jetë e mundur pozitat e anglo-amerikanëve në Shqipëri — nën këtë prizëm duhet ta shikonim vijën e politikës sonë të jashtme. Atë që s'mundën dot të arrinin anglezët dhe amerikanët gjatë kohës së luftës me «Ballin Kombëtar» dhe me «Legalitetin» do të përpinqeshin ta bënin në kohë të paqes, me mbeturinat e këtyre organizatave që përfaqësonin reaksionin e vendit tonë. Pozitat tona ndërkombëtare do

të forcoheshin shumë e më shumë kur ne të forconim pozitat tona brenda, domethënë Frontin, ekonominë, pushtetin dhe të krijonim në masat e gjera të popullit një dashuri të vërtetë dhe me baza të shëndosha për Bashkimin Sovjetik. Që ta bënim këtë gjë duhej patjetër që populli të dallonte qartë se cilët janë aleatët e tij të vërtetë, të fortë dhe të sinqertë. Kjo gjë nuk mund të arrihej pa bërë diferencimin në mes të aleatëve dhe populli të shihte qartë realitetin. Ne kishim fushë të gjerë dhe raste të shumta që mund të ecnim pa frikë dhe pa ndrojtje se cënonim qoftë dhe një grimë kuptimin e aleancës së madhe dhe ruajtjen e paqes, që është e domosdoshme për të gjithë kombet. Ne duhej të koordinim politikën tonë me atë të Bashkimit Sovjetik, çdo veprim i ynë të ndihmonte Bashkimin Sovjetik në veprën e tij të madhe, pse ky ishte dhe interes i ynë. Populli ynë duhej të mësonte nga Bashkimi Sovjetik, jo në mënyrë formale, por me të gjitha ndjenjat dhe aspiratat, në të gjithë sektorët e aktivitetit të tij shoqëror dhe ekonomik. Për ne dhe për gjithë popullin Bashkimi Sovjetik duhet të jetë atdheu i madh i socializmit për forcimin e të cilit duhet të kontribuojë fuqimisht dhe vendi ynë i vogël. Mund të thotë ndonjëri që s'mund të ketë anëtar partie që të mendojë ndryshe. Kjo është e vërtetë, por mund të ketë anëtarë partie që të mos përdorin të njëjtën taktkë për t'ja mbërrijtur këtij qëllimi, dua të them, që mund të ketë anëtarë partie, që duke e pasur këtë qëllim, të kenë njëkohësisht një taktkë të gabuar dhe oportuniste për këtë çështje. Pikërisht kështu ka ndodhur dhe te ne. Është e vërtetë që në shtypin tonë është folur dhë është shkruar për Bashkimin Sovjetik, por jo

sa duhet e si duhet dhe s'kanë qenë mjetet teknike që e kanë ndaluar, por pikëpamja e gabuar se nuk duhej t'i ndanim aleatët nga njëri-tjetri duke folur më shumë për njërin dhe më pak për tjetrin. Ka dominuar çështja e njohjes së qeverisë. Kjo ishte një gjë që na preokuponte, ashtu si na preokuponin dhe çështjet e tjera ndërkomëtare, mbledhjet ku ne duhej të ftoheshim sepse e meritonim, si në konferencat e ndryshme ndërkomëtare etj. Por ekzistonte edhe një pikëpamje e gabuar se duhej edhe me sakrifikue diçka për t'ja arritur këtij qëllimi, d.m.th. jo vetëm me fjalë, por edhe me qëndrime konkrete t'u linim të kuptionin aleatëve anglo-amerikanë se këtu kishte një demokraci liberale. Qëndrimi i butë kundrejt reaksionit, qëndrimi oportunist kundrejt ekonomisë private, lëkundjet përsa i përket vjeljes së tatimeve të jashtzakonshme, përpilimi i listave elektorale dhe përbërja e tyre, e më në fund qëndrimi dhe kuptimi që ju dha notave anglo-amerikane në lidhje me njohjen e qeverisë dhe më vonë çështja e traktateve me amerikanët, e cila qëndroi një çështje e brendshme e Byrosë, të gjitha këto le që ishin një qëndrim oportunist kundrejt anglo-amerikanëve, por njëkohësisht kri-jonin në popull një efekt të kundërt me çka synonim ne të arrinin në lidhje me popullarizimin e Bashkimit Sovjetik.

Qëndrimi kundrejt aleatëve, me shtyp dhe me gojë i njëllojtë me atë kundrejt Bashkimit Sovjetik shkaktoi që në popull të krijohej opinioni se çështja e njohjes së qeverisë sonë nga anglo-amerikanët është një konditë sine qua non për regjimin popullor në Shqipëri. Këtij qëllimi synonin t'ja arrinin anglo-amerikanët, këtë favor

kërkonte reaksioni i brendshëm për të pasur kohë të riorganizohej. Kjo nga njëra anë, dhe shumë lëshime të tjera, i kanë dhënë shpresat dhe e kanë inkurajuar borgjezinë reaksionare të përpinqet të orientojë marrëdhënjet tonë ekonomike drejt Perëndimit dhe në radhë të parë drejt Italisë, ndaj së cilës nuk është mbajtur një qëndrim si kundrejt një shteti që ka detyrime të mëdha ndaj vendit dhe popullit tonë.

Pozita e kompromisit me reaksionin në vijën politike të Frontit u reflektua dhe në politikën ekonomike. Nuk është çështja këtu të numërojmë masat që janë marrë si shtetëzimi i minierave, ose zbatimi i reformës agrare, por është çështja se si kuptohej në realitet forcimi i sektorit të shtetit dhe sektori i kooperativave. Sektori i kooperativave deri në kohët e fundit ishte një letër e vdekur. Kjo gjendje nuk është vetëm pasojë e neglizhençës, ajo i ka rrënjet gjetiu dhe është më serioze në realitet. Ajo është e lidhur me ekzistencën e sektorit privat të ekonomisë. Kundrejt kapitalit privat dhe sektorit privat të ekonomisë u mbajt një qëndrim mjaft liberal dhe oportunist. Jo vetëm që s'mendohej seriozisht të vihej një kontroll i shëndoshë mbi veprimtarinë e tij, të kufizohej spekulimi dhe tregu i zi, me masa drakoniane dhe njëkohësisht të drejta, por i premtoset përkrahje dhe ndihmë nën pretekstin e aktivizimit të iniciativës private dhe të nxitjes së prodhimit. Flitej për «eksperiencën e madhe» të tregëtarëve të mëdhenj, nga e cila duhej «të përfitonim»; flitej t'u hapnim kredi në bankë atyre që ishin të tatuar për t'u lehtesar pagesat dhe për t'i lënë në qetësi të vazhdonin eksperiencën e tyre në kurrizin tonë; flitej për ndalimin e masave të

ashpra, po të drejta kundrejt tregëtarëve të mëdhenj të tatuar, por kurrë s'flitej seriozisht dhe të ndërmirrej çështja e ngritjes së sektorit të kooperativave. Kjo natyrisht do të thotë të mbash një qëndrim oportunist ndaj sektorit privat të ekonomisë; kjo do të thotë ta dobësosh sektorin e shtetit dhe të kooperativave. «Në luftë do të mundet kapitali privat», thuhej, por pikërisht kjo luftë s'po bëhej dhe evitohej të bëhej. Lufta ishte zbutur në të gjithë sektorët dhe kjo e kishte burimin në tendencën e theksuar oportuniste që shfaqej në vijën politike. Kjo gjë nuk ishte e mundur të shihej përnjëherësh dhe të merreshin masat, pse, si thashë edhe më lart, ne s'kemi arritur në atë gradë pjekurie që të ecim pa ju nënshtuar influencimit, i cili kur është jo i drejtë, të çon në qorrsokak. Por kjo s'do të thotë aspak se çështjet kanë shkuar në Byronë tonë pa diskutime dhe pa kundërshtime rreth vijës politike, kundërshtime që kanë shkuar kurdoherë duke u thelluar derisa u arrit në dy tendencia të ndryshme, siç u konstatua në mbledhjen e Byrosë, që u mbajt në datën 6 dhjetor dhe që mori fund në 11 dhjetor¹ të vitit të kaluar. Konkluzionet që tregova më lart përsa i përket vijës, në të cilat erdhi Byroja më 11 dhjetor 1945 kërkonin patjetër thirrjen e Plenumit të Komitetit Qendror për të marrë në shqyrtim vijën, për të përcaktuar drejt qëndrimet e paskëtajme dhe njëkohësisht t'i japë fund dhe zgjidhje të drejtë,

¹ Në dhjetor 1945 Byroja Politike e KQ të PKSH kritikoi dhe dënoi veprimtarinë oportuniste të Sejfulla Malëshovës. Por edhe pas kësaj mbledhje Sejfulla Malëshova vazhdoi të mbronte me këmbëngulje pikëpamjet e tij.

situatës së krijuar në Byronë e KQ të Partisë ku dominonin pikëpamje të kundërta në çështjen e vijës. Veçanërisht pikëpamja e Sejfulla Malëshovës ishte në kundërshtim dhe kështu është paraqitur deri në fund në të gjitha bisedimet dhe diskutimet që janë bërë rreth kësaj çështjeje me rëndësi vitale për Partinë tonë.

Tendencës oportuniste në vijën tonë i ka dhënë tonin dhe e ka mbrojtur deri në fund Sejfulla Malëshova. Por Byroja nuk mund të shfajësohet për këtë gjë, ashtu si edhe i gjithë Komiteti Qendror i Partisë nuk mund t'i shmanget përgjegjësisë përpëra Partisë. Por ka përgjegjësi kolektive, ashtu si ka edhe përgjegjësi personale dhe këtyre të dyjave Sejfulla Malëshova nuk mund t'u shpëtojë. E theksova edhe më lart se ishte e zorshme të shihej përnjëherë një tendencë e tillë prej Byrosë, që sa kish dalë nga një provë shumë e vështirë si ajo e Beratit. Nga ana tjetër, mungesa e eksperiencës në një etapë të re, e bënte më të zorshme këtë punë. Por prapë, punët në Byro, sikundër e thashë edhe më lart, nuk shkonin pa diskutime të ashpra, qoftë për çështjen e ushtrisë, për reformën agrare, për qëndrimin ndaj aleatëve, qoftë dhe për politikën ekonomike.

Në çështjet ekonomike, Sejfullai është përpjekur të tregohet si njeriu që ka eksperiencë të madhe në këto çështje dhe Byroja e kishte caktuar të drejtonte Këshillin Ekonomik. Çështja ekonomike është një kyç i dorës së parë në punën tonë, e cila influencon në të gjithë punën që zhvillohet në sektorët e tjera të aktivitetit të shtetit. Sejfullai jo vetëm që nuk ishte në gjendje të drejtonte si duhej këtë sektor me rëndësi kaq të madhe, por ai ka qenë kurdoherë partizan i një farë liberalizmi

të tepruar, që shkonte deri në oportunizëm. Çështja e shtetëzimit të minierave, të Bankës Kombëtare të Shqipërisë e të tjera të këtij lloji, është një gjë, po tjetër gjë është, që, i bazuar në këto fitore, të drejtosht sektorin e shtetit si duhet duke e forcuar dita-ditës. Kundrejt sektorit privat të ekonomisë Sejfullai ka mbajtur kurdoherë një qëndrim të lëkundshëm dhe shumë herë oportunist; ky sektor konsiderohej prej tij edhe si një mbështetje e sigurt për shtetin. Këtë ai e arësyetonte duke thënë se kapitali privat ishte mjaft i fortë dhe i konsiderueshëm dhe se privatët, në këtë kohë të parë, ishin më në gjendje të administronin më mirë dhe të drejtonin më me sukses një ndërmarrje sepse ishin të pajisur me eksperiencë. Për çështjen e reformës agrare, Sejfullai ishte i mendimit që jo vetëm pjesa që ju caktohej bujqve pronarë, të ishte më e madhe se ç'është sot, por ishte i mendimit që me zbatimin e reformës duhej të mbrohej dhe fshatari i pasur. Tendenca për të lehtësuar të tatuarit për fitimet e jashtzakonshme të luftës, azhurnimi i pagesave ose dhënya kredi nga ana e Bankës së Shtetit elementëve kapitalistë, të gjitha këto dhe shumë të tjera jo vetëm që tregonin një tendencë oportuniste të theksuar në pikëpamjen e tij mbi politikën tonë ekonomike, por kanë pasur dhe reperkusionë në zhvillimin e punës dhe në tregun tonë. Me krijimin e import-eksportit, në baza të gabuara dhe me njerëz të pakontrolluar si edhe nga fryma që mbizotëronte në Këshillin Ekonomik, për arësyte të pikëpamjeve që treguan më lart, u arrit të krijohej pikëpamja për ta orientuar tregëtinë e jashtme drejt Italisë.

Në çështjen e politikës së jashtme, Sejfullai ka qenë

kurdoherë partizan i një politike të butë dhe oportuniste kundrejt anglo-amerikanëve dhe e nënvleftësonte më tepër se kushdo tjetër rrezikun e reaksionit të jashtëm. Ai kujtonte se duke u bërë koncesione anglo-amerikanëve, qoftë në qëndrimet tona të përditshme, qoftë duke u dhënë dhe nga një koncesion të vogël, do të shpejtohej njohja e qeverisë dhe do të normalizohej situata jonë ndërkombëtare. Një pikëpamje e tillë u duk më e qartë me ardhjen e notave anglo-amerikane në lidhje me njohjen e qeverisë. U muar për njohje ajo që s'ishte njohje dhe u vu në një plan me njohjen e qeverisë nga Bashkimi Sovjetik. Megjithëse u pa gabimi dhe nuk u shkua më tej, Sejfullai insistonte në mendimin e tij se ato ishin akt i njohjes. Përsa i përket konditës amerikane, për njohjen e traktateve që ekzistonin në mes të dy shteteve, Sejfullai ka qenë partizan i pranimit të tyre në parim. Ai ka qenë në kundërshtim me pjesëtarët e tjerë të Byrosë, që nuk e pranuan këtë konditë, sepse kjo na angazhonte të pranonim traktatë që ishin në dëm të vendit tonë dhe cënonin pavarësinë dhe indipendençën e shtetit tonë.

Në çështjen e Frontit dhe në politikën tonë të brendshme, Sejfullai ishte ai që mbronte tezën e zgjerrimit të Frontit me sa më shumë elementë, qofshin këta dhe armiq. Ai ishte mbrojtësi i një politike të butë me klerin katolik dhe njëkohësisht për një koalicion me të në çështjen e zgjedhjeve.

Sejfulla Malëshova në diskutimet që janë bërë në Byro, në lidhje me çështjen e vijës, ka qëndruar kurdoherë dhe deri në fund në pikëpamjet e tija, domethënë se në vijën tonë jo vetëm që s'ka shfaqje të oportuniz-

mit, por e kundërta. Përveç asaj ai ka pranuar se «në Byro ka pas diskutime dhe kundërshtime, por është arritur të merren vendime dhe në vendime kemi qenë të gjithë të një mendjeje». Kjo nuk është e vërtetë. Që Byroja është influencuar në këtë drejtim, kjo s'ka asnë dyshim, dhe pikërisht këtu qëndron përgjegjësia e saj, që nuk ka vepruar për ta ndaluar një gjendje të tillë. Këtu, sipas mendimit tim, janë dy çështje: e para, çështja e vijës dhe zbatimi i saj, dhe e dyta, përgjegjësia e Byrosë dhe e Sejfulla Malëshovës veçanërisht. Që Sejfulla Malëshova është ai që i ka dhënë tonin kësaj tendencë të theksuar oportuniste, kjo, s'ka asnë dyshim. Këtë gjë e provon qëndrimi i tij në pozitat e gabuara bile deri para pak ditësh, kur ai shprehu mendimin se «me të vërtetë s'e kishte parë mirë çështjen, se kishte gabuar», pohimi i tij, sipas mendimit tim, nuk ka qenë i singertë dhe bindës.

Këto dy gjëra me rëndësi, që kanë lidhje me çështjen e vijës dhe me përbërjen e Byrosë, duhet t'i marrë në diskutim serioz Komiteti Qendorr i Partisë.

* * *

Spastrimi i këtyre tendencave të sëmura paraqitet urgjent dhe ky duhet të bëhet radikalisht. Njëkohësisht gjithë Komiteti Qendorr, i cili ka edhe ai përgjegjësinë e vet në këtë gjë, duhet që, jo vetëm ta ketë të qartë vijën që duhet të ndjekim paskëtaj, por të ketë gjithash tu kujdesin e madh në zbatimin e mirë të saj dhe në kontrollin njëkohësisht, pse shumë shokë, sipas mendimit tim, qofshin të Byrosë ose të Komitetit Qendorr,

nuk janë treguar në lartësinë e funksioneve që ju kësuar Partia. Pa rrëshqitur në gabime alarmante, këta kanë treguar një indiferentizëm dhe një plogështi jo vetëm në kuptimin e çështjeve, por sidomos në zbatimin e tyre. Komiteti Qendror jo vetëm që duhet të jetë një forum me të vërtetë drejtues i Partisë sonë, por çdo anëtar i tij duhet të jetë një autoritet në gjithë organizatën. Ky autoritet të krijohet me zotësinë e tij, me pikëpamjet e tij të qarta në çdo gjë, me punën e tij në sektorin që i ngarkohet. Kjo punë të kryhet prej tij si prej një udhëheqësi dhe jo si prej një anëtari të thjeshtë. Anëtari i Komitetit Qendror, duhet të jetë shembull jo vetëm i një aktiviteti të palodhur dhe pozitiv, por shembull për të gjithë si udhëheqës me pikëpamje të gjera dhe të qarta politike dhe organizative. Këto i them, që diskutimet që po bëjmë në mbledhje të ndryshme të plenumit, të mos merren si çështje që i takojnë një ose dy personave, por që i takojnë gjithë Partisë dhe në radhë të parë gjithë Komitetit Qendror, i cili është po aq përgjegjës sa Byroja për mbarëvajtjen e punës.

Do të jetë gabim të kuptohet, sikundër ka ngjarë zakonisht pas një mbledhjeje plenumi, sikur ne dalim tani me një vijë të re dhe që këtë vijë e shtrojmë për herë të parë. Kjo s'është e vërtetë dhe do të jetë e dëmshme në rast se paraqitet në organizatë në mënyrë të tillë. Posaçërisht në këtë gjë tërheq vëmendjen tuaj që të keni kujdesin më të madh në paraqitjen e këtyre çështjeve përpëra organizatës. Një paraqitje joserioze dhe e pastudjuar mirë, fare lehtë mund ta çorientojë një organizatë të Partisë ose gjithë Partinë. Partia ka

pasë një vijë, ka pasë një program me të cilin ka punuar dhe ka korrur suksese, por, në këtë vijë është dukur e theksuar një tendencë oportuniste, që ka krijuar situata të vështira në sektorët e ndryshëm, që ka penguar shkuarjen përpara me atë ritëm që dëshërojmë të shkojnë punët, ka lejuar krijimin e situatave që mund të bëhenë kërcënuese për vendin tonë, në rast se nuk shikoheshin me kohë, në rast se nuk qëndrohej zgjuar në disa sektorë dhe nuk u pritej hovi. Pikëpamjet oportuniste nuk e kanë zhdukur aspak mundësinë që poshtë në organizata ose në pushtet, të shfaqeshin pikëpamje sektare. Këto dy tendenca pjellin njëra-tjetrën. Pra sot nuk shtrojmë një vijë të re, por analizojmë gabimet dhe tendencat e gabuara që janë dukur në këtë vijë dhe përcaktojmë e vëmë pikat mbi qëndrimet që duhet të mbajmë paskëtaj duke mësuar nga këto gabime që kemi bërë.

Plenumi i Beratit duhet të bënte një kthesë në punët tona të Partisë dhe të pushtetit. Deri ku u bë kjo kthesë, nuk mund të matet me metro, por sipas mendimit tim mbetet shumë për të dëshiruar. Një kohë e gjatë ka shkuar që prej Beratit dhe deri tani; Partisë sonë ju shtua edhe një kohë e gjatë me një eksperiencë të re në drejtimin e gjithë sektorëve të shtetit dhe, tamam të armatosur me këtë eksperiencë të re, ne duhet të vëmë në dukje si duhet përpara Partisë gabimet dhe të metat tona si nga pikëpamja politike, ashtu dhe nga pikëpamja organizative. Të bëjmë që Partia të ringjallet, të marrë jetë, të ecë me një frymë dhe me një stil të ri, duke i zotëruar mirë çështjet dhe duke i zbatuar si duhet. Kjo përsëri është një kthesë dhe një kthesë serioze, por

organizata duhet të kuptojë esencën e vërtetë të kësaj kthese dhe jo si ajo celula e Partisë që thosh: «Mirë, atë kthesën e jashtme e kuptova, por këtë kthesën e brendshme s'e kuptoj».

Shkuarja në socializëm nuk bëhet as duke ndénjur me duar kryq dhe as duke mbajtur qëndrime të lëkundshme dhe oportuniste; këtë organizatat duhet ta kuptojnë mirë. Kjo gjë është e kondicionuar me situatën e jashtme, por sidomos me situatën tonë të brendshme. Forcimi i situatës sonë të brendshme shpejton këtë proces, dhe kjo gjë arrihet me qëndrime të drejta dhe të vendosura.

- *Politika jonë ekonomike* duhet të na preokupojë në radhë të parë. Është sot çështja më e zorshme, më delicate dhe më e rëndësishme. Kjo do të influencojë në të gjithë sektorët e punës sonë. Këtu duhet të përqëndrojmë gjithë forcat tona, sepse këtu pregetitet edhe armiku të na godasë. Problemi ekonomik nuk mund të konsiderohet vetëm çështje e pesë ose e dhjetë specialistëve, por problem i gjithë masave të popullit tonë, të cilat duhet të mobilizohen realisht për zgjidhjen e këtij problemi vital për popullin dhe për pushtetin. Për zgjidhjen e këtij problemi kaq të madh, duhet të mobilizohen njëkohësisht energjitetë si nga pikëpamja teknike e organizative, ashtu edhe politike. Po më parë çështja duhet shtruar drejt. Ekzistenca e shtetit tonë dhe e ardhmja e tij janë të lidhura ngushtë me ekzistencën e forcimin e sektorit të shtetit dhe atë të kooperativave. Forcimi i sektorit të shtetit, nuk bëhet vetëm me shtetëzimin e minierave, me shtetëzimin e bankave, me kontrollin mbi sektorin privat dhe me monopolin e

tregëtisë së jashtme, por me organizimin e gjithë këtyre sektorëve dhe me krijimin e një industrie të rëndë shtetërore, e cila të jetë ndihmësja kryesore e ngritjes së industrisë së lehtë dhe e gjithë zhvillimit ekonomik të vendit tonë. Organizimi, shtimi i prodhimit si dhe përmirësimi i tij duhet të jenë në rendin e ditës. Organizimi i mirë dhe i shëndoshë i shfrytëzimit të minierave tona do t'i japë një gjallëri të vegantë industrisë së vogël në vendin tonë dhe që të dyja këto duhet të jenë në duart e shtetit. Deri tani në vendin tonë kapitali i borgjezisë është hedhur më shumë në lëmin e tregëtisë. Tani, duke mos parë asnje shteg për këtë zhvillim, ky kapital do të tentojë të shtrihet në zhvillimin e industrisë për të kriuar baza mbështetjeje për të na luftuar dhe për të mbytur ekonominë tonë. Këtë ne nuk duhet ta lejojmë në asnjë mënyrë. Përkundrazi me një kontroll të rreptë, ne duhet jo vetëm të detyrojmë pronarët e fabrikave private të punojnë në drejtimin që i cakton shteti, por edhe prodhimet që nxjerrin, të kontrollohen dhe të administrohen ashtu si e sheh të arësyeshme shteti. Të gjitha këto masa duhet të merren dhe të ndiqet zbatimi i tyre me rigorozitetin më të madh në mënyrë që brenda një kohe të shkurtër, shteti të bëhet zot i këtyre fabrikave të vogla dhe kjo industri të shkrihet në sektorin e shtetit. Kapitalit privat duhet t'i presim të gjitha mundësitë që të zhvillohet dhe të forcohet. Çdo lëshim në këtë drejtim do të thotë të lësh borgjezinë të forcohet, të lësh të krijohet një klasë e re borgjeze industriale që të pengojë shkuarjen tonë drejt socializmit. Kontrolli mbi sektorin privat të ekonomisë do të ushtrohet njëkohësisht me kufizimin e

tregut qoftë të brendshëm, qoftë të jashtëm. Shteti duhet të jetë i vetmi që të bëjë tregëtinë e jashtme, kurse në tregun e brendshëm ai duhet të ushtrojë kontroll mbi të gjitha mallrat më të rëndësishme. Kjo do të arrihet me anë të kooperativave të konsumit dhe të prodhimit, me anë të dyqaneve të shtetit që duhet të çelen në një shkallë të gjerë, me anë të enteve të ndryshme. Puset e vajgurit, minierat tona të bakrit, të serës, të kromit përbëjnë sektorin shtetëror më të rëndësishëm. Këtij sektori duhet t'i kushtojmë kujdesin më të madh pse është mbështetja më e rëndësishme e ekonomisë sonë. Në shfrytëzimin maksimal të tyre do të mbështetet buxheti ynë dhe pra ndihma për sektorët e tjera. Kapitali privat dhe borgjezia reaksionare e vendit tonë, e ndihmuar dhe nga reaksiioni i jashtëm, do të na bëjnë luftën më të ashpër në këtë sektor. Ndihmë për realizimin e planit tonë ekonomik ne do të kemi nga Bashkimi Sovjetik. Të mendosh se do të kesh përkrahje nga Perëndimi, do të thotë të mendosh gabim. Zgjerimi dhe forcimi i sektorit të shtetit, nuk mund të arrihet pa pasur një plan pune të caktuar dhe të harmonizuar për të gjithë degët e ekonomisë. Shfrytëzimi i minierave në mënyrë të përsosur, aktivizimi i industriës së lehtë, kontrolli i sektorit privat të ekonomisë, zhvillimi i tregëtisë së jashtme, ngritja e kooperativave dhe e dyqaneve të shtetit, janë një kompleks i tërë, për të cilin lypset një organizim i fortë, krahas planit të punës dhe të koordinimit. Por aktivizimi politik i masave për përkrahjen e këtij sektori, për një punë të palodhur dhe sistematike, për sakrifica dhe vetëmohim të jashtzakonshëm, është më se i domosdoshëm. Këtu

duhet të përqëndrohet puna e Frontit në lidhje me politikën ekonomike.

Ky është kursi që ne duhet të ndjekim në ekonomi. Çdo gjë për forcimin e sektorit të shtetit; luftë të pamëshirshme kapitalit privat; ndihmë sa më të madhe nga ana e shtetit kooperativave të konsumit dhe të prodhimit dhe këto të bëhen një mbështetje e madhe përtë. Zgjerimi dhe forcimi i sektorit të shtetit është në rendin e ditës, është një nga punët më të rëndësishme që na vihen përpara. Këtu nuk do të ndalem aspak në format organizative që do të na ndihmojnë në zhvillimin e këtij sektori si edhe në metodën e punës që duhet të ndjekim, por do të përpinqem të përcaktoj gjendjen e këtij sektori dhe perspektivat tona.

Të gjithë jemi në dijeni se në ç'gjendje ndodheshin minierat tona në prakun e çlirimt të Shqipërisë dhe se në ç'gjendje ishim ne. Në fillim të punës ishte një ndërmarrje e zorshme përt'i vënë të gjitha në shfrytëzim. Na mungonte organizimi, na mungonin veglat, na mungonin financat e shumë gjëra të tjera. Megjithatë kantiereve të Kuçovës, që kishin një rëndësi të madhe, pse pa naftë e benzinë nuk mund të shkohej përpara, ne u vumë një rëndësi të veçantë, kurse minierat e baku, të kromit, të serës e të qymyrgurit mbeten të pashfrytëzuara. Në kantieret e Kuçovës duhej të prodhohej karburant dhe të ngrihej administrata shqiptare. Në organizimin e punës gjetëm shumë vështirësi, por ato që hasëm në çështjet teknike ishin më të mëdha. Rafineritë ishin të shkatërruara, furnizimi i kantierit me energji elektrike ishte i vështirë. Me gjithë këto vështirësi ne mundëm të ngremë tri distileri, ngritëm

disa grupe gjeneratorësh, oficina të ndryshme e të nevojshme dhe impiantin e oksigjenit. Që prej muajit nëntor 1944 dhe deri në dhjetor 1945 ne kemi arritur të vëmë në veprim 661 puse. Në kantierin e Kuçovës mbeten akoma dhe 260 puse për t'u vënë në veprim. Konditat në të cilat është punuar deri tani përsa i përket produktivitetit nuk kanë lejuar të bëhet një studim i imtë për vlerësimin e fushës vajgurore të Kuçovës. Për t'ja arritur këtij qëllimi lypset që puset të shfrytëzohen pa ndërprerje dhe për disa muaj, në mënyrë që të nxirret prej tyre produkti real dhe që këtej do të dalë vetëveti sa produkt duhet të konsumohet. Duke qenë se konsumi (prej distilerive) në konditat e sotme qëndron rrëth 150-200 m³ naftë brut në ditë, pëmpimi i puseve bëhet në një mënyrë të racionaluar. Kjo gjë pengon në studimin e vijës së përkulur (të deklacionit) të puseve dhe të fushës vajgurore të Kuçovës. Kur gjithë puset kanë qenë në aktivitet normal, prodhimi mesatar i gazit ka qenë prej 50 000 m³ dhe i gazolinës prej 3 000 litra në ditë. Prodhimi i sotëm i gazit është 18 000-20 000 m³ në 24 orë me një prodhim gazoline prej 1 000 litra. Sasia e gazolinës, në lidhje me prodhimin e vajgurit brut, mund të shtohet deri në 2 000 litra, por kur të mos mungojë energjia elektrike.

Sipas mendimit të specialistëve të vajgurit, fusha vajgurore e Kuçovës përsa i përket produktivitetit është një fushë në rënje. Megjithatë kjo prapë qëndron për ne një këntier me rëndësi. Perspektiva jonë duhet të jetë që këto fusha të shfrytëzohen në maksimum. Pikësëpari, mendohet të shfrytëzohet në vend nafta brut pse nënproduktet e saj përbëjnë vetëm 34% të brutit që

shkon në një distilacion të parë. Pjesa tjetër që ka lëndë, si naftë të rëndë, lubrifikant dhe bitum shkon nëpër pellgje. Me impiantet e lubrifikantëve që kemi ngritur, ne prodhojmë karburant të një kualiteti 99%, por që përmbajnë një përqindje të vogël squfur, naftë, vajguri etj. Këto lëndë e bëjnë përsëri këtë karburant korozif. Me funksionimin e rregullt të tri rafinerive parashikohet pas muajit mars 1946 të kemi:

Benzinë 525 000 litra në muaj

Naftë 716 000 litra në muaj

Vajguri 356 000 litra në muaj

Mesatarja mujore nga qershori 1945 deri në janar 1946 ka qenë:

Benzinë 486 890 litra në muaj

Naftë 518 920 litra në muaj

Vajguri 178 970 litra në muaj

Në qoftë se marrim parasysh statistikat e prodhit mit brut të muajit të fundit të vitit 1943, mund të bazo hemi në një prodhim vjetor prej 144 000 ton prej të cilëve 60 000 ton nevojiten për të furnizuar distileritë dhe 84 000 ton mund të eksportohen. Por, për të mbërrijtut në prodhimin total të Kuçovës, nevojiten të ndërtohen depozita të paktën për $2\ 000\ m^3$ dhe të vihen në gjendje punimi të 25% të puseve që mbeten; gjithashtu të rregullohen transporti Kuçovë-Vlorë si dhe depot e Vlorës.

Kantieri vajguror ose më mirë fusha e Patosit,

sipas specialistëve, paraqitet shumë më e pasur se ajo e Kuçovës, vetëm se densiteti i vajgurit të Patosit, është më i madh se i atij të Kuçovës. Përveç kësaj, në Patos është më e vështirë zgjidhja e problemit të ujut të pishëm/dhe çështja e energjisë elektrike. Numri i puseve në këtë kantier arrin në 69 nga të cilët 44 janë me prodhim të mirë. Sikundërqë e dimë Patosi ka pësuar shumë dëme nga lufta, por duke marrë si bazë raportet e prodhimit të muajit gusht 1943 rezulton një sasi prodhimi ditor prej $119,6 \text{ m}^3$ naftë brut për 30 puse aktive. Në kohën kur ka qenë në aktivitet Patosi ka pasur një produkt prej 36 000 ton naftë brut. Kjo sasi transpor-tohej deri në Fier nga ku, duke u përzier me prodhimin brut të Kuçovës shkonte për në Vlorë. Për të pasur këtë prodhim, nevojitet të rindërtohet krejt kantieri i Patosit me një stacion pompimi në vend. Prodhimi brut që do të destinohej në këtë mënyrë për eksportim prej të dy kantiereve, do të ishte prej 120 000 ton.

Përpara nesh, pra, vihet shfrytëzimi urgjent i fushave vajgurore të Kuçovës dhe të Patosit. Teknikët thonë se ka mjaft vështirësi, sidomos në maqineri dhe në gjeneratorë elektrikë si dhe në mjete financiare. Shuma e parashikuar prej tyre për shpenzime për ushtrimin finansiar 1946—1947 për të dy fushat arrin në 54 887 810 franga.

Përsa i përket shfrytëzimit të minierës së serës të Selenicës ajo ka një perspektivë më të qartë dhe mundësi shfrytëzimi më të lehtë sepse nuk nevojiten maqineri sikundër në fushat vajgurore. Çështja e organizimit të punës dhe grumbullimi i punëtorëve të përshtatshëm dhe në numër të madh në këtë minierë, do-

të na lejojnë të nxjerrim një sasi të konsiderueshme sere për eksportim. Në këtë drejtim do të ecim gjatë këtij viti. Shtimi i prodhimit të serës është në rendin e ditës.

Përsa i përket kromit, shfrytëzimi i tij nuk paraqet ndonjë pengesë nga ana teknike, si pajisja e minierave me maqineri, por është i vështirë transporti i tij. Pa siguruar transportin dhe tregun ai do të jetë doradorës një kapital i blokuar.

Sa për minierat e bakrit këto janë një pasuri e rëndësishme për sektorin tonë shtetëror dhe ne duhet të kujdesemi shumë për shfrytëzimin e tyre. Mendimi i specialistëve është se, pasi të kryhen punimet e rindërtimit të minierave, ne mund të fillojmë nxjerrjen e bakrit që mund të arrijë deri në 40-50 ton në muaj në minierën e Bulshizës dhe 60-80 ton në minierën e Dervenit. Miniera e Bulshizës mund të angazhojë deri më 1000-1200 punëtorë. Gjatë vitit 1942—1943 italianët kanë arritur të tërheqin nga Bulshiza afro 20 000 ton bakër gjë kjo që ka shkaktuar varfërimin e minierës. Megjithëse specialistët nuk mund të shprehen kategorikisht për gjendjen e minierës dhe potencialin e saj, prapëseprapë minierat e bakrit konsiderohen një pasuri e madhe për vendin tonë.

Minierat në përgjithësi janë mbështetja kryesore e sektorit të shtetit; shfrytëzimi i tyre duhet të merret në studim me seriozitetin më të madh, jo vetëm për perspektivën e afërt dhe të ngushtë lokale, por njëko-hësisht duhet të mendojmë për rëndësinë që ka shfrytëzimi në maksimum i tyre për të ndihmuar aleatët tanë, Bashkimin Sovjetik dhe Jugosllavinë. Aspak s'duhet të

harrojmë fjalimin e Stalinit¹ me rastin e zgjedhjeve, ku përmendi dhe caktoi normat që duhet të arrijë produktiviteti i çelikut, i gizës dhe i mineraleve të tjera të domosdoshme. Kjo duhet të na bëjë të mendojmë se edhe ne këtu, pasuritë e nëntokës duhet t'i shfrytëzojmë për të forcuar ekonominë tonë, e cila do të jetë baza e çdo përparimi në sektorët e ndryshëm si sot, ashtu edhe në të ardhmen.

Këtçj del vetëvetiu pyetja: A do të mundim dot ne me forcat tona t'i shfrytëzojmë si duhet këto miniera në radhë të parë për interesin e vendit tonë? Ne na duket se kjo çështje është në rendin e ditës dhe do të paraqitet urgjente brenda pák kohe. Sikundërqë e dini në vendin tonë kanë ardhur një numër specialistësh sovjetikë për të na ndihmuar me pasë një ide të qartë mbi gjendjen e minierave dhe perspektivat që mund të kemi në shfrytëzimin e tyre. Nuk është shtruar çështja me ta për bashkëpunim ose për ndihma konkrete, por kjo do të vijë patjetër sepse, sipas mendimit tonë, do të ketë sektorë ku ne do të mbështetemi plotësisht në mundësitet tona, po do të ketë edhe sektorë ku ne do t'u kërkojmë ndihmë të ndryshme qoftë sovjetikëve, qoftë jugosllavëve, në materiale ose teknikë për shfrytëzimin e tyre me mundësitet tona. Njëkohësisht do të paraqitet rasti që në disa sektorë të bashkëpunohet me këta, sidomos në ato sektorë, ku ne nuk do të jemi dot në gjendje të fillojmë shfrytëzimin me forcat dhe mundësitet tona. Por çështjet duhen përcaktuar konkretisht. Kjo, sipas men-

¹ Është fjala përfi fjalimin që mbajti J.V. Stalini më 9 shkurt 1946 në mbledhjen me zgjedhësit e rrethit elektoral «Stalin» të qytetit të Moskës.

dimit tim, duhet të dalë nga diskutimet që duhet të bëjmë këtu. Pasi të kemi studjuar mirë këtë sektor kaq të gjërë dhe kaq të rëndësishëm ne duhet të dalim me vendime të caktuara. Sa për modalitetet këto mund të vijnë edhe më vonë. Bashkëpunimi në këtë drejtim me sovjetikët dhe me jugosllavët është i domosdoshëm, por ky mund të realizohet drejt kur ne të jemi në gjendje të dimë ç'kemi dhe ç'duhet të bëjmë për të shkuar përpara me një hov të madh dhe të sigurt dhe me një perspektivë të qartë.

Problemi bujqësor gjithashtu është një problem i madh që duhet të preokupojë gjithë Partinë. E kemi theksuar shumë herë rëndësinë e madhe të reformës agrare, por duhet të kemi parasysh se mungesa e bukës ka qenë kurdoherë preokupante për vendin tonë, veçanërisht vitin e kaluar, por dhe këtë vit mbetet përsëri me pikëpyetje. Ne duhet ta ngremë problemin që patjetër ta bëjmë vetë bukën e vitit dhe jo të jemi të detyruar ta importojmë nga jashtë. Ndihma dhe kujdesi që duhet t'i vërë shteti zhvillimit të bujqësisë, duhet të jetë e madhe dhe kjo ndihmë duhet të jetë e shumanshmë, si në mjete financiare, ashtu dhe në vegla. Nga ana tjetër duhet të mobilizohet gjithë Partia dhe Fronti për të nxitur në katundarët ndjenjën e punës sistematike. Ata duhet të kuptojnë rëndësinë e momentit që lyp akoma sakrifica të mëdha. Punimi i gjerë i tokës, mbjelljet dhe kursimi duhet të bëhen një çështje nderi. Problemi kryesor në bujqësi, siç thamë dhe më sipër, është sigurimi i bukës. Përveç inkurajimit nga ana e pushtetit, duhet të zhvillojmë një fushatë propagandistike me të gjitha forcat tona për të bërë që të mbillet

sa më shumë grurë e misër. Nga ana tjetër t'i japim një hov të veçantë zhvillimit të bujqësisë, të pyjeve dhe të blegtorisë.

Mirëmbajtja e pyjeve dhe pyllëzimi, veçanërisht kanë rëndësi të posaçme, si për çështjen e industrisë së drurit, ashtu dhe për përmirësimin e tokës. Përpara nesh ekziston i pazgjidhur problemi i ndërtimit të objekteve të shkatërruara nga lufta. Shqipëria ka importuar qereste, por në rast se ngremë industrinë tonë, ne jemi në gjendje jo vetëm të plotësojmë nevojat tona, por edhe të eksportojmë.

Çështja e blegtorisë ka një rëndësi të veçantë për ne. Ne duhet ta përmirësojmë racën e kafshëve tona dhe t'i shtojmë ato. Kjo, natyrisht, do të vijë kur ne të kemi ndihmuar buqit jo vetëm për të mbjellë dhe për të sigruuar ushqimin e tyre e të kafshëve, por njëkohësisht kur t'i kemi edukue për përmirësimin e këtij sektori me rëndësi. Nga një përmirësim i tillë varet suksesi i industrive tona të vogla, si ajo e djathit, e lëkurëvet, etj.

Në lidhje me bujqësinë dhe me perspektivat tona, ne duhet të ecim në krijimin e disa fermave modele, përveç këtyre që janë, ku të punohet me kujdesin më të madh jo vetëm për një prodhim më të përsosur, por që të bëhen dhe një nxitje për favorizimin dhe shpejtimin e kolektivizimit të tokave. Në këtë drejtim ne duhet të punojmë edhe për mekanizimin e bujqësisë, përkrijimin e qendrave të maqinave bujqësore të cilat të vihen në shërbim të bujqve për përmirësimin e produhit dhe të punimit të tokës. Nga ana tjetër ato të ndihmojnë në nxitjen e kolektivizimit. Duhet të inkurajojmë

zhvillimin e kurseve për bujqësinë dhe për mekanikën bujqësore. Duhet të futim në prodhim dhe drithëra ose prodhime të tjera, që bujku ynë nuk jua di akoma vlefthen dhe rëndësinë. Kjo, natyrisht, lyp jo vetëm kujdesin e specialistëve që punojnë në këtë drejtim, por edhe një punë politike të palodhur nga ana e Partisë dhe e organizatave të masave.

Politika arësimore. Nuk mund të themi se ne nuk kemi qenë të preokupuar për çështjen arësimore që prej Plenumit të Beratit dhe deri tani. Por me thënë se kemi pasur një politikë arësimore të përcaktuar mirë edhe kjo nuk do të ishte ekzakte. Politika jonë arësimore ka konsistuar vetëm me hapë shkollat e vjetra që kanë qenë, me hapë sa më shumë shkolla fillore dhe me inkurajue arësimin sa më shumë në popull. Por kjo s'është e mjaf-të, bille problemi nuk është kapur si duhet. Problemi i arësimit është shumë i gjerë dhe i rëndësishëm. Sikundërqë bëmë një revolucion të madh në lëmin shoqëror dhe ekonomik, ashtu dhe në atë kultural e arësimor duhet të ecim me po atë ritëm. Veçse këtu gjejmë mjaft pengesa serioze. Në radhë të parë është çështja e kuadrit arësimor, i cili do të pregetitë kuadrot e brezat e ardhshëm me atë frymë që kërkojmë ne. Arësimi në Shqipëri ishte privilegji i një pakice, prandaj fatkeqësisht numri i arësimtarëve në përgjithësi është i paktë përparrë nevojave që na paraqiten. Në radhë të dytë, dhe që ka një rëndësi të dorës së parë për ne, është çështja e programeve, të cilave duhet patjetër t'u bëhet një revision dhe me hartue programe të reja, me frymë të re, të bazuara në programet sovjetike dhe të adaptuara përvendin tonë dhe për konditat tona. Kjo është një gjë

urgjente dhe e domosdoshme. Sikundërqë gjithë politikë janë tështë orientuar nga Bashkimi Sovjetik, ashtu duhet të orientohet dhe në fushën e arësimit tonë. Përveç këtyre dy çështjeve me rëndësi, siç është ai i kuadrit dhe i programeve të shkollave, rrjedh vetëvetiu dhe çështja e revizionimit të shkollave që ekzistojnë tani në vendin tonë. Sipas orientimit që duhet t'i japim zhvillimit të vendit, ashtu duhet të krijojmë dhe shkollat. Shkollat që janë çelur në Shqipëri, jo vetëm që janë ngritur sipas kriterit të vjetër, por janë mbajtur dhe ruajtur, në mos shtuar, numri i liceve dhe i gjimnazeve. Sa për shkollat industriale ose teknike ato janë shumë mangut. Çështja tjetër që duhet të na preokupojë në arësimin e shtëorientimi i masave të gjera të fshatit dhe të punëtorëve që të edukohen dhe të marrin arësimin në dorë. Arësimi të mos jetë më një armë në dorë të borgjezisë, por në dorë të punëtorëve dhe të fshatarëve. Shteti këtu duhet të vëré gjithë përkrahjen dhe kujdesjen. Përveç çështjes së shkollave brenda në vendin tonë, vihet dhe problemi i edukimit të masave të gjera të popullit, jo vetëm me luftën kundër analfabetizmit, por me dhënjen e një edukate të përgjithshme, me krijimin e kurseve të ndryshme dhe të universiteteve popullore. Këtu po e prek në përgjithësi dhe në vija të trasha çështjen e arësimit, e cila sigurisht e shtë më e gjerë dhe që këtej ne duhet të dalim me një vijë të përcaktuar mirë e qartë dhe në bazë të kësaj të punohet qysh tani për vitin e ri shkollor.

Që të mund të zbatojmë si duhet politikën tonë ekonomike si dhe çështjet e tjera në radhë të parë ne duhet të kemi *pushtetin* të fortë. Dhe kjo duhet të kupto-

het drejt, sepse në këtë çështje ka pasë edhe pikëpamje e tendenca të gabuara, qoftë oportuniste, qoftë sektare. Pushteti ynë është një pushtet popullor, por kjo s'duhet të mbetet vetëm në parim, por të bëhet një realitet. Pushteti duhet të jetë një pushtet popullor dhe demokratik si në strukturën e tij, ashtu edhe në përbërjen dhe përmbajtjen e tij. Për t'ja arritur plotësisht kësaj ne duhet të bëjmë akoma shumë. Në të vërtetë këshillat, qofshin ato të bazës, qofshin ato të nënprefekturave, o prefekturave, në shumë raste kanë mbetur formale, nuk e kryejnë detyrën e vërtetë të tyre ose ndër to është e theksuar mënyra e punës së vjetër, dua të them e regjimeve të kaluara. Pushteti është çdo gjë për ne dhe mjeti që do t'i zgjidhë të gjitha çështjet, prandaj ai duhet të jetë nga më modernët si në strukturë, si në përbërjen e personelit, si në përmbajtje. Nevoja për specialistë ka bërë që të futen në pushtet dhe në zyrat e tij në punës të regjimeve të kaluara, që kanë sjellur në pushtet fryshtë dhe metodat e vjetra. Partia jonë në këtë sektor të gjerë nuk ka mundur dot të kontrollojë situatën. Këtu ka pasur shfaqje tarafllëku, moskujdesimi, shfaqje të burckracisë, të dembellëkut e shumë gjëra të tjera të papëlqyera. Kjo ka bërë që të infektohen disa nga kuadrot tanë; që të shfaqet shumë herë edhe tendenca sektare në pushtet. Nga ana tjetër, në pushtetin tonë të ri, janë mbajtur shumë forma të vjetra organizative, jo të përshtatshme me kohën e re dhe me punën që duhet të kryhet. Njerëzit dhe format e vjetra të organizimit kanë penguar dhe do të pengojnë shumë ecjen përparrë se nuk ngjallet në Partinë tonë ndjenja e përgjegjësisë dhe e një pune të shëndoshë.

Në pushtet, duhet të vijnë njerëz të ndershëm të popullit, që ka besim populli në ta, të vijnë në radhë të parë, punëtorë, katundarë dhe intelektualë të ndershëm; këta të mësohen dhe të zhvillohen në punë krah për krah me ata që janë specialistë. Edhe për këta specialistë duhet kujdes i madh. Me i vu në punë këta njerëz, me i çmue në punë dhe për punën që bëjnë, por njëkohësisht të kontrollohet puna që bëjnë dhe mos mbahet qëndrim oportunist kundrejt tyre në dëm të punës. Përveç kësaj, në lidhje me çështjen e pushtetit, jo vetëm që duhet të ushtrojmë në maksimum kontrollin nga brenda dhe të lejojmë kritikën e autokritikën konstruktive, por njëkohësisht të nxitim edhe iniciativën e masave për ndihmën direkte që duhet t'i jepin pushtetit dhe kontrollin që duhet të ushtrojnë mbi njerëzit e tij. Këshillat, nga dalin komitetet ekzekutive, duhet ta ushtrojnë realisht pushtetin e tyre, si në emërimin e njerëzve në komitete dhe në kontrollin e tyre, ashtu edhe në heqjen, kur këta nuk punojnë mirë. Të veprësht ndryshe do të thotë të ruash formën e pushtetit popullor, por në brendi të sundojë fryma dhe metoda e vjetër. Këtë gjë duhet ta luftojmë me ashpersinë më të madhe.

Në çështjen e pushtetit armiku do të bëjë çmos të na luftojë. Ai do të na luftojë formën e regjimit tonë duke marrë si argumenta gabimet dhe lëshimet që bëjnë disa nëpunës që, më të shumtën e herës, janë njerëzit e tij që ka futur brenda dhe do t'i paraqesë sikur këto gabime bëhen pse forma e regjimit nuk është e përshtatshme. Nga ana tjetër ai do të përpinqet të depërtojë në pushtet, për të sabotuar, për të ngadalësuar

punën, për të futur të gjitha veset e këqia të regjimit borgjez, dhe po t'i lëshosh shesh të lirë, ai të kap edhe pozitat kyçe të sektorëve të ndryshëm. Shembulla për këto gjëra kemi mjaft. Këto duhet të na shërbejnë si mësim.

Roli i Frontit duhet të jetë i madh. Këtë çështje nuk duhet ta konsiderojmë pa rëndësi. Më aktivizue masat e popullit, me i ba të ndërgjegjshme, që të janë mbështetja e vërtetë e ligjeve dhe e gjithë ndërmarrjeve të shtetit, s'është aspak një punë e vogël dhe e lehtë. Por kjo bëhet e lehtë dhe e frytshme në rast se dimë t'i mobilizojmë masat atje ku janë dhe në rast se dimë t'i lidhim interesat e tyre imediate me interesat e përgjithshme. Vetëm në këtë mënyrë ato do të edukohen, do të mobilizohen si një trup për çështje të përgjithshme dhe me karakter nacional, vetëm në këtë mënyrë ato do të lidhen ngushtë me pushtetin. Njerëzit e Frontit që janë në pushtet dhe që kanë drejtimin e shtetit, me punën e tyre të pastër, duhet t'ja bëjnë të qartë popullit se pushteti është i tij, pse ai i zgjidh çështjet që i interesojnë atij dhe është i téri në shërbimin e popullit. Fronti duhet të grumbullojë masat punonjëse që janë për zbatimin e programit të Frontit dhe që këtë program këto masa e mbrojnë jo vetëm me fjalë dhe fjalime, por e mbrojnë duke punuar me ndërgjegje. Duhet të mobilizojmë masat e gjera të popullit në Front për një luftë të organizuar kundër reaksionit, kundër sabotatorëve. Në asnjë mënyrë ne nuk duhet të evitojmë luftën brenda në Front kundër këtyre elementëve armiq. Masat e popullit në Front të janë kurdoherë në lëvizje dhe në luftë ashtu si duhet të janë edhe në punë. Përndryshe

humbet çdo kuptim i kësaj organizate politike të popullit tonë. Aktiviteti dhe gjallëria e Frontit do të pasqyrojë aktivitetin dhe gjallërinë e pushtetit tonë. Duke punuar në këtë drejtim ne e forcojmë Frontin dhe drejt kësaj rruge duhet të shkojmë. Fronti duhet të jetë i gjallë kudo, në lagje, në fabrikë, në shkollë, në dyqane, me një fjalë kudo ku ka grumbullime njerëzish. Dhe të gjitha këto masa që përbëjnë Frontin, duhet t'i interesosh për çështjet imediate dhe këto t'i lidhësh edhe me interesat e tyre. Fronti duhet të jetë aktiv, në luftën kundër tregut të zi, kundër spekulimeve, në zbatimin e ligjeve dhe të rregulloreve të pushtetit, kundër sabotatorëve dhe armiqve të pushtetit, kundër analfabetizmit etj. etj. Një Front që vepron në të gjitha këto drejtime të jetës së përditshme, është i aftë të kuptojë edhe problemet e mëdha të vendit, t'i mbrojë këto me mish e me shpirt, të kuptojë ç'është pushteti dhe si duhet ta mbrojë sepse ai është i popullit. Duke vepruar kështu ai do të dijë më mirë të dërgojë në pushtet njerëzit që meritojnë dhe kanë besimin e plotë të tij; do të dijë më mirë të kontrollojë aktivitetin e tyre, t'u sugjerojë mendime dhe t'u hapë perspektiva.

Në politikën e jashtme, marrëdhënjet dhe qëndrimet, që duhet të kemi me aleatët, Anglinë dhe Amerikën nga njëra anë dhe me Bashkimin Sovjetik nga ana tjetër, duhet t'i kemi të qarta. Në këtë çështje duhet të shkojmë me kujdes, sepse një gabim i vogël mund të na kushtojë shtrenjtë. Me mbrojtë paqen, nuk do të thotë me pasë qëndrime oportuniste ose me ju ba koncesione anglo-amerikanëve, por me forcue pozitat e demokracisë, që do të thotë, me forcue sa më shumë e më mirë

pozitat e demokracisë në vendin tonë dhe me mbrojtë Bashkimin Sovjetik duke përkrahur politikën e tij të drejtë.

Për ne s'mund të jenë në një plan Bashkimi Sovjetik me Anglinë dhe me Amerikën. Formula «formalisiert» duhet dhe ajo të mos ekzistojë më. Kjo s'do të thotë aspak se ne do t'i hapim luftë Anglisë dhe Amerikës, por ne do të mbrojmë hapët dhe pa asnjë ndrojtje politikën e Bashkimit Sovjetik dhe do të luftojmë qëndrimet reaksionare të politikës anglo-amerikane. Pavarësia e Shqipërisë është e lidhur ngushtë me forcimin e Bashkimit Sovjetik, ai është mbrojtësi dhe përkrahësi ynë i vërtetë.

Kundërshtime të hapëta po paraqiten në mes të Bashkimit Sovjetik dhe anglo-amerikanëve. Politika e këtyre të fundit është një politikë e hapët reaksionare për forcimin e reaksionit në dëm të demokracisë, për mëkëmbjen e fashizmit dhe të kohës së para luftës. Tendenca e tyre është krijimi i grupeve të ndryshme në Perëndim dhe i bloqeve antisovjetike për të shtypur lirinë e popujve dhe për të sjellë në fuqi klikat fashiste. Bashkimi Sovjetik është mbrojtësi i demokracisë së vërtetë, i lirive të popujve dhe i vetëvendosjes së tyre. Anglezët dhe amerikanët, me paturpësinë më të madhe po mbrojnë fashistët grekë, po kërkojnë të fshehin paturpësisht barbarizmat që po bën ushtria e tyre në Greqi, në Indonezi e gjetkë; një fushatë të hapët shpifëse kanë filluar në shkallë të gjerë ata kundër Bashkimit Sovjetik dhe gjithë atyre vendeve që kanë vendosur një demokraci përparamtare si Shqipëria etj. Ata po mbajnë në këmbë të armatosur një ushtri të tërë fashiste

polake¹; ata po mbajnë në këmbë ushtritë fashiste gjermane dhe japoneze, ata janë përkrahës të rivendikimeve shoviniste të fashistëve grekë e italianë në kurriz të vendit tonë; me njëmijë mënyra ata përpinqen të ndihmojnë reaksionin në vandin tonë, të krijojnë grupe dhë partira fashiste për të prishur qetësinë dhe për të rrëzuar pushtetin demokratik; ata janë shtytësit dhe organizatorët e veprimtarisë së sabotatorëve të çdo natyre. Me një fjalë anglezët dhe amerikanët, me çdo mjet dhe me çdo kusht, kërkojnë të rrëmbejnë nga duart e popujve fitoret që ju kushtuan kaq gjak dhe sakrifica.

Përpara një situate të tillë, qëndrimi ynë duhet të jetë i prerë, i vendosur dhe i zgjuar. Populli ynë duhet ta ketë të qartë këtë situatë, ta ndjejë rrezikun dhe të ecë krah për krah me qeverinë për të mbrojtur vandin, për të mbrojtur indipendencën, për të mbrojtur integritetin tokësor dhe demokracinë nga të tillë brigandë. «Duhet të manevrojmë» na thuhet. Kjo është e drejtë, por nën këtë formulë të mos fshihet asnjë lloj oportunitazi dhe të mos bëhen as koncesione. Qëndrimi korrëkt, por i prerë, i ashpër atje ku duhet për të mbrojtur të drejtat, është i vetmi qëndrim i drejtë. Një vijë të tillë të drejtë patjetër duhet ta japë Partia, dhe populli ta bëjë të tijën. Ne duhet të sqarojmë popullin me anë të shtypit, të konferencave, të agjizacionit të vogël se ç'është për ne Bashkimi Sovjetik, dhe ç'janë të

¹ Është fjala për ushtrinë poloneze (të mërgimit), e inkudruar në Korpusin e dytë polonez nën komandën e gjeneralit reaksionar Anders dhe e dislokuar në Itali. Me mbarimin e Luftës së dytë botërore ajo jo vetëm që nuk u shpërndau, por u bë qendër e propagandës fashiste.

tjerët si anglo-amerikanët. Populli duhet ta ndjejë dashurinë e madhe për Bashkimin Sovjetik, për komunizmin, për udhëheqësin e tij, Stalinin e madh, ashtu si ndjen dashurinë për vendin e tij dhe për Partinë e tij Komuniste. Për t'ja arritur këtij qëllimi ne nuk mund të kënaqemi vetëm duke shkruar në gazeta dy ose tre artikuj për Bashkimin Sovjetik. Kjo do të jetë fare pak dhe pa fryt. Duhet një fushatë e shumanshme dhe konkrete, manifestime të ndryshme sportive, kulturale, ekspozita. Populli ta mbrojë dhe ta dojë me gjithë forcat e veta Bashkimin Sovjetik. Të dojë dhe të mbrojë pushtetin e popullit në Shqipëri. Me Jugosllavinë gjithashtu duhet të krijohen marrëdhënje korrekte dhe të sinqerta në çdo lëmë aktiviteti. Mundësitë janë krijuar, lufta na ka lehtësuar shumë në këtë drejtim. Marrëdhënjet ekonomike, sipas mendimit tonë, nuk janë konkretizuar si duhet, përkundrazi, ato janë të shthurura.

Rreziku nga jashtë është i madh dhe nuk duhet të nënçmohet. Nga ana e anglo-amerikanëve po bëhen kërcënime të poshtra, shantazhe të turpshme, që populli ynë duhet t'i dijë dhe të kuptojë esencën e tyre. Mbrojtja nga ky rrezik është një mbrojtje legjitime, sepse manevrime të tilla drejtohen kundër Bashkimit Sovjetik, kundër popullit tonë. Në rast se ne s'ja vëmë në dukje popullit qëndrimin e Bashkimit Sovjetik nga njëra anë dhe atë të anglo-amerikanëve dhe satelitëve të tyre nga ana tjetër, atëherë ne i kemi munguar detyrës sonë kryesore dhe e kemi mbajtur popullin në errësirë, s'ja kemi mprehur ndjenjën e mbrojtjes legjitime nga kërcënimet që po i bëhen prej imperialistëve. Oficeri

anglez ose amerikan, që ndodhet në vendin tonë, ai është këtu për të na luftuar, për të organizuar sabotazhe dhe «kryengritje» kundër pushtetit, ai është informatori më i rrezikshëm i imperializmit. Këtë duhet ta kemi të qartë ne dhe gjithë populli dhe të mos rrojmë me iluzione. Popullin duhet ta mësojmë të ruhet nga këta njerëz, pse këta punojnë për të keqen e tij.

Shokë të Komitetit Qendror,

Me pasë një vijë të qartë, ta kuptojmë, ta bëjmë tonën dhe ta zbatojmë, është gjithshka për ne. Në çdo moment duhet të kemi parasysh qëllimin tonë: ku po shkojmë dhe si duhet të shkojmë. Komiteti Qendror në radhë të parë, që është koka drejtuese e Partisë duhet t'i japë jo vetëm tonin dhe vijën organizatës, por ai të jetë shembull i pjekurisë në çështjet, në realizimin e tyre dhe i zgjuar në kontrollin e zbatimit të tyre. Çorinentimi në krye, lëkundje ose pikëpamje të gabuara, do të thotë dobësim i Partisë në të gjithë jetën dhe aktivitetin e saj. Prandaj këto duhet t'i luftojmë dhe t'i goditim pa mëshirë. Në një kohë paqeje ne duhet të kemi një parti luftarake, monolite, të disiplinuar, një parti të tipit të ri, që me të vërtetë të drejtojë, të jetë pararоjë dhe jo të rrëshqasë në gabime e në kurthe që i ngrenë armiqtë e popullit, që janë armiqtë e saj. Jemi përgjegjës përpara Partisë dhe e gjithë Partia përpara popullit; prandaj roli i saj është historik dhe vendimtar. Nuk lejohet që çështjet e Partisë të gjykohen me mendjelehtësi e me frymë familjariteti. Mbi të gjitha duhet të vëmë interesin e Partisë, sepse andej varet çdo gjë. Prandaj duhet

ta mbrojmë Partinë me të gjitha forcat kundër çdo fryrë me të sëmurë. Nga ana tjetër kurrë të mos harrojmë se sqarimet që po bëjmë sot, s'duhet të mbeten vetëm për ne. Lëshimet dhe gabimet tona kanë reperkusione në Parti, të cilave duhet t'u gjejmë shërimin. Në rast se ne nuk u futemi në thelb çështjeve si kanë shkuar dhe si duhet të shkojnë, atëhere do ta orientojmë përsëri keq organizatën, pse çështjet s'janë as të lehta, as të dorës së dhjetë, por janë çështjet kryesore të Partisë për të cilat jemi përgjegjës ne në radhë të parë. Këtë s'duhet kurrë ta harrojmë.

Botohet për herë të parë si-pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

INTERVISTË DHËNË GAZETËS «BASHKIMI» RRETH PRETENDIMEVE GREKE NË KËSHILLIN E SIGURIMIT KUNDËR PRANIMIT TË SHQIPËRISË NË OKB

10 mars 1946

PYETJE: Cila është arësyja që z. Rendis¹ kërkon ta paraqesë Shqipërinë në radhë të agresorëve, kurse Shqipëria zë një vend të parë në radhët e atyre që luf-tuan kundër agresorëve?

PËRGJEGJE: Qëllimet e z. Rendis, qëllimet e kësaj manevre të fashistëve grekë, të ndihmuar nga reaksiuni ndërkombëtar, ka kohë që po i vë në dukje shtypi reak-sionar grek me metodat më të poshtra. Këto qëllime janë pretendimet e tyre mbi Shqipërinë e Jugut.

Argumenti i z. Rendis, paraqitur OKB-së për mos-pranimin e Shqipërisë në këtë organizatë, argument mbështetjeje për pretendimet e tyre imperialiste, është aq qesharak sa edhe preteksti i Italisë fashiste kur i deklaroi luftë Greqisë dhe që konsistonte në «vrasjen e

¹ Rendis, Ministër i Punëve të Jashtme të Greqisë monarko-fashiste në këtë kohë dhe kryetar i delegacionit grek në OKB.

Daut Hoxhës»¹. Me argumentin e tij z. Rendis përpinqet ta paraqesë Shqipërinë dhe popullin shqiptar si të lidhur ngushtë me agresionin që ju bë Greqisë nga ana e Italisë fashiste, ta konsiderojë Shqipërinë në një plan, dhe fajtore si Italinë fashiste dhe këtej të mbështetë tezën e tij imperialiste për pretendime tokësore dhe për reparacione. Kur qeveria e Athinës, me anën e letrës së z. Rendis, thotë se «pret që të vendosen marrëdhënjet normale në mes të dy vendeve», shfaq sa thashë më lart.

Z. Rendis, qeveria e tij dhe gjithë fashistët grekë duhet të dinë një gjë, se atë që pësoi Greqia më 1940 nga ana e Italisë, vendi ynë e pësoi që më 7 prill 1939. Dhe, kur populli shqiptar luftonte më 7 prill dhe në fillim të okupacionit, miqtë e z. Rendis, Metaksas² me shokë jo vetëm nuk e ngritën zërin kundër kësaj katastrofe që po i ndodhët fqinjës së tyre të vogël, po as që e konsideruan këtë agresion si një rrezik imminent që i kanosej Greqisë dhe gjithë Ballkanit. Urrejtja e popullit shqiptar për Italinë imperialiste dhe fashiste është e njohur në gjithë botën. Këtë urrejtje populli ynë e ka manifestuar në Luftën e Vlorës (1920), në përpjekjet kundër regjimit të Zogut, vegël e fashistëve italianë dhe më në fund në epopenë e tij të madhe që filloi më 7 prill 1939 dhe mbaroi me shkatërrimin e Gjermanisë naziste. Duhet të kesh gjkimin dhe qëllimet e z. Rendis që të përpinqesh të mbulosh diellin me shoshë, të fshehësh

¹ Daut Hoxha, në verën e vitit 1940 u gjend i vrarë në kufirin me Greqinë. Vrasja e tij u përdor si pretekst për sulmin e Italisë fashiste kundër Greqisë në tetor 1940.

² Metaksas (1871-1941), gjeneral fashist grek, kryesoi diktaturën fashiste në Greqi në vitet 1936—1941.

të vërtetën e madhe. Ngjet një gjë te z. Rendis dhe shokët e tij: ata s'mund të dallojnë dot kuislingët nga populli dhe prova është se në Greqi kuislingët janë në fuqi dhe populli po shtypet. Në gjithë botën përparimtare dhe antifashiste është bërë dallimi i kuislingëve nga populli. Në Shqipërinë tonë ky dallim u bë që më 7 prill, u bë me armë dhe me luftë të pamëshirshme, të paprerë e pa kompromis. Greqisë nuk ja deklaroi luftën populli shqiptar, por Italia fashiste dhe kuislingu Shefqet Vërlaci me shokët e tij. Se qysh e filloi dhe e mbaroi luf्�ten e tij heroike populli shqiptar kundër Italisë fashiste, zoti Rendis dhe shokët e tij le të informohen më mirë, le të këqyrin më së afërmë përpjekjet e përgjakshme të popullit tonë, le të studjojnë më mirë deklaratat që kanë bërë ministrat e jashtëm të aleatëve të mëdhenj Mollotov, Hull dhe Iden, le të studjojnë deklaratat e oficerëve aleatë kur ndodheshin në vendin tonë gjatë kësaj lufte. Se ç'përfaqësonin kuislingët në vendin tonë dhe ç'dënim u dha këtyre populli, pseudodemokrati Rendis, po të interesohet t'i mësojë, do t'i copëtohet zemra përfatim që pësuan këta tradhëtarë.

Përsa i përket shpalljes së luftës Greqisë nga ana e Italisë fashiste dhe kuislingut Shefqet Vërlaci dhe përsa i përket zhvillimit të vetë luftës, jo vetëm që populli shqiptar s'ka asnë përgjegjësi, por populli ynë ishte kundër luftës italo-greke, ishte me popullin heroik grek që vritej dhe futej në një robëri të rëndë, sikundërqë u fut edhe ai vetë që më 7 prill të 1939-s. Populli ynë, këto ndjenja që ushqente kundrejt fqinjët të tij, i manifestoi duke luftuar kundër italianëve. Zoti Rendis duhet të dijë se, kur Italia fashiste i deklaroi luftë Greqisë, burgjet u

mbushën me patriotë shqiptarë që manifestonin nëpër rrugët e qyteteve dhe gjakoseshin me karabinierinë italiane. Me mijëra patriotë shqiptarë mbushën kampet e përqëndrimit në Itali. Luogoteneca u përpoq të shtyp-te shpirtin patriotik e kryengritës të të rinjve shqiptarë duke i dërguar ata në kampe përqëndrimi, pse rezistenca e popullit tonë kishte marrë hov. Zoti Rendis duhet të dijë se muerset e Tiranës u mbushën me afishe kundër luftës italo-greke, se grupet e rezistencës me trakte dhe me propagandë, bënë të dezertonin nga radhët e ushtrisë kukslinge ushtarët shqiptarë. Shumë nga ata u internuan në fushat e përqëndrimit të fashizmit. Zoti Rendis duhet të dijë se çetat e lëvizjes nacional-çlirimtare goditën me armë në Shqipërinë e Mesme italianët dhe furnizimet e tyre që shkonin në frontin grek dhe se dëshira e popullit tonë për të luftuar krah për krah me ushtrinë greke kundër italianëve u refuzua kategorikisht nga komanda greke; jo vetëm kaq, por edhe u çarmatos populli i Shqipërisë së Jugut. Simpatinë për popullin grek dhe solidaritetin në luftën për kauzën e përbashkët, populli shqiptar e vazhdoi edhe nën okupimin gjerman. Battalionet e brigadave tona, të vëllazëruar me ushtrinë e ELAS-it¹ dhe me gjithë popullin grek, kanë kaluar kufirin dhe kanë goditur në tokat greke okupatorin e përbashkët gjerman. Këto i di populli i ndershëm grek, po këto i di edhe banditi Zerva dhe shokët e tij.

Ç'po ngjet tani në Greqi, e di gjithë bota, dhe ç'përfaqëson zoti Rendis, edhe këtë e di gjithë bota antifashiste. Provokacionet e panumërtë dhe të përditshme,

¹ ELAS — Ushtria Nacional-Çlirimtare Greke.

që fashistët grekë po bëjnë në kufirin tonë, fushata e shtypit reaksiuar grek me pretendimet e kota dhe me shpifjet e poshtra, pretendimet e zotit Rendis dhe të qeverisë së tij përpara Asamblesë së Kombeve të Bashkuara, të gjitha këto janë një vepër e tërë e denjë për dishepujt e vërtetë të dr. Gëbelsit. Populli shqiptar nuk u trembet këtyre kërcënimeve, as pretendimeve të tipit fashist, sepse ai e provoi përpara gjithë botës si luftoi fashizmin dhe agresionin, si luftoi kukslingët e vendit të tij, si shqelmoi dhe çori vendimet e këtyre të fundit, që s'kishin të bënin aspak me ndjenjat e popullit, por ishin në kundërshtim flagrant me to.

Do të jetë mohimi i gjithë luftës së madhe antifashiste, ku u vranë me miliona njerëz, po të ketë njerëz dhe shtete që të lejojnë persona të tillë, si zoti Rendis dhe shokët e tij, të vazhdojnë veprën e fashistëve gjermanë e italiannë dhe të turbullojnë paqen. Sa për popullin tonë, ai, ashtu si ishte i ndërgjegjshëm për të luftuar fashizmin okupator, ashtu është edhe sot i ndërgjegjshëm dhe i vendosur të mbrojë paqen dhe të drejtat e tija që kërkojnë t'ja shkelin ose t'ja grabitin banditët fashistë të tipit të ri.

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 369,
10 mars 1946*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 369,
10 mars 1946*

**LETËR DREJTUAR KRYESISE SË KËSHILLIT TË
NËNMINISTRAVE TË PUNËVE TË JASHTME TË
ANGLISË, TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË
AMERIKËS, TË BASHKIMIT TË REPUBLIKAVE
SOCIALISTE SOVJETIKE E TË FRANCËS NË
LIDHJE ME DËMSHPËRBLIMET QË ITALIA
I DETYROHEJ SHQIPËRISE**

Londër

20 mars 1946

Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë ka nderin t'i parashtrojë sa vijon gjykimit të Këshillit të Nënministrave të Punëve të Jashtme, që janë mbledhur në Londër për të përpiluar projektin e Traktatit të Paqes me Italinë:

Siç dihet dhe nga ai Këshill, Shqipëria qe i pari vend ballkanik që u sulmua nga Italia fashiste dhe që në fillim, ishte i pari që përqafoi lëvizjen e rezistencës së armatosur kundër fashizmit duke hedhur në luftë të gjitha forcat e tija materiale e morale.

Sakrificat e pasembullta dhe dëmet që pësoi nga kjo luftë dhe që ka prekur thellë ekonominë e tij kombëtare, i japin vendit tonë të drejtën që të kërkojë

ndreqjen nga ana e Italisë të shkatërrimeve të shkaktuara, në mbështetje të parimeve të shpallura solemnisht nga fuqitë aleate.

Duke u mbështetur mbi të drejtën e saj dhe nga dëshira që ta sqarojë Këshillin mbi natyrën dhe gjerësinë e këtyre shkatërrimeve, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë ka nderin t'i paraqesë bashkangjitur një listë të hollësishme të dëmeve të pësuara, listë në të cilën janë regjistruar dhe vlerësuar në mënyrë krejt objektive humbjet dhe shkatërrimet për të cilat bëhet fjalë.

Nga ana tjetër, qeveria shqiptare rezervohet t'i parashtrojë më vonë Këshillit çdo element ose informatë tjetër që do të gjykohet e nevojshme.

Duke bërë këtë përçapje Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, ka bindje të plotë, se Këshilli do të ketë mirësinë ta studjojë këtë çështje me të gjithë kujdesin e duhur, se ai nuk do të rrijë pa marrë shënim mbi kërkesat e drejta të Shqipërisë, kur të diskutojë mbi nenet financiare të projektit të Traktatit të Paqes me Italinë, në lidhje me dëmshpërblimet që ka për të paguar ky vend.

**Kryetari i Këshillit të Ministrave të RPSH
Gjeneral-Kolonel**

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 377,
20 mars 1946*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 377,
20 mars 1946*

PROGRAMI I QEVERISE SË PARË TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË, PARAQITUR PARA KUVENDIT POPULLOR TË RPSH

24 mars 1946

Shokë deputetë,

Asambleja e lartë Kushtetuese, me proklamimin e Statutit Themeltar të Shtetit¹, kreu detyrën historike që i kish ngarkuar populli ynë. Proklamimi i Statutit i dha shtetit formën e vërtetë popullore, i dha Shqipërisë regjimin republikan, që shpreh aspiratat e mbarë popullit tonë. Me proklamimin e Statutit plotësohet një etapë e shkëlqyer e vendit tonë, etapë plot heroizma e sakrifika, luftë dhe punë të palodhur, të kryera ndër momente shumë të vështira si të brendshme, ashtu dhe të jashtme. Me forcat e veta populli ynë çlroi atdheun nga skllavëria e rëndë, fitoi indipendencën, sovranitetin, ngriti pushtetin e tij popullor dhe ju përvesh punës së rindërtimit të vendit të rrënuar. Gjatë kësaj etape të pasluftës, populli shqiptar ka korrur suksese jo vetëm në konsolidimin e pushtetit të tij, po edhe në ngritjen e ekonomisë së vendit dhe në zhvillimin politik dhe kulturnal të masave të gjera punonjëse. Proklamimi i Statutit

¹ Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë.

çel, nga ana tjetër, një etapë të re për gjithë popullin dhe në këtë etapë do të ecë me hapa të sigurta në drejtimet që i cakton Statuti.

Për fitoret e deritanishme është dashur mobilizimi i gjithë popullit tonë, pse as lufta e madhe e çlirimit, as etapa e parë e rindërtimit të vendit nuk mund të kryhesin pa këtë pjesëmarrje të gjerë. Çlirimi i atdheut i takon gjithë popullit, kjo ishte një detyrë e shenjtë, po aq e shenjtë dhe vitale është dhe detyra e rindërtimit të atdheut dhe kjo lyp po ato sakrifica, po atë energji dhe ndërgjegje që u tregua nga ana e gjithë popullit në kohën e luftës. Detyrat janë të rënda dhe të vështira, pse në rrugën tonë do të hasim pengesa. Për këtë gjë, Qeveria e parë e Republikës Popullore të Shqipërisë, e formuar në bazë të Statutit, është e ndërgjegjshme, ashtu si është e ndërgjegjshme për përgjegjësinë e madhe që ka kundrejt popullit shqiptar. Po këto detyra të rënda që na vihen përpara, ne duhet t'i kryejmë dhe do t'i kryejmë, sepse populli shqiptar e tregoi me fakte se është në gjendje të ndërtojë dhe të krijojë, sepse ai ka një vitalitet dhe energji të madhe, sepse atij s'i trëmbet syri nga vështirësitë dhe nga pengesat dhe se ai është i ndërgjegjshëm që ndërton të ardhmen e tij, ndërton Shqipërinë e re. Për kryerjen e këtyre detyrave, përvèç entuziazmit, vrullit e ndërgjegjes, duhet edhe organizim i mirë dhe i shëndoshë, duhet punë me plan. Puna me plan dhe organizimi i shëndoshë në punë duhet të hyjë në gjakun e popullit shqiptar dhe të funksionarëve të shtetit. Që të kryhen këto detyra si duhet, është e domosdoshme të kuptohet mirë prej të gjithëve, se cilido qoftë ka detyra për të përbushur ndaj shoqërisë; inte-

resi personal është i lidhur ngushtë me interesin e përgjithshëm dhe përmirësimi i gjendjes ekonomike i gjithseçilit varet kryekëput nga përmirësimi ekonomik i gjithë vendit. Prandaj, që të mund ta kryejë me sukses barrën e saj, qeveria e re kërkon mbështetjen dhe ndihmën e gjithë popullit. Nga ana tjetër, ajo kërkon nga të gjithë funksionarët e shtetit, që prej më të voglit dhe gjer te më i madhi, që prej atij nëpunësi të vjetër dhe gjer te ai i riu, disiplinë në punë, ndërgjegje, ndershëmëri dhe entuziazëm. Ata nëpunës, që kujtojnë se në Shqipërinë e re mund të vazhdohet të punohet me frymën e vjetër të tarafit, të burokracisë, të dembellëkut, gabohen rëndë; ata njerëz të vjetër, o të rinj, që kujtojnë se funksionet në administratë janë një «refugium peccatorum», ku merret rroga pa u lodhur dhe pa krijuar, do të kenë shpejt deziluzione të hidhura për ta. Puna duhet të bëhet një nder për çdo shqiptar.

Me Statutin që na dha Asambleja Kushtetuese, i cili na hap perspektiva të gjera punimi dhe rindërtimi të një shoqërie të lumtur dhe që na siguron të gjitha mjetet për shkuarjen me sukses përpara, qeveria e Republikës, e mbështetur në sukseset e korrura në etapën e parë dhe sidomos në forcën krijuese të masave, në energjinë dhe vitalitetin e popullit shqiptar, do t'i ka-përcejë me siguri vështirësitë që do të hasë përpara në zgjidhjen e problemeve jetike të vendit tonë.

Problemi i ndërtimit të Shqipërisë së re

Ky problem është më kryesor, që do të preokupojë qeverinë dhe gjithë popullin shqiptar, pse është më

delikati, më i vështiri, por jo i pazgjidhshëm. Këtu duhet të vihen gjithë forcat tona, pse këtej varet e ardhmja më e lumtur e vendit.

Të ndërtosh Shqipërinë e re do të thotë të ndërtosh ato që na dogji dhe na shkatërroi armiku, në radhë të parë, dhe të kalosh më tej me forca të dyfishuara, të ndërtosh shtëpitë e djegura, të përmirësosh dhe të hapësh rrugë të reja komunikacioni, që janë mjeti i domosdoshëm i zhvillimit më të mirë ekonomik, të rindërtosh dhe të vësh në funksionim të mirë minierat e ndryshme, pasuria më e madhe e vendit tonë, të mëkëmbësh industrinë e lehtë dhe të inkurajosh prodhimin, i cili të shtohet dhe të përmirësohet. Të ndërtosh Shqipërinë e re do të thotë të ngresh ekonominë e vendit, ta përmirësosh dhe ta bësh të begatshme jetën e popullit dhe popullin shqiptar ta pajisësh me një kulturë dhe me një arësim të shëndoshë, të ndërtosh, pra, një shoqëri të re në Shqipërinë e re.

Këto detyra të rënda i takojnë, në radhë të parë, qeverisë së Republikës dhe gjithë popullit shqiptar dhe përzgjidhjen e këtij problemi të madh duhet të mobilizohen gjithë energjitet tona si nga pikëpamja politike ashtu dhe teknike e organizative. Duhet të kuptojmë një gjë, se të gjitha këto punime të domosdoshme, që do të kryejmë, është e pamundur të përballohen me buxhetin e zakonshëm të shtetit. Kjo mungesë do të përmbushet me forcën e gjallë të popullit, me iniciativën dhe sakrificat e tij që do t'i vërë në shërbim të atdheut. Kjo është lufta e dytë e lavdishme e popullit tonë, ajo e ndërtimit të ri të shoqërisë sonë nga do të dalin heronjtë e punës.

Qeveria e re është duke hartuar planin e punës dhe buxhetin e ri të shtetit dhe në këtë plan pune të qeverisë figurojnë në radhë të parë:

a) Ngritja dhe shfrytëzimi në maksimum i fushave tona të vajgurit e të minierave të serës, të bakrit e të kromit. Shfrytëzimi më i mirë i kësaj pasurie të çmueshme të vendit tonë do të jetë mbështetja kryesore në ngritjen dhe përforcimin e sektorëve të tjera të industrisë. Në këtë sektor pune me rëndësi qeveria do të vërë gjithë fuqitë e saja; gjithashtu qeveria kërkon prej punëtorisë shqiptare gjithë ndihmën e çmueshme të saj, kërkon prej tyre të forcojnë ndjenjën e klasës, të bëhen të ndërgjegjshëm për rolin e tyre të madh në udhëheqje dhe në rindërtim. Punëtoria jonë duhet të bëhet shembull i sakrificës për gjithë kauzën e popullit, shembull për punë të organizuar dhe të disiplinuar.

b) Vënga në eficiencë maksimale dhe në shërbim të interesit të përgjithshëm të gjithë industrisë së lehtë të vendit tonë, e cila gjer tani ka punuar pa kriter dhe ka shërbyer për të pasuruar disa njerëz në kurrizin e popullit tonë.

c) Ndreqja e shtëpive të djegura. Gjer tani qeveria ka bërë ç'ka qenë e mundur për të strehuar ata që lufta i kishte lënë pa shtëpi, ka ndihmuar me material për meremetimin në mënyrë provizore të një shumice shtëpish ndër fshatra të djegura nga lufta. Por kjo s'ka qenë kurrë e mjaftë. Nuk do të jemi përsëri në gjendje të bëjmë që sivjet planin e përgjithshëm të ngritjes së fshatrave e të qyteteve të djegura, po qeveria e re ka në programin e saj ndërtimin e shtëpive të fshatrave që kanë vuajtur më shumë nga lufta dhe në radhë të

parë, ato të Kurveleshit, të Vlorës, të Mallakastrës, të Gjirokastrës dhe të Korçës. Kjo jo vetëm që është një detyrë që ka atdheu kundrejt atyre që luftuan heroinisht, që u vranë dhe u dogjën, por edhe një nevojë e ngutshme që duhet të përbushet brenda verës dhe vjeshtës. Qeveria kërkon për këtë gjë përkrahjen e gjithë popullit: në sharrat e në fabrikat e tullave, kudo që prodhohet çimento e gëlqere, të shtohet me ritëm të madh prodhimi, të mobilizohen masat e gjera për punë vullnetare, të mobilizohen dhe të punojnë me ndërgjegje teknikët, mjeshtrit, marangozët dhe gjithë ata që mund të ndihmojnë vëllezërit e tyre që u dogjën nga lufta si edhe rindërtimin e atdheut të rrënuar.

d) Vendi ynë ka nevojë për rrugë të reja, të vogla dhe të mëdha; për këtë gjë qeveria ka në programin e saj, jo vetëm nibajtjen mirë të atyre që kemi, por dhe hapjen e rrugëve të reja. Në Jug dhe në Veri do të ndërmerren punime të tilla. Do të duhet, sigurisht, një kohë e gjatë që ne të arrijmë të ndërtojmë një rrjet rrugor të përsosur, por duhet të fillojmë që sivjet të hapim rrugë në malësitë tona të Veriut për t'u ardhur në ndihmë fshatarëve të malësisë, për të ngritur nivelin ekonomik dhe kultural të popullsisë sonë të malësisë. Rrugët do të jenë mjet i rëndësishëm për të shkulur nga rrënjet mbeturinat e mesjetës dhe të feudalizmit ndër ato vende. Atje nuk do të shkojë më fjala e jezuitëve dhe e Maliq Bushatëve me shokë, po fjala e Shqipërisë së lirë, e Shqipërisë së re.

Në lidhje me rindërtimin e vendit tonë një ndihmë për ne do të jenë dhe reparacionet e luftës që do të marrim nga Gjermania dhe nga Italia. Këto dy vende

kanë qenë shkaktarët e Luftës së dytë botërore, djegësit dhe shkatërruesit e vendit tonë. Për këto rrënime të pashembullta në histori këta duhet të paguajnë. Konferanca e reparacioneve, që u mbajt në Paris¹, na caktoi një kuotë për vendin tonë, e cila përbëhej prej fabrikash të ndryshme. Për tërheqjen e tyre qeveria shqiptare ka deleguar komisionin e vet në Komitetin e reparacioneve në Bruksel. Konferanca e Parosit, padrejtësisht, na caktoi një kuotë shumë të vogël në krahasim me shkatërrimet që na shkaktoi Gjermania, por qeveria do të kërkojë me këmbëngulje që një gjë e tillë të mos ngjasë në lidhje me reparacionet që ne kërkojmë nga Italia. Italia që vjete me radhë vodhi dhe ropi vendin tonë, grabiti gjithë pasurinë e nëntokës dhe të mbitokës së vendit tonë dhe, më në fund, e dogji, e shkatërrroi dhe vrau e preu me qindra mijëra shqiptarë, duhet t'i paguajë të gjitha këto dëme. Qeveria do të ngulë këmbë për këtë gjë dhe disa nga aleatët tanë duhet të mos harrojnë se vendi ynë ka qenë ai që pësoi agresionin më të poshtër dhe i rezistoi këtij agresioni me armë gjer në fund. Në të gjitha këto ndërmarrje të qeverisë, të përkrahura fuqimisht prej gjithë shtresave të popullit, duhet të kemi për qëllim të parë shtimin e prodhimit dhe përmirësimin e tij. Arritja e këtyre qëllimeve do të thotë furnizimin e mundshëm të masave fshatare, punëtore dhe qytetare me këto prodhime dhe njëkohësisht krijimin e mundësisë për shtimin e industrisë dhe të prodhimeve të fa-

¹ Konferanca e reparacioneve u mbajt në Paris në nëntor-dhjetor 1945. Në të mori pjesë edhe një delegacion i vendit tonë i kryesuar nga shoku Hysni Kapo.

brikuara. Në vendin tonë të varfër dhe të djegur duhet të zhvillohet në maksimum ndjenja e kursimit, e mbajtjes mirë dhe e ruajtjes së pasurisë së shtetit, sepse të bësh kursime, të ruash pasurinë e shtetit dhe të pakësosh shpenzimet në nxjerrjen e prodhimit, do të thotë të ulësh çmimet e këtyre prodhimeve, të krijosh besimin e popullit në situatën e sotme, të çelnikosësh bashkimin në mes të fshatarëve, punëtorëve dhe intelektualëve, në Republikën Popullore të Shqipërisë.

Në lëmin kultural dhe arësimor qeveria ka një barrë të rëndë. Populli ynë ka nevojë për më shumë bukë, por ka nevojë gjithashtu edhe për më shumë kulturë dhe arësim. Kjo kulturë dhe ky arësim nuk duhet të jenë më vetëm një stoli e pavlefshme, po duhet të shërbejnë për interesin e përgjithshëm, për të prodhuar më shumë dhe më mirë, për të ngritur standardin e jetës në vendin tonë. Ne kemi nevojë për atë kulturë që ta bëjë popullin më të zot të punojë dhe të prodrojë; dhe këtë kulturë dhe arësim ta bëjmë një armë të masave të gjera punonjëse. Qeveria do të luftojë çdo gjë që do të pengojë të shkohët në këto drejtime. Në Shqipërinë e re që po ndërtojmë dhe me Statutin e ri që na udhëheq nuk mund të ecet më as me organizimet dhe as me programet e vjetra. Çdo gjë do t'i përshtatet kohës dhe situatës së krijuar dhe kjo duhet të ndërrojë jo vetëm në formë, por edhe në përbajtje.

Përsa i përket arësimit, qeveria do të shumëzojë shkollat fillore dhe do të zgjidhë përkohësisht problemin e mësuesve duke krijuar kurse të shpejta për mësues. Ajo do të jetë rigorozë kundër atyre mësuesve dhe profesorëve, që nuk e kryejnë si duhet funksionin e lartë

që ju ngarkohet si dhe kundër atyre prindërve që nuk zbatojnë ligjin, duke mos dërguar djemtë e vajzat e tyre në shkollë gjatë gjithë periudhës që i detyron ligji.

Dyert e shkollave të mesme duhet të jenë të hapëta për masat e gjera të rinisë së fshatit dhe të qytetit. Për këtë gjë qeveria do të përpinqet të krijojë mundësi më të mëdha për t'u ardhur në ndihmë shtresave të varfëra, për të vazhduar mësimet e mesme; qeveria do të inkurajojë gjithashtu që në shkolla të ketë sa më shumë vajza, që kështu gruaja shqiptare të luajë rolin e saj të madh në Shqipërinë e re.

Reforma e shkollës¹ dhe ndryshimi i programeve do të jenë detyrat e para të qeverisë në lëmin arësimor. Reforma dhe ndryshimi në programe do të jenë të përshtatshme me konditat e krijuara në vendin tonë dhe me nevojat që paraqiten për ndërtimin e Shqipërisë së re.

Formimi i kuadrove, që do të luajnë rolin kryesor në këtë drejtim, do të jetë kujdesi më i madh i qeverisë. Do të dërgohen të rinj të aftë dhe jashtë shtetit për studime.

Për të ngritur nivelin kultural të popullit, qeveria do të vërë gjithë forcat për të luftuar analfabetizmin, do të organizojë kurse nate, kurse të veçanta për punëtorë, kurse për specialistë. Teatrit, radios, kinemasë, do t'u japë të gjithë përkrahjen në mënyrë që këto të bëhen një mjet i mirë për lartësimin e nivelit kultural të popullit. Qeveria do të përkrahë sportin dhe kulturën fizi-

¹ Reforma e shkollës filloj të zbatohet në Shqipëri mbas aprovimit nga Kuvendi Popullor të Ligjit Nr. 282, datë 17 gusht 1946 «Mbi reformën e arësimit».

ke, për forcimin e brezit të ri, i cili të bëhet punëtor dhe luftëtar i zoti për Shqipërinë e re.

Problemi bujqësor

Ky problem është nga më kryesorët që lyp një zgjidhje të shpejtë e të drejtë. Vendi ynë është një vend agrar dhe masa e parë, që u muar dhe që ka një rëndësi historike, ishte zbatimi i reformës agrare, e cila u dha tokën atyre që e punojnë dhe, në radhë të parë, fshatarëve të varfër e të mesëm. Në ndarjen e tokës fshatarëve, në bazë të ligjit të reformës, janë bërë përparime, por kjo punë s'ka nbaruar. Qeveria do të vëré forcën që kjo të bëhet sa më shpejt dhe sa më mirë. Për këtë ajo do të shtojë numrin e teknikëve të reformës. Përveç kësaj, qeveria u bën thirrje komiteteve fshatare të jatin përkrahjen e tyre më të madhe që puna të shpejtohet e të bëhet drejt në interesin e fshatarëve dhe të Shqipërisë. Fshatarët e Shqipërisë të luftojnë me ashpërsinë më të madhe kundër dredhive dhe padrejtësive ose interpretimeve false që ndonjë nëpunës i pandërgjegjshëm i reformës mund t'i bëjë ligjit. Këtu askush të mos bëjë iluzione dhe dredhira. Qeveria nuk do të lejojë që të luhet me tokën dhe me fatin e fshatarëve. Në rast se ndonjë nen i ligjit të reformës lë vend për interpretim, ky do të bëhet vetëm në favorin e fshatarëve. Jo vetëm që qeveria do të shpejtojë ndarjen e tokës, por ajo do të çelë kreditin agrar për t'u ardhur në ndihmë fshatarëve me të holla dhe me vegla, do të shtojë dhe do të përmirësojë qendrat mekanike bujqësore, të cilat do të vihen në shërbim të bujqve. Për sivjet do të jetë i zor-

shëm zbatimi i planit të gjerë të bonifikimeve, po qeveria ka në programin e vet hapjen e shumë kanaleve, tharje kënetash, si ajo e Maliqit, etj. Të gjitha këto duhet të kenë për qëllim ngritjen e bujqësisë sonë nga një fazë primitive në një fazë më të përparuar; punimin e sa më shumë tokave, shtimin dhe përmirësimin e prodhimit bujqësor. Parulla në këtë drejtim duhet të jetë: të bëjmë bukën vetë dhe të mos varemi prej importit. Në kryerjen e këtyre detyrave vitale nuk mjafton vetëm interesimi i qeverisë, por duhet që i tërë populli të mobilizohet të punojë vullnetarisht, të sakrifikojë për një të ardhme më të mirë.

Në lidhje me çështjen bujqësore, do t'i vëmë një rëndësi të madhe dhe blektorësë, ku do të shumëzojmë dhe do të përmirësojmë racën e kafshëve tona. Kjo, natyrisht, do të vijë kur ne jo vetëm të kemi ndihmuar bujkun për të mbjellë dhe për të sigruar ushqimin e tij dhe të kafshëve, por njëkohësisht kur ta kemi edukuar për përmirësimin e këtij sektori me rëndësi. Për këtë gjë qeveria do të hapë kurse speciale për fshatarët, përvëç kurseve dhe shkollave bujqësore. Shumë degë të industrisë së lehtë të vendit tonë, që do të kenë një të ardhme të shpejtë më të lulëzuar, varen nga përmirësimi i këtij sektori. Industria e përpunimit të qumshtit e të lesht dhe ajo e lëkurëve, janë të lidhura ngushtë me këtë sektor.

Nga ana tjeter, çështjes së mirëmbajtjes së pyjeve dhe pyllëzimit të vendit tonë do t'i vihet kujdesi i vëçantë si nga ana e qeverisë, ashtu dhe nga ana e popullit, se kjo jo vetëm që ka të mirat e sajë në lidhje me përmirësimin e tokës dhe të klimës, por është një pasuri e madhe për vendin, me zhvillimin e industrisë së drurit

dhe të kartës aq shumë të domosdoshme për rindërtimin e vendit tonë. Që bujqësia jonë të shkojë përpara dhe të zhduket anarkia në prodhimet bujqësore ajo duhet të jetë nën kontrollin e organeve qeveritare. Fshatarëve duhet t'u jepet farë e mirë, plehra, vegla, por edhe udhëzime se ç'duhet të mbjellin dhe për çfarë gjërash ka më shumë nevojë vendi. Duhet të shfrytëzohen konditat e ndryshme të natyrës dhe të tokës, të inkurajohet prodhimi i atyre bimëve që bujku ynë akoma nuk ua di vlerën dhe rëndësinë. Vetëm kështu do të përpalojë bujqësia dhe do të sjellë fryte më shumë për të forcuar ekonominë në përgjithësi. Krijimi i kooperativave fshatare, të cilat na i dikton dhe Statuti, jo vetëm që do të gjejë përkrahjen e madhe nga qeveria, po ato do të jenë në kujdesin e shtetit në radhë të parë dhe në duart e masave të varfëra e të mesme të fshatarëve dhe jo në duart e spekulatorëve.

Problemi financiar

Ky problem i rëndësishëm do të zgjidhet me mundësitë tona. Burimi kryesor i të ardhurave do të jetë zhvillimi i mirë i ekonomisë dhe i industrisë së vendit. Zhvillimi i ekonomisë dhe çështja financiare janë dy gjëra që shkojnë së toku dhe do të zhvillohen së toku, në harmoni. Një faktor me rëndësi për zhvillimin e mirë të këtij sektori shtetëror do të jetë Banka e Shtetit Shqiptar, e cila nuk do të jetë më furnizuesja e kredive për të pasuruar tregëtarët e mëdhenj, por për të ndihmuar ndërmarrjet e mëdha shtetërore, për të ndihmuar ekonominë dhe bujqësinë. Nga ana tjetër, do të kontribuojë

pa masë dhe puna vullnetare, iniciativa e masave në punë, sakrifica dhe ndihma e popullit në ndërmarrjet publike. Duhet të kemi kurdoherë parasysh se vendi ynë është i shkatërruar dhe nevojat janë të mëdha; këto nuk mund të përballohen, si thashë edhe më lart, me buxhetin tonë të zakonshëm. Duhet punë dhe njëkohësisht kur-sime. Financat tona do të qëllojnë të gjithë ata që janë pasuruar në kurrizin e popullit fukara dhe taksat do të janë më të rënda për ata që kanë më shumë.

Problemi social

Qeveria, duke pasur si udhëheqës Statutin, do të marrë edhe masa sociale. Ajo do të kujdeset kurdoherë për ata që lufta i la jetimë e në mes të katër rrugëve dhe për ata që i bëri të pazotë për punë. Do të krijojë punë të posaçme për të gjymtuarit e luftës dhe në punët publike do të merren në shërbim në radhë të parë, ata që s'kanë asnjë të ardhur. Ndihma të mëdha janë dhënë nga ana e shtetit për të mjeruarit, por nga këto kanë përfituar dhe njerëz që nuk u takonte kjo ndihmë, kanë përfituar edhe nga ata që ishin në gjendje të punonin. Këtyre çrregullimeve do t'u japim fund dhe Komisioni i Kontrollit të Shtetit, që u formua në gjirin e qeverisë, në bazë të Statutit, do të marrë masa për funksionimin e drejtë të aparatit të shtetit për të zhdukur këto të meta e abuzime që bëhen nga njerëz parazitë e të pandërgjegjshëm që dëmtojnë shtetin dhe shoqërinë. Qeveria do të jetë e ashpër kundër atyre që shkelin ose shtrembërojnë ligjin, kundër atyre që nuk plotësojnë detyrimet që kanë ndaj qeverisë dhe shtetit.

Qeveria do të ndalojë shfrytëzimin e punëtorëve dhe do të rregullojë shpërndarjen e tyre në punë sipas mundësive dhe veçanërisht përsa u përket grave dhe të rinjve. Nga ana tjetër do të organizojë entin e siguri-meve kundër fatkeqësive në punë¹, hapjen e shtëpive të pushimit për masat punonjëse dhe do të bëjë të respektohen tetorëshi në punë dhe ditët e pushimit që akordon ligji. Veçanërisht invalidëve të luftës qeveria do të përpinqet t'u sigurojë një jetë të denjë.

Në lëmin e drejtësisë

Në lëmin e drejtësisë do të bëhen ndryshime të rëndësishme, në harmoni me bazat e përcaktuara në Statut. Që të kemi një drejtësi me të vërtetë popullore është e nevojshme të vazhdojmë duke ecur përpara në rrugën e reformave. Drejtësia duhet t'u përshtatet konditave shoqërore dhe ekonomike të reja. Detyra kryesore e gjyqtarëve është të sigurojnë zbatimin pikë pér pikë të ligjeve që bën vetë populli dhe çdo vendim i tyre të ketë vulën e frysë së re. Populli në zgjedhjen e gjyqtarëve të tij do të ketë parasysh jo vetëm aftësitë profesionale, por sidomos cilësitetë e duhura pér të garantuar mbrojtjen e interesave të tij e të fryteve të luftës që i kushtoi kaq gjak.

Pér shëndetin e popullit

Qeveria do të interesohet veçanërisht pér shëndetin e popullit duke zhvilluar një propagandë të gjerë pér

¹ Është fjala pér Degën e sigurimit shoqëror pranë Drejtorisë së punës, e cila u krijuar me dekretligjin e Presidiumit të Kuvendit Popullor Nr. 427, dt. 6.5.1947.

higjienën dhe profilaksinë. Nga ana tjetër, do të forcojë kujdesin dhe kontrollin më të madh mbi spitalet dhe mbi specialistët, të cilët profesionin e tyre të mos ta bëjnë më tregëti, por ta quajnë si një mision të lartë humanitar. Qeveria gjithashtu do të përpinqet të ngrëjë disa spitale të tjera dhe sidomos krijimin e sa më tepër ambulancave nëpër fshatra. Qeveria do të marrë masa të ashpra kundër të gjithë atyre që do të kërkojnë të spekulojnë me materialin farmaceutik. Krijimi i kurseve për infermierë është në programin e qeverisë.

Politika e jashtme

Politika e jashtme e qeverisë së re do të jetë vazhdimësia e politikës së qeverisë së mëparshme. Qeveria do të mbrojë interesat e paqes dhe të demokracisë ashtu si do të mbrojë dhe interesat e vendit të vet. Shqipëria s'është më një vend që të merret nëpër këmbë dhe as të bëhet plaçkë tregu i asaj diplomacie që është përgjegjëse e Luftës së dytë botërore. Pozitat që zë Shqipëria në gjirin e kombeve antifashiste nuk ja fali njeri, por i fitoi me gjak dhe me sakrifica mbinjerëzore. Populli ynë, që u hodh pa rezerva në luftën antifashiste, për të drejtat e tija, për të drejtat e njerëzimit, për forcimin dhe triumfin e demokracisë, për liritë e popujve, kërkon me këmbëngulje dhe me ballin lart t'i respektohen të drejtat e tij. Populli shqiptar besnik gjer në fund i aleancës së madhe antifashiste, me zemërim dhe me indinjacion sheh të shtyhet kërkesa e tij legjitime për të genë anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, dhe ai hidhërohet edhe ca më tepër kur kjo gjë shkak-

töhët prej aleatëve të tij: Anglisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Arësyet e këtyre pengesave që i bëjnë vendit tonë, i cili kërkon të zërë «de jure» vendin që meriton në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, unë s'jam në gjendje as t'i imagjinoj, po edhe zoti Bevin dhe zoti Stetinius nuk ishin në gjendje t'i formulonin dhe t'i shfaqnin haptazi përpara kërkësës sonë dhe përpara mbrojtjes miqësore të kryetarëve të delegacionit sovjetik, jugosllav dhe polonez, ndaj të cilëve dhe vendeve të tyre populli ynë është shumë mirënjos.

Ne besojmë se në Organizatën e Kombeve të Bashkuara duhet të bëjnë pjesë ato shtete që u sakrifikuani për qëllimet që synon kjo organizatë e lartë dhe që janë: forcimi i paqes dhe bashkëpunimi i singertë ndërkombëtar. Duke qenë të bindur në këtë gjë, ne themi se atje e kemi vendin më parë nga ato shtete që kanë bashkëpunuar haptazi ose tërthorazi me fashistët italianni dhe gjermanë. Qeveria, që kam nderin të kryesoj, jo vetëm që do të përpinqet t'i fitojë këto të drejta të merituara për vendin e vet, por ajo do të jetë e zonja të bëjë të respektohen prej të gjithëve dhe sidomos prej atyre që kanë në gjak Hitlerin dhe Musolinin: liria, indipendenca dhe integriteti tokësor i Republikës Popullore të Shqipërisë. Për këtë gjë qeveria e Republikës e ka me vete gjithë popullin shqiptar.

Por Shqipëria e vogël ka miq të mëdhenj në botën e jashtme, miq të singertë, që e duan popullin tonë, që e ndihmojnë me gjithë fuqitë e tyre në rrugën e rindërtimit dhe të përparimit dhe këtë ata e bëjnë sepse panë se si populli ynë u sakrifiku për kauzën e madhe të përbashkët, sepse panë se vendi ynë u dogj dhe u rrë-

nua, po s'u përkul përpara maqinës shtypëse gjermane e italiane. Tani ata shohin si populli ynë shkon me hapa të sigurta drejt rimëkëmbjes, përparimit dhe demokracisë së vërtetë dhe bëhet një faktor me rëndësi paqeje në Ballkan dhe në Evropë. Këtë miqësi të singertë dhe këtë besim që kanë miqtë tanë për Shqipërinë, qeveria e Republikës do të vërë gjithë forcat e saja që ta forcojë dhe ta meritojë për interesin e popullit tonë, të paqes dhe të demokracisë.

Një nga faktorët më të rëndësishëm të fitores mbi fashizmin dhe, pra, faktor kryesor i jashtëm për çlirimin e vendit tonë, është vendi i lavdishëm i Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike. Bashkimi Sovjetik është faktor i madh për mbrojtjen e popujve të vegjël, për mbrojtjen e sovranitetit, të lirisë dhe të indipendençës së tyre. Populli shqiptar e ka kuptuar mirë këtë gjë e prandaj ai ndjen thellë në zemrën e tij një dashuri të madhe dhe të singertë për Bashkimin Sovjetik dhe për udhëheqësin e tij të madh J.V. Stalinin. Populli ynë gjatë historisë së tij nuk e ka ndjerë kurrë veten aq të lidhur ngushtë me një miqësi të singertë me ndonjë popull se sa me popujt e Bashkimit Sovjetik. Populli ynë pa në luftën e tmerrshme se me ç'heroizëm legjendar lutftoi Ushtria e Kuqe për çlirimin e popujve dhe ai sheh dita-ditës se si Bashkimi Sovjetik, Partia Bolshevikë e Lenin-Stalinit po mbron të drejtat tona legjitime në fushën ndërkombëtare, se si ndihmon popullin shqiptar të rimëkëmbet ekonomikisht dhe në pikëpamje kulturale.

Këto ndjenja të larta miqësie dhe dashurie të singertë, që ka Bashkimi Sovjetik për vendin tonë, populli shqiptar dhe qeveria e Republikës, që përfaqëson vull-

netin e tij, do të vënë gjithë forcat e tyre që marrëdhënjet dhe bashkëpunimi politik, ekonomik dhe kultural në mes të Bashkimit Sovjetik dhe shtetit tonë të bëhen një realitet i shëndoshë. Populli shqiptar i është mirënjojës Bashkimit Sovjetik dhe Gjeneralisimit Stalin për miqësinë e madhe që kanë ndaj vendit tonë e ndihmën që i kanë dhënë atij.

Me popujt e mëdhenj anglo-amerikanë qeveria e re do të vazhdojë, si në të kaluarën, të forcojë miqësinë me ta në luftë me manevrat e neofashistëve dhe të klikave reaksionare ndërkombejtare. Qeveria jonë ka marrëdhënie diplomatike dhe miqësore me shumë vende të Evropës, si Jugosllavinë, Poloninë, Çekoslovakianë, Francën dhe do të përpinqet që t'i forcojë këto marrëdhënje të mira. Me popullin bullgar na lidh një miqësi e vjetër që prej kohës së Rilindjes shqiptare, ku patriotët tanë kanë gjetur përkrahje dhe ndihmë. Këtë miqësi qeveria jonë do ta përforcojë në baza të reja dhe të shëndosha me Bullgarinë e Frontit Patriotik.

Marrëdhënjet e përzemërtë, që u vendosën gjatë luftës kundër okupatorit të përbashkët, në mes të popullit tonë dhe popullit grek, mjerisht, u ndërprenë dhe kjo s'është as faji ynë as faji i popullit punëtor grek; faji është i fashistëve që sundojnë në Athinë, që shtypin aspiratat e popullit grek dhe që kërkojnë të turbullojnë paqen në Ballkan dhe në Evropë. Kundrejt vendit tonë fashistët e Athinës dhe reaksiuni ndërkombejtare po luajnë lodrën më të turpshme dhe më të poshtër. Një fushatë e tërë shtypi dhe propagandë shpifjesh dhe provokacionesh është ngritur në sistem kundër një populli të ndershëm, që luftoi kaq shumë kundër fashizmit dhe që

kërkon të rrojë i qetë dhe i lirë në tokën e tij. Shpifjet, provokacionet me armë gjatë kufirit tonë, grabitjet e grave të minoritetit grek nga ana e bandave të hitosve¹, torturat e poshtra dhe shtazarake, që njerëzit e Athinës kryen mbi mëmën plakë minoritare të dëshmorit, patriotit Thanas Ziko², janë një turp i madh po aq për fashistët grekë, sa dhe për ata që i ndihmojnë këta banditë.

Populli shqiptar duhet të dijë mirë çka kërkojnë fashistët grekë. Këta s'kërkojnë gjë tjetër përvçese Gjirokastrën dhe Korçën gjer në Shkumbin, se qenka toka e tyre, thonë. Dhe reaksiioni ndërkombëtar po i ndihmon në këtë komedi të madhe, se ai do që Shqipëria të bëhet çifliku i kriminelëve shqiptarë të luftës, që rrojnë në pallatet e Romës dhe të Kajros. Çdo shqiptar, i madh dhe i vogël, habitet dhe egërsohet, kur sheh se pas kësaj lufte kaq të tmerrshme kundër fashizmit të ketë edhe njerëz e shtete që hiqen demokratë, përkrahin fashistët grekë në këtë tezë kaq të marrë dhe kaq të poshtër. A mund të ketë shqiptar që të mos revoltohet përparrë pretendimeve të tilla? A mund të ketë shqiptar që të mos rrokë armët për të mbrojtur atdheun e tij kundër agresorit, qoftë ky fashist italian, gjerman, o grek? Jo, nuk ka, prandaj fashistët grekë dhe ata që i mbrojnë duhet ta kenë të qartë se nuk guxon njeri të lëvizë asnjë

¹ Hitosët — pjesëtarë të bandave terroriste në shërbim të xhandarmërisë greke.

² Thanas Ziko, patriot revolucionar. Punoi dhe luftoi për përmbysjen e regjimit feudalo-borgjez të A. Zogut. Vdiq në emigracion në Beograd në shkurt 1941.

pëllëmbë pirimidat e kufirit tonë të Jugut, se derdhet gjak, dhe do të ketë skena dhe përfundime të hidhura për ata që do të dëshirojnë ta provokojnë këtë gjë. Qeveria e Athinës dhe zoti Rendis, ministër i jashtëm i saj, përpiken që popullin shqiptar ta bëjnë përgjegjës përluftën italo-greke, ta vënë në një plan me Italinë fashiste dhe këtej të kërkojnë reparacione. «Shqipëria i ka deklaruar luftë Greqisë», gërrhet fashisti Rendis për të forcuar tezën e tij qesharake të «Epirit të Veriut». Populli shqiptar kurrë nuk i ka deklaruar luftë Greqisë, përkundrazi, ai ka luftuar më mirë se kushdo tjetër kundër italianëve dhe kuislingëve shqiptarë, autorë të këtij krimi. Populli shqiptar ka simpati për popullin grek. Ai ka goditur me armë forcat e furnizimet italiane që shkonin në frontin e Jugut; ai është përleshur me karabinierët nëpër rrugë. Edhe ata ushtarë të paktë që u muarën me forcë nga italianët, hodhën armët, dezertuan, u vranë ose u internuan nga SIM-i. Për luftën kundër Italisë fashiste dëshmojnë viktimat tona, fshatrat e djegura, deklaratat e aleatëve, dëshmojnë djemtë e popullit grek që panë me sytë e tyre vullnetin e madh të popullit shqiptar të Jugut, që kërkonte të luftonte krah për krah me ta kundër italianëve, por që këtë dëshirë ua refuzuan komandantët e ushtrisë së Metaksait.

Le të shohë më mirë poshtërsinë e këtij argumenti populli ynë: fashistët grekë dhe reaksiuni ndërkombëtar e akuzojnë popullin tonë për një krim që ai kurrë s'e ka bërë, por e ka luftuar me gjithë forcat e tija. Autorët e vërtetë të këtij krimi tanë po përkëdhelen në hotelet e mëdha të Romës dhe kush e kush t'u japë rroga më të majme. Fashistët harrojnë ujkun për të kërkuar gjurmët.

Vallë zoti Rendis dhe shokët e tij përse i ruajnë kriminelët italianë të luftës dhe kuisingjet shqiptarë, autorë të luftës kundër Greqisë, si Viktor Emanuelin, Shefqet Vërlacin, Mustafa Krujën, Kolë Bibë Mirakën etj.?

Këta janë përgjegjësit e aktit të poshtër kundër Greqisë dhe jo populli shqiptar. Populli shqiptar dhe qeveria e tij e vërtetë kurrë nuk i ka shpallur luftë Greqisë, përkundrazi, ata kanë simpatizuar dhe kanë ndihmuar popullin punëtor grek në përpjekjet e tij për çirim.

Zoti Rendis dhe shokët e tij i ruajnë ata kriminelë të luftës, përgjegjës për luftën italo-greke, për të përsëritur ndoshta tragji-komedinë e Musolinit. Por zotërinjtë e Athinës duhet të dinë mirë se populli shqiptar s'u përngjet fashistëve italianë të Musolinit.

Bota përparimtare duhet t'u tregojë vendin këtyre njerëzve që rrezikojnë paqen dhe zhvillimin normal dhe paqësor në mes të shteteve. Vendi ynë dëshiron të rrojë i qetë dhe në marrëdhënje të mira me të gjithë, por të drejtat e tij s'lejon t'ja shkelë njeri dhe di t'i mbrojë heroikisht dhe të fitojë.

Qeveria e Republikës do të rrrethojë me kujdesin dhe me dashurinë më të madhe ushtrinë tonë heroike, që nëpërmjet betejash të përgjakshme çlroi atdheun, i siguroi këtij indipendencën dhe sovranitetin. Qeveria jonë do të vërë gjithë forcat që ushtria jonë popullore, që është mburoja e sigurt e të drejtave që fitoi populli, mburojë e indipendencës dhe e integritetit tokësor të Shqipërisë, të bëhet një ushtri nga më modernet dhe simbol i një dashurie të madhe nga ana e popullit tonë, që e lindi dhe e rriti nëpërmjet kaq furtunash.

Shokë deputetë,

Duke paraqitur shkurtimisht detyrat e qeverisë së re, dëshiroj të theksoj edhe njëherë se nga kryerja e këtyre detyrave varet e ardhmja e lumtur e Republikës Popullore të Shqipërisë. Këto probleme vitale do t'i zgjidhim me mundësitë tona materiale, prandaj lypset që i gjithë populli shqiptar të mobilizohet dhe të ketë parasysh se do të duhet të bëjmë sakrifica dhe të heqim dorë nga shumë gjëra derisa të kapërcejjmë vështirësitë kryesore. Me një mobilizim të tillë në punë, ku të derdhet djersë dhe të tregohet aftësi dhe ndërgjegje, ne do të arrijmë të ndërtojmë Shqipërinë e re ashtu si e deshën ata që luftuan dhe ranë në fushën e nderit, që Shqipëria të rrojë kryelartë, e begatshme, e kulturuar, e lumtur.

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 382,
25 mars 1946*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 382,
25 mars 1946*

**FJALA NE KUVENDIN POPULLOR ME RASTIN E
EMERIMIT KOMANDANT TE PERGJITHSHEM TE
FORCAVE TE ARMATOSURA TE REPUBLIKES
POPULLORE TE SHQIPERISE**

26 mars 1946

Shokë deputetë,

Ju falenderoj shumë për besimin e madh që tregoni ndaj meje duke më emëruar Komandant të Përgjithshëm të Ushtrisë sonë Kombëtare. Unë e ndjej përgjegjësinë e madhe të detyrës që më ngarkon populli ynë, nëpërmjet jush, dhe unë nuk do të harroj për asnjë minutë përgjegjësinë që kam: që ushtria jonë heroike, e cila lindi në momentet më të vështira që kaloi populli ynë, që u rrit nëpër beteja të përgjakshme, që u mbajt me djersën e kafshatën e gojës së popullit tonë dhe që u pajis me idealet e larta të mbrojtjes së atdheut e të fitoreve të lirisë, të mbrojë me mish e me shpirt, ashtu siç e ka në gjak, indipendencën dhe integritetin tokësor të vendit tonë. Unë do të vë të gjithë forcën time, që Ushtria jonë Popullore të bëhet e denjë për popullin tonë, të jetë kurdoherë gati për të mbrojtur interesat e

popullit, për të mbrojtur Shqipërinë dhe njëkohësisht ajo të jetë faktori i madh i rindërtimit.

Rroftë Ushtria jonë Kombëtare!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 384,
27 mars 1946*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 384,
27 mars 1946*

**NOTË DËRGUAR J. E. XHEJKOBS, KRYETAR I
MISIONIT TË SHBA NË SHQIPËRI, NË LIDHJE ME
QËNDRIMIN ARMIQËSOR TË SENATIT AMERIKAN
NDAJ SHQIPËRISË**

12 prill 1946

I ndershmi zotri,

Duke qenë kurdoherë dëshira jonë që të zhduket çdo keqkuptim që mund të errësojë marrëdhënjet mi-qësore që ekzistojnë në mes vendit tonë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, lutem të keni mirësinë të na sqaroni se deri ku janë të vërteta lajmet e poshtme të përhapura nga radio Londra, agjencia Rojter dhe shtypi amerikan.

Radio Londra në emisionin e saj në gjuhën italisht në ora 11 të mbrëmjes datë 27 mars 1946 ka thënë tekstu alisht kështu:

«Senatori amerikan Vandenberg komunikoi se Komisioni i punëve të jashtme të Senatit Amerikan aprovoi një mocion ku thuhet se Dodekanezi dhe «Epiri i Veriut» t'i jepen Greqisë». Nga ana tjetër agjencia Rojter me datën 30 mars duke bërë fjalë për udhëtimin e agjentit grek Pandeleimon Kotokos në Uashington në mes të

tjerave transmetoi: «Komisioni i Senatit Amerikan për punët e jashtme shprehu simpati për kauzën greke në lidhje me «Vorio Epirin»». Përveç kësaj një numër i madh gazetash të Shteteve të Bashkuara dhe të vendeve të tjera e vënë në dukje këtë gjë.

Kemi kurdoherë dyshim në vërtetësinë e lajmeve që përhapin agjenci të tilla në lidhje me Shqipërinë dhe që synojnë të dobësojnë miqësinë që ekziston në mes të dy vendeve tona, prandaj do t'Ju lutemi të na sqaroni: A janë të vërteta këto vendime të Komisionit të Senatit Amerikan për punët e jashtme të pretenduara nga radio Londra, agjencia Rojter dhe shtypi amerikan?

Duke shpresuar se do të kemi një sqarim sa më të shpejtë, lutemi, i ndershmi zotri, pranoni nderimet e mia më të shquara.

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

KËRKESE DREJTUAR KONFERENCES SË
MINISTRAVE TË PUNËVE TË JASHTME NË
PARIS, NË LIDHJE ME TË DREJTËN E
SHQIPËRISË PËR TË MARRË PJESË NË
DISKUTIMIN E TRAKTATIT TË PAQES
ME ITALINË

27 prill 1946

KONFERENCES SË MINISTRAVE TË PUNËVE TË JASHTME
TË BRITANISË SË MADHE, TË SHTETEVE TË BASHKUARA
TË AMERIKËS, TË BASHKIMIT TË REPUBLIKAVE SOCIA-
LISTE SOVJETIKE DHE TË FRANCËS¹.

Paris

Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë ka
nderin të parashtrojë sa vijon në gjykimin mirëdashës
të Konferencës së Ministrave të Punëve të Jashtme të
Britanisë së Madhe, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës,
të Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike
dhe të Francës:

¹ Është fjala për Konferencën e Paqes që u mbajt në Paris
nga 29 korrik — 15 tetor 1946 për të shqyrtau projekttraktatet
e paqes me shtetet aleatë të Gjermanisë hitleriane në Evropë:
Italinë, Bullgarinë, Rumaninë, Hungarinë dhe Finlandën, gjatë
Luftës së dytë botërore.

Me rastin e mbledhjes në Paris të Konferencës së Ministrave të Punëve të Jashtme të fuqive kryesore aleate për të diskutuar rrëth çështjeve të ndryshme në lidhje me Traktatin e Paqes me Italinë, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, duke interpretuar ndjenjat e thella të popullit shqiptar, tërheq vëmendjen mirëdashëse të konferencës mbi të drejtën e Shqipërisë që të ftohet të parashtrojë pikëpamjen e saj në diskutimin e Traktatit të Paqes me Italinë.

Shqipëria është palë e interesuar në këtë diskutim, sepse ka pësuar vuajtje shumë të rënda nga agresioni i Italisë fashiste.

Si dihet, më 7 prill 1939, Italia fashiste, me forca të armatosura të mëdha, goditi Shqipërinë dhe e okupoi.

Populli shqiptar i rezistoi okupatorit dhe derdhi gjakun e tij në portet dhe në rrugët prej ku hynë ushtritë fashiste.

Okupacioni i Shqipërisë nga Italia qe rezultat i një agresioni të armatosur, i mbështetur vetëm mbi fuqinë brutale ushtarake dhe zgjati deri në kapitullimin pa kushte të Italisë fashiste.

Rezistenca shqiptare kundër okupatorit, e filluar që ditën e okupacionit, më 7 prill 1939, vazhdoi dhe u zhvillua në të gjitha format. Manifestime të mëdha të masave popullore në vitet 1940 e 1941 kundër okupatorit fashist u mbytën në gjak. 6 500 shqiptarë antifashistë u hodhën në burgjet ose në fushat e përqëndrimit prej italianëve; mijëra të tjerë u masakruan me gjakftohtësi në qytetet dhe në katundet e Shqipërisë për veprimitari antifashiste.

Që më 1939 kishte 3 000 shqiptarë antifashistë në

malet që goditnin fashistët italianë. Këta ishin bërthama e çetave partizane, të cilat më pas do të mbuloheshin me lavdi në luftën kundër italianëve fashistë së pari dhe më vonë kundër gjermanëve nazistë, të cilët zëvendësuan të parët.

Lufta e vazduar nga populli shqiptar kundër të dy okupatorëve krah aleatëve të mëdhenj i detyroi italianët dhe gjermanët të mbanin përherë në Shqipëri një numër të konsiderueshëm divizionesh nga më luftaraket. Që më 1942 në Shqipëri kishte zona të çliruara nga partizanët, dhe më 1943 në prakun e kapitullimit të Italisë më tepër se gjysma e Shqipërisë ishte e çliruar.

Në mes të luftës dhe në mes të vuajtjeve më të dhimbshme, populli shqiptar krijoi Ushtrinë e tij Nacional-Çlirimtare, ushtrinë partizane të organizuar në brigada, divizione dhe korparmata, dhe që në fund të luftimeve mbërriji 70 000 njerëz. Kjo luftoi trimërisht kundër dy armiqve dhe, pas çlirimtës së Shqipërisë, ajo ndoqi hitlerianët përtej kufive, në Jugosllavi.

Kësisoj, populli shqiptar tregoi se kauza aleate ishte e tija. Me gjakun e derdhur dhe me sakrificat e pësuara në të njëjtën luftë dhe kundër të njëjtit armik, populli shqiptar u radhit me kurajo në anën e aleatëve të mëdhenj dhe besnikëria e tij për kauzën aleate qe e patundur.

Për fitoren e përbashkët ai dha kontributin maksimal: Më tepër se 50 000 të vdekur dhe të plagosur, 35% të qyteteve dhe të katundeve të Shqipërisë të bëra shesh, komunikacionet e shkatërruara, ekonomia kombëtare e asgjësuar nga okupatorët fashistë, dëshmojnë se sa e gjerë qe lufta e popullit shqiptar kundër fashizmit.

Vetëm kësisoj populli shqiptar fitoi lirinë dhe pavarësinë e tij, krijoi ushtrinë çlirimtare dhe, me të njëjtën luftë, ngriti një regjim demokratik.

Me sakrifica të tilla njerëzore dhe me dëme materiale shumë të mëdha gjatë luftës së përbashkët, Shqipëria fitoi të drejtën të parashtrojë kërkesat e saja kundrejt Italisë si dhe kundrejt Gjermanisë.

Prandaj duke paraqitur këtë kërkesë legjitime dhe konform me principet e drejtësisë dhe të së drejtës ndërkombëtare, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë ka besimin e patundur se ajo konferencë e kujdesshme në respektimin e të drejtave dhe interesave të shteteve të vegjël, do të ketë mirësinë të konsiderojë këtë kërkesë me gjithë interesimin e duhur dhe t'i japë një vijim të favorshëm duke i lejuar popullit shqiptar të ngrejë zërin e tij në këtë rast.

Kryeministri dhe Ministri i Punëve të
Jashtme
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 412,
27 prill 1946*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Bashkimi», Nr. 412,
27 prill 1946*

MESAZHE DREJTUAR FAN S. NOLIT PËR
ÇËSHTJEN E NJOHJES SË QEVERISË DEMOKRA-
TIKE DHE MBROJTJEN E PAVARËSISE
SË SHQIPËRISË

MESAZHI I PARË

[Prill 1946]

Zotit Fan Noli,

Kam marrë mesazhet dhe i çmoj përsëtepërmi përpjekjet tuaja dhe të gjithë shqiptarëve në Amerikë. Kujdesi dhe dëshira jonë ka qenë dhe vazhdon të jetë forcimi i marrëdhënjeve të mira dhe i miqësisë me të gjithë aleatët e mëdhenj. Me popullin amerikan na lidh një miqësi e vjetër. Ne kemi dashur dhe dëshirojmë ta forcojmë këtë miqësi në baza të shëndosha e të sinqerta. Përpjekjet tona për të marrë kontakt me vëllezërit tanë në Amerikë dhe për t'i bërë të njojur opinionit amerikan, luftën heroike të vendit tonë, qëndrimin tonë të patundur për kauzën aleate, na janë refuzuar në mënyra të ndryshme, por, me gjithë pengesat e mëdha që na janë bërë nga ana e funksionarëve amerikanë në Shqipëri, kemi shpresuar se çështja jonë do të zgjidhej

në mënyrë të kënaqshme për të dy vendet. Kondita e njohjes së qeverisë sonë, e vënë nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara, na ka habitur dhe hidhëruar pse këtë e konsiderojmë, si një mohim të sovranitetit dhe të vetë-vendosjes së popullit tonë për të cilat populli shqiptar derdhi kaq gjak. Vendimet e Kongresit të Përmetit, të bazuara në principin e 'vetëvendosjes, na urdhërojnë prishjen e të gjitha traktateve të konkluduara me shtetet e huaja nga qeveritë e mëparshme antipopullore dhe nënshkrimin e traktateve të reja në interesin e kombit tonë. Kjo është një e drejtë elementare e popullit shqiptar, i shtypur nga regjimet tiranike, që luftoi për të fituar çdo të drejtë dhe çdo liri dhe që do të rrojë independent e sovran në gjirin e kombeve të bashkuara dhe do të ecë kryelartë me frymën e re ndërkontaktare. Përsa u përket traktateve që ekzistojnë me Shtetet e Bashkuara, ne kurdoherë kemi qenë dhe jemi të dispozuar t'i rishikojmë, t'i shqyrtojmë dhe në frymë miqësore dhe pariteti të nënshkruajmë traktatë të reja në interesin e të dy vendeve tonë, pasi të njihet qeveria jonë.

Një qëndrim i tillë i drejtë i popullit shqiptar dhe i qeverisë së tij duhet të çmohet jo si obstruksion nga ana jonë, por si një çështje parimi nga më demokratikët. Nga ana tjetër nga zgjidhja e drejtë e këtij problemi, ne kemi bindjen se do të sigurohet një miqësi dhe marrëdhënje të mira me baza të shëndosha dhe të singerta në mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara.

Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

MESAZHI I DYTEË

Zotit Fan Noli,

Hidhërohemë tepër kur shohim se shtypi amerikan dhe personalitete të larta amerikane mbajnë një qëndrim jo të drejtë dhe armiqësor ndaj Shqipërisë, e cila luftoi me trimëri të rrallë për kauzën e përbashkët. Çështja e të ashtuquajturit Vorio Epir, e ngritur nga ana e fashistëve grekë, që mbrohet dhe përkrahet nga ana e këtyre personaliteteve patjetër nuk e forcon miqësinë e popullit shqiptar me Shtetet e Bashkuara. Mbrojtja e një teze kaq të marrë nga ana e tyre sjell me vete edhe përgjegjësi ndërkombëtare, pse të mbrosh hajdutët fashistë, që kërkojnë të rrëmbejnë tokën e tjetrit, do të thotë të bëhesh pjesëtar në këtë kusëri. Të gjithë duhet të jenë të bindur se me të gërrhitura dhe me «vendime» rrëth tryezave të gjelbëra, nuk copëtohet kollaj Shqipëria. Po të cënohen kufitë e Shqipërisë, ju sigurojmë se ne do t'i mbrojmë deri në njeriun e fundit dhe agresorët fashistë nuk do t'ja arrijnë qëllimit. Kujt ja ka qejfi, mund ta diskutojë «çështjen e Shqipërisë së Jugut», por duhet të mendojë se në mes të «vendimit» që mund të marrin fashistët grekë e miqtë e tyre dhe zbatimit të këtij «vendimi», ndodhet një kufi në Shqipërinë e Jugut që do të jetë zor të kapërcehet. Ne nuk vëmë në diskutim atdheun tonë, por këtë e mbrojmë kundër çdo agresori. Për këtë, populli shqiptar është i gjithë në këmbë, ashtu siç jeni të gjithë ju vëllezërit tanë të dashur në Amerikë. Populli ynë do të rrojë i lirë në vendin e tij dhe në marrëdhënje të mira me të gjithë. Ne mendojmë dhe jemi të sigurtë se dhe ju men-

doni si ne, se populli ynë luftoi jo për t'u futur në një robëri tjetër, por për të rrojtur i lirë, për të rrojtur i nderuar, ashtu sikundër ai nderon të tjerët. Ai kërkon t'i respektohen të drejtat e tij, ashtu sikundër respekton të drejtat e tjeërit. Ne jemi të bindur se për Mëmëdheun dhe për mbrojtjen e të drejtave të tij do të ngrihen edhe vëllezërit tanë në Amerikë, ashtu si kanë bërë kurdoherë. Ne do të fitojmë mbi ata fashistë të rinj që do të kërkojnë të dëmtojnë vendin tonë, pse jemi në të drejtë. Në kohërat më të errëta të luftës, populli shqiptar nuk u tremb dhe ca më pak tani, pse ai ka besim në forcat e veta dhe në të gjithë demokratët e vërtetë të botës.

Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

MESAZHI I TRETE

Zotit Fan Noli,

Nuk e quajmë të drejtë që për çështjen e traktateve, vendi ynë të mos përkrahet nga ana e qeverisë amerikane për t'u pranuar në OKB. Që të jemi anëtarë të OKB-së, këtë populli ynë e ka fituar me luftë të ashpër dhe të paprerë kundër fashizmit italian dhe gjerman, armikut të përbashkët të njerëzimit. Organizata e Kombeve të Bashkuara që duhet të përfaqësojë përpjekjet që kanë bërë vendet antifashiste për arritjen e fitores dhe sigurimin e paqes si edhe për zhvillimin e drejtë të marrëdhënjeve ndërkombëtare në mes shteteve, nuk mund të refuzojë dhe të mos përkrahë pjesëmarrijen e vendit tonë që u sakrifikuva për këto qëllime të larta. Një qëndrim i kundërt nga cilido shtet qoftë e sidomos nga

aleatët e mëdhenj, do të thotë mohim i luftës sonë të ashpër, mohim i deklaratave që kanë bërë vetë këta aleatë mbi luftën dhe përpjekjet e popullit tonë, do të thotë gjithashtu refuzim nga ana e tyre i kontributit që mund të japë një shtet, qoftë kaq i vogël, sa është Shqipëria, por që ka dhënë prova të mëdha besnikërie dhe vendosmërie për të luftuar fashizmin, në konsolidimin e paqes dhe në zhvillimin e mirë dhe paqësor. Një qëndrim i tillë ndaj nesh nga cilido shtet, nuk do të mirëpritet nga populli ynë dhe nga të gjithë demokratët e botës, pse është një padrejtësi flagrante që i bëhet një populli heroik në ato të drejta për të cilat ranë me miliona njerëz.

Nga ana tjetër do të jetë një padrejtësi nga ana e autoriteteteve amerikane, që për çështjen e traktateve të përkrahët një tezë shumë e padrejtë dhe e pathemeltë, sikundërqë është ajo e të ashtuquajturit Vorio Epir. Popullit tonë kurrë nuk do t'i ngrohet zemra ndaj atyre njerëzve ose autoriteteteve që do të guxojnë të bëjnë një padrejtësi kaq të madhe dhe flagrante. Kjo është e natyrshme, dhe s'do të jetë faji i popullit shqiptar. Populli ynë dhe ne do të bëjmë çmos që të forcohet miqësia në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Shqipërisë, por kjo miqësi, që të jetë e vërtetë, duhet të bazohet në respektimin e të drejtave tona si shtet indipendent dhe sovran.

Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botohen për herë të parë si-
pas origjinaleve që gjenden në
Arkivin Qendror të Partisë*

FJALIM I MBAJTUR PËRPARA PUNËTOREVE TË KUÇOVËS

1 maj 1946

Shokë punëtorë të Kuçovës,

Ndjej një gjëzim të madh që jam përsëri në mes tuaj sot ditën e 1 Majit, të cilën jua uroj të mbarë dhe të lumtur, të mbarë dhe të lumtur për gjithë popullin tonë.

Fytyrat tuaja ndritin nga gjëzimi se për herën e parë në historinë e vendit tonë festa ndërkombëtare e proletariatit botëror festohet në këtë shkallë me madhështi e anekënd Shqipërisë sonë të çliruar. Kjo ditë na kujton përpjekjet vigane dhe luftërat e përgjakshme që kanë bërë me miliona punëtorë të botës kundër shfrytëzimit kapitalist, kundër shtypjes barbare dhe çnjerëzore të imperialistëve, kundër regjimeve të errësirës; kjo ditë na kujton luftën e madhe antifashiste që bota përparimtare bëri kundër bishave fashiste italiane dhe gjermane, armiqve më të mëdhenj të klasës punëtore dhe të njerëzimit mbarë. Sot kjo ditë e madhe e punës na tregon rrugën ku duhet të ecë bota e qytetëruar për të ndërtuar një jetë të lumtur, të lirë dhe plot nder.

Sot, shokë punëtorë, ju dhe gjithë populli gëzojmë frytet e fitores së madhe që korrëm pas përpjekjeve aq të tmerrshme për jetë a për vdekje. U hodhëm, pa kursyer as jetën tonë, në betejat më të ashpra dhe të pabarabarta, për të fituar lirinë dhe pavarësinë, për të siguruar ekzistencën tonë që ishte në rrezik të madh të zhdukej. Në momentet më të rrezikshme të historisë sonë kombëtare, që ishin të njëllojta me ato të mbarë njerëzimit, populli shqiptar s'u përkul, por qëndroi si shkëmb në gjirin e kombeve aleate antifashiste, u bëri ballë valëve të tërbuara dhe, më në fund, ai e mundi vdekjen dhe doli në dritë. Sot, në ditën e 1 Majit, Shqipëria e vogël me krenari dhe me ballin lart i thotë njerëzimit: «Unë e bëra detyrën», ashtu sikurse edhe ju, punëtorë të Shqipërisë, mund t'i thoni kryelartë proletariatit botëror se e bëtë detyrën tuaj proletare.

Ju, punëtorët e Shqipërisë, ishit të parët që, me në krye Partinë tuaj të lavdishme Komuniste të Shqipërisë, ngritët lart flamurin e luftës së armatosur kundër shtypësve fashistë të vendit tonë, ju u bëtë hallka e shëndo-shë që lidhi dhe çimentoi bashkimin e popullit tonë në luftë dhe në paqe për të përmbushur nevojat jetike të kombit dhe aspiratat e popullit. Na u vranë me qindra e me mijëra djem nga më të mirët; u dogjën nga dora mizore kasollet e shtëpitë, fshatrat dhe qytetet tona, që i kishim ndërtuar me fukarallëk të madh; na u grabit pasuria e vendit, por populli ynë s'e pushoi për asnje çast luftën e çlirimt, sepse andej varej e ardhmja e tij. Për të çliruar mëmëdhenë nga okupatorët, për të fshirë vjetërsirat dhe kalbësirat e regjimeve antipopullore të mëparshme, që kishin helmuar dhe hidhëruar jetën e

popullit tonë të mjerë dhe që kishin pregetitur dhe ndihmuar okupacionin, për të fituar të drejtat demokratikë të popullit, sakrificat s'janë kurrë të mjafta; këto populli shqiptar i mori në sy, prandaj fitorja që korri është e paçmueshme.

Objektivat historike, që faza e luftës u kish përcaktuar klasës punëtore, fshatarësisë, intelektualëve patriotë dhe gjithë njerëzve liridashës dhe demokratë të Shqipërisë u arriten. Të bashkuar në një aleancë të shëndoshë në Frontin e madh Demokratik të popullit tonë, fill pas çlirimtës plotë të atdheut, ata u hodhën në luftën e rindërtimit të vendit të rrënuar. Lufta e rindërtimit, po aq e shenjtë sa dhe e para, nuk mund të fillonte dhe të vazhdojë pa pjesëmarrjen e masave të gjera punonjëse të Shqipërisë. Konditat ishin për një gjë të tillë dhe këto i kish krijuar vetë lufta; punëtorët, fshatarët dhe gjithë populli i ndershëm i Shqipërisë që pagoi me gjak lodrat dhe tradhëtitë e politikanëve avenirë, që e qeverisnin në të shkuarën duke e shtypur, kuptoi përsë luftonte dhe sakrifikonte. Lufta e madhe e çlirimtës bëri popullin tonë zot të fateve të veta dhe, pra, rruga e tij tanë ishte e caktuar. Reformat e mëdha shoqërore dhe ekonomike e forcuan edhe më tepër besimin e popullit në forcat e veta, në pushtetin e tij. Fshatari mori tokën dhe u çlirua përgjithmonë nga zgjedha e beut dhe e agait që i kish pirë gjakun tërë jetën. Djersa që kullon sot ndër ara e bën grurin të hedhë shtat për lumturinë e fshatarëve tanë. Sot minierat, fabrikat, kantieret e ndryshme të punës janë në duart e punëtorëve, të cilët udhëheqin punën e rindërtimit të Shqipërisë. Mund të çuditën ata që s'e njojin

popullin tonë, që s'e kanë parë në luftë dhe në punë, për përparimet që janë bërë në një periudhë të shkurtër. Iniciativa krijuese e masave punonjëse të vendit tonë ka qenë aq e madhe, sa edhe e frytshme. Riparimi i çdo gjëje që na kish shkatërruar armiku, rimëkëmbja e minierave dhe e industrisë së lehtë etj., nuk ishin punë që mund të ngriheshin dhe të viheshin në funksionim vetëm duke harxhuar shuma të mëdha, të cilat na mungonin, por u lyp nga punëtoria jonë ndërgjegje dhe vullnet, disiplinë dhe sakrifica. Këta s'i munguan thirrjes së atdheut dhe puna u krye. Sot punohet kudo me vrull të madh, punohet nëpër ara e nëpër rrugë, punohet në Kuçovë, në Rubik e në Selenicë, punohet në të gjitha fabrikat e ndryshme të Shqipërisë, punohet për një qëllim: të ndërtohet Shqipëria e re, të përmirësohetjeta e popullit, të lehtësohen vuajtjet dhe mjerimet, të shohë populli ditë të bardha. Ne jemi në gjendje të shkojmë përpara dhe me vullnetin tonë të madh të kapërcejjmë çdo pengesë. Garat e 1 Majit, që çuan peshë gjithë popullin tonë, janë prova e gjallë: brenda një kohe të shkurtër, me rastin e garave, gjysmë milioni vullnetarë, gra, burra, pleq, të rinj e të reja kanë kryer 3 milion orë punë vullnetare, që në të holla do të thotë gati 13 milion franga shqiptare dhe këto të holla ja kanë kursyer shtetit, ja kanë kursyer atdheut. Janë hapur kanale që kanë shpëtuar nga mbytja me mijëra hektarë tokë, janë çelur rrugë, janë ngritur godina dhe ura, janë ndërtuar fabrika dhe oficina, janë spastruar qytete, janë punuar dhe mbjellë ara me grurë, janë çelur shkolla e kopshte përfëmijë. E gjithë kjo përfaqëson punën vullnetare brenda pak muajve, kësaj i shtohet dhe puna e

rregullt ku është treguar energji e vitalitet i çuditshëm. Sot në festën e 1 Majit, për të shpërblyer shërbimin që po i bëhet atdheut, Presidiumi i Kuvendit Popullor po dekoron me urdhëra e medalje të punës, krahina, qytete e fshatra, kantiere e fabrika, punëtorë, katundarë, qytetarë, që kanë derdhur pa kursyer djersën që Shqipëria të rindërtohet dhe të përparojë. Lavdi popullit tonë heroik dhe punëtor!

Shokë punëtorë të Kuçovës,

Jemi në rrugë të drejtë, por kemi shumë punë dhe detyra të mëdha pér të kryer, dhe këto presin të kryhen vetëm nga ne. Prandaj që të kryejmë si duhet dhe shpejt çdo gjë që na ngarkohet, duhet t'i kuptojmë mirë këto detyra dhe rrethanat në të cilat jetojmë. Momentet janë historike dhe përgjegjësitë të rënda, por njerëzit me vullnet të fortë, njerëzit që u dhimbset populli dhe atdheu, as nuk ju shmangen, as nuk ju tremben përgjegjësive. Njerëz të tillë, modeli i të cilëve është klasa punëtore, jo vetëm mbajnë mbi supet e tyre përgjegjësi të tilla, po këtyre u dalin zot.

Statuti Themeltar i Shtetit, që ju dha popullit nga Asambleja Kushtetuese, çel pér vendin tonë një etapë të re me perspektiva të gjera, që do t'ja ndryshojnë faqen Shqipërisë në favorin e masave të gjera punonjëse. Reformat e mëdha me karakter ekonomik e social patjetër nuk mund të jenë kurrë në favorin e atyre që shtypën popullin, që i pinë gjakun, që e vranë dhe e burgosën, që e shitën te i huaji. Dhe mbeturinat e këtyre plehrave do të lehin, por ata s'janë më në gjëndje as

të na kafshojnë. Mos vallë populli ynë derdhi gjakun e tij të vlefshëm që të vazhdonin të rronin rehat bejlerët e feudalët, të vazhdonin të mbanin tokat e fshatarëve dhe t'i shfrytëzonin këta gjer në palcë? Apo mos vallë populli ynë u gjakos dhe u sakrifikua vjete me radhë për t'i lënë tregëtarët e mëdhenj dhe fabrikantët spekulues të pinë në rehati gjakun e popullit tonë, që e patën bërë plaçkë tregu? Jo, aspak. Populli luftoi për të vendosur ligjin e tij të drejtë, dhe e vendosi. Për Shqipërinë lindi një kohë e re ku do të jetojë njeriu i ndershëm, njeriu që punon me ndërgjegje dhe me nder, njeriu që s'rron vetëm për vete, por edhe për të tjerët, njeriu që duhet t'i japë shoqërisë që të mund të kërkojë prej saj. Ky është kuptimi i thellë i reformave tona, të cilat janë varg të lidhura njëra me tjetrën dhe që përbëjnë realitetin e Shqipërisë së re. Nuk mund të kuptohet reforma agrare pa shtetëzimin e minierave dhe të fabrikave të ndryshme, ashtu si nuk mund të kuptohet shtimi dhe përmirësimi i prodhimit bujqësor pa shtimin e prodhimit industrial. Këto dy probleme të rëndësishme dhe jetike për vendin tonë janë aq të lidhura ngushtë me njëri-tjetrin, sa është e ngushtë edhe aleanca e shëndoshë që ekziston në mes të punëtorëve dhe të fshatarëve të Shqipërisë. Këto probleme populli ynë i zgjidhi me vendosmëri, por që këto fitore të konsolidohen dhe të jepin frytet e duhura, tanë duhet një punë intensive dhe e shëndoshë. Për t'i realizuar këto, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe gjithë populli shqiptar, me në krye klasën punëtore, i janë përveshur punës. Ju, punëtorët, që duhet tëjeni shembull për të gjithë, e dini fare mirë se rezultate të tilla

nuk arrihen as duke fjetur e as duke lidhur duart, por duke djersitur dhe duke sakrifikuar. Komitetet fshatare dhe teknikët e reformës duhet të punojnë pa u lodhur dhe drejt, që të shpejtohet ndarja e tokës. Duhet që fshatarësia të punojë sa më shumë tokën, të shtojë sa më shumë dhe të përmirësojë prodhimet e veta, se kështu do të pasurohet ajo vetë dhe bashkë me të, gjithë populli. Duhet të punohet ditë e natë në kantieret e Kuçovës, të Rubikut e të Selenicës. Në të gjitha fabrikat dhe punëtoritë e Shqipërisë të punohet për të prodhuar sa më shumë e sa më mirë; të bëhen sa më shumë kur-sime. Duhet që punëtorët të fitojnë profesione, të spe-cializohen në degë të ndryshme dhe maqina ku punojnë të bëhet skllavi i tyre. Punëtorët duhet të janë për të gjithë shembull i një discipline të hekurt në punë, shem-bull i ndërgjegjes së pastër dhe i sakrificës, shembull i realizimeve të mëdha. Në shoqërinë e re përgjegjësítë tuaja, o shokë punëtorë, janë të rënda; por ju do t'i kryeni me nder, pse jeni nga ai çelik që s'thyhet kurrë. Është detyra juaj të qëndroni në radhët e para të luftës për rindërtimin, ashtu si qëndruat në radhët e para të luftës së çlirimt.

Qeveria, në programin e saj dhe në planin e punës që do të shpallet për së shpejti me rastin e paraqitjes së buxhetit, ka mjaft punime të një rëndësie të dorës së parë që duhet të kryhen. Buxheti ynë është i vogël, por planet e punimeve janë të mëdha, ashtu si janë të mëdha dhe nevojat e popullit. Si do t'ja dalim mbanë kësaj gjëje? Duke punuar dhe vetëm duke punuar. Ligji i punës është ligji i jetës së begatshme. Puna të bëhet nder për gjithë popullin tonë, pse vetëm ajo do të na

inxjerrë në ditë të bardha. Ai që s'punon është i dënuar të vdesë si një organizëm i pavlefshëm, ky është një ligj i natyrës. Populli ynë është plot dinamizëm, plot gjallëri dhe jetë, ai është destinuar të shkojë përpara drejt përparimit dhe lulëzimit. Prandaj që të rrojë dhe të përparojë Shqipëria, që të jetojë i lumtur populli ynë, të mobilizojmë masat e gjera të punonjësve ndër punët konkrete të pushtetit, të forcojmë besimin e tyre që kanë për këtë pushtet dhe të kuptojnë njëherë e përgjithmonë që ai është i tyre dhe punon për ta, të forcojmë dhe të shtojmë entuziazmin dhe yrullin që ka populli ynë për punë, të forcojmë në ta ndjenjën e lartë të patriotizmit, ndjenjën e mbrojtjes së indipendencës dhe të integritetit tokësor të atdheut, të forcojmë ndjenjën e mbrojtjes së fitoreve që na kushtuan kaq gjak dhe sakrifica. Të vëmë të gjitha forcat tona që masat e gjera të popullit të ndershëm të përqafojnë dhe të kuptojnë si duhet të gjitha reformat që po bëhen, t'i mbrojnë këto reforma kundër armiqve të brendshëm, kundër spekulatorëve, kundër mbeturinave të fashizmit, që s'mund të durojnë dot kur shohin popullin të jetë i lumtur. Njerëzit e ndershëm të çdo kategorie duhet të kuptojnë se çdo hap që hidhet përpara është në të mirën e përgjithshme dhe qëllimi është të ndërtojmë një Shqipëri të lumtur për të gjithë dhe jo për një pakicë të privilegjuar.

Shokë punëtorë,

Vendi ynë dhe populli heroik shqiptar, që luftoi burrërisht kundër fashizmit italian dhe gjerman, që luftoi me aq besnikëri për kauzën aleate, që i rroku armët

i pari dhe e pushoi zjarrin kur u shtri përdhe Gjermania naziste, sot po ngrë zërin e tij të fuqishëm për të kërkuar nga bota përparimtare të drejtat e tija të pamohueshme. Shqipëria duhet të thërritet si anëtare në Organizatën e Kombeve të Bashkuara; kjo është e drejta jonë dhe këtë të drejtë e kemi paguar shtrenjtë. Për çdo ditë vonesë shtohet padrejtësia nga ana e atyre që kërkojnë t'i mohojnë këtë të drejtë një populli të vogël heroik, që luftoi kaq shumë, që qëndroi besnik deri në fund i aleancës antifashiste, që çlroi vendin e tij me duart e veta dhe vendosi demokracinë, që është më i vendosur se kurrë për të mbrojtur paqen e njerëzimit. Një situatë e tillë jo vetëm që është e pakuptueshme, por është mohimi i principeve, për të cilat u bë lufta antifashiste dhe u krijua Organizata e Kombeve të Bashkuara.

Gjithashtu ne kërkojmë të thërritemi dhe të marrim pjesë në Konferencën e Parisit për nënshkrimin e Traktatit të Paqes me Italinë. Kush më tepër se vendi ynë ka të drejtë t'i kërkojë llogari Italisë dhe të figurojë i pari në nënshkrimin e Traktatit të Paqes me këtë shtet? Ne ishim në Evropë i pari shtet që u bëmë preja e fashizmit italian dhe i pari popull që e luftuam me armë. Lufta jonë kundër Italisë fashiste ishte aq e pamëshirshme sa edhe e pabarabartë; burgjet dhe kampet e përqëndrimit të fashizmit u mbushën me patriotë, tanksat e mitralozat e karabinierisë dhe të milicisë së zezë korrnin popullin shqiptar; krahinave të tëra ju vu zjarri, por lufta heroike kundër italianëve nuk u shua. Ajo u shtua dita-ditës, ajo u zmadhua, ajo u bë e tmerrshme kundër fashistëve të Musolinit. Italia na detyrohet mi-liarda franga ar për dëmet që na ka shkaktuar, prandaj

duhet të na i paguajë deri në një. Italia ishte një shtet armik i vendit tonë, një shtet fashist, prandaj në Traktatin e Paqes me Italinë duhet të marrë pjesë dhe Shqipëria. Kur Shqipëria u invadua nga tanksat e gjeneral Guxonit¹, kur gjaku i shqiptarëve derdhej nëpër porte dhe nëpër rrugë, shumëkush nga ata që bënë Mynihun², bënë veshin e shurdhër përparrë tragjedisë së popullit tonë. Pengesat që na bëhen në lëmin ndërkombëtar janë të pathemelta dhe, pra, të pakuptueshme për ne dhe për gjithë demokratët e botës. Populli ynë dhe udhëheqja e tij, për vendosmërinë e tyre që treguan në luftën antifashiste, për besnikërinë ndaj aleancës anti-hitleriane, për sakrificat e tyre mbinjerëzore, gjatë gjithë kohës së luftës, kanë merituar lavdërimet e personaliteteve drejtuese të shteteve të mëdhenj alcatë, si edhe të udhëheqësve të tyre ushtarakë. Të gjitha këto fakte që do t'i shkruajë historia a mund të shlyhen vallë aq kollaj? Jo, këtë mos e besoni kurrë. Drejtësia do të dalë në shesh. Populli shqiptar dhe qeveria e tij janë model për përpjekjet e mëdha dhe për mirëkuptimin që tregojnë në zgjidhjen e çdo çështjeje ndërkombëtare, dhe këtë e bëjnë se në shpirtin e popullit tonë është e rrënjosur ndjenja e solidaritetit dhe e bashkëpunimit të singertë me të gjitha kombet aleate, ndjenja për të respektuar frymën e re ndërkombëtare, që krijuan vetë rrethanat e luftës së përbashkët. Vallë pse na

¹ Guxoni — Kryekomandanti i forcave italiane që pushtuan Shqipërinë më 1939.

² Është fjala për marrëveshjen famëkeqe të Mynihut që u përfundua në shtator 1938 midis krerëve të qeverisë të Britanisë së Madhe, Francës, Gjermanisë dhe Italisë.

bëhen këto pengesa? Sepse ne jemi luftëtarë të pathyér të këtyre principeve të mëdha të demokracisë apo sepse populli ynë po krijon një jetë të re, të lumtur dhe të lirë, në realitetin e një demokracie të shëndoshë?

Kjo gjë është krejt e padrejtë, është e qartë se fashistët grekë dhe reaksiuni ndërkombetar, që i ndërsen, e kanë halë në sy Shqipërinë e re demokratike, e kanë halë në sy përparimin e madh që bëhet në vendin tonë, kurse në Greqinë e martirizuar po mbretërojnë terrori dhe uria. Fashistët grekë dhe reaksiuni ndërkombetar po bëjnë një zallahi të madhe për pretendimet e tyre të poshtra e të rreme, të falsifikuara si çdo punë e tyre. Shqipëria e Jugut është e jona dhe e askujt tjetër, kjo është e prerë me thikë, por pretendime të tilla të poshtra të fashistëve grekë, që do të bëjnë fiasko të turpshme, do t'i jasin botës së qytetëruar dhe popujve liridashës të kuqojnë se fashizmi është akoma gjallë, prandaj duhet të shtërngojmë radhët për të çrrënjosur nga rrënjet farën e Hitlerit dhe të Musolinit, që kërcenojnë paqen dhe bashkëpunimin në mes të popujve.

Por pretendimet e poshtra dhe qesharake të fashistëve të Athinës, nuk mund të fshehin dot krimet e grabitjet që ata bënë në kurrizin e vellezërve tanë çamër. A kujtojnë vallë fashistët grekë dhe të gjithë ata që u ndihmojnë se këto krime të poshtra, që i janë bërë një minoriteti shqiptar në shtëpinë dhe tokën e tij prej bandave të Athinës, do të kalojnë në heshtje? Sigurisht, jo. Fashistët grekë do të jasin llogari për vrasjet në masë të popullsisë çame të pambrojtur, për masakrimin e grave, të kalamajve dhe të pleqve të Filatit e të Paramithisë, do të jasin llogari për krimin e tyre që

bënë duke zbuar çamërit nga tokat dhe shtëpitë e tyre dhe që janë vetëm të tyret.

Pasuria e minoritetit shqiptar çam në Gregi është grabitur dhe është djegur nga fashistët e Athinës. Këto duhet të vihen në vend. Këtë e lyp drejtësia njerëzore.

Por, shokë punëtorë të Kuçovës, ne kemi besim në të ardhmen tonë dhe i jemi përveshur punës për ta bërë këtë të ardhme sa më të lulëzuar dhe të lumtur. Ky është ligji që duhet të na udhëheqë.

Dita e 1 Majit le të bëhet pra, për popullin tonë, nxitje për realizime dhe punime më të mëdha, le të bëhet dita e mobilizimit të masave të gjera të popullit, të cilat të hidhen pa kursim në prodhim e në punë për rindërtimin e atdheut.

Dita e 1 Majit le të bëhet dita e bashkimit të shëndoshë të popullit tonë në Frontin Demokratik, i cili të bëhet realiteti i pathyeshëm për mbrojtjen e pushtetit, dhe për zbatimin e ligjeve të tija të drejta.

Dita e 1 Majit le të bëhet për popullin tonë dita e forcimit të bashkëpunimit tonë sa më të ngushtë dhe më të singertë me popujt miq dhe alcatë dhe tok me tătë bëhemë mburoja e paqes së njerëzimit.

Le të brohoritim për ditën e 1 Majit, festën e gjithë popullit shqiptar!

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë Republika Popullore e Shqipërisë!

Rrofshin punëtorët e Shqipërisë dhe punëtorët e Kuçovës!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 416,
2 maj 1946*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 416,
2 maj 1946*

URDHËR DITE ME RASTIN E PËRVJETORIT TË PARË TË FITORES MBI GJERMANINË HITLERIANE

9 maj 1946

Ushtarë, nën oficerë, oficerë, gjeneralë të Ushtrisë Kombëtare,

Popull shqiptar,

Sot në atdheun e lirë ne festojmë ditën e madhe të fitores mbi Gjermaninë hitleriane dhe Italinë fashiste. Si sot një vit, mbi Rajhstagun në Berlin, valoi flamuri ngadhnjimtar i Sovjetëve dhe Gjermania naziste, e goditur për vdekje, u dorëzua pa kondita përpara forcave të bashkuara aleate.

Njerëzimi shpëtoi, shpëtoi qytetërimi nga barbarizma mesjetare e Hitlerit. Më 9 maj të vitit të kaluar, bota mori frymë lirisht, në saje të luftës heroike të Ushtrisë së lavdishme të Kuqe, e komanduar nga Kapiteni gjenial i kohërave të reja, Gjeneralisimi Stalin. Krahas Bashkimit Sovjetik, faktorit më të madh dhe vendimtar të fitores, forcat aleate anglo-amerikane dhe gjithë popujt e robëruar të Evropës dhanë kontributin e tyre për arritjen e kësaj dite.

Sot, në gjithë botën e çliruar nga ankthi i tmerrshëm

i fashizmit, gjithë popujt përparimtarë dhe demokratë të botës po punojnë për rindërtimin e vendeve të tyre të rrënuara nga lufta, po punojnë për forcimin dhe ruajtjen e fitores që i kushtoi njerëzimit me miliona të vrarë. Rreth Bashkimit Sovjetik, gjithë popujt progresivë të botës kanë bashkuar energjitetë e tyre për të vendosur një paqe të drejtë dhe të vazhdueshme, për të zhdukur mbeturinat e fashizmit dhe për të përbysur planet djallëzore të reaksionit ndërkombëtar që përpinqet të preqatitë dhe të nxitë një luftë të re.

Sot, në këtë ditë të shenjtë dhe gazmore, populli ynë, kujton me krenari përpjekjet e tija të panumërtë, luftën e tij heroike dhe ngadhnjimitare, që i kushtoi vuajtje dhe mjerime të pashembullta dhe ku ranë me mijëra nga bijt e tij më të mirë. Në Luftën nacional-çlirimtare populli ynë hodhi çdo gjë që kishte të shenjtë dhe të shtrenjtë, sepse ai kuptoi që nga kjo varej fati dhejeta e tij.

E filluan luftën vetëm, që më 7 prill të 39-s, kundër hordhive të Musolinit, duke qenë të sigurtë se bota e qytetëruar ishte me ne dhe e vazhduam këtë luftë deri në fund me vetëmohimin më të madh dhe me besnikërinë më të madhe ndaj kauzës së përbashkët aleate. Prandaj dita e fitores është dhe dita jonë, është dita e ushtrisë sonë heroike që u mbulua me lavdi në luftime të përgjakshme, që s'u zmbraps kurrë përpara forcave të mëdha dhe të armatosura në mënyrë moderne të italiannëve, gjermanëve dhe hyzmegarëve të tyre, që gozhdoi në vend divizione të tëra gjermane, kur aleatët anglo-amerikanë zbarkuan në Francë dhe bashkoi gjakun e saj me atë të vëllezërve jugosllavë.

Sot le të kujtojmë shokët tanë të dashur që dhanë jetën për çlirimin e atdheut dhe të popullit dhe, në shenjë solidariteti të përhershëm, si në kohën e luftës ashtu edhe tani në kohën e paqes, të kujtojmë me nderim gjithë luftëtarët e kauzës së madhe antifashiste që dhanë jetën për çlirimin e njerëzimit nga murtaja naziste.

Ushtarë, nënoficerë, oficerë, gjeneralë të Ushtrisë Kombëtare,

Popull shqiptar,

Fitorja na kushtoi shtrenjtë, prandaj populli ynë është i vendosur ta mbrojë për jetë këtë fitore dhe frytet e saja. Në Shqipërinë e lirë, ku populli vendosi demokracinë dhe pushtetin e tij, po ndërtohet një jetë e re dhe e lumtur për njerëzit e ndershëm dhe punonjës.

Energjitetë e pashterura të popullit tonë, me të cilat u fitua lufta e u sigurua indipendenca dhe sovraniteti i atdheut, sot janë hedhur pa kursim në rindërtimin e vendit të shkatërruar. Në vendin tonë çdo gjë po çelet, po rimëkëmbet, po ecën me vrullin më të madh, po ndërtohet e ardhmja nga vetë populli dhe ashtu si i pëlqen popullit. E shkuara e zezë u shqelmua përgjithmonë dhe nuk do të përsëritet kurrë më; për këtë, garanci e madhe është lufta e çlirimit që bëmë dhe fakti që populli ynë është bërë i ndërgjegjshëm për rolin vendimtar që duhet të luajë.

Rezultatet e punës që janë arritur që prej çlirimit të Shqipërisë e deri tani janë fakte të gjalla dhe të padiskutueshme. Ato tregojnë se q'mund të bëhet në një

vend si yni, ku pushteti buron nga populli dhe i takon gjithë popullit. Këtë realitet të shëndoshë, që është krijuar në vendin tonë dhe që shkon dita-ditës duke u përmirësuar, intrigat e reaksionit ndërkombe tar janë të pafuqishme ta dëmtojnë. Kundër realitetit dhe fakteve të gjalla, armiqtë e paqes dhe të qytetërimit mund të shpifin, këtë e kanë zakon, mund të na nxjerrin pengesa të pathemelta e qesharake në kërkesat tona të drejta në lëmin ndërkombe tar, por ne jemi të bindur se drejtësia do të dalë sheshit dhe popujt përparimtarë do t'i demaskojnë përpjekjet e të gjithë atyre që përpinqen të ringjallin të kaluarën e zezë në kurrizin e popullit tonë dhe të gjithë popujve paqedashës.

Le të vazhdojmë rrugën e drejtë që kemi nisur me vendosmiëri dhe me besimin më të madh dhe asgjë të mos na ndalë në ndërtimin e jetës së lumtur për popullin tonë. Të forcojmë bashkimin, të punojmë pa u lodhur me të gjitha forcat tona në rindërtimin e vendit, në ngritjen e ekonomisë së popullit, në edukimin e masave të gjera punonjëse si nga pikëpamja politike, ashtu dhe kulturale; të forcojmë dhe të modernizojmë ushtrinë tonë heroike, çlirimtaren e vendit tonë, mburojën e pathyeshme të popullit, të indipendencës dhe të integritetit të atdheut; të jemi kurdoherë të zgjuar e vigjilentë për të goditur pa mëshirë të gjithë ata që kanë në gjak aventurat dhe që do të tentojnë të prekin interesat e vendit dhe të popullit tonë; të mbrojmë paqen e përbotshme dhe të forcojmë miqësinë me gjithë popujt demokratë dhe liridashës.

Këto kërkon atdheu ynë i dashur nga të gjithë shqiptarët e shqiptaret.

Këto kërkon bota e qytetëruar nga populli paqedashës dhe përparimdashës shqiptar.

Populli ynë do t'i kryejë me nder këto detyra ashtu si i kreua me nder dhe me lavdi detyrat që ju vunë përpresa në kohën e luftës.

Rroftë dita e fitores së madhe!

Rroftë ushtria jonë heroike!

Rroftë populli shqiptar!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 422,
9 maj 1946*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Bashkimi», Nr. 422,
9 maj 1946*

KËRKESË DREJTUAR KONFERENCËS
SË MINISTRAVE TË PUNËVE TË JASHTME
NË PARIS PËR T'I CAKTUAR REPUBLIKËS
POPULLORE TË SHQIPËRISË SI DËMSHPËR-
BLIM NJË PJESË TË FLOTËS ITALIANE

11 maj 1946

Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë ka nnderin t'i parashtrojë kujdesit dashamirës të Konferencës së Ministrave të Punëve të Jashtme të fuqive aleate komunikimin që vijon:

Italia, besnikë e politikës së saj të shtrirjes imperialiste në Ballkan, nuk ka dashur kurrë që Shqipëria të kishte forca navale të afta për t'u bërë ballë nevojave të mbrojtjes së kufive të saj të gjatë detarë dhe të rojes në ujërat e saja territoriale, ashtu si kishte plotësisht të drejtë.

Në konformitet me këtë politikë, ajo ka vepruar gjithmonë në Shqipëri me të gjitha mjetet për të kundërshtuar çdo përpjekje të qeverisë shqiptare në këtë drejtim.

Në fakt, të katër luftanijet e vogla që kishte Shqipëria, u nxorën jashtë përdorimit, për shkak të presionit që ushtroi Italia mbi qeverinë shqiptare.

Nga ana tjetër, meqë Shqipëria ka qenë e para viktimitë e agresionit fashist në Evropë dhe duke marrë parasysh nevojën urdhëronjëse të Shqipërisë që të ketë një flotë të vogël dhe të përshtatshme për të mbuluar bregdetin e saj të gjatë dhe për të ushtruar rojen në ujërat e saja territoriale, qeveria shqiptare mendon se do të ishte e drejtë dhe e udhës që, kur të vendoset mbi fatin e flotës italiane, të merren parasysh konsideratat e lartpërmendura dhe t'i caktohet Shqipërisë një pjesë e arësyeshme dhe proporcionale me nevojat e mbrojtjes detare të vendit.

Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë ka besim se konferanca, duke çmuar drejtësisht pikëpamjet e formuluarë më sipër, do të ketë mirësinë t'i japë të drejtë dhe t'i rezervojë një pritje të favorshme kërkuesës së saj të drejtë dhe legjitime.

Kryeministri, Ministri i Mbrojtjes Kombëtare dhe
Ministri i Punëve të Jashtme

Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 424,
11 maj 1946*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 424,
11 maj 1946*

INTERVISTË MBI AKSIONIN E MADH TË RINISE: RRUGËN PESHKOPI—BICAJ¹

18 maj 1946

PYETJE: Ç'rëndësi ka për pushtetin aksioni që po ndërmerr rinia për ndreqjen e rrugës Peshkopi—Bicaj?

PËRGJEGJE: Rruja që po ndërtojmë që nga Peshkopia në Bicaj ka një rëndësi shumë të madhe për pushtetin dhe për popullsinë e të gjitha krahinave rreth e rrotull ku ndërmerren këto punime. Rruja është mjeti që çon përparimin, domethënë zhvillon ekonominë e vendit, e përmirëson këtë, përmirëson jetesën e popullit. Rruja është nga ana tjetër mjeti që ndihmon zhvillimin politik dhe kultural të atyre krahinave që do ta përdorin. Duke e ndjerë këtë nevojë të madhe dhe duke e çmuar rëndësinë e kësaj rruje, qeveria e Republikës sonë vendosi që punimet të fillojnë menjëherë.

Krahinat e gjera të Veriut ishin lënë pas dore prej regjimeve të mëparshme antipopullore. S'ishte në interesin e atyre regjimeve që populli i këtyre krahinave të çlirohet nga influenca mesjetare dhe barbare e krerëve feudalë dhe e bajraktarëve, që të përmirësohet jetesa e tyre, të merrnin edukatë dhe arësim, të zhvillohet

¹ Është fjala për rrugën Kukës—Peshkopi.

shumë dhe drejt dashuria për atdheun dhe solidariteti i shëndoshë i gjithë popullit shqiptar. Përkundrazi Zogu dhe gjithë kërret e tjerë të tradhëtisë kishin një qëllim: Veriun e Shqipërisë përpinqeshin ta kishin kurdoherë rezervën e reaksionit, armën e tyre për të luftuar gjithë pjesën përparimitare të vendit tonë. Për këta tradhëtarë populli ishte bagëti; ky zhytej në errësirën më të madhe, për ta blerë më lirë dhe për ta çuar në vëllavrasje. Malësorët tanë të mjeruar s'njihnin veç mizerjen e madhe dhe tmerrin e bajraktarëve. Duhet t'i shikojmë punët drejt. S'ishte faji i vellezërve tanë të Veriut, të Dibrës e të Mirditës që s'muarën pjesë në mënyrë aq të gjerë dhe aktive në luftën e çlirimit; s'ishte faji i atyre malësorëve që i gënjenin Gjon Marka Gjoni, Halil Alia e Fiqri Dinja me shokë, për t'i çuar në Jug të vriteshin me partizanët për pesë napolona në muaj. Fajin duhet ta kërkojmë gjatkë, ta kërkojmë në të shkuarën e tyre të dhimbshme dhe në xhelatët e tyre që kanë qenë xhelatët e gjithë popullit tonë. Malësorët tanë e duan jetën dhe Shqipërinë aq sa e do çdo bir i këtij populli. Kur lufta e çlirimit përfshiu ato vende, andej dolën luftëtarë trima, udhëheqës dhe partizanë që lanë nam. Kur ju vu zjarri kullave të Marka Gjonit, malësori i Veriut mori frymë dhe ai tani e shikon të ardhmen e tij me besim. Kujdesi i pushtetit, ndihmat, shkollat dhe më në fund rrugët që po çelim në Veri do t'ja forcojnë këtë besim. Malësorët e Veriut shohin se erdhi koha të rrojnë si njerëz, të punojnë si qytetarë të mirë të Republikës, ta duan gjithnjë më shumë atdheun dhe pushtetin e tyre dhe të vënë gjoksin për ta mbrojtur nga ata që u kanë pirë gjakun tërë jetën.

Në të gjitha krahinat ku do të çelet rruga e re, që prej Peshkopisë e deri në Bicaj, në Lurë e në Lumë, në Reç e në Dardhë, do të lindë një jetë e re, do të vihen në shfrytëzim pyjet e mëdha, do të shfrytëzohen vendet e bukura klimaterike të Lurës, do të përmirësohet dhe do të nxitet shtimi i prodhimeve në ato krahina dhe do të sigurohet për gjithë vitin transporti i tyre. Perspektivat janë që kjo rrugë të lidhet me rrugë të tjera që do të përshkojnë Mirditën si dhe me të tjera rrugë me karakter komunal. Në të ardhmen do të ndërtohen ura të reja në mënyrë që rruga që po hapet sivjet të shërbejë edhe për të gjithë fshatrat e tjerë nga ana e djathë e lumit.

PYETJE: Si e shikoni Ju ndihmën e rinisë në rindërtimin e vendit?

PËRGJEGJE: S'mund të kuptohet dhe as që mund të arrihet rindërtimi i Shqipërisë pa pjesëmarrjen e gjerë të rinisë. Shqipëria e re ndërtohet për rininë tonë, për brezat e ardhshëm, prandaj ajo duhet të luajë rolin kryesor në ndërtimin e atdheut që është ndërtimi i jetës së saj të lumtur. Këtë gjë rinia jonë heroike e ka merituar plotësisht. Kush luftoi më tepër për atdheun, kush e dha jetën pa kursyer, kush u sakrifikuavjete me radhë dhe tregoi heroizma të pashoqe? S'ka asnje dyshim që rinia. Tok me patriotizmin e saj të madh dhe të kulluar, që rrëzoi të gjitha konceptet e gabuara që i kishin ngritur në sistem pseudopatriotët, te rinia jonë u dukën kualitetet e paçmueshme që e bëjnë një popull të shkojë përpara drejt përparimit: ndjenja e shëndoshë e organizmit, e drejtimit dhe e disiplinës. Për këto rinia dha prova. Pikërisht këtu mbështetet sigurimi i një të ardh-

meje të lumtur për popullin tonë. Ai që s'ka kuptuar këtë të vërtetë të madhe; s'ka kuptuar asgjë. S'është problemi që shtronin dikur njerëzit e Zogut dhe tradhëtarët e shitur te okupatori, problemi pleq e të rinj. Në Shqipërinë e re të gjitha vlerat njihen; respektohen dhe shpërblehen të gjitha ato vlera që vihen në shërbim të atdheut dhe në interesin e përgjithshëm. Kushdo ka të drejtë ta gjëzojë jetën dhe të punojë me ndershmëri benda kuadrit të interesave të përgjithshme, pa marrë para-sysh se është plak ose i ri, por të mos harrojmë një gjë: lëngu i ri e bën bimën të rritet e të lulëzojë, kështu edhe Shqipëria jonë që të lulëzojë ka nevojë për gjak të ri. Dhe ky gjak i ri është rinia. Tani rinia është në këmbë për rindërtimin e atdheut siç ishte për çlirimin e tij. Rinia jonë është e gjallë dhe dinamike kudo, në shkolla e në prodhim. Drejtuesit e BRASH-it më kanë bërë një tok propozimesh ku më thonë se janë gati të ndërmarrin aksione të rëndësishme dhe t'i drejtojnë ata vetë si: hapje kanalesh, tharje kënetash, hapje rrugësh etj. Kjo tregon një gjë, një gjë të madhe: që Shqipëria do të ndërtohet dhe do të përparojë.

Prandaj qeveria me besimin më të madh e ngarkoi rininë të ndërmarrë dhe të drejtojë vetë të gjitha punimet që do të bëhen në rrugën Peshkopi—Bicaj. Rinia më ka dhënë fjalën se do ta kryejë këtë gjë dhe unë e di, sepse e kam provuar në momentet më të rrezikshme që kalonte atdheu, se rinia s'e bën kurrë fjalën dysh.

U thoni gjithë shokëve të rinisë se unë dhe qeveria do t'u japim gjithë përkrahjen në këtë ndërmarrje që po marrin, do t'i ndjekim me kujdes punimet e tyre, do t'i ndihmojmë me gjithë forcat tona. U thoni shokëve të

rinisë se ata po ndërmarrin një vepër me karakter të madh ekonomik dhe politik që do t'u shtohet në flamurin e tyre ku janë shkruar kaq fitore të shkëlqyeshme. U thoni shokëve të rinisë se rruga që do të hapin do të jetë një nga monumentet e tyre të lavdishme dhe katundari i Veriut, që do të kalojë andej, do të kujtojë me dashuri dhe me respekt, zotësinë, djersën dhe mundimet e rinisë që s'i kurseu kurrë as në luftë e as në paqe për ta nxjerrë popullin në dritë, për t'i lehtësuar mjerimet, për t'i dhënë dorën që të shkojë në një jetë të re dhe më të mirë.

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 431,
19 maj 1946*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 431,
19 maj 1946*

KËRKESË DREJTUAR KONFERENCËS SË MINISTRAVE TË PUNËVE TË JASHTME NË PARIS PËR RIATDHESIMIN E ÇAMËRVE

4 qershor 1946

KONFERENCËS SË MINISTRAVE TË PUNËVE TË JASHTME, TË BASHKIMIT TË REPUBLIKAVE SOCIALISTE SOVJETIKE, TË BRITANISE SË MADHE, TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS DHE TË FRANCËS

Paris

Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë ka nderin t'i paraqesë Konferencës së Ministrave të Punëve të Jashtme të fuqive kryesore aleate sa vijon:

Kufitë që ju imponuan Shqipërisë më 1913 prej Konferencës së Londrës¹ i linin Greqisë të gjithë krahinën e Çamërisë që shkon nga gjiri i Prevezës gjer në

¹ Konferenca e Ambasadorëve në Londër më 22 mars 1913 cakttoi kufitë e Shqipërisë. Duke marrë nëpër këmbë interesat e popullit shqiptar kjo konferencë padrejtësisht i shkëputi Shqipërisë sipërfaqe të mëdha nga territori i saj.

Kep të Stilloz, me një popullsi prej afro 60 000 shqiptarë autoktonë.

Duke shkelur çdo parim njerëzor dhe të gjitha aktet ndërkontebtare, qeveria greke ka ndjekur kurdoherë një politikë shfarosjeje kundrejt minoritetit shqiptar çam, duke e shtypur nën një regjim burgimesh, plaçkitjesh, përdhunimesh të ndryshme, masash shpronësimi me forcë, tatimesh të mëdha dhe shpërndajtjesh në masë.

E drejta e mësimit dhe e përdorimit të gjuhës amtare shqipe, e drejta e emërimit në detyra zyrtare qoftë edhe në më të ulëtat ose e drejta e përfaqësimit, i ishin mo-huar krejtësisht elementit shqiptar në Greqi.

Minoriteti çam ka jetuar në marrëdhënje të mira me popullin grek dhe ka bashkëpunuar me të. Gjatë luftës së çlirimit kombëtar kundër pushtuesve italianë dhe gjermanë, çamët kanë luftuar përkrah popullit grek në radhët e ELAS-it. Por në qershori 1944 dhe në mars 1945, bandat monarko-fashiste të gjeneralit grek Zervas e sulmuan minoritetin shqiptar të Çamërisë, ato masakruan pa asnje shkak e arësy 800 vetë, fëmijë, gra dhe pleq të pafajshëm e të pambrojtor; shkatërruan e dogjën 68 katunde dhe plaçkitën gjithë vendin.

Ky terror i bandave greke, i ushqyer prej ndjenjave më të ulëta të një urrejtjeje shoviniste dhe fetare, arriti kulmin me shpërndajtjen me forcë të afro 23 mijë çamërve që erdhën në konditat më të vajtueshme e u strehuan në Shqipëri.

Qeveria shqiptare bëri përpjekje të mëdha për të lehtësuar vuajtjet e këtyre bashkatdhatarëve fatkëqinj me gjithë gjendjen e vështirë ekonomike në të cilën

ndodhej vetë Shqipëria për shkak të dëmeve të shumta që i la lufta.

Mungesa e sendeve të ndryshme dhe sëmundjet kanë shkaktuar gjer tani 2 755 vdekje ndër çamët e ikur. Po t'ju shtojmë këtyre edhe ata mijëra të vrarë gjatë 32 vjetve të sundimit grek në Çamëri, katundet e rrënuara dhe gjendjen e mjeruar të çamérve të ikur, mund të merret me mend sa e madhe është tragjedia e hidhur e çamérve dhe të kuptohet indinjata e drejtë që ka shkaktuar shumë herë kjo tragjedi në botën aleate.

Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, dëshmuese e vuajtjeve që i shtohen dita-ditës populsisë çame të goditur kaq rëndë dhe duke pasur drejtpërdrejt interes që t'i jepet fund martirizimit të saj, kërkon që Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme të fuqive kryesore aleate, duke marrë parasysh të drejtat legitime dhe sakrificat e bëra nga çamët në luftën kundër armikut të përbashkët, të ketë mirësinë të marrë masat urgjente që përmenden më poshtë:

1) Riatdhesimin e menjëhershëm të të gjithë çamérve të ikur.

2) Sigurime dhe garanci përsa u përket të drejtave të tyre civile, kulturale dhe politike.

3) Kthimin ose shpërbllimin e të gjitha pasurive të tyre, ndihmë për rindërtimin e vatrave të tyre dhe sigurimin personal.

4) Gjykimin dhe dënimin e të gjithë përgjegjësve të krimeve të kryera.

Qeveria shqiptare është e bindur që konferenca, duke pasur parasysh faktet e shënuara më sipër dhe në përputhje me parimet e proklamuara solemnisht gjatë

kësaj lufte, do të ketë mirësinë t'i japë fund këtyre padrejtësive duke marrë masat e drejta. në favor të çamërve.

Kryetari i Qeverisë dhe Ministri i Punëve
të Jashtme

Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 444,
4 qershor 1946*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 444,
4 qershor 1946*

TEZAT PËR RISHIKIMIN E PLENUMIT II TË KQ TË PKSH

(*Raport i mbajtur në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PKSH*)¹

9 qershor 1946

Shokë të Byrosë,

Dëshiroj të shtroj përparrë Byrosë një çështje që më duket me rëndësi për Partinë tonë. Do të përpinqem t'i peshoj mirë fjalët dhe kërkoj nga ana tjetër që të kuptohen drejt këto fjalë. Këto i them pse përgjegjësitë tona janë të mëdha para Partisë sonë dhe popullit, vçanërisht në këto momente, kur ne vemi për në Kongresin I, ku do të përcaktohet via e Partisë dhe do të zgji-

¹ Pa ditur ende gjë për prapaskenën e Beratit, për komplotin e kurdisur nga udhëheqja e PKJ kundër PKSH, për gjithë pjesëtarët e këtij komploti, shoku Enver Hoxha duke i analizuar me syrin e marksistit punimet e Plenumit II të KQ, që u mbajt në Berat në nëntor 1944, kishte krijuar bindjen se në këtë plenum via e Partisë që dënuar pa të drejtë dhe se Plenumi i Beratit ishte bërë burim i një varg dobësish që viheshin re në punën e Partisë. Për këtë arësyec preqatiti këtë raport që ja paraqiti By-

dhet forumi i lartë udhëheqës, Komiteti Qendror. Këtë çështje me rëndësi nuk e shtroj as për të rrëzuar forume dhe as për të rrëzuar shokë, këtë gjë s'na lejohet ta bëjmë pse është në dëm të Partisë, kur këto forume dhe këta shokë janë udhëheqja e shëndoshë e saj, qoftë dhe sikur këto forume ose këta shokë mund të kenë gabuar në gjëra të vogla, po që janë të ndreqshme. Eksperienca e vlefshme e Partisë sonë na tregon se veprime të tilla të pamatura, të bëra pa dashur ose me qëllim, e kanë dëmtuar punën tonë, e kanë penguar zhvillimin normal të saj dhe janë burimi kryesor i lëshimeve ose i të metave që janë konstatuar në punën tonë të përgjithshme. Gabime në Partinë tonë ka pasur dhe do të ketë, pse ajo është një Parti e re, pse shokët, në përgjithësi, s'e kanë akoma pjekurinë e një komunisti të regjur dhe s'e përdorin si duhet dhe sa duhet eksperiencën e madhe të Partisë Bolshevikhe dhe të Partisë sonë. Kjo s'duhet aspak të na dëshpërojë, pse eksperienca nuk fitohet dhe nuk vihet në shërbim aq kollaj dhe prej kujdo. Pikërisht përt'ja mbërrijtur sa më shpejt dhe mirë kësaj gjëje, unë po shtroj çështjen që do të zhvilloj më poshtë. Do të shtoj dhe një gjë tjetër: aq sa Partia duhet të jetë indulgjente për ata shokë që kryejnë punë të madhe dhe të vlefshme

rosë Politike, me anë të të cilat kërkonte të rishikohej plenumi dhe të hidheshin poshtë vendimet e tij.

Këto kërkesa të drejta u kundërshtuan e nuk u pranuan nga Koçi Xoxe e Pandi Kristo. Ata kishin frikë se rishikimi i Plenomit të Beratit do të nxirrte në shesh punën e tyre anti-parti dhe ndërhyrjen armiqësore të PKJ në punët e brendshme të PKSH. Edhe Nako Spiru nuk guxoi të zbulonte veprimitarinë e pjesëtarëve në organizimin e prapaskenës.

për Partinë, por që edhe gabojnë në punë e sipër, gabime që e ka për detyrë t'ua korrigjojë dhe të mos i lërë të majisen, aq duhet të jetë e ashpër në gjykime dhe në vendime karshi atyre njerëzve që me qëllim kërkojnë të çojnë Partinë në qorrsokak, kërkojnë të dëmtojnë Partinë. Duhet të mësohemi të jemi të matur në vendime dhe në gjykime të çështjeve, të zhvishemi nga pasionet dhe të largohemi nga miqësitë jo të shëndosha, nga simpatitë e sëmura që mund të lindin dhe që e kanë burimin në një punë jobolshevike, të luftojmë paragjykimet, pakënaqësitë dhe hatëret e mbeturat, të krijuara dhe të zhvilluara në fryshtë mikroborgjeze, të veprojmë dhe të punojmë si komunistë, që kanë vendsur të bolshevizojnë Partinë e tyre, shokët e tyre. Që këto çështje të vihen drejt dhe të punohet drejt, ne, komunistët, kemi dy armë të forta që s'i ka kush dhe që bëjnë forcën e Partisë sonë: kritikën dhe autokritikën. Duke pasur kurdoherë parasysh interesin e Partisë, forcimin e saj, bolshevizimin e saj, Partia në çdo moment duhet të bëjë analiza të veprimtarisë së saj, qoftë dhe sikur kjo veprimitari të mos ketë qenë e gabuar. Aq më shumë, në rastet kur bëhen gabime, kjo analizë është e domosdoshme. Në një çështje Partia mund të kthehet shumë herë, në intervale të afërta ose të largëta dhe kjo s'do të thotë aspak se Partia është çoroditur, është tronditur, është dobësuar. Përkundrazi, kjo tregon se Partia jonë është e fortë saqë mund të marrë çdo analizë qoftë dhe të zorshme dhe ta studjojë e ta zgjidhë si duhet; kjo do të thotë se në Partinë tonë që ndërmerr analiza të tillë, ka një unitet të shëndoshë, unitet mendimi dhe organizimi, ekziston disiplina e hekurt dhe e ndërgjegj-

shëmë e Partisë, ekziston dashuria e madhe për Partinë dhe për shokët. Në Partinë tonë të thjeshtë dhe të kulluar, e dalë nga një luftë e ashpër, e organizuar dhe e forcuar në zjarrin e kësaj lufte, unë nuk e kam frikën e krijimit të tarafeve, të fraksioneve, në rast se ne mbajmë gjallë dhe i shtojmë dita-ditës cilësitet që përmenda më sipër dhe që bëjnë forcën e Partisë sonë, në qoftë se ne e shtojmë dhe e përmirësojmë nga eksperiencia e fituar kombativitetin e Partisë sonë, në qoftë se ne dimë të dallojmë të mirët nga të ligjtë, gabimet e mëdha nga të voglat dhe dimë t'u gjejmë ilaqin e përshtatshëm që të dyjave. Unë jam i bindur plotësisht se Partia jonë është në gjendje të veprojë kështu, është në gjendje të ecë në këtë rrugë, që është rruga e bolshevizimit të saj, prandaj unë pa frikë dhe hapët po shtroj përpara jush çështjen që bëra fjalë më sipër.

Veprimtaria e Partisë sonë, që nga ditët e para të krijimit të saj dhe deri tani, mund të ndahet në vija të përgjithshme në dy etapa kryesore: ajo e luftës dhe ajo e çlirimtës së Shqipërisë. Në mes të këtyre dy etapave qëndron një datë e rëndësishme: Mbledhja e Plenumit të Komitetit Qendror në Berat. Kjo mbledhje u zhvillua në përfundim të Luftës nacional-çlirimtare që udhëhoqi Partia jonë dhe njëkohësisht në prak të etapës së re të rindërtimit të vendit dhe të qeverisjes së tij në kondita të reja, që do të bëhej përsëri prej Partisë sonë, e cila kishte frenat e komandës në dorë. Pikërisht dëshiroj të bëj një analizë të punimeve dhe të vendimeve që u muarën në këtë mbledhje me rëndësi të Partisë, pse e quaj të domosdoshme që përpara Kongresit I ku do të përcaktohet vija e Partisë dhe do të zgjidhet Komiteti

Qendror i saj, të vihen çështjet drejt, që të shkojnë pünët drejt.

C'duhet të ishte Berati për ne dhe në ç'frymë duhej të zhvilloheshin punimet e plenumit nga një anë dhe, nga ana tjetër, si u zhvilluan ngjarjet në atë mbledhje e ç'vendime dualën andej? Këto dy gjëra do të përpinqem të analizoj për të nxjerrë konkluzionet e mia, të cilat të diskutohen prej Byrosë dhe të merren vendime të caktuara për t'i shtruar përpara Komitetit Qendror të Partisë dhe organizatës.

Plenumi i Beratit s'ishte një mbledhje e rregullt për arësyet e mëposhtme: preqatitja e punimeve të plenumit në Byro nuk ishte objektive as edhe si duhej komuniste. Çështjet në Byro nuk u shtruan në formë shoqërore dhe komuniste, por në formë të prerë dhe të vendosura jashtë Byrosë, pra jo pas një analize të thellë marksiste që mund të bëhesh prej vetë Byrosë, pa pa-sione dhe pa paragjykime. Çështjet u shtruan brutalisht dhe në një formë «coup d'état»¹ që nuk e lejonin as rrethanat, as konditat, as metodat e Partisë sonë dhe as do të ngjiste një gjë e tillë, po të ishte bërë si duhej një analizë marksiste e të gjithë veprimtarisë së Partisë deri në prakun e Mbledhjes së Plenumit në Berat. Në mbledhjen e plenumit çështjet u shtruan jo në rrugë të drejtë dhe përpara elementëve të rinj joanëtarë të plenumit, që ishin paravendosur të bëheshin anëtarë të plenumit, gjë që ka pasë konsekuenca të hidhura në zhvillimin e punës së mëvonshme, siç do ta përcaktoj më vonë gjatë ekspozesë sime. Çështjet në Plumin e

¹ «Coup d'état» (frëngj.) — grusht shteti.

Beratit janë shtruar shtrembër dhe, pra, andej dualën edhe një sërë konkluzionesh të gabuara.

Plenumi i Beratit duhej të ishte një mbledhje e domosdoshme, e rëndësishme për Partinë tonë, duhej të bënte një kthesë të madhe në punën tonë dhe në metodat e punës sonë; ai duhej të ishte vazhdimësia e veprimtarisë së lavdishme të Partisë sonë gjatë gjithë kohës së luftës, në një etapë të re plot vështirësi. Plenumi i Beratit duhej të ishte hallka e shëndoshë e këtyre dy etapave. Etapa e luftës, para Beratit, ishte gjithë veprimitaria e Partisë sonë, lufta e saj heroike, organizimi dhe forcimi i saj, ishte kryengritja e përgjithshme e popullit, vepra e pavdekshme e Partisë sonë, ishte krijimi i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare që luftoi pa pushim kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve, ishte rrëzimi i pushtetit të vjetër dhe hedhja e bazave të pushtetit të ri, ishte shpartallimi i reaksionit, ishte çlirimi i Shqipërisë, ishte marrja e fuqisë nga ana e Partisë sonë dhe mbajtja e kësaj fuqie në mënyrë të shëndoshë. Me një fjalë etapa e luftës, para Beratit, ishte çdo gjë, ku do të mbështetej veprimitaria e ardhshme. Plenumi i Beratit këtë etapë të shkëlqyer e errësoi, e përcmoi, e dënoi. Këtu qëndron gabimi i madh i tij dhe këtu e kanë rrënjen një sërë gabimesh të rëndësishme që janë dukur më vonë në punën tonë. Në etapën e luftës dhe para Beratit kishte gabime në punën tonë, kishte gabime organizimi, kishte sektarizëm dhe oportunizëm, kishte lëshime dhe të meta, s'kishte stil dhe metodë aq të mirë pune, s'kishte politikë aq të drejtë kuadrosh, por Partia jonë s'kishte gabuar politikisht, vija e Partisë sonë ishte e drejtë dhe jo e gabuar siç pretendoi Sejfulla Malëshova dhe Velimir

Stojniçi¹ në Plenumin e Beratit. Partia jonë ishte një Parti Komuniste, e krijuar në zjarrin e luftës dhe që luftoi me heroizëm dhe jo si thoshte Sejfulla Malëshova në Plenumin e Beratit që «ajo s'ishte as marksiste, as komuniste». Partia jonë s'ishte një parti «banda kriminelësh» ku «ishin konfonduar puna politike dhe krimi» siç tha Sejfulla Malëshova në Plenumin e Beratit. Udhëheqësit e Partisë Komuniste dhe veçanërisht unë, s'kishim dalë rastësisht siç pretendoi Sejfulla Malëshova në Plenumin e Beratit, kur ekspozoi teorinë e tij «mbi krerët dhe kryetarin», por nga lufta e popullit tonë. Por, mbi këto çështje, do të zgjatem më vonë. Plenumi i Beratit s'diti t'i ndante këto gjëra dhe kjo u bë me qëllime nga disa dhe pa qëllime nga disa të tjerë. Detyra e Plenomit të Beratit ishte ta analizonte në mënyrë marksiste gjithë punën tonë, por mjerisht ata që pretendojnë se marksizmin e kanë në gjak dhe e luajnë në majë të gishtërinjve si Sejfulla Malëshova, vepruan në mënyrë antimarksiste dhe antiparti. Plenumi i Beratit duhej të korrigjonte gabimet që ishin bërë, të godiste ashpër atje ku duhej dhe atje ku këto gabime ishin bërë

¹ Velimir Stojniçi erdhi në Shqipëri në gusht të vitit 1944 me cilësinë e kryetarit të misionit ushtarak jugosllav dhe të ndërlidhësit midis PKJ dhe PKSH. Duke zbatuar urdhërat e udhëheqjes revisioniste jugosllave ai organizoi prapaskenën e Beratit dhe zhvilloi një veprimtari të theksuar armiqësore kundër udhëheqjes marksiste-leniniste të Partisë dhe vijës së saj të drejtë. Në këtë kohë, kur shoku Enver Hoxha kritikoi të deleguarin e KQ të PK të Jugosllavisë, nuk ishte zbuluar ende tradhëtia e klikës së Titos. Megjithatë kjo kritikë në fakt drejtohej njëko-hësisht edhe kundër vetë udhëheqjes jugosllave.

me tendenca, sidomos të vinte drejt çështjen organizative të Partisë, çështjen e politikës së kuadrove; të vinte në dukje dhe të shërbenin si mësime të metat dhe lëshimet që ishin shfaqur në punë dhe të përcaktonte qartë vijën politike dhe organizative që duhej të zbatohet me rigorozitetin dhe pjekurinë më të madhe në etapën pas Beratit. Nga ana tjetër vepra e madhe e Partisë sonë, e cila nuk mund të kryhej në rast se vija politike dhe organizative ishin të gabuara, duhej vënë në dritë dhe ajo duhej të dominonte gjithë punimet e Plenumit të Beratit, gjithë vlerësimin e punës së Partisë. Mirëpo u bë e kundërtta. Këtu mbroj Partinë tonë, prestigjin e Partisë sonë, i cili duhet të jetë një gjë konkrete, reale, që ta shohë, ta ndjejë, e të mburret dhe anëtari më i thjeshtë i Partisë, i cili s'ka kursyer as jetën për këtë gjë. Duke thënë këto gjëra kam për qëllim të vetëm të mbroj Partinë nga arrivistët dhe jo të mbroj njerëzit, por edhe njerëzit janë të lidhur me Partinë e sidomos në radhë të parë, udhëheqësit e Partisë.

Në Berat u ndoq një praktikë e gabuar. U dënuar vija e Partisë, u dënuan edhe njerëzit që e zbatuan këtë vijë. Plenumi i Beratit hodhi në erë më të shumtët nga ata që organizuan Partinë, që organizuan luftën, që drejtuan Partinë dhe luftën...

Në këtë plenum u dënuar dhe Liri Gegë, dhe unë them se i vetmi dënim që u dha me vend dhe që e meritonte plotësisht, ishte dënim i Liri Gegës. Puna e Lirisë ishte një punë e sëmurë dhe tarafi, plot ambicie dhe tendenca sektare. Ajo s'punonte për Partinë, por për veten e saj, për të forcuar pozitat e saja në Parti.

Puna e saj ishte plot gabime të rënda, politike dhe organizative, që s'kishin të bënин aspak me vijën e Partisë, por që Sejfulla Malëshova i bëri kapital për të goditur Partinë dhe vijën e Partisë... Puna e Lirisë edhe pas Beratit e deri tani vë akoma më mirë në dukje, ç'është Liria dhe ku po shkon ajo. Liri Gega jo vetëm që s'duhej të ishte në Komitetin Qendror, por në rast se nuk ndërron rrugë, mendime dhe metodë, ajo s'do të jetë edhe e denjë të mbajë emrin e anëtares së Partisë.

Përsa më përket mua që isha, sipas konkluzioneve të Plenumit të Beratit, «njeriu që kish gabuar më shumë» qëndrova përsëri, jo vetëm në Byro dhe në Komitetin Qendror, por edhe Sekretar i Përgjithshëm i Partisë. Kjo ishte një anomali dhe për mua si person dhe si udhëheqës i Partisë, një pozitë false, një pozitë formale. Pas Beratit, pra Partia s'kishte sekretar politik real dhe udhëheqja e Partisë, dua të them veçanërisht e Byrosë, me përjashtim të Nakos dhe të Koçit, ishte e re.

Si ngjau që punët arritën në këto rezultate dhe në këto konkluzione. Përgjegjësit kryesorë për mua janë dy: Velimir Stojniçi dhe Sejfulla Malëshova. Ka përgjegjësi edhe Nakua edhe Koçi, por këto përgjegjësi janë më të lehta, pse mendoj se qëllimet dhe tendencat e tyre, që u frymëzuan nga ata të dy, degjeneruan më vonë, u keqpërdorën në mënyrë jomarksiste¹. Unë s'kam qenë kurrë i bindur përsa u vendos në Berat

I Shoku Enver Hoxha ende nuk dinë gjë për rolin që kishin luajtur Koçi Xoxe e Nako Spiru në organizimin e prapaskenës së Beratit.

për arësyen e vetme se u hodh poshtë dhe u nënvleftë-sua gjithë puna e Partisë dhe jo pse u rrëzuan njerëzit... Besimi im ka qenë i madh te Partia, për të cilën kisha luftuar aq sa dhe shokët më të mirë të saj, kisha besim në këta shokë, besim dhe dashuri të shëndoshë, pse kisha luftuar tok me ta dhe i dija që ata ishin të vendosur për Partinë, sikundërqë isha dhe unë. Por njerëzit edhe gabojnë. Gabojnë me qëllim ose pa dashje. Këtu duhet të jemi shumë të kujdeshshëm dhe të kuptojmë nuancat e këtyre gabimeve që janë vitale për Partinë tonë. Velimir Stojniçi gaboi deri në fund. E bëri me qëllim këtë gabim, që të dëmtonte Partinë tonë? S'mund të them gjë, veçse gabimi i tij na kushtoi. Velimir Stojniçi ndërhyri në mënyrë të paligjshme dhe të rrezikshme në çështjet e Partisë sonë...

Velimir Stojniçi, një kuadër i ri dhe pa eksperiencë, pasi e bëri këtë gabim të madh, më vonë u përpoq ta ndreqte në mënyrë të gabuar, pra gaboi përsëri. Ai kuptoi se në Berat bëri një gjë që s'i lejohej kurrë, ai hodhi poshtë veprimtarinë e madhe të Partisë sonë heroike dhe uli prestigjin e udhëheqjes së Komitetit Qendror dhe këtë gabim ai u përpoq ta rregullonte jo në mënyrë marksiste. Shumë muaj pas Plenumit të Beratit ai vinte te unë dhe përpinqej të më mbushte mëndjen se unë isha me të vërtetë Sekretar i Përgjithshëm, Kryeministër, udhëheqës kryesor i popullit, prandaj duhej të merrja punën në duar dhe të drejtoja efektivisht; ai zinte Koçin dhe i thoshte se «duhet të futim në KQ përsëri Liri Gegën dhe Ramadan Çitakun», ai zinte Ramadan Çitakun, sigurisht edhe Liri Gegën dhe u thoshte se «do të rregullohet puna juaj, kam folur

me shokët dhe do të futeni në Komitetin Qendror». Velimir Stojniçi luante me Partinë tonë dhe me njerëzit tanë. Por kjo manevrë nuk zinte vend te unë. Velimir Stojniçi shkoi më tej. Ai s'i kuptonte drejt bashkëpunimin dhe lidhjet që duhej të kishim ne me partinë jugosllave, ai e kuptonte gabim indipendencën e partive. Çështja e Brana Peroviçit¹ me rininë tonë ishte një nga këto manifestime të gabimit në kuptimin e marrëdhënjeve të Partisë sonë me partinë jugosllave dhe kërkesa e fundit që më bëri mua Velimiri, duke më kërkuar që t'i dorëzonim çdo herë të gjitha raportet e Partisë që vinin nga organizatat që t'i këndonte dhe të merrte nga një kopje, e bënte të qartë se Velimir Stojniçi e kishte të gabuar pikëpamjen mbi marrëdhënet në mes të dy partive dhe indipendencën e partive.

Velimir Stojniçi s'ishte në gjendje që atë eksperiencë sado të paktë që kishte, ta përshtatte me rrethanat dhe konditat e vendit dhe të luftës sonë. Megjithëse konditat tona me ato të Jugosllavisë, sido që në vija të përgjithshme, ishin gati të njëllojta, ekzistonin variancë dhe rrethana që s'ishin të njëllojta... Ai fliste «me sigurinë më të madhe» dhe për gjëra që s'i dinte dhe që ne i dinim më mirë se ai, pse ishim shqiptarë dhe kishim drejtuar një luftë të tërë. Ai nënçmoi eksperiencën e Partisë sonë dhe të njerëzve të Partisë sonë...

Gabimi i Velimir Stojniçit pati konsekuenca të hi-

¹ Brana Peroviç, anëtarë e Komitetit Qendror të Rinisë Jugosllave, delegate në Kongresin e dytë të Bashkimit të Rinisë Antifashiste Shqiptare (BRASH). Ajo u përpoq t'i imponojë Komitetit Qendror të BRASH-it pikëpamjet e udhëheqjes jugosllave.

dhura për Partinë tonë dhe në shumë drejtime. Të fillojmë me radhë.

Cështja e Sejfulla Malëshovës: Kush ishte Sejfulla Malëshova? Sigurisht ai s'ishte as fashist, as tradhëtar. Dihej se qe një komunist i vjetër, antifashist dhe patriot. Asnjëri nga ne s'dinte më tepër për këtë njeri. Ai erdhi në Shqipëri me pretendime të mëdha, shumë të mëdha. «Lufta kish filluar dhe po zhvillohej», sepse Sejfulla Malëshova kishte punuar në Moskë e në Francë (pa pasur as lidhjen më të vogël me lëvizjen tonë); kështu dilte nga pretendimet e tij. Por ç'kish punuar në Moskë ky njeri, jo atëhere që nuk e dinim, por as edhe tanë nuk e dimë me saktësi. Ne kemi detyrë t'i provojmë vetë njerëzit; Partia Bolshevikë s'të imponon kurrë njerëz. Ç'ka bërë Sejfulla Malëshova në Francë? Asgjë konkrete dhe rezultatet janë gati zero. Si duhej sjellë me këtë njeri qëkurse hyri në Shqipëri? Mendimi im është: me kujdesin më të madh, jo pse ishte i dyshimtë, s'e kam fjalën këtu, por për t'i dhënë vendin që ai do ta meritonte duke luftuar. Sejfulla Malëshova duhej të jepte prova, por duke përfituar nga qenja e tij si emigrant politik në Moskë, sikundërqë bëheshin punët në atë kohë, ai u bë kandidat i Plenumit të Komitetit Qendror, pas disa javësh, si erdhi në Shqipëri. Sejfulla Malëshova s'ishte aspak i kënaqur, «vendi i tij ishte kryesia e Partisë». Për të udhëheqja e Partisë sonë ishte një gjë «pa vlerë udhëheqjeje»; ai «ishte revolucionari i regjur e i pajisur me teorinë e madhe marksiste dhe me praktikën, gjithashtu». Jo vetëm Sejfulla Malëshova s'u përpoq kurrrë dhe as i shkoi ndër mend të luftonte si duhej dhe të meritonte vendin që ju dha

dhe me prova të shkonte edhe më lart, por ai qëndroi në kullën e tij të fildishtë, bënte vetëm kritika duke pritur rastin t'ja mbërrinte qëllimit të tij të paracaktuar me metoda të tjera. Në diskutimet që u zhvilluan me Tempon rreth çështjes në se duhej goditur «Balli» në një moment të caktuar apo jo, Sejfulla Malëshova u bashkua me Tempon¹ dhe doli si njeriu i vetëm që pa «se Partia po gabonte» dhe dha «alarmin e parë», si tha ai në Berat. Por çfarë alarmi? Ai alarm është për t'u diskutuar. Do të shohim në qoftë se duhej goditur «Balli» në ato momente apo jo. Partia do të bëjë analiza edhe më të imta të këtyre çështjeve në dritën e faktave, të cilat duhet të mblidhen dhe të studjohen me kujdes, sepse kjo është historia e Partisë sonë dhe s'mjafton pse e tha Tempua ose Sejfulla Malëshova që ajo duhet të ishte medoemos e drejtë. Por tani s'është çështja këtu. Qoftë edhe sikur të pranojmë se duhej goditur «Balli» në një moment të caktuar, kjo a do të thotë se vija politike e Partisë ishte e gabuar, a thua vallë se udhëheqja s'vlente një pare? U demaskua «Balli» si organizatë sot, në vend që të demaskohej një muaj më parë, ose më pas, kjo është një çështje taktike, por jo një vijë e gabuar, pse fakti është se «Balli» u godit dhe u shpartallua dhe kjo u bë jo pse Sejfulla Malëshova dha «alarmin e parë», por sepse vija e Partisë sonë

¹ Në korrik të vitit 1943, Vukmanoviç Tempo — një nga udhëheqësit kryesorë të PKJ, i cili kishte ardhur në Shqipëri me mision të posaçëm për të krijuar të ashtuquajturin «Shtab Ballkanik», akuzoi PKSH-në për qëndrim oportunist ndaj «Ballit Kombëtar». Me akuzat e Tempos u bashkua edhe Sejfulla Malëshova.

s'ishte e gabuar. Por qëllimet e Sejfullaut ishin të tjera. Dhe ato u dukën në Berat, u dukën edhe pas Beratit. Aktet e Sejfulla Malëshovës s'kanë qenë sporadike, por konsekiente; vija e gabuar e Sejfulla Malëshovës s'ka qenë e rastit, por një vijë e tij, një vijë oportuniste që ai e ka në gjak dhe që e ka manifestuar kurdoherë, derisa me të vërtetë u bë alarmante për Partinë tonë.

Plenumi i Beratit për Sejfulla Malëshovën ishte terreni i tij, ku ai do të manevronte dhe manevroi. C'i kishte dhënë Sejfullau luftës dhe Partisë deri në Berat? Mund të themi fare pak, për të mos thënë aspak. Në Berat ai doli mbi të gjithë, «njeriu që bënte ligjin, njeriu i pagabueshëm», «njeriu që i kish parashikuar të gjitha gabimet e mëdha të Partisë», «njeriu që dha alarmin, por s'ju dëgjua» dhe tani i erdhi koha të godasë majtas e djathtas Partinë dhe udhëheqësit pa përjashtim e me sigurinë më të madhe të përcaktonte «vijën e re».

Cilat ishin shkurtimisht tezat e Sejfulla Malëshovës që shtroi në Plenumin e Beratit?

«Politika e Partisë për Frontin ka qenë e gabuar; në të vërtetë nuk ka pasur një vijë në lidhje me Frontin.

Qëndrimi i Partisë ndaj «Ballit Kombëtar» pas daljes së tij, për të mos ta goditur atë si organizatë, ka qenë oportunist. Partia ka pritur që diferencimi në «Ballin Kombëtar» të bëhej në mënyrë spontane. Kjo ishte një taktikë oportuniste.

Pas Konferencës së dytë Nacional-Çlirimtare të Labinotit ne e goditëm «Ballin» me armë. U hodhëm kështu nga oportunizmi në sektarizëm e viceversa.

Unë (Sejfulla Malëshova — *Red.*) kam mbrojtur të zën që «Balli» vetëm duhet demaskuar dhe jo luftuar me armë. Unë dhe Tempoja kemi kundërshtuar të imerreshin masa të rrepta kundrejt Doktorit (Ymer Dishnicës — *Red.*) dhe Mustafa Gjinishit, lidhur me Mukjen. E kemi quajtur gabim të rëndë që pas Mukjes nuk vajtëm të takoheshim dhe të bisedonim me «Ballin», ashtu si ishte vendosur në Mukje.

Në Parti, në ushtri dhe në popull ka pasur tendenca terroriste. Kjo tregon dobësitë e politikës së Partisë dhe mungesën e lidhjes së saj me masat. Kështu në Parti u dukën simptoma të degjenerimit — dhe në qoftë se s'marrim masa, ajo do të degjenerojë në një bandë kriminelësh. Rrënjet e gabimeve nuk duhet t'i kërkojmë gjetkë, por në vetë Partinë tonë. Po të ishte ajo një Parti komuniste e vërtetë, kjo nuk do të ndodhte. Një nga arësyet kryesore të gabimeve është kompozicioni social i Partisë, e cila ka dalë nga borgjezia e vogël. Arësyja e dytë kryesore janë traditat politike të vendit tonë — tradita puçiste dhe terroriste. Partia s'është edukuar me frymë marksiste-leniniste. Kuadrot kanë ardhur nga shkolla borgjeze dhe s'janë pajisur me teorinë marksiste-leniniste. Libra marksiste-leniniste janë kënduar, por kjo nuk mjafton, duhet punuar me metodë dhe stil marksist-leninist. A mund të quhet marksiste-leniniste ajo që është shkruar në shtypin tonë për Enverin si një faktor kryesor i Luftës nacional-çlirimtare? Ne, pra, s'kemi pasur as Parti, as udhëheqje marksiste-leniniste.

Në partitë komuniste duhet të ketë një politikë

të krerëve dhe të kryetarit të partisë. Si është shtruar dhe është zgjidhur kjo në Partinë tonë? Edhe këtu kemi gabuar, sepse s'kemi menduar si marksistë. Krerët dhe kryetari nuk bëhen me dekrete, ata dalin nga lufta. Të marrim punën e Enverit si kryetar të Partisë. Në Partinë tonë nuk kemi pasur dhe nuk mund të kishim një kryetar, sepse s'ka pasur një parti marksiste-leniniste dhe një vijë të drejtë. Nuk është mjaft të kesh një sekretar të përgjithshëm, duhet të kesh kryetar. Ky do të dilte kur Partia jonë do të forcohej. Në Helmës¹ u vendos që të popullarizohej Enveri. A ishte ky mendimi i Partisë? Partia nuk mund ta thoshte fjalën e saj. Kështu politika e krerëve dhe e kryetarit u shtrua dhe u zgjidh keq.

Fronti Nacional-Çlirimtar duhet të zgjerohet me njerëz që kanë autoritet dhe besimin e popullit. Kufi për zgjerimin e Frontit nuk ka. Këtu mund të vijnë edhe disa njerëz si Cen Elezi, pse duhet t'i shkëputim ata nga reaksioni dhe të mobilizojmë masat. Edhe në punën e gjyqeve nuk duhet të jemi të ashpër, sepse kemi qenë në pozita të gabuara.

Komiteti Qendror nuk e ka pasur të qartë rolin e këshillave nacional-çlirimtare si organe të pushtetit popullor. U bë në Labinot Statuti i këshillave, por nuk e dinte njeri ç'domethënë. Meqë kemi pushtetin në dorë, do bëhen transformime ekonomiko-sociale, por ato do të kenë karakter demokratiko-borgjez. Sot ne kemi një qeveri dhe këshillat nacional-çlirimtare

¹ Në Plenumin I të KQ të PKSH, maj 1944.

dhe mbi këto themele duhet të ngremë një shtet, prandaj duhet të menjohemi mirë.

Sukseset tona ushtarake s'kanë shkuar paralel me ato politike. Këshillat nacional-çlirimtare dhe terrenin i kemi të dobët. Ushtria s'është e lidhur si duhet me pushtetin. Ka tendenca që ajo të shkëputet. Kjo vjen ngaqë puna politike e Partisë në ushtri është e dobët. Me rritjen e ushtrisë puna jonë komplikohet edhe më tepër.

Koçi Xoxe dhe Nako Spiru, si anëtarë të Byrosë Politike, duhej të bënин më tepër për të ndryshuar situatën në Parti. Megjithëse gjendja nuk mund të ndryshohej pa ndërhyrjen e Komitetit Qendror të PK Jugosllave, ata duhej të jepnin alarmin e tretë. Alarmin e parë e dha Tempoja, të dytin e dhashë unë. (Sejfulla Malëshova — Red.)

Rreziku më i madh për Partinë ka qenë dhe është sektarizmi. Por kjo s'do të thotë që s'ka pasur dhe s'ka tendenca oportuniste. Zjarrin më të madh duhet ta drejtojmë kundër sektarizmit.

Ky plenum shënon vetëm fillimin e kthesës në Partinë tonë. Kthesa duhet të bëhet në gjithë organizatat e Partisë, në gjithë lëvizjen, në Frontin, në këshillat, në ushtri».

Sejfulla Malëshova në Berat u bë anëtar i Komitetit Qendror dhe anëtar i Byrosë Politike.

Sejfullau pra, i cili nxori konkluzionet e Plenumit të Beratit (mania e tij ka qenë kurdoherë të nxjerrë konkluzionet dhe kjo gjë bëhej prej tij me qëllim) e dënoi vijën e Partisë dhe e quajti të gabuar.

Tani bëhet pyetje: A ishte e gabuar vija e Partisë, para Beratit? Unë mendoj se jo. Mund të ketë pasur dhe ka pasur raste, ku taktika ka qenë e gabuar, por kjo është korrigjuar. Në qoftë se ka pasur raste, ku taktika ka qenë e gabuar për një çast, kjo sipas mendimit tim, nuk rriddhe se vija e Partisë kish qenë e gabuar, por se metoda dhe stili i punës kishin defekte të mëdha, sepse çështjet organizative të Partisë nuk ishin një gjë e përsosur, dhe sepse rrrethanat e luftës (kjo ka qenë arësyjeja kryesore) nuk na lejonin me pasë lidhje të shëndosha me tërë organizatat. Një punë e tillë, e zhvilluar në konditat që i dimë të gjithë dhe po të mbahet parasysh shkalla e eksperiencës dhe kapaciteti që kishin shokët, patjetër ka pasë sektarizëm dhe oportunitizëm. Por këto s'arritën kurrë që të bëheshin një rrezik i madh, që të izolohej Partia ose të likuidohej Fronti. Kjo s'ngjau. Dhe nuk ngjau se vija e Partisë s'ka qenë e gabuar. Ndryshe nuk do të ishim në këto pozita. Mukja s'ka qenë «piella e vijës së gabuar të Partisë» sikundërqë u tha në Berat, por pjella e doktor Dishnicës, i cili e ka merituar plotësisht dënimin që i është dhënë. Këtu dua të bëj një parantezë: Sejfulla Malëshova ka qenë konsekuent në taktilën e tij; Mukjen ai e nxori si «rezultatin logjik të vijës së gabuar të Partisë» dhe pra, dënimin e doktor Dishnicës, të padrejtë; prandaj ai propozoi dy herë që Doktori të hynte në Komitetin Qendror. Në punën tonë, para Plenumit të Beratit, ka pasë gabime, por të një natyre tjeter. Çështjet organizative të Partisë në përgjithësi nuk ishin shtruar drejt, kishte të meta dhe lëshime. Ndryshe është se kur i analizojmë tanit ato gabime e të meta, me këtë jetë par-

tie që kemi e me këtë eksperiencë më të madhe, jemi më të gjerë e më indulgjentë për këto gabime, se sa ishim në Plenumin e Beratit. Atëhere momentet, rrethanat dhe eksperienca jonë kanë qenë ato që dimë, megjithatë ato ishin gabime dhe të meta që Plenumi i Beratit duhej t'i shëronte dhe t'i ndreqte. Të tilla ishin: çështja e vetë Komitetit Qendror dhe çështja e Byrosë, puna e tyre si organe udhëheqëse të vërteta duhej vënë drejt, duhej ndërruar stili dhe metoda e punës; çështja e kuadrove dhe politika e kuadrove lypte një revizion të mirë dhe të shëndoshë. Rreth këtyre gjërave kryesore ka pasë edhe shumë çështje të tjera të vogla, të cilat kishin krijuar moskënaqësi që nuk shpreheshin lirisht, në mënyrë marksiste dhe si duhet të veprohet në një parti të shëndoshë. Ky qëndrim s'bënte përjashtim në të gjithë metodën dhe stilin e punës sonë. Tamam, tok me analizën e gjithë punës, Plenumi i Beratit duhej të korrígjonte edhe këto gabime, të zhdukte këto moskënaqësi, t'i vinte punët sa të mundej më drejt për të ardhmen. Esenca e këtyre moskënaqësive kishte baza dhe s'ishte e sëmurë, por këto u shtruan shtrembër, me mënyrat dhe qëllimet që tregova më lart dhe muarën shtrembër. Për mua faktori kryesor në shtruarjen e çështjes gabim është Velimir Stojniçi, i cili i orientoi dhe i inkurajoi punimet e plenumit në këtë drejtim ku arriti dhe Sejfulla Malëshova, i cili u vuri kapakun dhe vulën e tij gjithë punimeve të plenumit.

Pas çlirimt, Partia mori një hov të ri, shpresa të reja u ngjallën në kuadrot, besimi në Partinë forcohej, perspektivat e së ardhmes i kishim më të qarta dhe u krijuar besimi se punët do të shkonin më mirë dhe më

drejt për të zgjidhur problemet e zorshme që kishim përpara me rastin e çlirimit të plotë të Shqipërisë. Çështja organizative e Partisë u vu më drejt dhe në forma më të rregullta dhe më konkrete. Çlirimi i Shqipërisë vetë ishte një faktor i madh që organizata jonë do të bëhej më koherente, më kompakte nga ana organizative, pse lidhjet dhe kontaktet do të bëhen në rregull dhe me më shumë lehtësi se në kohën e luftës. E gjithë Partia e kuptonte përgjegjësinë e rëndë që kishte mbi supet për drejtimin e shtetit tonë; kuadrot udhëheqës, me gjithë mungesën e eksperiencës së tyre në drejtimin e aparatit të ri të shtetit dhe në zgjidhjen e problemeve vitale ekonomike të vendit në konditat e vështira të pasluftës, i realizonin detyrat e rënda. Ata kishin besim në vete, sepse ishin njerëzit e luftës. Plenumi i Beratit ndihmoi në këtë drejtim.

Mirëpo kthesa do të ishte e plotë në Parti, po të qe se Berati do të kish qenë me të vërtetë një mbledhje plenumi ashtu si theksova më lart dhe po të mos ishin bërë gabimet që përmenda. Plenumi i Beratit la në Partinë tonë dhe në kuadrot disa pikëpamje të gabuara dhe të dëmshme që u bënë të rrezikshme deri në një pikë, dhe, në rast se ne nuk i spastrojmë, puna do të pengohet.

1. U krijuar një pikëpamje, si rrjedhim i punimeve të Plenomit të Beratit, se në udhëheqjen e Partisë ka njerëz që kanë gabuar rëndë dhe njerëz që s'kanë gabuar fare, pra vjen vetëvetiu se te kush duhet të mbështetet besimi. U kritikua ashpër mënyra e punës në Komitet Qendror dhe në Byro, si organe drejtuese gjatë gjithë kohës së luftës. Kjo duhej të na shërbente si mësim i madh edhe pas Beratit dhe të na ndalonte të

përsëritnim gabime të tilla. Por çështja e Komitetit Qendror dhe sidomos e Byrosë, nuk eci si duhej. Kjo çështje u shtrua prapë gabim, sepse me kompozicionin e saj të ri dhe me të metat e saja organike dhe subjektive të atyre që formuluan kritikat në Plenumin e Beratit, do të na conte përsëri në gabime. Byroja që u riorganizua në Berat, si thashë dhe më lart, ishte një Byro e re me përjashtim të Nakos, të Koçit dhe timin. Në formë dukej sikur kishte unitet mendimesh dhe harmoni në këtë Byro, por në realitet s'ishte ashtu. E para, pozita ime konsiderohej nga të tjerët formale, se unë, në sy të shokëve, isha njeriu që kisha gabuar dhe rrija atje se s'mund të bëhej ndryshe. Sejfullau nuk kishte fituar jo vetëm besimin tim, por, jam i sigurt, se as atë të Koçit dhe as të Nakos, dua të them besim në këtë pikëpamje që Sejfullau të ishte një element i shëndoshë në Byro. Ky mendim për Sejfullaun vinte, sepse ai s'kish dhënë prova tangibles¹ të një pune konkrete.

Pandi, Bedriu, Tuku, që të tre këta, ishin të rinj në Byro. Kam qenë i vetmi që kam hezituar për ju të tre që të vinit në Byro dhe kam hezituar në se do të ishit në gjendje të drejtonit me të vërtetë si anëtarë të Byrosë. Këtu nuk dua të them se ne të tjerët ishim petrita, por kishim pak më tepër eksperiencë. Tani me një Byro të tillë ishte rrezik të binim në gabime të tjera dhe s'munguam. I bëmë «kritikë» metodës së punës së vjetër në Berat, por çështja ishte që të mësonim nga kjo. Në vend që Komiteti Qendror dhe Byroja të drejtonin efektivisht gjithë punën, në vend që problemet të

¹ Tangibles (frëngj.) — të prekshme, të vërteta.

shtroheshin dhe të zgjidheshin efektivisht atje dhe të drejtoheshin organizatat e Partisë dhe pushteti nga një qendër efektive, në bazë të centralizmit demokratik, nuk u bë ashtu. Këtu s'është puna se çështjet nuk shtroheshin në Byro, por mënyra e punës në Byro ishte gati si ajo e vjetra, me ndryshimin që mbledhjet bëheshin më shpesh se në kohën e luftës, por stili linte shumë të dëshirohesh dhe me pak përmirësimë ishte si ai para Beratit. Drejtimi efektiv u spostua, drejtimi bëhej jo nga Byroja Politike, por nga zyrat e KQ të Partisë dhe nga njerëzit që punonin atje, domethënë: nga Koçi me aparatin e kuadrove dhe nga ana tjetër nga Nakua, i cili ishte më në kontakt, në pikëpamje pune, me ta. Puna pra s'ishte dhe s'mund të ishte e përqëndruar në duart e Byrosë dhe të kontrollohej prej saj. Përgjegjësitetë s'ishin të caktuara, kompetencat ishin të ngatërruara. Ç'tuhesh në Byro (për aq sa merreshin dhe si merreshin ato vendime) dhe ç'bënte Sejfullau? Shumë herë bënte të kundërtën. Çdo gjë ky e teorizonte dhe përpinqesh, në këtë mënyrë, të çante me supe për të dalë në krye efektivisht; por teorizimi i tij s'përputhej me realitetin dhe shumë herë ishte në kundërshtim. Konkretisht në zbatimin e vendimeve ai vazhdonte të jepte fare pak, rendimenti i tij ishte negativ. U tha, kur u bë analiza e punës në Plenumin V dhe në punimet e Byrosë para këtij plenumi, se Sejfullau kishte influencuar më shumë në tendencat e theksuara oportuniste që u dukën në vijën tonë. Këtu s'u gabuam aspak, pse këto tendenca Sejfullau i kishte shfaqur dhe ngritur në teori që në Plumin e Beratit, por më mirë dhe më qartë u dukën pas çlirimit. Ku i kishim sytë ne që s'e pamë këtë gjë

më parë? Pikërisht sytë s'i kishim në vend, pse s'ekzistonte një Byro me unitet për imjaft kohë pas Beratit, pse unë isha në ato pozita që thashë, pse Tuk Jakova interesohej më pak nga të gjithë dhe tregonte një plogështi të çuditshme ndaj çështjeve, pse Pandin, natyra e tij dhe metoda e punës së tij, e bënин t'i shihte punët ngushtë, pa perspektivë të gjerë, pse Bedriu punonte, por fare lehtë influencohej edhe për të mirë edhe për të keq, si ngjau përsa i përket gjykimit mbi Sejfullanë. Kishte kundërshtime në Byro e sidomos përtendencat e Sejfullaut, por këto kundërshtime s'u realizuan në një koncept të shëndoshë analize të vijës. Shkaku ishte te përbërja e Byrosë. Në një shkallë më të vogël, por jemi përsëri në ujërat e Plenunit të Beratit. Besimi në shokët nuk ekziston i shëndoshë, flitet me rezerva, me paragjykime, ka ndrojtje, ka ftohtësi. Këtu gjeti përsëri shesh Sejfullau që të influencojë përgabime në vijë. Mund të mendoni ju dhe të thoni: Mirë, po pse s'i pe ti këto gjëra dhe t'i shtroje si i shtron sot? S'është e vërtetë që s'i kam parë, por ka edhe nga ato që s'i kam parë dhe që i realizoj tanë; edhe më mirë akoma mund t'i realizojmë, unë edhe ju bashkë, më vonë. Por është fakt sikundërqë thashë edhe më lart, se unë s'isha i bindur përsa u vendos në Berat. Pse s'u shfaqa haptas? Për dy arësy: E para, pse shihja që s'ishte momenti dhe e ndjej përgjegjësinë për këtë dhe e dyta, pse dhe unë jam sikundër edhe ju të gjithë, me po ato kualitete dhe me po ato të meta të trashëguara nga puna e vjetër. Por vetëm unë konstatoja fare qartë një gjë dhe këtë ja kisha shfaqur edhe Koçit edhe Nakos: unë isha i shternguar të lidhja duart, domethënë s'po

punoja dot dhe s'po drejtoja dhe, me këtë doja t'i jepja atyre që ta kuptionin, se këtu s'drejton Byroja. Kisha folur shumë herë për dualitetin që ekzistonte Parti-pushtet dhe që drejtimi i pushtetit nuk bëhej në rrugën që duhej të bëhej. Nga ana tjetër shihja korrentet që vinin e përplaseshin te unë. Kur vinte Sejfullau që me mënyrat e tij më qahej «jo pse nuk popullarizohej ai dhe pse popullarizohej Nakua», etj., kur vinte Velimir Stojniçi dhe, për t'u treguar i afruar, më thoshte se «duhej të drejtoja, pse isha sekretar e kryeministër» ose më linte të kuptoja se «Sejfullau është ambicioz ose s'është gjë» etj., unë nxirrja konkluzionet e duhura. Por shokët duhej të shihnin qartë një gjë: që vija para Plenomit të Beratit nuk ishte e gabuar dhe unë nuk kisha gabuar ashtu si u shtrua në Berat dhe nuk meritoja atë trajtim që m'u bë. Unë nuk akuzoj asnjë shok, qoftë nga të Byrosë ose të plenomit që t'u ketë munguar dashuria dhe vlerësimi i mirë ndaj meje, por atje, në Berat u godit në radhë të parë vija e Partisë dhe unë isha nga kryesorët që u godita. Pra, efektivisht pas kësaj unë nuk mund të kisha autoritetin e duhur. Kjo është evidente dhe këtu është arësyjeja që unë s'i shtrova më përpara pikëpamjet e mia dhe këtë e bëra që këto të mos merreshin si çështje personale. Por unë kam pasur kurdoherë besim te shokët e ndërgjegjshëm dhe do të gjeja rastin e përshtatshëm për t'i shtruar këto çështje të rëndësishme. Dhe duke e pasur këtë besim të patundur te shokët, se të gjithë e duan Partinë njësoj dhe punojnë njësoj për të, do të vazhdoj të analizoj hapët të metat e tjera që trashëguam nga e kaluara dhe nga Plenumi i Beratit.

Në Berat, pra, hynë në Komitetin Qendror njerëz të rinj, të thjeshtë, të pastër, që kishin të ardhme të mirë për Partinë. Mirëpo këta njerëz të rinj, që asistuan për herë të parë në Komitetin Qendror patjetër, përvèç mësimave të mira që muarën nga plenumi, muarën dhe ato të këqiat. Ata njerëz kujtuan se nga Berati e tëhu mbaruan gabimet, s'ishte rrezik të gabojmë më, ata që gabuan u hodhën tej, puna do të ishte e pagabueshme. Besimi konshient është i mirë, por besimi pa baza është i dëmshëm. Në punë do të shihnim në gabonim më, apo jo. Shumë pak i shihnim ne të Byrosë, gabimet që po bëheshin nga shokët që punonin në Komisionin e kuadrove dhe që drejtonin efektivisht për një kohë të gjatë. Jo vetëm që punët nuk shkonin dhe aq mirë, por kishte shumë të meta dhe gabime, bile këto të meta e gabime u përngjanin atyre që ne gjoja kritikuam aq shumë në Plenumin e Beratit. Nga aparati i KQ të Partisë dilnin udhëzimet për Partinë dhe për pushtetin; atje zgjidheshin problemet që duhej të zgjidheshin në Byro. Kjo mund të vazhdonte pa përpjekje për një kohë të shkurtër, por jo gjatë, sepse, kur nuk drejton Byroja, të gjithë drejtojnë pas kokës; urdhërat kundërshtojnë njëri-tjetrin; gjithsecili përpinqet të mbrojë pikëpamjen e vet dhe të ngulë këmbë edhe kur pikëpamja e tij është e gabuar, ose të lëshojë terren pa qenë kurrë i bindur se këtë duhej ta bënte, por vetëm se ashtu e lypte «politika».

Në Byronë Politike të Partisë sonë dhe në mes shokësh s'ka «politikë», sepse «me ba politikë» me shokët, do të thotë të lësh të majisen çështjet, të krijohen mërisira, të krijohen pikëpamje të sëmura, të krijohen tarafe, të krijohen më në fund fraksione. Burimin e këtyre gjërave,

që janë në kundërshtim me parimet e Partisë sonë duhet ta zhdukim. Këto të këqia duhet t'i luftojmë pa mëshirë. Lufta kundër këtyre të këqiave nuk është dhe aq e lehtë, por është e mundshme në Partinë tonë të re dhe të dalë nga lufta e me kuadro të shëndoshë dhe të rinj që këto gjëra nuk i kanë në gjak e në traditë.

2. Një çështje tjetër është mënyra që u përdor në shtruarjen e këtyre problemeve me rëndësi në Berat, domethënë në formën e «coup d'état». Zgjidhja e çështjeve në Plenumin V nuk u bë si në Berat, nuk u arrit me një metodë pune si ajo që pregetiti Plenumin e Beratit. Megjithatë nga shumë shokë pa të drejtë u konsiderua dhe konsiderohet njësoj si «coup d'état» e Beratit. Unë them se s'janë njësoj. Punimet e Plenumit V duhet të konsiderohen ndryshe nga gjithë Partia për arësyet që do të rreshtoj më poshtë.

Kur në punimet e Byrosë, para Plenumit V dhe në plenumin vetë u shtrua çështja e likuidimit të shfaqjeve oportuniste në vijën politike, kjo gjë u bë sepse ishte më e rëndësishmjë, më kritikja, më e rrezikshmja, më tendenciozja. Por kishte edhe diçka tjetër, që duhej shtruar dhe që s'u shtrua. Ishin pikërisht këto çështje që po shtroj sot.

Plenumi i Beratit e kish djegur shumë Partinë dhe unë nuk dëshiroja kurrën e kurrës të përsëritez ai gabim. Duhej të korrigjohej, të bëhej e drejtë via politike dhe të dënohej ashpër Sejfulla Malëshova pse e meritonte, por duhej të kritikoheshin, natyrisht, pak më ngadalë, më butë, por drejt edhe ata shokë që mund të kishin gabuar joqëllimisht, por që edhe punonin shumë. Kush punon gabon, kurse Sejfulla Malëshova s'punoj edhe

gaboi. Këtë ta kuptojmë mirë. Të kuptojmë, pra drejt ndryshimin në mes Plenumit V dhe mbledhjes së tanishme me atë të Beratit. Çfarë ishte ajo diçkaja tjetër, përveç çështjes së vijës politike që nuk u shtrua në Plenumin V? Ishte analiza e vijës organizative të Partisë, ishte gjithë drejtimi, organizimi i brendshëm i Partisë, i Frontit dhe i pushtetit. A ka pasë tendenca të gabuara serioze në punën organizative, sikundërqë ka pasur në atë politike? Unë mendoj se ka pasur gabime, ka pasur të meta dhe lëshime. Vetë tendencat e gabuara që u dukën në zbatimin e vijës sonë politike kanë pasur reperkusione në punën organizative. Plenumi i Beratit ka pasur reperkusionet e tija, puna e para Beratit dhe metoda e stili i vjetër kanë pasur dhe ato reperkusionet e tyre. Këtu mos kemi iluzione. Të gjithë mund të binim në këto gabime dhe të gjithë kemi rënë kush më shumë e kush më pak dhe të mos çuditemi aspak se edhe pas kësaj analize edhe pas një analize tjetër e tjetër, do të gjejmë përsëri gjurmat e këtyre gabimeve. Por sa kohë do të shkojë? Eksperienca jonë do të jetë më e madhe, do të gabojmë më pak dhe kjo do të jetë shenja që Partia jonë shkon drejt bolshevizimit.

Gabimi i parë dhe kryesori është te Komiteti Qendror dhe te Byroja. Këto forume nuk kanë drejtuar si duhet të drejtonin dhe këto për arësyet që thashë më lart. Por këtej rrjedhin një varg gabimesh të tjera. Komisioni i kuadrove me anëtarë të plenumit dhe me Koçin në krye, përgjegjës kryesor përpara Byrosë, drejtonin efektivisht punën. Por Komisioni i kuadrove i kish kaluar kompetencat e veta dhe si rrjedhim ata nuk mund të ishin në gjendje si duhej, qoftë edhe sikur atje

të ishin shokë me eksperiencë të madhe, të kryenin një barrë aq të rëndë sa ishte ajo e drejimit të Komisionit të kuadrove vetë dhe të punës në përgjithësi. Ata filluan t'i marrin në duart e tyre edhe kompetencat e të tjera. Kjo është një e metë organizative që ka konsekuencia jo të mira në punë. Përveç kësaj puna u muar pakëz si qesim prej tyre dhe u formua pak nga pak një bindje sikur çdo gjë po drejtohesh mirë dhe pa gabime. Mirëpo në realitet s'ishte ashtu. Politika e kuadrove nuk zgjidhej drejt, kuadrot tanë s'po edukoheshin si duhej, kurset s'po ecnin, gabimet në pushtet ishin të shumta, konferencat e ndryshme me kuadrot s'ishin substanciale, s'i-shin konkrete sa duhej. Kuadrot e Partisë dhe të pushtetit vinin në zyrat e KQ të Partisë dhe pikërisht në Komisionin e kuadrove dhe aty merrnin udhëzime për zgjidhjen e problemeve me shumë rëndësi, bile vitale, për Partinë. Deri ku këto udhëzime ishin të frytshme dhe jepnin rezultate si duhej? Kjo është e dyshimtë për mua, sepse vetë Byroja s'ishte e qartë në këto probleme, sepse vetë Byroja nuk punonte në një mënyrë të atillë që t'i zgjidhte këto probleme dhe të udhëzonte gjithë Partinë. Shokët e Komisionit të kuadrove bënин çmund-nin (s'mund të mohohet puna e tyre e palodhur), por në atë drejtim që kish marrë puna, ata praktikisht do t'i bënин mangut që të dyja. Këtu e kanë burimin dhe shumë të meta të pushtetit. U krijua një farë dualiteti Parti-pushtet. S'ishte kuptuar mirë si e drejton Partia pushtetin, pse ishin konfonduar punët në krye. S'ishte i qartë roli i pushtetit, rëndësia e tij kryesore për Partinë. Ministri, qoftë sikur të ishte dhe nga komunistët më të mirë dhe më të provuar, s'kishte shumë vleftë për nje-

rëzit e Partisë. Partinë ata s'e shikonin në pushtet, ë shihnin vetëm një disa zyra. Këtej lindnin lëshime sa të duash, mospërgjegjësi në punë, mungesë respekti dhe disipline, mungesë konspiracioni, pozita të shtrembëra, akraballëk, krijim miqësish false, arrivizëm, e shumë të liga të tjera. Në mënyrën si ishte shtruar çështja, Partia e kishte të pamundur të kontrollonte punën, të bënte një politikë si duhet të kuadrove, të bënte mobilizimin e gjerë të masave, të zgjidhte si duhej problemet e mëdha që i viheshin përpara. Pra puna ishte marrë pak si më të lartë nga Komisioni i kuadrove dhe kritikat s'para i pritnin me qejf. Por që të pranohet kritika, duhet të ketë kaluar andej dhe autokritika si prej atij që i bëhet ajo kritikë, ashtu dhe nga ai që e bën, sepse në parti mund të thuash pa frikë: s'ka kush që të mos gabojë, por ka gabime dhe gabime. Vlera e një komunisti qëndron kur ai i sheh këto gabime dhe përpinqet t'i korrigojë, të korrigojë edhe shokët. Një punë e tillë, një drejtim i tillë ka krijuar disa situata jo të pëlqyera, bile të rrezikshme, në rast se nuk veprojmë shpejt.

Të marrim çështjen e rinisë. Rinia është sektori më i rëndësishëm i Partisë, ajo është burimi i kuadrove tanë dhe i kuadrove që do të ushqejnë Partinë, që do ta çojnë përpara. Është fakt i pamohueshëm që rinia, ashtu si ka qenë në luftë faktor vendimtar, ashtu është edhe tanii, pse ajo ka entuziazmin, ka forcën dhe gjallërinë dhe po të edukohet mirë nga Partia, do të bëhet mbësh-tetje e mirë për të. Rinia është iniciativa, guximi, e tanishmja e madhe dhe perspektiva e qartë për të ardhmen. Vihet pyetja: A e ka drejtuar efektivisht rininë, Partia? Unë mendoj se jo. Dhe në mënyrën që janë zhvi-

lluar punët, s'mund ta ketë drejtuar. Me drejtue këtë sektor të gjerë dhe të rëndësishëm, s'është vetëm me mbajt lidhjet dhe me dhënë herë pas here disa udhëzime, por me i rrahë mirë në Byro problemet e rinisë, me i studjue konkretisht dhe me ja dhënë rinisë këto drejtime, këto probleme të zgjidhura si duhet, të punuara si duhet. A e kemi bërë këtë gjë? Unë them se jo. Përkundrazi, shokët e rinisë na i kanë paraqitur ne. Por mund të jetë ndonjë që të thotë se ata janë më në korrent të çështjeve të tyre. Unë them mirë, janë njerëz që shkojnë përpara, por pse të mos vihet në korrent si duhet Byroja Politike dhe Komiteti Qendror i Partisë sonë për këto gjëra? Kjo gjë duhet bërë që të shihet drejtimi, që të ndjehet lidhja, që të ndjehet kohezioni dhe respekti ndaj udhëheqjes. Ndryshe rinia ka rrezik të shkëputet. Shkëputja ka qenë një rrezik i përhershëm, por mua më duket se faji s'është aq i rinisë, sa është yni. Rinia ka marrë hov në vendin tonë, kjo duhet të na gjëzojë dhe ta inkurajojmë, por edhe ta drejtojmë. Por ta drejtosh, s'do të thotë ta pengosh. Këtu të kupto hemi dhe këtu të ndërrojmë mentalitet në qoftë se është rasti se ka mentalitet për të ndërruar. Unë kam konstatuar një frymë dualiteti në mes Partisë dhe rinisë, dua të them në mes disa shokëve të Partisë dhe të rinisë, flas për udhëheqjen e saj. Po pse rrjedh kjo? Për mua është çështje drejtimi. Njëri kërkon t'i imponohet tjetrit. Duhet të ketë vetëm një drejtim: Partia. S'ka kush e mohon këtë gjë. Çështja është që ta drejtojmë rininë drejt dhe efektivisht. Ka tendencë në disa shokë të Komitetit Qendror e veçanërisht të Komisionit të kuadrove, që të mos shikohet drejt çështja e rinisë, të vihen në dukje shumë gabimet

e saj atje ku janë, por edhe atje ku s'janë. Kjo s'është e drejtë. Është krijuar një farë acarimi në mes shokësh të mirë të Partisë dhe të rinisë. Kjo duhet sqaruar dhe luf-tuar, se është shumë e dëmshme. Më të gjerë duhet të jenë njerëzit e pjekur të Partisë për gabimet e vogla të ri-nisë; këto gabime e kemi për detyrë të domosdoshme t'i shohim dhe t'i korrigojmë, por për një gabim të njëllot-të, një anëtari të vjetër të Partisë mund t'i sëllojmë më fort, se i mban kurrizi, kurse te i riu të kemi kujdes se është i njomë, ai ndreqet më lehtë, sepse është filiz i ri. Pastaj, më duket se shokët e Komisionit të kuadrove du-het të analizojnë pak më qartë punën e tyre, gabimet e tyre, të cilat s'janë alarmante, por që, po t'ju vihen në dukje si duhet, do ta shohin dhe më qartë punën e rinisë, dhe atëhere do të zhduken krejt ato keqkuptime dhe ajo frymë që është e huaj për Partinë. Këtu nuk dua ta laj krejt rininë për të metat që ka në punën e saj, por mendoj se ato janë më pak të dëmshme se të me-tat tona. Megjithatë kjo s'do të thotë që ne t'i lëmë ato pas dore.

Do të mbaroj edhe me një vërejtje tjetër që edhe kjo e ka burimin në mënyrën e mendimit e të punës së vjetër dhe në mënyrën si u shtruan dhe u zgjidhën çështjet në Berat. Dua të them për singjeritetin dhe lirinë e plotë në shfaqjen e mendimeve. Është krijuar në shokët një frymë e sëmurë, një frikë me shfaq atë që mendon se mos merret për keq ose mos ketë konsekuanca. Do ta marr punën konkretisht këtu në Byro dhe kjo duhet të jetë model për gjithë Partinë. Duhet të ekzistojë besimi i madh në Partinë dhe në udhëheqjen, kjo është e domosdoshme. Por kjo do të jetë e tillë kur çdo gjë të

zgjidhet si e zgjidhin komunistët, haptas dhe në mënyrë shoqërore dhe kur ky besim është i vendosur mirë dhe ka dalë nga analiza dhe nga arësyetime të shëndosha. A ngjet kështu zakonisht në Byronë tonë dhe pastaj në Parti? Unë them se s'ngjet tamam kështu. Ka gradacione, dikush ka më guxim, dikush ka më pak, dikush ka më tepër besim në mendimet e veta, dikush ka më pak, dikush i shtron çështjet më mirë, dikush më dobët. Në të gjithë ne ekzistojnë këto gjëra, por te kush më shumë dhe te kush më pak. Kam vënë re shumë herë te Bedriu një pasiguri në mendime dhe një ndrojtje në shfaqjen e mendimeve. Mua shumë herë më ka thënë për çështjen e ushtrisë, për çështjen e personelit që s'ecën, pér pengesat dhe vështirësitë që hasen në këtë sektor, por këto si fakte. Unë kam përshtypjen se te Bedriu nuk mund të ishin vetëm fakte të palidhura dhe nga të cilat të mos kishte nxjerrë një konkluzion, ashtu si kishin nxjerrë edhe të tjerë. Kam pasë përshtypjen se Bedriu nuk ma shfaqte tamam mendimin e vet, por me ndrojtje dhe me rezerva. Përse të mos ta themi hapët? Unë nga pjesa ime dyshova pér qëndrimin e Bedriut në çështjen e Sejfullaut, por s'u dëshpërova. Bedriu akoma s'e kish parë mirë Sejfullaun dhe s'ka arritur t'i thellojë më fort këto çështje. Unë jam i sigurt pér një gjë dhe që është e vërtetë pér të gjithë ne, se Partinë dhe dashurinë pér të s'e varim në qafën e njërit ose të tjegrit. Ne, shokët i duam, i respekojmë, i ndihmojmë kur ata janë pér Partinë, por Partinë e duam më shumë se çdo gjë. Qëndrimet e Tukut dhe shfaqjet e tij kanë një karakter tjeter, Tuku është njeriu me pak pasione, kjo është një gjë e mirë, por bëhet jo e mirë kur këto

pasione gjenden në formën që i ka Tuku. Tuku jep një gjykim të lehtë dhe të pamatur për çështjen e Sejfullaut. Mendimi i tij është nxjerrë pa u thelluar. Kështu qëllon edhe për shumë gjëra të tjera, si pikëpamjet e tij në mbledhjen e fundit të plenumit për çështjet e popullarizimit dhe të legalizimit të Partisë¹. Ato janë mendime të papjekura, por Tuku mund të gjykojë më thellë. Interesimi i Tukut si drejtues i Partisë ka qenë i paktë. Tuku mund të justifikohet sa të dojë, unë nuk jam dakord me të. Është e vërtetë se punët në Byro nuk shkonin me atë ritëm që duhej, por në ato kondita, në qoftë se Tuku nuk është interesuar aq sa duhej, fajtë është më shumë i tij se sa i ndonjë njeriu tjetër. Sa për Pandin, ai interesohet, por për cikërrima dhe këto i sheh ngushtë, çdo gjë në një prizëm të vogël, ai nuk mund të realizojë si duhet gjerësinë e çështjes dhe është kurdoherë në pritje që të vendosin të tjerë, ta hapin të tjerë, pse ndruhet se mos thyhet diçka. Ai s'e ka fituar besimin në vetëvete dhe në gjykimet e tij. Këtu s'kam në mend të bëj kritikën e shokëve, por desha të ilustroja atë që thashë edhe më parë: çështjen e ndrojtjes dhe të frikës, me shfaq mendimin qoftë sikur edhe të jetë i gabuar. Këtu jemi në Byro dhe jo në pazar, këtu jemi në mes shokësh dhe jemi të gjithë përgjegjës përpara Komitetit Qendror. Është bërë si modë — kur bëhen kritikat ose

¹ Në Plenumin VI të KQ të PKSH që u mblohdh në prill 1946 Tuk Jakova tok me Koçi Xoxen në mbështetje të pikëpamjes së udhëheqjes jugosllave u shprer për ta mbajtur Partinë në ilegalitet, në kundërshtim me mendimin e shokut Enver Hoxha për ta legalizuar Partinë dhe për ta popullarizuar atë si udhëheqës së vendit.

rishikohen çështjet, dy-tri vetë hanë drunë, të tjerët kanë përshtypjen sikur janë të larë nga ato gjëra. Kësh-
tu doli në Plenumin e Beratit: tri-katër vetë e kishin «fajin», ata muarën dënimin, të tjerët s'kishin asnjë faj.
Kjo s'është e drejtë dhe s'mund të jetë e drejtë as për Plenumin V. Kush po gabon? Byroja në çdo moment dhe dy-tri vetë të Byrosë, ata që punojnë më shumë. Por të kuptohemi një çikë mirë. Gabojnë edhe Pandi, edhe Tuku edhe Bedriu bile edhe më tepër nga të tjerët në shumë raste. Por mos të kujtojnë, dhe s'duhet t'i lëmë të flenë në gjumin e rëndë, shokët e tjerë anëtarë të KQ, dhe anëtarë të Komisionit të kuadrove të cilët dhe ata kanë gabuar boll. Këtu nuk dua të them se në Partinë tonë s'bëhen përveçse gabime, por duhet çështjet të shikohen drejt dhe të vihen drejt.

Po të mos shtrohen çështjet drejt, vjen vetëvetiu mosbesimi në udhëheqje ose ka një besim fals dhe jo të rrënjosur mirë. Edhe shokët e mirë, kur nuk u shtro-
hen çështjeve drejt, mund të gabojnë në gjykime... Që ka gabime në punën tonë — kjo s'ka asnjë dyshim, por ka gabime të mëdha, ka edhe të vogla. Të dyja katego-
ritë duhet t'i korrigojmë dhe të përpinqemi të bëjmë sa më pak gabime, të gjitha këto analiza duhet të kenë këtë qëllim.

Në qoftë se shkojmë me këto parime, në qoftë se analizat e punës sonë i bëjmë në këtë frysme, ne do të kemi rezultate të mëdha në punë. Mos harrojmë se jemi përpara kongresit dhe të gjitha këto çështje duhet të zgjidhen mirë dhe drejt. Një zgjidhje e tillë është gjys-
mëpregatitja e kongresit, do të shohim më qartë vijën që do të punohet atje, do të zgjidhet në baza më të shën-

dosha Komiteti Qendror që do të dalë nga kongresi, do t'i shohim më mirë dhe do t'i zbatojmë më mirë punët, me një stil dhe metodë të vërtetë bolshevikë për të cilën ka aq nevojë gjithë zhvillimi i veprimtarisë së Partisë sonë. Unë çështjet i preka në përgjithësi dhe i hodha në letër pak me nxitim. Do të më falni në qoftë se ka dhe gabime, por këtu jemi, le t'i korrigojmë, pikërisht për këtë punë jemi mbledhur dhe të dalim që këtej me rezultate të shëndosha, të drejta, komuniste.

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

MESAZH PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR SHQIPTAREVE QË JETOJNË NË SHBA

14 qershor 1946

Vëllezër shqiptarë të Amerikës,

Me rastin që po nisen për aty delegatët e Shqipërisë për në Konferencën Ndërkombëtare të Shëndetësisë, jam i lumtur t'ju dërgoj përshtendetjet e mia.

Këta shokë janë shqiptarët e parë që po vijnë nga Shqipëria e lirë e po takohen me ju. Ata do t'ju tregojnë për luftërat e mëdha plot sakrifica po dhe plot heroizma që bëri populli ynë për të luftuar zaptuesit e egër fashistë dhe nazistë, për të çliruar Shqipërinë e dashur nga thundra e huaj e fëlliçur dhe nga tradhëtarët e pashpirt të vendit.

Populli ynë me Luftën nacional-çlirimtare u radhit përkrah kombeve të bashkuara dhe tregoi faqe botës se sa e do lirinë, se si e derdh gjakun për të drejtat dhe pavarësinë e tij.

Populli ynë me Ushtrinë e tij Kombëtare të lavdishme, që lindi e u farkëtua në zjarrin e luftës më madhështore të historisë së tij, fitoi lirinë, ngriti pushtetin e tij të fortë demokratik dhe sot, po me atë entuziazëm që pati në luftë, i është përveshur punës së rindërtimit për të ndrequr gërmadhat e panumërtë dhe për të shëruar plagët e rënda që na lanë armiqjtë.

Përmes vuajtjesës së pashembullta, me dhëmbë e me

thonj, ashtu si luftoi, populli ynë po punon për të ardhmen e tij, për një të ardhme të drejtë e të lumtur. Ai punon pse e do lirinë, do paqen e vëllazërimin, pse është i vendosur të ruajë e të forcojë të drejtat dhe pushtetin demokratik, që i fitoi me gjak, pavarësinë dhe integritetin tokësor të Shqipërisë si edhe të rrojë në harmoni dhe në bashkëpunim të plotë me të gjithë kombet paqedashëse.

Shokët që po vijnë do t'ju thonë se populli ynë, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe unë personalisht i dimë dhe i kemi ndjekur me simpati të veçantë përpjekjet e vëllezërve shqiptarë të Amerikës për lirinë dhe të drejtat e atdheut të largët.

Ne që të gjithë shprehim besim të patundur se ju, ashtu si në të kaluarën, bij të denjë të popullit tonë, do të qëndroni blok i pathyer, kurdoherë gati për të mbrojtur, kur ta lypë nevoja, lirinë dhe të drejtat e shenjta të atdheut tonë.

Unë ju uroj nga zemra gjithë të mirat dhe jam i bindur se edhe larg atdheut, me punën, me sjelljen dhe me bashkimin tuaj, ju do ta nderoni emrin e Shqipërisë.

Kryeministri

Ministri i Mbrojtjes Kombëtare dhe Ministri
i Punëve të Jashtme të Republikës Popullore
të Shqipërisë
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

PËRSHËNDETJE NË KONGRESIN E DYTE TË BASHKIMIT TË GRAVE TË SHQIPËRISË

4 korrik 1946

Jam shumë i prekur për pritjen tuaj kaq të përzmërt. Unë ju falenderoj shumë. Më ka ardhur keq që nuk pata fatin të isha qysh në fillim në kongresin tuaj, por unë jam vënë në korrent për punën e madhe që ju keni bërë këtu. Pa dyshim kongresi juaj ka qenë më tepër një kongres pune, se sa një kongres manifestimi. Dhe manifestimi ka rëndësinë e vet, por rëndësia më e madhe e tij është se nga ky kongres do të dalin rezultate të shëndosha, në mënyrë që puna e gruas të shkojë përpara me hapa të mëdha. Për këtë do t'ju them disa fjalë:

Populli shqiptar, me luftën e madhe që bëri, fitoi disa gjëra shumë të çmueshme, siç janë liria dhe pavarësia. Me këtë luftë populli ynë bëri gjithashtu dhe një revolucion të thellë shoqëror. Ndryshe, pa këtë luftë të tij, që u zhvillua vjete me radhë për dëbimin e okupatorit fashist, për rrëzimin e institucioneve të vjetra, për dënimin e klikave tradhëtare, e atyre që i kishin pirë gjakun popullit e që nuk e linin të merrte frymë, ishte e pamundur që të arrinim në ditën e sotme, ku populli shqiptar ka marrë fuqinë në dorë, vendos vetë mbi fatin e tij dhe nuk u la gjë në dorë atyre që kanë qenë kur-

doherë kundër tij. Në këtë luftë gruaja shqiptare ka dhënë një kontribut shumë të madh. Dhe këtë gjë ta kuptojnë të gjithë mirë dhe drejt. Gruaja jonë ka marrë pjesë aktive me armë, ka ndihmuar luftën jo vetëm materialisht, por ka kontribuar edhe në mënyra të tjera të mahnitshme që kanë pasur rëndësi shumë të madhe në kohën e luftës dhe kanë rëndësi të madhe edhe në kohën e sotme: gruaja e popullit tonë ka pasur një forcë shpirtërore dhe morale të madhe. Flas për gratë e popullit, për ato që u dhimbsej atdheu, për ato që kishin vuajtur tërë jetën e tyre, për ato gra mbi të cilat rëndonte e shkuara jonë e hidhur: mjerimet, vuajtjet, robëria, zakonet e këqia të vjetra, pra këto gra heroike shqiptare u bënë nxitëse dhe inkurajuese e të rinjve dhe e të rejave, që me një kurajo të madhe shkonin në luftën e armatosur dhe sakrifikonin çdo gjë për lirinë e atdheut. Në kohën e sotme, në epokën e pasluftës dhe të rindërtimit, roli i gruas është po aq i rëndësishëm, sa dhe i kohës së shkuar. Nuk mund të përparojë vendi ynë, nuk mund të ndërtohet Shqipëria si duhet, pa pjesëmarrjen e gruas, pse gruaja jo vetëm me forcat e saja fizike, po edhe me forcat e saja intelektuale dhe shpirtërore duhet të kontribuojë në rindërtimin e vendit. Ajo njëkohësisht do të luajë një rol të madh si edukatore e brezit tonë të ri, që është shpresa e së ardhmes, që është forcë e madhe dhe faktor kryesor i përparimit të vendit tonë. Patjetër gruaja do ta përbushë këtë detyrë, por lypset një punë e palodhur, duhet të përparojë, sepse, që të ketë një forcë shpirtërore të tillë dhe të jetojë e gjitha në këtë epokë, duhet që gruaja jonë të edukohet. Për këtë gjë shteti do të vërë gjithë forcat

që gruaja të ecë përpara, pse është në interes të vendit. Gruaja duhet të pajiset me kulturë. Në vendin tonë, mjerisht, gruaja, nga shkaku i së kaluarës, ka mbetur prapa, përqindja e analfabetizmit është shumë e madhe. Këtë gjë duhet ta zhdukim dhe me punë të plotësojmë këtë të metë. Nga ana tjetër, gruaja duhet të fitojë me të vërtetë pavarësinë e saj. Ç'do të thotë të fitojë pavarësinë e saj? Domethënë që kjo të bëhet e zonja e vetes, që kjo të hyjë në prodhim, të punojë në fabrika, në spitale e në zyra, të punojë kudo ku punojnë dhe burrat. Kjo nuk është gjë e lehtë, por ne kemi bindjen se do të arrijmë rezultate të mira. Natyrisht, gruaja jonë, e edukuar në një mënyrë të tillë, do të luajë një rol edukativ për brezin e ri, do të dijë t'u futë në shpirt si duhet fëmijëve dashurinë për atdhe e punë. E mbësh-tetur në traditat e kësaj lufte të madhe, ajo do t'i mësojë ata të jenë të rregullt në jetë, të duan rregullin dhe disiplinën, të mësojnë sa më tepër që të bëhen të vlefshëm për vendin. Gratë do të jenë ato që do të mbrujnë karakterin e të rinjve, pse kush më mirë se gratë, kush më afër se këto, janë me brezin e ri? Akoma ka mjerime e vuajtje në vendin tonë dhe do të ketë edhe për një kohë mjaft privacione. Do të jemi të detyruar të bëjmë edhe sakrifica. Por gruaja shqiptare do të jetë përsëri ajo që do të forcojë shpirtin e të rinjve, do t'i mësojë të bëjnë sakrifica për të kaluar në një jetë më të lumtur. Qeveria do të vërë të gjitha fuqitë që gruas t'i japë arësim dhe kulturë, t'i japë mundësi të marrë pjesë në jetën ekonomike dhe shoqërore. Organizata juaj këto detyra duhet t'i kuptojë mirë dhe duhet të jetë një mbështetje e madhe për zbatimin e programit të qeverisë. Duhet të kemi

besim në të ardhmen tonë, e cila, për të qenë e lumtur, varet nga përpjekjet dhe puna jonë. Me luftën dhe me sakrificat që bëmë, me vendosjen e demokracisë këtu në vandin tonë, ne kemi fituar simpatinë e gjithë botës përparimitare. Ne duhet të dimë se ne kemi miq të fortë, të cilët do të na mbrojnë nga çdo rrezik e në çdo moment dhe do të na ndihmojnë pa masë që vendi ynë të përparojë, që jeta ekonomike të shkojë përpëra dhe vendi ynë të rindërtohet.

Tani na presin punë të mëdha dhe duhet të dini një gjë, se këto punë nuk kryhen me fjalë. Populli ynë ka një gjallëri të madhe dhe një vitalitet e një entuziazëm të çuditshëm që shumë rrallë mund ta gjesh. Kjo të na japë shpresë dhe të na inkurajojë që ne të realizojmë shpejt e mirë gjithë planin e punës që kemi përpëra, por në punë duhet të ketë rregull e disiplinë. Pa këto dy gjëra, nuk mund të ecim përpëra. Gruaja shqiptare, që ka dhënë aq shumë më parë edhe tani ajo do të jetë në ballë të punës. Me punë do të ngrihet niveli i jetës sonë, do të përmirësohet jeta e grave të Shqipërisë. Prandaj unë ju uroj sukses dhe detyrat e kongresit tuaj të zbatohen si duhet në jetë. Të bëni që masat e gjera të grave të Shqipërisë të jenë në luftë të përhershme për rindërtimin dhe, të bashkuar rrëth pushtetit, t'i vëmë krahët dhe supet punës për të rindërtuar Shqipërinë tonë, për të bërë jetën e popullit më të lumtur.

Rrofshin gratë e Shqipërisë!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 471,
5 korrik 1946*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 471,
5 korrik 1946*

FJALA E MBAJTUR NË KONFERENCEN E INVALIDËVE

9 korrik 1946

Shokë invalidë të Luftës nacional-çlirimtare,

Kush më tepër nga ju mund ta ndjejë aq thellë si moralisht, ashtu edhe fizikisht sakrificën e madhe që bëri populli ynë për të fituar pavarësinë dhe lirinë? Heronjtë tanë të rënë në fushën e nderit, ju të gjymtuarit e luftës, fshatrat dhe qytetet e djegura janë shembulli më i lartë i kësaj sakrifice të shenjtë. Armiqtë e betuar të popullit, fashistët okupatorë dhe tradhëtarët e vendit tonë pregetitën me imtësi planet e tyre për të na shfarosur, ata përdorën çdo mjet barbar për t'i vënë në zbatim këto plane, por populli ynë s'u mposht. Regjimet shtypëse të së kaluarës që pregetitën invadimin e vendit dhe robëria e rëndë fashiste jo vetëm që s'ishin në gjendje t'i zhduknin ndjenjat e popullit tonë për liri e pavarësi dhe traditat tona luftarake, por ato shtuan dhe forcuan në zemrën e popullit tonë ndjenjën e fortë të hakmarrjes, ndjenjën e organizimit për një rezistencë të patreguar që do të mbetet legjendare për brezat e ardhshëm. Çdo shqiptar kuptoi rëndësinë e momentit që ka-

lonte atdheu, ai kuptoi se luftohej për jetë a për vdekje, prandaj për të realizuar aspiratat shekullore të popullit tonë, sakrifica supreme ishte në rendin e ditës. Për të çliruar atdheun dhe popullin tonë u muar parasysh sakrifica më e madhe. Luftohej për liri, për një të ardhme më të lumtur, luftohej për Shqipërinë e re ku njerëzit e sotshëm dhe brezat e ardhshëm të jetojnë dhe të punojnë të lirë dhe me ndër. Luftuam vjete me radhë me vetëmohimin më të madh, pa marrë parasysh sakrificat në njerëz dhe në material; luftuam për veten tonë dhe për mbarë njerëzimin që kërcënohej për vdekje nga fashizmi gjerman dhe italian; dhamë kontributin tonë me gjak në luftën e përbashkët antifashiste, ku Bashkimi i madh Sovjetik dhe ushtria e lavdishme e tij luajtën rolin vendimtar dhe historik duke shpëtuar njerëzimin nga vdekja e sigurt. Gjermania u mposht në sajë të heroizmit legjendar dhe të sakrificave mbinjerëzore të ushtrisë së lavdishme të Stalinit dhe si gjithë popujt e botës përparamtare edhe populli ynë i është mirënlohës për jetë.

Nesër, shokë invalidë të luftës, është festa e ushtrisë sonë, ku ju keni qenë pjesëtarë të denjë të saj. Dita e nesërme simbolizon për popullin shqiptar sakrificat e panumërtë, heroizmat e patreguara të partizanëve shqiptarë, që vjete me radhë në shi e në borë, në male e në qytete, kundër armiqve të egër dhe të armatosur deri në dhëmbë, mbajtën lart flamurin e luftës sonë dhe e çuan këtë nga fitore. Me mijëra e me mijëra shokë na u vranë, na u torturuan, na u gjyntuan por ne s'u ndalëm për asnjë moment në rrugën që na caktonte historia. Ushtria jonë e lavdishme u bë mburoja e çel-

niktë e popullit, u bë kampionja e çlirimtë të atdheut. Nga revolucioni i madh popullor lindi ushtria e popullit e pajisur me të gjitha virtytet që bëjnë lavdinë dhe pavardekshmërinë e popullit tonë. Dinamizmi, vitaliteti, vetëmohimi, heroizmi, shpirti përparimtar dhe zelli i patreguar për ndërtimin e jetës së re të lumtur që shihen në popullin tonë, shihen dhe te Ushtria jonë Kombëtare. Ushtri dhe popull janë një dhe të pandarë. Kjo është garancia më e madhe për mbrojtjen e fitoreve që korrëm e që na kushtuan kaq gjak. Kjo është garancia e padiskutueshme për ndërtimin dhe lulëzimin e vendit tonë. Ushtria jonë Kombëtare, që e kish kuptuar aq mirë misionin e saj në kohën e luftës dhe që e përmbushi me krenari, edhe tani në kohën e paqes, në kohën e rindërtimit, ajo e ka kuptuar misionin e saj dhe do ta përmbushë me nder. Dita-ditës ne shohim ushtrinë tonë të pararojës, të modernizohet, të forcohet, të bëhet shembull dhe model për dashurinë ndaj atdheut dhe popullit, shembull dhe model disipline në detyrë e në punë, shembull sakifice, vetëmohimi dhe pjekurie politike. Dhe pikërisht përkëto virtyte të larta që e shquajnë ushtrinë tonë, populli e ka rrethuar këtë me një dashuri të thellë, të ngrohtë, ashtu siç mund të jetë dashuria e një populli për pjellën e tij më të lavdishme, që e lindi dhe e farkötoi me kaq vuajtje e mundime në zjarrin e rreptë të betejave.

Shqipëria e re që është rezultati i Luftës sonë nacional-çlirimtare po ecën me hapa të sigurta në traditat e lavdishme të kësaj lufte. Shporrëm okupatorët nga vendi ynë; këputëm përgjithmonë zinxhirët e robërisë mesjetare të bejlerëve feudalë, të gjakpirësve të popullit; mposhtëm dhe likuiduam tradhëtarët, të shiturit e

përhershëm te i huaji, ata që Shqipërinë dhe popullin e kishin bërë plaçkë tregu; fajdexhijtë e spekulatorët i bëmë të vjellin çka i kishin grabitur popullit. Po punohet dhe po rindërtohet në vendin tonë dhe masat e gjera punonjëse të popullit, konshiente të rolit të madh dhe vendimtar që luajnë në regjimin e sotëm popullor, i janë përveshur punës për forcimin dhe modernizimin e pushtetit, për përkrahjen e paçmueshme që duhet t'i japin pushtetit në kryerjen e program-punimeve të tij. Populli shqiptar i organizuar merr pjesë aktivisht në rindërtimin e Shqipërisë, në jetën politike dhe kulturale të vendit. Populli ynë, që lufta e tij e nxori në planin e parë, u bë faktori vendimtar i jetës së këtij vendi. Populli shqiptar, që ka frenat e vetëqeverimit në dorë dhe që është i vendosur të mos i lëshojë kurrë, e sheh qartë të ardhmen e tij dhe përpinqet e punon me gjithë shpirt për ta ndërtuar sa më të mirë dhe sa më të lumtur.

Lufta jonë e përgjakshme kundër fashizmit, vendosja e demokracisë në vendin tonë dhe përpjekjet e mëdha ndërtimtare që zhvillohen me një ritëm të çuditshëm, kanë ngritur prestigjin tonë dhe kanë forcuar dashurinë e shëndoshë që ushqejnë për ne miqtë e singertë dhe besnikë të Shqipërisë së vogël. Ata na mbrojnë me vendosmëri të madhe, ata luftojnë në lëmin ndërkombëtar për të drejtat tona dhe të të gjithë popujve të tjerë të vegjël, që klikat reaksionare ndërkombëtare kërkijnë t'i marrin nëpër këmbë dhe t'i skllavërojnë.

Populli shqiptar në ditët më të këqia i njoihu miqtë e ngushtë dhe të singertë që e ndihmuani pa kursim në luftë dhe që po e ndihmojnë edhe në paqe.

Shokë invalidë,

Ju jeni mbledhur sot për të hedhur themelet e organizatës suaj, me qëllim që të ndihmoni pushtetin sa më mirë, me qëllim që të jeni deri në fund në shërbim të popullit, që e doni aq shumë dhe për të cilin u hodhët në zjarrin e luftës pa kursyer jetën tuaj. Shqipëria ju është mirënjojëse, ju jeni dëshmia e sakrificave të saja, e vuajtjeve, e dhimbjeve, por njëkohësisht jeni shembull i krenarisë, i guximit, i shpirtit përparimtar të popullit tonë. Ju jeni në vendin e nderit dhe keni respektin e gjithë popullit. Pushteti dhe populli ka kurdoherë nevojë për ndihmën tuaj të çmueshme dhe qeveria e Republikës do të vërë gjithë fuqitë për t'jua lehtësuar dhimjet, për t'jua përmirësuar jetesën, për t'ju bërë të aftë të jetoni më mirë, të ndihmoni sa më shumë në ngritjen e Shqipërisë së re për të cilën ju sakrifikuat kaq shumë. Ju meritoni më tepër se kushdo tjetër kujdesin e veçantë të pushtetit dhe të jeni të sigurtë se ky nuk do t'ju mungojë.

Të rrojë Shqipëria jonë e dashur!

Të rrojë populli ynë heroik!

Të rrojë ushtria jonë e lavdishme!

Rrofshin invalidët tanë heroikë të Luftës nacional-çlirimtare!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 476,
11 korrik 1946*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 476,
11 korrik 1946*

RELACION MBI PROJEKTLIGJIN E PËRGJITHSHËM TË KËSHILLAVE POPULLORE, MBAJTUR NË SEANCËN V TË KUVENDIT POPULLOR

5 gusht 1946

Shokë deputetë,

Pas Statutit Themeltar të Republikës Popullore të Shqipërisë, projektligji mbi këshillat popullore është padyshim ai më i rëndësishmi dhe më kryesori ndër ligjet që ka aprovuar deri tani Kuvendi Popullor. Rëndësia e këtij projektligji qëndron në faktin se ai përmban mjetet dhe rrugët e përforcimit dhe të zhvillimit të plotë të këshillave popullore, të cilat janë bazat dhe organet e pushtetit shtetëror.

Krijimin dhe zhvillimin e këshillave popullore, si baza politike dhe organe të pushtetit shtetëror, do t'i gjejmë gjatë periudhës së lavdishme të Luftës nacional-çlirimtare të popullit tonë kundër okupatorëve fashistë dhe klikave tradhëtare të vendit. I gjithë aparati i këshillave popullore, që nga këshilli lokal më i vogël dhe deri te Kuvendi Popullor i Republikës Popullore të Shqipërisë janë fitore kryesore të Luftës nacional-çlirimtare. Populli shqiptar, që rroku armët për të hedhur

poshtë zgjedhën e robërisë fashiste italiane dhe gjermane, organizoi njëkohësisht këshillat nacional-çlirimtare të masave të gjera si organe politike dhe ndihmëse të luftës së tij. Këshillat nacional-çlirimtare zëvendësuan që në fillim organet shtetërore të pushtetit të vjetër kuisling dhe tradhëtar, i cili që në ditët e para të okupacionit u vu i téri në shërbim të armikut. Populli, me kryengritjen e tij, e shkatërrroi pushtetin e vjetër dhe mbi gërmadhat e tij ngriti pushtetin e ri të këshillave nacional-çlirimtare. Këto organe lindën në zjarrin e luftës, nga vullneti i masave të popullit punëtor për të përballuar konditat që krijoj vetë lufla antifashiste dhe për të marrë populli në duart e veta fatet e tija, vetë-qeverisjen që deri në atë kohë ishin në duart e klikave-tradhëtare, feudale dhe borgjeze që kishin shitur atdheun te i huaji. Këshillat nacional-çlirimtare, pra, të krijuara në këto rrethana, ishin shprehja e gjallë e vullnetit të popullit tonë dhe të aspiratave të tija shekullore për të marrë fuqinë në dorë dhe për të vendosur regjimin populor dhe demokratik të vërtetë. Roli i madh i këshillave nacional-çlirimtare gjatë gjithë periudhës së luftës ka qenë i lavdishëm; ato ishin organet e mobilizimit të përgjithshëm të popullit në luftë, ato ishin ndihmëset e paçmueshme të luftës, ato ishin organet politike dhe bazat e pushtetit të ri të të gjitha zonave të çliruara nga pushtimi i armikut. Kongresi i Përmetit me vendimet e tij historike përforcoi themellet politiko-juridike të këshillave nacional-çlirimtare. Nën drejtimin e Këshillit të Përgjithshëm Antifashist të Shqipërisë dhe në saje të fitoreve të shkëlqyera të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare-rrjeti i pushtetit populor u zgjerua pa masë si në Shqi-

përinë e Jugut, ashtu dhe në atë të Veriut. Përsa i përket funksionimit dhe përmirësimit të pushtetit popullor u arritën rezultate të kënaqshme. Pas çlirimtës së Shqipërisë e deri në aprovimin e Statutit prej Asamblesë Kushtetuese, Qeveria Demokratike e Shqipërisë ndërmori një punë të madhe në ndërtimin sa më të mirë të këtij pushteti, si dhe në përmirësimin e administratës shtetërore. Me çlirimtin e Shqipërisë, përpara këshillave nacional-çlirimtare që morën emrin këshilla popullore, viheshin detyra të reja të shumta, më të rëndësishme dhe më të zorshme, në lidhje me situatat që solli çlirim i plotë i Shqipërisë. Problemet shtetërore dhe nevojat e popullit, që doli nga një luftë kaq e ashpër dhe kaq shkatërrimtare, ishin të rëndësishme dhe kërkonin një zgjidhje të shpejtë dhe të drejtë. Për këtë arësyen duhej patjetër që Qeveria Demokratike e Shqipërisë të përqëndronte fuqitë në përmirësimin e administratës së shtetit dhe në ngritjen e kësaj administratës në shumë krahina, ku pushteti popullor ishte akoma në format e thjeshta të kohës së luftës. Eksperienca e fituar dita-ditës bëri që kjo administratë në gjirin e këshillave popullore të ndërtohet dhe të përmirësohet mjaft mirë dhe problemet e rëndësishme me një karakter urgjent dhe vital për popullin tonë dhe për vetë jetën e shtetit tonë të gjejnë zgjidhje të drejtë dhe të kënaqshme.

Në Statutin Themeltar të aprovuar prej Asamblesë Kushtetuese të Shqipërisë këshillat popullore u përcak-tuan në formë të prerë dhe definitive si bazë e si organe të pushtetit shtetëror, u vunë kësisoj bazat e krejt pushtetit dhe të administratës shtetërore. Si rrjedhim i këtij vendimi të madh, që e përcakton qartë Statuti i

shtetit tonë, është e domosdoshme aprovimi i këtij projektligji të këshillave popullore që qeveria e Republikës ka nderin t'ja paraqesë Kuvendit Popullor. Ky projektligj legalizon sistemin dhe organizimin e këshillave dhe lejon zhvillimin në të gjitha format organizative në të ardhmen. Përveç kësaj, projektligji mbi këshillat popullore është i një rëndësie të dorës së parë, sepse përcakton marrëdhënjet ndërmjet pushtetit shtetëror dhe administratës shtetërore. Është e domosdoshme që këto marrëdhënje, si dhe marrëdhënjet e këshillave popullore me organet supreme të pushtetit shtetëror dhe të administratës shtetërore, të krijojen në një bazë të fortë juridike. Pa këtë bazë puna nuk mund të ecë përpara, por do të pengohet orë e çast, gjë që nuk do të lejojë zhvillimin e organizimit tonë shtetëror dhe zbatimin e mëtejshëm të Statutit si dhe preqatitjen e konditave të plota dhe të domosdoshme për zhvillimin e këshillave popullore si organe lokale të pushtetit shtetëror.

Projektligji mbi këshillat popullore ndahet në gjashë pjesë. Në pjesën e parë bëhet fjalë mbi parimet themelore të këshillave që mbështeten në mënyrën më të zhvilluar në konceptet e caktuara në Statutin Themeltar të shtetit tonë.

Një nga parimet kryesore është ky: «Këshillat popullore janë organe të pushtetit popullor, me anën e të cilave populli ushtron pushtetin e tij në njësitë administrative lokale».

Ky parim vë mirë në dukje karakterin demokratik të këshillave popullore. Ai është baza themelore e vetë-qeverisjes. Statuti me nenin e dytë ka vënë bazat juridike të organizimit të shtetit tonë të ri.

Këshillat popullore që lindën në Luftën nacional-çlirimtare kundër fashizmit dhe reaksionit, janë organe përfaqësuese të pushtetit shtetëror, me anën e të cilave populli ushtron pushtetin e tij. Këshillat popullore, si organe më të larta të pushtetit shtetëror në rrëthim e tyre, kryejnë detyra me rëndësi lokale. Por këto këshilla kanë edhe një detyrë tjetër po me aq rëndësi; të realizojnë detyrat me karakter të përgjithshëm. Kjo siguron unitetin në pushtetin tonë popullor.

Nga ana tjetër ngritja e këshillave popullore nga organe të pushtetit shtetëror në njësitet administrative lokale, në organe të pushtetit në përgjithësi, është rezultati logjik i pajtimit të parimit të vetëqeverisjes dhe të centralizmit demokratik.

Këshillat popullore, të zgjedhur me votim të përgjithshëm, të barabartë, direkt dhe të fshehtë, ushtrojnë pushtetin e tyre dhe japid vendime me karakter të përgjithshëm e në konformitet me Statutin, me ligjet dhe me urdhëresat e organeve më të larta të pushtetit shtetëror dhe të administratës shtetërore. Këto dispozita do të jenë udhëheqja e këtyre organeve në zgjidhjen e problemeve lokale.

Ligji cakton kriterin e shëndoshë të lidhjeve që duhet të ekzistojnë midis organeve të pushtetit shtetëror që nga këshilli i lokalitetit dhe deri në Kuvendin Popullor.

Neni 7 shprehimisht thotë: «Lidhjet në mes të këshillave popullore si edhe në mes të këshillave popullore dhe organeve të tjera shtetërore, mbështeten në të drejtat dhe në detyrat e caktuara me ligj dhe me dispozita të tjera të përgjithshme».

Këto lidhje, të bazuara në të drejta dhe në detyra

të caktuara me ligj, tregojnë qartë se jemi larg çdo burokratizmi që është një pengesë e madhe në mbarëvajtjen e punës dhe dëmon ton rëndë interesat e shumicës.

Detyrat e këshillave popullore nuk kufizohen në zbatimin e thjeshtë të këtyre vendimeve dhe urdhëresave të organeve të larta. Një gjë e tillë është në kundërshtim me karakterin demokratik të pushtetit popullor si edhe me parimin e nenit 7.

«Këshillat popullore kanë të drejtë të shqyrtojnë të gjitha çështjet që janë në kompetencën e organeve më të larta të pushtetit shtetëror dhe të bëjnë propozimet e tyre në lidhje me këto çështje» (neni 6).

Nga përbajtja e këtij nenit kuptohet se këshillat popullore më të ulëta kanë njëlloj kontrolli dhe të drejtën e iniciativës. Këtë e kërkon interes i përgjithshëm, pse kështu ato mund të ndihmojnë efektivisht organet e larta.

Projektligji kërkon të sigurohen lidhjet e ngushta dhe të paprera në mes organeve të pushtetit shtetëror dhe masave të gjera të popullit, në mes të këtij pushteti dhe organizatave të ndryshme punëtore. Masat e gjera punonjëse, fshatarët dhe punëtorët u ngritën dhe lufthan kundër forcave invaduese dhe bashkëpunëtorëve të tyre, ata luftuan kundër kthimit të regjimeve tiranike të së kaluarës dhe aparatit të tyre shtypës që hyri menjëherë në shërbimin e të huajve. Populli luftoi dhe përbysi format e vjetra të qeverisjes dhe me gjakun e bijve të tij më të mirë ngriti një sistem të ri qeverisjeje. Ai me kryengritjen e tij popullore vendosi pushtetin popullor dhe këshillat popullore. Prandaj ai ka të drejtë të marrë pjesë sa më gjerë në pushtet. Këto

këshilla me pjesëmarrjen e popullit u bënë organë të forta të luftës dhe sot në periudhën e rindërtimit po bëhen organë pune dhe paqeje.

Pjesëmarrja e popullit, e shfaqur dhe e konsakruar në mënyrë të ndryshme, është një fitore e kryengritjes popullore. Populli zgjedh dhe zgjidhet në të gjitha organet e pushtetit popullor; populli është mbështetja e këtyre organeve në plotësimin e detyrave të tyre.

Projektligji cakton në vija të përgjithshme ndarjen administrative dhe këshillin që ka çdonjëra nga këto ndarje. Kemi këshilla popullore në fshat, në qytet, në komune, në nënprefektura dhe në prefektura¹.

Një nga ndryshimet me rëndësi në ndarjen e re, në krahasim me atë të mëparshmen, është krijimi i komuneve. Përhapja e fshatrave tona dhe largësia e madhe ndërmjet fshatit dhe nënprefekturës krijon një boshillëk në aparatin tonë administrativ. Për të forcuar aparatin shtetëror dhe për t'u ardhur në ndihmë më direkt nevojave të popullit, u pa e nevojshme krijimi i komuneve. Kjo parashikohet edhe prej Statutit.

Në vargun e gjatë të parimeve themelore rreshtohet dhe e drejta e këshillave popullore si persona juridikë që administrojnë pasurinë e përbashkët të popullit me rëndësi lokale në bazë të planit të tyre ekonomik dhe në bazë të dispozitave dhe të udhëzimeve të përgjithshme të organeve më të larta shtetërore. Administrimi i kësaj pasurie do të jetë një nga burimet e të ardhurave të buxhetit të tyre.

¹ Në këtë kohë ruhej ende ndarja e vjetër administrative: komunë, nënprefekturë, prefekturë.

Parimi i vetëqeverisjes do të mbetej pa aplikim praktik, në rast se këshillat popullore nuk do të kishin financat dhe buxhetin e tyre lokal. Kjo është një e drejtë dhe një nevojë e këshillave popullore që lidhet me detyrat e këshillave për ngritjen e nivelit ekonomik dhe kultural të vendit.

Caktimi i pasurisë së përbashkët të popullit nën administrimin e këshillave popullore nuk shkakton dallim midis pasurisë lokale dhe shtetërore. Kjo pasuri është në duart e popullit dhe këshillat popullore e ministrojnë në bazë të ligjit. Me vendim të Presidiumit të Kuvendit Popullor do të caktohet se cila pasuri e përbashkët e popullit do të vihet në administrimin e këshillave popullore të prefekturave, nënprefekturave, komuneve dhe lokaliteteve¹.

Pjesa e parë e projektligjit përfundon me konsakrimin e parimit të bashkëpunimit dhe të ndihmës midis këshillave popullore.

Pjesa e dytë e projektligjit ka një rëndësi të veçantë. Ajo zgjidh një nga problemet më delikate në organizimin e shtetit tonë: problemin e kompetencës. Të dy vjetët e kaluara ishin për ne një periudhë studimi dhe një etapë prove praktike për të gjitha organet e pushtetit. Ndryshimet në strukturën e këshillave dhe në fushën e kompetencave janë rezultati i dy vjetve eksperiencë.

Cila është karakteristika e ligjit tonë ose më mirë

¹ Në ligjin «Mbi këshillat popullore» të dt. 8 gusht 1946 me fjalën lokalitet tregohet një njësi administrative bazë, si fshat ose qytet i vogël.

e organizimët tonë shtetëror përsa i përket kompetencës së këshillave popullore? Detyrat dhe kompetencat e këshillave popullore caktohen me ligj. Organi më i lartë nuk mund të ngushtojë rrethin e kompetencës së këshillave popullore më të ulëta, as t'u heqë një të drejtë që jua ka njohur ligji. Vetëm me një akt legjislativ të dalë nga Kuvendi Popullor mund të bëhen ndryshime mbi kompetencën e këshillave popullore.

Neni 23 i projektit numëron një nga një detyrat e përbashkëta të këshillave popullore. Në krye të këtyre detyrave qëndron nxitja dhe organizimi i pjesëmarrjes direkte të masave popullore në administratën shtetërore si dhe zbatimi i politikës së bashkimit dhe të vëllazërimit të popullit. Këshillat nacional-çlirimtare gjatë luftës kanë luajtur një rol të madh në bashkimin e popullit. Ky bashkim u bë një faktor deciziv në triumfin e kauzës së çlirimit. Populli shqiptar, dikur i përqarë prej politikës së klikave sunduese, në Luftën nac.-çl. u bashkua dhe u vëllazërua. Në Shqipërinë e re bashkimi i popullit është bërë një realitet; ky është një nga forcat e mëdha të pushtetit popullor. Sot nuk ka privilegje dhe dallime për shkak origjine, pozite, pasurie dhe shkallë kulture. Dhe neni 23 vazhdon: «Këshillat popullore kanë për detyrë të zbatojnë politikën e bashkimit të popullit punëtor të qytetit dhe të fshatit, të ngrenë nivelin kulturnal të masave, të ndihmojnë popullin punëtor që të bashkohet dhe të mbrohet kundër shfrytëzimit ekonomik», etj. Përveç detyrave të përbashkëta këshillat popullore kanë detyra të veçanta. Kemi detyrat e këshillave popullore të lokalitetit, të komunës, të nënprefekturës dhe të prefekturës. Këto detyra kanë lidhje me

planin, me bujqësinë, me tregëtinë dhe zejtarinë, me financat, me raportet në punë, me arësimin, me shëndetin e popullit dhe me sektorët e tjera të aktivitetit shtetëror. Rrethi i kompetencave të këshillave popullore nuk është i njëjtë. Ato të këshillave më të larta janë më të gjera.

Organizimi i këshillave popullore përbën pjesën e tretë të projektligjit. Numri i anëtarëve të këshillave popullore caktohet me vendim të Presidiumit të Kuventit Popullor, por ligji cakton minimumin dhe maksimumin e anëtarëve që duhet të ketë çdo këshill. Rëndësia e raporteve ekonomike dhe kulturale, numri i banorëve dhe rrethana të tjera janë kritere për të caktuar numrin e anëtarëve të këshillave popullore. Ligji për zgjedhjen e këshillave popullore konsakron parimin e ndarjes në rrethe elektorale. Për çdo rreth elektoral zgjidhet një anëtar këshilli. Kjo është e nevojshme për ushtrimin e së drejtës së revokimit nga ana e zgjedhësve. Këshillat popullore ushtrojnë të drejtat e tyre ose direkt në mbledhjen e të gjithë anëtarëve të këshillit ose me anën e komiteteve të tyre ekzekutive. Funksionet ekzekutive dhe gjyqësore ushtrohen prej komiteteve ekzekutive. Detyrat që janë në kompetencën ekskluzive të këshillave popullore janë këto: zgjedhja dhe shkarkimi i anëtarëve të komitetit ekzekutiv, shpërndarja e këshillave popullore më të ulëta dhe të komiteteve ekzekutive të tyre, caktimi i zgjedhjeve për këshillat më të ulëta, përpilimi i planit ekonomik dhe i buxhetit, kontraktimi i huarave, krijimi i ndërmarrjeve dhe i instituteve, hartimi i rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të këshillave popullore, marrja e vendimeve, caktimi i taksave lokale, anulimi, pezullimi ose ndryshimi i vendi-

meve të këshillave popullore më të ulëta dhe zgjedhja ose shkarkimi i gjyqtarëve dhe i ndihmësgjyqtarëve.

Në bazë të parimeve të Statutit, këtij ligji themelor, në njësitë administrative lokale, të vetmet organe të pushtetit popullor janë këshillat popullore. Ligji në një kohë cakton edhe çështjet që janë në kompetencat eksklusive të komiteteve ekzekutive në lidhje, natyrisht, me seksionet dhe zyrat që mund të krijohen në gjirin e këshillave popullore. Komitetet ekzekutive nuk mund t'u ngarkojnë seksioneve ose zyrave këto punë: nxjerrjen e urdhëresave, përpilimin e buxhetit dhe të planit ekonomik, lidhjen e marrëveshjeve dhe të obligimeve, aprovin e shpenzimeve të jashtzakonshme dhe punë të tjera që përmenden në nenin 57. Ligji në caktimin e kompetencave eksklusive të këshillave popullore dhe të komiteteve ekzekutive ka pasur për kriter rëndësinë e natyrës së çështjeve si dhe parimin që këshillat popullore janë organet më të larta në njësitë administrative lokale.

Para se të caktohen detyrat e komiteteve ekzekutive, neni 56 i ligjit thotë: «Komiteti ekzekutiv kryen si tërësi të gjitha detyrat dhe punët që i janë lënë në kompetencën e tij si organ ekzekutiv dhe administrativ dhe udhëheq bashkarisht të gjitha degët e administratës shtetërore».

Komititetek ekzekutive udhëheqin administratën shtetërore si organe kolektive. Kjo garanton karakterin demokratik të pushtetit popullor.

Në gjirin e këshillave popullore, me përjashtim të këshillave popullore të lokaliteteve, mund të krijohen seksione ose zyra të drejtuara nga anëtarët e komitetit ekzekutiv. Këto seksione ose zyra janë për ekonomi, për

bujqësi e pyje, për financë, për punë botore, për arësim, për kujdesin shoqëror dhe për shëndetin e popullit. Krijimi i këtyre seksioneve ose zyrave pranë këshillave popullore varet nga rëndësia e punës së këtyre këshillave. Seksionet dhe zyrat do të krijohen aty ku shihet e nevojshme dhe aq sa është e nevojshme.

Lidhjet e këshillave popullore dhe të komiteteve ekzekutive me organet më të larta të pushtetit shtetëror dhe të administratës shtetërore përbëjnë përbajtjen e pjesës së katërt të projektligjit të paraqitur për aprovim. Këshillat popullore, si u përmend shumë herë më parë, janë organe vetëqeverisjeje në njësitet administrative lokale dhe vaprojnë në bazë të Statutit dhe të ligjeve. Me këtë cilësi këshillat popullore kanë për detyrë të zgjidhin çështje të rrethit të tyre dhe t'u vijnë në ndihmë interesave dhe nevojave lokale. Por këshillat popullore nö një kohë janë organe të pushtetit në përgjithësi me detyra, që të bëhen një mbështetje e fortë në zgjidhjen e problemeve me rëndësi të përditshme.

Duke parë këshillat popullore me këtë prizëm, ato nuk mund dhe nuk duhet të sjellin një përcarje në unitetin e pushtetit dhe të ngrihen në organe autonome të shkëputura nga organet më të larta. Për këtë arësy Statuti dhe ky ligj u njeh të drejtën dhe detyrën organeve më të larta të pushtetit shtetëror që të ndihmojnë dhe të kontrollojnë punën e këshillave popullore më të ulëta. Edhe organet e administratës shtetërore, qeveria dhe komitetet ekzekutive kanë për detyrë të ndihmojnë dhe të kontrollojnë veprimtarinë e komiteteve ekzekutive inferiore.

Ndihma qëndron në dhënjen e direktivave të për-

gjithshme dhe në caktimin e politikës administrative, kontrolli në zbatimin e detyrave të tyre në konformitet me Statutin, me ligjet dhe me vendimet me karakter të përgjithshëm të organeve eprore.

Parimi i centralizmit demokratik imponon nevojën e lidhjeve të ngushta në mes të organeve të pushtetit dhe të administratës shtetërore dhe një kontroll të fortë dhe të fryshtës.

Sipas nenit 67 të projektligjit, Presidiumi i Kuvendit Popullor dhe këshillat popullore më të larta kanë të drejtë të anulojnë, të pezullojnë ose të ndryshojnë vendime, urdhëresa dhe udhëzime të kundërligjshme dhe të parregullta të këshillave popullore më të ulëta, ndërsa qeveria dhe komitetet ekzekutive mund të ndalojnë vetëm zbatimin e këtyre akteve.

Ky projektligj është një hap i madh përpëra në përpunimin e Statutit tonë dhe në ndërtimin e aparatit tonë shtetëror si dhe në forcimin e pushtetit të ri me të vërtetë demokratik të Republikës sonë Popullore.

Ky projektligj përfaqëson ligjshmërinë e plotë të një pushteti të ri në formë dhe në esencë demokratik ndër të gjitha shkallët e organizimit tonë shtetëror.

Duke qenë i bindur se një projektligj i tillë u përgjigjet nevojave të stabilizimit dhe të zhvillimit të organizatës sonë shtetërore dhe u përgjigjet interesave dhe dëshirave të popullit tonë, i propozoj Kuventit që këtë projektligj ta diskutojë dhe ta aprovojë.

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 499,*

6 gusht 1946

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 499,*

6 gusht 1946



FJALA E MBAJTUR NE KUVENDIN POPULLOR ME RASTIN E EMERIMIT SI KRYETAR I DELEGACIONIT SHQIPTAR NE KONFERENCEN E PAQES

17 gusht 1946

Shokë deputetë,

Në lidhje me Konferencën e Paqes, në të cilën vendi ynë është thirrur të shfaqë pikëpamjet e tija si në mbledhjet plenare dhe në komisionet ku hartohet Traktati i Paqes me Italinë, qeveria jonë caktoi dhe dërgoi delegacionin shqiptar të kryesuar provizorisht nga deputeti shoku Hysni Kapo. Qeveria duke marrë parasysh rëndësinë e çështjes vendosi që të shkoj unë atje dhe të marr kryesinë e delegacionit për të shfaqur pikëpamjet e qeverisë shqiptare. Duke kërkuar leje për mungesën që do të bëj në punimet e Kuvendit, ju siguroj se shokët dhe unë do ta paraqesim si duhet pikëpamjen e Shqipërisë, për t'i treguar botës përparimtare dhe aleatëve se populli shqiptar, ashtu si ka derdhur gjak për të mposhtur fashizmin, ashtu do të jetë në radhë të parë për mbrojtjen e paqes në Ballkan dhe në botë.

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 510,
18 gusht 1946*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 510,
18 gusht 1946*

FJALIM I MBAJTUR NË SEANCËN PLENARE TË KONFERENCES SË PAQES NË PARIS

21 gusht 1946

Zoti Kryetar,

Zoterinj delegatë,

Në emër të popullit shqiptar dhe të qeverisë së tij, përshëndes Konferencën e Parisit, duke i uruar suksës të plotë në punën e saj fisnike.

E ndjej për detyrë të përshëndes gjithashtu qeverinë frëngje dhe popullin heroik francez dhe ta falenderoj për mikpritjen e tij tradicionale.

Pas kësaj lufte të egër dhe të pashebullt në histori, gjatë së cilës popujt e qytetëruar, të kërcënuar në ekzistencën e vet nga nazizmi gjerman dhe fashizmi italian, u hodhën në përleshjen e tmerrshme me parullën e vetme: «të fitojmë o të vdesim», ne, ja, arritëm në këtë konferencë të lartë që duhet të ndërtojë një paqe të qëndrueshme, të dëshiruar kaq tepër. Popujt e qytetëruar bënë një luftë çlirimtare dhe tanë presin me ankth që kjo paqe të ndërtohet në bazë të parimeve dhe idealeve, për të cilat miliona njerëz dhanë jetën që t'i sigu-

rojnë njerëzimit ditë më të mira dhe një drejtësi të vërtetë.

Konferenca e Parisit është mbledhur për të vendosur traktatet e paqes me vendet ish-aleatë dhe satelitë të Gjermanisë dhe t'i japë fund agresionit duke siguruar marrëdhënje të shëndosha midis popujve paqedashës që kanë etje për lirinë, drejtësinë dhe demokracinë.

Për këtë qëllim u thirr edhe Shqipëria që të parashtrojë pikëpamjet e veta për Traktatin e Paqes me Italinë. Megjithatë, Shqipëria e quan të padrejtë vendimin për të mos ta ftuar atë si pjesëtare të Konferencës. Populli shqiptar që rröku i pari armët kundër fashistëve italianë, të cilët rendnin me urë në dorë për t'i vënë zjarrin Evropës dhe që e pushoi luftën vetëm kur u mposht Gjermania hitleriane, meritonte një drejtësi më të madhe.

Populli shqiptar, besnik i traditave luftarake përliri e pavarësi dhe besnik gjer në fund ndaj çështjes aleate, që prej 7 prillit të vitit 1939 e gjer në ditën e fitores, nuk ju shmang asnje sakrifice. Shqipëria dha pa kursim një kontribut të madh gjaku për çështjen e përbashkët: ajo e kish fituar me luftë të drejtën të marrë pjesë në këtë konferencë, me titull dhe me të drejta të njëjta me ato të njëzetënë kombeve fitimtare.

Populli i vogël shqiptar, i vetëm dhe pa mbrojtje, ka qenë viktima e parë e agresionit italian. Italia fashiste e Musolinit, duke sulmuar vendin tonë më 7 prill 1939, kurorëzoi politikën e saj grabitqare dhe ekspansioniste të ndjekur me këmbëngulje gjatë gjysmë shekulli kundër vendit tonë.

Bota e qytetëruar e sjell ndër mend atë të premte

të zezë të vitit 1939, kur 173 anije lufte u vërsulën në limanet tona, 600 aeroplana bombardues përshkuan qie-lin tonë dhe më tepër se 50 000 ushtarë të armatosur gjer në dhëmbë u turrën si ujq mbi popullin tonë të vogël, po trim. Fashistët italianë donin të na robëronin, të na dërmonin, e të na grabitnin përgjithmonë lirinë e pavarësinë tonë dhe të na skllavëronin. Por fashistët e Musolinit s'i kishin bërë hesapet mirë. Populli shqiptar s'është një popull që duron skllavërinë. Historia jonë e dëshmon këtë; malet dhe pyjet tona janë mbushur me oshiëtimat e luftërave heroike të stërgjyshërvë tanë që shekuj me radhë kanë luftuar me tërbim kundër shtypësve.

Dhe në vitin 1939, kur Evropa heshtë, bijtë e vendit tonë binin në fushën e nderit për një çështje të drejtë që pak më vonë do të bëhej çështje e mbarë njerëzimit.

Fashistët italianë mund të na zaponin, por kurre s'do të na dërmonin, ne e kishim koskën të regjur nga mjerimet që kishin pllakosur vendin tonë shekuj me radhë.

Fill të vetëm, përpala një armiku të pamëshirshëm, ne e kemi mbajtur ballin lart në furtunë, ne i shpallëm armikut luftë të ashpër dhe të paprerë. Malet, fushat dhe luginat tona, qytetet dhe fshatrat tanë dëshmojnë për luftërat heroike të popullit tim, që është xheloz për pavarësinë dhe lirinë e vet, dhe që pranon më mirë të vdesë me armë në dorë se sa të përkulë shpinën.

Pesëmbëdhjetë mijë vullnetarë shqiptarë luftuan si heronj në Durrës, Vlorë, Sarandë, Shëngjin, si dhe në thellësi të vendit kundër zaptuesit të urryer. Po ç'mund të bënte ky popull i vogël, pa armë, pa municione, kun-

dër një armiku të tillë? E pra, me gjithëse u okupua ai s'e quajti kurrë veten të mundur. Ne ngjitëm rrugën e vuajtjeve dhe të lavdisë me ballin lart dhe me vullnet të patundur. Ne ishim të sigurt për fitoren, se çështja jonë ishte e drejtë.

Pas ditëve të përgjakshme të prillit, rezistenca vazhdoi dhe u zgjerua, 3 000 burra të armatosur kishin marrë malet, kështjellat e përhershme të popullit tonë. Mbarë populli ishte i ndërgjegjshëm për ndërmarrjen e tij heroike, plot rreziqe dhe sakrifica, por ai ishte i ndërgjegjshëm gjithashtu se në ato beteja vendosej fati i tij, ekzistenca e tij. Përlleshjet e përgjakshme me okupatorin ndiqnin njëra-tjetrën në qytete; njerëzit tanë binin nën plumbat e mitralozave të armiqve, që donin të thyenin kështu rezistencën tonë.

Nga qytetet dhe fshatrat, nga rrugët dhe rrugicat, partizanët shqiptarë vërsuleshin mbi armikun për të sabotuar maqinën e tij luftarake, për të sulmuar rrugët, transportet, urat, për të hedhur në erë depot e municionit, për të goditur dhe për të vrarë spiunët, oficerët, kuislingët. Ishte një luftë e pamëshirshme. Por dhe italianni na e shpaganin me terrorin që mbretëronte në qytete dhe në fshatra. Burgjet ishin mbushur me patriottë; ata varnin me dhjetëra, internonin me mijëra në ishujt e vdekjes: në Lipari, Ventotene¹ dhe gjetkë.

Por gjithë ky terror, këto varje dhe pushkatime ja shtonin edhe më tepër urrejtjen popullit tonë kundër fashistëve italianë dhe e nxitnin për luftë. Kur italianni

¹ Ventotene, ishull i thatë në detin Tirren që përdorej nga fashistët italianë si vend internimi për antifashistët.

sulmuan Greqinë, populli shqiptar me aksione me armë, të guximshme ë të fuqishme i dha një ndihmë të madhe popullit grek, që po pësonte fatin tonë. Ne ishim të lidhur nga e njëjtë fatkeqësi e shkaktuar prej armikut të përbashkët. Në rrugët e Durrësit, të Tiranës, të Gjirokastrës, partizanët shqiptarë sulmonin autokolonat ushtarake italiane që niseshin kundër Greqisë.

Italianët dhe kuislingët shqiptarë, veglat e tyre, e shikonin fare mirë rrezikun që ju turrej, prandaj ata shtonin përpjekjet e tyre dhe terrorin. Malet ishin mbushur me partizanë të organizuar në formacione të rregullta, që atakonin pa pushim. Si raprezalie, qindra fshatra u dogjën, por ne mbronim pëllëmbë për pëllëmbë tokën e çliruar. Italianët u shtrënguan të futen në qytete, pse malet s'u vinin dhe aq pas shëndetit. Nën sundimin italian qeveritë kuislinge binin dhe ndërroheshin çdo dhjetë muaj. Populli shqiptar ua bënte jetën të tmerrshme si atyre, si patronëve që i urdhëronin. Kjo tregonte hendekun e madh që ndante kuislingët nga populli heroik shqiptar.

Pas kapitullimit të Italisë dhe pushtimit të vendit prej trupave gjermane që vinin nga Greqia, populli shqiptar shtrëngoi edhe më tepër radhët e tij, pse e dinte se kish të bënte me një armik tjetër të egër e gjakatar.

Me të hyrë në Shqipëri, gjermanët u sulmuan nga formacionet tona partizane, në rrugën Perat — Korçë. Dhjetëra kamiona u dogjën, qindra gjermanë u vranë. Si raprezalie, gjermanët rrafshuan përtokë fshatin Borovë dhe vranë banorët: gra, pleq, fëmijë. Gjermanët me qëllim që të na asgjësonin shpërthyen kundër nesh dy

ofensiva të mëdha. Katër divizione gjermane, divizione alpine, të regjura në luftime kundër partizanëve, u hodhën kundër nesh. Ndodheshim në mes të dimrit, pa bukë e pa këpucë, po partizanët tanë luftuan trimërisht dhe dolën fitimtarë.

Kur anglo-amerikanët, aleatët tanë, zbarkonin në Francë, ne ishim të zënë në luftime të egra kundër katër divizioneve gjermane. Ne e ndjenim veten kryelartë në përlleshjen e përgjakshme, pse po bënim detyrën tonë kundrejt aleatëve dhe popullit mik francez.

Lufta e popullit shqiptar kundër gjermanëve u kurorëzua me betejën heroike të Tiranës, ku luftuam 19 ditë me radhë, ditë e natë, rrugë më rrugë, shtëpi më shtëpi, duke çliruar çdo pëllëmbë tokë të kryeqytetit tonë, duke sakrifikuar luftëtarët tanë më të mirë, po duke vrarë me mijëra gjermanë. Mbeturinat e forcave gjermane, që donin të çanin rrugë për t'i ardhur në ndihmë garnizonit të tyre të rrethuar në Tiranë, u asgjësuan në Qafën e Kërrabës. Ushtria jonë Nacional-Çlirimtare kish marrë nga Shtabi i Përgjithshëm urdhërin e prerë të mos i linte gjermanët të dilnin nga kufiri shqiptar, por t'i asgjësonte brenda në tokën shqiptare.

Kështu e kuptionim ne aleancën e madhe antifashiste, kështu e kuptionim ne besnikërinë ndaj çështjes aleate. Ndjekja e trupave gjermane jashtë kufive tanë, në tokat jugosllave të Malit të Zi, të Sanxhakut dhe të Hercegovinës është një provë tjetër e shkëlqyer për ata që duan të shikojnë dhe që kanë zemër për të ndjerë se sa të mëdha janë sakrificat e popullit tonë të vogël.

Më se pesë vjet luftoi populli shqiptar kundër okupatorëve fashistë italianë e gjermanë dhe kundër shër-

bëtorëve të tyre shqiptarë. I organizuar në Frontin Nacional-Çlirimtar, ai bëri një luftë të pabarabartë, po vendimtare. Duke përballuar urinë dhe të ftohtit, por i armatosur me guxim dhe besim të patundur në forcat e veta dhe në ato të aleatëve, ai eci përpara pa u tutur, që të çlirohet Shqipëria dhe të shkatërrohet fashizmi.

Shqipëria u bë kështjellë e luftës për liri e demokraci. Lufta jonë çlirimtare u njoh shpejt edhe jashtë. Në dhjetor 1942, zotérinjtë Iden, Hull dhe Mollotov i drejtonin përgëzime popullit shqiptar për rezistencën e tij që i siguronte indipendencën dhe që ndihmonte luftën e përbashkët.

Ushtria Nacional-Çlirimtare, që lindi nga guerrilet e para, e organizuar dhe e forcuar në beteja të ashpra, u bë një ushtri e fortë dhe guximtare. Ajo dërmoi maqinën luftarake të armikut dhe i rrëmbeu armët me të cilat e mundi. Ajo u bëri ballë me sukses ofensivave të mëdha, të organizuara, të italianëve dhe të gjermanëve që kishin qëllim të shkatërronin luftën tonë të çlirimt. Nga këto ofensiva armiku pësoi humbje të ndjeshme, kurse ushtria jonë doli përherë më e fortë dhe më e regjur. Me karakter kryesisht popullor, ajo ishte e pandarë nga populli; ajo ishte shpëtimi i vetëm i tij. Okupatorët fashistë dhe nazistë përdorën terrorin më të zi për të larguar popullin nga lufta e drejtë çlirimtare; me mijëra vetë u vranë ose u varën në qytete dhe në fshatra, lart nga 300 të tjerë u vranë nga mitralozat, mu në mes të ditës në qytetin e Korçës, të Tiranës e të Vlorës, sepse protestuan kundër okupacionit; 10 000 shqiptarë u përplasën në burgjet e Shqipërisë, në fushat e përqëndrimit të Porto Romanos, të Mborjes, të Burrelit, të Kavajës, të

Prishtinës, si dhe në fushat e vdekjes në Gjermani, për shkak të ndjenjave dhe të aktivitetit të tyre antifashist.

Ata u vunë zjarrin dhe gjakosën qytete të tëra, si Leskovikun, Pogradecin, Sarandën, Përmetin dhe krahina të tëra si Mallakastra, Kurveleshi, Peza e Skrapari u rrafshuan për tokë dhe pësuan raprezaliet e egra të ushtarëve fashistë dhe nazistë. Por, megjithkëtë, populli shqiptar me luftë të paprerë dhe me sakrifica të mëdha, vetë me forcat e tija, çlroi gjithë tokën kombëtare.

Shifrat e mëposhtme tregojnë qartë se sa e madhe ka qenë rezistenca jonë në prakun e çlirimtare plotë të Shqipërisë: Ushtria jonë Nacional-Çlirimtare kish në radhët e saj 70 000 luftëtarë, 6 000 prej të cilëve ishin gra. Italia u detyrua të mbajë në Shqipëri kundër forcave të rezistencës lart nga 100 000 dhe Gjermania lart nga 70 000 ushtarë.

Sakrificat e popullit tonë qenë shumë të mëdha. Me një popullsi prej një milion njerëzish, 28 000 të vrarë, 12 600 të plagosur, 10 000 të internuar politikë në Itali dhe në Gjermani, 35 000 të përdorur në punë të detyrueshme; 850 qytete dhe fshatra nga 2 500 që ka Shqipëria, u shkatërruan ose u rrafshuan përtokë; të gjitha komunikacionet, instalimet e limaneve, të miniereve dhe ato elektrike u shkatërruan; pasuritë bujqësore dhe bagëtia u grabiten; gjithë ekonomia kombëtarc u shkatërrua.

Nga ana tjeter, humbjet që pësoi armiku janë këto: 53 639 italianë dhe gjermanë të vrarë, të plagosur ose të zënë rob, afro 100 tanksa dhe autoblinda u shkatërruan, 1 334 topa dhe mortaja, 2 855 mitraloza dhe 1 934 kamiona u shkatërruan ose u kapën, pa llogaritur pushkët,

munitionet dhe depot që u shkatërruan ose u kapën.

Aleatët e kanë çmuar kontributin që dhamë ne përluftën e përbashkët. Në muajin qershor 1943 ata dërguan pranë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare misione ushtarake ndërlidhëse, si dhe ndihma materiale të hedhura me parashutë. Dua të përmend këtu emrat e disa prej krerëve të këtyre misioneve: major Bill Mak Lin, nënkolonel Palmer, gjeneral Deiviz — anglezë, kapiten Thomas Stefan — amerikan, major Ivanov — rus. Dhe prej vitit 1944 një mision ushtarak shqiptar ishte akredituar pranë Kuartierit të Përgjithshëm aleat të Mesdheut në Itali.

Krerët aleatë kanë përshëndetur shumë herë kontributin e popullit tonë për çështjen e përbashkët.

Zoti Uinston Çërçill, në përgjegje të një pyetjeje që ju bë në Dhomën e Komuneve, më 4 nëntor 1943 deklaronte:

«Me mijëra shqiptarë po luftojnë në malet e tyre përlirinë dhe indipendencën e vendit të tyre dhe, sipas raporteve të misionit ushtarak britanik në Shqipëri, ata po bëjnë aksione të shkëlqyera».

Zoti Kordell Hull, me rastin e përvjetorit të festës kombëtare shqiptare, më 28 Nëntor 1943 në një letër që i dërgonte zotit Çarles Hart, ish-ministër i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri dhe president i Shqatës «Miqtë e Shqipërisë» shkruante:

«Qeveria dhe populli i Shteteve të Bashkuara kanë qenë përherë në dijeni të luftës që bëjnë shqiptarët përtë ruajtur integritetin dhe indipendencën e vendit të tyre. Ne e kemi ndjekur me simpati dhe admirim rezistencën e tyre kundër Italisë fashiste, si dhe vendosmërinë e

tyre patriotike për të ruajtur sovranitetin kombëtar. Sot, këta luftëtarë trima po e vazhdojnë luftën kundër armikut nazist si të gjithë ata që e duan lirinë, ashtu dhe ne vetë.

Më 28 Nëntor 1912, shqiptarët shpallën indipendençën e tyre. Në këtë ditë përvjetori ata mund të shpresojnë përmbushjen e plotë të qëllimit të tyre të madh.

Megjithëse shqiptarët nuk kanë përjashta një qeveri, që të shprehë aspiratat e tyre kombëtare, ne shikojmë në vullnetin e tyre kombëtar idetë dhe parimet që na frymëzojnë ne dhe aleatët tanë, si dhe dëshirën që ta vazhdojnë luftën gjer në zhdukjen e plotë të nazizmit».

Pasardhësi i zotit Hull, zoti Eduard Stetinius, më 22 maj 1945 më drejtonte mesazhin që vijon:

«Unë e di mirë luftën e pareshtur që ka bërë populli shqiptar kundër agresorit dhe unë i çmoj plotësisht sakrificat që ai ka bërë për të kryer çlirimin e vendit të tij dhe për të ndihmuar në realizimin e fitores përfundimtare kundër armikut të përbashkët... Dëshiroj t'ju siguroj për simpatinë dhe miqësinë që populli i Shteteve të Bashkuara ndjen për Shqipërinë dhe popullin e saj dhe unë e di se në të ardhmen Shqipëria do t'i sjellë çështjes së paqes po të njëjtin kontribut të shëndoshë që i ka dhënë realizimit të fitores». Dhe komandanti i përgjithshëm i forcave aleate në Mesdhe, Meitlland Uillson, më 12 tetor¹ 1944, më shkruante me këto fjalë:

«Kam vërejtur me admirim përmbushjen e detyrave nga ana e Ushtrisë suaj Nacional-Çlirimtare në përpje-

¹ Në botimet e mëparshme gabimisht është shkruar, 12 nëntor.

kjet e saja të shkëlqyera kundër armikut të përbashkët dhe për qëllimin e njëjtë tonin».

Do të mundja, zotërinj, të tregoja edhe një numër të madh dokumentash që provojnë se sa janë çmuar përpjekjet tona nga ana e aleatëve. Po trimëritë e popullit tonë nuk kanë nevojë për dokumenta. Ato flasin vetë: të 13 gratë amerikane që, për shkak të një avarie të aeroplanit, u detyruan të zbresin në një tokë të pushtuar prej gjermanëve, i kanë shpallur botës mbarë se me sa sakrifica dhe vetëmohim partizanët shqiptarë, duke përbuzur vdekjen e sigurt, i shpëtuan nga thonjtë e gjermanëve. Aviatorët neozelandezë dhe australianë që u shpëtuan prej njerëzve tanë nga predhat gjermane, duke u larguar nga qendra e Shtabit tonë, më shtrënguan dorën duke më thënë:

«Gratë dhe fëmijët tanë do t'jua dinë për të mirë që na shpëtuat jetën».

Por partizanët tanë nuk bënë veçse detyrën e tyre të bashkëluftëtarit dhe të aleatit.

Me qëllim që të shtrembërojnë historinë dhe të mohojnë faktet, që janë të qarta si dielli, bëhen gjithë këto përpjekje për të mos i trajtuar në mënyrë të barabartë ata që trimërisht kanë luftuar për kauzën e përbashkët. Në këtë konferencë të lartë është folur shpeshherë për mbrojtjen e interesave të popujve të vegjël, por në fakt, përsë i përket popullit tonë, është vepruar krejt praptazi. Populli shqiptar, i vogël në numër, por i madh për veprat që ka bërë, duhej të ndodhej tani në këtë konferencë me të njëjtat të drejta me kombet e tjera fituese, të drejta, të cilat i ka paguar shumë shtrenjtë.

Populli shqiptar e ndjen veten të ofenduar që është

vënë në të njëjtën radhë me Austrinë, me atë Austri që nuk ka shtënë asnje pushkë kundër gjermanëve, po përkundrazi ka dërguar njerëzit e saj për të vrarë gratë dhe fëmijët tanë, për të djegur qytetet dhe katundet tonë bashkëpunim me gjermanët.

Askush nuk do të mund të mohonte besnikërinë e popullit shqiptar kundrejt aleatëve dhe kauzës së madhe antifashiste. Të gjithë ata që do të përpiqen të provojnë të kundërtën me argumenta të gënjeshtërtë do të bëhen qesharakë dhe do të pësojnë një disfatë të madhe.

Populli shqiptar paraqitet kryelartë përpara kësaj Konference të Paqes i bindur se e ka plotësuar kryekëput detyrën e tij të aleatit. Shqipëria paraqitet këtu për të kërkuar të drejtat për dëmshpërblime dhe drejtësi kundër Italisë që i vuri flakën dhe e mbyti në gjak, dhe për të diktuar vullnetin e saj të fitimtares, në mënyrë që Italia të mos jetë më një rrezik për paqen e botës dhe për indipendencën e sovranitetin e vendit tim.

Por, para se të parashtroj pikëpamjen e vendit tim mbi këtë çështje, jam i detyruar t'u përgjigjem akuzave të gënjeshtërtë të z. Calderis, kryetar i delegacionit grek, akuzave dhe rivendikimeve që ka formuluar kundër Shqipërisë në seancat e ndryshme të mëparshme të konferencës.

Z. Calderis përpinqet të provojë se Shqipëria nuk është një vend aleat, se Shqipëria ka atakuar Greqinë dhe se kjo është në gjendje lufte me të. Nga ana tjetër, z. Calderis rivendikon Shqipërinë e Jugut duke pretenduar se kjo është një tokë greke dhe se i takon asaj me të drejtë.

Nëse Shqipëria është një vend aleat dhe nëse e ka

merituar plotësisht këtë cilësim, z. Caldaris përgjigjen tonë pér këtë e ka në fjalët që sapo thashë më parë. Populli shqiptar flak poshtë me përbuzje akuzën poshtëruese të delegatit grek, që e padit vendin tim si sulmues. Populli shqiptar nuk e ka sulmuar kurri popullin e ndershëm grek, nuk i ka shpallur kurri luftë. Përkundrazi, e ka simpatizuar kauzën e tij që ishte njëkohësisht dhe kauza e popullit shqiptar, sepse që të dy popujt kishin pësuar të njëjtin fat, duke qenë se kishin të bënин me të njëtin armik.

Populli shqiptar e ka treguar jo vetëm gjatë luftës antifashiste, po edhe gjatë Luftës së parë botërore, se sa i vendosur ishte pér të luftuar imperializmin italian që u kishte vënë synë tokave dhe pasurive tona. Midis popullit shqiptar dhe fashistëve italianë u bë një luftë e tmerrshme dhe e pamëshirshme. Ja pse z. Caldaris nuk do të bindë asnjeri, as budallenjtë bile, me argumentin e tij «të famshëm»; z. Caldaris duhet t'i kërkojë llogari Italisë fashiste pér sulmin e poshtër kundër vendit të tij e jo neve. Le t'i kërkojë llogari kriminelit të luftës Viktor Emanuelit dhe jo popullit shqiptar, që u pushtua prej armiqve të Greqisë vetë dhe që luftonte, si dhe populli grek, me tërbim pér indipendencën dhe sovranitetin e tij.

Do të ishte qesharake të mendohej, se një dekret i thatë i Viktor Emanuelit, mbretit të Italisë, do të mund të ngarkonte me faj popullin shqiptar, i cili luftonte pa mëshirë kundër Italisë që nga dita e parë e pushtimit dhe që atentoi edhe kundër jetës së mbretit vetë gjatë vizitës së vetme që bëri në Shqipëri në maj 1941. Z. Caldaris tregon si argument pér mbrojtjen e tezës së tij

aktin e shpalljes së luftës nga kuislingu shqiptar Vërlaci. Populli shqiptar i futi në të njëjtin thes pushtuesit dhe kuislingët dhe nuk bëri asnje dallim midis tyre. Kuislingët shqiptarë, si gjithë kuislingët e tjerë të Evropës, nuk kishin të bënин aspak me popullin tonë. Ata ishin armiqtë më të fëlliqur të popullit dhe, si të këtillë, i kemi luftuar pa pushim. Kuislingët shqiptarë nuk kanë mundur të grumbullojnë kundër ushtrisë së çlirimt dhe kundër aleatëve veçse disa batalione të dobëta, por populli shqiptar u ngrit si një njeri i vetëm kundër shtypësit dhe kundër tradhiëtarëve. Ja ndryshimi që ekziston midis popullit tonë dhe kuislingëve. A do z. Caldaris të dijë për më tepër se ç'i bëri populli shqiptar këta kuislingë? Ja pra: që të gjithë i zhduku dhe kështu ata i paguan me jetën e tyre krimet që bënë. Dhe nëse do të dijë më gjatë mbi fatin e shokëve të tyre të luftës, që kanë marrë arratinë bashkë me trupat gjermane, le ta dijë se tani këta kriminelë gjenden në hotelet më të mirë të Romës, të këtij qyteti, nga ku u nisen aeroplanat që bombarduan në mënyrë të poshtër gratë dhe fëmijët shqiptarë e grekë.

Do të doja ta pyesja z. Caldaris: përse nuk flet për kuislingët e Evropës që e dëmtuan aq rëndë kauzën aleate dhe posaçërisht për kuislingët të cilët, pas krimeve të tyre të shëmtuara, shëtitin lirish? Përse z. Caldaris nuk guxon të përzgjedh kuislingët e tjerë të Evropës me popujt e tyre respektivë?

Dua të përmend se gjatë luftës italo-greke disa qindra ushtarë shqiptarë, të mbledhur me forcë prej italianëve, u ngritën kundër këtyre në kauzë të përbashkët me popullin grek; një pjesë dezertoi dhe u hodh nga

ana e ushtarëve grekë për të luftuar bashkë me ta, por këta i trajtuan si robër lufte dhe i dërguan në Gjirit, ku gjatë zbarkimit gjerman, luftuan trimërisht përkrah ushtarëve britanikë. Një pjesë tjetër u bashkua me partizanët shqiptarë, të tjerët u çarmatosën prej italianëve, u tërroqën nga fronti, u mbyllën në fushën e përqëndrimit të Shijakut dhe ju dërguan gjykatës ushtarake për «tradhëti të lartë».

Mbi këtë ngjarje agjencia «Rojter» më 22.XII.1940 transmetonte këtë lajm nga Manastiri:

«Ushtarë shqiptarë të mobilizuar me forcë në ushtrinë italiane kanë ngritur krye dje në një sektor të prapavijave italiane dhe i kanë shkaktuar armikut humbje të rënda derisa u kapën. Një pjesë e tyre ka marrë përpjetë brigjeve, ku vazhdon të rezistojë».

Më 4.XII.1940 agjencia «Anatoli» lajmëronte nga Athina se «një gjeneral italian, i kapur rob prej grekëve, ka deklaruar se ushtria italiane po pëson humbje të rënda nga shkaku i tradhëtisë së shqiptarëve».

Edhe Musolini vetë, në një letër dërguar Hitlerit më 22 nëntor 1940, donte t'i justifikonte po në këtë mënyrë humbjet.

Dhe ja, se ç'thotë Badoljo në kujtimet e tij:

«Fushata fillon, pra. Gjithë bota e di zhvillimin e saj. Trupat greke në Epir qëndrojnë trimërisht mbi Kalamas, kurse bandat dhe trupat shqiptare, që bënin pjesë në divizonet tona, ose na tradhëtuan duke bërë sabotazhe ose u hodhën te grekët».

Gazeta «Figaro», Nr. 588, 4 korrik 1946, duke bërë fjalë për luftën italo-greke shkruante:

«Çetat shqiptare nga ana e tyre sulmonin autoko-

lonat dhe trupat italiane në rrugët që çonin në front».

Ndërsa radio Londra më 26.X.1940 transmetonte:

«Mësohet nga Shqipëria se çeta shqiptare në veprim të prapavijave italiane presin dhe sabotojnë vijat e komunikacionit, duke u futur tmerrin reparteve italiane të izoluara.

Grupe të armatosurish kanë mundur të hyjnë në kryeqytet dhe kanë afishuar mbi të gjitha godinat qeveritare e deri edhe në pallatin e qeverisë italiane proklamata, me të cilat i ftojnë italianët të zbrazin Shqipërinë».

Gjithashtu më 4.I.1941 — A.A.(BBC) transmetonte:

«Në rrethet ushtarake vihet re se shqiptarët u sjeillin ndihmë të madhe grekërve kundër italianëve».

Por krahas akuzave të gënjeshtërtë kundër popullit shqiptar z. Caldaris duhet të dijë të na sqarojë këtu edhe këto pyetje:

— A i konsideron agresorë, sikundër e bën Shqipërinë — edhe popujt e ndryshëm të Evropës, kuislingët e të cilëve kanë dërguar jo vetëm batalione po kanë organizuar ekspedita të tëra kundër Ushtrisë së Kuqe heroike, që ishte për të gjithë popujt shembull heroizmi dhe trimërie dhe njëkohësisht mbështetja e tyre më e madhe? — Është zor t'i përgjigjet kësaj pyetjeje.

— A do ta konsiderojë z. Caldaris si vend agresor Francën, prej ku Hitleri mendoi të ndërmarrë ofensivën kundër Anglisë? — Edhe kësaj pyetjeje është zor t'i përgjigjet.

Z. Caldaris kujton se i lejohet çdo gjë kundër Shqipërisë së vogël, por gënjehet. Argumentat e tij pa ndonjë vlerë, nuk mund të qëndrojnë më këmbë.

Jo, populli shqiptar nuk ka qenë kurrë dhe nuk do të jetë kurrë agresor dhe nuk përbën asnë rrezik për popullin grek, siç pretendon z. Caldaris. Sulmet e delegatit të parë grek kundër vendit tim, duke pretenduar se ne i turbullojmë ujërat, na bëjnë të kujtojmë përrallën e La Fontenit. Kemi jetuar gjithnjë mirë me popullin grek, me të cilin kemi luftuar krah për krah kundër okupatorëve fashistë italianë dhe gjermanë.

Gjatë luftës sonë antifashiste populli shqiptar u lidh me miqësi të sinqertë me fqinjët e tij, me popujt jugosllavë dhe grek.

Në dritën e këtyre fakteve, akuzat greke duken nën figurën e tyre të vërtetë, të gënjeshtërtë dhe pa asnë bazë. Por a e ka harruar z. Caldaris kaq shpejt se kuslingët grekë, në bashkëpunim me gjermanët, kanë luf tuar shumë herë kundër shqiptarëve dhe janë përgjegjës për njëmijë të këqia?

Ja disa prova:

Më 8 shtator 1943, ditën e kapitullimit të Italisë, gjermanët hynë në Konispol duke ardhur nga ana e Sajadhës, të udhëhequr prej kapitenit zervist të quajturit Vitos dhe dogjën më se 50 shtëpi. Gjatë ofensivës së madhe të dimrit 1943—44, organizuar prej gjermanëve kundër Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare, forcat gjermane me bandat e Zervës erdhën nga Greqia në Shqipëri dhe u vunë zjarrin krahinave të Zagorisë dhe të Pagonit.

Banda të tjera zerviste bashkë me gjermanët luf tuan kundër partizanëve shqiptarë në janar 1944 dhe u vunë zjarrin katundeve Krane dhe Dermish, si dhe shtëpive të të gjithë partizanëve minoritarë të Dropullit,

kurse në shkurt 1944 këto banda dogjën katundin Dhrovjan.

Gjatë ofensivës tjetër të madhe të gjermanëve në qershori të vitit 1944 forcat zerviste erdhën përsëri bashkë me ushtrinë gjermane nga Greqia nga ana e Voshtinës dhe dogjën në Zagori ç'kishin lënë herën e parë. Kështu kurdoherë që gjermanët vinin nga Greqia për të goditur forcat e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare mbështetja e tyre kryesore përbëhej prej bandave të gjeneralit kuisling grek Napoleon Zervas.

Delegacioni grek ka pretenduar se qeveria shqiptare e tanishme ndjek një politikë shkombëtarizimi kundrejt minoritetit grek në Shqipëri.

Zoterinj, minoriteti grek në Shqipëri, që përbëhet prej 35 mijë fryshtesh ka luftuar krah për krah me mbarë popullin shqiptar kundër pushtuesve fashistë dhe nazistë dhe kundër kuislingëve shqiptarë dhe grekë. Sot në gjirin e Republikës Popullore të Shqipërisë ai gjeson të drejta të njëllojta me popullin shqiptar. Ai ka 79 shkolla dhe një lice në gjuhën greke, ai e ushtron vetë pushtetin lokal autonom si populli shqiptar; ai ka përfaqësuesit e tij në Kuvendin Popullor; në radhët e ushtrisë dhe të administratës ndodhen gjithashtu minoritarë grekë.

Nga ana tjetër, nuk e di nëse zoterinjtë delegatë kanë dijeni për terrorin e ushtruar në kurriz të pakicës shqiptare në Greqi. Nga të 60 mijë shqiptarët e mbetur në Greqi, sipas Traktatit të Londrës, nga viti 1913 e gjer në vitin 1923, 35 mijë shqiptarë u dërguan me forcë në Turqi si «nënshtetas turq» në këmbim të grekëve të Azisë së Vogël; në kundërshtim me angazhimet e marrura solemnisht prej Greqisë, qeveritë greke kanë

ndjekur gjithmonë një politikë shfarosjeje kundrejt minoritetit shqiptar në Greqi dhe nuk i njohën kurrë ndonjë të drejtë. Në qershor të vitit 1944 dhe në mars të vitit 1945, bandat e gjeneralit kuisling Napoleon Zervas deshën t'i zhduknin shqiptarët që kishin mbetur: ata dogjën katundet e tyre, u plaçkitën pasuritë dhe vranë me mijëra burra dhe gra, fëmijë dhe pleq. Më se 20 mijë shqiptarë, që mundën të shpëtonin nga vdekja, u arratisën në Shqipëri, ku sidomos që kanë ndihmën e qeverisë dhe të popullit shqiptar, jetojnë në një mjerim të madh.

Por objektivi i vërtetë i gjithë këtyre thënjeve të delegatit grek është që t'i merren Shqipërisë dy krahina: të Korçës dhe të Gjirokastrës, që kanë qenë gjithmonë nga qendrat më të zjarra të patriotizmit shqiptar, si gjatë pushtimit të gjatë turk, ashtu edhe gjatë Luftës nacional-çlirimtare kundër zaptuesve italianë dhe gjermanë. Këto qëllime pasqyrojnë politikën e vjetër të «Megalidhesë» greke, domethënë të zgjerimit imperialist grek në krejt Ballkanin, ide që ka mbirë edhe në kokën e qeveritarëve grekë të tanishëm. Në fakt, këta, me rivendikimet që bëjnë kundër Shqipërisë, me provokimet e tyre të përditshme në kufitë tanë dhe me intrigat që kurdisin, si ajo e propozimit, bërë delegatit jugosllav prej z. Caldarisit vetë, për ta ndarë Shqipërinë¹, kërkojnë të turbullojnë paqen në Ballkan.

Zotérinj, ne kujtojmë se është pa vend dhe një gjë e papranueshme të preket në këtë konferencë çështja e

¹ Në Konferencën e Paqes në Paris Caldaris, aso kohe Kryeministër i Greqisë dhe kryetar i delegacionit grek në konferencë, i bëri, në mënyrë konfidenciale, kryetarit të delegacionit jugo-

integritetit tokësor të Shqipërisë. Populli shqiptar i vogël në numër, por i madh nga sakrificat që ka bërë përkauzën e përbashkët, nuk ndodhet këtu përfshirë diskutuar përkufitë e tij, por përfshirë shprehur dhe përfshirë kërkuar të drejtat e veta.

Po deklarojmë solemnisht se: brenda kufive tanë të tanishëm nuk ka asnjë pëllëmbë tokë të huaj dhe nuk do të lejojmë kurrë që të na preken, sepse ato përfshirë ne janë të shenjta.

SHQIPËRIA DHE TRAKTATI I PAQES ME ITALINË

Italia, zotërinj delegatë, është plotësisht përgjegjëse përfshirë humbjet dhe dëmet që ju shkaktuan popullit shqiptar në këtë luftë. Kapitullimi i 8 shtatorit 1943 u dha fund agresioneve dhe paturpësive të Italisë fashiste, por ne kërkojmë, në emër të mijëra të rënëve dhe përfshirë fatkeqësítë e shkaktuara prej Italisë vendit tonë, që Traktati i Paqes i nënshkruar, t'i japë fund njëherë e mirë politikës agresive dhe imperialiste të Italisë.

Shqipëria ka vuajtur shumë nga Italia fashiste, por ka vuajtur gjithashtu edhe nga Italia parafashiste, e ashtuquajtura demokratike, dhe shumë shenja e fjalë të qeverisë së tanishme italiane nuk paralajmërojnë asgjë të mirë, përveçse po atë politikë italiane kundrejt Shqipërisë, domethënë një politikë dominimi dhe pushtimi.

sllav një propozim përfshirë ndarjen e Shqipërisë midis Greqisë dhe Jugosllavisë. Përfaqësuesi i Jugosllavisë nuk e pranoi këtë propozim pse shpresonte që një ditë Shqipëria do të bëhej krejt e Jugosllavisë.

Italia e tanishme është bërë streha e gjithë kriminelëve shqiptarë të luftës që kanë mundur të shpëtojnë nga ndëshkimi i drejtë i popullit dhe që kanë gjetur atje një fushë të përshtatshme për të propaganduar dhe komplotuar kundër Shqipërisë së re Demokratike. Kriminelët italianë të luftës, përgjegjës për agresionin kundër Shqipërisë dhe për kaq të këqia në kurriz të popullit shqiptar, janë të lirë dhe bile me pozita të larta. Në mars 1946, fashistët italianë vranë në Bari një kapter shqiptar të misionit ushtarak shqiptar pranë Shtabit të Përgjithshëm aleat. Burra shteti të qeverisë së tanishme italiane, në fjalimet e tyre gjatë fushatës së zgjedhjeve të pranverës së kaluar, kanë solur me lakmi për pavarësinë e Shqipërisë, dhe po këtu, delegacioni italian ka në gjirin e vet burra që ishin agjentë besnikë të Musolinit për t'i imponuar Shqipërisë vullnetin e Italisë, për të pushtuar dhe martirizuar vendin tonë.

Delegacioni shqiptar e ka studjuar me kujdes projektin e Traktatit të Paqes me Italinë dhe i shpreh mirënjohjen Këshillit të Ministrave të Jashtëm, i cili në kohën e punimit të këtij traktati, nuk i ka kaluar në heshtje interesat e Shqipërisë. Megjithkëtë ai merr guxmin sot të bëjë disa vërejtje mbi këtë traktat duke rezervuar të drejtën të shprehë pikëpamjen e vet më me hollësi përparrë komisioneve kompetente mbi çështjet e veçanta, kurdoherë që do ta gjejë me vend.

Shqipëria kërkon që Traktati i Paqes t'i sigurojë garanci të forta, t'i presë hovin në të ardhmen një kthesë agresive të politikës imperialiste italiane kundrejt saj dhe t'i heqë Italisë çdo mundësi të përsëritë të kaluarën, si për kohën para 7 prillit 1939, ashtu edhe për kohën

pas kësaj date, që të paraqesë kundrejt Shqipërisë reklamime të çdo lloji qofshin.

Për këtë shkak delegacioni shqiptar merr guximin të propozojë disa përmirësimë:

1. Delegacioni shqiptar çmon se forcat ushtarake, tokësore, detare dhe ajrore që i janë lënë Italisë i lejojnë kësaj të prekë paqen dhe sigurinë e fqinjëve dhe të vendeve ballkanike. Shqipëria është e mendimit që këto forca të pakësohen edhe më tepër për ta vënë Italinë në gjendje që të mos mundë të rrezikojë paqen, kështu që të mund të rrojmë dhe të punojmë në siguri.

2. Delegacioni shqiptar do të dëshironte të bënte një vërejtje mbi një pikë shumë me rëndësi të këtij traktati dhe që lidhet ngushtë me ngritjen ekonomike të Shqipërisë. Dua të flas mbi kapitullin e dëmshpërblimeve. Këshilli i Ministrave të Jashtëm ja lë konferencës barrën të vendosë mbi kërkimet e dëmshpërblimeve nga ana e Francës, Jugosllavisë, Greqisë, Shqipërisë dhe Abisinisë. Dhe z. De Gasperi¹, në fjalimin e tij, megjithëse heshtazi, kërkon që ta shpëtojë vendin e tij nga detyrimet e drejta që fashizmi i ka ngarkuar atij me agresionet e veta kriminale.

Zotërinj, për 54 muaj rresht, agresorët italianë, me dashje dhe për qëllime të caktuara, duke grabitur dhe duke shfrytëzuar rrënjesisht të gjitha burimet e tokës dhe të nëntokës, bujqësinë tonë dhe bagëtitë tona, duke djegur qytetet dhe fshatrat tanë për ta larguar popullin

¹ De Gasperi — politikan demokristian, reaksionar italian. Kryeministër i Italisë në vitet 1945-1953. Ndoqi një politikë anti-demokratike.

nga kauza e tij e drejtë e çlirimit, duke e kthyer vendin tonë paqedashës në fushë lufte, i kanë shkaktuar ekonomisë sonë kombëtare dëme të pandreqshme. Kanë vrarë, torturuar, bërgosur ose mbyllur në fusha përqëndrimi me mijëra patriotë dhe kanë vënë në zi me mijëra mëma, gra dhe fëmijë.

Italia është përgjegjëse kundrejt Shqipërisë për humbjet dhe dëmet që kapin shumën prej 3 544 232 626 franga ari.

Delegacioni shqiptar do të parashtrojë me hollësi kërkesat e veta për dëmshpërblim dhe përmirësimet e nevojshme në traktat, por që tani ai kërkon, si një të drejtë të pabisëdueshme për vendin e tij, që Traktati i Paqes të caktojë shumën që Italia duhet t'i paguajë Shqipërisë, si dhe kushtet e pagimit.

3. Nga sa u tha më lart del se Traktati i Paqes me Italinë ka një rëndësi të dorës së parë për Shqipërinë. Ka edhe pika të tjera me rëndësi, mbi të cilat nuk desha të zgjatem këtu; si nenet mbi kriminelët e luftës, mbi kthimin e sendeve të grabitura, mbi pasuritë e nënshtetasve të kombeve të bashkuara në Itali, përveç disa hollësive, por jo pa rëndësi, që prekin drejtpërdrejt vendin tonë.

Ky traktat parashevë për Shqipërinë të drejta dhe detyrime shumë me rëndësi. Këto janë lidhur ngushtë me indipendencën, sovranitetin dhe integritetin e saj tokësor, me të ardhmen e saj ekonomike dhe politike. Megjithkëtë delegacioni shqiptar është i detyruar të konstatojë se, megjithësa u thanë më lart dhe me gjithë faktin se Shqipëria me kontributin e saj në luftën e përbashkët, është radhitur me mish e me shpirt në ra-

dhët e kombeve të bashkuara fitimtare, Traktati i Paqes me Italinë, ashtu siç paraqitet sot në projekt, nuk i siguron Shqipërisë të gjitha të drejtat që i takojnë normalisht dhe (a mos është vallë ndonjë paradoks juridik?) nuk e lejon ta nënshkruajë këtë traktat si palë kontraktuese, sepse nuk konsiderohet si fuqi-shoqe.

Delegacioni shqiptar shpreson se konferenca do ta pranojë amendamentin që vijon dhe që do të mbante si numër «nenin 26 a» në pjesën II, seksioni V ose të shtonet në parathënjen, gjë që do të zhdukte një varg keq-kuptimesh dhe ndërhyrjesh të vazhdueshme nga ana e delegacionit tonë.

Amendamenti i propozuar është ky:

«Neni 26 a»

«Përsa i përket zbatimit të këtij traktati, Shqipëria konsiderohet si një fuqi-shoqe».

Dua të përcaktoj se delegacioni shqiptar rezervon të drejtën të paraqesë pikëpamjen e tij në mbledhjen plenare të konferencës, si dhe përpara komisioneve kompetente, kurdoherë që do ta gjykojë me vend, që të ndërhyjë mbi Traktatin e Paqes me Italinë.

Delegacioni shqiptar e ndjen për detyrë të paraqesë kërkesat e tija të drejta kundrejt Italisë në mënyrë që kjo të pushojë së qeni një rrezik i vazhdueshëm për Shqipërinë e vogël dhe paqedashëse, që t'i paguajë dëmshpërblimet, t'i kthejë sendet e rrëmbyera dhe t'i dorëzojë sa më shpejt kriminelët shqiptarë të luftës dhe të huaj, të kërkuar prej qeverisë shqiptare dhe që gjenden të strehuar në Itali.

Republika Popullore e Shqipërisë do të jetë e lumtur të ketë marrëdhënje normale me një Itali të re me

të vërtetë demokratike që t'u përgjigjet me nder detyrimeve të sajë ndërkombe të, që të mbajë kufitë e saj natyralë dhe të respektojë ato të të tjerëve, që të mos jetë një çerdhe neofashistësh dhe kriminelësh lufte të të gjitha vendeve, që të mos jetë një vatër e re agresioni, por që t'ja ketë ëndë të bashkëpunojë me vendet e tjera demokratike për paqen dhe për sigurimin kolektiv.

Shqipëria nuk kurseu asgjë për fitoren e përbashkët. Ajo është po aq e vendosur të japë përkrah aleatëve të luftës dhe të të gjithë vendeve demokratike kontributin e saj për vendosjen e një paqeje të drejtë dhe të një sigurimi kolektiv.

Delegacioni shqiptar do ta ndjejë veten të lumtur nëse ky kontribut i vogël në këtë konferencë do të ndihmojë në kryerjen e kësaj barre të rëndë.

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 540,
22 shtator 1946*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 540,
22 shtator 1946*

DEKLARATË DHËNË PËRFAQËSUESVE TË SHTYPIT NË PARIS

16 shtator 1946

Populli im, i cili u hodh i pari në luftën kundër fashizmit dhe luftoi gjer në fund, kishte besim të madh, kur më dërgoi mua në Konferencën e Paqes, për një drejtësi më të mirë. Populli shqiptar me ndërmjetësinë time, nuk ka kërkuar veçse atë drejtësi, për të cilën kanë rënë bijtë e bijat e tij heroikë, ai nuk ka kërkuar veçse frytin e sakrificave të tija të mëdha. Kjo drejtësi na u mohua. Pas kaq sakrificash të bëra nga populli ynë, pas kaq provash të shkëlqyeshme heroizmi dhe vetëmohimi, pas kaq gjaku të derdhur nga i gjithë njerëzimi, ka njerëz që i mohojnë paturpësish përpjekjet tona vigane, që e quajnë luftën tonë «një mit», që duan të na vënë në radhën e agresorit fashist italian dhe që kërkojnë nga vendi ynë toka që nuk kanë qenë kurrë ndonjëherë të tyre. Por populli im nuk çuditet që ka edhe sot njerëz të tillë, vetëm i vjen keq kur sheh që përfaqësuesit e disa vendeve aleate, të cilët e dinë fare mirë luftën tonë heroike, dinë sakrificat tona të mëdha, dhe që vetë ata i kanë mburrur, përkrahin haptas ose nën maskë qeveritarët e Athinës, turbullues të paqes në Ballkan dhe në

botë. Historia do të jetë gjykatëse e kësaj padrejtësie të madhe që i bëhet Shqipërisë, por kjo e fundit do të qëndrojë me krye lart, pasi ajo, në kohën e rrezikut e ka përbushur gjer në fund detyrën e saj kundrejt njerëzimit.

Popujt e qytetëruar dhe demokratë e kuptojnë patjetër këtë padrejtësi që i bëhet vendit tim të vogël, i cili meriton nderime dhe të drejta të plota.

Kur populli shqiptar luftonte trimërisht kundër fashizmit, të tjerët i hidhnin lule, por kur erdhi koha që ai të kërkonte vendin e tij kaq shumë të merituar në OKB ose në Konferencën e Paqes, i hodhën gurë. Populli im nuk do të mund ta kuptoje kurrë këtë logjikë, pasi ajo nuk është e ndershme. Por në gjithë këtë çështje një gjë është e qartë: të drejtat e popujve të vegjël shpeshherë merren nëpër këmbë. Për këtë gjë populli im është i bindur plotësisht, ashtu siç është i bindur dhe është mirënjos, nga ana tjetër, kundrejt miqësisë së madhe dhe të singertë që tregohej ndaj tij në çdo çast kur çështja jonë shtrohej nga shumë delegacione të vendeve aleatë dhe miq qoftë në Konferencën e Parisit ose në OKB.

Por populli shqiptar, i cili nuk dekurajohet kurrë, edhe në çastet më kritike të ekzistencës së tij, do ta vazhdojë rrugën e përparimit dhe do t'i shkrijë të gjitha forcat e tija modeste për përforcimin e paqes. Populli im, që punon në paqe dhe në rregull për rindërtimin e vatrave të tija, nuk trembet nga fashistët grekë që kurdisin komplotë kundër tij. Ne jemi një popull paqedashës, por ne nuk jemi nga ata që lejojmë të na marrin nëpër këmbë. Në dimë t'i mbrojmë të drejtat tona, lirinë,

pavarësinë, sovranitetin, integritetin tonë tokësor. Shekuj me radhë populli shqiptar ka luftuar për t'i fituar këto të drejta të shenja dhe ai është gati edhe sot ta fillojë përsëri luftën e tij, në qoftë se aventurierët fashistë do të guxojnë t'ja prekin.

Fashistët grekë, që prej çlirimit të vendit tim, nuk bëjnë gjë tjetër veçse të provokojnë në kufirin tonë të Jugut; pothuajse çdo ditë kryhen sulme të armatosura të grekëve kundër rojeve tona të kufirit, kundër popullit tonë punëtor dhe paqedashës, kundër limaneve dhe bregdetit tonë. Fashistët grekë nuk mund të durojnë që në kufirin e tyre të Veriut të ekzistojë një demokraci e fortë dhe e shëndoshë, siç është kjo jona. Ata bëjnë çmos për të turbulluar paqen në Ballkan, ata shkojnë deri atje sa të kërkojnë edhe Shqipërinë e Jugut pse, thonë ata, ajo «është një tokë greke». Konferenca e Parisit, me 11 vota pro, 7 kundër dhe 2 abstenime, votoi në favor të kërkesës greke, e cila synon diskutimin e kufirit të Shqipërisë së Jugut.

Unë deklaroj solemnisht se: as Konferenca e Parisit, as Konferenca e të Katërve, as çdo konferencë tjetër qoftë, nuk mund të marrin në shqyrtim kufitë e vendit tonë brenda të cilëve nuk ka asnje pëllëmbë tokë të huaj. Kufitë tanë janë të padiskutueshëm dhe askush nuk do të guxojë t'i prekë. Që të mundin të marrin një pëllëmbë tokë të vendit tonë, grekët duhet të vënë në lëvizje të tjera mekanizma përveç votës së Konferencës së Parisit. E gjithë bota ta dijë se populli shqiptar nuk lejon që të diskutohen kufitë e tij dhe toka e tij.

Nga ana tjetër protestoj kundër vendimit të marrë në seancën plenare të Konferencës së Parisit. Populli

shqiptar nuk e ka dërguar delegacionin e tij në Paris për të dhënë llogari, por për t'u kërkuar llogari atyre që e kanë dëmtuar aq tepër dhe që ai i ka luftuar me ash-përsi gjer në fund. Ne e kemi bërë detyrën tonë ashtu si e kanë bërë edhe të mëdhenjtë. Dëshmorët tanë dhe sakrificat tona janë për ne po aq të shenjta sa janë dhe dëshmorët e sakrificat e të mëdhenjve; të drejtat tona janë po aq të shenjta, sa janë edhe ato të atyre. Mirëpo Konferenca e Parosit siç duket, nuk i mori parasysh këto gjëra.

Duke u larguar nga Parisi dua të falenderoj, në emër të popullit tonë, të gjithë përfaqësuesit e atyre vendeve që e mbrojtën kauzën e drejtë dhe të merituar të popullit të vogël shqiptar. Ne urojmë me gjithë zemër, nga ana tjetër, që t'i jepet fund kësaj fushate të padrejtë dhe të shpifur fund e krye kundër vendit tonë, që ka luftuar me kaq trimëri kundër fashizmit dhe që do t'i shkrijë të gjitha forcat e tija për të përforcuar paqen e drejtë dhe të gjatë.

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 537,
19 shtator 1946*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 537,
19 shtator 1946*

FJALIM I MBAJTUR NË AEROPORTIN E TIRANËS ME RASTIN E KTHIMIT NGA KONFERENCA E PAQES

17 shtator 1946

Jam shumë i gjëzuar që kthehem në atdhe pas disa javësh mungese. Populli ynë, që luftoi aq burrërisht kundër fashizmit dhe që është një nga faktorët e shëndo-shë të një paqeje të drejtë dhe të vazhdueshme, meritonte një drejtësi më të madhe nga ana e Konferencës së Parisit. Shumë shtete, nga ata që janë pjesëtare të Konferencës së Parisit, po bëjnë demagogji me barrë përsa i përket të drejtave të shteteve të vegjël dhe mbrojtjes së tyre, por nën fjalët e tyre fshihet një realitet tjetër që s'ka të bëjë aspak me drejtësinë e vërtetë. Shqipëria u thirr në Konferencën e Paqes vetëm për të shfaqur pikëpamjen e saj në lidhje me Traktatin me Italinë, në vend që ajo të thërritej si pjesëtare me të gjitha të drejtat, sikundër edhe të 21 kombet e tjerë. Këtë të drejtë ajo e kish fituar me gjak e me sakrifica.

Vendi ynë shkonte në Paris për t'u kërkuar hesap atyre që e dogjën, e shkatërruan, e robëruan, e gjakosën dhe jo që t'i kërkohet hesap qoftë edhe prej disa avenirierëve, vrasës të popullit të tyre, bashkëpunëtorë të gjermanëve, dua të them, përfaqësuesve të Greqisë, që

mund të kenë vend gjetkë, por jo në Konferencën e Paqes. Me gjithë pengesat e panumërt dhe aspak të justifikuara, pse pa baza, Konferenca e Parisit ka qenë për popullin shqiptar një tribunë nga ku bota dëgjoi sa të mëdha ishin sakrificat e një populli të vogël, i cili vuri në kohën e luftës të gjitha fuqitë modeste të tij në balancën e aleatëve dhe që tani, ka vënë të gjitha fuqitë e veta pa i kursyer në ndërtimin e paqes. Shqipëria në Konferencën e Paqes, me gjithë pengesat e drejtpërdrejtë dhe të tërthorta që i bënин korri sukses të madh si politik edhe moral. Ne me luftë kemi korrur fitoret më të mëdha dhe nuk harrojmë kurrë se në këtë botë çdo gjë duhet të fitohet me përpjekje, pse në rrugën e drejtë që ndjekin popujt demokratë, sikundërqë është populli shqiptar, gjejmë edhe njerëz të ligj, edhe mbeturina të fashistëve, edhe nga ata që me çdo kusht përpiken të kthejnë rrotën prapa. Mirëpo rrota jonë ka marrë rrugën e drejtë dhe është shumë zor që armiqtë e demokracive ta pengojnë në rrugën e saj.

Gjatë punimeve të Konferencës së Paqes, sikundër-që jeni në korrent, kurdoherë që shtrohej çështja e Shqipërisë, diskutimet, qoftë në seancat plenare, qoftë në komisionet e ndryshme, ishin të zjarrrta.

Çështja jonë e drejtë, populli ynë heroik, mbrohej me vendosmëri të jashtzakonshme nga miqtë tanë më besnikë dhe më të shtrenjtë, nga delegatët e Bashkimit të madh Sovjetik, nga përfaqësuesit e të madhit Stalin, nga Mollotovi dhe shokët e tij, mbrohej gjithashtu nga përfaqësuesit e Jugosllavisë, Polonisë, Çekoslovakisë, Bjellorusisë, Ukrainës. Aṭa ishin kurdoherë gati, kur ishte për t'u mbrojtur çështja jonë.

Mbrojtja e të drejtave tona, mbrojtja e tokës sonë që e kemi vadir me gjak shekuj me radhë, mbrojtja e Shqipërisë sonë të dashur nga ana e Sovjetëve dhe miqve të tjerë nuk mund të përshkruhet.

E gjithë bota e opinioni ndërkombëtar demokratik ka qenë pro nesh, simpatizonte çështjen tonë. Shqipëria s'ka pasur miq dhe mbrojtës kaq të fortë, Shqipëria s'ka pasur me vete opinionin ndërkombëtar sikundërqë e katanë dhe kurrë armiqtë e popullit shqiptar s'janë bërë aq qesharakë me pretendimet e tyre qesharake.

Në Konferencën e Parisit askush nuk guxoi të thotë një fjalë të keqe për Shqipërinë, përveç fashistëve grekë. Megjithatë, Konferenca e Parisit, në një mbledhje të saj plenare, duke shkelur çdo rregull dhe procedurë, me 11 vota pro, me 7 kundër dhe 2 abstenime, votoi në favor të kërkesës greke që ka për qëllim diskutimin e kufive të Shqipërisë së Jugut.

Mekanizma e votës ishte për ata që pengojnë vendet tona në rrugën e përparimit, por fitorja ishte jona. Populli ynë, i madh e i vogël, gra e burra, duhet të mbajë gjallë dhe ta shtojë kurdoherë miqësinë dhe dashurinë për popujt sovjetikë që po e ndihmojnë dhe e mbrojnë me aq zemër në rrugën e tij të drejtë.

Populli ynë, që don të rrojë në harmoni dhe në miqësi me të gjithë shtetet demokratë, nuk mund ta kuptojë logjikën e disa shteteve, të cilët, duke e njohur mirë luftën tonë, duke ditur sakrificat tona e që vetë njerëzit e mëdhenj të tyre i kanë bërë kaq lavdërimë luftës së vendit tonë, ndihmojnë tërthorazi ose haptas qeveritarët e Athinës, vrasësit e demokratëve grekë dhe të popullit grek, turbulluesit e paqes në Ballkan e në botë.

Bota e dëgjoi, por është mirë që ta dëgjojë edhe një herë, se: as Konferenca e Paqes e Parisit, as Konferenca e të katër Ministrave të Punëve të Jashtme dhe as ndonjë konferencë tjeter qoftë, nuk janë kompetentë të diskutojnë kufitë tanë. Kufitë tanë janë të padiskutueshëm dhe të paprekshëm. Fashistëve grekë, nuk do t'u shërbejnë as provokacionet e përditshme, që na bëjnë në kufi, as mekanizma e votës në konferencën plenare që të rrëmbejnë as edhe një centimetër të tokës sonë. «Ballistët» grekë, për të prekur tokat tona, duhet të vënë në lëvizje diçka tjeter, duhet të prepatit luftën. Ne-i njohim mirë ballistët, qofshin shqiptarë, qofshin grekë dhe dimë t'u japim mësimin e merituar, në qoftë se kanë akoma qejf të bëjnë aventura.

Pretendimet, aq të poshtra sa edhe qesharake, të qeveritarëve të Athinës, do të dështojnë me turp. Metoda të tilla, që Calderisi përdor për të shtypur popullin grek, për të vendosur monarkinë, s'kanë vlerë për botën e qytetëruar dhe ca më pak për ne.

Britmat e Calderisit as na trembin, as na alarmojnë, por reaksionarët grekë duhet të dinë se ne jemi kurdoherë vigjilentë dhe gati po ta lypë nevoja, për të mbrojtur tokat tona.

Populli shqiptar për të mirën dhe për forcimin e paqes dëshiron që të marrë fund kjo lodër qesharake dhe njëkohësisht e rrezikshme.

Sa për popullin shqiptar, ai e ndjen veten të sigurt në vendin e tij që e çlroi me kaq sakrifica dhe që e ndërton me kaq mundime. Rruga e tij, që po ndjek me kaq bindje dhe vendosmëri, është rruga e demokracisë së vërtetë dhe të shëndoshë, që do ta bëjë vendin tonë

një nga vendet më të lumtura. Shqipëria jonë do të rrojë e fortë dhe e nderuar; garanci është rruga që po ndjek, është vullneti dhe gjallëria e njerëzve të Shqipërisë, janë miqtë tanë të fortë dhe të sinqertë, që na ndihmojnë dhe na mbrojnë pa kursim, ashtu sikundër mbrojnë të gjithë popujt e vegjël.

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 536,
18 shtator 1946*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Bashkimi», Nr. 536,
18 shtator 1946*

RAPORT MBI AKTIVITETIN DHE DETYRAT E REJA TË FRONTIT, MBAJTUR NË MBLEDHJEN E DYTE TË KESHILLIT TË PËRGJITHSHËM TË FRONTIT DEMOKRATIK

7 tetor 1946

Shokë të Frontit Demokratik,

Ju përshëndes nga ana e Sekretariatit të Frontit dhe nga ana ime, të gjithë juve, të mbledhur këtu, si edhe gjithë anëtarët e Frontit Demokratik. Po bëhen plot 6 muaj nga mbledhja e fundit e Këshillit të Frontit që u mbajt në Tiranë më 7 prill të këtij viti, 6 muaj, plot punë, plot ngjarje, ku organizata jonë politike e masave ka luajtur një rol kryesor. Në regjimin tonë popullor, ku populli është në krye të punës, në institucionet shtetërore ose në ndërmarrjet e ndryshme në bazë dhe në krye të pushtetit, ku ai bën ligjin dhe dikton vullnetin e tij, drejton fatet e vendit dhe bën politikën e vërtetë, e cila përputhet krejtësisht me interesat e tij, mbledhje të tillë, jo vetëm që janë të nevojshme, por janë të domosdoshme. Udhëheqësit dhe populli duhet të jenë në kontakt të ngushtë dhe të vazhdueshëm; udhëheqësit e zgjedhur prej popullit kanë për detyrë të kryejnë me përpikëri detyrat që u besohen, por kanë gjithashtu për detyrë t'i japid llogari popullit për punën që u ka ngar-

kuar, të marrin aprovin e tij dhe të përfitojnë nga eksperienca e madhe e masave të gjera krijuese, burimi kryesor i shkuarjes përpara. Këtë të mos ta harrojmë kurrë sepse kjo është baza, ku mbështetet regjimi ynë dhe kush e shkel ose e harron këtë parim të madh të demokracisë sonë, ai është në rrugën e kundërt dhe të gabuar. Nën prizmin e këtij parimi duhet të shohim ekzistencën e vetë Frontit si organizatë politike e masave të gjera të popullit tonë, gjithashtu dhe politikën që e udhëheq Frontin në realizimin e detyrave që i vihen përpara në etapa të ndryshme të zhvillimit historik të vendit tonë.

Fronti Nacional-Çlirimtar, që ishte pjella e lavdishme e Luftës nacional-çlirimtare nuk ishte, as organizatë formale, as manevër maskimi e Partisë Komuniste të Shqipërisë, sikundër u përpoqën ta paraqitnin tradhëtarët e vendit tonë, veglat e ndyra të okupatorit. Parulla e krijimit të Frontit Nacional-Çlirimtar si dhe organizimi dhe forcimi i tij, i detyrohen Partisë Komuniste të Shqipërisë. Ky është fakt i madh historik, dhe populli shqiptar, kësaj organizatoreje të shquar do t'i jetë mirënjohëse për jetë. Fronti u krijuar kur atdheu ishte në rrezikun më të madh. Duhej mbrojtur atdheu, duhej çliruar atdheu, duhej shpëtuar populli nga okupatori dhe nga tradhëtarët dhe ky të merrete fuqinë në dorën e vet, për të ndërtuar një jetë të re. Kjo ishte një nevojë imperative, pse jeta e kombit tonë ishte në rrezik. Për Mehdi Benë, Mithat Benë¹ ose Ali Benë² pak punë prish-

¹ Mithat Bej Frashëri.

² Ali Bej Këlcyra.

te nësejeta e popullit ishte në rrezik; përkëta bejlerë, rreziku ishte populli. Në konditat kritike që kalonte atdheu lindi e domosdoshme dhe e nevojshme mobilizimi i tërë popullit, vëllazërimi i tij, bashkimi i tij, përnjë qëllim të vetëm dhe të përbashkët: me luftue pa mëshirë okupatorin dhe veglat e tija dhe me çlirue atdheun. Sa më tepër Fronti ynë zgjerohej dhe forcohej, aq më tepër ashpërsonej lufta, aq më tepër zmadhohej dhe forcohej Ushtria jonë e lavdishme Nacional-Çlirimtare, aq më tepër forcohej pushteti i këshillave nacional-çlirimtare, aq më tepër çliroheshin zona të tëra. Çfarë konkluzionesh duhet të nxjerrim këtej nga kjo eksperiencë e madhe e luftës sónë dhe që të na shërbijnë në çdo hap si mësim dhe si orientim në punën tonë ndërtimitare?

Në radhë të parë, Fronti, si organizatë e gjerë politike e masave të popullit, lindi nga rrethanat e luftës dhe nga nevojat imperative të këtyre masave për t'u çliruar përgjithmonë nga zgjedha e të huajit dhe nga zgjedha e feudalëve dhe e gjakpirësve të tjerë të tij. Pra Fronti s'ishte as organizatë e rastit, as një organizatë formale. Pa ekzistencën e Frontit, Shqipëria nuk do të ishte në këtë gjendje që është sot, pse Fronti është populli dhe politika e Frontit është politika e popullit. Populli e bëri luftën, populli e fitoi luftën, populli e çlroi Shqipërinë dhe po e ndërton Shqipërinë. Fitoret e shkëlqyera të luftës u realizuan nga populli, i grumbulluar dhe i bashkuar në Frontin Nacional-Çlirimtar, i udhëhequr nga politika e drejtë e Frontit. Realizimet në Shqipërinë e re të popullit, do të bëhen përsëri prej popullit, i grumbulluar, i bashkuar në Frontin Demokratik, i udhëhequr nga politika e drejtë e këtij Fronti. Në veprat e

popullit ka vazhdimësi dhe konsekuencë, ashtu si ka madhështi dhe eternitet.

Fronti Nacional-Çlirimtar, e çoi vendin drejt fitores pse politika e tij ishte e drejtë dhe se kjo politikë synontë realizimin e qëllimeve dhe të aspiratave të popullit punëtor dhe të ndershëm. Një platformë politike e tillë, si ajo e Frontit, mund të mobilizonte dhe të bashkonte punëtorin, katundarin, intelektualin e ndershëm dhe patriot, interesat e të cilëve puqeshin. Luftohej për atdheun dhe për ekzistencën: dy gjëra të pandara për popullin tonë punëtor. Shumë njerëz, (nuk flas për armiqtë e popullit), nuk ishin në gjendje të dallonin mirë ku ishte interes i tyre i vërtetë; këta njerëz të thjeshtë të popullit, nga injoranca, nga frika, ose nga traditat patriarkale prapanike, lëkundeshin dhe nuk e gjenin dot rrugën e vërtetë. Këtu Fronti ka luajtur rol kryesor në bindjen e këtyre njerëzve. Kështu u bë zgjerimi i Frontit që do të thoshte njëkohësisht forcimi i tij. Në Front kishin vend gjithë njerëzit e ndershëm të Shqipërisë, që ju dhimbsej atdheu dhe që çështja e popullit ishte çështja e tyre. U ngrit ndërgjegjja e popullit shqiptar, u forcua dhe u konkretizua ndjenja e patriotizmit, u kuptua përsë luftohej dhe kundër kujt luftohej; popullit ju hapën sytë, ju hapën perspektivat, dhe me vendosmërinë më të madhe, ai eci drejt objektivave, që vetë i kish caktuar. Organizimi i tillë i masave, me qëllime dhe objektiva të caktuara, pikërisht kjo s'ju leverdiste fashistëve, bejlerëve feudalë, tregëtarëve pasanikë, politikanëve aventurierë, fajdexhinjve dhe spekulatorëve. Këta ishin armiqtë e përhershëm të popullit tonë; këta e panë rrezikun në organizimin e shëndoshë të popullit e në luftën e tij

vendimtare dhe u bashkuan haptas me fashizmin, e vëmja shpresë e tyre, e vëmja armë e tyre për të shtypur revolucionin popullor dhe për të ruajtur privilegjet. Me terror dhe demagogji këta u përpoqën ta çanin Frontin për të shtypur luftën tonë; çdo gjë përdorën, por parullat e tyre binin erë lireta e marka gjermane dhe popullit i ishte zhvilluar pa masë të nuhaturit. Pra politika e drejtë e Frontit i ndau lakinat, e ndau kashtën nga kokrra, por kjo s'donte të thoshte se u qëruan të gjithë plehrat. Këtu është çështja e vigjilencës së popullit, për të mbrojtar atdheun nga mbeturinat e fashizmit, për të mbrojtar fitoret e luftës, për të mbrojtar interesat e tij. Rruga tanë është e çelur.

Fronti Demokratik, vazhduesi i Frontit Nacional-Çlirimtar, do të përfitojë qind për qind nga mësimet e luftës sonë të lavdishme dhe kjo eksperiencë e madhe do t'i shërbejë që Shqipëria e re të zhvillohet e të ecë me hapa të sigurta dhe të mëdha. Me çlirimin e Shqipërisë, përpara Frontit u vunë detyra të rëndësishme dhe të vështira, të cilat mund të viheshin në rrugë të mbarë dhe të realizoheshin kryesisht me pjesëmarrjen direkte dhe të gjerë të popullit. Duhej pra mobilizim i madh, aktivizim i masave, drejtim dhe kanalizim i këtyre energjive të shëndosha të popullit. Kjo do të realizohej me ndihmën e Frontit dhe të pushtetit. Prandaj detyra kryesore ishte të forcohej pushteti, të përmirësohej dhe të perfeksionohej administrata shtetërore, duke ruajtur dhe duke zbatuar kurdoherë me përpikëri parimin themelor: pushtetin në duart e popullit dhe pjesëmarrjen e gjerë të tij në të gjithë aktivitetin e vendit. Me anë të pushtetit do të realizoheshin të gjitha veprat për rindërtimin

e Shqipërisë, do të realizoheshin reformat e mëdha sho-qërore dhe ekonomike. Armiqtë e popullit, mbeturinat e fashizmit dhe të regjimeve shtypëse të së kaluarës, do të tentonin të rigrumbullohen dhe, duke ju ambientuar situatave të reja, ata do të goditnin dhe do të dëmtonin pushtetin, me metoda të reja sabotimi. Si paraqitej situata e brendshme në përgjithësi, pas çlirimt të Shqipërisë? Shumë njerëz të lehtë nga mendja, por që ua dëshironte zemra të mendonin kështu, kujtonin se me mbarimin e luftës dhe me çlirimt e Shqipërisë, punët do të zinin karar për ta, domethënë do të kthehej koha e vjetër dhe ata do të ishin kurdoherë në pozitat kyçe të komandës, pse, për ta populli ishte një xhahil i madh, që s'mund të qeverisej dhe të drejtohej pa ndihmën e tyre. Kur bëhej lufta dhe populli vritej, ata përqafohen me italianët dhe me gjermanët, ata pasuroheshin dhe spekulonin në kurrizin e popullit, ata bënин «Te Deume»¹ në kisha për Musolinin dhe Hitlerin, ata na lufttonin me armë. Kur u çlirua Shqipëria, mbeturinat e këtyre hajdutëve predikonin si jezuitët: «Paqen dhe vëllazërimin», duke invokuar në çdo moment sloganin: «Mjaft gjak u derdh, jemi vëllezër». Dhe ne ua dhamë paqen, i këshilluam të rrinë urtë, të ndërrojnë rrugë dhe metodë, të ndërrojnë mentalitet, të tregojnë me prova të dukshme se ata po e korrigojnë të shkuarën e tyre të zezë. Vallë nuk i njihnim dhe nuk i njohim ne këta njerëz, si dhe ç'mendojnë dhe ç'bëjnë? Ne i njohim fare mirë, por ne u dhamë mundësitë të rehabilitoheshin dhe të mos e mbushnë kupën, pse ne ishim në gjendje t'ua

¹ Hymne që këndohen në ceremoni fetare.

thyenim kupën në duar. Këta zotërinj, përkundrazi, as muarën mësim nga lufta dhe nga vepra e madhe e popullit, ata kujtuan se duke u infiltruar andej e këtej, në Front e në pushtet, duke i hedhur disa lule false Luftës nacional-gjirimitare, duke folur disi butë për reformat, të cilat ata kujtonin se ishin si ato reforma që, dikur në regjimin shtypës të tyre, bëheshin nga njëqind në kartë, do të mundnin më lehtë të riorganizoheshin, të forcohen, të shtinin përsëri pozitat në dorë dhe pastaj dinin ata se si të qeverisnin. Populli ynë i njihte mirë këto metoda, pse gjatë historisë së hidhur të tij, ai ishte vrarë dhe gjakosur dhe kur vinte koha për të korrur frytet, atij i mbeteshin shkopinjtë dhe litari. Por këtë herë populli mundi t'u thotë: «Harroje mushkë valarenë». Rrota e historisë së Shqipërisë së re nuk kthehej prapa, forca e shëndoshë e popullit e vinte në lëvizje këtë rrotë drejt objektivave të caktuara dhe prandaj ishin dy rrugë: ose të bashkoje forcën tënde me atë të gjithë popullit për të mirën e kolektivitetit, ose të mori lumi.

Populli triumfoi dhe do të triumfojë kurdoherë. Mos vallë gjithë ata dhjetëra mijë bij të popullit luftuan e u vranë që tokat t'ua linin përsëri bejlerëve dhe agallarëve, e këta të merrnin ushuret¹, të shtypnin katundarët dhe të rronin këmbëkryq? A mos vallë u luftua për të mos u kërkuar llogari zotërinje tregëtarë të mëdhenj spekulatorë dhe të liheshin këta të spekulonin me mishin dhe gjakun e popullit fukara? Apo u luftua që zotërinjtë pasanikë të vazhdonin të mbanin në duart e tyre fabrikat e ndryshme, të cilat ishin ngritur me gjakun e popullit dhe me

¹ Ushuret (turq.) — lloj takse.

anën e të cilave ata zotërinj shfrytëzonin punëtorët dhe gjithë popullin? Pa dyshim jo. Ata që kishin iluzione të tilla gaboheshin rëndë. Por edhe ata armiq të popullit që nuk kishin të tilla iluzione, gaboheshin përsëri në besimin e tyre se do ta përmbysnin këtë situatë. Disa procese gjyqësore janë zhvilluar botërisht në Shqipëri. Gjyqet e popullit kanë gjykuar armiqtë e popullit. Ç'ishin këta njerëz, ç'përfaqësonin këta njerëz dhe ç'ishin qëllimet e tyre? Këta kriminelë, që kanë marrë dënimin e merituar, kanë qenë feudalë, bajraktarë, priftërinj katolikë, tregëtarë të pasur, intelektualë aventurierë dhe të shitur, me njëqind flamurë në xhep, oficerë tradhëtarë të regjimit të Zogut, gjithë llumi dhe mbeturinat e fasizmit dhe të reaksionit të brendshëm. Ku ishin këta njerëz pas çlirimtë të Shqipërisë? Këtu ishin, por ishin të topitur nga sukseset e shkëlqyera të luftës së popullit, ishin të dërmuar, ishin nga ata që thashë më lart, që përpinqeshin të maskoheshin me ndonjë buzëqeshje në dukje, ndërsa në prapaskenë férkonin duart e punonin për t'u rimëkëmbur, për të grumbulluar rrëth vetes ata njerëz të asaj kategorie tjetër që përmenda e që kishin iluzione se, me çlirimin e Shqipërisë, punët do të qëndronin në vend dhe reformat do të mbeteshin në kartë. Të dy këto kategori njerëzish nuk mund ta duronin këtë situatë, pse kjo i mbyste. S'mund ta gjëlltitnin ata reformën agrare që ju merrte tokat dhe privilegjet, s'mund të pranonin pagimin e tatim fitimit të drejtë që u ishte caktuar, s'mund të duronin krijimin e sektorit të madh të shtetit, baza e ngritjes së nivelit të jetesës së popullit, s'mund të shihnin me sy të mirë zhvillimin dhe organizimin kaq të madh të rinisë sonë heroike që fitonte çdo

betejë, s'mund t'ju pëlgente organizimi, zhvillimi dhe pjesëmarrja e gruas shqiptare në jetën e vendit, s'mund të duronin organizimin e shëndoshë të punëtorisë ndër sindikata, s'mund të duronin këtë hov të madh që mori arësimi dhe kultura në vendin tonë. Tymi i oxhaqeve të fabrikave dhe i kantiereve tona që punonin me vrull i mbyste. Zhurma e çekanëve, e kazmave dhe e lopatave, në ndreqjen e urave, në hapjen e rrugëve, në ndërtimin e fshatrave dhe të qyteteve tona të djegura nga lufta, për këta zotérinj ishte si këmbana e vdekjes. Veprimtaria e tyre kundër popullit varej nga intervencioni i huaj, nga ndihma e reaksionit ndërkombëtar. Kjo është fare e natyrshme; këta njerëz as kanë pasur dhe as do të kenë mbështetje në popull, populli është armiku më i madh për ta. Zaten mbështetja e këtyre njerëzve ka qenë kurdoherë paraja dhe bajoneta e imperialistëve të huaj. Shqipëria dhe populli për ta kanë qenë plaçkë tregu. Shihni këta njerëz, që janë gati të shesin dhe këmishën e trupit te i huaji, si lëvrijnë kur i bëhet ndonjë padrejtësi Shqipërisë dhe popullit tonë heroik; ata bashkohen me Calderisin dhe janë gati ta japid haraqë Shqipërinë e Jugut, për të grabitur përsëri tokat dhe privilegjet e humbura, ata e kanë në gjak të bëhen shërbëtorë të ndyrë të të huajve për të shtypur regjimin e popullit. Por mbështetja e këtyre kriminelëve, reaksiuni ndërkombëtar, i ka thonjtë të prerë këtu në Shqipëri dhe s'do të mundë dot kurrë të futë hundët në punët tona të brendshme. Shihni si ju dështojnë njëra pas tjetrës tentativat e tyre të poshtra dhe të padronëve të tyre të jashtëm; shihni nga ana tjetër, sa madhështor, sa burrëror është qëndrimi i popullit tonë dhe si ai del me sukses në çdo ndërmarrje të tij.

Parullat e këtyre njerëzve përputhen krejtësisht me parullat e armiqve të popullit jashtë; ata bëjnë çdo gjë për të dobësuar, për të dëmtuar, për të penguar. Këta njerëz po demaskohen dita-ditës dhe përpjekjet e tyre djallëzore eliminohen që në vezë. Eliminimi i tyre forcon Frontin, zgjeron Frontin, forcon veprën ndërtimitare të popullit, forcon demokracinë dhe shtetin tonë. Politika e Frontit Demokratik, në lidhje me situatën e brendshme dhe që konsiston në një politikë të shumanshme dhe të koordinuar mirë me të gjitha veprimtaritë e sektorëve të ndryshëm të aktivitetit shoqëror dhe ekonomik në vendin tonë, duhet të jetë e tillë që të prekë të gjitha masat e popullit dhe këto t'i vërë në lëvizje, t'i bëjë të ndërgjegjshme, të koordinojë punët e tyre, të kanalizojë dhe të sistemojë energjitë e këtyre masave dhe t'i edukojë politikisht me vijën e tij të drejtë. Çështja e edukimit dhe e sqarimit të masave ka rëndësi shumë të madhe. Këtu konsiston roli kryesor i Frontit. Fronti duhet të tregohet aktiv në luftën kundër parullave të disa klerikëve, agallarëve dhe bejlerëve në lidhje me reformën agrare. Zbatimi i reformës agrare te ne ka qenë një nga veprat më të mëdha të pushtetit tonë popullor. Kjo reformë është duke u zbatuar me sukses. Fshatari shqiptar tani është zot përgjithmonë i tokës që punon. Ky është shpërblimi më i madh për të. Frontit në zbatimin e kësaj reforme ju desh të zhvillonte një aktivitet të gjerë, të mobilizonte gjithë fshatarësinë dhe popullin rreth këtij interesit të madh të tij, në mënyrë që reforma të zbatohej shpejt dhe drejt. Këtu u panë përpjekjet e bejlerëve dhe të agallarëve si edhe tentativat e klerikëve katolikë që ta ngadalësonin ose ta pengonin këtë reformë kaq popullore.

Klerikët në fjalë dhe çifliksahibinjtë, si gjithmonë kordinonin veprimet për të dëmtuar interesat e popullit. Nën parullat e kishës dhe të zotit ata fshihnin veprimtarinë e tyre kriminale, duke u thënë fshatarëve të mos e marrin tokën, se ajo «s'është e tyre», se «toka është e zotit» dhe se «zoti do t'i mallkojë» e të tjera gjëra të tilla. Kjo është një gjë, por nën parullat e kishës dhe të zotit ata kanë preqatitur akte kriminale kundër regjimit, dhe popullit, ata kanë marrë në qafë edhe disa njerëz të thjeshtë dhe injorantë. Gjyqet e popullit ju kanë dhënë dënimin e merituar këtyre njerëzve. Fronti ka një politikë ndaj fesë dhe kjo është në përputhje me ligjet dhe me nejet e Statutit të Republikës Popullore. Ne as ndalojmë dhe as pengojmë njeri që të besojë zotin dhe të shkojë në kishë e në xhami të falet. Prifti ose hoxha kanë të drejtë të bëjnë në faltoret shërbimet fetare dhe vetëm fetare. Por që kisha ose xhamia të përdoren si vende, ku bëhet politikë për të mashtruar besimtarët, kjo është kundër ligjit. Prifti ose hoxha, të cilët janë qytetarë si gjithë qytetarët e tjerë të Shqipërisë janë të lirë të kenë opinionet e tyre politike, por janë përgjegjës për aktet e tyre politike, sikundër janë përgjegjës të gjithë nënshtetasit e Republikës. Funksioni i tyre fetar me bindjet e tyre politike dhe me personin janë dy gjëra të veçanta dhe që s'duhet të konfondohen. Çdo njeri që shkel ligjet e Republikës duhet të japë llogari përpëra gjyqit, qoftë ky prift, hoxhë ose laik. Dënim i merituar i një prifti ose hoxhe që ka shkelur ligjet, s'do të thotë aspak se luftohet besimi ose persekutohet kisha. Shumë priftërinj katolikë kanë vepruar në këtë mënyrë për të fshehur veprimtarinë e tyre

kriminale kundër popullit; ata edhe kushdo tjetër duhet të dinë se ne jemi në dijeni dhe i kuqtojmë mirë manevrat e tyre kundër popullit dhe kemi marrë masa dhe do të marrim në qoftë se nuk ecin drejt.

Situata ka nxjerrë sot përpara shtetit problemin e arësimit dhe të kulturës si një problem me shumë rëndësi për përparimin e vendit tonë dhe për rindërtimin e Shqipërisë së re. Ky problem bëhet akoma më i madh kur kemi parasysh prapambetjen kulturale arësimore që trashëgojmë nga e kaluara dhe detyrat e mëdha dhe të zorshme që na vihen sot përpara për forcimin e shtetit. Unë besoj se është e qartë për të gjithë se kjo nuk është një çështje e thjeshtë arësimore ose administrative, por këtu jemi përpara një problemi të madh politik që ka lidhje me të ardhmen tonë si komb dhe si shtet. Ndërtimi i Shqipërisë së re nuk mund të bëhet me njerëz analfabetë, por ka nevojë për njerëz të ditur e të aftë me drejtue degët e ndryshme të ekonomisë dhe të të gjithë jetës së vendit. Gjithë Fronti, pra, duhet të vihet përpara këtij problemi të madh dhe të rëndësishëm dhe t'i vijë në ndihmë shtetit për zgjidhjen e drejtë e në një kohë sa më të shkurtër të këtij problemi të rëndësishëm. Shkolla jonë dhe kultura përgjithësisht duhet të zhvillohen në baza shkencore dhe të pastrohen nga të gjitha ideologjité reaksionare që gjenden në kundërshtim flagrant me principet e mëdha që dualën nga lëvizja nacional-çlirimtare, që udhëheqin sot Frontin tonë dhe Republikën Popullore. Edukimi i brezave të rinj, kultura dhe riedukimi i masave të popullit na vënë sot përpara përgjegjësive të mëdha, prandaj qeveria ka në plan të parë që t'i japë më shumë arësim dhe kulturë popullit tonë.

Pa dyshim këtu ka shumë vështirësi, por ndihma e Frontit do të jetë shumë e madhe dhe vendimtare. Duhet me mobilizue popullin për ngritjen e shkollave në të gjitha anët e Shqipërisë e sidomos në krahinat e Veriut, por duhet të bëjmë njëkohësisht çdo gjë që populli ynë ta quajë të domosdoshme nevojën e ngritjes arësimore dhe të zhvillohet kështu dëshira dhe nevoja me mësue. Rreth këtij problemi Fronti duhet të sqarojë masat e gjera të popullit e sidomos ato të Veriut, që janë më prapa nga pikëpamja e shkollave dhe ku numri i analfabetëve është tepër i madh, pse ata kanë qenë tërë kohën të shtypur nën thundrën e feudalëve dhe të bajraktarëve. Në Shqipërinë e re të gjithë të rinjtë duhet të venë në shkolla. Çështja e dërgimit të vajzave në shkolla duhet të merret si një problem serioz dhe i rëndësishëm. Shumë klerikë e sidomos nga ata të Veriut dhe disa njerëz prapanikë përpiken të pengojnë vajtjen e vajzave në shkollë. Qëllimi i tyre s'do shpjegim, por ne ju themi atyre njerëzve se një akt i tillë formon një krim të rëndë kundër përparrimit të popullit dhe se ata që do të guxojnë ta vazhdojnë këtë propagandë, shpejt do të pendohen. Fronti në këtë drejtim do të luajë dhe një rol tjetër me rëndësi, që është preqatitja politike dhe ideologjike e mësuesve duke bërë me ta një punë të madhe sqaruese me shtyp, konferanca e të tjera, për t'i bërë këta të denjë për misionin e lartë që u ka ngarkuar shteti në edukimin e brezit të ri, e ardhmja e lulëzuar e vendit.

Në historinë e vendit tonë nuk ka pasë kurrë ndonjëherë një organizim politik kaq të fortë si është ky i Frontit ku populli ynë ka grumbulluar të gjitha energjitet e tija për rindërtimin e Shqipërisë së re. Si dje në luftë,

ashtu edhe sot Fronti është bërë shprehja politike e përpjekjeve të popullit tonë për të krijuar një të ardhme më të mirë dhe të sigurt. Pas shpalljes së Shqipërisë Republikë Popullore dhe aprovimit të Statutit, detyra të reja dhe të rënda u vunë përpara organizatës së Frontit, pse për popullin tonë u hapën rrugë dhe perspektiva të reja që të çonin drejt forcimit të shtetit dhe rindërtimit të një jete më të mirë për të gjithë. Edhe kësaj here Fronti i udhëhoqi masat e popullit, i bashkoi dhe i futi në një rrugë që është shpëtimi i popullit tonë, në rrugën e rindërtimit ekonomik dhe në organizimin e jetës sonë të brendshme në bazë të Statutit të Republikës. Karakteristika më e shquar e Frontit ka qenë aktiviteti i tij i gjallë dhe i paprerë në mobilizimin e masave për kryerjen e detyrave konkrete që na janë vënë në situata të ndryshme. Asnjëherë vendi ynë nuk ka parë një entuziazëm dhe një vullnet kaq të madh të popullit për të shkuar përpara. Mobilizimi i masave të gjera të fshatit dhe të qytetit, që u bë me sukses pas thirrjes që bëri Komiteti Ekzekutiv i Frontit për rindërtimin e vendit në bazë garash, është shprehja më e gjallë e këtij entuziazmi dhe e këtij vullneti që ka sot populli ynë. Kjo është bërë sot një forcë materiale që e shtyn vendin tonë përpara dhe na bën të mendojmë se në ç'mënyrë e me ç'forma duhet t'i organizojmë më mirë dhe t'i drejtojmë më mirë këto forca të gjalla që japid kaq garanci për të ardhmen e sigurt të vendit tonë. Është e natyrshme që këto forma dhe këto mënyra duhet të janë të tilla që të na bëjnë të arrijmë më shumë rezultate në punën tonë të rindërtimit, që të aktivizojmë akoma më shumë masa të fshatit dhe të qytetit dhe të bëjmë që forcat tona t'i

drejtojmë në të gjitha fushat e veprimtarisë, të cilat, në tërësinë e tyre, e forcojnë pozitën e demokracisë në vendin tonë, duke forcuar kështu fuqinë e shtetit tonë. Sot pra kërkohen dy gjëra prej Frontit: të bashkojë popullin të tërë rrëth një platforme politike të përbashkët dhe të bëhet gjithashtu iniciatori i punës dhe i aktivitetit, i organizimit dhe i stilit të ri në punë për me çue vendin tonë përpara. Sot format dhe mënyrat e organizimit duhet të vlejnë për këtë qëllim dhe është detyra jonë ta orientojmë punën në këtë drejtim. Në qoftë se pranojmë këtë, atëhere unë mendoj se është e qartë se këshillave në bazë, në fshat, në punëtori, në zyrë dhe kudo, d.m.th. aty ku punohet dhe jetohet së bashku, dhe këshillave të nënprefekturave dhe prefekturave u bie barra më e madhe për kryerjen e këtyre detyrave. Pra duhet të forcojmë dhe të konkretizojmë edhe më shumë Frontin, duhet të bëhen më të forta bashkimi i brendshëm dhe fuqia e tij organizuese, duhet të forcohen këshillat, pse detyrat që na janë vënë përpara dhe ato që do të na vihen në çdo moment, kërkojnë zgjidhje dhe presin nga ne dhe vetëm nga ne. Punojmë në kondita të përgjithshme të vështira si nga ana ekonomike, ashtu edhe financiare; ky është trashëgimi i luftës dhe këtë të gjithë duhet ta kenë parasysh. Me këtë dua të them se sakrificat dhe privacionet janë kurdoherë në rendin e ditës. Por megjithatë unë jam i mendimit se situata ekonomike e vendit tonë në përgjithësi është përmirësuar dhe kjo i detyrohet kryesisht punës së palodhur të popullit dhe të pushtetit që kanë kuptuar rolin e tyre, që vënë vullnetin më të madh për t'i kapërcyer pengesat. Unë jam optimist dhe i sigurt edhe për një gjë tjetër,

se paskëtaj, duke parë se punët kanë hyrë në rrugë të mbarë, situata do të shkojë dita-ditës duke u përmirësuar.

Programi i shpallur prej qeverisë sonë parashikonte zgjidhjen e shumë problemeve të rëndësishme për jetën e vendit dhe këto probleme do të zgjidheshin në kondita financiare të vështira. Por programi do të mbështetet gjithashtu në iniciativën e masave, në punën e saj vullnetare, në kursimet në punë etj. Mund të themi se në shumë çështje rezultatet janë të kënaqshme. Reforma agrare gati po merr fund në gjithë Shqipërinë dhe kjo reformë e madhe, kaq e dëshiruar nga populli ynë dha rezultate dhe bëri efektet që priteshin. Fshatari forcoi besimin në punën e tij dhe problemi bujqësor mori një aspekt krejt të ndryshëm. Sivjet u punuan më shumë toka dhe më mirë.

Konditat atmosferike të këtij viti nuk kanë qenë të favorshme për bujqësinë e si pasojë vjelja e misrit ishte e dobët. Megjithatë, ne nuk i trembemi dimrit, sepse populli dhe qeveria do të marrin të gjitha masat që të mos mungojë buka në sofër. Lidhur ngushtë me problemin bujqësor ishte edhe problemi i blegtorisë. Në këtë sektor mund të themi me siguri që kemi pasur përmirësimë të dukshme dhe sidomos në bagëtitë e vogla, të cilat janë shtuar dhe përmirësuar. Bujqësisë dhe blegtorisë duhet t'u vëmë kujdes të veçantë, pse këtej dalin burimet kryesore që formojnë pasurinë e vendit tonë. Tokën tonë jo vetëm që duhet ta punojmë mirë, jo vetëm që duhet të inkurajojmë kultivimin e bimëve të reja, por duhet njëkohësisht që këto prodhime të mos ngelin më në fatin e konditave atmosferike. Me këtë dua të them që, tok me programin e sivjetëm të kanalizimeve,

të inkurajohet hapja e kanaleve nga vetë fshatarët. Problemi i bonifikimeve do të jetë në rendin e ditës të programit tonë të ardhshëm. Por me hapjen e tokave të reja buke, të nevojshme për të siguruar bukën tonë të viti, duhet të kemi kujdesin më të madh për kullotat. Prandaj të inkurajohet pastrimi i tokave për kullota dhe njëkohësisht të merren masa për perfektionimin e racës së kafshëve tona dhe për perfektionimin e prodhimit tonë bujqësor.

Punime të rëndësishme po kryhen në vendin tonë dhe këto mund të themi se kanë sukses dhe po mbahen më të shumtata e premtiveve. Kudo po punohet me vrull, në rrugën e rinisë, në tharjen e Maliqit, në Kanalin e Jubës, ku punimet u mbaruan para afatit të caktuar. Jemi duke punuar në kanalin e Elbasanit e të Vlorës¹, po punohet në Jug për hapjen e disa rrugëve të reja që parashikohen në programin tonë, po ndërtohen shkolla të reja me plan, numri i të cilave arrin në 400, po ndërtohen shumë shtëpi të fshatrave të djegura nga lufta, po ndërtohen spitale.

Në minierat tona të serës, të bakrit si dhe në puset e vajgurit po punohet me energjinë më të madhe; punëtoria në këto miniera dhe sidomos në puset e Kuçovës po organizohet dhe po bëhet e ndërgjegjshme për detyrat e mëdha që i ka besuar populli. Lavdërimë të veçanta meritojnë punëtorët e kantiereve të Kuçovës, të cilët po bëhen shembull për gjithë punëtorët e Shqipërisë, për ndjenjën e lartë të organizimit, për ndërgjegjen në punë,

¹ Është fjalë për kanalin vaditës të Hajdaranit në Elbasan që mori emrin «Naum Panxhi» dhe për kanalin vaditës Penkovë-Llakatund në Vlorë.

për disiplinën e çelniktë. Ata e kanë kuptuar se në atë mënyrë i shërbehet atdheut, se në atë mënyrë do të përparojë populli ynë dhe do të lulëzojë vendi. Të gjithë të marrin shembull andej. Nuk mund të lë pa kujtuar këtu dhe punëtorët e fabrikës së çimentos të Shkodrës, të cilët duhet të merren si shembull për punën e tyre të ndërgjegjshme, ashtu si mund të bëjnë punëtorët e vërtetë. Industria jonë e lehtë është mëkëmbur dhe jep një rendiment të kënaqshëm. Fabrikat e vajit, të sapunit, të cigareve, distileritë e ndryshme po prodhojnë dhe po përmirësojnë cilësinë. Shumë dyqane të shtetit në prefektura dhe në nënprefektura janë çelur dhe furnizojnë popullin me plaçka të ndryshme. Në lidhje me sektorin ekonomik u muarën shumë masa të rëndësishme dhe të nevojshme. Këto masa kanë pasur për qëllim forcimin e sektorit të shtetit dhc përmirësimin e gjendjes ekonomike të popullit, normalizimin e tregut dhe luftimin e spekulimit dhe të tregut të zi. Për të gjitha këto masa populli duhet të jetë i mobilizuar pse këto merren në fryshtë e tij dhe në interesin e tij. Me këto masa populli do të shohë përmirësimë dhe do të mënjanohen sikundërqëjanë mënjanuar shumë situata të vështira për popullin. Fronti duhet të luftojë çdo disfatzëm dhe moskënaqësi në lidhje me situatën tonë ekonomike, duke dhënë sqarime dhe duke qëlluar ku duhet, që kështu të mos shkaktohen dezorientime. Kemi kapërcyer situata ekonomike të vështira, do të kemi edhe vështirësi të tjera dhe që të mund t'i kapërcejmë duhet të bëjmë kursime dhe privacione. Populli duhet të kuptojë mirë se privacionet dhë kursimet bëhen për të preqatitur një situatëmë të mirë, e cila nuk do të vonojë shumë.

Për realizimin e programit tonë na është dashur t'i vëmë kujdesin kryesor forcimit të pushtetit, i cili sa më i fortë, sa më i perfekcionuar të jetë, aq më me lehtësi i zgjidh problemet që i vihen përpara. Administrata e shtetit ka bërë përparime, por përsëri nuk mund të themi se kemi arritur në rezultatet e dëshiruara. Pre-gatitja e kuadrove për ne, cdukimi i tyre me teknikën e duhur dhe pajisjen e tyre me fryshten e re dhe me një stil dhe metodë të ndryshme nga ajo e vjetra në punë, duhet të jetë një nga preokupacionet më kryesore të Frontit dhe të pushtetit.

Ka pasë edhe të meta në punën tonë, këto do të jetë gabim t'i fshehësh dhe të mos i kritikosh e goditësh fort ku duhet për t'i korrigjuar dhe për t'i ndrequr. S'duhet të kemi frikë nga kritikat e shëndosha, ato na forcojnë dhe nuk na dobësojnë. Pushteti ynë popullor buron nga populli dhe i përket popullit. Pra në këshillat popullore duhet të vijnë njerëzit më të mirë të popullit, më të dashurit, më aktivët. Këto këshilla janë përgjegjëse për punën e tyre përpara zgjedhësve të tyre, domethënë përpara atij populli që i ka zgjedhur. Në shumë krahina sidomos në nënprefektura dhe prefektura, ky parim i madh në disa raste neglizohet. Fronti duhet të ngrejë zérin për këtë çështje, se është një çështje me rëndësi të madhe parimore. Po të mos vihet në vend ky parim, po të mos aplikohet me rigorozitetin më të madh, atëhere ne s'kemi pushtet të popullit dhe çdo gjë do të ecë prapa. Populli dhe Fronti, haptas në mbledhje të gjera, të kritikojnë ato këshilla dhe ata njerëz që veprojnë ndryshe. Këtu s'lejohen lëshime se këtej kanë burimin shumë të këqia.

Ka akoma në aparatet tona burokratizëm, frysë e vjetër pune, neglizhencë nga disa njerëz jo të ndërgjegjshëm, që funksionin e tyre që u ngarkohet e marrin vetëm nga ana e sigurimit të rrogës personale, pa detyrën le ta marrë lumi, populli dhe hallexhiu le të presë ditë e javë me radhë te dera e zyrës; ka akoma në aparatin tonë të shtetit nga ata njerëz të vjetër që s'kanë iniciativë aspak, që kërkojnë shumë nga të tjerët, por s'japin asgjë ose fare pak nga vëtja e tyre; ka njerëz që nuk sillen mirë me publikun; në shumë raste, ka mungesë organizimi dhe discipline në punë. Të gjitha këto e shumë të tjera janë të meta që organizata e Frontit duhet t'i luftojë sistematikisht, për t'i përmirësuar njerëzit ose për t'i mënjanuar kur ata janë të pakorrigjueshëm.

Por ka njerëz, dhe këta janë armiq të popullit dhe të pushtetit, kritika e të cilëve p.sh. nuk rreh te gabimi ose e meta e atij shitësit të dyqanit të shtetit, por te ngritja e sektorit të dyqanit të shtetit. Pak punë prish për këta njerëz se një shitës i dyqanit të shtetit nuk ju suall mirë një klienti (sjellje që duhet të korrigohet dhe të merren masa kur përsëritet). Kjo gjë mund t'i ngjiste edhe në një dyqan privat, por ajo që u djeg këtyre zotërinjve dhe që përpiken me çdo mjet t'i luftojnë, janë vetëm dyqanet e shtetit. Kështu ngjet dhe për shumë gjëra të tjera. Këta njerëz luftojnë reformat tona të mëdha, realizimet tona të shëndosha, duke marrë si pretekst gabimet që mund të bëhen dhe bëhen dhe që duhet të rrimë me çekan mbi kokë për t'i korrigjuar. Këta zotërinj të «zgjuar» dhe kritizerë të sëmurë i aku zojnë njerëzit tanë për mungesë eksperience. Kjo mund të jetë e vërtetë, por kur vullneti është i madh, kur bes-

nikëria ndaj popullit është e madhe, kur besimi në forcat e veta dhe në forcat e popullit është i patundur, eksperiencia fitohet në punë. Vetëm këtyre zotërinjve ju themi një gjë, që edhe kështu si janë, njerëzit tanë kanë një eksperiencë më të madhe nga ata dhe kjo me prova dhe jo me fjalë. Provat janë realizimet e mrekullueshme që arrijmë në çdo lëmë aktiviteti dhe që ata kritizerë të sëmurë nuk do t'i bënin as për njëzet vjet. Eksperienca e njerëzve tanë, që rritet dita-ditës është konstruktive, kurse e tyrja është destruktive. Ata kanë ditur dhe dinë të vjedhin, të grabitin, të sabotojnë, por njerëzit e Shqipërisë së re me sigurinë më të madhe nuk do t'u lënë më fushë të lirë që ta vënë në zbatim «eksperiencën e tyre».

Për realizimin e punëve të pushtetit dhe në përbushjen e programit të punimeve është çuar peshë populli i tërë. Ç'e shtyn gjithë këtë forcë të shkojë me kaq vrull përpara, me kaq besim të patundur, drejt rrugës së përparimit? Përgjegjja është e thjeshtë. Një grua plakë kurveleshase, me tumane e me shami të zezë, që sigurisht një ose dy djemtë e saj kishin rënë në fushën e nderit për çlirim e atdheut, gërmonte me kazëm hendedekun e rrugës publike dhe e dëgjoja që këndonte: «Ndërtoj Shqipërinë e re, ndërtoj shtëpinë time». Ja forca që e shtyn popullin tonë përpara. Lavdi popullit tonë punëtor!

Shihni ç'po bën rinia jonë heroike. Ajo që ishte në radhët e para të zjarrit të luftës që në fillimin e luftës dhe deri në mbarim, ajo që vritej për atdheun me gjoksin përpara dhe me këngë në gojë, ajo sot me vrull po rindërtton atdheun. Aksioni i saj i madh po merr fund në

ditën e caktuar, bile edhe më parë¹. Ky aksion i saj s'është as i pari as i fundit. Në flamurin e saj të fitoreve do të shkruhet me ar mirënjojja e popullit të tërë. Lojnat Ballkanike që po zhvillohen sot në Tiranë dhe që kanë jo vetëm një karakter të madh sportiv, por përfaqësojnë edhe vëllazërimin dhe miqësinë e popujve të Ballkanit, janë vepra e rinisë. Kongresi i saj i tretë që do të mbahet në Tiranë javën që vjen, s'do të jetë vetëm kongresi i rinisë, por kongresi i gjithë popullit shqiptar. Të vëmë të gjitha energjitet për ta forcuar rininë tonë, për ta edukuar rininë tonë, për t'ja bërë jetën të lumtur rinisë sonë, pse kështu kemi forcuar Shqipërinë.

Shihni sa vullnet kanë gratë e Shqipërisë, ato kanë etje për punë, për kulturë, ato kanë vënë gjithë forcat e tyre që janë të konsiderueshme në rindërtimin e vendit. Ku ishte parë që gruaja, ajo që s'dilte as te praku i derës, të dalë vullnetarisht dhe të punojë në rrugë? Gruaja jonë, tërëjeta e së cilës ishte një burg, mori pushkën, luftoi dhe shkëputi prangat. Ajo është një forcë e madhe përparimtare që po ecën përpara. T'i japim dorën, t'i japim ndihmën më të madhie, ky është interesi i atdheut.

Sindikatat që grumbullojnë në gjirin e tyre gati gjithë punëtorinë e vendit tonë, po bëhen një nga mbësh-tetjet kryesore të pushtetit tonë. Ato po organizohen dhe forcohen dita-ditës, kjo do të thotë se punëtoria jonë po bëhet faktori kryesor i jetës së vendit, i të ardhmes së lumtur të vendit.

Fronti ynë Demokratik me politikën e tij të qartë

¹ Është fjala për aksionin e rinisë, rrugën Kukës-Peshkopi.

dhe me organizatat e shëndosha të masave që ka në gjirin e vet dhe që përbëjnë qëndrueshmërinë dhe forcën e tij, është një realitet i shëndoshë. Fronti ynë është kështu jo vetëm si një organizatë politike e gjerë e masave, por edhe një organizuese e shëndoshë. Kështu është realiteti dhe kështu duhet ta kuptojë i gjithë populli organizatën e tij të madhe politike, kështu duhet ta kuptojnë të gjithë politikën e drejtë dhe ndërtimtare që bën Fronti.

Në politikën e jashtme Fronti Demokratik dhc qeveria ashtu si edhe Fronti Nacional-Çlirimtar gjatë luftës, kanë pasur gjithë kohën një qëndrim të drejtë përparimtar dhe konsekuent në rrugën e demokracisë së vërtetë. Kjo politikë kishte për qëllim të forcoheshin pozitat e Shqipërisë në botën e jashtme, të forcoheshin marrëdhënjet dhe miqësia me kombet aleate dhe miq dhe të ruheshin interesat e vendit tonë. Politika jonë e jashtme nuk mund t'u përngaiste manevrave dhe politikës aventuriere të një regjimi si ai i Zogut dhe i të gjithë rretheve reaksionare dhe tradhëtare të vendit tonë që, në bazë të çdo marrëveshjeje ndërkontaktare, ata vinin në mezat interesat jetike të popullit dhe të atdheut, duke shitur vendin dhe pasuritë e tij te i huaji, për të mbushur xhepet e tyre dhe për të mbajtur popullin nën zgjedhë e nën terror.

Me luftën e tij populli shqiptar ndiqte një rrugë të përcaktuar, të diktuar nga zhvillimi historik i jetës së tij si edhe nga rrethanat ndërkontaktare që zhvilloheshin në botë, ku ai jetonte si komb dhe si shtet. I kërcenuar në ekzistencën e vet nga fashizmi agresor, populli ynë u hodh në luftë, për t'u çliruar nga zgjedha e okupatorit

dhe e tradhëtarëve të vendit dhe për të marrë fuqinë në dorën e tij. Lufta pra ishte e ashpër, për jetë a për vdekje, sepse masat e gjera të popullit tonë, që luftonin për të fituar lirinë dhe pavarësinë, kishin përballë përvëç okupatorit të huaj fashist edhe klasat sunduese me klikat reaksionare feudale dhe borgjezinë pasanike me politikanët aventurierë të saj të shitur kokë e këmbë te paraja e huaj dhe të mbështetur që të gjithë te fashizmi okupator. Në një luftë të tillë të pamëshirshme, të vësh-tirë, por vendimtare, u shquan meritat e popullit tonë, i cili diti ta zgjidhë këtë problem vital, të kalojë nëpërmes furtunash, të kapërcejë pengesat, të mposhtë armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm dhe të marrë fuqinë në dorë.

Populli ynë sikundër e thashë edhe më lart jetonte si komb edhe si shtet brenda rrethanave dhe ngjarjeve ndërkombëtare dhe veprimtaria e tij në luftë ishte e lidhur ngushtë me veprimtarinë e gjithë popujve për-parimtarë antifashistë që ishin çuar me armë në dorë kundër të njëjtët armik. Nga qëndrimi i popullit tonë, pra, kundrejt agresionit fashist, varej fati i vendit. Këtë qëndrim populli ynë e mori që në ditët e para të invadimit. Lufta heroike e tij kundër fashizmit italo-gjermanështë hapi i parë i lavdishëm i popullit tonë në politikën ndërkombëtare. Kjo ishte baza e sigurt e fitoreve tona dhe guri themeltar i politikës së jashtme të lëvizjes nacional-çlirimtare, mbi të cilën eci dhe do të ecë Republika jonë Popullore. Si rrjedhim logjik i këtij akti të madh, populli ynë u rreshtua me vendosmëri në kampin e aleatëve dhe aleanca antifashiste ishte bazë e politikës së jashtme ku mbështetëm luftën tonë dhe fitoren tonë. I qëndruam besnik deri në fund kësaj aleance, luftuam

deri në fund kundër fashizmit; me mijëra nga njerëzit tanë më të mirë ranë heroikisht duke luftuar për popullin e tyre dhe për kauzën e përbashkët aleate.

Karakteri i luftës sonë çlirimtare, ashpërsia me të cilën ajo u zhvillua deri në fund, pa marrë parasysh humbjet dhe sakrificat në njerëz dhe në material, e vunë popullin shqiptar në pararojë dhe në radhën e atyre popujve përparimtarë që shihnin në zhdukjen dhe çrrënjosjen e fashizmit, shpëtimin e botës dhe të njerëzimit, vëllazërimin e popujve, ndërtimin e një paqeje të drejtë e të vazhdueshme dhe forcimin e demokracisë. Bota e qytetëruar pa se ç'mund të bëjë një popull i vogël si yni kur ai ka vendosur të rrojë i lirë dhe të vetëqeveriset. Për përpjekjet dhe heroizmat e popullit tonë kanë folur përfaqësuesit e aleatëve, Mollo Sovi, Hulli, Ideni, Çërcilli, e shumë të tjerë. Radiot, shtypi, etj. kanë folur me simpati dhe me admirim për luftën mbinjerëzore që bënин shqiptarët. Populli shqiptar ishte një pjesëtar aktiv dhe i shëndoshë i blokut antifashist, që dha pa kursyer kontributin e tij për zhdukjen e fashizmit dhe që duhej të përkrahej deri në fund dhe të nderohej prej të gjithë atyre shteteve me të cilët ai luftoi krah për krah. Lufta, vuajtjet, përpjekjet e përbashkëta na bënë të njohim mirë miqtë dhe armiqtë, të forcojmë solidaritetin me të parët dhe të luftojmë pa mëshirë dhe deri në fund të dytët. Ankthi i luftës kishte mbërthyer gjithë popujt dhe dëshira e tyre e vetme ishte që lufta të mbaronte sa më parë dhe të shtypej fashizmi. Por zhdukja e fashizmit dhe mbarimi i luftës varesin nga vendosmëria dhe ashpërsia e luftës që do t'i bën Gjermanisë naziste popujt përparimtarë të botës. Mirën johja

e thellë e gjithë njerëzimit u detyrohet atyre popujve që derdhën gjakun pa kursyer, që bënë sakrificat më të mëdha, që u bënë pishtari i luftës çlirimtare dhe ku popujt panë mbështetjen më të sigurt e më të fortë në luftë dhe në ndërtimin e paqes pas fitores mbi Gjermaninë naziste. Në blokun e madh antifashist që kontribuoi për mposhtjen e fashizmit kush mund të mohojë rolin vendimtar dhe kryesor që luajti Bashkimi Sovjetik dhe ushtria e tij e lavdishme? Populli shqiptar, sikundër edhe gjithë popujt e tjerë të robëruar, kuptoi mirë se fati i botës vendosej në fushat e Rusisë. Fitoret e Ushtrisë së Kuqe sillnin me vete fitoren e njerëzimit përparrimtar dhe pra dashuria dhe miqësia për Bashkimin Sovjetik ishte kondita sine qua non për mposhtjen e fashizmit dhe për vendosjen e një paqeje të drejtë. Bashkimi Sovjetik u bë shtylla e çelniktë e blokut antifashist dhe bota pa në të, shpëtimtarin kryesor të njerëzimit nga murtaja fashiste dhe nga mjerimet që e mbulonin, pa mbrojtësin e drejtësisë dhe të popujve të vegjël, pa mbrojtësin e të drejtës së vetëvendosjes së popujve dhe të sigurisë në zhvillimin e një jete paqësore dhe të lumtur në kohën e pasluftës. Dashuria e popullit tonë për Bashkimin Sovjetik, për Ushtrinë e Kuqe, për udhëheqësin e tyre të madh Stalinin, ishte e rrënjosur thellë, ishte pa kufi. Në shpirtin revolucionar të popujve të Bashkimit Sovjetik, në luftën e tyre heroike dhe legjendare, në vendosmërinë dhe vetëmohimin që treguan në këtë luftë të ashpër e të përgjakshme ku mbajtën peshën më të rëndë në supet e tyre, në kuptimin e lartë të drejtësisë nga ana e njerëzve sovjetikë, qëndron forca e madhe tërheqëse e vendit të madh të socializmit, për

të cilin mbarë bota dhe veçanërisht populli ynë i vogël, i shtypur tërë jetën nën thundrën e imperialistëve të huaj dhe veglave të tyre të brendshme, s'mund të mos ushqejë një dashuri të pakufishme dhe një mirënjohje të thellë.

Një miqësi e tillë e singertë me popujt antifashistë dhe përparimtarë e bazuar në themele të shëndosha ishte e nevojshme, e domosdoshme për popullin tonë. Politika e Frontit Nacional-Çlirimtar i rihte pa pushim në këtë drejtim, duke pasur kurdoherë parasysh që një miqësi e tillë të ishte një mburojë dhe një mbështetje për vendin dhe jo të cënonte ose të dëmtonte interesat e popullit. Interesat e atdheut ishin të shenja dhe ato udhëhiqnin lëvizjen nacional-çlirimtare. Këto objektiva të popullit tonë gjatë Luftës nacional-çlirimtare, përsa i përket marrëdhënjeve miqësore me shtetet aleate dhe miq, u arritën dhe kjo në saje të politikës së drejtë të Frontit Nacional-Çlirimtar, që e udhëhoqi popullin tonë drejt fitores.

Gjatë periudhës së luftës populli ynë konstatoi shumë gjëra që s'ishin në rrugën e aleancës antifashiste nga ana e rretheve reaksionare anglo-amerikane, që orvateshin të përçanin blokun dhe të ngadalësonin luftën. Këto veprime të këtyre rretheve reaksionare kishin reperkusionet edhe te ne, ku me anë të shtypit, të radios, ose me anë agjentësh, ata orvateshin të shpëtonin tradhëtarët dhe kuislingët nga llumi ku kishin rënë kokë e këmbë, t'i rehabilitonin këta njerëz të shitur dhe të rimerrnin kështu pozitat e falimentuara të reaksionit të brendshëm shqiptar. Mirëpo këto orvatje ishin të kota dhe falimentuan, pse populli ynë ishte i vendosur deri në fund që

të mos linte më të ngjalleshin ata që e kishin shtypur dhe që shkaktuan këtë katastrofë të madhe që ishte Lufta e dytë botërore. Për një gjë të tillë s'guxon kush të ná bëjë kritikën më të vogël, pse mbulohet me turp dhe diskreditohet. Populli shqiptar u tregua i zoti ta luftojë fashizmin, të qëndrojë besnik deri në fund i aleancës antifashiste; ai ishte i zoti të rregullonte gjendjen e tij të brendshme, si t'i dukej më mirë dhe më e përshtatshme. Kjo ishte një e drejtë e pakontestuëshme e tij, populli ishte zot i fateve të veta dhe s'lejonte në asnjë mënyrë që të tjerët nga jashtë të ngatërrroheshin në punët e tij të brendshme. Dhe këtu politika jonë e jashtme përputhej me principet e mëdha të shpallura botërisht dhe që konsistonë në vetëvendosjen dhe vetëqeverisjen e popujve. Të gjitha këto, pra, tregojnë rrugën e qartë që ndoqi populli shqiptar. Këto vënë në dukje qartazi se populli shqiptar dhe pushteti që ai i dha vendit të tij kanë qenë dhe janë një faktor i fitores mbi fashizmin dhe një garanci e shëndoshë për vendosjen e një paqeje të drejtë dhe të vazhdueshme që do të shërbejë në rimëkëmbjen e botës së shkatërruar nga lufta, në vëllazërimin dhe në marrëdhënjet e mira të popujve të botës.

Lufta jonë nacional-çlirimtare, jo vetëm që çliroi vendin nga të huajt dhe nga tradhëtarët e brendshëm, por hapi rrugën e miqësisë me popujt fqinjë të Jugosllavisë së re. Miqësia dhe aleanca me Jugosllavinë s'është vepra e dy-tre njerëzve, por është vepra e popullit shqiptar dhe e popujve të Jugosllavisë dhe kjo u farkëtua në luftën e përbashkët. Në fushën e luftës i dhamë dorën shoqi-shoqit, sinqerisht, vëllazërisht.

Periudha e pasluftës, domethënë kjo që po kalojmë, është për popullin tonë një periudhë tjetër prove, e cila vë qartë përpëra syve të tij sa e drejtë ishte rruga jonë gjatë luftës, sa konsekuese dhe përparimtare ishin qëndrimet e tij me botën e jashtme aleate dhe mike. Nuk do të zgjatem këtu se ç'ndodhi në Shqipëri pas luftës, por do të theksoj vetëm se populli shqiptar, i cili u çlirua krejtësisht me forcat e veta, që dërgoi forcat e tija jashtë shtetit shqiptar, për ta vazhduar luftën kundër gjermanëve deri në fund, vendosi në vendin e tij regjimin populor, një demokraci të shëndoshë dhe përparimtare, ku fjalën e kishte populli dhe vetëm populli. Çdo gjë ishte në duart e popullit, i cili çdo vepër të tij që i kushtoi kaq vuajtje, kaq gjak e sanksionoi me ligj, me mënyrat dhe metodat e një demokracie nga më përparimtaret. Po me atë hov që bëri luftën, populli ynë ja filloi punës për të rindërtuar një jetë të re ku puna të zinte vendin e parë dhe të bëhesh një nder për të gjithë. Miqtë e vendit tonë, ata që i donin të mirën popullit shqiptar, gëzoheshin për këtë zhvillim të shpejtë dhe të drejtë që merrte vendi ynë në rrugën e demokracisë. Dhe këta miq të vyer të vendit tonë s'munguan të japid prova të njëpasnjëshme të besimit dhe të miqësisë kundrejt popullit tonë heroik dhe përparimtar. Njohja e Qeverisë Demokratike të Shqipërisë prej Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë ishte për ne një fitore dhe sodisfaksion plotësisht i merituar për popullin shqiptar. Populli shqiptar hyn zyrtarisht në familjen e kombeve aleate, me të cilët luftoi dhe u sakrifikuva aq shumë përkauzën e përbashkët. Rrethi i shteteve që njohën qeverinë shqiptare shtohet: Polonia, Çekoslovakia, Franca,

Bullgaria lidhën marrëdhënje diplomatike me ne. Asnjë prej këtyre shteteve nuk i vuri kondita njohjes së qeverisë sonë. S'kishte përse. Një populli heroik që luftoi kundër fashizmit që më 1939 e deri në fund, një populli që bëri kaq sakrifica dhe kaq heroizma në këtë luftë, një populli që i qëndroi besnik kauzës aleate, një populli që ju njohën lufta dhe sakrificat e tij zyrtarisht, duke mos munguar lavdërimet dhe inkurajimet, një populli që vendosi demokracinë dhe drejtësinë në vendin e tij, një populli që bëri çmos dhe ja arriti qëllimit: të forconte aleancën antifashiste dhe miqësinë me të gjithë pjesëtarët e blokut të madh antifashist, nuk i vihen kondita për njohjen e qeverisë së tij. Populli ynë është në dijeni që qeveritë angleze dhe amerikane vepruan ndryshe; ata vunë kondita për njohjen e qeverisë sonë. Siç është e natyrshme këto nuk u pranuan nga ana jonë. Konditat e vëna nga qeveria angleze vetëvetiu binin, pse karakteri i regjimit populor në Shqipëri, ligjet dhe vendimet si edhe aplikimi i tyre bëheshin dhe zbatohen në mënyrën më demokratike. Qeveria britanike njoftoi njohjen e qeverisë sonë, por ministri i saj fuqipotë, i caktuar për në Tiranë s'erdhi kurrë. Për ç'arësy? Dëshiroj të sqaroj opinionin shqiptar si dhe opinionin e jashtëm për këtë gjë, pse nuk dëshiroj që agjencitë e huaja të spekulojnë mbi këtë dhe t'i deformojnë faktet. Misioni ushtarak anglez, i akredituar pranë Shtabit të Përgjithshëm, me njohjen c qeverisë shqiptare nga ana e qeverisë angleze, i mbaroi funksionet e veta dhe u tërroq me dëshirën e plotë të Shtabit aleat të Mesdheut dhe të qeverisë angleze dhe s'është aspak e vërtetë që ishim ne që insistuam për ikjen e tij. Stabilizimi i marrë-

dhënjeve normale diplomatike sjell me vete dhe largimin e këtij misioni me karakter ushtarak. Në mënyrë reciproke u veprua dhe me misionin tonë ushtarak në Bari, i cili u tërroq. Për vonesën e ardhjes së ministrit britanik në Tiranë, qeveria angleze ngriti si pretekst se gjoja ne kishim penguar pjesëtarët e misionit ushtarak në punët e tyre si edhe në shetitjet e tyre përqark Shqipërisë dhe njëkohësisht i kishim dhënë urdhër të largohej nga Shqipëria një oficeri anglez që interesohej për varrezat e ushtarëve aviatorë anglezë të rënë gjatë luftës në tokën tonë. Për ne këto nuk përbëjnë aspak një arësyte të shëndoshë për të mos vendosur marrëdhënje normale me një shtet aleat, por megjithatë këto arësyte s'kanë asnë themel. Misioni ushtarak anglez ka pasur liri jo vetëm të qarkullojë rrreth Shqipërisë «për punën e tij» sikundër e cilësonin anëtarët e misionit, por anëtarët e misionit ushtarak anglez kanë qenë edhe për pikniqe e gjueti. Kurrë s'u ishte bërë ndonjë pengesë, bile kanë pasë shkuar dhe atje ku s'duhej dhe që s'hynte «në punët e tyre». Sa për oficerin e varrezave çështja s'ishte aspak sikundër e paraqet radio e Londrës për efektet e sajë propagandistike. Në fakt këtij oficeri ju akordua përsëri leja dhe kjo ka afro gjashë muaj. Ai as erdhi të kryente «misionin e tij» dhe as ka ndër mend që të vijë. Një gjë e tillë na forcon bindjén se s'ishte çështja e oficerit të varreve dhe e «misionit të tij», por çështja e këtij oficeri ishte një pretekst për mosardhjen e ministrit. Pas këtyre preteksteve, që s'mund të qëndronin në këmbë, dualën pretekste të tjera të po kësaj natyre për mosardhjen e ministrit anglez. Por edhe këto arësyte të tjera, që u vunë si pretekst

nga qeveria angleze, u sheshuan, u rregulluan dhe s'kishte asnjë farë pengese për vendosjen e marrëdhënjeve diplomatike. Por kush dëshiron të nxjerrë pengesa, mund të nxjerrë në çdo kohë. Çështja e anijeve angleze në Sarandë¹ u bë një pengesë e re. Faji s'është aspak i yni për atë ngjarje regrettable² po të analizohen rrethanat në të cilat ngjau. Anijet greke, me flamur dhe pa flamur, me dhjetëra herë dhe muaj me radhë, vinin në ujërat tona, afroheshin në bregdet, qëllonin me top, qëllonin me mitraloz, merrnin robër nënshtetas shqiptarë, grabitnin varka e bënин njëmijë provokacione të tilla. Pikërisht në këto kohëra, dy vaporë, pa flamurë, ishin në ujërat tona dhe drejtoheshin drejt portit të Sarandës. Bateritë tona japid shenjën e largimit dhe pastaj qëllojnë me disa të shtëna rreth e përqark. Kur anijet ngriten flamurin anglez, ishte tepër vonë. Kurrë nuk ishte në intensionin³ e komandës sonë bregdetare të qëllonte anijet e Britanisë së Madhe, por rregulli ndërkombëtar i detrave e lyp që të kërkohet leje më parë se të hyhet në ujërat territoriale të tjegrit, që të evitohen aksidente të tilla dhe sidomos kur grekërit provokacionet me anën e detit i kishin ngritur në sistem.

Të gjitha këto që tregova më lart dhe që paraqiteshin herë pas here prej qeverisë angleze si pretekst i mosvendosjes së marrëdhënjeve diplomatike, jo vetëm që s'ishin të shëndosha, që s'kishin baza, por kurdoherë

¹ Më 15 maj 1946 dy luftanije angleze, me qëllime të dukshme provokimi hynë në ujërat territoriale të Shqipërisë në afërsi të Sarandës.

² Regrettable (frëngj.) — për të ardhur keq.

³ Paramendimin.

qeveria jonë është treguar e gatshme t'i sqarojë, t'i zhdukë me një fryshtë të shëndoshë miqësie dhe mirëkuptimi.

Kondita që vuri qeveria amerikane për njohjen e qeverisë sonë, ishte pranimi i traktateve që ekzistonin para 1939-s ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara. Siç dihet, qeveria e Zogut kishte firmuar një seri traktatesh me shtete të ndryshme të huaja. Se ç'qëllime kishin më të shumtata e këtyre traktateve të Zogut, se ç'tregëti të poshtër kish bërë Zogu me anën e këtyre traktateve në kurrizin e popullit tonë, se ku e çuan vendin tonë këto traktate dhe marrëveshje të Zogut, më duket s'është nevoja t'jua numëroj. Ato na kushtuan gjakun dhe koskat e bijve tanë më të mirë. Populli shqiptar me plot të drejtë mori vendimin në Kongresin e Përmetit, i cili anulonte këto traktate dhe i jepte të drejtë qeverisë të shqyrtonte ato traktate që ishin në interesin e popullit shqiptar.

Vendimi i popullit që mori në Përmet ishte përgjegjja e qeverisë sonë që u dha amerikanëve. Interesat e popullit tonë mbi çdo gjë. Këtë të drejtë dhe detyrë të parës'mund të na e mohojë askush, ashtu sikundër dhe ne s'ua mohojmë të tjerëve. Me një komb mik, si kombi amerikan, ne kemi qenë kurdoherë të gatshëm për me u marrë vesh mbi këtë çështje. Vullneti i mirë nga ana jonë nuk ka munguar kurrë; ne kemi kërkuar që njohjes së qeverisë sonë, të mos i vihet konditë dhe me përfaqësuesin amerikan, që do të vinte në Tiranë, pas njohjes, ne ishim gati të merrnim menjëherë në shqyrtim traktatet në fjalë, t'u bënim ndryshimet e duhura, të krijuara nga rrethanat e kësaj Lufte të dytë botërore dhe në frymën e re ndërkombëtare që krijoi kjo luftë. Ne shkuam

edhe më tej për të treguar vullnetin e mirë të qeverisë në këtë çështje: ne pranuam vlefshmérinë e të gjitha traktateve me karakter ndërkombetar që ekzistojnë në mes Amerikës dhe nesh dhe sa për dy a tri traktatet e tjera me karakter bilateral, ne treguam gatishmérinë t'i merrnim menjëherë në shqyrtim, pasi të njihet qeveria jonë¹. Ky hap përpëra nga ana jonë ka kohë që është bërë, por qeveria amerikane nuk është përgjegjur.

Në dritën e këtyre fakteve konkrete dhe të pamohueshme, çdo njeri le të gjykojë sa i drejtë ka qenë qëndrimi ynë ndaj aleatëve anglo-amerikanë, sa të mëdha kanë qenë përpjekjet tona ku s'mungonte as dëshira, as vullneti për me forcue marrëdhënjet miqësore me popujt anglezë dhe amerikanë dhe sa të pajustifikuara dhe jo të drejta janë pengesat që na bëhen nga ana e tyre për lidhjet e marrëdhënjeve diplomatike, por sidomos për të drejtat tona të pamohueshme në gjithë forumet ndërkombe.

Populli shqiptar me luftën e tij heroike fitoi të drejta të padiskutueshme në lëmin ndërkombetar, fitoi po ato të drejta që fituan dhe të 21 kombet e tjera që u mblodhën në Paris për të diskutuar Traktatin e Paqes

¹ Traktatet me karakter ndërkombetar ishin lidhur me çështje që nuk preknin pavarësinë ekonomike e politike të Shqipërisë, prandaj dhe u njohën nga Qeveria Demokratike e Shqipërisë. Përsa u përket traktateve bilaterale të përfunduara midis Shqipërisë e SHBA, qeveria shqiptare tregoi gatishmérinë për t'i marrë në shqyrtim, po gjithnjë duke pasur si synim ndryshimin e përbajtjes së tyre, me qëllim që të bëheshin të pafuqishëm për cënimin e pavarësisë ekonomike dhe politike të vendit.

me Italinë dhe me satelitët e tjerë të Boshtit. Mohimi i të drejtave tona formon një padrejtësi të madhe dhe një shkelje flagrante të të drejtave të popujve të vegjël.

Populli shqiptar prej një periudhe të gjatë po asiston dhe po dëgjon me indinjatën më të madhe dhe me zemërim të thellë, të ngrihen në sistem shpifje të poshtëra kundër tij nga armiqtë e popullit shqiptar, të kurdisen fushata të turpshme që të kujtojnë kohën kur fashizmi ishte në kulmin e fuqisë së tij, të preqatiten dhe të bëhen me sistem provokacione me armë gjatë kufirit tonë të Jugut, të kërkohen tokat tona prej njerëzish që fashizmin e kanë në gjak, të mohohen të drejtat tona më elementare në mënyrë të turpshme dhe pa qenë të zot t'i argumentojnë me arësyetimin qoftë edhe më të vogël. E gjithë kjo fushatë është vepra e atyre që përpinqen me çdo kusht të sabotojnë paqen dhe të hedhin botën në një përleshje tjetër të përgjakshme. Por të gjitha këto përpjekje djallëzore do t'u dështojnë, sepse forcat përparimtare në botë janë në gjendje t'i bëjnë të falimentojnë me turp të gjitha këto orvatje. Sot më tepër se kurrë duhet që këto forca përparimtare të shtrëngojnë radhët e tyre, të forcojnë bashkimin dhe miqësinë, e vetmja armë për të përballuar manevrat e bujshme të reaksionit. Kësaj fushate shpifjesh dhe provokacionesh populli shqiptar i bën ballë me kryet lart, më i fortë se kurrë, më i nderuar dhe më i respektuar se kurrë. Të drejtat e tija dhe rruga e tij e drejtë, që ai i mbron me krenari dhe me guxim, e bëjnë popullin tonë një nga luftëtarët e papërkulur të demokracisë dhe të paqes. Në këtë mes populli ynë pa gjithashtu si mbroheshin të drejtat e tija nga miqtë dhe aleatët e tij të singertë e të shtrenjtë.

Cilat janë të drejtat tona, që duhet të na njihen dhe të na jepen? Këto populli ynë i ka kërkuar dhe do t'i kërkojë me këmbëngulje. Zëri i fuqishëm i popullit tonë shumë herë është ngritur për pjesëmarrjen tonë si anëtarë efektivë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. E zjarrtë ka qenë mbrojtja në Këshillin e Sigurimit nga ana e delegacionit sovjetik, po ashtu ka qenë dhe ajo e delegacionit jugosllav dhe polonez. Këtë e di populli ynë. Me shumicë votash, ne u pranuam si anëtarë të OKB-së nga Këshilli i Sigurimit, por Amerika dhe Anglia vunë veton, pa asnjë arësyte të shëndoshë. Populli shqiptar dhe gjithë bota e sheh që kjo është një padrejtësi që i bëhet një populli të vogël që sakrifikoi kaq shumë në luftën antifashiste; populli ynë hidhërohet dhe ca më tepër kur shikon se ai vihet në një radhë me Portugalinë që ka qenë dhe është një çerdhe e atyre që kanë ndihmuar dhe ndihmojnë fashizmin. Por e drejta jonë do të dalë në shesh dhe populli ynë do të shkojë në OKB pse këtë të drejtë e ka fituar me gjak.

Dua t'ju flas pak për Konferencën e Paqes dhe vendimet e saj në lidhje me Shqipërinë. Në Konferencën e Parisit përveç të tjerave, do të diskutohej Traktati i Paqes me Italinë. Në këtë konferencë të lartë pra, Shqipëria duhej të merrte pjesë si anëtarë efektive me të drejta të barabarta si të 21 kombet e tjera fituese. Arësyet tona kanë qenë shumë të shëndosha dhe vetëm mekanizma e votës në konferencë mundi t'i rrëzonte, duke mbajtur ison e pretendimeve të poshtra greke. Dhe këshfu ngjau. Me anë votash kërkesa jonë e drejtë u hodh poshtë, me gjithë mbrojtjen magjistrale të miqve të shquar të popullit shqiptar. Ne u thirrëm vetëm të shfaq-

nim pikëpamjen tonë në lidhje me Traktatin me Italinë si në mbledhjen plenare, ashtu edhe në komisionet e ndryshme ku do të paraqitnim dhe amendamentet e ndryshme në lidhje me këtë traktat.

Italia fashiste e Musolinit, që ndiqte me vendosmëri-në dhe me brutalitetin më të madh gjurmat e Italisë së Luftës së Vlorës, na sulmoi barbarisht më 7 prill të 1939-s. Populli shqiptar e priti me armë dhe s'i hodhi armët deri në kapitullimin e saj. Mizoritë e italianëve në Shqipëri, vrasjet, djegjet, plaçkitjet kanë qenë të mëdha. Italia, pra, kishte për të na dhënë hesap. Jo vetëm që ajo duhet të paguajë të gjitha dëmet që na ka shkaktuar, por Traktati i Paqes me Italinë, përsa na përket neve, duhet të jetë një garanci për të gjitha të drejtat tona morale dhe materiale, për indipendencën, lirinë dhe integritetin tokësor tonin dhe një ndalesë e fuqishme në të ardhmen kundër një agresioni të përsëritur nga ana e saj ndaj vendit tonë. Në Traktatin e Paqes me Italinë, me këtë vend agresor dhe fashist, që na shkaktoi kaq dëme, Shqipëria duhet të ketë të drejtën të konsiderohet si një «puissance associée»¹. Kjo kërkesë e drejtë e jona përsëri me anën e mekanizmit të votës u hodh poshtë. Në projekttraktatin e paqes me Italinë, Këshilli i Ministrave të Jashtëm s'i kish lënë mënjanë interesat e Shqipërisë. Një kapitull i veçantë i projekttraktatit, i përbërë prej 6 nенesh dhe që kanë të bëjnë me mbrojtjen e çështjes sonë, u pranua plotësisht nga ana e Komisionit territorial dhe politik për Italinë, pas një mbrojtjeje të shkëlqyer dhe të vazhdueshme të

¹ «Puissance associée» (frëngj.) — fuqi-shoqe

Mollotovit, Vishinskit e mbrojtësve të tjerë të çështjes sonë, kundër pretendimeve qesharake të delegacionit grek dhe mbështetësve të përhershëm të tij. Por megjithëtë delegacioni shqiptar në Konferencën e Paqes ka paraqitur një seri amendamentesh të tjera në lidhje me projekttraktatin me Italinë. Këto përbëjnë kërkesat tona, për reparacionet që na detyrohet Italia, për dorëzimin e kriminelëve të luftës, për kthimin e arit tonë që na ka grabitur duke e transportuar në Itali dhe që andej i tërhequr prej gjermanëve në Gjermani, për dorëzimin e një pjesë të armatimit që ajo na ka grabitur në fillim të okupacionit, për dorëzimin e vaporit tonë «Iliria» dhe të një numri tjetër vaporësh si shpërblim i atyre që na ka grabitur ose djegur dhe për kthimin ose shpërblimin e gjëra me vlefte që na ka djegur ose grabitur. Të gjitha këto janë të drejtat tona të padiskutueshme që duhet të na akordohen. Ato që kërkojmë s'janë përvçese një pjesë e vogël e dëmeve dhe e mjerimeve që na shkaktoi Italia fashiste. Delegacioni shqiptar do të insistojë deri në fund dhe populli shqiptar do t'i kërkojë me këmbëngulje të drejtat e tija.

Në Konferencën e Parisit u trillua orvatja më e poshtër nga ana e reaksionarëve grekë dhe përkrahësve të tyre, për të copëtuar Shqipërinë, për t'i rrëmbyer Shqipërisë Korçën dhe Gjirokastrën, djepe të patriotizmit e të lëvizjes nacional-çlirimtare. Dhe një orvatje e tillë bëhej pas një lufte kaq të ashpër ku me miliona njerëz ranë për lirinë dhe drejtësinë dhe në një konferencë paqeje, ku ishin mbledhur për t'i dhënë fund agresionit dhe fashizmit. Dhe më e keqja është se, kjo tentativë e poshtër e fashistëve grekë, mbështetej haptas

ose tërthorazi nga përfaqësuesit e disa prej atyre shteteve me të cilët derdhëm gjakun së toku.

Po Shqipëria s'ishte vetëm dhe të drejtat e saja nuk shkeleshin aq kollaj. Miqtë e saj ishin të fortë, ishin mbrojtësit e njerëzimit, mbrojtësit e paqes, mbrojtësit e drejtësisë, mbrojtësit e popujve të vegjël. Ishin përfaqësuesit e Bashkimit të madh Sovjetik, ishin shokët e Stalinit të madh. Populli shqiptar nuk do të harrojë kurrë mbrojtjen që i bëri çështjes sonë Mollozovi. Nuk do të harrojë kurrë mbrojtjen e Vishinskit, i cili në çdo mbledhje ku flitej për Shqipërinë, fliste dhe mbronte me zjarr të drejtat e popullit tonë të vogël. Manuilski, që mbronte aq nxehësisht çështjen tonë, në Paris dhe në Nju Jork më thoshte: «Unë e dua shumë popullin e vogël shqiptar dhe do ta mbroj deri në fund, se ai është trim, se ai është sakrifikuar, se ai është përparimtar». Mbrojtja e një çështjeje kaq të drejtë, sikundërqë ishte kjo e jona, s'mund të kishte përvëçse ato rezultate që u arritën: çështja e drejtë e vendit tonë u njoh prej gjithë botës; Shqipëria fitoi simpatinë e gjithë popujve përparimtarë; nga ana tjetër e gjithë manevra e reaksionit ndërkombëtar, me në krye reaksionin grek, pësoi fiaskon më të turpshme dhe më të bujshme. Diskutimi i kufive të Shqipërisë së Jugut, që aq padrejtësisht u votua nga mbledhja plenare e konferencës, në bazë të propozimit grek, u tërhoq nga rendi i ditës së konferencës, duke mbuluar me turp ata që e kishin propozuar dhe mbështetur. Nga të gjitha këto ngjarje që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me të ardhmen e tij dhe njëkohësisht me paqen e gjithë njerëzimit, populli shqiptar ka nxjerrë konkluzionet e veta. Populli ynë do të ruajë për miqtë e tij, që e duan dhe

e-mbrojnë, dashurinë më të madhe dhe do të vërë të gjithë forcat e tija për ta forcuar këtë miqësi kaq të sin-qertë, pse ajo është një siguri për qenjen e tij si komb dhe si shtet dhe njëkohësisht është një faktor i çmueshëm për paqen e botës. Populli shqiptar nuk ka merituar kurrsesi padrejtësinë e hapët që ju bë nga ana e përfaqësuesve të atyre popujve, me të cilët ai është mik dhe aleat, por populli ynë ka kurdoherë besim se një gjendje e tillë e padrejtë do të marrë fund. Sa për popullin grek, heroik por të mjeruar, që vritet dhe masakrohet prej bandave reaksionare dhe fashiste të qeveritarëve të Athinës, populli ynë nuk mund të ushqejë përveçse një simpati të madhe. Reaksiuni grek c di fjalën tonë përsa u përket pretendimeve të tyre të poshtra mbi Shqipërinë e Jugut, ata e hëngrën dackën dhe turpin në Konferencën e Paqes, por ata të mos harrojnë asnjë moment se populli shqiptar nuk fle, por ruan më i fortë se kurrë, kufirin e Jugut. 7 prilli nuk do të përsëritet më, qoftë edhe nga kufiri i Jugut. Por me gjithë dështimin e orvatjeve të tyre të turpshme, reaksiuni grek s'i ka hedhur armët, ai përditë po na provokon në kufi dhe përpiqet të mbajë një gjendje të turbullt për të përbushur ndërmarrjet e tija kriminale brenda në Greqi. Reaksiuni grek po shpif dhe po trillon se gjoja ne ndihmojmë me armë dhe me njerëz kryengritësit grekë. Të tilla provokacione dhe shpifje duhet të marrin fund. Ne nuk përzihemë në punët e brendshme të popullit grek, ashtu sikundër dëshirojmë që dhe ata të mos përzihen në tonat. Qeveritarët e Athinës, për të fshehur mizoritë dhe krimet e tyre që po bëjnë në kurrizin e popullit grek, për të shuar zjarrin e kryengritjes që ka shpërthyer

në të katër anët e Greqisë dhe hovin e kryengritjes popullore që po ju kërcënnon pozitat e tyre të kalbura, përpiken ta paraqesin këtë kryengritje si të ndihmuar nga jashtë. Shpifjet e grekërve janë të pathemelta, ne i përgjenjeshtrojmë kategorikisht. Tërë bota e pa qartë se ç'qëllime kanë pasur të gjitha shpifjet dhe provokacionet e reaksionit grek kundrejt vendit tonë; tani mbetet t'u thuhet ndal këtyre turbulluesve të paqes dhe shtypësve të popullit demokrat grek.

Rruja që ka ndjekur populli ynë në politikën e jashtme ka qenë ajo më e drejta dhe më përparimtarja; ne do të vazhdojmë të ecim me vendosmëri dhe me bindjen më të madhe në këtë rrugë. Ne do të forcojmë shumë e më shumë miqësinë e ngushtë që na lidh me Bashkimin e madh Sovjetik; ne do të forcojmë miqësinë dhe aleancën tonë me popujt vëllezër të Jugosllavisë; ne kemi marrëdhënje të përzemërtë me popujt ballkanikë, si Bullgarinë dhe Rumaninë. Këto do të përpinqemi t'i forcojmë dhe t'i konkretizojmë, ashtu si do të forcojmë miqësinë me të gjithë shtetet e tjerë përparimtarë dhe demokratë të botës. Ne do të luftojmë deri në fund përtë çrrënjosur mbeturinat e fashizmit dhe do të jemi kurdoherë në radhën e parë për të mbrojtur dhe për të forcuar paqen, ashtu si kemi qenë në radhë të parë në luftën kundër fashizmit italian dhe nazizmit gjerman.

Shokë të Frontit Demokratik,

Këto momente që po kalon Shqipëria janë momente nga më të rëndësishmet e historisë së saj, prandaj dhe detyrat dhe përgjegjësitë tona janë të mëdha. Të vihem

përpara detyrave dhe të marrim përgjegjësitë. Pikësëpari jemi në rrugën më të drejtë, pse këtë rrugë të drejtë e zgjodhi vetë populli, e gjeti pas kaq shekuj vuajtjesh dhe mjerimesh, e gjeti gjatë një lufte aq të përgjakshme, sa kurrë s'e ka parë historia e tij. Populli fitoi lirinë, indipendencën, sovranitetin, shporri armiqtë e jashtëm, spastroi rrugën nga armiqtë e brendshëm, vendosi një demokraci nga më të shëndoshat dhe përparimtaret, forcoi dhe konsolidoi prestigjin dhe pozitat e vendit të tij jashtë, duke i siguruar këtij miq dhe aleatë të fortë e të sinqertë. Këto janë fitoret e mëdha të popullit tonë. Detyra jonë e parë, si anëtarë të Frontit, është t'i ruajmë këto fitore si sytë e ballit, t'i konsolidojmë, t'i forcojmë.

T'i ruash këto fitore do të thotë të mbrosh atdheun. Mbrojtja e atdheut është një detyrë e rëndë, por e lavdishme. Atdheu nuk mbrohet në njëzet vjet një herë dhe pastaj të të zërë gjumi mbi dafina deri sa të të hedhë litarin në grykë tjetri. Atdheu mbrohet çdo ditë, vazhdimisht, me çdo hap, me çdo fjalë, me çdo punë të përditshme që bëjmë. Jeta jonë individuale është e lidhur ngushtë me jetën e gjithë kolektivitetit shqiptar, pra interesin tonë vetjak ta lidhim ngushtë me interesin e përgjithshëm. Këtej lind dhe forcohet ideja e patriotizmit, e sakrificës, e solidaritetit, e bashkimit dhe e mbrojtjes. Ku punohet për xhep, atje s'ka patriotizëm, atje s'ka vigjilencë, as kujdes, as disiplinë, atje s'ekziston ndjenja e mbrojtjes së atdheut. Armiku i jashtëm dhe i brendshëm nuk fle, ai përpinqet të dobësojë këtë ndjenjë me çdo kusht, dhe me çdo mënyrë që të të hedhë më në fund duart në grykë. Populli e sheh në punën e përditshme se si tenton të na luftojë armiku, prandaj duhet të

jemi në luftë të vazhdueshme me të. Këtu s'ka butësi prej murgeshe, këtu luftohet për jetën; kur armiku të kish vënë shqelmin në fyt dhe të pinte gjakun, s'të mëshironte, por t'u desh të lije në fushën e luftës me mijëra të vrarë e të plagosur nga djemtë e tu më të mirë, t'u desh shkatërrimi i një pjese të madhe të Shqipërisë, që të mund të shpëtoje jetën. Tani është në dorën tonë që ta mbrojmë këtë jetë, është e drejta jonë dhe ne do ta mbrojmë dhe do ta bëjmë të lumtur.

T'i konsolidosh fitoret e luftës, do të thotë të jesh në përmirësim të vazhdueshëm, domethënë të ndërtosh vendin tënd nga çdo pikëpamje. Problemi i ndërtimit të ri të vendit është një problem i gjerë, i shumanshëm dhe që lyp nga ne kujdesin, vullnetin, disiplinën, drejtësinë më të madhe. Që të ngresh ekonominë e vendit dhe të përmirësosh kështu jetën e popullit duhet të mendosh njëkohësisht për zhvillimin e arësimit dhe të kulturës në popull, nga ku do të dalin kuadrot e shëndoshë dhe të zot që të drejtojnë gjithë ekonominë e vendit në baza shkencore, duhet të përmirësosh dhe të modernizosh bujqësinë; duhet të rindërtosh dhe të modernizosh industrinë, duhet të forcosh dhe të modernizosh apartin e shtetit, etj. Të gjitha këto formojnë problemet kryesore të shtetit tonë dhe ne po ecim në rrugën e zgjidhjeve të tyre. Fronti duhet të koncentrojë të gjitha fuqitë e tija për të mobiluar gjithë popullin, për të mbështetur veprën e shumanshme të pushtetit, në radhë të parë ngritjen e ekonomisë së vendit. Në radhë të parë reforma agrare të marrë fund në kohën e caktuar. Por problemi agrar është një problem i gjerë dhe që lyp një kujdes të veçantë nga ana e pushtetit dhe e Frontit në lidhje me

bonifikimet në shkallë të gjerë me anë të të cilave ne do të përmirësojmë tokat dhe do të fitojmë toka të reja. Për Frontin detyrë imediate është që t'i japë ndihmë më të madhe pushtetit në korrigimin e shpejtë të gabimeve që mund të jenë bërë gjatë aplikimit të reformës, të aktivizojë fshatarët dhe popullin në çeljen e kanaleve të vogla dhe të mëdha me karakter nacional dhe që janë në planin e qeverisë.

Si detyrë tjetër imediate e Frontit është të bëjë fushatë të madhe përmirësimi i aférme sipas planit të aprovuar nga ana e Ministrisë së Bujqësisë. Rezultati i kësaj fushate të madhe duhet të jetë jo vetëm që të mos mbetet asnjë pëllëmbë tokë pa u punuar, por të inkurajohen ato prodhime dhe në ato vende që caktohen në planin e aprovuar nga Ministria e Bujqësisë.

Çështja e minierave dhe e fabrikave. Këtu sindikatat dhe Fronti në përgjithësi duhet t'i jalin mbështetjen më të madhe ndërmarrjes kolosale të shtetit në këtë drejtim qoftë në miniera, në fabrika ose në kantiere. Punëtori ynë duhet të kuptojë mirë se jeta e tij ashtu dhe ajo e përgjithshme do të përmirësohen, kur ai të punojë me ndërgjegje dhe të prodhojë gjithnjë më tepër. Çështja e normave në punë të bëhet një problem për punëtorët, për sindikatat dhe për drejtuesit e ndërmarrjeve.

Në sektorin e shtetit në përgjithësi, detyra e Frontit është e madhe. Për këtë sektor të madh ne duhet të kujdesemi që ky të japë më shumë se të tjerët. Këtu hyn çështja e disiplinës, e organizimit, e edukimit të kuadrove dhe e zhvillimit të iniciativës. Duhet që Fronti në çdo gjë të ngjallë iniciativën në masat dhe të mos lërë që ato të presin çdo gjë nga qeveria. Në lëmin e ekonomisë

duhet të kursejmë sa më tepër, ta bëjmë punën më më pâk shpenzime që të mund të realizojmë punët e ndërmarrura dhe ta mbulojmë deficitin.

Fronti duhet të aktivizohet në zhvillimin sa më tepër të kooperativave sidomos, në fshatra, ato të shitblerjes e të punës. Këto duhet të bëhen të kuptueshme për popullin, këto duhet të mbështeten në iniciativën e masave, pse këto nuk rregullohen me mënyra burokratike. Këto do të shërbejnë për të evituar spekulimin, për shtimin e prodhimit dhe për ngritjen e nivelit të jetesës së prodhuesve të vegjël si dhe për të ndihmuar konsumatorin.

Çështjen e arësimit dhe të kulturës po e përsëris edhe njëherë. Kjo është një nga problemet më të rëndësishme të Frontit dhe të shtetit. Arësimi duhet të përkrahet me çdo kusht, të përkrahen shkollat, të mos mbetet i ri dhe e re pa vajtur në shkollë, të luftohet me të gjitha forcat analfabetizmi, veçanërisht në krahinat e Veriut. Të hapen sa më shumë dhe të përkrahen shtëpitë e kulturës, klubet e sportit. Shtypi të shpërndahet dhe të lexohet nga të katër anët dhe ky të jetë një shtyp jo vetëm informativ, por sidomos edukativ dhe të pasqyrojë jetën dhe frymën e re.

Fronti ka për detyrë të madhe të forcojë në njerëzit e Shqipërisë ndjenjën e drejtësisë, që është gjëja më e lartë dhe më e shenjtë në regjimin tonë popullor. Gjykatësit tanë duhet të zgjidhen nga radhët e njerëzve më të ndershëm dhe të pakorruptueshëm, nga njerëzit që u dhimbset çështja e popullit dhe që të gjykojnë e të japid vendime në frymën e re. Prokurorët e shtetit duhet të gjejnë mbështetjen më të madhe në njerëzit e Frontit për të kryer detyrën e tyre shumë të rëndësishme.

Komisioni i Kontrollit të Shtetit, gjithashtu, duhet që të gjejë nga ana e Frontit mbështetjen më të plotë. Sikundërqë dihet, detyrat e Komisionit të Kontrollit të Shtetit nuk janë me shtyp iniciativën, me pengue udhëheqjen, por përkundrazi me ndihmues me anë të shkëmbimit të eksperiencës dhe të kritikës së gabimeve dhe me i vu në dukje këto gabime për me i ba të afta organet e administratës shtetërore që t'i kryejnë sa më mirë dhe me efikasitet detyrat e tyre.

Shokë të Frontit Demokratik,

Anëtarët e Frontit tonë Demokratik kanë filluar t'i kuptojnë mirë detyrat e tyre, t'i rrahin dhe t'i zgjidhin. Në këtë mbledhje të rëndësishme të sotshme t'i shtrojmë, pra, këto probleme, të shkëmbejmë eksperiencën me njëri-tjetrin dhe kjo të na shërbejë për t'i dhënë një vrull punës ndërtimtare të vendit tonë. Punët janë në shesh, të punojmë me atë vrull që ja kemi nisur, se kështu ndërtohet Shqipëria, kështu do të rrojë e lumtur dhe e fortë Shqipëria.

Rroftë populli shqiptar dhe organizata e tij e madhe politike, Fronti Demokratik!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 553,
8 tetor 1946*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

FJALIM I MBAJTUR NË KONGRESIN E TRETE TE RINISE POPULLORE TE SHQIPERISE

16 tetor 1946

Të dashur shokë dhe shoqe të rinisë,

Më parë dëshiroj t'ju përgëzoj dhe t'ju uroj nxehësisht nga zemra në emër të qeverisë dhe timin, juve të mbledhur këtu në këtë kongres si dhe gjithë Rininë Popullore të Shqipërisë dhe t'ju shfaq mirënjojen e madhe tonën për gjithshka po bëni ju për popullin dhe për atdheun.

Kongreset tuaja kanë një kuptim të madh jo vetëm për ju të rinxjtë e vendit tonë, por për tërë popullin shqiptar, pse problemet që rriven në këto kongrese dhe vendimet që merren, duke pasur anën e tyre speciale për rininë, janë të lidhura ngushtë dhe të pandara me të gjitha problemet jetike të vendit tonë. Rinia jonë dhe problemet e saja nuk mund të jenë të shkëputura nga populli dhe nga problemet e popullit, prandaj Kongresi juaj i tretë, sikundër edhe gjithë kongreset tuaja të mëparshme, kanë qenë njëkohësisht kongreset e gjithë popullit shqiptar dhe shënojnë një datë historike në krijimin dhe ndërtimin e Shqipërisë së re. Ju keni qenë nga

faktorët kryesorë të fitores vendimtare që solli çlirimin e Shqipërisë, ashtu sikundër jeni një nga faktorët kryesorë të ndërtimit të jetës së re që ju e meritoni dhe që do ta gëzoni.

Kur ju shoh të mbledhur kështu si një trup i vetëm, ku rreh një zemër për një qëllim, s'mund të rri pa përmendur atë që ju bëri të jeni të fortë si çeliku, dua të them Luftën e lavdishme nacional-çlirimtare. Po në ujë e në zjarr forcohet çeliku, në zjarrin e luftës u çelnikosët edhe ju. Në thirrjen e Partisë Komuniste të Shqipërisë, që i bëri popullit në kohërat më të rrezikshme, ju patë shpëtimin, ju patë çlirimin e atdheut, ju patë fitoren dhe jetën e re dhe rrokët armët e bëtë luftën më të lavdishme që ka parë historia. Shumë u tallën me ju dhe me qëllimet e idealet tuaja të larta, por zotërinjtë, patriotë të liretës e të parasë së huaj, shpejt u drodhën nga grushti juaj i fortë dhe vendimtar që i goditi pa mëshirë. Atje ku ishte lufta më e ashpër, atje ishit ju o shoqe e shokë të rinj, atje ku duhej zemër, ku duhej trimëri dhe vetëmohim, ku duhej forcë organizimi, atje ishit ju, të zhveshur e pa këpucë, në borë e në shi, por kurdoherë të patrembur dhe të patundur. Ju dhatë shembullin e madh, heronjtë e rinisë u bënë kushtrimi i luftës dhe populli mbarë, gra, burra e pleq të thinjur u hodhën në rrugën e luftës, në rrugën e shpëtimit për të ndërtuar, tok me bijtë e tyre heroikë, jetën e lumtur për brezat e rinj. Më kujtohet si tani Kongresi juaj i parë¹ që mbajtët në malet e Ostrovicës. Ju erdhët nga të katër anët e

¹ Kongresi i parë i Bashkimit të Rinisë Antifashiste Shqiptare u mblohdh në Helmës të Skraparit më 8 gusht 1944.

Shqipërisë me pushkë në krah. Nga çdo njësit, nga çdo brigadë, nga çdo qytet, duke kaluar njëmijë rreziqe, shokët ju kishin deleguar të bisedonit mbi problemin e madh që na preokuponte: luftën e çlirimit. Atje ju diskutuat, muarët vendime të tilla, që do të mbeten historike jo vetëm për faktin e madh që i dhanë një hov të çuditshëm luftës, por edhe për seriozitetin dhe pjekurinë e këtyre vendimeve. Brezi i ri i Shqipërisë ishte një forcë e madhe në vendin tonë, një forcë e madhe që po ngrihej dhe që po farkëtohej në një luftë të ashpër. Ajo ishte garanci e fitores dhe e së ardhmes së vendit tonë. Këtu nuk gabuam dhe s'mund të gaboheshim. Gjatë luftës ju ndjetë nevojën e një organizimi të gjerë dhe të shëndoshë të rinisë, organizim që të përfshinte të gjithë të rinjtë e vendit tonë. Pa një organizim të tillë, nuk mund të krijohej realiteti i forcës suaj të madhe dhe nuk mund të arriheshin qëllimet dhe të kryheshin detyrat e mëdha që ju viheshin përpara. Ju i kuptuat këto nevoja imperitative që krijoj lufta, dhe ju realizuat më së miri unitetin dhe bashkimin e gjithë rinisë shqiptare. Me një forcë të tillë të organizuar, të disiplinuar dhe të fryshtuar nga parime që mbajnë në veten e tyre realizimin e aspiratave të shëndosha të rinisë dhe të mbarë popullit, ne kapërcyem dhe do të kapërcejmë çdo pengesë.

Kur ne kapërcyem me suksesin më të madh etapat e tmerrshme të luftës, duke mposhtur armikun e jashtëm dhe armiqtë e brendshëm, pa asnjë dyshim ne do të arrijmë ta ndërtojmë Shqipërinë tonë dhe ta bëjmë popullin tonë të lumtur.

Që prej çlirimit të Shqipërisë dhe deri tani ne kemi korrur suksese si në lëmin ekonomik, ashtu edhe në atë

shoqëror. Patjetër konditat kanë qenë shumë të vështira. dhe këto kondita i krijoi lufta. Çështja ishte t'i kuptonim këto kondita dhe t'i përmirësonim me forcat tona, se vetëm me forcat tona mund të përmirësoheshin këto kondita. Mbeturinat e armiqve të popullit do të përpinqeshin gjatë gjithë kësaj periudhe të krijonin ose të inkurajonin situata për ta demoralizuar popullin, për t'ja shtuar fatkeqësitë, për të krijuar pengesa në ndërmarrjen e tij të madhe të rindërtimit. Por këtu ata armiq s'mund të kishin kurrë suksese, arma që ata me shekuj e kishin përdorur për të shtypur popullin u kishte ikur përgjithmonë nga duart. Fuqia ishte në duart e popullit, por në duart e një populli që kishte bërë një luftë kaq të madhe dhe ishte bërë i ndërgjegjshëm për forcat e tija, për zotësinë e tij. Populli ynë jo vetëm që s'i linte më interesat e tija t'ja rregullonte beu dhe fajdexhiu, por ua theu kokën këtyre dhe do t'ua thyejë në rast se ata lëvizin dhe s'qëndrojnë urtë. Vendosja e pushtetit popullor të këshillave, vendosja e demokracisë së vërtetë dhe të shëndoshë, regjimi që populli i dha vendit, Statuti Themeltar, janë fitoret kryesore të luftës sonë, të cilat i hapën Shqipërisë së re rrugën e përparimit. Dhe në këtë rrugë të re ecën rinia jonë heroike tok me popullin e vet, për të cilin ajo luftoi trimërisht, për të cilin ajo ka përveshur llërët dhe ka vënë pa kursim të gjitha energjitetë e saja të reja e të shëndosha. Vjen vetëvetiu që në një regjim të këtillë, si yni, ku punohet në mënyrë të organizuar për një jetë më të mirë, brezit të ri i vihet kujdesi më i madh. Edukata e rinisë, pajisja e saj me kulturë dhe me arësim, shëndeti i saj, krijimi i konditave të jetesës sa më të mirë për të, janë dhe do të janë

preokupacionet më kryesore të pushtetit tonë popullor.

Këto i sheh rinia jonë. Ajo është aq e ndërgjegjshme, aq patriote, aq e thellë në mendime dhe në vepra, saqë çështjet e saja nuk i merr kurrë të shkëputura nga realiteti i vendit, nga konditat dhe rrëthanat ku jetojmë. Ajo i kupton më mirë se kushdo vështirësitë, pse ka njohur vështirësi nië të mëdha në kohën e luftës, ajo ka besimin më të madh se do t'i kapërcejë këto vështirësi, që s'janë më të vogla se ato të luftës, ajo e di që duhet të mësojë dhe të edukohet dhe e di përse i duhet ai mësim dhe ai edukim, por di njëkohësisht se duhet të punojë. Dhe kontributi që ka dhënë rinia në rindërtimin e Shqipërisë është aq i madh, sa ka qenë kontributi i saj në çlirimin e atdheut. Në çdo vepër rindërtimi është mobilizuar rinia, ajo ka punuar me kokë dhe me krahë, kuadrot e rinj me vullnetin e tyre, me shpirtin e tyre të drejtë, me stilin dhe me hovin e ri në punë, kanë dhënë rezultate të shkëlqyeshme. Rinia në ushtri, në ushtrinë tonë heroike, që në kohën e luftës formoi radhët e para dhe që tani përbën pjesën më të madhe të saj, zhvillon një aktivitet të tillë që e bën ushtrinë tonë të mbajë të pashuar dhe të shtojë shpirtin dhe zjarrin e patriotizmit, të heroizmit, të disiplinës që e udhëhoqën në luftën e lavdishme. Ndër fabrika e miniera, ndër arar kantiere, rinia jonë e organizuar dhe me ndërgjegje të formuar për rolin e saj të madh po punon me një vullnet të patreguar. Rinia jonë është e etshme për arësim dhe për kulturë, ajo ndjek rregullisht dhe me sukses mësimet. Fakti se me qindra shkolla të reja po hapen në të katër anët e Shqipërisë tregon se për të rinjtë arësimi është bërë një detyrë e madhe dhe një nevojë; të rinjtë

é kanë kuptuar, se, duke u pajisur me kulturë, atyre do t'u hapen horizonte të reja, dhe kështu do t'i shërbejnë më mirë popullit dhe do ta ndërtojnë më shpejt jetën e lumtur. Është në mbarim e sipër rruga Kukës-Peshkopi, kjo ndërmarrje e madhe e rinisë sonë. Muaj me radhë, me mijëra të rinj, nga të katër anët e Shqipërisë, po derdhin djersë dhe tregojnë zotësi, po çajnë malet e Veriut, për të çuar në ato vende përparimin, kulturën. Shqipëria i falenderon dhe unë ju ftoj që të çohemi të gjithë në këmbë dhe të brohoritim për shokët e rinisë që punojnë në rrugën Kukës-Peshkopi, të brohoritim përkëta pionierë të mëdhenj të përparimit.

Reformat e mëdha me karakter ekonomik dhe shoqëror, që krijojnë një jetë të re në Shqipëri, e bëjnë rininë tonë jo vetëm që të grumbullojë të gjitha forcat e saja për realizimin dhe konkretizimin e këtyre reformave, por e bëjnë njëkohësisht të shtojë vigjilencën e saj kundër manevrave dhe tentativave të armiqvë të popullit, që kërkojnë t'i sabotojnë ose t'i pengojnë këto reforma. Rinia, sikundër edhe gjithë populli, ka eksperiencën e luftës në këtë çështje. Sa më tepër t'i afrohet vdekja armikut, aq më tepër ai mundohet të grumbullojë energjitetë e tij për të dëmtuar. Për armikun s'ka mëshirë. Armiku i brendshëm, që grumbullohet nga mbeturinat e fashizmit e të feudalëve, të fajdexhinjve dhe të tregëtarëve të mëdhenj, nga ata klerikë ose intelektualë e teknikë që shesin te armiqtë e huaj atdheun, nderin dhe çdo gjë tjeter të shenjtë, të gjithë ata që e humbën betejën e armatosur dhe atë politike, do të përpilen me njëmijë mënyra të sabotojnë ose të pengojnë rindërtimin, veprën e madhe të popullit. Këtu duhet t'i hapim sytë

dhe t'i bëjmë katër, se kështu kemi mbrojtur djersën dhe gjakun tonë. Sukseset tona në lëmin ekonomik dhe kudo gjetkë, këta zotërinj i kanë halë në sy, por ne nuk do të lejojmë kurrsesi që këta të dëmtojnë popullin. Më duket se ky është qëndrimi më i drejtë që mund të mbajmë. Në Shqipërinë e re çdo njeri i ndershëm ka të drejtë të rrojë, të punojë, të fitojë brenda ligjeve që rregullojnë jetën e përgjithshme të popullit. Në qoftë se ka ndonjë regjim që respekton të ndershmin, të mësuarin, teknikun, ky është regjimi ynë demokratik. Por këta duhet të kuptojnë mirë detyrat që kanë në Shqipërinë e re të popullit dhe diturinë e tyre ta vënë në shërbim të kolektivitetit. Është e vërtetë se teknika duhet të çmohet dhe tekniku ose profesori duhet respektuar e përkrahur. Shteti ka vënë gjithë forcat për krijimin e kësaj tekniqe dhe të kësaj inteligjence, dhe me sigurinë më të madhe do të arrijmë në rezultate të mira, por këtu dua t'u them diçka atyre njerëzve «të mësuar» ose teknikë që në kokën e tyre kanë koncepte të ndryshme nga ato që udhëheqin Shqipërinë e re. Ata të mos kujtojnë asnje sekondë se respekti që kemi ndaj tyre dhe përkrahja që i japim teknikës dhe teknikut do të na ndalojë për të marrë masat më të ashpra kundër atij personi që teknikën e vë në shërbim të armikut të brendshëm ose të jashtëm për të sabotuar veprën e popullit. Ne i kemi punët të qarta. Ka kurdoherë kohë për ata që i vënë si detyrë kryesore vetes të korrigohen dhe të përqafjnë rrugën e drejtë. Unë jam i sigurt se rinia të gjitha këto punë i kuption mirë, se janë të lidhura ngushtë me jetën dhe të ardhmen e saj, dhe jam i sigurt edhe për një gjë tjetër, se rinia jonë, që ka në shpirt

drejtësinë, do ta zbatojë atë me rigorozitetin më të madh, dhe do të goditë pa mëshirë atje ku sheh se luhet me interesat e me jetën e popullit.

Tani dua t'ju them disa fjalë për disa çështje që i interesojnë rinasë, ashtu sikundër i interesojnë gjithë popullit, e kam fjalën në lidhje me marrëdhënjet tona me botën e jashtme dhe me kërkkesat tona të drejta në lëmin ndërkombëtar dhe kundrejt Italisë.

Fituam luftën, fituam edhe miq e aleatë të sin-qertë që simpatizojnë dhe mbrojnë popullin dhe vendin tonë nga të gjitha tentativat dhe manevrat e reaksionit ndërkombëtar. Në radhë të parë është Bashkimi Sovjetik. Ka edhe të tjerë si Jugosllavia, Polonia, Çekoslovakia, Franca, Bullgaria, të cilat kanë njojur qeverinë tonë dhe kemi marrëdhënje diplomatike me to. Rinia është ajo pjesë e popullit që ka kontribuar pa masë në krijimin dhe forcimin e kësaj miqësie të pavdekshme me Bashkinin Sovjetik dhe me të gjithë ata popuj që na duan të mirën dhe ua duam të mirën. Miqësia është një gjë e madhe dhe një gjë e shenjtë, dhe ne shqiptarët, që jemi djegur tërë jetën, dimë ta çmojmë miqësinë, po jo vetëm ta çmojmë, por edhe ta ruajmë si sytë e ballit dhe ta forcojmë dita-ditës. Në bazë të një miqësie të vërtetë ka një drejtësi të madhe, ka respekt reciprok për të gjitha të drejtat e njëri-tjetrit, ka harmoni dhe vëllazërim dhe këtej rrjedh dhe ndihma për njëri-tjetrin e sidomos në kohët më të këqia ku njihet miku i vërtetë. Ç'është Bashkimi Sovjetik për Shqipërinë dhe për gjithë njerëzimin, këtë e pamë dhe e provuam gjatë kohës së luftës, këtë po e provojmë tani kur po ndërtohet paqja dhe veçanërisht

ne e provojmë sa e madhe, sa e sinqertë është kjo miqësi, kur armiqjtë e vendit tonë dhe reaksiuni ndër-kombëtar po bëjnë orvatjet më të turpshme të mohojnë të drejtat që i kemi fituar me gjak. Në i jemi mirënjo-hës Bashkimit Sovjetik dhe do të kemi për të, miqësinë më të madhe dhe më të sinqertë, pse ai na ndihmoi të fitojmë lirinë dhe pavarësinë dhe pse ai mbron interesat e popullit tonë duke qenë i sigurt se mbron drejtësinë e vërtetë.

Vendi ynë i vogël ka nevojë që të shtojë rrithin e miqve të tij. Sa më tepër të ketë miq njeriu, aq më mirë është. Rrethi i miqve tanë jashtë nuk është aspak i vogël dhe ne, duke çmuar këtë miqësi, kemi vënë forcat dhe do t'i shtojmë që kjo t'i ketë bazat të shëndosha dhe të shërbejë për interesin e të dy palëve dhe të të gjithë botës përparimtare në përgjithësi.

Por ka njerëz dhe shtete që s'e kuptojnë miqësinë kështu si e kuptojmë ne dhe që s'e bazojnë në respektin e të drejtave të tjegrit, konditë kjo nga kryesoret përvendosjen e marrëdhënjeve të mira dhe të vazhdueshme. Unë këtu nuk do të përsëris ato që kam thënë edhe disa ditë më parë përsa u përket marrëdhënjeve tona me Anglinë dhe me Amerikën, por do të shtoj diçka tjeter, se vargu i padrejtësive kundër popullit tonë po shtohet. Sikundërqë e dini, Konferanca e Paqes i mbaroi punimet në lidhje me Traktatin më Italinë, i cili u votua krejtësisht. Në lidhje me këtë traktat ne kishim paraqitur mendimin tonë dhe kërkeshat tona, të cilat jo vetëm që ishin të drejta dhe të pamohueshme, por ishin dhe modeste. Kishim kërkuar që në artikullin 21 të projekt-traktatit të paqes me Italinë, atje ku thuhej se «Italia

njeh dhe detyrohet të respektojë sovranitetin dhe independentën e shtetit shqiptar», të shtohej dhe fjala «integritet». Kishim kërkuar që të na kthehej ari i grabitur prej Italisë fashiste dhe i transportuar në Gjermani, kishim kërkuar që ne të konsideroheshim si fuqi-shoqe (puissance associée), kishim kërkuar reparacione nga Italia. Të gjitha këto kërkesa tona të drejta u mbrojtën me mish e me shpirt deri në fund nga përfaqësuesit sovjetikë, e të tjerë, por, më në fund këto kërkesa u rrëzuan dhe delegacioni anglez dhe amerikan bënë presion në konferencë për këtë gjë. Delegati britanik Hud deklaroi dhe insistoi që «Shqipëria të mos marrë fare dëmshpérblime». Këtë qëndrim mbajti edhe delegati amerikan gjatë gjithë konferencës përsa u përket të drejtave tona. U duk haptas se në atë konferencë të lartë, ku duhej të bëhej procesi dhe të merreshin masat kundër agresorëve, siç ishte Italia fashiste, nga shumë shtete të Perëndimit u mbrojt Italia dhe u shqelmuant të drejtat e atyre popujve që derdhën kaq gjak për liri dhe demokraci.

Populli shqiptar nuk i pranon në asnjë mënyrë vendime të tilla të padrejta, ku duket haptas se mbrohen ata që na dogjën, na grabitën, na vranë dhe populli shqiptar kërkon me këmbëngulje që Konferenca e Mistrave të Punëve të Jashtme, që do të marrë në shqyrtim vendimet e Konferencës së Paqes, ta vërë në vend drejtësinë dhe të na njihen të drejtat që janë tonat, që na kanë kushtuar kaq gjak dhe sakrifica. Vendime të tillë të padrejta vallë shërbejnë për krijimin dhe forcimin e një miqësie të shëndoshë në mes të popujve? Vallë populli shqiptar do të harrojë aq lehtë mizoritë dhe

vrasjet, grabitjet dhe djegjet që na shkaktoi Italia? Kur vjen puna që kjo të paguajë për krimet e saj si rrjedhim i të cilave i kemi plagët në trupin tonë dhe në zemrën tonë, dalin përfaqësues shtetesh, me të cilët kemi luftuar së toku, dhe thonë se Shqipërisë s'duhet t'i japim asgjë. Jo, një qëndrim të tillë të padrejtë nuk mund ta harrojmë dhe nuk mund ta pranojmë kurrsesi.

Të gjitha këto padrejtësi, që i bëhen popullit shqiptar në lëmin ndërkombëtar, s'kanë asnjë bazë mbështetjeje dhe bile vendimet e padrejta që merren në Konferencën e Paqes kundër vendit tonë janë në kundërshtim të hapët me thënjet e mëparshme të po këtyre shteteve që vendosin në një mënyrë të tillë për Shqipërinë. Shumë herë kam paraqitur para jush dokumenta zyrtare anglo-amerikane të njerëzve me përgjegjësi, ku ata po hojnë me plot gojën përpjekjet e popullit shqiptar. Më lejoni t'ju citoj një dokument tjetër amerikan. Këshilltari politik i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në Kazerta me datën 22 mars 1945 më drejtonte një memorandum, ku në mes të tjerave më thoshte: «Si dihet mirë, populli i Shteteve të Bashkuara ka treguar gjithmonë një interes të veçantë për fatet e popullit shqiptar. Ai i di mirë vuajtjet dhe sakrificat e mëdha të shqiptarëve gjatë luftës së tanishme dhe trimërinë e patriotëve shqiptarë në rezistencën e tyre kundër armiqve agresorë».

Këto më shkruante këshilltari politik amerikan nga Kazerta para 20 muajve. Tani unë bëj pyetjen: Të interesohesh gjithmonë për fatet e popullit shqiptar, a pajtohet kjo me vendimet që merren në Konferencën e Parisit? Mua më duket se «me u interesue veçanërisht për fatet e popullit shqiptar, të cilit i njihen mirë vuaj-

tjet dhe sakrificat gjatë luftës së tanishme», sikundër më shprehet në atë memorandum përfaqësuesi i lartë amerikan, kjo nuk bëhet duke refuzuar kërkesat e drejta të Shqipërisë kundrejt agresorit. Këtu është e qartë: ose mbrohen të drejtat e Shqipërisë ose nuk mbrohen. Fakti është se interesat e Shqipërisë shqelmojnë dhe ato të agresorit mbrohen. Për këtë gjë kaq të qartë askush nuk mund të na bëjë të ndërrojmë mendim, përveç kur të shohim konkretisht provat e kundërta. Dhe ne kërkojmë që të ndryshojë ky qëndrim i pajustifikueshmë kundrejt një populli të vogël dhe heroik, që bën çdo përpjekje të mëkëmbet nga shkatërrimet që i kanë ngjarë dhe që është një faktor i shëndoshë paqeje. Të gjitha këto pengesa, që na bëjnë, thuhet se gjoja e kanë shkakun në faktin që qeveria jonë nuk është njohur dhe në «kokëfortësinë e qeverisë sonë». Por edhe kjo legjendë duhet të marrë fund. E shpjegova edhe disa ditë më parë këtë situatë të krijuar në mes nesh dhe aleatëve anglo-amerikanë. Dhe këtu duhet t'i kemi punët të qarta. Ne, nga ana jonë, kemi treguar gjithë vullnetin e mirë që të marrë një zgjidhje kjo situatë që kanë krijuar, por të gjithë duhet të dinë se interesat e Shqipërisë ne nuk i vëmë në lojë; nga ana tjetër, s'ka asnjë rrezik që ne të kërcënojmë interesat e shteteve të mëdha.

Shumë gjëra thuhen jashtë në kurriz të Shqipërisë për të «argumentuar» tezat e padrejta kundrejt vendit tonë, por kemi edhe ne shumë gjëra për të thënë. Në lidhje me njohjen e qeverisë sonë, më 22 mars 1945 përfaqësuesi politik i Shteteve të Bashkuara në Kazerta më dërgonte një memorandum, ku në mes të tjerave më thoshte:

«Kjo qeveri (qeveria amerikane) nuk ka ndër mend të dërgojë një mision ushtarak në Shqipëri, siç ka marrë vesh se po bën qeveria britanike, dhe njësitet speciale amerikane tani atje, natyrisht, nuk mundet të pretendohet se përballojnë nevojat e reja që lindën në fazën e tanishme. Prandaj Departamenti i Shtetit do të dëshironte që në një datë të aférme të dërgonte një grup të vogël përfaqësuesish të vet në Shqipëri në një bazë krejt informative me qëllim që qeveria e Shteteve të Bashkura të furnizohej me informata, për të cilat tani ka nevojë. Gjeneral Hoxha, sigurisht, ka me e kuptue se çdo vonesë e rregullimit të çështjes, si më sipër, kishte me kontribue vetëm me azhurnue një vendim nga kjo qeveri mbi veprimin që kishte me marrun përsa i përket njohjes». Këto më shkruante përfaqësuesi amerikan në lidhje me njohjen e qeverisë dhe dërgimin e misionit amerikan këtu me qëllime të caktuara.

Gjeneral Hoxha s'mungoi t'i përgjigjet «ofertës» amerikane dhe pranoi ardhjen e misionit këtu. Misioni special amerikan erdhi në Shqipëri dhe ka afro 20 muaj, por njohja e qeverisë shqiptare akoma s'po duket. Dy herë kryetari i këtij misioni, z. Xhejkobs, ka shkuar në Uashington dhe dy herë më ka pohuar zyrtarisht se ai e ka mbaruar misionin e tij me sukses dhe se raportet e tij kanë qenë në favorin e njohjes së qeverisë sonë. Atëherë nuk kuptoj një gjë: çfarë pune bën ky mision këtu, kur kryetari i tij më thotë se «e ka kryer punën e vet dhe ka dhënë raporte në favorin e njohjes së qeverisë sonë»? Unë nuk shoh asnje përpjekje për shpejtimin e njohjes së qeverisë sonë nga një mision që e ka mbaruar funksionin e vet. Unë nuk dua që të përsëriten po ato

argumenta, që u përdorën me rastin e ikjes së misionit ushtarak anglez, i cili e kish mbaruar funksionin e vet. Vetë letra e këshilltarit politik të Shteteve të Bashkuara, që më ka drejtar, e përcakton mirë qëllimin dhe detyrat e misionit amerikan në Tiranë. Pra, këto detyra ai i ka mbaruar. Nga ana jonë dëshirojmë që të vendosen sa më parë marrëdhënje të mira miqësore me popullin e madh amerikan, ashtu sikundër dëshirojmë edhe me popullin anglez. Nga ana jonë, nuk ka pasur dhe s'do të ketë pengesa, kur interesat dhe të drejtat e vendit tonë nuk cënohen dhe nuk preken, sikundërqë edhe ne kemi kujdesin më të madh që të mos cënojmë as të mos prekim interesat e të tjerëve. Më duket se kjo duhet të jetë baza e marrëdhënjeve të mira.

Jua them këto çështje, pse ju të rinjtë si gjithë populli jeni të prekur thellë për padrejtësitë që na bëhen në lëmin ndërkombëtar. S'ka as dyshimin më të vogël që ju revoltoheni me të drejtë, kur shihni që gjaku që keni derdhur, shtëpitë tuaja që ju janë djegur nga armiku, konsiderohen prej disave si gjëra të pavlefshme dhe, në vend që të mbrohen këto të drejta, ato përbuzen dhe shqelmojen në favorin e atyre që ishin shkaktarët e kësaj kasaphane të madhe. Pa asnjë dyshim zëri juaj do të çohet dhe do të bashkohet tok me atë të të gjithë popullit që këto padrejtësi të marrin fund.

Dua t'ju them dhe diçka mbi detyrat që keni përpara, dhe unë jam më se i bindur se këto detyra ju do t'i kryeni sikurdoherë me ndër.

Detyra juaj e parë është të forconi sa më shumë bashkimin tuaj dhe organizata juaj e rinisë të përfshijë të gjithë të rinjtë e Shqipërisë. Organizimi i shën-

doshë dhe parimet e shëndosha do të na bëjnë të kalojmë çdo pengesë, pse atje ku ka organizim, ka rregull, ka disiplinë, ka emulacion, ka vetëmohim ka rezultate të dukshme. Në rininë tonë duhet të forcohet ndjenja e patriotizmit dhe e mbrojtjes së atdheut; dhe kjo ndjenjë e shenjtë të depërtojë nëpërmjet jush te njeriu më i thjeshtë i vendit tonë. Ashtu si ishit të vendosur në fushën e luftës, ashtu duhet të jeni të vendosur në fazën e rindërtimit dhe të krijimit të njëriut të ri.

Ju e dini fare mirë se hasim vështirësi, po këto po i kapërcejmë njérën pas tjetrës dhe jeta jonë po përmirësohet. Për mbrojtjen e kësaj jete të re, që po ndërtojmë me duart tona, të jeni luftëtarë të pamposhtur, pse kështu do të kontribuoni në mbrojtjen e indipendencës, të lirisë, të sovranitetit dhe të integritetit tokësor të vendit tonë.

Edukimi i rinisë duhet të jetë një detyrë kryesore e organizatës suaj. Pushteti ynë do të vëré të gjitha forcat për këtë qëllim. Të rinxjtë duhet të mësohen të përvetësojnë shkencën dhe këtë ta bëjnë armën më të fortë për përparimin dhe për lulëzimin e vendit. Duhet të dini një gjë, se pa mësuar nuk mund t'i përbushim dot detyrat e rënda që na vihen përpara, dhe në këtë lëmë ne jemi mjافت prapa. E kaluara jonë, përsa i përket kulturës dhe arësimit, ka qenë e vajtueshme. Por të rinxve tanë s'u mungon as vullneti, as zgjuarësia për ta zhdukur këtë situatë. Reforma e re e arësimit, reformë nga më përparimtaret, do të kontribuojë fuqimisht për krijimin e një brezi të ri të pajisur me principe të shëndosha shkencore dhe politike, që kanë për

qëllim të vetëm përparimin e vendit dhe përmirësimin e jetës së popullit. Ju të rinjtë duhet të mobilizoheni të gjithë për aplikimin si duhet të kësaj reforme të madhe që bëhet në interesin tuaj dhe të gjithë vendit. Të interesohesh për aplikimin e kësaj reforme të madhe arësimore do të thotë t'u vini gjoksin mësimeve, ta përvetësoni kulturën dhe ta përhapni kudo, të ndihmoni me çdo mjet luftën kundër analafabetizmit, të përkrahni çdo institut arësimor e kultural. Në këtë drejtim organizata juaj duhet t'ja lehtësojë punën pushtetit. Kur ju ta keni kuptuar mirë këtë detyrë të madhe, atëherë çdo gjë do t'ju duket më e lehtë. Forcat tuaja për ndërtimin e atdheut do të shumëfishohen dhe pozitat e demokracisë dhe të Republikës sonë do të forcohen edhe më shumë. Ju dhatë çdo gjë pa u kursyer për Republikën tonë Popullore, ku ju fituat të gjitha të drejtat. Jeta është juaja, e ardhmja është juaja, ju jeni një faktor kryesor që do ta ndërtoni jetën e re të lumtur.

Përveç mësimit dhe kulturës, që ju duhet t'u vini rëndësinë më të madhe, duhet të mos harroni kurrë sakrificat që bën populli për ju, për t'ju mësuar, për t'ju edukuar. Këto sakrifica janë të përbashkëta dhe tok do t'i kapërcejmë. Dua të them se vështirësive ekonomike që na dalin përpara, ne do t'u gjejmë zgjidhjen me një punë intensive të organizuar. Në ngritjen e ekonomisë sonë ju keni përsëri detyra të rënda dhe këtu është e domosdoshme ndihma juaj. Ne kemi ngritur shumë gjëra, ne kemi ndërtuar ura, rrugë, fabrika etj. Ne po ndërtojmë shkolla e spitale; ne i kemi vënë rëndësinë më të madhe bujqësisë, por këto që kemi bërë s'janë të mjafta dhe nuk duhet të na kënaqin, prandaj

ne duhet të nderim të gjitha forcat tona në lëmin e rindërtimit. Çdo gjë do të bëhet me sistem që rinia të mësojë, e të punojë njëkohësisht dhejeta e saj të bëhet dita-ditës më e mirë, më e lumtur. Këtu të vëmë të gjitha forcat tona. Ne nuk do të lejojmë kurrë që të abuzohet me forcat e rinisë sonë, pse ato janë thesaret më të çmuara të vendit tonë, atje bazohet e ardhmja e vendit tonë.

Unë dua të përfundoj duke ju uruar sukses të madh në punë dhe duke ju këshilluar të ruani këtë hov të madh revolucionar që zjen në ju dhe ta shtonit dita-ditës; të shtonit entuziazmin që ju karakterizon në çdo punë tuajën; kështu ne do të ndërtojmë një Shqipëri të re, një jetë të lumtur, kështu çdo orvatje e armiqve të vendit do të dështojë. Populli ndjek me kujdes punimet e kongresit tuaj, ju gëzoni dashurinë dhe admirimin e gjithë popullit në veprën tuaj përparimtare; ai është me ju, me bijtë e tij të shtrenjtë.

Rroftë populli shqiptar dhe rinia e tij heroike!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 561,
17 tetor 1946*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 561,
17 tetor 1946*

TELEGGRAM

SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM
TË ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA
ME ANËN E TË CILIT PROTESTOHET PËR MOSPRA-
NIMIN E SHQIPËRISE NË OKB

18 tetor 1946

ZOTIT TRYGVE LI, SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA E PËR
DIJENI KËSHILLIT TË SIGURIMIT

Nju Jork

Në emër të popullit shqiptar dhe të qeverisë së tij kam nderin t'Ju paraqes sa vijon: Në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit më datë 29 gusht 1946 Shqipëria u pranua me pesë vota pro dhe tri kundër në radhën e atyre shteteve, që do t'i paraqiten mbledhjes plenare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, për t'u pranuar si anëtare efektive të asaj organizate të lartë. Por, me hidhërim të madh, populli shqiptar pa se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Anglia përdorën fuqinë e vetos kundrejt kësaj të drejte të merituar dhe të fituar me gjak e me sakrifica nga ana e popullit shqiptar dhe

Shqipëria u hoq nga lista e shteteve që do të rekomanoheshin për anëtarë.

Vendimi i lartpërmendur i Këshillit të Sigurimit është një vendim i padrejtë dhe jo i merituar për vendin tonë, i cili luftoi me heroizmin dhe vetëmohimin më të madh kundër fashizmit italo-gjerman, sakrifikoi aq shumë për kauzën e përbashkët aleate dhe është një nga shtetet e vegjël të Evropës, që me sigurinë më të madhe do t'i përmbushë dhe do t'i mbrojë detyrimet e Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ashtu sikundër i përmbushi me nder të gjitha detyrimet që u viheshin përpara kombeve përparimtare të botës në luftë kundër fashizmit.

Duke u mbështetur në të drejtat e tija të pamohueshme dhe të padiskutueshme dhe duke shpresuar kurdoherë në një drejtësi më të mirë nga ana e shteteve aleate, populli shqiptar kërkon, me anën tonë, që të keni mirësinë dhe të vini çështjen e pranimit tonë në rendin e ditës të mbledhjes plenare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara që do të mbahet së shpejti, të hiqet vetoja jo e drejtë që i është vënë pranimit tonë si anëtarë efektive, dhe Shqipëria të pranohet anëtarë me të drejta të plota në atë organizatë të lartë. Shqipëria, që ka luftuar kaq vjet me radhë dhe që sot ka marrëdhënje diplomatike me shumë shtete që janë nga shtyllat më të shëndosha të mbrojtjes së paqes dhe anëtarë të shqar të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, shpreson se e drejta e saj do t'i jepet.

Kemi nderin gjithashtu t'Ju vëmë në dijeni që delegojmë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara me cilësinë e dëgjuesit, përfaqësuesit tanë zyrtarë zz. Hysni

Kapo, Ministër fuqipotë i Shqipërisë në Beograd dhe Behar Shtylla, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë.

Kryetari i Qeverisë së
Republikës Popullore të Shqipërisë
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 562,
18 tetor 1946*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 562,
18 tetor 1946*

MESAZHI TË RINJVE VULLNETARE TË RRUGËS KUKËS-PESHKOPI

27 tector 1946

Të dashur shokë dhe shoqe të rinisë që ndërtuat rrugën Kukës-Peshkopi,

E prisja me padurim këtë ditë të vija t'ju shihja dhe të gëzohesha me ju për suksesin e madh që korrët në fushën e rindërtimit të atdheut, por furtuna dhe shiu i tmerrshëm që shpërthyen në mbrëmjen e datës 23 e dëmet që u shkaktuan më kthyen nga rruga kur isha nisur për te ju. Detyrat qeveritare urgjente më penguan të nisësha përsëri, dhe unë e di se ju do të më kuptoni, por të jeni të sigurt se mendimet e mia më të mira dhe zemra ime është atje te ju, te ju që fituat, te ju që s' ka asnijë dyshim se do të fitoni kurdoherë, sepse në shpirtin tuaj keni të zhvilluar më tepër se kushdo tjetër ndjenjën e patriotizmit, të vetëmohimit dhe të sakrificës. Për juve të rintjtë e vendit tonë këto ndjenja s'janë gjëra abstrakte, por janë të lidhura ngushtë dhe fort me luftën, me përpjekjet, me dëshirat, me shpresat, me realizimet, me perspektivën tonë për ndërtimin e një jete të lumtur për brezat e rinj të vendit tonë dhe për mbarë popullin

shqiptar. Pa i pasë pasur këto ndjenja të zhvilluara në shkallën më të lartë, ashtu si i keni ju, ishte e pamundur të bëhej dhe të fitohej Lufta nacional-çlirimtare që i dha Shqipërisë lirinë, indipendencën, sovranitetin; gjithashtu janë po këto ndjenja që na bëjnë të fortë dhe të pamposhtur në ndërtimin e jetës sonë të lumtur. Ju, djem të rinj dhe ju vajza të reja, që luftuat si luanë ndër ato male, ku latë me mijëra të vrarë nga shokët tuaj më të mirë, sot po derdhni djersën tuaj për të vazduar rrugën e lavdishme të vaditur me gjakun e dëshmorëve tanë. Ashtu si luftuat me vetëmohim, ashtu po punoni edhe tani për një qëllim: Për Shqipërinë, për popullin. Për Shqipërinë, për popullin sakrificat më të mëdha s'janë kurrë të mjaftueshme. Këtë ju e keni kuptuar më së miri, kjo ju vë juve në pararojë dhe, për këtë gjë, populli ynë ju ka rrethuar me dashurinë dhe me dhëmshurinë më të madhe.

Por gjëzimi im do të ishte edhe më i madh sikur të ndodhesha edhe një herë në krahinat e Veriut të Shqipërisë, ndër ato vende dhe në mes të vëllezërve të Veriut, që kanë vuajtur shekuj me radhë në mjerime të patreguara të shkaktuara nga okupatorët e huaj dhe nga gjakpirësit vendas. Gjithë Shqipëria ka vuajtur të zezat e ullirit, por veçanërisht malësorët tanë të Veriut. Ndër ato vende kaq bujare, mbi ata malësorë kreshnikë, sundonte forca e bajraktarëve dhe e feudalëve, sundonte ligji gjakatar i tyre. Populli për këta bajraktarë hajdutë ishte skllav, ishte kafsha e punës dhe e mundimeve, ishte plaçka e tregut. Bajraktarët dhe bejlerët shtypës, priftërinjtë dhe hoxhallarët që i shërbën krimit, vrasjeve, intrigave dhe vjedhjeve, sundonin mbi të mjerin shqiptar

të Veriut. Çdo familje ishte në mëshirën e kanunit barbar, të intrigave të priftërinjve që bastardonin çdo ndjenjë të pastër, çdo zakon të vyer, që shkatërronin familjen, nderin e saj, ekonominë e saj. Dhe lufta u ndez në Shqipëri, lufta e shenjtë e çlirimt, ajo u rrit, u zmadhua, u bë e tmerrshme për armikun e huaj dhe për armiqtë e brendshëm të popullit shqiptar. Ata që luftonin në Shqipërinë e Jugut dhe në Shqipërinë e Veriut, kundër okupatorit dhe tradhëtarëve, ata që udhëhoqën këtë luftë çlirimtare, ata që ranë në fushën e ndërit, nuk mendonin: toskë e gegë, katolikë, ortodoksë e muslimanë, ata mendonin për çlirimin e një Shqipërie të vetme, për shpëtimin e një populli të vetëm dhe të bashkuar si një trup. Po kish ardhur koha që populli të thoshte fjalën e tij dhe e tha. Forca e popullit është e madhërishme dhe e pathyeshme. As intrigat e bajraktarëve gjakpirës dhe të priftërinjve, as bajonetat e armikut të huaj, mbështetja e vetme e tyre, nuk e ndalën hovin e madh revolucionar të popullit tonë të bashkuar. «Mos më shkelni në tokat e mia», bërtiste tradhëtar Bazi i Canës, agjent i armikut okupator dhe këlysh i Ahmet Zogollit, po partizanët heroikë e përlanë atë dhe mercenarët e tij brenda tri orëve. Po kështu bërtitnin, nga prehri i gjermanëve, tradhëtarët Gjon Marka Gjoni, Muhamrem Bajraktari, Fiqri Dine e të tjerë. Por brigadat e ushtrisë sonë të lavdishme. brigadat e popullit shqiptar, me një hov që s'është parë kurrë në historinë shekulllore të vendit tonë, përshkuan si rrufeja këto male duke ndjekur këmba-këmbës gjermanët dhe bajraktarët tradhëtarë e armiq të popullit. U vranë me mijëra shokë; ndër këto vende rrreth e rrotull ranë heroikisht Nazmi Rushiti nga

Dovolani, Demir Gashi dhe Riza Doda nga Reçi, Hasan Luma nga Peshkopia, Mexhit Tola nga Ostreni, Ahmet Cami nga Zerqani e shumë e shumë të tjerë. Por u çlirua Shqipëria e Veriut, u çlirua gjithë Shqipëria, populli mori frymë. Më kujtohet si tani një episod i kësaj lufte të madhe. Isha në malet e Korçës dhe në kohën kur forcat e ushtrisë sonë po ndiqnin këmba-këmbës mbeturinat e gjermanëve dhe të bajraktarëve përmes Mirditës, në Shtabin tonë kryesor ndodhej dhe një partizan plak prej Mirdite. Një mëngjez e shoh këtë partizan plak prej Mirdite të vijë me vrap te unë dhe të më thotë me një frymë: «Shoku Komandant, kullat e Gjon Marka Gjonit u banë shkrumb e hi». Sytë i ndritnin nga gjëzimi, ai ishte krejt i ndryshuar; për të lufta kishte mbaruar dhe ishte fituar. Unë vëreja supet e tij që pa u menduar i lëvizte pa pushim. Po, pa u menduar ai lëvizte supet sepse i ndjente të lehta; barra e rëndë shekullore e bajraktarit Gjon Marka Gjonit, që ai e simbolizonte me kullat e Oroshit, kishte rënë dhe ishte zhdukur përgjithmonë. «Sulltani s'kish muejt dot me i djegë këto kulla, por shokët tanë i rrafshuen», vazhdonte të më thoshte partizani plak prej Mirdite. Tok me fashizmin okupator mori fund përgjithmonë mbretërimi barbar i Gjon Marka Gjonit dhe i priftërinjve që e ndihmonin, mori fund përgjithmonë sundimi dhe terrori i Muhamrem Bajraktarit, i Fiqri Dines, i Pashuk Bibës, i Maliq Bushatit, i Prenk Calit e të tjerë banditë. Shqipëria tani është e popullit dhe vetëm e popullit, i cili ka fuqinë në dorë dhc askush nuk do të jetë në gjendje t'ja rrëmbejë. Këtë duhet ta kuptojnë dhe ta ndjejnë thellë vëllezërit tanë të Veriut. Në Shqipërinë e re nuk ka qeveri toskësh, por

ka qeveri të popullit, për të cilën shqiptarët janë njësoj; në Shqipëri nuk sundojnë toskët, sikundër shpifin mbe-turinat e fashizmit ndër ato anë, për të mbajtur gjallë metodat e vjetra përqarëse dhe shtypëse. Në Shqipërinë e re sundon populli shqiptar: toskë ose gegë qoftë, musliman, katolik apo ortodoks, pa asnje dallim, pa asnje ndryshim. U zhduk përgjithmonë sundimi i njerëzve ose i klikave antipopullore. Duhet të vëmë gjithë forcat tona për t'ua bërë të qartë të gjithë njerëzve të Shqipërisë dhe veçanërisht në shumë raste njerëzve të Veriut se si dhe qysh sundon populli dhe vetëqeveriset. Këtu qëndron programi ynë, dhe këtë duhet ta zbatojmë rigorozisht dhe pa as më të voglin lëshim. Malësorët e Veriut duhet të kuptojnë mirë se tanë ata janë bërë zot të tokës, të fateve të tyre, se sot ka ardhur koha të vetëqeverisen, ta bëjnë ligjin vetë dhe ta zbatojnë vetë. Ata duhet të kuptojnë mirë ç'është pushteti i këshillave popullore dhe cilët janë ata njerëz që duhet të vënë në ato këshilla popullore. Çdo gjë do të zgjidhet, çdo gjë do të ecë në rrugën e mbarë të përparimit dhc jeta do të bëhet ditaditës më e mirë, në rast se ne e bëjmë të ndërgjegjshëm malësorin tonë për këtë armë të madhe që ai e ka fituar në regjimin e sotëm. Duhet të dimë se puna s'është aq e lehtë. Dhe nëse puna s'paraqitet aq e lehtë, sa paraqitet në Shqipërinë e Jugut, këtu s'është faji i malësorëve tanë. Këtë duhet ta kemi të qartë. Mercenarët e Jugut, vegla të verbëra të Lumo Skëndos dhe të Ali Këlçyrës, që me armë vritnin, pritnin dhe grabitnin popullin për të mbrojtur dhe për të ndihmuar veprën e armikut okupator, ishin njëmijë herë më shumë fajtorë se mercenarët e krimine-

lëve tradhëtarë, Halil Alisë dhe Mark Gjon Markut.

Banditët e Ali Këlcyrës dhe të shokëve të tij dinin pse luftonin, por i mjeri katundar i Fush-Alisë vritej për pesë napolona ose për një kapotë. Malësori i Veriut, që gënjehej nga bajraktarët dhe çohej e luftonte në Gjormin e Vlorës, habitej kur përtej shkëmbit i bërtiste partizani: «Hej vëlla, pse po më vret, unë po luftoj për Shqipërinë, për mua dhe për ty, kundër italianit që na ka shkelur, që po na grabit pasuritë, nderin, tokën». I mjeri malësor kur shihte se ndër kodrat ku kishin zënë pozicion partizanët valonte flamuri i Shqipërisë, atëhere ai e kuptonte se ishte në tokën shqiptare, dhe luftonte kundër shqiptarëve, kundër vëllezërve të tij, dhe jo kundër grekërvë, sikundërqë i kishin thënë bajraktarët e urryer. Kjo situatë ishte. Po vallë kjo situatë a ka ndryshuar në çdo skaj të Shqipërisë së Veriut? Unë them se ka përparime të mëdha. Por duhet punë e madhe, duhet patjetër që situata ekonomike, sociale, kulturale e krahanave të Veriut të ndryshojë qind për qind; katundari dhe punëtori i Veriut duhet të zhvillohen, të mësojnë, të shkruajnë e të lexojnë, të zhvillojnë njojuritë e tyre, pse kështu do të përmirësojnë jetën e tyre dhe do të bëhen të vlefshëm për atdheun. Katundari i Veriut duhet të ketë ndihmën më të madhe dhe përkrahjen më të madhe, pse konditat e së kaluarës e kanë lënë shumë pas atë; por ai është i zoti, i fortë, i zgjuar, të ecë përpara, të arrijë shokët dhe të bëhet një nga faktorët kryesorë të Shqipërisë së re. Kush humbet durimin, humbet edhe luftën, por njerëzit e Shqipërisë së re s'janë të kësaj kategorie. Ne dimë se që të arrijmë atje ku dëshirojmë, që malësori i Veriut të zërë vendin e merituar në Shqipërinë e re, do të hasim

mjaft pengesa, por të gjitha të kapërcyeshme. Zakonet dhe traditat e këqia, që janë të huaja për malësorin tonë, por që bajraktarët dhe njerëzit e tyre janë munduar t'ua bëjnë si një jetë të dytë, do t'i hasim në rrugë. Këtu duhet të tregojmë zotësi dhe zgjuarsi për t'i zhdukur sa më shpejt këto. Malësori të kuptojë dhe të shohë dëmin që i sjellin këto të këqia, të cilat ishin ngritur në sistem prej gjakpirësve të popullit, me qëllim që malësori dhe katundari të ishte kurdoherë raja i beut dhe i bajraktarit ose i ndonjë prifti reaksionar. Katundari dhe malësori i Veriut të kuptojë mirë se ne nuk përzihemi me kishën e as me xhaminë, se ne nuk e ndalojmë atë të besojë, por ne luftojmë ata priftërinj ose ata civilë që fenë ose zakonet e këqia i përdorin për të skllavëruar dhe për të grabitur katundarin dhe malësorin. Për një gjë të këtillë katundari dhe malësori është qind për qind me ne dhe jo me ata që e kanë gënjerë dhe i kanë pirë gjakun tërë jetën.

Të vëmë të gjithë forcat tona dhe të zhdukim injorancën në malësitë e Veriut, pse një gjë e tillë do t'ja kthjellojë horizontin malësorit tonë. Në këtë vepër të madhe përparimitare mbeturinat e bajraktarëve dhe të priftërinjve reaksionarë do të përpiken të na pengojnë. Këtu unë po ju them se nuk do të kemi mëshirë. Për këtë gjë s'pranojmë asnjë arësy, asnjë konditë. Ai që nuk do të dërgojë djalin ose vajzën në shkollë, do të dënohet rreptësisht. Të gjithë ata prapanikë ose priftërinj katolikë që do të tentojnë të gënjejnë malësorin për rëndësinë e shkollës dhe të arësimit, dhe do ta pengojnë atë që ta marrë këtë arësim, punët nuk do t'i kenë aspak mirë me ne. Kjo është e qartë. Sa dëshirë kanë malëso-

rët e Veriut për hapjen e sa më shumë shkollave, këtë e tregojnë kërkesat e panumërtë të tyre, këtë e tregojnë shkollat e reja që janë ngritur, këtë e tregon puna vetë e tyre se sa me dashuri po punojnë për ngritjen e këtyre shkollave. Po t'u hedhim një sy punimeve që janë bërë në gjithë krahinën e Shkodrës, të Kukësit dhe në vetë «Rrugën e Rinisë» do të shohim sa dëshirë të madhe ka populli të punojë kolektivisht, për përmirësimin e jetës së tij, që është forcimi i atdheut.

Të vëmë, pra, gjithë forcat tona për të ndërtuar Shqipérinë dhe jetën tonë të re, të vëmë energjitet, dituritë dhe zotësitë tona që Veriu i Shqipërisë të përparojë, që jeta e katundarit dhe e malësorit tonë të përmirësohet nga çdo pikëpamje, që ata të shohin ditë më të lumtura, që ata të gëzojnë jetën si duhet në Shqipérinë e lirë, në Shqipérinë e tyre, në Shqipérinë e re. Kësaj gjëje ne do t'ja arrijmë, pse kjo është dëshira dhe vullneti i gjithë popullit shqiptar, pse kjo është dëshira dhe qëllimi i Partisë Komuniste të Shqipërisë.

Shokë të rinisë,

Rruja që po inaugurojmë sot dhe që do të mbajë emrin tuaj të pavdekshëm, bën pjesë në planin tonë që sapo tregova më lart, prandaj ju meritoni mirënjojjen e gjithë popullit shqiptar dhe veçanërisht të gjithë krahinës që do t'i shërbejë kjo rrugë. A keni menduar sa shërbime i keni bërë atdheut dhe popullit vetëm me hapjen e kësaj rruge? Fitimet materiale dhe morale që ka Shqipëria e re nga vepra juaj janë të paçmueshme.

Kjo rrugë, që ju e ndërtuat me aq dashuri, do të jetë një faktor përparimi në gjithë këto krahina. Ç'fituan tjetër nga vepra juaj, që populli shqiptar i ndoqi punimet me aq vëmendje dhe dashuri? Ja pra: populli ynë tanë e ka të qartë se me këtë rini që ka ai, e ardhmja e tij e lumtur është e siguruar. Në kasolleth më të largëta të Malësissë së Veriut po flitet për ju, për veprën tuaj, për zotësinë tuaj që treguat. Muaj me radhë ju punuat duke kënduar dhe kënga juaj, entuziazmi juaj, elektrizoi gjithë Shqipërinë, forcoi shpresat dhe besimin, ngjalli ndërgjegjen në punë. A mendoni pak se ç'efekte morale ka bërë puna juaj në krahinat e Veriut? Ai malësori, qëjeta e tij ishte një varr, kalon këtej dhe sheh një mizëri të rinjsh që çajnë malet me këngë në gojë. Por, «për kë punojnë këta njerëz?» — pyet malësori: — Për popullin e Veriut, për t'i lehtësuar vuajtjet malësorit, për ta ndihmuar të ngrihet dhe të përparojë, për ta bërë jetën e tij më të lumtur. — «Nga janë këta të rinj?» — pyet përsëri ai. — Ata janë nga të gjitha anët e Shqipërisë, ata janë katundarë, punëtorë, shkollarë, ata janë gjithë Shqipëria që punon si një trup dhe për një qëllim: për popullin, për atdheun. Dhe malësori i Veriut, sikundër malësori i Jugut, mendon dhe nxjerr këto konkluzione të veta: «Forca qëndron në bashkimin e çelniktë; përparimi dhe mirëqenja i ka bazat në punën e ndërgjegjshme, të pallodhur dhe të organizuar; një bashkim i tillë dhe një punë e tillë bëhen vetëm në Shqipërinë e re, në Shqipërinë e popullit». Të kemi sigurinë më të madhe se çdo shqiptar i ndershëm e ka bërë këtë hap të madh në rrugën e re të përparimit; na mbetet të ecim me këtë vrull që ja kemi nisur dhe ne do të ecim dhe do të përparojmë.

Shokë të dashur të rinisë,

Ju po ktheheni fitimtarë në familjet tuaja, por unë e di që s'jeni nga ata njerëz që t'ju dehin fitoret dhe t'ju zërë gjumi mbi dafina, ju e dini mirë rolin që luani në Shqipërinë e re, si edhe detyrat e reja që ju presin dhe që delegatët tuaj dhe të gjithë Rinisë Popullore të Shqipërisë i përcaktuan aq mirë e qartë në Kongresin e tyre të tretë që sapo mori fund. Ju uroj suksese nga zemra në punë dhe në jetë, t'i kryeni detyrat tuaja me nder ashtu sikundër i keni kryer të gjitha deri tani. Atdheu ju është mirënjoħes. Qeveria që kryesoj ju çon urimet më të nxehtha dhe ju siguron përkrahjen e pakufishme në çdo fushë të aktivitetit tuaj.

Rrofshin shokët dhe shoqet e rinisë që punuan në rrugën Kukës-Peshkopi!

Rroftë Rinia Popullore e Shqipërisë!

Rroftë populli shqiptar!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 570,
27 tetor 1946*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

TELEGRAM

SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA, ME ANËN E TË CILIT PROTESTOHET PËR SHKELJEN E UJERAVE TERRITORIALE DHE TË HAPËSIRËS AJRORE TË RPSH NGA FORCAT USHTARAKO-DETARE DHE USHTARAKO-AJRORE TË ANGLISE

30 tetor 1946

SHKËLQESËS SË TIJ TRYGVE LI, SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA

Nju Jork

Kam nderin t'Ju parashtroj Juve dhe nëpërmjet Jush, Asamblesë së Lartë të Kombeve të Bashkuara sa vijon:

Më datën 22.10.1946 në orën 13,00 katër luftanije engleze, të armatosura me topa, mitraloza dhe ushtarë hynë në ujërat tona territoriale të Sarandës, të Kakomesë dhe të Borshit pa pasur lejen nga qeveria shqiptare. Njëra prej këtyre luftanijeve, që mbante numrin R. 62 e pasuar nga një luftanije e dytë me Nr. R.41, hynë në gjirin e Sarandës, brenda në ujërat tona, në një largësi

prej 1,5 km. prej skelës, kurse dy anijet e tjera lundronin në ujërat tona territoriale përballë Kakomesë dhe Borshit, në veri të portit të Sarandës. Një vedetë e marinës bregdetare shqiptare, shkoi në drejtim të luftanive në fjalë, për të kërkuar arësyen e shkeljes së ujërave tona territoriale dhe për të dhënë ndihmën e nevojshme, se në njëren prej këtyre luftanive u duk të delte tym e flakë. Ekuipazhi i luftanijes britanike në fjalë, nuk denjoi t'u jepte asnje shpjegim marinarëve shqiptarë për këtë shkelje flagrante të integritetit të vendit tonë. Në orën 0,30' të mesnatës të katër luftanijet britanike u kthyen në limanin e Korfuzit.

Kemi nderin të theksojmë se në një interval jo shumë të gjatë, inkursione të tillë provokuese nga ana e luftanive britanike në ujërat tona territoriale janë përsëritur për të dytën herë dhe që të dy herët është tentuar të krijohen incidente, dhe është cënuar integriteti i vendit tonë. Nga ana tjetër, pas ngjarjes së datës 22.10.1946 dhe pikërisht në datën 23.10.1946, në mëngjez, pa lejën e qeverisë shqiptare, dhe në shenjë frikësimi dhe provokimi, aeroplana britanikë tremotorësh, njëri prej të cilëve mbante numrin PK 4, fluturuan në sektron që prej Qafës së Muzinës e deri në fshatin Radat. Në datën 23.10.1946 në qellin e portit të Sarandës, tri herë rresht, kanë fluturuar shumë ulët dy aeroplanë të tjerë anglezë.

Në emër të popullit shqiptar dhe të qeverisë së tij protestojmë energjikisht, pranë Jush dhe pranë Asamblesë së Kombeve të Bashkuara, për inkursione të tillë provokuese që i bëhen njëra pas tjetrës vendit të një populli heroik që luftoi dhe u sakrifikuva për kauzën e

përbashkët aleate, dhe që ka vënë gjithë forcat e tija; për ndërtimin e vendit të shkatërruar, për forcimin e një demokracie të vërtetë dhe për mbrojtjen e paqes në botë. S'mjaftojnë padrejtësitë e njëpasnjëshme që i bëhen popullit tonë në të drejtat e tija ndërkomëtare të fituara me gjak, por tentohet gjithashtu të krijojen incidente, si ato të lartpërmendurat, për të penguar vendin tonë të shkojë në rrugën e përparimit që ai i ka caktuar vetes. Nga ana tjetër ne theksojmë se ngjarje të tilla si këto të Sarandës, dhe që kanë për qëllim flagrant cënimin e integritetit të vendit tonë, nuk shërbejnë aspak për rivendosjen e marrëdhënjeve miqësore në mes të popujve paqedashës e përparimtarë, po përkundrazi shërbejnë për të dëmtuar paqen dhe miqësinë që duhet të krijohet dhe të forcohet dita-ditës në mes të popujve për të mirën e njerëzimit përparimtar. Populli shqiptar, është një popull i vogël, por paqedashës që dha prova të mëdha në luftën antifashiste se sa të shtrenjta ishin për të liria, indipendenca, sovraniteti dhe integriteti tokësor i tij. Për t'i fituar këto ai luftoi me heroizëm të madh dhe do të dijë t'i ruajë përgjithmonë e nuk do të lejojë t'ja cënojnë të tjerët. Populli shqiptar, i cili luftoi me abnegacionin më të madh për qëllimet e shenjta që duhet të mbrojë, t'i mbajë gjallë e t'i forcojë Organizata e Kombeve të Bashkuara, ka besim te kjo organizatë e lartë dhe kërkon prej Jush dhe prej Organizatës së Kombeve të Bashkuara që të ndërhyjë dhe t'u jepet fund provokacioneve të tilla që i bëhen vendit tonë. Këto provokacione dëmtojnë miqësinë e ngushtë dhe të singertë që duhet të ekzistojë në mes popujve paqedashës dhe rrezikojnë vendosjen e një paqe të shëndoshë e të vazhduesh-

me, për të cilën populli shqiptar s'do të mungojë asnje çast të japë kontributin e tij.

Kryeministri i Republikës Popullore të
Shqipërisë
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 572,
30 tetor 1946*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 572,
30 tetor 1946*

TELEGGRAM

SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË
ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA ME
ANËN E TË CILIT PROTESTOHET PËR PROVOKA-
CIONET E MONARKO-FASHISTËVE GREKË

30 tetor 1946

SHKËLQESISE SË TIJ TRYGVE LI, SEKRETAR
I PËRGJITHSHËM I ORGANIZATËS SË KOMBEVE
TË BASHKUARA

Nju Jork

Kam nderin t'Ju parashtroj Juve si dhe Asamblesë
së Kombeve të Bashkuara sa vijon:

Provokacionet e kurdisura nga monarko-fashistët
grekë dhe bandat e tyre të rregullta, po vazhdojnë të
bëhen më të dendura gjatë kufirit tonë të Jugut. Këto
provokacione me armë kanë filluar që prej çlirimit të
Shqipërisë nga okupatori dhe po vazhdojnë me një ritëm
të shtuar. Në mes të provokacioneve të tjera të panu-
mërtë, afro katër muaj më parë ne kemi sqaruar opini-
onin botëror rrëth provokimit në fshatin Radat, ku
forcat e rregullta greke sulmuan tokën tonë, më 5 dhe

7 korrik të këtij viti. Ushtari grek Jorgo Jotaqis, që u zu rob në tokën tonë, nxori në shesh para gjithë botës të vërtetën për prejatitjen e provokacionit në kufirin tonë nga ana e neofashistëve grekë.

Por këto nuk mjaftuan, dhe neofashistët grekë kurdisën një provokacion të ri. Më datën 21 të këtij muaji, në orën 16,30' në sektorin e kufirit të Konispolit në piramidën Nr. 54 afër katundit Vërvë, hyri në tokën tonë një patrullë greke prej dy vetësh. Në thirrjen e parë të patrullës sonë, ata ju përgjegjën me armë. Nga ana e kufirit grek filloj menjëherë zjarri i mitralozit të rëndë dhe më vonë një numër i konsiderueshëm ushtarësh grekë hynë në tokën tonë në një thellësi prej 200-300 metrash. Pas përpjekjes, grekët u detyruan të tërhiqen dhe lanë në tokën tonë një të vrarë dhe një ushtar tjetër grek që u zu rob prej forcave tona që quhet Jorgo Kristo Jani, nga katundi Sitarja e Pagonit grek. Jorgo Kristo Jani është efektiv i batalionit 582 dhe ai ka dekluaruar botërisht se ky sulm ishte urdhëruar nga komanda e batalionit në fjalë, për të goditur rojet e kufirit shqiptar dhe për të mbajtur gjallë situatën se gjoja shqiptarët bëjnë provokacione kundër Greqisë.

Ne i tërheqim vëmendjen Organizatës së Kombeve të Bashkuara për një situatë të tillë që monarko-fashistët grekë, me çdo mjet, kërkojnë të mbajnë gjallë. Ne kërkojmë nga ajo organizatë e lartë që të ndërhyjë kundër këtyre veprave kriminale që cënojnë tokën tonë, punën dhe nderin e popullit tonë paqedashës. Ne protestojmë energjikisht pranë jush dhe pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara, për këto akte të poshtra nga ana e fashistëve grekë, akte që kanë për qëllim të turbullojnë

ujërat në kufirin tonë të Jugut dhe që përbëjnë me sigrinë më të madhe një rrezik serioz për paqen në Ballkan dhe në botë. Populli shqiptar ka besim në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe në vendosjen e një paqeje të drejtë dhe të vazhdueshme në botë. Nga ana e vet populli shqiptar, do të mbrojë me vendosjen më të madhe, lirinë, indipendencën dhe integritetin e vendit të tij, nga çdo kërcënim i jashtëm, pse kështu ai është i sigurtë se ka mbrojtur jetën e tij dhe paqen dhe ka ndihmuar në forcimin e miqësisë ndërmjet popujve përparimtarë dhe demokratë.

Kryeministri i Republikës Popullore të
Shqipërisë
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 572,
30 tetor 1946*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 572,
30 tetor 1946*

TELEGGRAM

SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË
ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA
ME ANËN E TË CILIT PROTESTOHET KUNDER
SHKELJES SË UJERAVE TERRITORIALE TË RPSH
NË KANALIN E KORFUZIT NGA LUFTANIJET E
BRITANISE SË MADHE DHE KUNDER HYRJES SË
LUFTANIJEVE TË SHBA NË PORTIN E DURRËSIT
PA PËLQIMIN E QEVERISË SË RPSH

11 nëntor 1946

SHKËLQESISË SË TIJ TRYGVE LI, SEKRETAR
I PËRGJITHSHËM I ORGANIZATËS SË KOMBEVE
TË BASHKUARA

Nju Jork

Qeveria britanike më datën 10 nëntor 1946, me
ndërmjetësinë e ambasadës së saj në Beograd i njoftoi
qeverisë sonë se më 12 nëntor ka vendosur të pastrojë
kanalin e Korfuzit, sipas vendimit të marrë mbi këtë
çështje nga Komiteti qendror për pastrimin e minave.

Me një notë më datë 31 tetor, ne i kemi njoftuar
qeverisë britanike se, me përjashtim të ujërave territoriale
shqiptare, qeveria e Republikës sonë nuk sheh asnjë
pengesë që ujërat të pastrohen, po që çdo inkursion

anijesh të huaja në ujërat tona territoriale pa lejen e qeverisë sonë do të konsiderohej si një akt jomiqësor dhe do të shkelte sovranitetin e Shqipërisë.

Me notën e mësipërme qeveria angleze deshi ta vinte Shqipërinë përparrë një fakti të kryer, prandaj ne protestojmë energjikisht pranë OKB-së për këtë akt unilateral.

Nga ana tjetër ne nuk e njohim Komitetin qendror për pastrimin e minave që ka uzurpuar të gjitha të drejtat dhe që s'ka denjuar të konsultohet me qeverinë shqiptare për ndërmarrjen e punimeve të pastrimit në kanalin, ku Shqipëria ka të drejta të pamohueshme. Vëtëm një komision i dalë nga OKB-ja, ku të marrë pjesë dhe Shqipëria, mund të caktojë cilat janë ujërat jotorriale në kanalin e Korfuzit.

Në radhë të dytë, ne protestojmë energjikisht pranë OKB-së për insistimin që bën misioni amerikan në Shqipëri duke kërkuar të vijnë në portin e Durrësit dy anije lufte për të marrë këtë mision që do të niset nga Shqipëria. Ne e kemi autorizuar misionin amerikan që të sjellë në portin tonë një anije civile dhe tregëtarë dhe, në dashtë, i kemi lejuar të vijnë në aeroportin e Tiranës një ose dy aeroplani për transportin e personelit të misionit.

Kryetari i Qeverisë së RPSH
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 583,
12 nëntor 1946*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 583,
12 nëntor 1946*

T E L E G R A M

SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË
ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA
ME ANËN E TË CILIT PROTESTOHET KUNDËR
SHKELJES SË UJERAVE TERRITORIALE TË RPSH
NGA FORCAT USHTARAKO-DETARE TË ANGLISË

13 nëntor 1946

SHKËLQESISE SË TIJ TRYGVE LI, SEKRETAR
I PËRGJITHSHËM I ORGANIZATËS SË KOMBEVE
TË BASHKUARA

Nju Jork

Në lidhje me telegramin e protestës sonë më datën 11 nëntor 1946, kemi nderin t'Ju komunikojmë sa vijon:

Qysh më 12 nëntor në mëngjez një numër i madh anijesh lufte me flamurin anglez përshkuan në të gjitha drejtimet bregun tonë të Jugut të Shqipërisë, që nga Butrintoja gjer në Karaburun. Të gjitha anijet angleze në formacion lufte lundronin në ujërat tona territoriale dhe ekstra-territoriale në shenjë frikësimi dhe provokimi.

Sot, më 13 nëntor 1946, në orën 10 të mëngjezit dhe gjatë gjithë ditës, një numër i madh anijesh lufte dhe dragaminash angleze, numër që ndryshon në çdo orë nga 11 deri 23, hynë në ujërat tona territoriale të Sa-

randës në një largësi prej 1 500, 1 000, 500 metra nga porti me pretekst se pastronin minat. Nga anijet e luftës angleze, më çdo kohë, shkrehen batare mitralozash në ajër dhe në ujë, duke dashur kështu të krijojnë incidente.

Në emër të popullit shqiptar, paqësor dhe demokrat, në emër të këtij populli të vogël që, më 7 prill të vitit 1939, pa të dilnin në portin e Durrësit anijet e luftës të Musolinit, në emër të këtij populli të vogël që luftoi vjete me radhë me trimëri të pashoqe kundër fashizmit, përkrah aleatëve të mëdhenj dhe që la në fushat e betejave 50 000 të vrarë e të plagosur, i drejtohem Organizatës së Kombeve të Bashkuara për këtë akt brutal dhe unilateral nga ana e qeverisë britanike. Populli shqiptar e konsideron këtë akt si një shkelje të të drejtave të tija më të shenjta, të sovranitetit të tij, për të cilat populli shqiptar është kurdoherë gati të derdhë gjakun e tij. Nga ana tjetër, kërkoj nga Organizata e Kombeve të Bashkuara që ta gjykojë këtë akt të qeverisë angleze dhe të japë urdhërin e tërheqjes imediate të anijeve të luftës dhe të dragaminave angleze nga limanet tona dhe nga ujërat tonë territoriale, në interesin e ruajtjes së paqes, për të cilën populli shqiptar vuri të gjitha forcat për ta fituar.

Kryetari i Këshillit të Ministrave të Republikës
Popullore të Shqipërisë
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Bashkimi», Nr. 585,
14 nëntor 1946*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Bashkimi», Nr. 585,
14 nëntor 1946*

MESAZH PËRSHËNDETJEJE DREJTUAR POPULLIT SHQIPTAR ME RASTIN E VITIT TË RI

31 dhjetor 1946

Popull shqiptar, vëllezër dhe motra të dashura.

Në prakun e Vitit të ri, jam shumë i lumtur t'ju uroj nga zemra një vit plot gëzim e lumturi për të gjithë ju dhe për atdheun tonë të dashur.

Po hyjmë në vitin e tretë të një jete të lirë, të një Shqipërie të lirë indipendente, sovrane. Ne të gjithë e dimë sa vuajtje, sa mjerime dhe sa luftë të ashpër na u desh të bënim për t'ja arritur kësaj dite që gjëzojmë sot. sa njerëz nga më të mirët na u vranë, sa krahina na u bënë shkrumb e hi për të këputur zinxhirët e robërisë dhe për t'i dhënë fund përgjithmonë skllavërimi politik dhe ekonomik të vendit tonë. Këto s'duhet t'i harrojmë kurrë, s'na lejohet t'i harrojmë, pse atëhere do të harrojmë detyrat tona që na vihen përpala për të forcuar fitoret e luftës sonë të lavdishme, për ta bërë popullin dhe Shqipërinë tonë të lumtur. Zhvillimi dhe forcimi i demokracisë popullore në Shqipëri hyn në një fazë të re dhe vendimtare me Vitin e ri 1947, prandaj detyra të mëdha na presin, kryerja me sukses e të cilave do

të na sjellë fitore të reja në çdo lëmë aktiviteti të jetës sonë dhe në radhë të parë në forcimin dhe zhvillimin e regjimit tonë thellësisht demokratik, në ngritjen e një ekonomie të fortë dhe të planifikuar që të ecë krahas me këtë regjim. Arritja e këtyre fitoreve do të sjellë me vete ngritjen e standardit të jetës së popullit tonë, ta them më thjeshtë, do të sjellë ditë të bardha për vendin tonë.

Ne i kemi konditat që të shkojmë në këtë rrugë. Ekzistenca e pushtetit në duart e forta të popullit dhe që i dha mundësitetë të bëjë reforma të mëdha me karakter ekonomik dhe shoqëror jo vetëm që i ndryshoi krejtësisht faqen Shqipërisë, por përcaktoi qartazi rrugën e Shqipërisë së re, e Shqipërisë së popullit punëtor e të ndershëm. U krijuan rrethanat dhe konditat, të cilat do t'i shërbejnë popullit tonë për të ecur përpara në rrugën e ndërtimit të shpejtë të një ekonomie më të përparuar dhe të një jete më të lumtur. Një regjim politik i përparuar si yni, duhet të shkojë krahas me një ekonomi të përparuar. Që ta ngremë këtë ekonomi duhet të shfrytëzojmë të gjitha pasuritë e vendit tonë të mbitokës dhe të nëntokës me mënyra dhe metoda të reja. Në vitin 1947 përpara nesh hapen perspektiva të reja të një të ardhmeje më të mirë që vetë do ta ndërtojmë, me duart dhe me zotësinë tonë. Në planin e vitit 1947 parashikohen punime të mëdha si ndërtimi i rrugës së hekurt, forcimi dhe zhvillimi i bujqësisë sonë, bonifikime, ngritje centralesh elektrike, investime kapitalesh për zhvillimin dhe shfrytëzimin sa më të mirë të minierave tona, përmirësimin dhe ngritjen e disa fabrikave të reja, përvëç punimeve të tjera me karakter sekondar. Të gjitha këto

punime do të bëhen nga populli ynë dhe për interes të popullit. Prandaj për të siguruar jetën tonë, për t'u siguruar brezave tanë në të ardhmen një jetë më të begatshme na duhet të mobilizojmë të gjitha forcat tona për t'i kryer këto detyra të mëdha që na vihen përpara. Vepra të tilla si këto nuk mund të kryhen në rast se nuk do të kemi një organizim të fortë në punë dhe në rast se në radhët tona nuk do të ekzistojë e fortë ndërgjegjja në punë, rregulli dhe disiplina e shëndoshë. Kudo duhet të punohet me një rregull të fortë dhe me një kontroll të fortë. Gjithsecili duhet të kuptojë dhe ta kryejë mirë detyrën; te çdo njeri duhet të krijohet bindja se përmirësimi i jetës së tij është i lidhur me zbatimin sa më të mirë të detyrës që i është ngarkuar. Jeta e çdo njeriu shqiptar do të përmirësohet kur ai të përmirësojë punën e tij dhe këtë punë të dijë ta harmonizojë dhe ta koordinojë me gjithë aktivitetin e vendit dhe të shtetit. Klasa punëtore e vendit tonë ka nderin të luajë rolin kryesor, ajo duhet të jetë në ballë dhe shembull për të gjithë. Katundarët e Shqipërisë duhet të kuptojnë rolin e tyre në ndërtimin e ekonomisë së re, në ngritjen dhe zhvillimin e bujqësisë në forma të përparuara dhe të përshtatshme për regjimin tonë. Këta duhet të forcojnë aleancën dhe bashkëpunimin me klasën punëtore dhc me të gjitha shtresat e tjera punonjëse të qytetit. Ekonomia nü fshat nuk duhet të kuptohet e shkëputur nga ekonomia e qytetit, por e lidhur ngushtë me të me anë formash organizimi nga më të përparuarat sikundër janë kooperativat.

Një zhvillim i tillë përparimtar në Republikën Popullore të Shqipërisë ku ekziston një regjim thellësisht

demokratik dhe që përfaqëson gjakun dhe sakrificat tona, aspiratat qindravjeçare të popullit tonë të vogël, që ka vuajtur të zezat e ullirit nga shtypësit e huaj dhe të brendshëm, nuk u pëlqen rrtheve reaksionare të jashtme dhe disa qeverive të popujve aleatë të Perëndimit në mes të të cilave asaj angleze dhe amerikane: Kundrejt popullit tonë të vogël, demokrat dhe paqësor që luftoi me heroizëm kundër fashizmit, këto dy qeveri mbajnë një qëndrim jo të denjë për popujt e tyre. Politika e qeverisë amerikane kundrejt vendit tonë ka qenë një politikë notash diplomatike të pareshtura, me frymë kërcënuese, me ton frikësues dhe aspak miqësor. Qëndrimi i saj kundrejt të drejtave legjitime të popullit tonë ka qenë kurdoherë negativ dhe aspak i drejtë. Zyrtarët e saj në Shqipëri jo vetëm që s'kanë treguar një frymë miqësore, por u ka munguar dhe korrektesa kundrejt një populli sovran. Qëndrimi i qeverisë angleze ka qenë vëçanërisht fyes dhe jomiqësor. Frymës miqësore që u është treguar në çdo çast nga ana jonë ata i janë përgjegjur me një sëri notash plot shpifje dhe provokacione, me një sëri aktesh arbitrale, kërcënuese, frikësuese. Anijet e qeverisë britanike për tri herë rresht, në mënyrë brutale kanë shkelur sovranitetin e vendit tonë, ato kanë krijuar apostafat incidente në det për ta akuzuar popullin tonë për gjëra që ai s'ka as më të voglën përgjegjësi. Qeveria angleze e akuzon qeverinë shqiptare se gjoja kjo ka vënë mina në kanalin e Korfuzit dhe këtë e bën për t'i krijuar vendit tonë pengesa në të drejtat e tija në lëmin ndërkombëtar, për t'i kërkuar dëmshpërblime e të tjera gjëra të tillë. Qeveria britanike kanoset se do ta çojë çështjen e incidentit në kanalin e Korfuzit në

Këshillin e Sigurimit. Qeveria shqiptare çështjen e shkeljes së sovranitetit të saj për tri herë rrreshq nga ana e anijeve britanike e ka çuar më parë se qeveria angleze në Këshillin e Sigurimit dhe ne kërkojmë që të shqyrtohet sa më parë kërkesa jonë. Ne jemi gati të shkojmë në Këshillin e Sigurimit pse kemi shumë gjëra për të thënë dhe për t'i treguar botës. Këto fakte, për hir të miqësisë që na lidh me popullin anglez, ne nuk kemi dashur kurrë t'i zbulojmë, por ju siguroj se bota e përparruar do të çuditet, do të çuditet dhe populli anglez vetë me gjestet dhe veprimtarinë e zyrtarëve të tij kundrejt Shqipërisë. Nga ana jonë kemi bërë çmos dhe do të vazhdojmë që të arrihen marrëdhënje të përzemërtat në mes të popullit tonë dhe popujve miq e demokratë amerikanë dhe anglez, me të cilët na lidh një miqësi e vjetër që u përforcua gjatë kohës së luftës së përbashkët. Populli shqiptar dhe qeveria e tij dëshiron të kenë marrëdhënje të përzemërtat me të gjithë shtetet, qofshin këta të largët ose fqinjë. Qeveria shqiptare e frymëzuar nga këto qëllime, me kënaqësi e pranoi vendimin e Këshillit të Sigurimit për dërgimin e një komisioni për hetime në Greqi¹, pse ky është vendim i një instituti të lartë ndërkombëtar për të cilin populli ynë ka respekt. Ne do t'i japim çdo ndihmë që të kërkojë në rast se ai do të vijë në Shqipëri, ne s'kemi asgjë për të fshehur pse punët tona dhe qëndrimi ynë kundrejt Greqisë kanë qenë kurdoherë të qarta dhe shpifjet e akuzat që i bëhen vendit tonë s'kanë asnje themel.

¹ Është fjala për Komisionin hetimor që u krijua nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së më 19 dhjetor 1946, për të hetuar gjendjen në Greqi.

Popull shqiptar,

Në prakun e Vitit të ri ne duhet t'ja fillojmë punës me vrull, me ndërgjegje dhe heroizëm që karakterizojnë popullin tonë dhe rininë tonë. Do të punojmë pse ndërtojmë jetën tonë më të mirë, pse punojmë për veten tonë dhe për kalamajtë tanë. Në këtë ditë të Vitit të ri i gjithë populli ynë t'u drejtojë mirënjojen e tij të madhe popujve të Bashkimit Sovjetik dhe Stalinit të madh për miqësinë e ngushtë që ushqejnë për popullin tonë të vogël, për luftën e tyre heroike që shpëtoi njerëzimin nga robëria e fashizmit dhe për veprën e tyre të pavdekshme për ndërtimin dhe ruajtjen e paqes së njerëzimit.

Viti i ri ta gjejë gëzuar dhe të lumtur popullin tonë!

Rroftë populli shqiptar!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 626,
1 janar 1947*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

LËNDA

PARATHËNJE PËR VELLIMIN 3 V—VI

1945

NOTE DREJTUAR QEVERIVE TË SHTETEVE ALEATE, ANGLISË, BASHKIMIT SOVJETIK DHE AMERIKËS, NË EMËR TË QEVERISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË ME ANËN E SË CILËS KËRKOHET TË NJIHET QEVERIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË DHE TË VENDOSEN MARRËDHËNJE DIPLOMATIKE (4 janar 1945)	1—5
USHTRIA NACIONAL-ÇLIRIMTARE MBUROJA E POPULLIT DHE E ATDHEUT (24 janar 1945)	6—11
VASIL SHANTO (1 shkurt 1945)	12—14
PËRSHËNDETJE PIONIERËVE TË TIRANËS ME RASTIN E MANIFESTIMIT TË TYRE PËR JAVËN E RINISË BOTËRORE (27 mars 1945)	15—16
KËRKESË DREJTUAR TRE KRYETARËVE TË FUQIVE TË MËDHA: KRYEMINISTRIT ÇËRCILL, MARSHALIT STALIN DHE PRESIDENTIT RUZVELT NË LIDHJE ME PJESEMARRJEN E SHQIPËRISË NË KONFERENCËN E SAN-FRANÇISKOS (31 mars 1945)	17—18
FJALA NË KONGRESIN E DYTË TË RINISË (16 prill 1945)	19—38
RINIA NË LUFTË DHE NË PUNË (5 maj 1945)	39—45

MESAZH DREJTUAR POPULLIT SHQIPTAR ME RASTIN E DITËS SË FITORES MBI GJERMANINË HITLERIANE (10 maj 1945)	46—49
TELEGRAM DREJTUAR MARESHALIT TË BASHKIMIT SOVJETIK JOSIF STALINIT, PRESIDENT I KËSHILLIT TË KOMISARËVE TË POPULLIT, ME RASTIN E FITORES MBI GJERMANINË HITLERIANE (17 maj 1945)	50—51
FJALA NË HAPJEN E SHKOLLES SË PARTISE (25 maj 1945)	52—56
LETËR DËRGUAR PRESIDENTIT TË SHBA HERRI TRUMANIT NË LIDHJE ME TRAJTIMIN E MIRË QË U BËHET KRIMINELËVE SHQIPTARË TË LUFTËS NGA AUTORITETET ANGLO-AMERIKANE NË ITALI (1 qershor 1945)	57—58
SHOKU IM ALQI KONDI (1 korrik 1945)	59—62
URDHËR DITE DREJTUAR USHTRISË KOMBËTARE ME RASTIN E FESTËS SË KRIJIMIT TË SAJ (10 korrik 1945)	63—66
MESAZH DËRGUAR GJENERALISIMIT STALIN, KRYEMINISTRIT ÇËRCILL DHE PRESIDENTIT TRUMAN NË KONFERENCËN E POTSDAMIT ME ANËN E TË CILIT KËRKOHET NJOHJA E QEVERISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË (26 korrik 1945)	67—68
PËRSHËNDETJE NË EMËR TË QEVERISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË KONGRESIT TË PARË TË FRONTIT DEMOKRATIK (5 gusht 1945)	69—74
FJALA E MBAJTUR ME RASTIN E ZGJEDHJES PRESIDENT I FRONTIT DEMOKRATIK (8 gusht 1945)	75—76
FJALA E MBYLLJES NË KONGRESIN E PARË TË FRONTIT DEMOKRATIK (9 gusht 1945)	77—81

TA KUPTOJMË SI DUHET REFORMËN AGRARE (2 shtator 1945)	82—88
TELEGRAM KRYETARËVE TË QEVERTIVE TË TRI FUQIVE TË MËDHA: BRSS, ANGLI DHE SHBA ME ANËN E TË CILIT KËRKOHET PJESEMARRJA E SHQIPËRISË NË DISKUTIMIN E TRAKTATIT TË PAQES ME ITALINË (4 shtator 1945)	89—91
PËRGJEGJE MESAZHIT TË FAN S. NOLIT (25 shtator 1945)	92—93
RAPORT I MBAJTUR NË EMËR TË QEVERTISE DE- MOKRATIKE NË SESIONIN E TRETE TË KË- SHILLIT ANTIFASHIST NACIONAL-ÇLIRIMTAR (26 shtator 1945)	94—126
RAPORT I MBAJTUR NË PLENUMIN IV TË KO- MITETIT QENDROR TË PKSH (17 tetor 1945)	127—165
PËRSHËNDETJE NË KONGRESIN E PARË TË SIN- DIKATAVE (31 tetor 1945)	166—168
PËRGJEGJE TELEGRAMIT TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT TË GRUAS ANTIFASHISTE TË GJIRO- KASTRËS LIDHUR ME VËNJEN E KANDIDATURËS SË TIJ PËR DEPUTET NË QYTETIN E GJIROKAS- TRËS (6 nëntor 1945)	169
PËRGJEGJE AMBASADORIT POLONEZ NË BEO- GRAD NË LIDHJE ME NJOHJEN E QEVERTISE DE- MOKRATIKE TË SHQIPËRISË DHE VENDOSJEN E MARRËDHËNJEVE DIPLOMATIKE (7 nëntor 1945)	170—171
LETËR KRYETARIT TË MISIONIT USHTARAK SO- VJETIK NË TIRANË NË LIDHJE ME NJOHJEN E QEVERTISE DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË DHE VENDOSJEN E MARRËDHËNJEVE DIPLOMATIKE (10 nëntor 1945)	172—173

- PËRGJEGJE NOTËS SË KRYETARIT TË MISIONIT USHTARAK BRITANIK NË SHQIPËRI NË LIDHJE ME NJOHJEN E QEVERISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË NGA QEVERIA E BRITANISË SË MADHE (11 nëntor 1945) 174—176
- PËRGJEGJE NOTËS SË KRYETARIT TË MISIONIT AMERIKAN NË TIRANË NË LIDHJE ME NJOHJEN E QEVERISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË NGA QEVERIA E SHBA (17 nëntor 1945) 177—179
- FJALA NË MITINGUN E ORGANIZUAR NË KRYEQYTET ME RASTIN E PËRVJETORIT TË PARË TË CLIRIMIT TË TIRANËS (17 nëntor 1945) 180—188
- LETËR DREJTUAR KRYETARIT TË MISIONIT AMERIKAN NË SHQIPËRI LIDHUR ME RISHIKIMIN E TRAKTATEVE TË PERFUNDUARA NGA QEVERIA E ZOGUT ME QEVERINË E SHBA (23 nëntor 1945) 189—190
- FJALIM MBAJTUR NË FSHATIN GORE TË LUSHNJËS ME RASTIN E DHËNJES SË TAPIVE TË TOKAVE BUJQVE TË MYZEQESE (25 nëntor 1945) .. 191—195
- MESAZH DREJTUAR POPULLIT SHQIPTAR, ME ANË TË RADIOS, ME RASTIN E 33-VJETORIT TË SHPALLJES SË PAVARESISE (28 nëntor 1945) .. 196—202
- FJALA E MBAJTUR NË NJË KONFERENCË SHTYPI, ORGANIZUAR NË TIRANË PËR GAZETARET E HUAJ (3 dhjetor 1945) 203—212
- DEKLARATË SHEFIT TË INFORMATAVE TË RADIO SOFJES NË LIDHJE ME NJOHJEN E QEVERISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË NGA QEVERIA E BULLGARISË (20 dhjetor 1945) 213—214
- KËRKESË DREJTUAR KOMISIONIT PREGATITOR TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR PRANIMIN E

SHQIPËRISË NË OKB (20 dhjetor 1945)	215—216
PËRSHËNDETJE ME RASTIN E INAUGURIMIT TË DISTILERISE Nr. 3 NË KUÇOVË (22 dhjetor 1945) ..	217—220
KËRKOJMË TË NA DOREZOHEN KRIMINELET E LUFTËS (23 dhjetor 1945)	221—224

1946

REGJENTËT NË GJYQ (3 janar 1946)	225—228
FJALA NË ASAMBLENË KUSHTETUESE ME RASTIN E PARAQITJES SË DORËHEQJES SË QEVERISË (11 janar 1946)	229—231
INTERVISTË DHËNË KORRESPONDENTËVE TË KRYEQYTETIT (26 janar 1946)	232—237
INTERVISTË DHËNË GAZETËS «BASHKIMI» MBI DISKUTIMET NË LONDËR RRETH PRANIMIT TË SHQIPËRISË NË ORGANIZATËN E KOMBEVE TË BASHKUARA (31 janar 1946)	238—244
RAPORT I MBAJTUR NË PLENUMIN V TË KQ TË PKSH (21 shkurt 1946)	245—290
INTERVISTË DHËNË GAZETËS «BASHKIMI» RRETH PRETENDIMEVE GREKE NË KËSHILLIN E SIGURIMIT KUNDËR PRANIMIT TË SHQIPËRISË NË OKB (10 mars 1946)	291—295
LETËR DREJTUAR KRYESISË SË KËSHILLIT TË NËNMINISTRAVE TË PUNËVE TË JASHTME TË ANGLISË, TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS, TË BASHKIMIT TË REPUBLIKAVE SOCIALISTË SOVJETIKE E TË FRANCËS NË LIDHJE ME DËMSHPËRBLIMET QË ITALIA I DETYROHEJ SHQIPËRISË (20 mars 1946)	296—297

PROGRAMI I QEVERISË SË PARË TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË, PARAQITUR PARA KUVENDIT POPULLOR TË RPSH (24 mars 1946) ..	298—319
FJALA NË KUVENDIN POPULLOR ME RASTIN E EMËRIMIT KOMANDANT TË PËRGJITHSHËM TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË (26 mars 1946)	320—321
NOTE DËRGUAR J. E. XHEJKOBS, KRYETAR I MISIONIT TË SHBA NË SHQIPËRI, NË LIDHJE ME QËNDRIMIN ARMIQËSOR TË SENATIT AMERIKAN NDAJ SHQIPËRISË (12 prill 1946)	322—323
KËRKESË DREJTUAR KONFERENCES SË MINISTRAVE TË PUNËVE TË JASHTME NË PARIS, NË LIDHJE ME TË DREJTËN E SHQIPËRISË PËR TË MARRË PJESË NË DISKUTIMIN E TRAKTATIT TË PAQES ME ITALINË (27 prill 1946)	324—327
MESAZHE DREJTUAR FAN S. NOLIT PËR ÇËSH-TJEN E NJOHJES SË QEVERISË DEMOKRATIKE DHE MBROJTJEN E PAVARESISË SË SHQIPËRISË (prill 1946)	328—332
FJALIM I MBAJTUR PËRPARA PUNËTOREVE TË KUÇOVËS (1 maj 1946)	333—344
URDHËR DITE ME RASTIN E PËRVJETORIT TË PARE TË FITORES MBI GJERMANINË HITLERIANE (9 maj 1946)	345—349
KËRKESË DREJTUAR KONFERENCES SË MINISTRAVE TË PUNËVE TË JASHTME NË PARIS PËR T'I CAKTUAR REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË SI DËMSHPËRBLIM NJË PJESE TË FLOTËS ITALIANE (11 maj 1946)	350—351
INTERVISTË MBI AKSIONIN E MADH TË RINISE: RRUGËN PESHKOPI-BICAJ (18 maj 1946)	352—356

KËRKESË DREJTUAR KONFERENCËS SË MINISTRAVE TË PUNËVE TË JASHTME NË PARIS PËR RIATDHESIMIN E ÇAMËRVE (4 qershor 1946)	357—360
TEZAT PËR RISHIKIMIN E PLENUMIT II TË KQ TË PKSH (RAPORT I MBAJTUR NË MBLEDHJEN E BYROSË POLITIKE TË KQ TË PKSH) (9 qershor 1946)	361—395
MESAZH PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR SHQIPTARËVE QË JETOJNË NË SHBA (14 qershor 1946)	396—397
PËRSHËNDETJE NË KONGRESIN E DYTË TË BASHKIMIT TË GRAVE TË SHQIPËRISË (4 korrik 1946)	398—401
FJALA E MBAJTUR NË KONFERENCËN E INVALIDËVE (9 korrik 1946)	402—406
RELACION MBI PROJEKTLIGJIN E PËRGJITHSHËM TË KËSHILLAVE POPULLORE, MBAJTUR NË SEANCËN V TË KUVENDIT POPULLOR (5 gusht 1946)	407—419
FJALA E MBAJTUR NË KUVENDIN POPULLOR ME RASTIN E EMËRIMIT SI KRYETAR I DELEGACIONIT SHQIPTAR NË KONFERENCËN E PAQES (17 gusht 1946)	420
FJALIM I MBAJTUR NË SEANCËN PLENARE TË KONFERENCËS SË PAQES NË PARIS (21 gusht 1946)	421—445
DEKLARATË DHËNË PËRFAQËSUESVE TË SHTYPIT NË PARIS (16 shtator 1946)	446—449
FJALIM I MBAJTUR NË AEROPORTIN E TIRANËS ME RASTIN E KTHIMIT NGA KONFERENCA E PAQES (17 shtator 1946)	450—454
RAPORT MBI AKTIVITETIN DHE DETYRAT E REJA TË FRONTIT, MBAJTUR NË MBLEDHJEN E	

- DYTË TË KËSHILLIT TË PËRGJITHSHËM TË FRONTIT DEMOKRATIK (7 tetor 1946) 455—500
- FJALIM I MBAJTUR NË KONGRESIN E TRETË TË RINISË POPULLORE TË SHQIPËRISË (16 tetor 1946) 501—517
- TELEGRAM SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA ME ANËN E TË CILIT PROTESTOHET PËR MOS-PRANIMIN E SHQIPËRISË NË OKB (18 tetor 1946) 518—520
- MESAZHI TË RINJVE VULLNETARE TË RRUGËS KUKËS-PESHKOPI (27 tetor 1946) 521—530
- TELEGRAM SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA, ME ANËN E TË CILIT PROTESTOHET PËR SHKEL-JEN E UJERAVE TERRITORIALE DHE TË HAPË-SIRËS AJRORE TË RPSH NGA FORCAT USHTA-RAKO-DETARE DHE USHTARAKO-AJRORE TË ANGLISË (30 tetor 1946) 531—534
- TELEGRAM SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA ME ANËN E TË CILIT PROTESTOHET PËR PROVO-KACIONET E MONARKO-FASHISTËVE GREKE (30 tetor 1946) 535—537
- TELEGRAM SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA ME ANËN E TË CILIT PROTESTOHET KUNDER SHKELJES SË UJERAVE TERRITORIALE TË RPSH NË KANALIN E KORFUZIT NGA LUFTANIJET E BRITANISË SË MADHE DHE KUNDER HYRJES SË LUFTANIJEVE TË SHBA NË PORTIN E DURRËSIT PA PËLQIMIN E QEVERISË SË RPSH (11 nëntor 1946) 538—539
- TELEGRAM SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA ME ANËN E TË CILIT PROTESTOHET KUNDER

SHKELJES SË UJERAVE TERRITORIALE TË RPSH NGA FORCAT USHTARAKO-DETARE TË ANGLISË (13 nëntor 1946)	540—541
MESAZH PËRSHËNDETJEJE DREJTUAR POPULLIT SHQIPTAR ME RASTIN E VITIT TË RI (31 dhjetor 1946)	542—547